



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”, TIRANË

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I PËRPUTHSHMËRISË

NË

QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”,
TIRANË

Dhjetor 2023

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
1.Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2.Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	3
3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinionin e auditimit.....	21
II.HYRJA.....	24
1. Objekti i auditimit.....	24
2. Qëllimi i auditimit.....	25
3. Identifikimi i çështjes.....	25
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	25
5. Përgjegjësit e audituesve.....	26
6. Kriteret e vlerësimit.....	26
7. Standartet e auditimit.....	27
8. Metodatat e auditimit.....	27
9. Dokumentimi i auditimit.....	27
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	28
1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin.....	28
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	28
2.1. Planifikimi, realizimi dhe zbatimi i buxhetit.....	28-85
2.2. Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.....	85-113
2.3. Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime,etj).....	113-131
2.4. Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit, plotësimi i pasqyrave financiare në afat, si dhe dërgimi dhe miratimi në organet e vartësisë.....	131-178
2.5. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.....	178-306
2.6. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.....	307-323
2.7. Organizimi dhe funksionimi i protokoll arkivës në zbatim të Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe VKM Nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”.....	323-325
2.8. Organet drejtuese dhe vendimmarrja e tyre.....	325-335
2.9. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.....	335-348
2.10. Kryerja e shërbimit për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar) me barna të rimbursueshme nga shteti, për sëmundje tumorale dializë dhe transplant.....	348-369
2.11.Trajtimi i ankesës së shoqërisë “S.M.” sh.p.k., administruar në KLSH me Nr. 1331 prot., datë 07.12.2021 dhe Nr. 1331/1 prot., datë 09.12.2021	369-371
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	371-422

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë është Institucion Shëndetësor Publik Kombëtar mjekimi, mësimdhënieje dhe kërkimi shkencor. Drejtimi administrativ i QSUNT është në varësi të Bordit të Spitalit. Qendra Spitalore Universitare, sipas VKM Nr. 352, datë 09.09.1997, pika 5 është emëruar “Nënë Tereza” Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” është person juridik me zotësi të plotë për të vepruar.

Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", është e organizuar nga shërbimet universitare dhe njësi mjekësore, të cilat nga natyra e specialitetit mjekësor/klinik që trajtojnë, kanë lidhje funksionale me shërbimet shëndetësore universitare. Këto njësi realizojnë shërbime shëndetësore, funksione diagnostikuese e trajtuese.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Trajtimi i pacientëve ambulatorë me barna të rimbursueshme, për sëmundje tumorale, dializë dhe transplant.</p> <p>Për periudhën: 01.04.2021 deri më 31.12.2021, vlera e konsumit për rimbursim nga raportimi e-Rx është në vlerën 2,192,737,755.59 lekë, është likuiduar në vlerën 2,185,648,091 lekë.</p> <p>Për periudhën: 01.01.2022 deri më 31.12.2022, vlera e konsumit për rimbursim nga raportimi e-Rx është 3,280,487,262.14 lekë, është likuiduar në vlerën 3,280,404,118 lekë.</p> <p>Pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), paraqiten për të marrë shërbimin në QSUNT-së, sipas sistemit të referimit. Mbi bazën e këtij sistemi sipas sëmundjeve përkatëse, mjekët e QSUNT të kontraktuar nga FSDKSH, lëshojnë receta rimbursimi elektronike e-Rx, receta të cilat pasi kontrollohen nga Drejtorja e Administrimit të Paketave Shëndetësore dhe Ekzaminimet Terciare (drejtori e FSDKSH-së, e instaluar në QSUNT), konfirmohen dhe i kalojnë farmacisë për ekzekutim, dhënien e medikamenteve dhe pajisjeve mjekësore pacientëve për ekzekutim.</p> <p>Farmacia, me paraqitjen e pacientit me recetë të lëshuar nga mjeku dhe e konfirmuar nga Drejtorja e FSDKSH-së, e instaluar pranë QSUNT, bën ekzekutimin e recetës, duke i dhënë</p>	Pika 2.10, fq 348-369	E lartë	-Nga Drejtorët e Përgjithshëm QSUNT/FSDKSH ti kërkohet Ministrin të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale krijimi i mekanizmave efektiv për siguruar se palët përfituese jo vetëm duhet të respektojnë obligimet për arsyeshmërinë e plotë të shpenzimeve të subvencionuara/rimburësuar, por të vendosen dhe kontrollet e duhura me synim që bari/barnat për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), të regjistrohen dhe raportohen saktë në kontabilitet dhe pasqyrat financiare, për QSUNT por edhe për spitalet e tjera.

	<p>pacientit barin ose pajisjen mjekësore, por pa lënë asnjë gjurmë auditimi, pra nuk vërtetohet që bari ose pajisja është marrë nga pacienti, edhe pse këto barna dhe pajisje kanë çmim shumë të shtrenjtë.</p> <p>Kjo farmaci furnizohet nga importuesit, me faturë tatimore shitje (elektronike) sipas sistemit të fiskalizimit me NIPT të QSUNT dhe jo me NIPT të FSDKSH, fatura të cilat nuk bëhen hyrje në kontabilitetin e QSUNT, nuk bëhen hyrje dhe në kontabilitetin e FSDKSH, por bën hyrje në programin kompjuterik E-RX në postin që mundësohet nga farmacistët e QSUNT, pra në kontabilitet nuk regjistrohet ngjarja ekonomike.</p> <p>Barnat e furnizuara nga importuesit farmaceutikë, nuk merren në dorëzim nga grupi i ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm ose nga zyrtari i deleguar prej tij, siç bëhet dhe në farmacinë spitalore, por merren në dorëzim nga vetë punonjësit e farmacisë të sektorit të rimbursimit të barnave spitalore, edhe pse barnat dhe pajisjet mjekësore janë me çmime të shtrenjta.</p> <p>Në 31 kontratat trepalëshe të lidhura ndërmjet QSUNT-së, FSDKSH-së dhe Importuesve Farmaceutikë “Për rimbursimin e barnave të tregtuara në farmacinë e QSUNT-së dhe në marrëveshjet (kontratat) dypalëshe për reduktimin e çmimit të barnave të LBR që tregtohen në farmacitë e spitaleve nga mbajtësi i autorizimit për tregtim, të lidhura ndërmjet FSDKSH-së dhe Importuesve Farmaceutikë, nuk është përcaktuar:</p> <p>-Afati i skadencës: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.</p> <p>-Paketimi: Mbi çdo paketim duhet të jetë shënuar dhe vulosur mbishkrimi/pulla “Përdorim spitalor - ndalohet shitja”.</p> <p>Përcaktime që janë vendosur në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe procedurat e zhvilluara nga</p>		<p>- Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për pranimin e barnave nga Importuesit farmaceutikë, duke ngritur grupe pune për marrjen në dorëzim me qëllim jo vetëm kryerjen e tyre me specialist të fushave, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.</p> <p>- Nga drejtorët e përgjithshëm të QSUNT/FSDKSH, të merren masa për të rinegociuar kontratat/marrëveshjet në fuqi me Importuesit Farmaceutik, për të bërë amendimet përkatëse me qëllim për të përcaktuar:</p> <p>a. Afati i skadencës: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.</p> <p>b. Paketimi: Mbi çdo paketim duhet të jetë shënuar barnat duhet detyrimisht të jenë të vulosura edhe me vulën me pullën “Përdorim spitalor - ndalohet shitja”.</p>
--	---	--	--

	<p>QSUNT, duke aplikuar standard të dyfishtë edhe pse barnat janë me çmim shumë të shtrenjtë.</p> <p>Farmacia e QSUNT/Spitali, shkarkimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore e bën mbi bazën e recetës të lëshuar nga mjeku, receta të cilat konfirmohen nga Drejtoria e Administrimit të Paketave Shëndetësore dhe Ekzaminimet Terciare (Drejtori e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, e instaluar në QSUNT) duke bërë dhe rakordimet me FSDKSH-së. FSDKSH likuidon Importuesit farmaceutikë. Pra, likuidimet e importuesve kryhen nga FSDKSH dhe jo nga QSUNT, e cila gjeneron shërbimin: vizitë pacienti, lëshim recetë, personel farmaceutikë, edhe pse faturat importuesit farmaceutikë, i lëshojnë për QSUNT. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 8/1; Ligjin Nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 6, 7 dhe 8; Udhëzimi e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35/a,b,c.</p>			
2	<p>Grupi i auditimit për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti përzgjedhi 13 barna: Konkretisht barin me kod 710/96 “Palbociclib 125 mg”, barin me kod 631/335 “Infliximab 100 mg”, barin me kod 662/237 “Erelzi 25 mg” alternativ (Entanercept 25 mg), barin me kod 487/325 “Imatinib Accord 100 mg” alternativ (Imatinib 100 mg), barin me kod 732/92 “Ribociclib 200 mg” alternativ (Kisqali alternativë e parë), barin me kod 682/14 “Sorafenib 200 mg”, barin me kod 776/191 “Enzalutamide 40 mg alternativa e parë”, barin me kod 453/191 “Tacrolimus 1mg”, barin me kod 605/441 “Sevelamer Carbonate 800 mg”, barin me kod 705/92 “Dabrafenib 75 mg”, barin me kod 578/307 “Capecitabine 500mg”, barin</p>	Pika 2.10, fq 348-369	E lartë	<p>- Nga drejtorët e përgjithshëm të QSUNT/FSDKSH-së, të merren masa për të rinegociuar kontratat/marrëveshjet në fuqi me importuesit farmaceutikë për të bërë amendimet përkatëse, me qëllim përcaktimin e stokut (rezervës) të nevojshme në farmaci referuar numrit të pacientëve që trajtohen dhe të pritshmit (pacientët e rinj), për të eliminuar riskun e mos disponibilitetit të përkohshëm të barit/barnave për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti.</p> <p>-Pas përfundimit të kontratave/marrëveshjeve në fuqi nga Drejtorët e Përgjithshëm</p>

	<p>me kod 487/325 “Imatinib Accord 100 mg”.</p> <p>Për mungesën e këtyre barnave në farmaci, farmacistja e barnave të rimbursuara, ka njoftuar me e-mail QSUNT-në dhe QSUNT ka njoftuar FSDKSH-në, duke u shprehur në ligjëratë të drejtë se “...Importuesi nuk po furnizon farmacinë ...Theksojmë faktin se QSUNT, ka një numër pacientësh në pritje të barnave të lartpërmendura, të cilat janë të domosdoshëm për ecurinë e shëndetit të tyre”.</p> <p>Referuar dokumentacionit, furnizimet janë bërë nga 12 deri në 34 ditë me vonesë, në kundërshtim me recetat e lëshuara nga mjekët, ku barna të tilla për sëmundjet tumorale, dializë dhe transplant kanë një përsëritje fikse, p.sh., çdo 10 ose 15 ditë.</p> <p>Theksojmë se nuk bëhet fjalë për 13 pacientë, por për një numër të konsiderueshëm. Grupi i auditimit nuk mundi ta saktësoj, kërkoj, shifrën pasi institucioni i audituar e ka konsideruar sekret shtetëror.</p> <p>Menaxhmenti dhe personat e përfshire në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre nuk kanë maksimalizuar plotësisht efijencën dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike në lidhje me barnat e sipërcituara, ndërsa dëmi shëndetësor ndaj pacientëve është i pallogaritshëm dhe nuk ka pse të varet nga formalitetet burokratike të sistemit të shëndetësisë (Ministër, Bord drejtues, Drejtor të Përgjithshëm QSUNT/FSDKSH.</p> <p>Veprime në kundërshtim me:</p> <p>-Ligjin Nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>KREU II “Përgjegjësitë e shtetit dhe të shtetasve” Neni 4, pika 1 “Përgjegjësitë e shtetit”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Shteti ushtron veprimtarinë e tij lidhur me kujdesin shëndetësor në mbështetje të këtij ligji dhe zotohet për të rregulluar dhënien, mbikëqyrjen dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor”.</p> <p>-Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, neni 7, pika</p>			<p>QSUNT/FSDKSH, të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë duke vlerësuar lidhjen e marrëveshjeve kuadër, për furnizimin me bar/barna në princip aktiv jo në emrin tregtar me disa Importues Farmaceutik, për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti.</p> <p>Nga drejtorët e përgjithshëm të QSUNT/FSDKSH-së, të merren masa për të lidhur marrëveshje me homologët në vendet fqinje (Kosova etj), për të shkëmbyer bar/barna nga stoku (rezerva) i secilës palë në raste të mos disponibilitetit të bar/barnave për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti.</p>
--	---	--	--	---

	<p>I ku është shprehur “Spitali publik ofron shërbim mjekësor për të sëmurët e shtruar në shtruar, si dhe shërbime mjekësore për të sëmurët ambulatorë, sipas kritereve të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë”.</p>			
3	<p>Organizmi dhe funksionimi i QSUNT-së bëhet në zbatim të VKM Nr. 66, datë 3.2.2017 ndryshuar me VKM Nr. 654, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza".</p> <p>Statuti është miratuar në zbatim të Urdhrit të Përbashkët Nr. 709, date 10.10.2018, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e Statutit të QSU "Nënë Tereza".</p> <p>Në kundërshtim me statutin, pika 9.2, të kreut III “Organizimi”, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me urdhër Nr. 369, datë 24.08.2021, ka urdhëruar ngritjen e bordit të QSUNT, me 5 anëtarë. Bordi drejtues kryesohet nga znj. M. R. me detyrë Zv/ministër i Shëndetësisë.</p> <p>Ky urdhër i ministrit për ngritjen e bordit është në kundërshtim me:</p> <p>1. VKM Nr. 654, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", pika 2. Mënyra e funksionimit të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", si strukturë shëndetësore universitare, përcaktohet në statutin e saj, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.</p> <p>2. Urdhrit të Përbashkët Nr. 709, datë 10.10.2018, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e statutit të QSUNT "Nënë Tereza", kreu III “Organizimi”, pika 9.2: Bordi kryesohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.</p> <p>3. VKM Nr. 66, datë 3.2.2017 ndryshuar me VKM Nr. 654, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza".</p> <p>Për pasojë, të 7 vendimet e marra nga</p>	<p>Pika 2.8 fq 325-335</p>	<p>E lartë</p>	<p>Nga organet drejtuese t’i kërkohet ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të bashkërendojë dhe koordinojë veprimtarinë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për rikompozimin e Bordit ne përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe nën ligjor.</p>

	<p>bordi janë të pavlefshme, përfshi edhe rregulloren e organizimit dhe funksionimit të QSUNT.</p> <p>Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi znj. O.M. me detyrë ish-ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.</p>			
4	<p>a. Me urdhër të ministrit të Shëndetësisë Nr. 519, date 03.12.2021 “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, A.F. është emëruar në detyrën: Drejtor i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” deri në kryerjen e procedurave të konkurrimit në këtë pozicion pune. Në QSUNT nuk disponohet kontratë punësimi e përkohshme ose e përhershme me Drejtorin e Përgjithshëm A.F.</p> <p>Që prej datës 03.12.2021 deri më datën 31.05.2023, datë që përfundoi auditimi (18 muaj), QSUNT është drejtuar me drejtor të përkohshëm dhe dy zv/drejtor përgjithshëm/teknik të përkohshëm. Veprim në kundërshtim me statutin, kapitulli III, neni 13 “Drejtoria e Përgjithshme”, pika 13.1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite: “Drejtoria e Përgjithshme siguron drejtimin administrativ dhe institucional të QSU "Nënë Tereza". Ajo drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm. Drejtoria menaxhon aktivitetin e përgjithshëm të shërbimeve, programon orientimet strategjike dhe siguron zbatimin e tyre”.</p> <p>Pika 13.2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Drejtoria e Përgjithshme përbëhet nga: Drejtori i Përgjithshëm dhe zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm”. Në statut, Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 286, datë 21.5.2018 “Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm”, në asnjë nen nuk përcaktohet “Drejtor dhe zv/Drejtor i Përgjithshëm i Përkohshëm.</p> <p>b. Me urdhër të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 198, datë 30.03.2022 “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, N.S. është emëruar në detyrën e zv/drejtorit të përgjithshëm në</p>	<p>Pika 2.8 fq 325- 335</p>	<p>E lartë</p>	<p>Bordi i Spitalit të ndërmarrë veprime institucionale për përcaktimin përfundimtar të satutit të punës të drejtorit dhe zv/drejtorëve të përgjithshëm, shpërblimit dhe lidhjes së kontratave.</p>

	<p>Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.</p> <p>Nuk ka kontratë të lidhur ndërmjet drejtorit të përgjithshëm dhe zv/drejtorit të përgjithshëm N.S., në kundërshtim me statutin e spitalit, kreu IV, “Rregulla dhe procedura të punësimit dhe të vlerësimit”, pika 22. “Kontrata e Punës”. Veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr. 286, datë 21.5.2018 “Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm”.</p>			
5	<p>Agjencia Shtetërore e Blerjeve të Përqendruara me shkresën Nr. 119/26 prot., datë 15.07.2022, protokolluar me Nr. 35/33 prot., datë 15.07.2022, ka njoftuar Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza"(QSUNT) Tiranë për lidhje kontrate, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyresh”, me afat të marrëveshjes 1 vit, me fond limit 147,864,531 lekë pa TVSH.</p> <p>Nga verifikimi fizik i kryer në Spitalin A2 (Urgjencës), më datë 27 dhe 28.03.2023, në prani të E. N me detyrë përgjegjës i Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore dhe E. K. me detyrë specialist/inxhinier biomedikal i Sektorit të Inxhinierisë Klinike, u konstatua se në 1312 copë për 6 artikuj në vlerën 25,605,000 lekë me TVSH nuk janë zbatuar specifikimet teknike, si dhe mobiljet janë të pashoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat.</p> <p>Për pasojë, vlera 25,605,000 lekë për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe buxhetin e shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria “R.A.” sh.p.k .</p> <p>Veprime në kundërshtim me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Marrëveshjen kuadër të lidhur me Nr. 7/26 prot., datë 17.07.2020, ndërmjet QSUNT-së dhe operatori ekonomik “R.A.” shpk. -Kontratën e furnizimit Nr. I, lidhur 	Pika 2.5, fq 178-306	E lartë	<p>Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 25,605,000 lekë nga shoqëria “R.A.” shpk. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, si pasojë e moszbatimit të specifikimeve teknike në kontratën “Mobilimi i Spitalit të Ri të Ndërtuar (A2), me fond limit 147,864,531 lekë pa TVSH.</p>

	<p>me Nr. 62/127 prot., datë 16.08.2022 ndërmjet QSUNT-së të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë “R.A.” Shpk në vlerën 59,736,000 lekë me TVSH, neni 5.</p> <p>-Kontratën e furnizimit II, lidhur me Nr. 62/142 prot., datë 22.08.2022 ndërmjet QSUNT-së të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë “R.A.” shpk në vlerën 81,970,200 lekë me TVSH, neni 5.</p> <p>-Kontratën e furnizimi III, lidhur me Nr. 62/166 prot., datë 30.09.2022 ndërmjet QSUNT-së të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë “R.A.” shpk në vlerën 59,736,000 lekë me TVSH.</p> <p>- Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 122.</p> <p>- Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690.</p> <p>-Deklaratën datë 03.05.2022 mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik “R.A.” shpk.</p>			
6	<p>Për furnizim vendosje të aparaturave mjekësore për Spitalin e Ri të Ndërtuar (A2), loti 10, viti 2022 është lidhur kontrata me Nr. 64/124 prot., datë 26.07.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shoqërisë “B.A.” Shpk në vlerën 23,064,000 lekë me tvsh.</p> <p>Nga verifikimi fizik i kryer në Spitalin A2 (Urgjencës), më datë 27 dhe 28.03.2023 në prani të E.N. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore dhe E.K. me detyrë Specialist/ Inxhinier Biomedikal i Sektorit të Inxhinierisë Klinike, u konstatua se 130 shtretër pacienti me kontroll manual për vlerën 10,400,000 pa tvsh, ose 12,480,000 lekë me TVSH, nuk janë të rinj, por të përdorur.</p> <p>Pajisjet/shtretërit janë të pa shoqëruara me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test raportin e fabrikës). Veprime në kundërshtim</p>	Pika 2.5, fq 178-306	E lartë	<p>Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 12,480,000 lekë nga shoqëria “B.A.” shpk. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, si pasojë e moszbatim të specifikimeve teknike në kontratën “Mobilimi i Spitalit të Ri të Ndërtuar (A2), me fond limit në vlerën 147,864,531 lekë pa TVSH.</p>

	<p>me:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Kontratën me Nr. 64/124 prot., datë 26.07.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shoqërisë “B.A.” Shpk në vlerën 23,064,000 lekë me tvsh, neni 5.1. - Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 122 “Rregullat që zbatohen për kontratën”, pika 1. - Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690. -Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1. - Deklaratën datë 18.10.2021 mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik “B.A.” Shpk. Vlera 12,480,000 lekë përbën dëm ekonomik për QSUNT dhe Buxhetin e Shteti dhe duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria “B.A.” Shpk Shpk. 			
7	<p>Furnizim vendosje të pajisjes mjekësore për Spitalin e Ri “Kabineti i Endoskopisë”, viti 2022. Pjesët përbërëse të pajisjes të paraqitura në ofertën teknike kanë ardhur në Republikën e Shqipërisë dhe regjistruar në QKBPM, secila më vete në data dhe vite të ndryshme nga viti 2021-2022, me prodhues të ndryshëm dhe operatorë të ndryshëm, çka dëshmon se pajisja është asambeluar në Shqipëri. Procesimi/mbledhja (asamblimi) në një pajisje është bërë nga shoqëria “A.” Sh.p.k e cila nuk e ka tagrin ligjor/teknik për ta kryer këtë asamblim, referuar pikës 13.6.4 të VKM Nr. 731, datë 2.9.2015 “Për miratimin e rregullit teknik” Për Kërkesat Thelbësore, Vlerësimin e Konformitetit. Asamblimi, i pajisjes Videoendoskop, si dhe mosmbajtja e raportit të instalimit, funksionimit dhe trajnimit të stafit mjekësor, jo vetëm është shpenzim që nuk ia ka arritur qëllimit, por është risk i lartë për kryerjen e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për jetën e pacientëve. Pajisjet janë të pashoqëruara me certifikatën e origjinës dhe raportet e</p>	Pika 2.5, fq 178-306	E lartë	<p>Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 17,184,000 lekë nga shoqëria “A.” Sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, pasi pajisja është asambeluar në Shqipëri. Procesimi/mbledhja (asamblimi) i pjesëve në një pajisje është bërë nga një shoqëri e pa certifikuar/licencuar për këtë qëllim.</p>

	<p>testeve (test-raportin e fabrikës). Vlera 17,184,000 lekë përbën dëm ekonomik për QSUNT-në dhe Buxhetin e Shteti dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria “A.” sh.p.k. Ndërsa dëmi shëndetësor ndaj pacientëve është i pallogaritshëm (pra shumë herë më i madh), pasi shërbimi ndaj pacientëve me këtë pajisje të asambeluar në Shqipëri nga persona të palicensuar, pajisje pa kalibruar, pa raport instalimi dhe funksionimi, pa raport trajnimi për personelin, pa manuale shërbimi dhe përdorimi, pa raportet e testeve (test-raportin e fabrikës) është me risk të lartë për shëndetin e pacientëve.</p>			
8	<p>Zhvillimi i procedurës së prokurimit kërkesë me propozim me objekt “F. V kokë goditëse për pajisjen mjekësore ESWL, prodhuesi S.M./ekuivalent”, me REF -84075-01-14-2021, viti 2021, kontraktuar dhe likuiduar për vlerën 6,886,800 lekë shkakton mbivendosje (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e mirëmbajtjes në vlerën 5,636,219.18 lekë me TVSH, e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik “M.” shpk dhe QSUNT me numër prot., 173/36 datë 04.02.2021, ku specifikohet në termat e referencës se: “Operatori ekonomik fitues do të kryejë mirëmbajtje full risk, mirëmbajtja parandaluese/ preventive e pajisjeve mjekësore, mirëmbajtja korrigjuese e pajisjeve mjekësore, furnizim me pjesë këmbimi dhe aksesore, inspektimi i sigurisë së pajisjeve mjekësore”.</p> <p>Për veprimin e mësipërm është shkelur koncepti i “Bëgatimit pa shkak”, i ardhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të personave të përfshirë në këtë proces me përfitues padrejtësisht shoqërinë “M.” sh.p.k në vlerën 6,886,800 lekë. Referuar Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 655, “Bëgatimi pa shkak”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caceve</p>	Pika 2.5, fq 178-306	E lartë	<p>Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 6,886,800 lekë nga shoqëria “M.” Sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, pasi shkakton mbivendosje, (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e mirëmbajtjes në vlerën 5,636,219.18 lekë me TVSH, e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik “M.” shpk dhe QSUNT me numër prot., 173/36 datë 04.02.2021.</p>

	<p>të begatimit”.</p> <p>Vlera 6,886,800 lekë përbën dëm ekonomik për QSUNT-në dhe buxhetin e shteti dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria “M. shpk”.</p>			
9	<p>Zhvillimi i procedurës së prokurimit kërkesë me propozim me objekt “F. V kokë goditëse për pajisjen mjekësore ESWL, prodhuesi S.M./ekuivalent”, me REF 42106-09-16-2022, viti 2022, kontraktuar dhe likuiduar për vlerën 3,443,400 lekë shkakton mbivendosje (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e mirëmbajtjes në vlerën 3,074,122 lekë me TVSH, e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik “M.” shpk dhe QSUNT-së me numër prot., 581/28 date 01.03.2022, ku specifikohet në termat e referencës se: “Operatori ekonomik fitues do të kryejë mirëmbajtje full risk, mirëmbajtje parandaluese/preventive e pajisjeve mjekësore, mirëmbajtje korrigjuese e pajisjeve mjekësore, furnizim me pjesë këmbimi dhe aksesore, inspektim i sigurisë së pajisjeve mjekësore”.</p> <p>Për veprimin e mësipërm është shkelur koncepti i “Bogatimit pa shkak”, i ardhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të personave të përfshirë në këtë proces me përfitues padrejtësisht shoqëria “M.” Sh.p.k në vlerën 3,074,122 lekë. Referuar Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 655 “Bogatimit pa shkak”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të begatimit”.</p> <p>Vlera 3,443,400 lekë përbën dëm ekonomik për QSUNT-në dhe buxhetin e shteti dhe duhet të dëmshpërblehet, nga shoqëria “M.” shpk.</p>	<p>Pika 2.5, fq 178-306</p>	<p>E lartë</p>	<p>Të kërkohe në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 3,074,122 lekë nga shoqëria “M.” shpk . Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, pasi shkakton mbivendosje (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik “M.” shpk dhe QSUNT-së me numër prot., 581/28, datë 01.03.2022.</p>

10	<p>Nga inventarizimi në Polin e Administrimit të Spitalit Polivalent janë konstatuar 192 aktive të munguara në vlerën 21,885,993 lekë. Referuar raportit përmbledhës të inventarit me shkresën Nr.2450/8, datë 30.12.2022, “Mbi rezultatet për inventarizimin e aktiveve të QSUNT-së”, grupi i inventarizimit i përbërë nga E.T., E.K., M.R., E.B., A.K., deklaroi se janë gjetur dyert e hapura me dhunë (të dëmtuara) dhe një pjesë e aktiveve nuk janë gjetur. Drejtori i Përgjithshëm, në zbatim të kompetencave dhe detyrimeve ligjore që janë përcaktuar në statut, si dhe të legjislacionit specifik për administrimin e pronës shtetërore, nuk ka marrë asnjë masë për sa i përket denoncimit të aktit në organet kompetente (prokurori, polici etj.), nxjerrjes së përgjegjësive për aktivet e humbura, si dhe dëmshpërblimin e vlerës 21,885,993 lekë për 192 aktivet e humbura. Drejtori i Përgjithshëm i është drejtuar policisë së shtetit 4 muaj me vonesë, në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 8, udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 93.</p>	Pika 2.4, fq 131-178	E lartë	Bordi i spitalit të analizojë vlerën 21,885,993 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me 192 aktive të munguara në Polin e Administrimit të Spitalit Polivalent, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për zhdëmtim, vlerë e cila për QSUNT-në dhe buxhetin e shtetit përbën dëm ekonomik.
11	<p>QSUNT ka lidhur kontratë 543/4 prot, datë 27.01.2020 me shoqërinë “A.” shpk me objekt “Për ofrimin e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavijonet e QSUNT-së për 30.05 ditë/muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, me të drejtë rinovimi automatikisht çdo muaj deri në lidhjen e kontratës bazë” në vlerën 26,738,538.88 lekë me TVSH. Grupi i auditimit përzgjedhi 11 materiale të buta për t’i peshuar, nga 15 materiale në total për shërbimin e lavanterisë nga ku krahasuar peshave për të cilat QSUNT paguan referuar stacioneve të firmosura nga OE “A.” u konstatuan diferenca në peshë për 5 materiale. Referuar situacioneve mujore, grupi i auditimit për çdo muaj për periudhën</p>	Pika 2.3, fq 113-131	E lartë	Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 11,032,753.88 lekë nga shoqëria “A.” shpk. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga

	<p>objekt auditimi kreu llogaritjen e tyre sipas peshave faktike, nga ku u konstatua se për periudhën prill-dhjetor 2021, OE “A.” shpk është likuiduar në vlerën 193,300,331.07 pa TVSH, ndërkohë që referuar peshave reale duhej të likuidohej në vlerën 189,622,252.16 lekë, më një diferencë prej 3,678,078.91 lekë ose 4,413,693.82 lekë me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik për QSUNT-në dhe buxhetin e shtetit.</p> <p>Për vitin 2022, OE “A.” shpk është likuiduar/paguar në vlerën 259,913,157.42 lekë pa TVSH ndërkohë që referuar peshave reale duhej të likuidohej/paguhej në vlerën 254,397,274.03 lekë, më një diferencë prej 5,515,883.39 lekë pa TVSH ose 6,619,060.07 me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik për QSUNT-në dhe buxhetin e shtetit.</p> <p>OE “A.” shpk për periudhën objekt auditimi ka përfituar pa të drejtë në total vlerën 9,193,961.57 lekë ose 11,032,753.88 lekë me TVSH, duke shkaktuar dëm për QSUNT-në dhe buxhetin e shtetit. Veprime në kundërshtim me kontratën Nr.543/4, datë 27.01.2022, neni 3, Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 122, Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690, Deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik “A.” shpk, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij.</p>			<p>kjo shoqëri, si pasojë e diferencës së peshave të materialeve të buta të paguara me ato faktike.</p>
12	<p>Në datë 12 maj 2022, në PAI-n e Qendrës së Konsultave Ambulatorëe, u transferua nga PAI i Spitalit Infektiv, aparatura e elastografisë në vlerë 14,140,000 lekë. Më datë 20 korrik nga PAI i Spitalit Infektiv është sjellë në PAI-n e Konsultave Ambulatore një sondë, e cila nuk ka lidhje me sondën e inventarizuar të kësaj pajisje. Fakt i konstatuar në datë 9 gusht nga “B.”, me interpretimin se sonda e sjellë nuk është ajo e inventarit bazuar në numrin serial dhe datën e kalibrimit të realizuar të</p>	<p>Pika 2.4, fq 131-178</p>	<p>E lartë</p>	<p>Bordi i Spitalit të analizojë vlerën 14,140,000 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me diferencë inventari (sondë) të pajisjes së elastografisë në PAI-n e Qendrës së Konsultave Ambulatore, jo vetëm që modifikimi me sondë tjetër është shpenzim i tepër, por është risk i lartë për kryerjen e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për jetën e pacientëve. Të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për</p>

	<p>prodhuesit, me Mirëmbajtjen Preventive 2021. Në lidhje me këtë çështje, znj. R.G. me detyrë administratore e PAI-t të Konsultave ka deklaruar/sqaruar se momentalisht aparatura elastografi në vlerën 14,1140,000 lekë është e vetmja në QSUNT si dhe rajon, e cila shërben për të nxjerrë analizat e funksionimit të mëlçisë, kryesisht për pacientët me Hepatit B dhe C, aparaturë së cilës i është vendosur një sondë tjetër dhe kjo duke mos qenë sonda e saj, aparatura shpesh herë kërkon kalibrimin e pajisjes. Referuar pikës 13.6.4 të VKM Nr. 731, datë 2.9.2015, “Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore, vlerësimin e konformitetit, klasifikimin dhe markimin të pajisjeve mjekësore” kalibrimi i pajisjeve mjekësore, është i detyrueshëm për të siguruar dhe vërtetuar se rezultatet të cilat vijnë nga këto pajisje janë të sakta dhe të sigurta.</p> <p>Modifikimi i pajisjes mjekësore me sondë tjetër, jo bashkëkohore në përshtatje të plotë me specifikat teknike të pajisjes së elastografisë, jo vetëm është shpenzim i tepër, por është risk i lartë për kryerjen e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për jetën e pacientëve.</p> <p>Përpos sa më sipër, transferimi i aparaturës së elastografisë është bërë jo vetëm i mangët, por edhe me tre muaj me vonesë, duke shkaktuar kështu mosdhënien e shërbimit për pacientet për tre muaj radhazi (shërbim i llojit të veçantë). Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe Neni 8, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 93.</p>			<p>zhdëmtim, vlerë e cila për QSUNT-në dhe buxhetin e shtetit përbën dëm ekonomik. Dëmi shëndetësor është i pallogaritshëm, pasi nuk u është dhënë shërbimi për tre muaj t pacienteve me diagnozë (Hepatit B & C), por prej datës 21.08.2022 e në vazhdim, analizat e kësaj pajisjeje janë të pasigurta pasi nuk është kryer kalibrimi i kësaj pajisjeje. (pas vendosjes së sondës së re).</p>
13	<p>Ndërtesa e Pediatriisë Infektive, përbëhet nga 3 kate mbi tokë dhe një gjysmë kati teknik mbi soletën e katit të fundit me lartësi 1.95 m, duke krijuar një interkapet mes tarracës dhe katit të dytë. Spitali i Pediatriisë Infektive ka një lartësi kati prej 3.25 m dhe arrin një sipërfaqe totale</p>	Pika 2.4, fq 131-178	E lartë	<p>- Nga Drejtori i Përgjithshëm i QSUNT, të prezantohet në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale risku i lartë i qëndrueshmërisë së godinës së Pedriatisë Infektive, i ardhur si pasojë e mos korrigjimeve të projektit, duke i kërkuar</p>

	<p>ndërtimi 3,191 m²: Kati përdhes 1,075 m², kati i parë 1,058 m², kati i dytë 1,058 m². Referuar situatës së tërmetit të 26.11.2019, nga analiza e grupit të projektuesve pas situatës së tërmetit, vihen re dëmtime në muraturë kryesisht në katin e dytë të godinës të cilat vijnë si pasojë e dëmtimeve në strukturat konstruktive të mureve mbajtëse perimetrale dhe plasaritje të lehta në suvanë e jashtme dhe të dukshme në rifiniturat e brendshme. Kati i fundit i godinës është i evakuar, për çështje sigurie ky kat është i boshatisur.</p> <p>Në kushtet e emergjencës për vazhdimin e funksionimit të tij, projektuesi ka rekomanduar puntelimin dhe nxjerrjen nga puna të komplet katit të dytë teknik të objektit. Në mënyrë që të zgjidhen problematikat kryesore të ndërtesës, opsioni përfundimtar i sugjeruar nga projektuesi për Spitalin e Pediatriisë së Përgjithshme parashikon zgjatjen e jetëgjatësisë së objektit ekzistues deri në 2-3 vjet dhe më vonë ndoshta rikonceptimi i një objekti të ri, i cili do të zhvillohet në prishjen e objektit ekzistues dhe ndërtimi i një objekti të ri të Spitalit të Pediatriisë së Përgjithshme me parametra bashkëkohore.</p> <p>Oponenca teknike e realizuar nga Instituti i Ndërtimit, me Nr. 1190/2 prot., datë 06.06.2020, është kontradiktore, ka paqartësi ose mos dhënie e përfundimeve të sakta të oponencës teknike. MSHMS nuk ka vlerësuar drejt investimin e rikonstruksionit të një objekti ekzistues, pa marrë masa përforcuese dhe ndërhyrjet e duhura strukturore, duke e lënë katin e dytë të mbështetur në puntela dhe një investim për një periudhë shfrytëzimi prej 2 vitesh, ç'ka do të thotë që për një vit Buxheti i Shtetit ka paguar 13,319,442 lekë me TVSH (26,638,885 lekë me tvsh / 2) ose për 2 vite 26,638,885 lekë me TVSH, në një kohë kur ky projekt është hartuar në kundërshtim me Kushtet teknike të Projektimit KTP dhe zbatimit KTZ, miratuar me VKM Nr. 68, datë 15.2.2001, "Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të</p>			<p>Ministritsë së linjës të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës për përcaktimin e integritetit strukturor të godinës, si dhe funksionalitetit operacional të saj në shërbim të pacientëve.</p> <p>- Nga QSUNT dhe MSHMS, në të ardhmen të merren masa që çdo investim të vlerësohet rëndësia e ruajtjes së integritetit strukturor të godinave, duke përcaktuar dhe vlerësuar kapacitetin sizmik dhe metodikat për riaftësimin strukturor të tyre, në mënyrë që të mosqëq menaxhohet vlera për investime dhe rikonstruksione të objekteve spitalore.</p>
--	--	--	--	---

	<p>punimeve të ndërtimit” si dhe Leja e ndërtimit Nr. 14544/4 datë 04.08.2021, është dhënë në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.</p> <p>Kontradiktore është dhe Bashkia Tiranë, pasi pas 3 herë aplikim dhe refuzim të lejes së ndërtimit, në përfundim merret vendimi 14544/4, datë 04.08.2021, ku miratohet leja e ndërtimit. Miratimi i lejes së ndërtimit, pas 3 refuzimesh dhe më pas miratohet, kur projekti i rikonstruksionit nuk ka pësuar ndryshime apo korrigjime nga reflektimet e oponencës realizuar nga Instituti i Ndërtimit, bie në kundërshtim me arsyet fillestare të refuzimeve dhe me Ligjin Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Pra, projekti është realizuar në prill 2020, kontrata e zbatimit është nënshkruar në dhjetor 2020 dhe leja e ndërtimit është miratuar në gusht 2021.</p> <p>Në opinionin e grupit të auditimit, zgjidhja teknike dhe situata aktuale e godinës paraqitet një rrezik shumë të madh në rast të një tërmeti tjetër brenda një periudhe dyvjeçare (e cila ka kaluar), ku ambienti shfrytëzohet për hospitalizimin e fëmijëve. Gjithashtu, zgjidhja e dhënë në projekt me puntelimin e katit të fundit nuk zgjidh ose përforcon muret perimetrale mbajtës, të cilët kanë pasur shkëputje në një zonë me muret ndarës të brendshme. Pra ky investim nuk ka arritur zgjidhjen e qëndrueshmërisë së godinës edhe në rastin e menduar prej 2 vitesh me puntela (ku mbahet soleta), ku nuk është menduar zgjidhja e qëndrueshmërisë së mureve perimetrale, çka do të kërkojë rikonstruksionin e plotë të godinës. Pra, buxheti i shtetit/ QSUNT do të harxhojë fonde përsëri që godina të jetë e shfrytëzueshme dhe e sigurt për funksion spitalor. Nga MSHMS dhe nga QSUNT, nuk është parashikuar asnjë Investim për Pediatriinë Infektive, për ndërtimin e ndonjë objekti të ri apo edhe për rikonstruksion përfundimtar të godinës së vjetër mbi katin e dytë të</p>			
--	--	--	--	--

	mbajtur me puntela provizore. Referuar sa më sipër, vlera prej 26,638,885 lekë me TVSH për rikonstruksioni e pediatriisë Infektive përbën efekt negativ të konstatuar në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike.			
14	Nga inventarizimi në Polin e Administrimit të Spitalit Polivalent janë konstatuar 165 aktive të papërdorshme, të dëmtuara, për t'u vlerësuar për nxjerre jashtë përdorimit në vlerën 86,754,536 lekë. Ky fakt është pasqyruar në raportin përmbledhës të inventarit me shkresën Nr.2450/8, datë 30.12.2022, "Mbi rezultatet për inventarizimin e aktiveve të QSUNT-së", grupi i inventarizimit i përbërë nga E.T., E.K., M.R., E.B., A.K.. Vlera prej 86,754,536 lekë për 165 aktivet e dëmtuara përbën një shpenzim për të cilin nuk është arritur plotësisht qëllimi i blerjes, pasi nuk janë përdorur deri në amortizimin apo mosfunksionimin plotë të tyre, por janë dëmtuar duke u nxjerrë jashtë funksionit.	Pika 2.4, fq 131-178	E lartë	Bordi i Spitalit të analizojë vlerën 86,754,536 lekë, vlerë e cila ka të bëjë 165 aktive të papërdorshme, të dëmtuara, për t'u vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit në Polin e Administrimit të spitalit Polivalent, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për zhëmtim, vlerë e cila për QSUNT-në dhe buxhetin e shtetit është shpenzim pa ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet nga QSUNT.
	QSUNT dhe F. kanë nënshkruar aktmarrëveshjen me nr. 1242/41, datë 16.11.2018, ndryshuar me amendamentin Nr. 1, protokolluar me Nr. 884/2, datë 12.04.2022, në zbatim të VKM nr. 135/2022, "Për disa shtesa në vendimin Nr. 688, datë 14.11.2018 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga MSHMS të F., të objektit me emërtim "Oborr i QSUNT-së". VKM 688 /2018 pika 3 dhe 4, ndryshuar me VKM 135/2022 pika 4/1, ka përcaktuar qartë raportet e ndarjes së të ardhurave midis palëve nënshkruar në aktmarrëveshje. Pas momentit të hyrjes në fuqi të aktit normativ, hyrjes në fuqi të VKM 135/2022 (botuar në FZ Nr. 37, datë 09.03.2022) detyrimi ligjor mbi palët është se deri në momentin e hyrjes në fuqi të VKM 135/2022, të ardhurat e krijuara dhe të papërdorura duhet të kalojnë në buxhetin e QSUNT-së në masën 80% si të ardhura dytësore për t'u përdorur për investime në infrastrukturë, pajisje mjekësore ose	Pika 2.6, fq 307-323	E lartë	Mbështetur në Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", neni 10, pika 2, QSUNT, t'i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për qëndrimin e saj zyrtar lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor për mbajtjen 15% të tatimit mbi fitimin nga pjesa takuese e të ardhurave të QSUNT-së në shumën 13,499,579 lekë, në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 135/2022, "Për disa shtesa në vendimin Nr. 688, datë 14.11.2018 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga MSHMS e F. të objektit me emërtim "Oborr i QSUNT" dhe zbatimin e aktmarrëveshjes së nënshkruar midis QSUNT-së dhe F.-së, me Nr. 1242/41, datë 16.11.2018, ndryshuar me Amendamentin Nr. 1, protokolluar me Nr. 884/2, datë 12.04.2022.

15	investime të tjera etj. Nga auditimi u konstatua se QSUNT nuk ka arkëtuar shumën 13,499,579 lekë për faturat për arkëtim Nr. 33/2, datë 22.04.2022 Nr. 37/2022, datë 06.10.2022, konsideruar si 15% tatim fitim për t'u mbajtur nga pjesa takuese e të ardhurave të QSUNT-së. Mbajtja e tatim fitimit në masën 15% mbi të ardhurat dytësore të QSUNT-së, çënon raportin e ndarjes së të ardhurave sipas kërkesave të VKM Nr. 135/2022, pika 4/1 dhe Akt Marrëveshjes nr. 1242/41, datë 16.11.2018, të ndryshuar.			
16	Nga auditimi u konstatua QSUNT ka nënshkruar kontratë shërbimit Nr. 5216, datë 09.10.2020, me kontraktorin "O." shpk, me objekt "Mirëmbajtje e sistemit të informacionit për shëndetin publik të QSUNT-së (SISP)". Neni 8.1 dhe 8.2 i kontratës parashikon se kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha shërbimet siç specifikohet të oferta teknike dhe kushtet e veçanta të kontratës neni 10, "Pranimi Shërbimeve". Me shkresë Nr. 1544/1 prot, datë 01.06.2022, QSUNT ka kërkuar nga kontraktori hedhjen në SISP të tarifave të ndryshuara, miratuar në urdhrin e MSHMS-së nr. 310, datë 17.05.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhrin nr. 493, datë 02.07.2019 "Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik". Kërkesa për dijëni i është drejtuar dhe AKSH-it dhe MSHMS-së. Sipas kontratës së nënshkruar, kërkesa e QSUNT-së përbën detyrim kontraktual për t'u përmbushur nga kontraktori. Kontraktori në sistemin SISP ka ndryshuar tarifat në datën 26 shtator 2022 në kundërshtim me kërkesën me shkresën Nr. 1544/1 prot, datë 01.06.2022, dhe urdhrin e MSHMS nr. 310, datë 17.05.2022 , "Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr. 493, datë 02.07.2019 , "Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik", i cili në paragrafin e fundit kërkon zbatim të menjëhershëm të tij. Kontraktori ka aplikuar me vonesë tarifat e reja, me efekt pas datës 26 Shtator 2022, në kundërshtim me kontratën e shërbimit nr. 5216, datë 09.10.2020, neni 8.1	Pika 2.2, fq 85-113	E lartë	- Drejtori i Përgjithshëm i QSUNT-së në bashkëpunim me AKSH-in, të ngrenë një grup të përbashkët pune për të vlerësuar teknikisht nëse shërbimet e kërkuara me shkresën Nr. 1544/1 prot, datë 01.06.2022 për hedhjen në Sistemin Informacionit për Shëndetin Publik (SISP) të tarifave të ndryshuara të shërbimeve, kanë qenë pjesë e kontratës së shërbimit Nr. 5216, datë 09.10.2020, nënshkruar midis kontraktuesit dhe përfituesit. Pas verifikimit , nëse kushtet nuk ndryshojnë, të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 2,055,301 lekë, për mosmbajtje tarife ditore (dëm) në vlerën 2,055,301 leke.

	<p>dhe 8.2 dhe kushtet e veçanta të kontratës , neni 10 , kërkesën e QSUNT-së me nr. 1544/1 prot, datë 01.06.2022 dhe urdhrin e MSHMS Nr. 310, datë 17.05.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin Nr. 493, datë 02.07.2019 “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”. Për pasojë , QSUNT duhet të përllogariste dhe mbante tarifa ditore (dëm) për kryerjen me vonesë të shërbimit të kërkuar në hedhjen me vonesë të tarifave të reja në sistemit SISP, sipas urdhrin të MSHMS Nr. 310, datë 17.05.2022 , “Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin Nr. 493, datë 02.07.2019 , “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”, për 85 ditë në vlerën 2,055,301 lekë (24,179,892 * 85 * 1/1000), në zbatim të nenit 20, germa “c” të kontratës së shërbimit nr. 5216, datë 09.10.2020.</p>			
--	--	--	--	--

1.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditim

Në kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë SHA, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.04.2021 deri me datë 31.12.2022. Nga auditimi i ushtruar u konstatuan se aktiviteti i QSUNT në përgjithësi përputhet me kërkesat dhe kriteret e kuadrit ligjor në fuqi. Pavarësisht sa u citua si më sipër, për periudhën objekt auditimi u konstatuan edhe shkelje të kuadrit nënligjor dhe rregullator të cilat konsistojnë në: Organizimin dhe funksionimin të organeve drejtuese, zbatimin e kontratave për punë publike (pajisjet), zbatimin e procedurave për trajtimin e pacientëve ambulator me barna të rimbursueshme, për sëmundje tumorale dializë dhe transplant, zbatimin e procedurave për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, zbatimin e procedurave gjyqësore, hartimin dhe zbatimin e programit ekonomik, pagave dhe shpërblimeve, hartimin e dokumentacionit të tenderimit etj.

Opinion i kualifikuar

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë (QSUNT) me kriteret e vlerësimit që përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij Institucioni.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një

opinionin të kualifikuar të përputhshmërisë.

Baza për opinionin të kualifikuar të përputhshmërisë.

Në jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet e tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale.

Konkluzionet dhe opinionin ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion QSUNT, e cila konsiderohet nga ana e jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme.

Në kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinionin me siguri të arsyeshme.

Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, ISSAI 1500 (ISA 500) dhe ISSAI 1530 (ISA 530); Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit, kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit në këtë auditim përputhshmërie.

Në kemi mbledhur dhe vlerësuar evidencën e auditimit, si dhe kemi konkluduar me gjetje dhe rekomandime në lidhje me fushën/objektin e auditimit, qasjen, kohën dhe burimet, me qëllim për të kryer një punë audituese që redukton në një nivel të ulët të pranueshëm, riskun e një konkluzioni ose opinionin të gabuar rreth objektivit të auditimit.

Bazuar në punën e kryer të auditimit, nga gjetjet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e opinionit të mësipërm, veçojmë:

-Nga verifikimi fizik i kryer në Spitalin A2 (Urgjencës), më datë 27 dhe datë 28.03.2023 u konstatua se në 1312 copë për 6 artikuj në vlerën 25,605,000 lekë me TVSH, nuk janë zbatuar specifikimet teknike, si dhe mobiljet janë të pa shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat.

-Nga verifikimi fizik i kryer në Spitalin A2 (Urgjencës), më datë 27 dhe 28.03.2023 u konstatua se 130 shtretër pacienti me kontroll manual për vlerën 12,480,000 lekë me TVSH, nuk janë të rinj, por të përdorur. Pajisjet/shtretërit janë të pa shoqëruara me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test raportin e fabrikës), veprim në kundërshtim me Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1.

-Furnizim vendosje të pajisjes mjekësore për Spitalin e Ri “Kabineti i Endoskopisë”, viti 2022. Pjesët përbërëse të pajisjes të paraqitura në ofertën teknike kanë ardhur në Republikën e Shqipërisë dhe regjistruar në QKBPM, secila më vete në data dhe vite të ndryshme nga viti 2021-2022, me prodhues të ndryshëm dhe operatorë të ndryshëm, çka dëshmon se pajisja është asambeluar në Shqipëri. Procesimi/mbledhja (asamblimi) në një pajisje është bërë nga një shoqëri e cila nuk e ka tagrin ligjor/teknik për ta kryer këtë asamblim.

-Procedura e prokurimit kërkesë me propozim me objekt “F. v kokë goditëse për pajisjen mjekësore ESWL, prodhuesi S.M./ekuivalent”, me REF -84075-01-14-2021, viti 2021,

kontraktuar dhe likuiduar për vlerën 6,886,800 lekë shkaktën mbivendosje, (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e mirëmbajtjes në vlerën 5,636,219.18 lekë me TVSH.

-Zhvillimi i procedurës së prokurimit kërkesë me propozim me objekt “F. v kokë goditëse për pajisjen mjekësore ESWL, prodhuesi S.M./ekuivalent”, me REF -42106-09-16-2022, viti 2022, kontraktuar dhe likuiduar për vlerën 3,443,400 lekë shkaktën mbivendosje, (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e mirëmbajtjes në vlerën 3,074,122 lekë me TVSH.

-Investimi i godinës Pediatrikë Infektive në vlerën 26,638,885 lekë, nuk ka arritur zgjidhjen e qëndrueshmërisë së godinës me risk të lartë mbi qëndrueshmërinë dhe integritetin strukturor në rast tërmeti.

-Zhvillimi i procedurës e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me objekt “Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore për përballimin e nevojave ekstreme, deri në lidhjen e kontratës bazë të procedurave konkurruese me të drejtë shkëputje pa pasoja për aturitetin kontraktor me fond limit në vlerën 61,002,230 lekë pa TVSH, ka ardhur si pasojë e mos vëmendjes së duhur institucionale dhe përgjegjësisë ndaj detyrës së strukturave të përfshirë në këtë proces, duke filluar nga nivele të larta menaxheriale/drejtuese.

-Në të gjitha procedurat e prokurimit për periudhën objekt auditimi, për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, blerjen e pajisjeve mjekësore dhe barnave, është vendosur kriteri favorizues i kualifikimit autorizim nga prodhuesi.

-Për mirëmbajtje full-risk të pajisjeve mjekësore, autoriteti kontraktor, para shpalljes së proceduarve nuk ka hartuar planin e mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore për çdo vit, plan i cili duhet miratuar nga komiteti mjekësor, kjo për faktin se numri i pajisjeve për nevoja mirëmbajtje është shumë i madh dhe nuk mbulohen nga fondet e QSUNT-së.

-Ngjarjet ekonomike, për furnizim me barna që rimburohen nga shteti për kryerjen e shërbimit për pacientët ambulator (të pa hospitalizuar) nuk regjistrohen në kontabilitet.

-Barna të pa furnizuara në kohë për pacientët, duke shkelur protokollin e mjekimit me pasojë vënie në rrezik të shëndetit e tyre, pasi janë barna të sëmundjeve tumorale, dializë dhe transplant.

-Emërim i përgjegjësit të sektorit të Auditit të Brendshëm është kryer pa patur certifikimin profesional nga Ministria e Financave dhe pa përvojë 5-vjeçare në profesion.

-Nga inventarizimi në Polin e Administrimit të Spitalit Polivalent janë konstatuar 192 aktive të munguara në vlerën 21,885,993 lekë.

Nga QSUNT nuk janë marrë masa përsa i përket denoncimit në kohë të aktit në organet kompetente (prokurori, polici etj.), nxjerrjes së përgjegjësive për aktivet në mungesë, si dhe dëmshpërblimin e vlerës 21,885,993 lekë për 192 aktivet e humbura. QSUNT i është drejtuar policisë së shtetit 4 muaj me vonesë në kundërshtim me pikën 93 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

-Në zbatim të kontratës nr.543/4 prot, datë 27.01.2020 me Shoqërinë “A.” Shpk me objekt “Për ofrimin e shërbimit të lavandrisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavijonet e QSUNT, u konstatua diferencë e peshave të materialeve të buta të paguara me ato faktike në vlerën 11,032,753.88 lekë.

- Diferencë inventari (sondë) të pajisjes së elastografisë në PAI-n e Qendrës së Konsultave Ambulatore në vlerën 14,140,000 lekë.

-165 aktive të papërdorshëm, të dëmtuara për tu vlerësuar për nxjerje jashtë përdorimit në

Polin e Administrimit të spitalit Polivalent në vlerën 86,754,536 lekë, për të nuk është arritur plotësisht qëllimi i blerjes, pasi nuk janë përdorur deri në amortizimin apo mos funksionimin plotë të tyre, por janë dëmtuar duke u nxjerrë jashtë funksionit.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të QSUNT

Strukturat drejtuese të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, janë përgjegjëse për zbatimin e veprimtarisë në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e raportit përfundimtar të auditimit. Në komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Në identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur sipas përcaktimeve ligjore është vendosur që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJJA

Mbështetur në Ligjin Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH Nr. 1177/1 prot., datë 13.01.2023, i ndryshuar, nga data 16.01.2023 deri 31.05.2023, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”(QSUNT) Tiranë, për periudhën nga data 01.04.2021 deri me datë 31.12.2022, u krye auditim “Përputhshmërie” me përbërje:

1. F.I., përgjegjës grupi,
2. E.K., audituese,
3. E.T., audituese
4. A.H., audituese,
5. E.K., audituese,
6. A.K., auditues,
7. V.B., audituese.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

a. Objekti i auditimit:

Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: Rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: Standarde, ligje, Vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë, që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

-Njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik).

-Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese, si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

b. Qëllimi i auditimit:

-Është:

-vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë QSUNT.

-dhënia e opinionit mbi rregullshmerinë dhe përputhshmërinë apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime¹.

c. Identifikimi i çështjes:

Raporti synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza"(QSUNT) Tiranë, në funksion diagnostikues e trajtues në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë si pjesë e Universitetit të Mjekësisë, Tirane.

Në funksion të këtij angazhimi, janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e kriterëve mbi administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, respektimin e organigramës dhe të strukturës organike, vendimmarrja e organeve drejtuese etj. Në fokusin e angazhimit janë përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare Vjetore nga ana e QSUNT, në mbështetje të dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi në fushën e kontabilitetit të sektorit publik dhe pasqyrave financiare, si dhe aspektet e zbatimit të kërkesave të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar e kontrollin", i ndryshuar.

Aktivitetet e vlerësuara nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit Nr. 1177/1 prot., datë 13.01.2023, i ndryshuar.

d. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Drejtimi i QSUNT është përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike, zbatimin e kuadrit rregullator ligjor dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare. Ky Institucion duhet që të menaxhojnë burimet dhe të ushtrorjnë autoritetin në përputhje me vendimet dhe kërkesat e legjislacionit.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe për vendosjen dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm, që ai i konsideron të nevojshme, për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa anomali materiale për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Është përgjegjësi e subjektit të audituar për të siguruar besueshmërinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare, si edhe pohimet respektive në pasqyrat vjetore.

Drejtimi ka përgjegjësinë e tij për hartimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kontrollit të brendshëm për të parandaluar, ose për të zbuluar dhe rregulluar gabimet materiale ose mospërputhshmëritë, që të jetë i përshtatshëm për këtë qëllim.

Drejtimi dhe menaxhimi janë përgjegjës për përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësisë publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet. Ata përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe

¹ -Rregullorja e Procedurave të Auditimit në KLSH, miratuar nga Kryetari KLSH me Vendimin Nr. 107, datë 8.9.2017, me ndryshimet.

efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator.

e. Përgjegjësitë e audituesve:

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Në këtë kontekst duhet:

-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4000*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde në aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryej në mënyrë efektive auditimin (*ISSAI 1300*)

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse (*ISSAI 1500/ISA 300*).

-Të kryej procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Në jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në *ISSAI-n 10* “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe *ISSAI 30* “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Në i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, në besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të vlerësuar përputhshmërinë e aktivitetit. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.

f. Kriteret e vlerësimit: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA)IFAC; (ISSAI) të INTOSAI-t; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Baza Ligjore:

Ligji Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji Nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për Sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8615, datë 01.06.2000 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji Nr. 89/2014, “Për pajisjet mjekësore”, i ndryshuar; Ligji Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar; Ligji Nr. 147/2014 “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”; Ligji Nr. 138/2014 “Për kujdesin paliativ në Republikën e Shqipërisë”; Ligji Nr. 7761, datë 19.10.1993 “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse”, i ndryshuar; Ligji Nr. 7975, datë 26.7.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, i ndryshuar; Ligji Nr. 9718, datë 19.4.2007 “Për urdhrin e infermierit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji Nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar; Ligji Nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”; Ligji Nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji Nr. 111/2018 datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”; Ligji Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe

disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Ligji Nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për Sponsorizimet”, i ndryshuar; Ligji Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Ligji Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji Nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar; Ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji Nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore”, i ndryshuar; VKM Nr. 654, datë 10.11.2017, “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Qendrës Spitalore Universitare, “NËNË TEREZA”; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 447, datë 9.7.2004 “Për përcaktimin e gjendjes së të sëmurit që ka nevojë për ndihmë urgjente, si dhe dokumentacioni i nevojshëm për mbulimin e shpenzimeve të bëra”; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 527, datë 01.11.1993 “Për përcaktimin e çmimeve në sistemin shëndetësor shtetëror”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 508 datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1661 datë 29.12.2008 “Për financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar; VKM Nr. 555, datë 11.08.2011 “Për pagat e punonjësve me arsim të lartë në sistemin e MSH”, i ndryshuar; VKM Nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”; VKM Nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”; VKM Nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar; VKM Nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.

g. Standardet e auditimit:

- ISSAI 100- (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*);
- ISSAI 4000- (*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë*);
- ISSAI 400 - (*Parimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisë*);
- SNA) të IFAC - (*Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*);
- Manual i IDI-t -(*Implementimi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI për auditimet e përputhshmërisë*);
- *Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë*;
- Rregullore e Procedurave të Auditimit në KLSH-së*;
- Kodi etik i KLSH*.

h. Metoda e auditimit:

Auditim i njëpasnjëshëm me zgjedhje dhe ose i plotë sipas gjykimit të audituesit.

i. Dokumentimi i auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave, evidencat e marra gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale të bëra në arritjen e konkluzioneve u konsideruan të përshtatshme dhe të rëndësishme për të konfirmuar dhe mbështetur konkluzionet dhe raportin e audituesve dhe shërbyen si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e evidencave të marra, akt-konstatimeve të mbajtur, observacioneve të paraqitura u përgatit Raporti i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë është Institucion Shëndetësor Publik Kombëtar mjekimi, mësimdhënieje dhe kërkimi shkencor. Drejtimi administrativ i QSUNT është në varësi të Bordit të Spitalit. Qendra Spitalore Universitare, sipas VKM Nr. 352, datë 09.09.1997, pika 5 është emëruar “Nënë Tereza” Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” është person juridik me zotësi të plotë për të vepruar.

Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", është e organizuar nga shërbimet universitare dhe njësi mjekësore, të cilat nga natyra e specialitetit mjekësor/klinik që trajtojnë, kanë lidhje funksionale me shërbimet shëndetësore universitare. Këto njësi realizojnë shërbime shëndetësore, funksione diagnostikuese e trajtuese.

Të ofroj shërbimin mjekësor me përkushtim, profesionalizëm dhe cilësi të larte, duke vënë në dispozicion të të sëmurëve maksimumin e kapaciteteve njerëzore, dijeve dhe falsiteteve që disponon;

Të japë ndihmë mjekësore të specializuar (terciare) për gjithë banoret e vendit dhe shërbim mjekësor dytësor për banoret e Tiranës, duke shërbyer me profesionalizëm sipas rregullave të deontologjisë dhe të etikes mjekësore, si dhe duke ruajtur sekretin profesional dhe informacionin e pacienteve.

Të trajtojë dhe t'u shërbejë të sëmurëve, sipas gjendjes dhe nevojave psikologjike dhe fizike, me standartin me të lartë deontologjik, duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e të sëmurëve, si dhe duke ruajtur sekretin profesional dhe privatësinë e pacienteve.

Të shërbejë si bazë pedagogjike për formimin e studenteve të Mjekësisë, formimin e vazhdueshëm të mjekëve dhe specializanteve.

Të shërbejë si bazë kërkimore-shkencore në fushën e shëndetësisë, në bashkëpunim me Universitetin e Mjekësisë Tiranës dhe struktura të tjera kërkimore shkencore.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Planifikimi, realizimi dhe zbatimi i buxhetit.

a. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të ministrisë së financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Projekt Buxheti 2021-2023

Hartimi i projekt Buxhetit të QSUNT për vitin 2021 dhe 2021-2023 bazohet në Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimin e Përhershëm të Ministrisë së Financave Nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; Udhëzimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 2880, datë 17.06.2020 “Procedurat e hartimit të projekt buxhetit për vitin 2021-2023”, dërguar me email datë 18.06.2020, protokolluar në institucion me Nr. 2129, datë 18.06.2020; Shkresë përcjellëse e FSDKSH me Nr. 39740 prot, datë 24.06.2020, protokolluar në institucion me Nr. 752 prot, datë 26.06.2020 “Mbi hartimin e treguesve të programit buxhetor afat mesëm 2021-2023” Shkresë përcjellëse e FSDKSH me Nr. 460 prot, datë 01.07.2020, protokolluar në institucion me Nr. 2129/74 prot, datë 08.07.2020 “Mbi hartimin e treguesve të programit buxhetor afat mesëm 2021-2023”.

Për hartimin e treguesve të programit buxhetor, referuar shkresës Nr. 2880, datë 17.06.2020 të MSHMS nëpërmjet shkresës Nr. 39740 prot, datë 24.06.2020 “Mbi hartimin e treguesve të programit buxhetor afat mesëm 2021-2023” dhe shkresës Nr. 460, datë 01.07.2020, FSDKSH si

institucion që financon paketën e shërbimeve spitalore të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 308, datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH”, i ndryshuar, ka udhëzuar hartimin e treguesve buxhetore afatmesëm për të ardhurat dhe fondin e shpenzimeve për rimbursimin e barnave e pajisjeve mjekësore.

Në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator të sipërcituar, Drejtori i përgjithshëm i QSUNT, me Urdhër Nr. 203, prot Nr. 2129/1, datë 23.06.2020, ndryshuar me Urdhër Nr. 203/1 prot, datë 01.07.2020 “Për hartimin e projekt buxhetit të QSUNT për vitet 2021 dhe 2022-2023” ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës mbi hartimin mbi parashikimin e projekt buxhetit për vitin 2021 dhe projekt buxhetin afatmesëm 2022-2023, për zërat: 1-Paga dhe Sigurime (llogaria 600; 601); 2-Shpenzime për mallra dhe shërbime (llogaria 602); 3- Investime (llog 230;231) dhe 4-Të ardhurat dytësore. Në përfundim të shqyrtimit të nevojave grupi i punës urdhërohet të hartojë Relacion Përmbledhës për vitin 2021 dhe projekt buxhetin afat mesëm 2022-2023, bazuar në kërkesat me shkrim dhe të analizuara të çdo drejtorie fondet e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve me fonde buxhetore.

Titullari, ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e nevojave të shërbimeve mjekësore në QSUNT për barna dhe materiale mjekësore, me Urdhër Nr. 204, prot Nr. 2129/1, datë 23.06.2020, ndryshuar me Urdhër Nr. 204/1 prot, datë 01.07.2020 “Për hartimin e nevojave për barna dhe materiale mjekësore QSUNT për vitet 2021 dhe PBA 2022-2023”. Në zbatim të Urdhrit Nr.203/2020, janë paraqitur kërkesa për fonde buxhetore për periudhën 2021-2023 në relacionet e paraqitura nga Drejtoria e Performancës Spitalore, me shkresë Nr. 2129/40 prot, datë 02.07.2020, bazuar në kërkesën e sektorëve dhe aktivitet që zhvillon kjo drejtori; Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, me shkresë Nr. 2129/60 prot, datë 03.07.2020, bazuar në projekt buxhetin për kontratat dhe investimet që ndiqen nga kjo drejtori; Drejtoria e IT dhe inxhinierisë Klinike, me shkresë Nr. 2129/61 prot, datë 03.07.2020, bazuar në projekt buxhetin lidhur me mirëmbajtjen e dhe shërbimet për pajisjet mjekësore në QSUNT, të cilat ndiqen nga kjo drejtori etj.

Grupi Punës referuar Urdhrit Nr. 203, prot Nr. 2129/1, datë 23.06.2020, ndryshuar me Urdhër Nr. 203/1 prot, datë 01.07.2020 “Për hartimin e projekt buxhetit të QSUNT për vitet 2021 dhe 2022-2023” ka përgatitur relacion për titullarin, me shkresën Nr. 2129/72 prot, datë 06.07.2021, “Mbi hartimin e PBA për shpenzimet operative, shpenzimet për investime dhe planifikimi të ardhurave dytësore në vitin 2021 dhe PBA 2022-2023”. Relacioni mbështet në kërkesat e drejtorive, në nevojat e shërbimeve dhe mastrplanin zhvillimor të QSUNT, referuar kjo edhe shkresës së MSHMS Nr. 2880 prot, datë 17.06.2020 “Procedurat e hartimit të projekt buxhetit për vitet 2021-2023”. Projekt Buxheti mbulon parashikimin për fondin e pagave, fondit të kontributit për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore; planifikimin shpenzime operative për “mallra dhe shërbime”; planifikimin e artikullit “Investime” dhe planifikimin e të ardhura të vetë institucionit. Vlera totale e shpenzimeve personeli në shumën 3,441.297 mije lekë , shpenzime për mallra dhe shërbime në shumën 12,699,132 mijë lekë dhe shpenzime për investime në shumën 608,2013 mijë lekë, në total 16,748,642 mijë lekë.

Grupi punës, referuar me Urdhrit Nr. 204, prot Nr. 2129/1, datë 23.06.2020, ndryshuar me Urdhër Nr. 204/1 prot, datë 01.07.2020 “Për hartimin e nevojave për barna dhe materiale mjekësore QSUNT për vitet 2021 dhe PBA 2022-2023”, ka hartuar relacion për titullarin e institucionit dhe Drejtorinë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar me shkresën Nr. 2129/71 prot, datë 03.07.2020 për PBA 2021-2023. Nëpërmjet tij, grupi ka vlerësuar nevojat për barna dhe materiale mjekësor, bazuar në kërkesat e ardhura nga shërbimet mjekësore, situatën e furnizimeve me barna dhe materiale mjekësore për vitin 2019 si dhe konsumin mesatar të viteve

paraardhëse. Në informacion trajtohet se kërkesa për fonde buxhetore rritet, me argumentin se: - Ka rritje të numrit të pacientëve të shtruar në spital nga 102,673 pacientë në vitin 2018 në 112,855 pacientë ose 10,182 pacientë më shumë; -Ka rritje të lartë të rasteve për ndërhyrjet kirurgjikale të specializuara në kardiokirurgji dhe neurokirurgji të cilat shoqërohen me kosto të lartë; -Në vitin 2019 ka rritje me 4% të analizave, ndërsa ekzaminimet imazherike kanë pësuar rritje me mbi 60%; -Ka rritje të numrit të pacientëve për onkologjikun, onko-hematologjine pediatike, etj. Të gjitha këto pasqyrohen në shtim të konsumit për barna dhe materiale mjekësore. Sipas relacionit të grupit të punës fondi i parashikuar për vitin 2021 për barna dhe materiale të konsumit mjekësor është 10,358,892 mije lekë dhe në afat mesëm parashikimi për vitin 2023 është 10,606,178 mijë lekë, dhe për vitin 2024 është 11,746,941 mijë lekë.

Me shkresë Nr. 2129/73 prot, datë 06.07.2021, referuar Urdhrit Nr. 203/2020, grupi Punës i ngritur për këtë qëllim, ka përgatitur Relacion mbi Projekt Buxhetin e vitit 2021 dhe PBA 2022-2023 “Mbi hartimin e PBA për shpenzimet kapitale për investime në vitin 2021 dhe PBA 2022-2023”, bazuar në kërkesat e shërbimeve sipas nevojave referuar edhe shkresës së MSHMS me Nr. 2880 prot, datë 17.06.2020 “Procedurat e hartimit të projekt buxhetit për vitet 2021-2023”. Projekt Buxheti për shpenzime kapitale përbëhet nga 1. Projekt dhe preventivë zbatimi për ndërtimet e reja apo rikonstruksione; 2- Ndërtime të reja; 3-Rikonstruksion objektsh; 4- Blerje Pajisje Mjekësore; 5- Blerje Pajisje Mobilimi; 6- Blerje pajisje elektrike, elektronike dhe industriale. Vlera totale e parashikuar për shpenzime për investime kapitale është 608,213 mijë lekë për vitin 2021, 728,074 mijë për vitin 2022 dhe 380,358 mijë lekë për vitin 2023.

Me shkresë Nr. 2129/76 prot, date 08.07.2020 “Për Shpenzimet Operative, Shpenzimet për Investime dhe planifikimit të ardhurave dytësore”, titullari ka dërguar në FSDKSH, parashikimin e Projekt Buxhetit të vitit 2021 dhe afat mesëm 2022-2023, mbështetur në relacionin e grupit të punës ngritur me Urdhër Nr. 203/2020 dhe shkresën e MSHMS me Nr. 2880, datë 17.06.2020 “Mbi procedurat e hartimit të projekt buxhetit për vitet 2021-2023”, sipas së cilës për mbulimin e kërkesave për shpenzime personeli, shpenzime operative dhe shpenzime për investime në total 16,748,642 mijë lekë (përfshirë edhe shpenzimet kapitale për investime).

Gjithashtu, me shkresë Nr. 2129/78 prot, date 08.07.2020, institucioni i është drejtuar MSHMS, me relacion “Për Shpenzimet Kapitale për Investime” mbi hartimin e projekt buxhetit të vitit 2021 dhe plan buxhetin afat mesëm 2021-2023, më të cilën vlera e shpenzimeve kapitale për vitin 2021 parashikohet në shumën 608,213 mijë lekë.

Sa me sipër kërkesa për fonde buxhetore për PBA 2021-2023, referuar shkresave të sipërcituara, paraqitet si më poshtë vijon:

Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore: QSUNT në total ka përllogaritur fonde buxhetore në shumën 3,441,297 mijë lekë dhe sipas një strukture prej 3017 punonjësish në total, të shpërndara në 8 PAI (Pole të Administrimit të Integruar) dhe punonjësit e administratës. Fondi i pagave (llog 600) në total është përllogaritur në shumën u përllogarit në shumën 2,969,073 mijë lekë dhe fondi për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore u përllogarit në shumën 472,224 mije lekë. Shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësor bazohen në kapacitetin e strukturës organike të shërbimeve spitalore të QSUNT.

Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera: QSUNT për vlerësimin e nevojave për hartimin e projekt buxhetit është mbështetur në kërkesat e paraqitura nga shërbimet mjekësore, faktin e furnizimeve me barna për vitet paraardhëse 2019-2020. Në shkresën Nr. 2129/76, datë 08.07.2020, relacion mbi PBA 2021-2023 drejtuar FSDKSH me kërkesë mbi nevojat e institucionit për financimin nga buxheti të shpenzimeve operative, bazuar në të dhënat statistikore të vitit 2017, 2018 dhe vitit 2019, në të cilat ka patur rritje të numrit të shtrimeve në spital për ndërhyrje kirurgjikale në kardiokirurgji, neurologji, onkologjik, hematologji, onko-

hematologji pediatrike të cilat shoqërohen me rritje të kostove laboratorike, imazherike etj., të cilat pasqyrohen me rritje të kërkesës për barna dhe materiale mjekësor. Sipas sektorit të kostos dhe statistikës në QSUNT, theksohet se vitin 2019 ka shënuar një rritje të numrit të pacientëve në 112,698 pacientë nga 102,568 pacientë që ishin në vitin 2018, ose më shumë 10,130 paciente në vitin 2019. Referuar numrit të ndërhyrjeve kirurgjikale rezultoi se në vitin 2019 janë kryer 25,871 ndërhyrje, kundrejt 28,087 ndërhyrje të realizuara në vitin 2018, ose kemi një ulje të rasteve 2,216 ndërhyrje ose 7,9% më pak se viti 2018. Brenda ndërhyrjeve kirurgjikale, ka rritje ai grup ndërhyrjesh që kanë peshe më të lartë në zërin e kostove, si neurokirurgji, kardiokirurgji, kirurgji vazale, të cilat priten të shtohen edhe në vitet në vazhdim. Në shërbimin onkologjik në vitin 2019 janë shënuar 17,335 shtrime kundrejt 17,208 shtrimeve të ndodhura në vitin 2018, me një rritje të shtrimeve për 127 raste ose 0,7% krahasuar me vitin 2018. Të dhënat statistikore të aktivitetit spitalor për periudhën 5-mujore të vitit 2020, nuk mund të merren në konsideratë tërësisht, për shkak të përballimit së situatës së pandemisë Covid-19 dhe masave të marra nga MSHMS me Urdhrin Nr. 147, datë 09.03.2020 për ndërprerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale të planifikuara. Sipas këtij relacioni shpenzimet operative për vitin 2021 janë parashikuar në shumën 12,699,132 mijë lekë, nga të cilat parashikimi për shpenzime për barna dhe materiale mjekësore llogaritet në shumën 10,358,892 mijë lekë.

Shpenzimet për investime: Parashikimi është referuar në procedurat dhe pasqyrat e dërguara nga MSHMS me shkresën Nr. 2129/78 date 08.07.2020 dhe vlerësimin nga grupi i punës i ngritur i ngritur për këtë qëllim nga titullarit institucionit, sipas Urdhrit të Nr. 203, datë 23.06.2020, i ndryshuar. Projekt buxheti për shpenzime kapitale në total parashikon kërkesën për fonde buxhetore në shumën 608,213 mijë lekë për vitin 2021, në shumën 728,374 mije lekë për vitin 2022 në shumën 380,358 mije lekë për vitin 2023, si dhe 386,811 mijë lekë për vitin 2024. Kërkesa për shpenzime kapitale përfshin projekte dhe preventiva zbatimit për ndërtime të reja apo konstruksione, ndërtime të reja, rikonstruksione objektsh, blerje pajisje mjekësore, blerje pajisje mobilimi, blerje pajisje elektrike, elektronike dhe industriale, të pasqyruara në shtojcën 1/A, pasqyra 6 “Lista përmbledhëse e projekteve të investimeve publike me financim të brendshëm të parashikuar në PBA 2021-2023”. Lista përmbledhëse e projekteve për investime parashikon kërkesën për fonde buxhetore për vitin 2021 në shumën 641,381mije lekë dhe përmban:-Projekt Preventiva Zbatimi për ndërtime të reja dhe rikonstruksione (sipas VKM Nr. 305 datë 11.05.2016dhe VKM Nr. 1055 dt.. 22.12.2010) në vlerë 18,502 mije lekë; Rikonstruksione objektsh në vlere 298,107 mije lekë; Blerje Pajisje Mjekësore 219,274 mije lekë; Blerje pajisje mobilimi 10,815 mijë; Blerje pajisje elektrike/elektronike dhe industriale 61,515 mije lekë.

Parashikimi për të ardhurat dytësore. Të ardhurat e veta janë të ardhura të krijuara nga vetë institucioni, të pavarura fondet buxhetore, të krijuara nga përdorimi sistemit të referimit dhe tarifatat e miratuara nga Ministri i MSHMS. Të ardhurat e veta grupohen në: 1-Të ardhura nga shërbimi ambulatorë, konsultat dhe shërbime mjekësore të specializuara; 2- Të ardhura nga veprime administrative. Të ardhurat e parashikuara të institucionit sipas dokumentit të PBA-së 2020-2022, parashikuar nga institucioni me shkresë Nr. 1955/1 prot, datë 15.07.2021 për vitin 2022 parashikohen në shumën 24,820 mijë lekë ose me tendence rënie 4,146 mijë lekë më pak se parashikimi për vitin 2020 si dhe 6,566 mijë lekë më pak se realizmi vitit 2020, kjo për shkak të sistemi të referimit.

Parashikimi të ardhurave të veta sipas PBA 2022-2024 paraqitet sipas tabelës si me poshtë vijon:
Parashikimi të Ardhurave të veta PBA 2021-2023 *(në mije lekë)*

Emërtimi	Fakti	I Pritshmi	Parashikimi	Parashikimi
	2020	2021	2022	2023
Të ardhura nga qiratë	9,842	12,120	12,120	12,000

Të ardhura për edukimin në vazhdim	2,461	2,500	2,700	2,700
Të ardhura nga shërbimi konsultave mjekësore	13,448	10,000	7,000	5,000
Të ardhura nga gjoha, urdhër zhdëmtime	572	700	700	600
Të ardhura nga tarifa të ndryshme të shërb. adm	1,389	1,300	1,300	1,300
Të ardhura nga shërbimi shërbimit ambulatorë	1,254	1,400	1,000	800
Të ardhura të tjera	0	0	0	0
Total	28,966	28,020	24,820	22,400

Planifikimi i buxhetit për të përballuar shpenzimet për barna dhe materiale mjekësore 2021-2023

Me urdhër Nr. 204, prot Nr. 2129/2 datë 23.06.2020, i ndryshuar, Drejtori i përgjithshëm i QSUNT ka urdhëruar ngritjen e grupit të vlerësimit të nevojave të shërbimeve mjekësore të QSUNT për barna dhe materiale mjekësore për vitet 2021-2023, konkluzionet e të cilit janë përcjellë me shkresën Nr. 2129/71, prot datë 03.07.2020. Grupi i Punës me shkresën Nr. 2129/71, datë 03.07.2020, arsyeton se parashikimi në projekt buxhet 2021-2023 mbështet në kërkesat e paraqitura nga shërbimet mjekësore, faktin e furnizimeve me barna për vitet paraardhëse 2019-2020, tendencës se rritjes së numrit të shtrimeve në spital (*sipas evidencës statistikore*) për ndërhyrje kirurgjikale në kardiokirurgji, neurologji, onkologjik, hematologji, onko-hematologji pediatrike të cilat shoqërohen me rritje të kostove laboratorike, imazherike, etj. Këto pasqyrohen me rritje të kërkesës për barna dhe materiale mjekësor. Sipas grupit të punës ngritur me Urdhër Nr. 204, datë 23.06.2020 theksohet numri i pacienteve që kanë përfutur shërbim është rritur duke shkuar nga 102,673 pacientë të shtruar në vitin 2018, në **112,855 pacientë** të shtruar gjatë vitit 2019. Rritje të shtrimeve në spital kanë patur rastet e shtrimeve në kardiokirurgji dhe neurokirurgji, të cilat shoqërohen me kosto të lartë për çdo rast. Gjatë vitit 2019 ka patur një rritje prej 4% të numrit dhe gamës së analizave. Rritje ka pësuar edhe numri i shërbimeve imazherike i cili ka pësuar rritje mbi 60%. Rritje kanë pësuar edhe rastet e shtrimit në pacientëve të onkologjikut, hemtalogjisë, onko-hematologjisë etj. Futja në efikasitet e Shërbimit të Okulistikës, ORL etj. Të gjitha këto pasqyrohen me një shtim të numrit konsumit për barna dhe materiale mjekësore. Për sa më sipër, duke marrë edhe në konsideratë objektivat e MSHMS dhe QSUNT për t'i shërbyer pacientit me standarde ndërkombëtare, buxheti i propozuar nga QSUNT për furnizimin me barna dhe materiale mjekimi, për vitet 2021-2023 paraqitet si më poshtë:

Parashikimi PBA 2021-2023 për barna dhe material mjekësor (në mijë lekë)

Nr.	Emërtimi	Buxheti	I Pritshmi	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
		2019	2020	2021	2022	2023
I	BARNA					
1	Barnat të sistemeve të ndryshme si nervore, anestezi, reanimacion, metabolizëm, hormonale dhe musko-skeletik (Paketa Baze)	N/A	N/A	1,434,654	1,464,871	1,611,143
2	Anti infektive të përgjithshëm + ARV	N/A	N/A	565,449	566,015	669,565
3	Barna për sëmundjet kronike të gjakut dhe organet e tjera faktorët e koagulimit të gjakut	N/A	N/A	1,523,500	1,532,744	1,614,682
4	Antineoplastikë dhe immunomodulatore	N/A	N/A	1,347,552	1,393,147	1,562,337
5	Barna për sëmundjet e rralla	N/A	N/A	1,298,800	1,338,800	1,378,800
	SHUMA			6,169,955	6,295,577	6,836,527
II	MATERIALE MJEKIMI					
6	Materiale mjekimi të përgjithshme	N/A	N/A	2,464,279	2,509,711	2,609,478
7	Materiale mjekimi specifik	N/A	N/A	1,724,658	1,800,891	2,300,935
				4,188,937	4,310,602	4,910,414
	BARNA + MATERIALE MJEKIMI (I)+(II)			10,358,892	10,606,178	11,746,941

(Burimi: Shkresa Nr.2129/71, datë 03.07.2020)

Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi, planifikimit buxhetor për barna dhe materiale mjekimi, për mbulimin e nevojave të QSUNT për fonde buxhetore, zhvillohet një procedurë e pa detajuar dhe e pa mirë analizuar nga shefat e shërbimeve bazuar kryesisht në kërkesat e periudhave të mëparshme, dhe jo në kërkesat reale të fondeve për barna të tilla si konsum historik i llojit të barnave, nevojat për bana sipas mjekimit, numrit të sëmurëve në periudhat e mëparshme, sasia e barnave të akorduara sipas pacientëve, trendi të rritjes se sëmundshmërisë etj.

Planifikimi fondeve buxhetore sipas PBA 2021-2023, hartuar nga QSUNT, në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

Përmbledhëse kërkesës buxhetore 2021-2023 sipas artikujve ekonomike (në mijë lekë)

Nr.	Emërtimi	Buxheti faktik	I pritshmi	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
		2019	2020	2021	2022	2023
I	Shpenzime personeli			3,441,297	3,613,362	3,974,698
1	600-Paga	2,357,551	N/A	2,969,073	3,117,527	3,429,279
2	601-Sigurime Shoqërore	339,612	N/A	472,224	495,835	545,419
II	Mallra dhe shërbime të tjera	4,163,059	3,910,700	12,699,132	12,821,310	14,014,731
1	602-Barna, Materiale mjekësore dhe materiale speciale	N/A	2,084,415	10,358,892	10,606,178	11,746,941
2	602-Mallra dhe shërbime të tjera	N/A	1,826,285	2,340,240	2,215,131	2,267,790
III	Shpenzime Kapitale	0	0	608,213	728,374	380,358
	230- Shpenzime kapitale të patrupëzuara të brendshme			18,502	0	0
1	230-Projekt preventiv zbatim për projektet e reja	N/A	N/A	18,502	0	0
	231- Shpenzime kapitale të trupëzuara të brendshme			589,711	728,374	380,358
2	231-Ndertime të reja	N/A	N/A	0	0	0
3	231-Rikonstruksion objektësh	N/A	N/A	298,107	494,653	28,254
4	231-Blerje pajisje mjekësore	N/A	N/A	219,274	155,834	262,890
5	231-Blerje pajisje mobilimi	N/A	N/A	10815	1,800	
6	231-Blerje pajisje elektronike dhe industriale	N/A	N/A	61,515	76,087	89,213
TOTAL (I)+(II)+(III)		7,099,031	3,910,700	16,748,642	17,163,046	18,369,787

(Burimi: QSUNT, Punoi KLSH)

PROJEKT BUXHETI I VITIT 2022-2024

Në zbatim të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Udhëzimi Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 2939, datë 25.06.2021, protokolluar në QSUT me Nr. 1789, datë 28.06.2021 mbi “Procedurat e Hartimit të Projekt Buxhetit për vitin 2022-2024” është përcjellë në QSUNT formati udhëzues për kryerjen e parashikimit të shpenzimeve nga ana e institucionit.

Drejtori i përgjithshëm i QSUNT, me Urdhër Nr.321, datë 29.06.2021 “Për hartimin e projekt buxhetit të QSUNT për vitet 2022 dhe 2023-2024”, protokoll Nr.1789/1 prot, datë 29.06.2021, ndryshuar me u ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës të përbërë nga 10 anëtarë , të cilët organizojnë procedurat dhe hartimin e raportit për parashikimin e projekt buxhetit të vitit 2022 si dhe projekt buxhetin afat mesëm 2023-2024 për zërat: Paga dhe Sigurime (Ilogaria 600; 601), Shpenzime për mallra dhe shërbime (Ilogaria 602), Investime (Ilog 230;231) dhe të ardhurat dytësore. Grupi i punës do të bazohet në PBA 2021-2023, buxhetin e realizuar të vitit 2020 dhe buxhetin e realizuar të 5-mujorit të parë të vitit 2021 dhe relacionet e çdo drejtorie për plan buxhet 2022-2024.

Në vijim të punës për përgatitjen e projekt buxhetit kanë paraqitur relacion shpjegues: -Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse me shkresë Nr. 1789/43 prot, datë 12.07.2021; Drejtoria Juridike me shkresë Nr. 1789/45, datë 12.07.2021; Drejtoria e IT dhe Inxhinierisë Klinike me shkresë Nr. 1789/48 prot, datë 12.07.2021; Drejtoria e Performancës Spitalore me shkresë Nr. 1789/49 prot, datë 12.07.2021; Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit Financiar me shkresë Nr. 1789/51 prot, datë 12.07.2021.

Drejtori i përgjithshëm i QSUNT, me Urdhër Nr.322, datë 29.06.2021, prot Nr.1789/2 prot, datë 29.06.2021 *“Për hartimin e nevojave për barna dhe materiale mjekësore 2022-2024”*, ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës të përbërë nga 7 anëtarë, për vlerësimin e nevojave për të gjithë shërbimeve mjekësore për barna dhe materiale mjekësore, bazuar në kërkesat e shërbimeve dhe vlerësimet e tyre. Grupi i punës në zbatim të Urdhrit Nr. 322/2021 ka paraqitur informacion me shkresë Nr. 1789/50 prot, datë 12.07.2021, sipas të cilës vlerëson kërkesat e ardhura nga shërbimet mjekësore për barna dhe materiale mjekësore, duke kërkuar fonde buxhetore për barna dhe materiale mjekësore për vitin 2022 në shumën 10,637,812 mijë lekë, për vitin 2023 në shumën 10,744,190 mijë lekë dhe për vitin 2024 në shumën 10,851,632 mijë lekë. Me shkresë Nr. 1955/1 prot, date 15.07.2021, institucioni ka dërguar në FSDKSH, relacion *“Për Shpenzimet Operative, shpenzimet për Investime dhe planifikimit të ardhurave dytësore”* mbi hartimin e projekt buxhetit të vitit 2022 dhe plan buxhetin afat mesëm 2022-2024. Me shkresë Nr. 1789/55 prot, date 21.07.2021, institucioni ka dërguar në MSHMS, relacion *“Për Shpenzimet Kapitale për Investime”* mbi hartimin e projekt buxhetit të vitit 2022 dhe plan buxhetin afat mesëm 2022-2024.

Në total kërkesa për fonde buxhetore 2022-2024, paraqitet në shumën 19,503,842 mijë lekë, nga të cilat shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore 4,100,325 mijë lekë, shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera 14,804,413 mijë lekë, shpenzimet për investime 599,104 mijë lekë, si më poshtë vijon:

Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore: QSUNT në total ka parashikuar fonde buxhetore në shumën 4,100,325 mijë lekë dhe sipas një strukture prej 3017 punonjësish, të shpërndara në 8 PAI-e (Pole të Administrimit të Integruar) dhe punonjësit e administratës qendrore, bazuar në Urdhër e MSHMS Nr. 51/1, datë 21.06.2020, protokolluar në QSUNT me Nr. 578/412, datë 25.06.2020. Fondi i pagave (Ilog 600) në total është përllogaritur në shumën u përllogarit në shumën 3,537,667mijë lekë dhe fondi për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore u përllogarit në shumën 562,658 mije lekë. Shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësor bazohen në kapacitetin e strukturës organike të shërbimeve spitalore të QSUNT. Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera: Për vlerësimin e nevojave për hartimin e projekt buxhetit është mbështetur në kërkesat e paraqitura nga shërbimet mjekësore, faktin e furnizimeve me barna për vitet paraardhëse 2019-2020. Në shkresën Nr. 1955/1, datë 15.07.2021, relacion mbi PBA 2022-2024 drejtuar FSDKSH me kërkesë mbi nevojat e institucionit për financimin nga buxheti të shpenzimeve operative, bazuar në të dhënat statistikore të vitit 2018 dhe vitit 2019, në të cilat ka patur rritje të numrit të shtrimeve në spital për ndërhyrje kirurgjikale në kardiokirurgji, neurologji, onkologjik, hematologji, onko-hematologji pediatrike të cilat shoqërohen me rritje të kostove laboratorike, imazherike, etj., të cilat pasqyrohen me rritje të kërkesës për barna dhe materiale mjekësor. Evidencat statistikore të vitit 2020 dhe 5-mujorit të parë të vitit 2021,shënojnë rënie numrit të pacienteve të hospitalizuar, janë marrë në konsiderate me rezerve për shkak të përballimit së situatës së pandemisë Covid-19. Sipas evidencës statistikore në vitin 2020 numri i pacienteve ka rezultuar 86,178 paciente nga 112,698 pacientë të shtruar në vitin 2019 ose 24% pacientë më pak se në vitin 2020, kjo për shkak të transferimit të një pjesë të ndërhyrjeve kirurgjikale (së bashku me stafin) në spitalin e traumës dhe masave të marra nga

MSHMS me Urdhrin Nr. 147, datë 09.03.2020 për ndërprerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale të planifikuara. Sipas këtij relacioni shpenzimet operative për vitin 2022 janë parashikuar në shumën 14,804,413 mijë lekë, nga të cilat parashikimi për shpenzime për barna dhe materiale mjekësore llogaritet në shumën 10,637,812 mijë lekë.

Shpenzimet për investime: Parashikimi referuar në procedurat dhe pasqyrat e dërguara nga MSHMS me shkresën Nr. 1789/55, date 21.07.2021 dhe vlerësimin nga grupi i punës i ngritur i ngritur për këtë qëllim nga titullarit institucionit, sipas Urdhrit të Nr. 322, datë 29.06.2021, i ndryshuar. Projekt buxheti për shpenzime kapitale në total parashikon kërkesën për fonde buxhetore në shumën 599,104 mijë lekë për vitin 2022, në shumën 641,381mije lekë për vitin 2023 në shumën 416,209 mije për vitin 2024. Kërkesa për shpenzime kapitale përfshin projekte dhe preventiva zbatimit për ndërtime të reja apo konstruksione, ndërtime të reja, rikonstruksione objektsh, blerje pajisje mjekësore, blerje pajisje mobilimi, blerje pajisje elektrike, elektronike dhe industriale, të pasqyruara në shtojcën 1/A, pasqyra 6 “Lista përmbledhëse e projekteve të investimeve publike me financim të brendshëm të parashikuar në PBA 2022-2024”.Lista përmbledhëse e projekteve për investime parashikon kërkesën për fonde buxhetore për vitin 2022 në shumën 599,104 mije lekë dhe përmban:- Projekt Preventiva Zbatimi për ndërtime të reja dhe rikonstruksione (sipas VKM Nr. 305 datë 11.05.2016 dhe VKM Nr. 1055 datë 22.12.2010) në vlerë 10,441mije lekë; Rikonstruksione objektsh në vlere 249,608 mije lekë për: - Blerje Pajisje Mjekësore 207,365 mije lekë; Blerje pajisje mobilimi 11,565 mijë; Blerje pajisje elektrike/elektronike dhe industriale 120,126 mijë lekë.

Përmbledhëse kërkesës buxhetore 2020-2024 sipas artikujve ekonomike (në mije lekë)

Nr.	Emërtimi	Buxheti	I pritshmi	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
		2020	2021	2022	2023	2024
I	Shpenzime personeli	2,785,700	3,201,950	4,100,325	4,100,325	4,100,326
1	600-Paga	2,785,700	2,785,700	3,537,667	3,537,667	3,537,668
2	601-Sigurime Shoqërore		416,250	562,658	562,658	562,658
II	Mallra dhe shërbime të tjera	4,401,868	4,051,367	14,804,413	14,894,369	15,036,632
1	602-Barna, Materiale mjekësore dhe materiale speciale -FSDKSH	N/A	N/A	10,637,812	10,744,190	10,851,632
2	602-Mallra dhe shërbime të tjera-FDKSSH	4,401,868	4,051,367	4,166,601	4,150,179	4,185,000
III	Shpenzime për investime	0	0	599,104	606,167	386,811
1	231-Projekt preventiv zbatimi për projektet e reja -MSHMS	N/A	N/A	10,441	0	0
2	231-Ndertime të reja -MSHMS	N/A	N/A	0	31,644	0
3	231-Rikonstruksion objektsh -MSHMS	N/A	N/A	249,608	434,923	251,550
4	231-Blerje pajisje mjekësore -MSHMS	N/A	N/A	207,365	138,100	135,261
5	231-Blerje pajisje mobilimi -MSHMS	N/A	N/A	11,565	1,500	0
6	231-Blerje pajisje elektronike dhe industriale-MSHMS	N/A	N/A	120,126	0	0
TOTAL (I)+(II)+(III)		7,187,568	7,253,317	19,503,842	19,600,861	19,523,769

(Burimi: QSUNT)

Parashikimi për të ardhurat dytësore. QSUNT realizon të ardhura dytësore, të pavarura nga buxheti i shtetit, të cilat vijnë si rezultat i shërbimeve të ofruara në konsulta dhe shërbime ambulatorë, gjenerimi të ardhurave nga dhënia në shfrytëzim të oborrit të QSUNT.

Të ardhurat e parashikuara të institucionit sipas dokumentit të PBA-së 2022-2022, parashikuar nga institucioni me shkresë Nr. 1955/1 prot, datë 15.07.2021 për vitin 2022 parashikohen në shumën 24,820 mijë lekë ose me tendence rënie 4,146 mijë lekë më pak se parashikimi për vitin

2020, si dhe 6,566 mijë lekë më pak se realizmi vitit 2020. Parashikimi të ardhurave të veta sipas PBA 2022-2024 paraqitet sipas tabelës si me poshtë vijon:

Parashikimi të Ardhurave të veta PBA 2022-2024

(në mijë lekë)

Emërtimi	Fakti	I Pritshmi	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
	2020	2021	2022	2023	2024
Të ardhura nga qiratë	9,842	12,120	12,120	12,000	12,000
Të ardhura për edukimin në vazhdim	2,461	2,500	2,700	2,700	2,700
Të ardhura nga shërbimi konsultave mjekësore	13,448	10,000	7,000	5,000	5,000
Të ardhura nga gjoba, urdhër zhdëmtime	572	700	700	600	600
Të ardhura nga tarifa të ndryshme të shërb. adm	1,389	1,300	1,300	1,300	1,300
Të ardhura nga shërbimi shërbimit ambulatorë	1,254	1,400	1,000	800	800
Të ardhura të tjera	0	0	0	0	0
Total	28,966	28,020	24,820	22,400	22,400

(Burimi: QSUNT)

Planifikimi i buxhetit për të përballuar shpenzimet për barna dhe materiale mjekësore 2022-2024 Drejtori i përgjithshëm i QSUNT, me Urdhër Nr.322, datë 29.06.2021, prot Nr.1789/2 prot, datë 29.06.2021 “Për hartimin e nevojave për barna dhe materiale mjekësore 2022-2024”, ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës të përbërë nga 7 anëtarë, për vlerësimin e nevojave për të gjithë shërbimeve mjekësore për barna dhe materiale mjekësore, bazuar në kërkesat e shërbimeve dhe vlerësimet e tyre.

Grupi i punës me shkresë Nr. 1789/50 prot, datë 12.07.2021, ka hartuar relacion për Titullarin dhe për dijeni për Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar, duke arsyetuar ka vlerësuar nevojat e institucionit për financimin nga buxheti të shpenzimeve operative, bazuar në të dhënat statistikore të vitit 2018 dhe vitit 2019, në të cilat ka patur rritje të numrit të shtrimeve në spital për ndërhyrje kirurgjikale në kardiokirurgji, neurologji, onkologjik, hematologji, onko-hematologji pediatrike të cilat shoqërohen me rritje të kostove laboratorike, imazherike, etj., të cilat pasqyrohen me rritje të kërkesës për barna dhe materiale mjekësor.

Përsa i përket nevojës dhe konsumit për barna, duke qene se viti 2020 ka qene vit pandemik, për reference janë marre vitet e mëparshme të cilat nuk janë prekur nga situata e pandemisë. Evidencat statistikore të vitit 2020 dhe 5-mujorit të pare të vitit 2021, shënojnë rënie numrit të pacienteve të hospitalizuar, janë marrë në konsiderate me rezerve për shkak të përballimit së situatës së pandemisë Covid-19. Sipas evidencës statistikore në vitin 2020 numri i pacienteve ka rezultuar 86,178 paciente nga 112,698 pacientë të shtruar në vitin 2019 ose 24% pacientë më pak se në vitin 2020, kjo për shkak të transferimit të një pjesë të ndërhyrjeve kirurgjikale (se bashku me stafin) në Spitalin e Traumës dhe masave të marra nga MSHMS me Urdhrin Nr. 147, datë 09.03.2020 për ndërprerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale të planifikuara.

Grupi i punës arsyeton se duke u rritur diagnostikimi në fusha të ndryshme, kjo do të evidentojë diagnoza të reja dhe si rrjedhojë protokolle të tjera mjekimi për këto diagnoza, sipas objektivave të MSHMS dhe QSUNT. Të gjitha këto pasqyrohen në shtim të konsumit për barna dhe materiale mjekësore, duke parashikuar që fondi për barna dhe materiale mjekësor për vitin 2022 të parashikohet në vlerën 10,637,812 mijë lekë, për vitin 2023 të parashikohet në shumën 10,744,190 mijë lekë dhe për vitin 2024 të parashikohet në shumën 10,851,632 mijë lekë.

Planifikimi i nevojave për barna 2022-2024 (në mijë lekë)

Nr.	EMËRTIMI	Buxheti 2020	I Pritshmi 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
-----	----------	--------------	-----------------	------------------	------------------	------------------

I	BARNA					
1	Barnat të sistemeve të ndryshme si nervore, anestezi, reanimacion, metabolizëm, hormonale dhe musko-skeletik (Paketa Baze)	N/A	N/A	1,285,015	1,297,865	1,310,843
2	Anti infektive të përgjithshëm + ARV	N/A	N/A	570,548	576,254	582,016
3	Barna për sëmundjet kronike të gjakut dhe organet e tjera faktorët e koagulimit të gjakut	N/A	N/A	1,689,852	1,706,751	1,723,818
4	Antineoplastikë dhe immunomodulatore	N/A	N/A	1,456,789	1,471,357	1,486,070
5	Barna për sëmundjet e rralla	N/A	N/A	1,310,281	1,323,383	1,336,617
SHUMA				6,312,484	6,375,609	6,439,365
II	MATERIALE MJEKIMI					
6	Materiale mjekimi të përgjithshme	N/A	N/A	2,524,402	2,549,646	2,575,142
7	Materiale mjekimi specifik	N/A	N/A	1,800,926	1,818,935	1,837,125
SHUMA				4,325,328	4,368,581	4,412,267
BARNA + MATERIALE MJEKIMI (I)+(II)				10,637,812	10,744,190	10,851,632

(Burimi: QSUNT)

QSUNT, pas vlerësimit të kërkesave të drejtorive të institucionit, bazuar në nevojat e shërbimeve ka hartuar Projekt- Buxhetin për vitin 2022 dhe afat mesëm 2022-2024, sipas zërave të detajuara në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Përmbledhëse kërkesës buxhetore 2021-2023 sipas artikujve ekonomike (në mije lekë)

Nr.	Emërtimi	Buxheti faktik	I pritshmi	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
		2019	2020	2021	2022	2023
I	Shpenzime personeli			3,441,297	3,613,362	3,974,698
1	600-Paga	N/A	N/A	2,969,073	3,117,527	3,429,279
2	601-Sigurime Shoqërore	N/A	N/A	472,224	495,835	545,419
II	Mallra dhe shërbime të tjera	4,163,059	3,910,700	12,699,132	12,821,310	14,014,731
1	602-Barna, Materiale mjekësore dhe materiale speciale	2,522,773	2,084,415	10,358,892	10,606,178	11,746,941
2	602-Mallra dhe shërbime të tjera	1,640,286	1,826,285	2,340,240	2,215,131	2,267,790
III	Shpenzime për investime	0	0	608,213	728,374	380,358
1	230-Projekt preventiv zbatimi për projektet e reja	N/A	N/A	18,502	0	0
2	231-Ndertime të reja	N/A	N/A	0	0	0
3	231-Rikonstruksion objektsh	N/A	N/A	298,107	494,653	28,254
4	231-Blerje pajisje mjekësore	N/A	N/A	219,274	155,834	262,890
5	231-Blerje pajisje mobilimi	N/A	N/A	10815	1,800	
6	231-Blerje pajisje elektronike dhe industriale	N/A	N/A	61,515	76,087	89,213
TOTAL (I)+(II)+(III)				16,748,642	17,163,046	18,369,787

(Burimi: QSUNT; Pasqyra Nr.4: PBA 2021-2023)

Nga auditimi u konstatua se:

1- Në parashikimin e fondeve buxhetore sipas PBA 2021-2023 drejtuar FSDKSH me shkresë Nr. 2129/76 prot, datë 08.07.2020 dhe PBA 2022-2024 drejtuar FSDKSH me Nr. 1955/1 prot, datë 15.07.2021, rezulton se QSUNT nuk ka parashikuar shpenzimet buxhetore sipas paketave të shërbimeve shëndetësore të miratuara. Kjo bie ndesh me kërkesat e VKM Nr. 308, datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH në shërbimin spitalor”, i ndryshuar, pika 4, sipas të cilës fondi financon paketat e shërbimeve shëndetësore, bazuar në koston e shërbimeve sipas shtojcave përkatëse.

Gjithashtu, nuk përputhet edhe me shkresën FSDKSH Nr. 460, datë 01.07.2020 “Për hartimin e treguesve të PBA 2021-2023”, protokolluar në QSUNT me Nr. 2129/74 prot, datë 08.07.2020, në të cilën për parashikimin e shpenzimeve për shërbimin shëndetësor në spital, duhet të

plotësohen pasqyrat shtesë në të cilat kërkohet parashikimi kostos sipas paketave të shërbimeve të miratuara me VKM Nr. 308/2014, të ndryshuar.

2- Bordi Drejtues i QSUT nuk ka miratuar Projekt Buxheti 2021 dhe PBA 2021-2023, në kundërshtim me Statusin Nr. 709, datë 10.10.2018 miratuar me Urdhrin e Përbashkët të MSHMS dhe MARS “Për miratimin e Statusit të QSUNT”, pika 10, germa “a”, si dhe Urdhrin e Ministrit të MSHMS Nr. 369, datë 24.08.2021 “Për ngritjen e bordit drejtues të spitalit universitar QSU “Nënë Tereza”” pika 3 germa “a”.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Statutin e QSUNT dhe Rregulloren bazë të QSUNT, nga punonjësit:

znj. A.F. në cilësinë e Drejtor i Përgjithshëm në QSUNT për periudhën nga data 03.12.2022 deri 31.12.2022. z. E.J. në cilësinë e ish Drejtor i Përgjithshëm në QSUNT për periudhën nga data 01.04.2021 deri 30.11.2021.

b. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Buxheti i QSUNT përcaktohet çdo vit pas daljes në fuqi të VKM-së respektive për financimin e shërbimeve shëndetësore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për shpenzimet operative ku përfshihen shpenzimet për paga, sigurime dhe shërbime.

Përgjatë vitit, FSDKSSH kryen rishikimin e këtij buxheti, duke bërë shtesa për fondet e alokuara në fillim të vitit për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore.

Për buxhetin që lidhet me financimin e investimeve, detajimi i projekteve të miratuara përcillet çdo fillim viti për institucionin nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe përgjatë vitit kryhen rishikimet sipas nevojave. Më hollësisht, për periudhën objekt auditimi, buxhetet e çelura krahasuar me kërkesat në PBA, si dhe rishikimet e kryera përgjatë vitit, trajtohen si më poshtë:

Buxheti i vitit 2021 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2021-2023. Në PBA 2021-2023, për vitin 2021 janë parashikuar 16,748,642 mijë lekë dhe pas rishikimeve të buxhetit janë alokuar 8,815,600 mijë lekë nga FSDKSSH dhe MSHMS ose 7,933,042 mijë lekë më pak se parashikimi buxhetor.

Sipas PBA 2021-2023 për shpenzimet operative QSUNT ka parashikuar për një buxhet prej 16,140,429 mijë lekë, nga të cilat 2,969,073 mijë lekë shpenzime për paga, 472,224 mijë lekë shpenzime për sigurime dhe 12,699,132 mijë lekë për shërbime. Krahasuar me buxhetin e alokuar për institucionin pas rishikimeve të kryera përgjatë vitit, deri në fund të vitit buxheti paraqitet në shumën prej 8,728,088 mijë lekë ose 7,402,341 mijë lekë ose 45.86% më pak se kërkesat e institucionit të parashikuara në PBA. Ndryshimi me i madh paraqitet në zërin e shërbimeve prej 7,402,341 mijë lekë ose 58.11% më pak se parashikimi buxhetor.

PBA 2021-2023 për shpenzimet kapitale për investime ka parashikuar një buxhet prej 608,213 mijë lekë, dhe deri në fund të vitit 2021 nga MSHMS sipas buxhetit të rishikuar janë alokuar fonde në vlerën 77,512 mijë lekë ose 530,701 mijë lekë më pak parashikimi në PBA.

Buxheti i vitit 2021 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2021-2023 (Në mijë lekë)

Emërtimi	Kërkesa	Plani fillestar i miratuar 2021	Buxheti Vjetor 2021	Diferenca (Kërkesa/Plani i rishikuar)	
	PBA 2021-2023				
Shpenzime operative (A)	Paga	2,969,073	2,208,700	3,009,600 ²	40,527
	Sigurime	472,224	324,350	409,250	-62,974

² Në plan janë përfshirë edhe transferime korente për 1,640 mijë lekë që përfaqëson transfertat dhe pagesat për punonjësit nga llogaria 606 për shpërblime për daljet në pension prej 495 mijë lekë dhe për raste fatkeqësish për 1,145 mijë lekë

	Shërbime	12,699,132	3,000,500	5,319,238	-7,379,894
Total (A)		16,140,429	5,533,550	8,738,088	-7,402,341
Shpenzime kapitale (B)	Investime	608,213	365,691	77,512	-530,701
Total (B)		608,213	365,691	77,512	-530,701
TOTAL (A)+(B)		16,748,642	5,899,241	8,815,600	-7,933,042

(Burimi: QSUNT, Punoi KLSH)

Plani i buxhetit: Në zbatim të VKM-së Nr. 20, datë 21.01.2021 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021”, Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” ka miratuar buxheti në vlerë totale 5,533,550 mijë lekë nga të cilat: shpenzime për paga (llog 600) në vlerë 2,208,700 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore (llog 601) në vlerë 324,350 mijë lekë, shpenzime operative llog (602) në vlerë 3,000,500 mijë lekë.

Krahasuar me buxhetin e alokuar për institucionin pas rishikimeve të kryera përgjatë vitit, deri në fund të vitit paraqitet në shumën prej 8,738,088 mijë lekë ose 7,402,341 mijë lekë më pak se kërkesat e parashikuara në PBA. Diferencën më e lartë e ka zëri “Shërbimeve” për 7,379,894 mijë lekë më pak se kërkesa buxhetore, kryesisht për barna dhe materiale mjekësore.

Në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 628/1, datë 22.01.2021, nga MSHMS me shkresën Nr. 142/3 prot, datë 02.02.2021 ka përcjellë në QSUNT çeljen e buxhetit për vitet 2021-2023 për shpenzimet kapitale në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale. Për shpenzimet kapitale për investime, PBA 2021-2023 ka parashikuar buxhet në shumën 608,213 mijë lekë. MSHMS deri në fund të vitit 2021 ka alokuar 77,512 mijë lekë ose 530,701 mijë lekë më pak se parashikimi në PBA.

VKM Nr. 20, datë 20.01.2021 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e kujdesit shëndetësor për vitin 2021” ka miratuar buxhetin për çdo shërbim spitalor.

FSDKSH ka përcjellë buxhetin e miratuar për vitin 2021 (fillestar) me shkresën Nr.670 prot, datë 01.02.2021, protokolluar në QSUNT, Nr. 80, datë 03.02.2021 dhe shkresën Nr. 80/5 prot, datë 04.02.2021 protokollar me Nr. 515/2, datë 08.02.2021, se bashku me detajimin mujor të çelur në degën e thesarit:-

Drejtori i përgjithshëm i QSUNT, nëpërmjet Urdhrit Nr.57, datë 03.02.2021, protokolluar në Nr.515, datë 03.02.2021, ka urdhëruar shpërndarjen e shpenzimeve operative (llog 602) në vlerën e miratuar prej 3,000,500 mijë lekë në total të detajuar sipas pasqyrës bashkëlidhur. Titullari ka urdhëruar detajimin mujor të fondeve të llog. 600 në shumën 2,208,700 mijë lekë, të fondeve të llog. 601 për shumën 324,350 mijë lekë. Peshën specifike më të lartë në shpërndarjen e shpenzimeve operative, e zë nën llogaria “Barna, materiale dhe proteza mjekësore” në shumën 1,134,640 mijë lekë ose 37.8 të fondeve të llog.602.

Ndryshime në buxhet

Ndryshimet për shpenzime paga, sigurime dhe shërbime

1. Me shkresën Nr.1526, datë 10.03.2021 të FSDKSH, protokolluar me Nr.867, datë 16.03.2021 është përcjellë në QSUNT shtesa e buxhetit në shërbimin spitalor, në vijim të Vendimit të KA të FSDKSH Nr.6, datë 24.02.2021 “Për financimin shtesë të spitaleve publike për realizimin e paketave të shërbimeve të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, të ofruara nga shërbimet spitalore publike në vitin 2021” duke informuar se shtesa e buxhetit konsiston në realizimin e paketave të kardiologjisë, kardiokirurgjisë, dializës dhe radioterapisë duke shtuar në total shumën prej 1,001,300 mijë lekë, nga të cilat shpenzime për paga (llog 600) janë shtuar me 147,000 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore (llog 601) janë shtuar me 23,600 mijë lekë, shpenzime për mallra dhe shërbime llog (602) janë shtuar me 830,700 mijë lekë.

Plani i rishikuar i QSUNT rezulton në vlerën totale prej 6,534,850 mijë lekë nga të cilat shpenzime për paga (600) në vlerë 2,355,700 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore (601) në vlerë 347,950 mijë lekë dhe shpenzime operative (602) në vlerë 3,831,200 mijë lekë.

Me Urdhër të Drejtorit të QSUNT Nr. 57/1prot, datë 24.03.2021, Prot Nr.515/3,datë 24.03.2021 është urdhëruar shpërndarja e shpenzimeve operative të llog. 602, për vlerën e shtuar, duke shtuar fondet në *“barna, materiale dhe proteza mjekësore”* me 550,700 mijë lekë dhe fondet në *“blerje oksigjen shëndetësor”* me 250,000 mijë lekë dhe shërbime të tjera (*pedagoget*) me 30,000 mijë lekë, në total shtesë prej 830,700 mijë lekë, llog. 600 shtese prej 147,000 mijë lekë dhe llog.601 shtesë prej 23,600 mijë lekë.

2. Me shkresën Nr. 2922/13 prot, datë 26.05.2021, protokolluar me Nr. 876/3 prot, datë 31.05.2021, QSUNT është informuar nga FSDKSH, mbi ndryshimet në buxhetin e vitit 2021. Ndryshimet kanë ardhur si rrjedhojë e ndryshimit VKM Nr. 20, datë 20.01.2021 me VKM Nr. 300, datë 19.05.2021 *“Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021”*, sipas të cilës buxheti në total shtohet shumë prej 718,467 mijë lekë, nga të cilat shpenzime për paga (llog 600) janë shtuar me 430,000 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore (llog 601) janë shtuar me 68,300 mijë lekë, shpenzime për mallra dhe shërbime llog (602) janë shtuar për shpenzime për PPP (laboratori) për 220,167 mijë lekë.

Plani i rishikuar i QSUNT rezulton në vlerën totale prej 7,253,317 mijë lekë nga të cilat shpenzime për paga (600) në vlerë 2,785,700 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore (601) në vlerë 416,250 mijë lekë dhe shpenzime operative (602) në vlerë 4,051,367 mijë lekë.

Me Urdhër të Drejtorit të QSUNT Nr. 57/2 prot, datë 02.06.2021, Prot Nr.515/5,datë 02.06.2021 është urdhëruar shpërndarja e shpenzimeve operative për vlerën e shtuar, duke shtuar fondet në *“blerje oksigjen shëndetësor”* me 220,167 mijë lekë.

Brenda llogarive ekonomike ka dhe rishpërndarje duke shtuar fondet në *“barna, materiale dhe proteza mjekësore”* me 70,000 mijë lekë, shërbime të tjera (*pedagoget*) me 30,000 mijë lekë dhe pakësuar fondet *“blerje oksigjen shëndetësor”* me 100,000 mijë lekë, efekt zero në total.

3. Me shkresën Nr. 4102 prot, datë 02.08.2021, protokolluar me Nr. 876/6 prot, datë 04.08.2021, QSUNT është informuar nga FSDKSH, mbi ndryshimet në buxhetin e vitit 2021. Ndryshimet kanë ardhur si rrjedhojë e Vendimit të KA të FSDKSH Nr.15, datë 27.07.2021 *“Për shpërndarjen e rezervës së buxhetit të shërbimit spitalor për vitin 2021”*, duke shtuar në totalin prej 584,546 mijë lekë, nga të cilat: shpenzime për paga (llog 600) janë shtuar me 80,000 mijë lekë dhe shpenzime operative llog (602) janë shtuar me 504,546 mijë lekë.

Plani i rishikuar i QSUNT rezulton në vlerën totale prej 7,837,863 mijë lekë, nga të cilat shpenzime për paga (600) në vlerë 2,865,700 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore (601) në vlerë 416,250 mijë lekë dhe shpenzime operative (602) në vlerë 4,555,913 mijë lekë.

Me Urdhër të Drejtorit të QSUNT Nr. 57/3, datë 18.08.2021, protokolluar me Nr. 515/25prot, datë 18.08.2021 është urdhëruar shpërndarja e shpenzimeve operative me vlerën e shtuar, duke kryer ndryshime që kanë konsistuar në shtesa e pakësime të fondeve në llogarinë 602. Ndryshimet në shtesa dhe ka patur në fondet në *“barna, materiale dhe proteza mjekësore”* të cilat janë shtuar me 160,000 mijë lekë, shpenzime laboratorike mjekësore (për PPP/ laboratori) për 354,546 mijë lekë, shpenzime për energji elektrike në shumë 10,000 mijë lekë. Pikësimet kane ndodhur në zërat shpenzime për *“shërbim katering”* në shumë 10,000 mijë lekë, shpenzime për *“ujë”* në shumë 10,000 mijë lekë, në total shtesa 504,546 mijë lekë.

Me Urdhër të Drejtorit të QSUNT Nr. 57/4, datë 25.08.2021, protokolluar me Nr. 515/26 prot, datë 25.08.2021, është urdhëruar rishpërndarja e shpenzimeve operative me vlerën e shtuar, duke kryer ndryshime që kanë konsistuar në shtesa e pakësime të fondeve në llogarinë 602, pa

ndryshime në total. Ndryshimet kanë ndodhur në shtesa ka patur në fondet në “barna, materiale dhe proteza mjekësore” të cilat janë shtuar me 45,500 mijë lekë. Pakësimet kanë ndodhur në zërat shpenzime për “energji elektrike” në shumën 1,000 mijë lekë, shpenzime për “ujë” në shumën 2,000 mijë lekë, shpenzime për ekzekutimin e detyrimeve kontraktuale dhe gjyqësore të papaguara në shumën 30,000 mijë lekë, shpenzime të pjesëmarrjes në projekte dhe shërbime me IAEA në shumën 3,000 mijë lekë, shpenzime për tatime, taksa dhe tarifa të pagueshme nga institucioni në shumën 2,000 mijë lekë. Në total shtesa zero lekë.

Me shkresën Nr. 5339/13 prot, datë 07.10.2021, protokolluar me Nr. 876/9 prot, datë 12.10.2021, QSUNT është informuar nga FSDKSH, mbi ndryshimet në buxhetin e vitit 2021. Ndryshimet kanë ardhur si rrjedhojë e ndryshimit VKM Nr. 20, datë 20.01.2021 me VKM Nr. 563, datë 29.09.2021 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021”, sipas të cilës buxheti në total shtohet shumën prej 409,250 mijë lekë, nga të cilat shpenzime për paga (llog 600) janë shtuar me 118,900 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore (llog 601) janë shtuar me 15,000 mijë lekë, shpenzime për mallra dhe shërbime llog (602) janë shtuar për shërbime dhe shpenzime për PPP (laboratori) për 400,000 mijë lekë, ndërsa shpenzimet për sigurime janë pakësuar në shumën 6,000 mijë lekë. Plani i rishikuar i QSUNT rezulton në vlerën totale prej 8,246,863 mijë lekë nga të cilat shpenzime për paga (600) në vlerë 2,880,700 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore (601) në vlerë 410,250 mijë lekë dhe shpenzime operative (602) në vlerë 4,955,913 mijë lekë.

Me Urdhër të Drejtorit të QSUNT Nr. 57/5 prot, datë 15.10.2021, protokolluar me Nr.515/27, datë 15.10.2021 është urdhëruar shpërndarja e shpenzimeve operative (llog 602) për vlerën e shtuar, duke shtuar fondet për “barna, materiale dhe proteza mjekësore” me 230,000 mijë lekë, shërbime laboratorike mjekësore në shumën 100,000 mije lekë dhe shpenzime “oksigen shëndetësor” shumën 70,000 mijë lekë, në total 363,325 mije lekë.

Me shkresën Nr. 6214 prot, datë 19.11.2021, protokolluar me Nr. 876/10 prot, datë 25.11.2021, QSUNT është informuar nga FSDKSH, mbi ndryshimet në buxhetin e vitit 2021. Ndryshimet kanë ardhur si rrjedhojë e ndryshimit VKM Nr. 20, datë 20.01.2021 me VKM Nr. 702, datë 18.11.2021 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021”, sipas të cilës buxheti në total shtohet shumën prej 481,225 mijë lekë, nga të cilat shpenzime për paga (llog 600) janë shtuar me 118,900 mijë lekë, shpenzime për mallra dhe shërbime llog (602) janë shtuar për shërbime operative për 363,325 mijë lekë, ndërsa shpenzimet për sigurime janë pakësuar në shumën 1,000 mijë lekë. Plani i rishikuar i QSUNT rezulton në vlerën totale prej 8,728,088 mijë lekë nga të cilat shpenzime për paga (600) në vlerë 2,999,600 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore (601) në vlerë 409,250 mijë lekë dhe shpenzime operative (602) në vlerë 5,319,238 mijë lekë.

Me Urdhër të Drejtorit të QSUNT Nr. 57/6 prot, datë 26.11.2021, protokolluar me Nr.515/28, datë 15.10.2021 është urdhëruar shpërndarja e shpenzimeve operative (llog 602) për vlerën e shtuar, duke shtuar fondet për “barna, materiale dhe proteza mjekësore” me 338,325 mijë lekë, “shpenzime për mirëmbajtjen e aparaturave dhe IT” në shumën 25,000 mijë lekë, në total 363,325 mije lekë.

Me shkresën Nr. 6798 prot, datë 21.12.2021, protokolluar me Nr. 876/12 prot, datë 28.12.2021, QSUNT është informuar nga FSDKSH, mbi ndryshimet në buxhetin e vitit 2021. Ndryshimet kanë ardhur si rrjedhojë e Vendimit të KA të FSDKSH Nr.25, datë 07.12.2021 “Për shpërndarjen e rezervës së buxhetit të shërbimit spitalor për vitin 2021”, duke shtuar në total shpenzimet për paga llog (600) shtesë me 10,000 mijë lekë.

Me Urdhër të Drejtorit të QSUNT Nr. 57/7, datë 28.12.2021, protokolluar me Nr. 515/29prot, datë 28.12.2021, është urdhëruar rishpërndarja e shpenzimeve operative me vlerën e shtuar, duke

kryer ndryshime që kanë konsistuar në shtesa e pakësime të fondeve (llog. 602). Ndryshimet kanë pësuar pothuaj të gjithë nënzërat e llogarisë 602 si më poshtë vijon:

- Shtesa në total në shumën 98,463 mijë lekë në zërat: - “blerje kancelari” në shumën 2,400 mijë lekë; “barna, materiale dhe proteza mjekësore” në shumën 23,421 mijë lekë; “shërbim katering” në shumën 5,890 mijë lekë; “hemodializa, shpenzime transporti” në shumën 1,000 mijë lekë; “energji elektrike” në shumën 8,309 mijë lekë; “shërbime telefonike” në shumën 379 mijë lekë; “poste dhe shërbim korrier” në shumën 3 mijë lekë; “shërbim për ngrohje” në shumën 14,000 mijë lekë; “shërbim bankar, zhdoganim, tvsh dhe burime radioaktive...” në shumën 2,700 mijë lekë; “pjesë këmbimi, goma dhe bateri” në shumën 14 mijë lekë; “shpenzime të siguracionit të mjeteve të transportit” në shumën 936 mijë lekë; “shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore” në shumën 6,850 mijë lekë; “shpenzime për ekzekutimin e detyrimeve kontraktuale dhe vendimeve gjyqësore” në shumën 31,800 mijë lekë; “shpenzime të tjera për materiale, shërbime etj.” në shumën 761 mijë lekë.

-Pakësimet në total 98,463 kane ndodhur në zërat shpenzime për “materiale pastrim, dezinfektim” në shumën 3,690 mijë lekë; “blerje dokumentacion dhe shtypshkrime” në shumën 1,600 mijë lekë; “uniforma dhe veshje të tjera speciale” në shumën 3,000 mijë lekë; “shërbimi lavanterisë” në shumën 3,300 mijë lekë; “energji elektrike” në shumën 6,271 mijë lekë; “shërbime të sigurimit dhe ruajtjes” në shumën 24,255 mijë lekë; “shërbim pastrim gjelbërimi” në shumën 5,288 mijë lekë; “furnizimi me materiale dhe trajtimi i mbetjeve spitalore dhe citostatike” në shumën 1,660 mijë lekë; “shërbime të tjera (*pedagoget*)” në shumën 90 mijë lekë; “karburant dhe vaj” në shumën 190 mijë lekë; “udhëtime dhe dieta brenda dhe jashtë vendit” në shumën 60 mijë lekë; “shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe IT” në shumën 12,900 mijë lekë; “blerje pjesë këmbimi për aparaturat mjekësore” në shumën 10,000 mijë lekë; “blerje pjesë për IT” në shumën 2,922 mijë lekë; “shpenzime për mirëmbajtje impiantistikës” në shumën 12,310 mijë lekë; “shpenzime për mirëmbajtje mjete transporti” në shumën 2,279 mijë lekë; “shpenzime për mirëmbajtje sistem informacioni SISP” në shumën 594 mijë lekë; “shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largim nga puna” në shumën 3,500 mijë lekë; “shpenzime për pritje-përcjellje” në shumën 500 mijë lekë; “shpenzime për aktivitete sociale për personelin” në shumën 500 mijë lekë; “shpenzime gjyqësore” në shumën 200 mijë lekë; “shpenzime të pjesëmarrjes në projekte dhe shërbime me IAEA” në shumën 2,000 mijë lekë; “shpenzime të pjesëmarrjes në konferenca” në shumën 500 mijë lekë; “shpenzime për tatime, taksa dhe tarifa ” në shumën 454 mijë lekë; “shërbimi monitorimit të medias me çështje që kanë lidhje me QSUNT” në shumën 400 mijë lekë.

Plani i rishikuar i QSUNT rezulton në vlerën totale prej 8,738,088 mijë lekë, nga të cilat shpenzime për paga (600) në vlerë 3,009,600 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore (601) në vlerë 409,250 mijë lekë dhe shpenzime operative (602) në vlerë 5,319,238 mijë lekë.

Ndryshimet në buxhetin për investime

Në zbatim të Ligjit Nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, Ligjit Nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, si dhe në vijim të shkresë së MFE Nr. 628/1, datë 22.01.2021, MSHMS me shkresën Nr. 142/3 prot, datë 02.02.2021, protokolluar në institucion me Nr. 532, datë 05.02.2021 ka çelur buxhetin për vitet 2021-2023 për shpenzimet kapitale (artikull 231) në shumën 365,691 mijë lekë. Fondi çelur për furnizim-vendosje aparatura mjekësore për spitalin e ri të ndërtuar me kredi të CEB-it në shumën 235,691 mijë lekë dhe furnizim-vendosje aparatura mjekësore, mobilim dhe hoteleri për godinën e re të pediatriisë të ndërtuar me kredi të Bankës Botërore në shumën 130,000 mijë lekë. Për sa i përket shpenzimeve për investime (llog. 231) për vitin 2021, me shkresën Nr. 142/3, prot datë 02.02.2021 të

Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përcjellë për QSUNT buxheti i çelur (fillestar) akordohet në vlerën 365,691 mijë lekë, i detajuar si më poshtë vijon, sipas tabelës së mëposhtme:

Projektet e çelura për investime për vitin 2021 (Në mijë lekë)

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti fillestar
18BB103	F.V aparatura mjekësore për spitalin e ri ndërtuar me kredi të CEB	235,691
18BB137	F.V aparatura mjekësore, mobilim dhe hoteleri për godinën e re të pediatriisë ndërtuar me kredi të BB	130,000
Total		365,691

(Burimi : QSUNT)

Përgjatë vitit 2021 janë kryer ndryshimet si më poshtë:

1. Me shkresën e MSHMS Nr. 2460/2 prot, 17.06.2021, bazuar në shkresën e MFE Nr. 9724/1 prot, datë 10.06.2021 janë transferuar fondet për investime për QSUNT në total pakësim në shumën 1,478 mijë lekë projektin:

- “F.V. aparatura mjekësore për spitalin e ri të ndërtuar në QSUT me kredi të CEB-it”, duke pakësuar fondet në shumën 235,691 mijë lekë projektin;
- “F.V. aparatura mjekësore, hoteleri dhe mobilim për spitalin e ri të ndërtuar në QSUT me kredi të CEB-it,” duke shtuar në vlere 189,641 mijë lekë;
- “FV pajisje mobilimi dhe sinjalistika për godinën e re të Pediatriisë ndërtuar me Kredi të Bankës Botërore” duke shtuar në shumën 42,272 mijë;
- “Pagese TVSH për Grantin Japonez”, duke pakësuar në shumën 2,300 mijë lekë.

2. Me shkresën Nr. 3923/2, prot datë 11.10.2021 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, protokolluar me Nr. 3923/2 prot, datë 11.10.2021, buxheti i QSUNT për investime është shtuar me vlerën 15,043 mijë lekë, fonde këto fillimisht të alokuara për projektin:

- “Rikonstruksion i godinës se arkivës së kartelave mjekësore në QSUNT”, parashikuar në PBA 2021-2023, por në vlere disa here më të vogël, përkatësisht “Rikonstruksioni për ambientin e arkivës se administratës në QSUNT” në vlere 2,314 mije lekë dhe “Supervizion + kolaudim për rehabilitimin e ambientit të arkivës se administratës në QSUNT” në vlerë 55 mijë lekë. Me shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Nr. 4656/2 prot datë 01.12.2021, protokolluar me Nr. 532/ 6 prot, datë 13.12.2021, buxheti QSUNT për investime është pakësuar me vlerë 270,174 mijë lekë, fonde këto të alokuara për projektet:

- F.V. aparatura mjekësore për spitalin e ri të ndërtuar në QSUT me kredi të CEB-it, në shumën 189,641 mijë lekë;
- F.V. aparatura mjekësore, mobilimi dhe hotellerie për godinën e re të pediatriisë ndërtuar me kredi të Bankës Botërore, në shumën 65,489 mijë lekë dhe;
- FV pajisje mobilimi dhe sinjalistika për godinën e re të pediatriisë ndërtuar me Kredi të Bankës Botërore në shumën 15,043 mijë lekë. Po brenda muajit dhjetor 2021 me shkresë të Ministrisë dhe Mbrojtjes Sociale, Nr. 4942/2 prot, datë 30.12.2021, protokolluar në QSUNT me Nr. 532/8, datë 31.12.2021 fondet për investime kapitale janë pakësuar në shumën 31,575 mijë lekë për projektin:
- “F.V. aparatura mjekësore, mobilimi dhe hotellerie për godinën e re të pediatriisë ndërtuar me kredi të Bankës Botërore” pakësim në shumën 26,527 mijë lekë dhe;
- “Rikonstruksion i godinës se arkivës se kartelave mjekësore në QSUNT” pakësim për vlerën 5,048 mijë lekë. Në total për vitin 2021, fondet buxhetore për investime kapitale janë pakësuar në

shumën 301,749 mijë lekë ose investimet kapitale për projektet e miratuara janë ulur në masën 78.80%.

Fondet buxhetore për investime kapitale 2021 (në mijë lekë)

Kodi projektit	Emërtimi i projektit	Buxheti i vitit 2021					Buxheti final
		Plani Çelur	shtesë/pakësim	shtesë/pakësim	shtesë/pakësim	Shtesë/Pakësim	
18BB103	F.V. aparatura mjekësore për spitalin e ri të ndërtuar në QSUT me kredi të CEB-it (kontributi i qev.shqiptare)	235,691	(46,050)		(189,641)		0
18BB137	F.V. aparatura mjekësore, mobilimi dhe Hotelerie për godinën e re të pediatriisë ndërtuar me kredi të Bankës Botërore	130,000		0	(65,490)	-26,527	37,983
18BB140	FV pajisje mobilimi dhe sinjalistika për godinën e re të Pediatriisë ndërtuar me Kredi të Bankës Botërore		42,272		(15,043)		27,229
18BB078	Pagese TVSH për Grantin Japonez		2,300				2,300
18BB079	Rikonstruksion I godinës se Arkivës se Kartelave Mjekësore në QSU Nene Tereza Tirane		-	14,048		(5,048)	9,000
18BB080	Supervizion dhe kolaudim për rikonstruksionin e godinës se Arkivës se Kartelave Mjekësore në QSUT		-	1,000			1,000
	Shuma	365,691	-1,478	15,048	-270,174	-31,575	77,512
		MSHMS shk 142/3, dt. 02.02.2021	MSHMS shkrese Nr. 2460/2 prot, date 17.06.2021	MSHMS shk 3923/2, dt. 11.10.2021	MSHMS shk 4656/2, dt. 01.12.2021	MSHMS shk 4942/2 prto, date 30.12.2021	

(Burimi: QSUNT)

Në mënyrë të përmbledhur, plani fillestar i buxhetit miratuar me VKM Nr. 20, datë 21.01.2021, si dhe plani përfundimtar pas shtesave/pakësimeve përgjatë vitit 2021, paraqitet si më poshtë:

Rishikimet e buxhetit të vitit 2021 (Në mijë lekë)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2021-2023	Plani fillestar i miratuar 2021	Plani rishikuar 2021	Plani rishikuar 2021	Plani rishikuar 2021	Plani rishikuar 2021	Plani rishikuar 2021	Plani rishikuar 2021	Plani rishikuar 2021	Plani rishikuar 2021	Diferenca (Kërkesa-Plani i rishikuar)
Shpenzime Operative (A)	Paga	2,969,073	2,208,700	+147,000	+430,000	+80,000	+15,000	+118,900	+10,000	+3,009,600	40,527
	Sigurime	472,224	324,350	+23,600	+68,300	0	-6,000	-1,000	0	+409,250	-62,974
	Shërbime	12,699,132	3,000,500	+830,700	+220,167	+504,546	+400,000	+363,325	0	+5,319,238	7,379,894
Total (A)	16,140,429	5,533,550	1,001,300	718,467	584,546	409,000	481,225	10,000	8,738,088	7,402,341	
Shpenzime Kapitale (B)	Investime	608,213	365,691	0	-1,478	0	+15,048	0	301,749	+77,512	-530,701
		608,213	365,691	0	-1,478	0	15,048	0	301,749	77,512	-530,701
TOTAL (A)+(B)	16,748,642	5,899,241	1,001,300	716,989	584,546	424,048	481,225	291,749	8,815,600	7,933,042	

(Burimi: QSUNT)

Nga auditimi konstatohet se:

Kërkesat e institucionit lidhur me fondet e miratuara për investime, nuk rezultojnë të merren në konsideratë nga MSHMS. Financimet për investime kapitale për vitin 2021 për kodin 18BB103 “F.V. aparatura mjekësore për spitalin e ri të ndërtuar në QSUT me kredi të CEB-it” në vlerë fillestare 235,691 mijë lekë, për projektin me kod 18BB137 “F.V. aparatura mjekësore, mobilimi dhe hotelerie për godinën e re të pediatriisë ndërtuar me kredi të Bankës Botërore” në vlerë 130,000 mijë lekë dhe projektin me kod 18BB140 “FV pajisje mobilimi dhe sinjalistika për godinën e re të Pediatriisë ndërtuar me Kredi të Bankës Botërore” në vlerë 42,272 mijë lekë, nuk janë propozuar nga QSUNT në PBA-në 2021-2023, referuar Pasqyrës Nr. 6 “Lista Përmbledhëse

e Projekteve të Investimeve Publike me Financim të Brendshëm të parashikuara”, dërguar në MSHMS me shkresë Nr. 2129/78 prot, datë 08.07.2020.

2. Deri në fund të vitit buxhetor, midis buxheteve të miratuara/rishikuara dhe kërkesave të QSUNT për shpenzime operative dhe kapitale, përcjellë respektivisht për FSDKSSH dhe MSHMS, ekzistojnë diferenca të konsiderueshme në shumën 7,933,042 mijë lekë. Diferenca me e lartë konstatohet në zërin “Shërbime” për 7,379,894 mijë lekë ose 58.11% më pak se buxheti i kërkuar në PBA 2021-2024. Duke marrë në analizë peshën specifike të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike në planin e shpenzimeve buxhetore mbi totalin e buxhetit e QSUNT për vitin 2021 në shumën 8,815,600 mijë lekë, siç mund të konstatohet në tabelën më lart pjesën më të madhe e zënë shpenzimet në llogarinë “Mallra dhe shërbime të tjera” me rreth 60.15%, pas tij llogaria “Paga” me rreth 34.13%, dhe “Sigurime shoqërore” me rreth 4.64%. “Shpenzimet kapitale” zënë një peshë mjaft të vogël në vetëm 0.88% të buxhetit të planifikuar.

Buxheti i vitit 2022 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2022-2024.

Në PBA 2022-2024, për vitin 2022 janë planifikuar 19,503,842 mijë lekë dhe deri në fund të vitit 2022 pas rishikimeve të buxhetit janë alokuar 9,346,328 mijë lekë nga FSDKSSH dhe MSHMS ose 10,157,514 mijë lekë më pak se plani në PBA.

Sipas PBA 2022-2024 për QSUNT për shpenzimet operative është parashikuar një buxhet prej 18,904,738 mijë lekë, nga të cilat 3,537,667 mijë lekë shpenzime për paga, 562,658 mijë lekë shpenzime për sigurime dhe 14,804,413 mijë lekë për shërbime. Buxheti alokuar pas rishikimeve të kryera përgjatë vitit, deri në fund të vitit buxheti paraqitet alokohet në shumën prej 9,346,328 mijë lekë ose 10,157,514 mijë lekë ose 47.92% më pak se kërkesat e institucionit të parashikuara në PBA. Ndryshimi me i madh paraqitet në zërin e shërbimeve prej 8,856,643 mijë lekë ose 40.18% më pak se parashikimi buxhetore. Diferenca vjen kryesisht në zërin e për shkak të fondeve më të ulëta të vendosura në dispozicion për QSUNT për barna dhe materiale mjekësore krahasuar kjo me kërkesat në PBA. Për shpenzimet kapitale për investime, në PBA 2022-2024 është parashikuar një buxhet prej 599,104 mijë lekë dhe deri në fund të vitit 2022 nga MSHMS nga buxheti i rishikuar janë alokuar fonde në vlerën 250,836 mijë lekë ose 348,268 mijë lekë ose 41.87% më pak parashikimi në PBA.

Buxheti i vitit 2022 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2022-2024

(në mijë lekë)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2022 - 2024	Plani fillestar i miratuar 2022	Buxheti vjetor 2022	Diferenca (Kërkesa/Plani i rishikuar)	
Shpenzime operative (A)	Paga	3,537,667	2,930,000	2,721,425	-816,242
	Sigurime	562,658	392,000	426,297	-136,361
	Shërbime	14,804,413	3,750,000	5,947,770	-8,856,643
Total (A)	18,904,738	7,072,000	9,095,492	-9,809,246	
Shpenzime kapitale (B)	Investime	599,104	0	250,836	-348,268
Total (B)	599,104	0	250,836	-348,268	
TOTAL (A)+(B)	19,503,842	7,072,000	9,346,328	-10,157,514	

(Burimi: QSUNT, Punoi KLSH)

Plani i buxhetit:–Në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 19405/138, datë 16.01.2014, të VKM-së Nr. 43, datë 19.01.2022 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2022”, Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, MFE me shkresë Nr. 19405/138, datë 16.01.2014 “Detajimi i limit mujor”, ka miratuar buxhetin 2022 (fillestar) në vlerë totale 7,072,000 mijë lekë nga të cilat: shpenzime për paga (Ilog 600) në vlerë 2,930,000 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore (Ilog 601) në vlerë 392,000 mijë lekë, shpenzime operative Ilog (602) në vlerë 3,750,000 mijë lekë.

Drejtori i përgjithshëm i QSUNT, nëpërmjet Urdhrit Nr.62, datë 03.02.2022, protokolluar në Nr.567, datë 03.02.2022, ka urdhëruar shpërndarjen e shpenzimeve operative (llog 602) në vlerën e miratuar prej 3,750,000 mijë lekë në total të detajuar sipas pasqyrës bashkëlidhur. Titullari ka urdhëruar detajimin mujor të fondeve të llog. 600 në shumën 2,930,000 mijë lekë, të fondeve të llog. 601 për shumën 392,000 mijë lekë. Peshën specifike më të lartë në shpërndarjen e shpenzimeve operative, e zë nënlllogaria “*barna, materiale dhe proteza mjekësore*” në shumën 1,170,340 mijë lekë ose 31.21% të fondeve të llog.602. *Ndryshimet për shpenzime paga, sigurime dhe shërbime.*

Me shkresën Nr.1316, datë 28.02.2022 të FSDKSH, protokolluar me Nr.567/2, datë 02.03.2022 është përcjellë në QSUNT shtesa e buxhetit në shërbimin spitalor, në vijim të Vendimit të Këshillit Administrativ të FSDKSH Nr.2, datë 15.02.2022 “*Për financimin shtesë të spitaleve publike për realizimin e paketave të shërbimeve të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, të ofruara nga shërbimet spitalore publike në vitin 2022*” duke informuar se shtesa e buxhetit konsiston në realizimin e paketave të kardiologjisë, kardiokirurgjisë, dializës dhe radioterapisë duke shtuar në total shumën prej 1,150,920 mijë lekë, nga të cilat shpenzime për paga (llog 600) janë shtuar me 163,296 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore (llog 601) janë shtuar me 27,490 mijë lekë, shpenzime për mallra dhe shërbime llog (602) janë shtuar me 960,132 mijë lekë.

Plani i rishikuar i QSUNT rezulton në vlerën totale prej 8,222,910 mijë lekë nga të cilat shpenzime për paga (600) në vlerë 3,093,286 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore (601) në vlerë 419,492 mijë lekë dhe shpenzime operative (602) në vlerë 4,710,132 mijë lekë.

Me Urdhër të Drejtorit të QSUNT Nr. 62/1 prot, datë 08.03.2022, Prot Nr.567/5, datë 08.03.2022 është urdhëruar shpërndarja e shpenzimeve operative të llog. 602, për vlerën e shtuar, duke shtuar fondet në “*barna, materiale dhe proteza mjekësore*” me 885,132 mijë lekë dhe fondet në “*shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve teknike dhe IT*” me 75,000 mijë lekë , në total shtese 960,132 mijë lekë për llog 602.

Me Urdhër të Drejtorit të QSUNT Nr. 233, datë 23.06.2022, protokolluar me Nr. 567/8 prot, datë 23.06.2022, është urdhëruar rishpërndarja e shpenzimeve operative me vlerën e shtuar, duke kryer ndryshime që kanë konsistuar në shtesa e pakësime të fondeve në llogarinë 602, pa ndryshime në total. Ndryshimet kanë ndodhur në shtesa ka patur në fondet në shtesa në total 184,800 mijë:

- “blerje dokumentacion për shtypshkrime” në vlere 3,000 mijë lekë;
- “barna, materiale dhe proteza mjekësore” të cilat janë shtuar me 170,200 mijë lekë;
- “shpenzime të siguracionit të mjeteve të transportit” shtese për 600 mijë lekë;
- “shpenzime për tatime, taksa dhe tarifa” shtesë për 2,000 mijë lekë;
- “shpenzime për pjesëmarrje në projekte dhe shërbime në IAEA” shtesë për 9,000 mijë lekë.

Pakësimi në total 184,800 mijë lekë kanë ndodhur në zërat shpenzime për ; - “blerje kancelari letër format A4” pakësim për 1,500 mijë; - “blerje oksigjen shëndetësor” pakësim për 60,000 mijë; - “shërbimi i kateringut” pakësim për 14,000 mijë; - “shërbimi i lavanterisë” pakësim për 3,000 mijë; - “energji elektrike” pakësim për 50,000 mijë; - “ujë ” në shumën 20,000 mijë lekë; - “shpenzime për evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore”, pakësim për 4,600 mijë lekë; - “për karburant për mjete dhe gjeneratorë” pakësim për 1,000 mijë lekë; - “shpenzime për mirëmbajtje impiantistikë” pakësim për 5,000 mijë lekë; - “blerje pjesë këmbimi për aparatura dhe pajisje mjekësore” pakësim për 20,000 mijë lekë; - “shpenzime për mirëmbajtjen e sistemit të informacionit SISP” pakësim për 3,100 mijë; - “shpenzime të tjera për radio mbrojtje” pakësim për 2,600 mijë lekë. Në total shtesa zero lekë.

Me shkresën Nr. 5504 prot, datë 07.09.2022, protokolluar me Nr. 567/16 prot, datë 12.09.2022, FSDKSH ka njoftuar QSUNT, mbi ndryshimet në buxhetin e vitit 2022. Ndryshimet kanë ardhur si rrjedhojë e Vendimit të KA të FSDKSH Nr.12, datë 30.08.2022 “Mbi shpërndarjen nga rezerva e buxhetit të shërbimit spitalor për vitin 2022”, duke shtuar në total shpenzimet në shumën 114,900 mijë lekë. Në totalin e shpenzimeve buxhetore janë shtuar shpenzimet për sigurime shoqërore (llog 601) në shumën 6,900 mijë lekë, shpenzimet për shërbime (llog 602) në shumën 240,000 mijë lekë dhe janë pakësuar shpenzimet për paga llog (600) për 132,000 mijë lekë.

Me urdhër të titullarit të QSUNT Nr. 358, datë 16.09.2022, protokolluar me Nr. 567/17 prot, datë 16.09.2022, është urdhëruar shpërndarja e shpenzimeve operative për vlerën e shtuar, duke kryer ndryshime që kanë konsistuar në shtesa në shumën 240,000 mijë të fondeve (llog. 602). Ndryshimet kanë pësuar pothuaj të gjithë nën zërat e llogarisë 602 si më poshtë vijon, në zërat: - “furnizim me lende djegëse për ngrohje dhe ujë sanitar ” në shumën 30,000 mijë lekë; “barna, materiale dhe proteza mjekësore” në shumën 130,000 mijë lekë; “blerje oksigjen” në shumën 30,000 mijë lekë; “energji elektrike” në shumën 50,000 mijë lekë.

Sipas shkresës Nr. 5504 datë 07.09.2022, përveç shpenzimeve operative kanë pësuar ndryshime në shtesë/ pakësim përkatësisht fondet buxhetore për llog 600 dhe 601, si më poshtë vijon: Shtesa ka pësuar fondet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (llog 601) në total 6,900 mijë lekë.

Pakësim ka ndodhur në fondin e pagave (llog 600) për shumën 132,000 mijë lekë, për të cilin Drejtoria Ekonomike dhe planifikimit Financiar ka kryer detajimin mujor të fondit të ndryshuar.

Me shkresën Nr. 5886/10 prot, datë 27.09.2022, FSDKSH ka informuar QSUNT, mbi ndryshimet në buxhetin e vitit 2022. Ndryshimet kanë ardhur si rrjedhojë e ndryshimit VKM Nr. 43, datë 19.01.2022 me VKM Nr. 615, datë 22.09.2022“*Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2022*”, sipas të cilës buxheti në total shtohet shumën prej 136,638 mijë lekë, nga të cilat shpenzime për paga (llog 600) janë shtuar me 118,900 mijë lekë, shpenzime për mallra dhe shërbime llog (602) janë shtuar për shërbime operative për 363,325 mijë lekë, ndërsa shpenzimet për sigurime janë pakësuar në shumën 1,000 mijë lekë.

Plani i rishikuar i QSUNT rezulton në vlerën totale prej 8,474,448 mijë lekë nga të cilat shpenzime për paga (600) në vlerë 2,873,286 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore (601) në vlerë 426,392 mijë lekë dhe shpenzime operative (602) në vlerë 5,174,770 mijë lekë.

Me Urdhër të Drejtorit të QSUNT Nr. 415 prot, datë 18.10.2022, protokolluar me Nr.567/23, datë 18.10.2022 është urdhëruar shpërndarja e shpenzimeve operative (llog 602) për vlerën e shtuar në total 224,638 mijë lekë, duke shtuar fondet për “uniforma dhe veshje të tjera speciale’ në shumën 2,367 mije lekë; “barna, materiale dhe proteza mjekësore” me 107,133 mijë lekë; “shërbim laborator mjekësor” në shumë 64,638 mijë lekë; “energji elektrike’ me shumën 40,000 mijë lekë; “karburant për mjete dhe gjeneratorë” në shumën 2,500 mijë lekë; “shpenzime për mirëmbajtje të objekteve ndërtimore” në shumën 8,000 mijë lekë.

Sipas shkresës Nr. 5886/10 datë 27.09.2022, përveç shpenzimeve operative ndryshime në pakësim kanë pësuar fondet buxhetore për paga (llog 600) në total 88,000 mijë lekë, për të cilin Drejtoria Ekonomike dhe planifikimit Financiar ka kryer detajimin mujor të fondit të ndryshuar.

Me shkresën Nr.6091/1, datë 10.10.2022, protokolluar me Nr.567/22, datë 14.10.2022, FSDKSH ka përcjellë në QSUNT shtesa e buxhetit të vitit 2022 në shërbimin spitalor, në zbatim të Vendimit të Këshillit Administrativ të FSDKSH Nr.17, datë 04.10.2022 “Për shpërndarje nga rezerva e buxhetit të shërbimit spitalor për vitin 2022” duke informuar për shtesë e të fondeve për shpenzime për mallra dhe shërbime llog (602) në shumën 573,000 mijë lekë.

Plani i rishikuar i QSUNT rezulton në vlerën totale prej 9,047,448 mijë lekë nga të cilat shpenzime për paga (600) në vlerë 2,873,286 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore (601) në vlerë 426,392 mijë lekë dhe shpenzime operative (602) në vlerë 5,747,770 mijë lekë.

Me Urdhër të Drejtorit të QSUNT Nr. 424 prot, datë 27.10.2022, Prot Nr.567/25, datë 27.10.2022 titullari ka urdhëruar shpërndarjen e shpenzimeve operative në total shtese 573,000 mije lekë për llog 602, duke shtuar fondet në zërat : “kancelari letër format A4 ” në shumën 500 mijë lekë; “furnizim për lënde djegëse dhe ujë sanitar” në shumën 4,000 mijë lekë; “barna, materiale dhe proteza mjekësore” me 421,563 mije mijë lekë; “shërbim i kateringut” në shumën 22,000 mijë lekë; “shërbime të tjera (Pedagoget)” në shumën 5,000 mijë lekë; “energji elektrike” në shumën 88,000 mije lekë; “shpenzime për ujë” në shumën 3,000 mijë lekë; “shpenzime të sigurimit dhe ruajtjes” në shumën 1,500 mijë lekë; “shërbime të pastrimit të jashtëm” në shumën 1,000 mijë lekë; “blerje pjesë këmbimi dhe bateri” në shumën 600 mijë lekë; “shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve teknike dhe IT” me 4,000 mijë lekë; “blerje pjesë këmbimi për aparatura dhe pajisje mjekësore” në shumën 20,000 mijë lekë; “shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largim nga puna” në shumën 600 mije lekë; “shpenzime për tatime, taksa të pagueshme nga institucioni” në shumën 237 mije lekë; “shpenzime për pjesëmarrje në projekte dhe shërbime IAEA” në shumën 1,000 mijë lekë.

Me shkresën Nr.6762/4, datë 16.11.2022, protokolluar me Nr.567/28, datë 21.11.2022, protokolluar në institucion me Nr. 567/28, datë 21.11.2022, FSDKSH ka përcjellë në QSUNT shtesë fonde për buxhetin e vitit 2022 në shërbimin spitalor, në zbatim të Vendimit të Këshillit Administrativ të FSDKSH Nr.20, datë 11.11.2022 “Për shpërndarje nga rezerva e buxhetit të shërbimit spitalor për vitin 2022” duke informuar për shtesë për shpenzime operative në shumën 200,000 mijë lekë, dhe pakësim për fondin e pagave (llog 600) në shumën 113,861 mije lekë, pakësim për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (llog 601) për shumën 95 mijë lekë.

Plani i rishikuar i QSUNT rezulton në vlerën totale prej 9,133,492 mijë lekë nga të cilat shpenzime për paga (600) në vlerë 2,759,425 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore (601) në vlerë 426,297 mijë lekë dhe shpenzime operative (602) në vlerë 5,947,770 mijë lekë.

Me Urdhër të Drejtorit të QSUNT Nr. 492 prot, datë 01.12.2022, Prot Nr.567/30, datë 01.12.2022 titullari ka urdhëruar shpërndarjen e shpenzimeve operative në total shtese 200,000 mije lekë për llog 602, duke shtuar fondet në zërat: - “kancelari letër format A4 ” në shumën 1,550 mijë lekë; “materiale për pastrim dhe dezinfektim” në shumën 760 mijë lekë; “blerje materiale dhe shtypshkrime” në shumën 196,470 mijë lekë; “barna, materiale dhe proteza mjekësore” me 196,470 mije mijë lekë; “letër rulo dhe plastmase” në shumën 820, mijë lekë; “shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largim nga puna” në shumën 400 mije lekë.

Me shkresën Nr. 7542 prot, datë 30.12.2022, protokolluar me Nr. 170 prot, datë 13.01.2023, FSDKSH ka informuar QSUNT , mbi ndryshimet në buxhetin e vitit 2022, në zbatim të VKM Nr. 898, datë 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme të institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës”. si Vendimit të Këshillit Administrativ të FSDKSH Nr. 29, datë 30.12.2022 “Për shpërndarjen e rezervës së buxhetit të shërbimit spitalor për vitin 2022”, duke rishpërndarë shpenzimet operative në shumën 5,947,770 mije lekë. Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit Financiar të bëjë detajimin e fondeve të pagave (llog 600) në shumën 2,721,425 mijë lekë, dhe transferta buxhetore përkatësisht për llogarinë 600 në shumën 2721425 dhe në zërin “606” në shumën 38,000 mijë lekë si dhe në llogarinë 601 në shumën 426,297 mijë lekë.

Plani i rishikuar i QSUNT rezulton në vlerën totale prej 9,133,492 mijë lekë nga të cilat shpenzime për paga (600) dhe transferta buxhetore (llog 606) në shumën 2,721,425 mijë lekë, në zërin transferta buxhetore (llog 606) në shumën 38,000 mije lekë si dhe në zërin shpenzime për

sigurime shoqërore (601) në vlerë 426,297 mijë lekë dhe shpenzime operative (602) në vlerë 5,947,770 mijë lekë. Me Urdhër të Drejtorit të QSUNT Nr. 546, datë 31.12.2021, protokolluar me Nr. 567/31 prot, datë 31.12.2022, titullari ka urdhëruar rishpërndarja e shpenzimeve operative me vlerën e shtuar, duke kryer ndryshime që kanë konsistuar në shtesa e pakësime të fondeve (llog. 602).

Ndryshimet e fondeve buxhetore për investime për vitin 2022

Në zbatim të Ligjit Nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, Ligjit Nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe në vijim të Udhëzimit Plotësues të MFE Nr.1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022, si dhe shkresës së MFE Nr. 22922/1, datë 31.01.2022, MSHMS me shkresën Nr. 26/3 prot, datë 03.02.2022, protokolluar në institucion me Nr. 567/4, datë 01.04.2022 janë çelur fonde buxhetore për vitet 2022-2024 për shpenzimet kapitale (artikull 231) në shumën 238,786 mije lekë.

Përgjatë vitit 2022, buxheti për shpenzime kapitale ka pësuar ndryshime si me poshtë:

Me shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 720/2, prot datë 01.03.2022 është buxheti i QSUNT për investime, në total ka pësuar shtesë në total me vlerën 2,546 mijë lekë, për fonde projekte:

F.V pajisje mobilim aparatura mjekësore për spitalin e ri të ndërtuar në QSUNT me kredi të CEB-it, pakësim për 210,809 mijë lekë; Rikonstruksion i godinës se arkivës së kartelave mjekësore në QSU Nene Tereza Tirane , shtesë për 2,500 mijë lekë; Supervizim dhe kolaudim për rikonstruksion i godinës se arkivës se kartelave mjekësore në QSU Nene Tereza Tirane shtesë për 49 mijë lekë;

F .V pajisje mobilimi për Spitalin e Ri të ndërtuar në QSUNT me kredi të CEB-it shtese për 210,809 mijë lekë.

Me shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 1468/2 prot, datë 14.04.2022, protokolluar në institucion me Nr. 35/27, datë 15.04.2022, jepet tabela e transferimit të fondeve për investime duke shtuar në total 16,549 mijë lekë buxhetin për investime të QSUNT, fonde këto të alokuara në projektin “F.V. aparatura mjekësore për spitalin e ri të ndërtuar në QSUT me kredi të CEB-it” shtesë për fonde në shumën 45,307 mijë lekë, “F.V. pajisje teknologjike, elektrike për godinën ekzistuese të pediatriisë, ndërhyrje e realizuar me kredi të BB”)” shtesë për fonde në shumën 4,532 mijë lekë “F.V pajisje mobilim për Spitalin e Ri të ndërtuar në QSUNT me kredi të CEB-it (duke pakësuar për projektin me fonde në shumën 33.290 mije lekë. Me shkresën Nr. 2843/2 prot, datë 13.07.2022, protokolluar me Nr. 62/110, datë 15.07.2022, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka miratuar transferimin e fondeve të investimeve, në total ka pësuar shtesë në total me vlerën 69,288 mijë lekë për projekte:

F.V pajisje, mobilimi spitalor dhe pajisje biomjekësore për spitalin e sëmundjeve të brendshme A2 (detyrim kontraktual) shtesë për fonde në shumën 37,830 mijë lekë; Lidhja e re e Energjisë Elektrike për godinën e re A2 të sëmundjeve të brendshme në QSUNT-pagese ndaj FSHU shtesë për fonde në shumën 6,459 mijë lekë;F.V pajisje mobilimi spitalor dhe pajisje biomjekësore për pediatriinë e re QSUNT (detyrim kontraktual) shtesë për fonde në shumën 25,000 mijë lekë;

Në zbatim të shkresës së MSHMS Nr. 3221/6 prot, datë 30.08.2022, protokolluar në QSUNT me Nr. 567/13, datë 01.09.2022, dërguar miratimi për pakësim në shumën 48,901 mijë lekë të fondeve për investime në kuadër daljes së Aktit Normativ Nr. 12, datë 29.07.2022 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022””, shkresës së MFE Nr. 14405/95, datë 24.08.2022, për projekte me financim të brendshëm që i përkasin: F.V pajisje mobilim aparatura mjekësore për Spitalin e Ri të ndërtuar në QSUNT me kredi të CEB-it, pakësim për 16,392 mijë lekë, F.V. pajisje teknologjike, elektrike për godinën ekzistuese të

pediatrisë, ndërhyrje e realizuar me kredi të BB pakësim për 32.509 mijë lekë, Me shkresën të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 4298/2, prot datë 17.11.2022, shkresës së MFE Nr. 20637/1, datë 16.11.2022, buxheti i QSUNT për investime është pakësuar në shumën 27,435 mijë lekë për projektin/etj, F.V pajisje mobilimi për Spitalin e Ri të ndërtuar në QSUNT me kredi të CEB-it, pakësuar për shumën 15,704 mijë lekë, F.V pajisje mobilim aparatura mjekësore për Spitalin e Ri të ndërtuar në QSUNT me kredi të CEB-it, pakësuar për shumën 11,731 mijë lekë.

Në mënyrë të përmbledhur, plani rishikuar për shpenzimet operative dhe shpenzimet kapitale pas shtesave/pakësimeve përgjatë vitit 2022, paraqitet si më poshtë:

Buxheti ndryshuar viti 2022 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2022-2024 (Në mijë lekë)

Emërtimi		Kërkesa PBA 2022-2024	Plani fillestar i miratuar 2022	Plani i rishikuar 2022	Plani i rishikuar 2022	Plani i rishikuar 2022	Plani i rishikuar 2022	Plani i rishikuar 2022	Plani i rishikuar 2022	Plani i rishikuar 2022	Plani i rishikuar 2022	Plani i rishikuar 2022 (Final)
Shpenzime operative (A)	Paga	3,537,667	2,930,000	3,093,286	3,093,286	3,093,286	3,093,286	3,093,286	2,961,286	2,873,286	2,873,286	2,721,425
	Sigurime	562,658	392,000	419,492	419,492	419,492	419,492	419,492	426,392	426,392	426,392	426,297
	Shërbime	14,804,413	3,750,000	4,710,132	4,710,132	4,710,132	4,710,132	4,710,132	4,950,132	5,747,770	5,747,770	5,947,770
Total (A)		18,904,738	7,072,000	8,222,910	8,222,910	8,222,910	8,222,910	8,222,910	8,337,810	9,047,448	9,047,448	9,095,492
Shpenzime kapitale (B)	Investime	599,104	0	238,786	241,335	257,884	327,173	278,272	278,272	278,272	250,836	250,836
	Total (B)	599,104	0	238,786	241,335	257,884	327,173	278,272	278,272	278,272	250,836	250,836
TOTAL (A)+(B)		19,503,842	7,072,000	8,461,696	8,464,245	8,480,794	8,550,083	8,501,182	8,616,082	9,325,720	9,298,284	9,346,328
llog 606												38,000

Shtesat/pakësimet sipas PBA 2022-2024 (Në mijë lekë)

Emërtimi		Kërkesa PBA 2022-2024	Plani fillestar i miratuar 2022	Plani i rishikuar 2022	Plani i rishikuar 2022	Plani i rishikuar 2022	Plani i rishikuar 2022	Plani i rishikuar 2022	Plani i rishikuar 2022	Plani i rishikuar 2022	Plani i rishikuar 2022	Plani i rishikuar 2022 (Final)
Shpenzime operative (A)	Paga	3,537,667	2,930,000	+163,286	0	0	0	0	-	-88,000	0	-151,861
	Sigurime	562,658	392,000	+27,492	0	0	0	0	132,000	0	0	-95
	Shërbime	14,804,413	3,750,000	+960,132	0	0	0	0	240,000	797,638	0	+200,000
Total (A)		18,904,738	7,072,000	1,150,910	0	0	0	0	114,900	709,638	0	48,044
Shpenzime kapitale (B)	Investime	599,104	0	+238,786	+2,549	+16,549	+69,288	-48,901	0	0	-27,435	0
	Total (B)	599,104	0	238,786	2,549	16,549	69,288	-48,901	0	0	-27,435	0
TOTAL (A)+(B)		19,503,842	7,072,000	1,389,696	2,549	16,549	69,288	-48,901	114,900	709,638	-27,435	48,044
llog 606												38,000

(Burimi: QSUNT)

Nga auditimit u konstatua se:

Kërkesat e institucionit lidhur me fondet buxhetore të miratuara për investime nga 599,104 mijë lekë të kërkuara në PBA 2022-2024, çelen në shumën 238,786 mijë lekë dhe në fund të vitit buxhetor 2022 mbyllen në shumën 250,836 mijë lekë, tregues se gjatë vitit 2022 kërkesat për investime të QSUNT vazhdojnë të mos të merren në konsideratë nga MSHMS.

Financimet për investime kapitale për vitin 2022 për kodin 18BB103 “F.V pajisje mobilimi për Spitalin e Ri të ndërtuar në QSUNT me kredi të CEB-it (kontributi Qeverisë Shqiptare)” në vlerë fillestare 210,809 mijë lekë, janë ndryshuar disa herë në (+/-) dhe në fund viti rezultojnë 149,719 mijë lekë ose 61,090 mijë lekë me pak se çelja e fondeve. Projekti me kod 18BB310 “F.V. pajisje teknologjike, elektrike për godinën ekzistuese të pediatriisë, ndërhyrje e realizuar me kredi të BB” në fillim të vitit nuk ka çelje fonde për realizim projekti, gjate vitit alokohen 2 shtesa në total 32,509 mijë lekë dhe me shkresat e MSHMS Nr. 3221/6, datë 30.08.2022 dhe 567/13, datë 01.09.2022 fondet pakësohen në shumën 32,509, duke anuluar vlerën e këtij investimi me fonde buxhetore. Në fund të vitit buxhetor 2022, midis buxheteve të miratuara dhe kërkesës buxhetore të QSUNT për shpenzime operative dhe kapitale ekzistojnë diferenca të konsiderueshme në shumën 9,809,246 mijë lekë ose 48.11% me pak se kërkesa në PBA 2022-2024. Diferenca me e

lartë konstatohet në zërin “Shërbime” për 8,856,643 mijë lekë, ose 40.18% më pak se buxheti i kërkuar në PBA 2022-2024.

Duke marrë në analizë peshën e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike në planin e shpenzimeve buxhetore mbi totalin e buxhetit e QSUNT për vitin 2022 në shumën 9,346,328 mijë lekë, siç mund të konstatohet në tabelën më lart pjesën më të madhe e zënë shpenzimet në llogarinë “Mallra dhe shërbime të tjera” me rreth 63.64%, pas tij llogaria “Paga” me rreth 29.05%, dhe “Sigurime shoqërore” me rreth 4.51%. “Shpenzimet kapitale” zënë një peshë mjaft të vogël në vetëm 2.69% të buxhetit të planifikuar.

c. Realizimi i fondeve të buxhetit.

Realizimi faktik i shpenzimeve buxhetore për vitin 2021.

Realizimi buxhetit 2021 (Në mijë lekë)

Emërtimi		Fakti 2020	Kërkesa PBA 2021-2023	Plani fillestar i miratuar (2021)	Plani i rishikuar (2021)	Realizimi	Realizimi (%)
Shpenzime operative (A)	Paga	2,357,551	2,969,073	2,208,700	3,007,960	3,006,330	99.95 %
	Sigurime	339,612	472,224	324,350	409,250	408,960	99.93 %
	Shërbime	4,401,868	12,699,132	3,000,500	5,319,238	5,319,234	100.00 %
Total (A)		7,099,031	16,140,429	5,533,550	8,736,448	8,734,524	99.98 %
Shpenzime kapitale (B)	Investime	0	608,213	365,691	77,512	73,764	95.16 %
Total (B)		0	608,213	365,691	77,512	73,764	95.16 %
TOTAL (A)+(B)		7,099,031	16,748,642	5,899,241	8,813,960	8,808,288	99.94 %
	llog 606				1,640	1,640	100.00 %

(Burimi: QSUNT)

Nga auditimi u konstatua se QSUNT në PBA 2021-2023 për vitin 2021 në total ka kërkuar fonde buxhetore në shumën 16,748,642 mijë lekë, nga të cilat në buxhetin fillestar janë alokuar 5,899,241 mijë lekë dhe buxhetin e rishikuar 8,813,960 mijë lekë. Shpenzimet e kryera nga institucioni rezultojnë në vlerën 8,808,288 mijë lekë, ose me realizimi prej 99.84%.

Sipas PBA 2021-2023, në vitin 2021 për shpenzimet operative nga QSUNT ka kërkuar 16,140,429 mijë lekë nga të cilat fillimisht janë alokuar 5,533,550 mijë lekë dhe në buxhetin e rishikuar janë alokuar 8,736,448 mijë lekë. Shpenzimet operative të kryera nga institucioni rezultojnë në vlerën 8,734,524 mijë lekë ose realizim 99.98% kundrejt buxhetit të rishikuar të vitit 2021. Për shpenzimet kapitale, sipas PBA 2021-2023 për vitin 2021 janë kërkuar 608,213 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 365,691 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar kjo vlerë rezulton në vlerën 77,512 mijë lekë, duke ulur shpenzimet për investime për 288.179 mije lekë krahasuar me buxhetin fillestar, ose pakësuar për 530,701 mije lekë krahasuar me kërkesën për investime në PBA 2021-2023.

Pesha specifike sipas zërave të shpenzimeve faktike të buxhetit 2021 në totalin e realizimit faktik për rreth 8,808,288 mijë lekë të vitit 2021, sipas peshës specifike “Mallra dhe shërbime” zënë 60.39% të buxhetit, më pas janë shpenzime për paga 34.13% dhe shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore zënë 4.64%. Shpenzime për Investime zënë 0.84% të buxhetit total.

Struktura e ndarjes të zërave të shpenzimeve operative nuk është e njëjtë me strukturën e paraqitur në kërkesat buxhetore në fazën e PBA. Kjo situatë e bën të pamundur kryerjen e analizave krahasimore të kërkesave buxhetore dhe planit, me realizimin faktik. Detajimi fondeve buxhetore për investimeve të kryera nga QSUNT në vitin 2021, krahasuar me alokimin në buxhetin fillestar, me ndryshime, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Ndryshimet e fonde buxhetore për shpenzimet kapitale për vitin 2021 (në mijë lekë)

Emërtimi i projektit	Çelje investimeve shkresa Nr.142/3, dt.. 02.02.2021	Plan buxhet shkresa Nr.2460 date 17.06.2021	Plan buxhet shkresa Nr. 3923 dt.. 11.10.2021	Plan buxhet shkresa Nr. 4656/2 date 01.12.2021	Plan buxhet shkresa Nr. 4942/2 dt.. 30.12.2022	Fondet e miratuara në total 2022
F.V. aparatura mjekësore për spitalin e ri të ndërtuar në QSUT me kredi të CEB-it (kontributi i Qeverisë Shqiptare)	235,691	(46,050)		(189,641)		-
F.V. aparatura mjekësore, mobilimi dhe hotelerie për godinën e re të pediatriisë ndërtuar me kredi të Bankës Botërore	130,000			(65,490)	(26,527)	37,983
FV pajisje mobilimi dhe sinjalistika për godinën e re të Pediatriisë ndërtuar me Kredi të Bankës Botërore		42,272		(15,043)		27,229
Pagese TVSH për Grantin Japonez		2,300				2,300
Rikonstruksion I godinës se Arkivës se Kartelave Mjekësore në QSU Nene Tereza Tirane			14,048		(5,048)	9,000
Supervizion dhe kolaudim për rikonstruksionin e godinës se Arkivës se Kartelave Mjekësore në QSUT			1,000			1,000
Shuma	365,691	(1,478)	15,048	(270,174)	(31,575)	77,512

Realizimi investimeve me fonde buxhetore sipas objekteve deri 31.12.2021 (në mijë lekë)

Kodi Projektit	Produkti	Llog	Fondi Çelur Thesar	Shpenzime Faktike	Realizimi (%)
18BB103	<i>F.V. aparatura mjekësore për spitalin e ri të ndërtuar në QSUT me kredi të CEB-it (kontributi Qeverisë Shqiptare)</i>	231	0	-	0.00 %
18BB137	<i>F.V. aparatura mjekësore, mobilimi dhe hotelerie për godinën e re të pediatriisë ndërtuar me kredi të bankës botërore</i>	231	37,983	37,983	100.00 %
18BB140	<i>FV pajisje mobilimi dhe sinjalistika për godinën e re të Pediatriisë ndërtuar me Kredi të Bankës Botërore</i>	231	27,229	26,921	98.87 %
18BB078	<i>Pagese TVSH për Garantin Japonez</i>	231	2,300	2,300	100.00 %
18BB079	<i>Rikonstruksion i godinës se Arkivës se Kartelave Mjekësore në QSU Nene Tereza Tirane</i>	231	9000	6,500	72.22 %
18BB080	<i>Supervizion dhe kolaudim për rikonstruksionin e godinës se Arkives se Kartelave Mjekësore në QSUT</i>	231	1,000	60	6.00 %
	Shuma		77,512	73,764	95.16 %

Fondet e investimeve akorduar nga MSHMS, sipas shkresave të sipërcituara, përgjatë vitit buxhetor janë pakësuar 288,179 mijë lekë ose 78.80% me pak se çelja e investimeve në fund të vitit. Përgjatë vitit fondet buxhetore për investime kanë pësuar ndryshime për gjithë projektet e miratuar si : Për projektin e investimit për projektin “*F.V pajisje mobilimi për Spitalin e Ri të ndërtuar në QSUNT me kredi të CEB-it (kontributi i Qeverisë Shqiptare)*” me kod projekti 18BB103, i cili nga 210,809 mijë lekë miratuar me shkresë Nr. 567/4,dt. 03.03.2022 dhe pakësimit të fondeve më shkresa të tjera të MSHMS, mbyllet me një fond investimi kapital prej 149,719 mijë lekë, thënë ndryshe për më pak për shumën 61,090 mijë lekë ose 28.98ë se fondet e çelura në fillim të vitit 2022.

Ndërsa investimi “*F.V. pajisje teknologjike, elektrike për godinën ekzistuese të pediatriisë, ndërhyrje e realizuar me kredi të BB*” me kod 18BB310, fondet e çelura për shumën 27,977 mijë lekë, deri në fund të vitit buxhetor bëhen zero, pra investimi nuk është kryer sipas planifikimit buxhetor.

Nga auditimi u konstatua se Investimet me fonde buxhetore në QSUNT rezulton se janë realizuar në shumën 73,764 mijë lekë ose në masën 95.16 % krahasuar me fondeve të çelura dhe ndryshuar gjatë vitit. Referuar ndryshimeve të fondeve gjatë vitit buxhetor rezulton se plani investime ka pësuar ndryshime me pakësimin të fondeve buxhetore deri në anulim të plotë të

financimit të projekteve të miratuara si investimi me kod projekti 18BB103 “F.V. aparatura mjekësore për spitalin e ri të ndërtuar në QSUT me kredi të CEB-it (kontributi i Qeverisë Shqiptare)” i cili në çelje në fillim viti akordon fonde në shumën 235,691 mijë të cilat në fund vitit bëhen zero. E njëjta situatë paraqitet me çeljen e fondeve për investime për projektin me kod 18BB137 “F.V. aparatura mjekësore, mobilimi dhe hotelerie për godinën e re të pediatriisë ndërtuar me kredi të bankës botërore” për të cilin fillimisht alokohen 130,000 mijë lekë dhe në fund viti alokimi rezulton në shumën 37,983 mijë për realizimin e investimit. Sa më sipër fondet buxhetore për investime të akordura nga MSHMS, nuk përputhen me kërkesën buxhetore të QSUNT në PBA 2021-2023. Detajimit shpenzimeve për mallra dhe shërbime (llog 602) në kode produkti sipas planifikimit dhe realizimi rezulton si më poshtë:

Evidenca e shpenzimeve sipas kodit të thesarit 2021 (në mijë lekë)

Kodi (thesarit)	Emërtimi i treguesit të performancës/produktit	Plani fillestar	Plani i rishikuar	Realizimi
91304AA	Pacientë të trajtuar në shërbim spitalor	3,000,500	3,813,825	3,813,821
91304AB	Pacientë të trajtuar me dialize	0	58,000	58,000
91304AD	Pacientë të trajtuar nga paketat e kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë	0	610,000	610,000
91304AF	Pacientë të trajtuar me katarakte	0	32,700	32,700
91304AG	Pacientë të trajtuar me radioterapi	0	130,000	130,000
91304AK	Ekzaminime laboratorike të kryera ndërmjet kontraktimit PPP	0	674,713	674,713
Totali		3,000,500	5,319,238	5,319,234

(Burimi: QSUNT Punoi: KLSH)

QSUNT rakordon me Degën e Thesarit për shpenzimet faktike të ndara në nivel produkti me kod produkti. Në fakt çeljet e buxhetit dhe shpenzimi faktik në thesar rezulton të jetë kryer i detajuar sipas kodeve të thesarit, sikundër paraqitet në akt rakordimet mujore. QSUNT nuk ka patur mundësinë objektive për të parashikuar shpenzimet buxhetore sipas paketave të shërbimeve shëndetësore të miratuara, sipas kërkesave të VKM Nr. 308, datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH në shërbimin spitalor”, i ndryshuar , pika 4, sipas të cilës fondi financon paketat e shërbimeve shëndetësore , bazuar në koston e shërbimeve sipas shtojcave përkatëse. Po kështu QSUNT nuk ka mundësi objektive të kostoje paketat e shërbimeve shëndetësore dhe të ndajë koston e shërbimeve spitalore.

Realizimi faktik i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022.

Realizimi Buxhetit i vitit 2022 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2022-2024 (në mijë lekë)

Emërtimi		Kërkesa PBA 2022 - 2024	Plani fillestar i miratuar 2022	Plani rishikuar i miratuar 2022	Fakti 2022	Realizimi planit (%)
Shpenzime operative (A)	Paga	3,537,667	2,930,000	2,721,425	2,709,556	99.56 %
	Sigurime	562,658	392,000	426,297	420,588	98.66 %
	Shërbime	14,804,413	3,750,000	5,947,770	5,947,750	100.00 %
Total (A)		18,904,738	7,072,000	9,095,492	9,077,894	99.81 %
Shpenzime kapitale (B)	Investime	599,104	0	250,836	250,836	100.00 %
Total (B)		599,104	0	250,836	250,836	100.00 %
TOTAL (A)+(B)		19,503,842	7,072,000	9,346,328	9,328,730	99.81 %

(Burimi: QSUNT Punoi: KLSH)

Pesha specifike sipas zërave të shpenzimeve faktike të buxhetit 2022 në totalin e realizimit faktik për rreth 9,328,730 mijë lekë të vitit 2022, sipas peshës specifike “Mallra dhe shërbime” zënë 63.76% të buxhetit, më pas janë shpenzime për paga 29.05% dhe shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore zënë 4.51%. Shpenzime për Investime zënë 2.69% të buxhetit total. QSUNT në PBA 2022-2024 për vitin 2022 ka kërkuar 19,503,842 mijë lekë nga të cilat fillimisht janë alokuar 7,072,000 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar janë alokuar 9,346,328 mijë lekë.


Shpenzimet e kryera nga institucioni rezultojnë në vlerën 9,328,730 mijë lekë ose realizuar në masën 99.81% të fondeve buxhetore të miratuara.

Për shpenzimet operative, sipas PBA 2022-2024, nga QSUNT për vitin 2022 janë kërkuar 18,904,738 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 7,072,000 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar janë alokuar 9,095,492 mijë lekë. Shpenzimet faktike të kryera nga institucioni rezultojnë në vlerën 9,077,894 mijë lekë ose me realizim prej 99.81%. Shpenzimet më të larta të kryera rezultojnë për zërin “shërbime” nën zëri kryesor “barnat dhe materialet mjekësore dhe laboratorët” me peshe specifike 84.11% të totalit të shpenzimeve operative, pasuar nga shpenzimet për paga që përbëjnë 29.92% të shpenzimeve operative.

Barna, materiale mjekësore dhe laboratorët (në mijë lekë)

EMERTIMI	Plan 2022	Fakt 2022
Janar	101,340	0
Shkurt	127,987	235,418
Mars	300,904	232,178
Prill	301,404	717,337
Maj	307,904	352,545
Qershor	307,904	304,204
Korrik	221,165	186,083
Gusht	297,439	372,186
Shtator	456,994	157,271
Tetor	482,125	187,891
Nëntor	561,963	231,254
Dhjetor	456,409	947,355
TOTALI	3,923,536	3,923,723

(Burimi: QSUNT Punoi: KLSH)



(Burimi: QSUNT Punoi: KLSH)

Nga auditimi u konstatua se shpenzimet operative për vitin 2021 u realizuan në masën 99.81% ose brenda planit të rishikuar. Pavarësisht detajimit të planit të shpenzimeve të kryera nga institucioni, konstatohet se në muajin dhjetor 2022 ka një tejkalim të buxhetit të planifikuar të zërit “Barna, materiale mjekësore dhe laboratorët” i cili nga 456,409 mijë lekë të planifikuara realizohet në shumën 947,355 mijë lekë ose 490,946 mijë lekë më shumë se detajimin mujor buxhetor në këtë llogari. Sa me sipër ndryshimet të disa hershme të fondeve buxhetore përgjatë

vitet ushtrimor dhe realizimi buxhetit në masën 99.81% nuk përbëjnë një tregues i mirëfilltë të një planifikimi dhe financimi të mirë dhe të plotë të nevojave të mbulimit të shërbimeve shëndetësore spitalore nga fondet e buxhetit. Realizimi i shpenzimeve operative sipas produkteve (viti 2022)

Nëse i referohemi detajimit në kode projekti të shpenzimeve për mallra dhe shërbime (Ilog 602) planifikimi dhe realizimi rezulton si më poshtë:

Shpenzimeve për mallra dhe shërbime (viti 2022) (në mijë lekë)

Kod Projekti	Emërtimi	Plan Vjetor	Plan Thesari	Shpenzime Thesari
91304AA	Trajtimi i pacientëve të shtruar në spitale	4,223,000		4,222,980
91304AB	Pacientë të trajtuar me dializë	90,000		90,000
91304AD	Pacientë të trajtuar me paketë kardiologji dhe kardiokirurgji	726,356		726,356
91304AF	Pacientë të trajtuar me paketat e transplantave renale	28,776		28,776
91304AG	Pacientë të trajtuar me radioterapi	115,000		115,000
91304AK		764,638		764,638
	6029999	5,947,770	5,987,545	5,947,750

(Burimi: QSUNT Përpunuar: KLSH)

Nga auditimi u konstatua se QSUNT rakordon me Degën e Thesarit për shpenzimet faktike të ndara në nivel produkti me kod produkti. Në fakt çeljet e buxhetit dhe shpenzimi faktik në thesar rezulton të jetë kryer i detajuar sipas kodeve të produkteve, sikundër paraqitet në akt rakordimet mujore, por kodi i produktit nuk përputhet me emërtimin e paketës shëndetësore duke paraqitur një raportim jo real të shpenzimeve sipas paketave shëndetësore. Nëse QSUNT do të përllogariste saktë shpenzimet sipas produkteve (pra paketave) duhet të kryhej ndarje të shpenzimeve për çdo paketë shëndetësore në shpenzime për paga dhe sigurime të personelit përkatës, të barnave dhe materialeve mjekësore dhe shpenzimeve përkatëse operative për energji elektrike, ngrohje, pastrim, ushqim, etj. Në rastin e QSUNT kodet e produkteve duhet të përputhen me emërtimin e paketa shëndetësore, për të cilat kryhen përllogaritje e kostove fillimisht nga FSDKSSH dhe raportimi i shpenzimeve sipas çdo paketë në raportet e buxhetit të MSHMS paraqet numrin e paketave të realizuara nga QSUNT. Në kushtet kur për raportimin e shpenzimeve për çdo produkt, institucioni e ka të pamundur të kryejë këto përllogaritje sipas produkteve (paketave shëndetësore), raportimi në degën e thesarit kryhet në kufirin e planit të çelur fillimisht për çdo paketë, sikundër paraqitet edhe në tabelat e hartuar nga grupi i auditimit.

Shpenzimet kapitale, sipas PBA 2022-2024, në vitin 2022 QSUNT ka kërkuar 599,104 mijë lekë nga të cilat fillimisht nuk janë alokuar fonde buxhetore dhe pas buxhetit të rishikuar janë alokuar 250,836 mijë lekë. Shpenzimet e kryer nga institucioni rezultojnë në vlerën 250,836 mijë lekë ose realizim 100.00%. Shpenzimet për investime janë të rakorduara me degën e thesarit, sipas projekteve për investime me kodet përkatëse dhe brenda limitit buxhetor të miratuar.

Shpenzimet kapitale për vitin 2022 me fonde buxhetore (në mijë lekë)

Kodi projektit	Emërtimi i projektit	Buxheti i vitit 2022			
		Plani i çelur	Obligim	Ecuria	Realizimi në %
18BB103	F.V pajisje mobilim aparatura mjekësore për Spitalin e Ri të ndërtuar në QSUNT me kredi të CEB-it (kontributi i qev.shqiptare)	17,184	17,184	17,184	100 %
18BB103	F.V pajisje mobilimi për Spitalin e Ri të ndërtuar në QSUNT me kredi të CEB-it (kontributi I qev.shqiptare)	149,719	149,719	149,719	100 %
18BB103	F.V pajisje mjekësore, mobilimi spitalor dhe pajisje biomjekësore për Spitalin e Sëmundjeve të Brendshme A2 (detyrim kontraktual)	37,830	37,830	37,830	100 %
18BB079	Rikonstruksion i godinës së Arkivës së Kartelave Mjekësore në QSUNT	2,500	2,500	2,500	100 %
18BB080	Supervizion Dhe Kolaudim Për Rikonstruksion I Godinës Se Arkivës Se Kartelave Mjekësore Në QSUNT	49	49	49	100 %

22AC603	Lidhja e re e Energjisë Elektrike për godinën e re A2 të sëmundjeve të brendshme në QSUNT, për pagese ndaj FSHU	6,458	6,458	6,458	100 %
18BB149	F.V pajisje mjekësore, mobilimi spitalor dhe pajisje biomjekësore për pediatriinë e re QSUNT (detyrim kontraktual)	25,000	25,000	25,000	100 %
18BB154	F.V Pajisje dhe orendi për disa nga shërbimet e QSUNT	12,096	12,096	12,096	100 %
	TOTALI	250,836	250,836	250,836	100 %

(Burimi: QSUNT Përpunuar:KLSH)

Ndryshimet e fonde buxhetore për shpenzimet kapitale për vitin 2022 (në mijë lekë)

Kodi projektit	Emërtimi i projektit	Shkresa Nr. 567/4, dt. 03.03.2022	Shkresa Nr. 567/7, dt. 08.04.2022	Shkresa Nr. 35/50, dt. 20.04.2022	Shkresa Nr.62/110, dt. 15.07.2022	Shkresa Nr. 3221/6, dt. 30.08.2022 & 567/13, dt. 01.09.2022	Shkresa Nr. 4298/2, dt. 17.11.2022 & 567/27, dt. 18.11.2022	Shkresa Nr. 2315/5, dt. 567/18, dt. 29.09.2024	Plani për vitin 2022	Fakti	Realizimi (%)
18BB079	Rikonstruksion i godinës se Arkivës se Kartelave Mjekësore në QSU Nene Tereza Tirane	2,500							2,500	2,500	100.00 %
18BB080	Supervizion dhe kolaudim për rikonstruksion I godinës se Arkivës se Kartelave Mjekësore në QSU Nene Tereza Tirane	49							49	49	100.00 %
18BB103	F.V pajisje mobilimi për Spitalin e Ri të ndërtuar në QSUNT me kredi të CEB-it (kontributi i qev.shqiptare)	210,809		(33,290)			(12,096)	(15,704)	149,719	149,719	100.00 %
18BB310	F.V. pajisje teknologjike, elektrike për godinën ekzistuese të pediatriisë, ndërhyrje e realizuar me kredi të BB	-	27,977	4,532		(32,509)			-		
18BB103	F.V. aparatura mjekësore për spitalin e ri të ndërtuar në QSUNT me kredi të CEB-it (kontributi i qev.shqiptare)	-		45,307		(16,392)		(11,731)	17,184	17,184	100.00 %
18BB103	F.V pajisje, mobilimi spitalor dhe pajisje biomjekësore për spitalin e sëmundjeve të brendshme A2 (detyrim kontraktual)				37,830				37,830	37,830	100.00 %
22AC603	Lidhja e re e Energjisë Elektrike për godinën e re A2 të sëmundjeve të brendshme në QSUNT-pagese ndaj FSHU				6,458				6,458	6,458	100.00 %
18BB149	F.V pajisje mobilimi spitalor dhe pajisje biomjekësore për pediatriinë e re QSUNT (detyrim kontraktual)				25,000				25,000	25,000	100.00 %
18BB103	F.V pajisje dhe orendi për disa pajisje të QSUNT						12,096		12,096	12,096	100.00 %
	Shuma	213,358	27,977	16,549	69,288	-48,901	0	-27,435	250,836	250,836	100.00 %

(Burimi: QSUNT Përpunuar:KLSH)

Nga auditimi u konstatua se MSHMS, përgjatë vitit buxhetor 2022 ka pakësuar fondet e investimeve në: - Projektin e investimit për projektin “F.V pajisje mobilimi për Spitalin e Ri të ndërtuar në QSUNT me kredi të CEB-it (kontributi i i Qeverisë Shqiptare)” me kod projekti 18BB103, i cili nga 210,809 mijë lekë miratuar me shkresë Nr. 567/4,dt. 03.03.2022 dhe pakësimin të fondeve më shkresa të tjera të MSHMS, mbyllet me një fond investimi kapital prej 149,719 mijë lekë, thënë ndryshe për më pak për shumën 61,090 mijë lekë ose 28.98% se fondet e çelura në fillim të vitit 2022. - Ndërsa investimi “F.V. pajisje teknologjike, elektrike për

godinën ekzistuese të pediatriisë, ndërhyrje e realizuar me kredi të BB” me kod 18BB310, fondet e çelura për shumën 27,977 mijë lekë, deri në fund të vitit buxhetor bëhen zero, pra investimi nuk është kryer sipas planifikimit buxhetor.

Fonde buxhetore për investimet në vitin 2022 u realizuan në shumën 250,836 mijë lekë ose realizimim 100% të fondeve të çelura, por referuar ndryshimeve të fondeve gjatë vitit buxhetor rezulton se plani i investimeve ka pësuar ndryshime të konsiderueshme nga MSHMS, të cilat nuk përputhen me kërkesën buxhetore të QSUNT në PBA 2022-2024. MSHMS ka financuar projekte të reja për investime në QSUNT të cilat duhet të ishin parashikuar në kohën e hartimit dhe miratimit të PBA 2022-2024, si projekte të vlerësuar domosdoshme për tu financuar përgjatë vitit buxhetor.

Drejtori i përgjithshëm nuk ka hartuar dhe dërguar për miratim në Bordin Drejtues të QSUNT Raportin Vjetor për vlerësimin e veprimtarisë financiare, në kundërshtim me Urdhrin e Përbashkët të MSHMS dhe MARS Nr. 709, datë 10.10.2018 “Për miratimin e Statusit të QSUNT”, pika 10, germa “ç”, dhe neni 15 germa “d”, si dhe Urdhrin e Ministrit të MSHMS Nr. 369, datë 24.08.2021 “Për ngritjen e bordit drejtues të spitalit universitar QSU “Nënë Tereza”” pika 3 germa “a”.

Në procedurat e monitorimit të buxhetit të QSUNT për vitin 2021-2022 ka mangësi në procedurat e monitorimit dhe raportimit të buxhetit sipas kërkesave të përcaktimit Ligji Nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjet respektive për buxhetin e vitit 2021 dhe 2022 dhe Udhëzimi i Përhershëm Nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. Monitorimet dhe raportimet për realizimin e buxhetit mbështeten vetëm në rakordimet mujore me degën e thesarit, monitorim ky që kryhet vlerë dhe jo në produkt, duke pasqyruar realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre. Rakordimet nuk mundësojnë kryerjen e monitorimit të performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, për shkak të mos krahasimit të treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. Nuk bëhet i mundur evidentimi nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin, në mënyrë që të kryhen propozime/rekomandime për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese nëpërmjet alokimit të burimeve. Nuk kryhet analiza krahasimore e realizimit të fondeve me periudhat e mëparshme. Nuk sigurohet informacion për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit. Të dhënat lidhur me performancën financiare nuk rezultojnë të publikuara në faqen zyrtare të QSUNT, për pasojë nuk garantohet transparenca institucionale. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Statutin e QSUNT dhe Rregulloren bazë të QSUNT, dhe nenin 23/1 të Nr. 10 296, datë 08.07.2010, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar nga punonjësit:

Znj. A.F. në cilësinë e Drejtor i Përgjithshëm në QSUNT për periudhën nga data 03.12.2022 deri 31.12.2022. Z. E.J. në cilësinë e ish Drejtor i Përgjithshëm në QSUNT për periudhën nga data 01.04.2021 deri 30.11.2021. I.K. në cilësinë e nëpunësit autorizues të nivelit të dytë e Drejtor të Drejtorisë Ekonomike në QSUNT për periudhën nga data 21.02.2022 deri 11.11.2022.

ç. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore.

Për periudhën objekt auditimi QSUNT ka realizuar të ardhura dytësore nga qiratë, parkingu, pagesa konsultash mjekësore (konsulta me mjekë më të specializuar), shërbim ambulatorë (analiza, ekzaminime) shërbime administrative (tarifa për vërtetime të ndryshme lëshuar nga QSUNT), sekuestrime dhe zhdëmtim, sponsorizime, dhe të tjera. Nga QSUNT kryhet planifikimi i fondeve për të ardhurat dytësore në fazën e hartimit të projekt buxhetit për periudhat pasardhëse. Ndërsa për përdorimin e tyre, nuk rezulton të jetë kryer planifikim paraprak në fillim

të vitit sipas zërave dhe vlerave respektive, si për investimet apo shpenzimet që institucioni që institucioni i vlerëson prioritare për tu kryer prej saj me fondet e veta. Realizimi i të ardhurave dytësore për Viti 2021:

Për vitin 2021, sipas PBA 2021-2023, të ardhurat dytësore janë planifikuar në vlerën 46,476 mijë lekë ose 11,433 mijë lekë më shumë se fakti vitit pasardhës, në të cilin të ardhurat faktike paraqiten në vlerën 35,043 mijë lekë.

Realizimi i të ardhurave për vitin 2021 është në shumën 40,416 mijë lekë³ ose realizuar në masën 86.96% krahasuar me planifikim në PBA 2021-2023, në të cilin janë planifikuar 46,476 mijë lekë. Diferencat në mos realizimin e të ardhurave sipas parashikimi buxhetor paraqitet në zërat: “shërbimi ambulatorë mjekësor” për më pak në shumën 4,151 mijë lekë; “konsultat mjekësore” për më pak në shumën 2,918 mijë lekë, “shërbime administrative” për më pak në shumën 1,109 mijë lekë dhe “qira parkingu” për më pak në shumën 334 mijë lekë. Në total mosrealizimi në shumën 6,060 mijë lekë. Realizimi të ardhurave dytësore kundrejt planifikimit buxhetor PBA 2021 - 2024, për vitin 2021 paraqitet si më poshtë:

Të ardhurat dytësore viti 2021 (Në mijë lekë)

Llogaria ekonomike	Kodi i Institucionit	Fakti 2020	PBA 2021-2023	Fakti 2021	Pjesa e Institucionit	Rritje e autorizuar	Derdhur në buxhet	Mbeten për tu trashëguar
7109600	Qira (Kontrata nën 200 m2)	9,842	11,376	13,677	4,252	0	9,425	4,252
7111004	Shërbim Ambulatorë Mjekësor	1,389	5,700	1,549	1,549	0	0	1,549
7113013	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
7113099	Konsulta Mjekësore	13,449	23,000	20,082	20,082	0	0	20,082
7111099	Shërbime Administrative	1,255	2,300	1,191	1,191	0	0	1,191
7115600	Sekuetime dhe zhdëmtime	572	1,000	1,151	0	0	1,151	0
7111007	Qira Parkingu	2,461	3,100	2,766	2,766	0	0	2,766
	Totali	28,968	46,476	40,416	29,840	0	10,576	29,840
7207011	Sponsorizime nga subjekte shtetërore dhe private	6,075	0	4,339	4,339			4,339
	Totali	35,043	46,476	44,755	34,179	0	10,576	34,179

(Burimi: Përpunuar nga KLSH sipas të dhënave të QSUNT)

Realizimi i të ardhurave dytësore 2021

QSUNT në fillim të vitit buxhetor rezulton se nga të ardhurat dytësore disponon 27,533 mijë lekë, gjatë vitit ka realizuar 34,179 mijë lekë dhe deri në fund të vitit 2021 janë përdorur 9,063 mijë lekë ose 26.52% të të ardhurave vjetore. Për tu përdorur në vitin pasardhës, janë trashëguar fonde në shumën 52,650 mijë lekë.

Realizimi dhe përdorimi të ardhurave dytësore (Në mijë lekë)

Nr	Spitalet	Mbetur pa përdorur 2020				Realizuar 2021	Përdorur 2021			Përdorur gjithsej	Mbetur pa përdorur gjithsej
		600	602	231	Mbetur pa përdorur gjithsej		600	602	231		
1	Q.S.U. Nene Tereza	3,170	6,147	12,361	21,678	34,179	2,480	900	5,683	9,063	46,794
2	Sponsorizim Toksikologji	1,242	176	397	1,814		0.00	0.00	0.00	0.00	1,814
3	Sponsorizim Pediatri 2	0	2,838	0	2,838		0.00	0.00	0.00	0.00	2,838
4	Sponsorizim Pediatri 3	0	1,203	0	1,203		0.00	0.00	0.00	0.00	1,203
	TOTALI	4,412	10,363	12,758	27,533	34,179	2,480.25	900.00	5,683	9,063	52,650

(Burimi: QSUNT)

Përdorimi i të ardhurave dytësore 2021.

Shpenzimet e QSUNT, financuar nga të ardhurat dytësore për vitin 2021 krahasuar me përdorimin pas miratimit nga MSHMS dhe nivelin e realizimit deri në fund të vitit, paraqitet për

³ Në PBA 2021-2023 nuk janë parashikuar të ardhura nga sponsorizimet.

investime në shumën 5,682 mijë lekë, për paga në shumën 2,480 mijë lekë dhe për shpenzime operative në shumën 900 mijë lekë, si më poshtë vijon:

Shpenzime për investime nga të ardhurat dytësore në vitin 2021, si më poshtë:

Në zbatim të VKM Nr.20 date 20.01.2021 "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021 dhe të VKM 432 date 28.06. 2006 "Për krijimin dhe administrimit të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore", QSUNT ka kërkuar dhe MSHMS ka miratuar përdorimin e fondeve të të ardhurave dytësore për investime si më poshtë vijon:

Me shkresën Nr. 85/45 prot, datë 31.03.2021, MSHMS ka miratuar përdorimin e fondit të planifikuar nga të ardhurat dytësore në total në shumën 7.792 mijë lekë (me TVSh) sipas me kërkesës Nr. 144/21, datë 30.03.2021, për llog 231 për projektin "FV dhe kolaudim i sistemeve të ujit në Shërbimin e Nefrologjisë". Me shkresë Nr. 85/77 prot, datë 03.06.2021, MSHMS ka miratuar përdorimin e fondit të planifikuar nga të ardhurat dytësore deri 283 mijë lekë (me TVSH dhe 340 mijë lekë (pa TVSh) sipas me kërkesës Nr. 1092/9, datë 10.05.2021, për llog 231 për projektin "Blerje (VF) kondicioneri në ambientet ku është instaluar CT-Skaner, donacion i BE".

Projektet e investimeve të financuara nga të ardhurat dytësore viti 2021 (Në mijë lekë)

Kodi projektit	Emërtimi i projektit	Furnitori	Kontrate	Likuiduar
19AH805	FV dhe kolaudim i sistemeve të ujit në Shërbimin e Nefrologjisë	M. shpk	Kontrate Nr. 1851/8 date 19.08.2021	5,391
19AH806	Blerje kondicioneri	S.K. shpk	Kontrate Nr. 1092/18 date 29.09.2021	292
TOTALI				5,683

(Burimi: QSUNT)

Përdorimi i të ardhurave për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (2021). Në zbatim të VKM Nr.20 date 20.01.2021 "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021 dhe të VKM 432 date 28.06. 2006 "Për krijimin dhe administrimit të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore", QSUNT ka kërkuar dhe MSHMS ka miratuar përdorimin e fondeve të të ardhurave dytësore:

Me shkresën MSHMS Nr. 85/25 prot, datë 22.02.2021, sipas kërkesës së QSUNT me Nr. 589 prot, datë 11.02.2021 për përdorimin e fondit të planifikuar për shpenzime për paga (art.600) për: a-Shpenzime për paga të punonjësve me kontratë në QSUNT për 2(dy) punonjës në pozicion "Inxhinier biomedikal", për dy muaj dhe b- Shpenzime për paga të punonjësve me kontratë në QSUNT për 1 (një) punonjës në pozicion "Mjek", për 12 muaj deri në shumën 2.052.964 lekë. Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për 2 (dy) punonjës në pozicion "Inxhinier biomedikal" dhe për 1 (një) punonjës në pozicion "Mjek", për 12 muaj deri në 342.845 lekë. Me shkresën MSHMS Nr. 85/62 prot, datë 30.04.2021, sipas kërkesës së QSUNT me Nr. 999/2 prot, datë 14.04.2021, deri në shumën 375.900 lekë për shpenzime për paga (art.600) dhe deri në 62.775 lekë shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për 1(nje) punonjës me kontratë afat 3 (tre) mujor, për pozicion mjek kirurg ORL me përvojë në kryerjen e procedurës së vendosjes së implantit koklear tek fëmijët që nuk dëgjojnë. Përdorimi i të ardhurave për paga (llog 600) si më poshtë:

Shpenzime për paga nga të ardhurat dytësore (në mijë lekë)

	Emërtimi	Shpenzime
1	Pagat e punonjësve me kontratë shërbimi	1,688
2	Sigurime Shoq. Shend. dhe Tap	792

	TOTALI	2,480
--	---------------	--------------

Përdorimi i të ardhurave për shpenzime të tjera operative

Me shkresën Nr. 85/52 prot, datë 14.04.2021, sipas kërkesës së QSUNT me Nr. 1065/2 prot, datë 12.04.2021 deri në 400.000 lekë me destinacion përdorimin e fondit të planifikuar për shpenzime operative (art.602) për specializim për mjekun Gj. të Shërbimit të Hemodinamikës pranë Shërbimit të Kardiologjisë, për një periudhë tre mujore pranë spitalit Universitar KOC në Stamboll, Turqi. Me shkresën Nr. 85/72 prot, datë 24.05.2021, sipas kërkesës së QSUNT me Nr. 680/14 prot, datë 24.05.2021, deri në shumën 1.000.000 lekë për shpenzime për operative (art.602) për mbulimin e një pjese të shpenzimeve doganore për sjelljen e burimit radioaktiv Co-60, për trajtimin e pacientëve në spitalin onkologjik.

Përdorimi i të ardhurave për paga (llog 6021) si më poshtë:

Nr.	Emërtimi		Pagesa	Date
1	Pagese udhëtimi akomodimi dieta	A000002	400,000	29.04.2021
2	Tvsh e lendes radioaktive	A000005	500,000	24.05.2021

Realizimi të ardhurave dytësore për vitin 2021, sipas burimit të krijimit rezulton si më poshtë:

Të ardhurat dhënia me "Qira" e ambienteve të QSUNT.

Bazuar në kriteret e VKM Nr.54/2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", subjekti ka lidhur kontrata qiraje për sipërfaqe deri/ mbi 200 M2, referuar tarifave dysHEME të përcaktuara në këtë akt normative. Arkëtimi, derdha në buxhet dhe të ardhurat për t'u trashëguar dhe përdorur nga njësia ekonomike, për çdo vit buxhetor, janë në përputhje me kreun VII të VKM Nr.54, datë 02.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, dhe të rakorduara me degën e thesarit.

Për vitin 2021⁴ në bazë të kontratave respektive sipas subjekteve qiramarrëse, të ardhurat nga qiratë janë realizuar të ardhurat në shumën 13,677 mijë lekë nga të cilat 11,763 mijë lekë janë e për kontrata qiraje me sipërfaqe mbi 200 m² dhe 6,074 mije të ardhurat e kontratave me sipërfaqe deri 200 m2. Sipas të dhënave të thesarit njësia ka derdhur në buxhet 11,763 mijë lekë ose 100ë të të ardhurave të qirasë për kontrata mbi 200 m² dhe 1,822 mije lekë ose 30ë të të ardhurave të qirasë për kontrata deri 200 m2, duke trashëguar shumën 4,252 mije lekë për tu përdorur nga vete njësia ekonomike. Nga administrimi i pronës lidhur me kontratat e qirasë, rezulton se subjektet kanë shlyer detyrimet kontraktuale. Detyrimet në fund të vitit buxhetor janë detyrime për tu arkëtuar në muajin pasardhës. Të ardhurat nga qiratë sipas subjekteve qiramarrëse për vitin 2021 rezultojnë si më poshtë:

Të ardhurat nga qiratë sipas subjekteve qiramarrëse për vitin 2021 (në lekë)

Nr.	QIRAMARRESI	Kontrata	Çelje e kërkesave për arkëtim 31.12.2020	TOTALI 2021			
				Totali I të ardhura nga qiratë 2021	Totali të Ardhurave nga Penalite 2021	Totali I arkëtimeve nga qira 2021	Totali për tu arkëtuar nga qirate deri 31.12.2021
	Mbi 200 m2		639,120	11,690,640	301,180	11,762,920	228,900
1	K.	Nr. 283/1 dt..22.01.2021	205,110	4,009,470	150,503	4,159,973	-

⁴ Monitorimi dhe realizmi kushteve të kontratës nga qiramarrësi do të realizohet në drejtimet e tjera të programit.

2	A.	Nr.1913 date 15.04.2014 ⁵	228,900	2,975,700	-	2,746,800	228,900
3	K.GJ.	Nr.7827 rep/2371/1 kol dt..26.10.2015	-	696,000	174	696,174	-
Nen 200 m2			456,261	6,240,449	41,452	6,074,010	207,891
4	S.K.	Nr.342/15 dt..23.04.2021	-	110,814	2,100	122,988	(10,074)
5	O.C.	Nr.858/10 dt..29.06.2020, 2523/6 dt..15.11.2021	-	2,484,000	34,400	2,509,600	8,800
6	G.O. shpk	Nr.342/14 dt..13.04.2021	(20,148)	201,480	840	241,776	(39,456)
7	B.C.	Nr.45852 dt..18.12.2020	471,511	2,014,639	2,572	2,017,212	(1)
8	C.P.	Nr.342/16 dt..06.05.2021	38,478	417,932	1,540	453,052	(33,580)
9	M.T.	Nr.342/13 dt..13.04.2021	(33,580)	335,800	-	369,380	(33,580)
10	V.A.	Nr.195/19 dt..23.07.2020	-	675,784	-	360,002	315,782
SHUMA				13,921,619	192,129	13,676,957	436,791

(Burimi: QSUNT)

Të ardhurat nga “Shërbim parkingu” për vitin 2021 janë realizuar në shumën 2,766 mijë lekë. VKM Nr.688, datë 14.11.2018 dhe Akt Marrëveshje nënshkruar mes QSUNT dhe F. Nr. 1242/41, date 16.11.2018 (QSUNT), kanë përcaktuar se 3ë e të ardhurave që F. do të gjenerojë nga shërbimi parkingut do të derdhen në llogarinë e QSUNT dhe 42 e të ardhurave do të investohet nga F. me kërkesë të QSUNT, pas miratimit paraprak të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të investohen në infrastrukturë, për përmirësimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme në përmbushje të objektivave dhe misionit të saj. QSUNT bazuar në akt rakordime firmosur nga përfaqësuesit e institucioneve, ka lëshuar fatura për arkëtim, në total të ardhura në shumën 2,767 mijë lekë, rakorduar me degën e thesarit, si me poshtë vijon:

Arkëtimet shërbim parkingu 2021 (në mijë lekë)

Viti 2021	Fatura	Periudha	Totali të Ardhurave	QSUNT 45%	Qsunt 42% Investim	Qsunt 3% Cash	Arkëtuar
Mars	Fat Nr. 280 , Date 16.03.2021	01.12.2020- 28 shkurt 2021	21,263	9,568	8,930	638	638
Qershor	Fat Nr. 311 , Date 08.06.2021	01 mars 2021- 31 maj 2021	23,620	10,629	9,921	709	709
Shtator	Fat Nr. 342 , Date 13.09.2021	01.qershor 2021 deri 31 gusht 2021	19,749	8,887	8,295	592	592
Dhjetor	Fat Nr. 374 , Date 15.12.2021	01 shtator 2021-30 nëntor 2021	27,588	12,414	11,587	828	828
Totali			92,220	41,499	38,732	2,767	2,767

Të ardhurat nga zëri “Shërbimet administrative” janë realizuar në shumën **1,191 mijë** lekë në vitin 2021 kundrejt 1,389 mijë lekë ose 198 mijë lekë më pak se viti paraardhës. Aplikimi tarifave mbështetet në Urdhrin Nr. 196, datë 05.06.2018, protokolluar me Nr. 2932 prot, datë 05.06.2018 mbi aplikimin e tarifave me çmime të miratuara mbi disa shërbime të ofruara nga QSUNT si lëshimi kopjes e kartelës klinike për paciente 350 lekë/kopje; lëshim vërtetim page/punësimi 100 lekë/kopje, etj. Arkëtimi i shumave kryhet pranë arkave të vendosura pranë çdo PAI ku kërkohet shërbimi. Regjistrimi i kërkesës për arkëtim regjistrohet në mënyrë elektronike në sistemin SISP.

Të ardhurat nga zëri “Shitja e mallrave e shërbimeve” paraqesin të ardhurat nga konsultat mjekësore të cilat rezultojnë në shumën 20,082 mijë lekë me një rritje prej më shumë se 6,634 mijë lekë nga viti 2020, ku këto të ardhura ishin në vlerën 13,448 mijë lekë, bazuar në legjislacionin në fuqi për sistemin e referimit dhe tarifën e shërbimit të shëndetit shëndetësor publik dhe Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë Mbrojtjes Sociale Nr.493, date 20.07.2019 “Për sistemin e referimit dhe tarifën e shërbimit shëndetësor publik”. Të ardhurat nga zëri “shërbimi ambulatorë” janë realizuar në shumën 1,549 mijë lekë, kundrejt me 1,254 mijë lekë në vitin

⁵ Kontrata me qiramarrës AGS Nr. 1913, datë 15.04.2014, ne nenin 3 parashikon ripërtëritje në mënyrë automatike për një periudhë një vjeçare.

2020, i cili përmban të ardhura nga shërbimi specializuar me sistem referimi për shërbim laboratorik, imazherik, të nevojshme për kryerjen e konsultës së specializuar në QSUNT.

Të ardhura nga sekuestrime dhe zhëmtime, arkëtimi në shumën 1,151 mijë lekë, derdhur 100ë në buxhet, arkëtime me arke në shumën 410 mije lekë për detyrime të prapambetura me “Plus Communication dhe 741 mije lekë arkëtime nga detyrime të prapambetura për paga, etj.

Arkëtime nga “Sponsorizime” në shumën 4,339 mijë lekë janë kontribute financiar në lidhje me kostot për Covid-19 për QSUNT sipas “Marrëveshjes për sigurimin e një kontributi financiar Nr. SAMRS/2021/FP/01/AL” me protokolluar Nr. 800, data 05.03.2021 (QSUNT) financuar në shumën 3,688 mije lekë dhe financim për studime klinike nga “Marrëveshja për studim klinik me Comac Medical”, financuar në shumën 651 mije lekë. Të ardhurat dytësore janë rakorduar me degën e thesarit sipas evidencës përkatëse mujore dhe progresive. Realizmi të ardhurave dytësore për vitin 2022. Për vitin 2022, të ardhurat dytësore janë planifikuar në vlerën 26,120 mijë lekë dhe janë realizuar 141,480 mijë lekë ose 96,725 mijë lekë më shumë se planifikimi sipas PBA 2022-2024, ose 115,360 mijë lekë më shumë se fakti vitit pasardhës, në të cilin të ardhurat faktike paraqiten në vlerën 44,755 mijë lekë.

Rritja kryesore vjen pas ndryshmit të VKM 688/2018 me VKM 135/2022, sipas të cilës F. ka në përgjegjësi administrimi të oborrit të brendshëm të QSU më sipërfaqe 10457 m², dhe të ardhurat e gjeneruara ndahen midis palëve sipas përqindjeve të përcaktuara në VKM 688/2018. Pas hyrjes në fuqi të VKM 135/2022, QSUNT-së i kaluan në buxhet 80% e të ardhurave të krijuara dhe të papërdorura në vite, të disponuara nga F., për investime në infrastrukturë, pajisje mjekësore, etj. duke rritur të ardhurat dytësore të papërdorura që nga data e lidhjes se Akt Marrëveshjes 15.11.2018 deri hyrjen në fuqi të efekteve të VKM 135/2022 për shumën 76,498 mije lekë, dhe në vazhdimësi gjenerim të ardhurash në shumën 26,330 mije lekë deri në fund të vitit 2022. Nga e ardhura e krijuar në shumën 141,480 mijë lekë në buxhet janë derdhur 9,115 mijë lekë. Të ardhurat dytësore për vitin 2022, rakorduar me degën e thesarit, sipas evidencës si me poshtë vijon:

Të ardhurat dytësore viti 2022 (Në mijë lekë)

Llogaria ekono.	Emërtimi llogarisë	Fakti 2021	I Pritshmi 2022	Të ardhurat progresive	Pjesa e Institucionit	Rritje e autorizuar	Derdhur në buxhet	Mbeten për tu trashëguar
7109600	Qira (Kontrata nën/mbi 200 m2)	13,677	12,120	12,833	4,132	4,132	8,701	0.00
7111004	Shërbim Ambulatorë Mjekësor	1,549	2,700	1,424	1,424	1,424	0.00	0.00
7113099	Konsulta Mjekësore	20,082	7,000	24,859	24,859	24,859	0.00	0.00
7111099	Shërbime Administrative	1,191	700	1,372	1,372	1,372	0.00	0.00
7115600	Sekuestrime dhe zhëmtime	1,151	1,300	414	0.00	0.00	414	0.00
7111007	Qira Parkingu	2,766	1,000	98,906	98,906	98,906	0.00	0.00
		40,416	24,820	139,807	130,692	130,692	9,115	0.00
7207011	Sponsorizime nga subjekte shtetërore dhe private	4,339	1,300	1,672	1,672	1,672	0.00	0.00
		44,755	26,120	141,480	132,365	132,365	9,115	0

(Burimi: QSUNT)

Sipas burimit të krijimit rezulton si më poshtë:

Të ardhurat dhënia me “Qira” e ambienteve të QSUNT. Për vitin 2022⁶ në bazë të kontratave respektive sipas subjekteve qiramarrëse, të ardhurat nga qiratë janë realizuar të ardhurat në shumën 12,833 mijë lekë nga të cilat 6,930 mijë lekë janë e për kontrata qiraje me sipërfaqe mbi 200 m² dhe 5,903 mije të ardhurat e kontratave me sipërfaqe deri 200 m². Sipas të dhënave të thesarit njësia ka derdhur në buxhet 6,930 mijë lekë ose 100% të të ardhurave të qirasë për kontrata mbi 200 m² dhe 1,771 mije lekë ose 30% të të ardhurave të qirasë për kontrata deri 200

⁶ Monitorimi dhe realizmi kushteve të kontratës nga qiramarrësi do të realizohet ne drejtimet e tjera të programit.

m2, duke trashëguar shumën 4,132 mije lekë për tu përdorur nga vete njësia ekonomike. Nga administrimi i pronës lidhur me kontratat e qirasë, rezulton se subjektet kanë shlyer detyrimet kontraktuale. Detyrimi për arkëtim në 31.12.2022 paraqet detyrime të dhjetorit që paguhen në janar 2023. Të ardhurat nga qiratë sipas subjekteve qiramarrëse për vitin 2022 rezultojnë si më poshtë:

Të ardhura nga qiratë viti 2022 (në lekë)

Nr.	QIRAMARRESI	Kontrata	Çelje e kërkesave për arkëtim 31.12.2021	TOTALI 2022			
				Totali të ardhurave nga qiratë 2022	Totali të Ardhurave nga Penalite 2022	Totali i arkëtimeve nga qira 2022	Totali për tu arkëtuar nga qiratë deri 31.12.2022
Mbi 200 m2			228,900	7,247,160	85,590	6,930,130	402,620
1	K..	Nr. 283/1 dt..22.01.2021		3,804,360	85,590	3,487,330	402,620
2	A.	Nr.1913 date 15.04.2014	228,900	2,746,800	-	2,746,800	-
3	K.GJ.	Nr.7827 rep/2371/1 kol dt..26.10.2015	-	696,000	-	696,000	-
Nen 200 m2			325,422	5,686,724	166,458	5,902,725	(49,543)
4	S.K.	Nr.178/26 dt..03.10.2022	-	129,156	3,000	145,376	(13,220)
5	O.C.	Nr.2523/6 dt..15.11.2021	8,800	2,182,300	82,400	2,265,500	(800)
6	G.O.shpk	Nr.178/24 dt..09.09.2022	840	238,959	-	269,022	(30,063)
7	B.C.	Nr.143/5 dt..16.02.2022		1,543,128	3,858	1,546,987	(0)
8	C.P.	Nr.178/25 dt. 13.09.2022		423,078	2,800	474,537	(48,659)
9	M.T.	Nr.178/32 dt..28.12.2022		134,320	-	134,320	-
10	V.A.	Nr.1267 dt..28.04.2022	315,782	1,035,782	74,400	1,066,984	43,198
SHUMA			554,322	12,933,884	252,048	12,832,855	353,077

Institucioni ka realizuar të ardhura vjetore “Shërbim parkingu” në shumën 98.906 mije lekë, kundrejt 2,766 mije lekë realizuar në vitin 2020. Burimi i të ardhurave dytësore është kalimi në përgjegjësi administrimi të sipërfaqes se oborrit të brendshëm të QSUNT prej 10,457 m², sipas kritereve të VKM 688/2018 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga MSHMS të FZHZZH të objektit me emërtim “Oborr i QSUNT Tiranë”, me qëllim shfrytëzimin për parkim, përmirësimin e infrastrukturës së jashtme urbane dhe pritëse, si dhe menaxhimin cilësor të shërbimeve publike që do të zhvillohen në këtë sipërfaqe. VKM 688/2018 në nenin 4 germa “a” dhe “b”, përcakton modalitetin e ndarjes se të ardhurave të gjeneruara, sipas të cilës nga pjesa takuese (45%) QSUNT, nga e cila 3% do të kalojë në llogarinë e QSUNT me destinacion edukimin e vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe 42% do të investohet nga F., me kërkesë të QSUNT dhe pas miratimit paraprak të MSHMS. Pas ndryshimeve të VKM 688/2018 me VKM Nr. 135, datë 02.03.2022 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga MSHMS të FZHZZH të objektit me emërtim “Oborr i QSUNT” Tiranë”, nenit 4 germa “a”, modaliteti përfitimit të të ardhurave dytësore për QSUNT ndryshohet dhe shtohet pikës 4/1, që përcakton kalimin 80% të ardhurave e krijuara të papërdorura në buxhetin e QSUNT-së, që nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit. Për periudhën 01.05.2022-31.05.2022, në zbatim të aktit normativ dhe të Akt Marrëveshjes datë 1242/41 prot, datë 16.11.2018, amenduar me Nr. 884/2 prot, datë 12.04.2022, QSUNT ka rakorduar të ardhurat e gjeneruara nga shërbimi parkimit. QSUNT nga shërbimi parkimit për vitin 2022, bazuar në akt rakordime të firmosura nga përfaqësuesit e institucioneve, ka lëshuar fatura për arkëtim, në total të ardhura në shumën 98,906,391 lekë, të rakorduara me degën e thesarit, si me poshtë vijon:

Të ardhura nga parkimi 2022

Viti 2022	Faturë për arkëtim	Periudha	Arkëtuar	Data e pagesës
-----------	--------------------	----------	----------	----------------

Janar	Faturë Nr.03, dt.. 10.01.2022	01.12.2022-31.12.2022	296,513	10.10.2022
Mars	Faturë Nr.25, dt.. 25.03.2022	01.01.2022-01.03.2022	538,150	26.03.2022
Prill	Faturë Nr.33/2 dt.. 22.04.2022	15.11.2018-01.03.2022	76,497,615	26.04.2022
Prill	Faturë Nr.42, dt.. 10.05.2022	02.03.2022-30.04.2022	4,755,795	11.05.2022
Qershor	Faturë Nr. 23/2022 dt.. 08.09.2022 (online)	01.05.2022-31.05.2022	2,138,354	07.10.2022
Shtator	Faturë Nr.22/2022 dt.. 07.09.2022 (online)	01.06.2022-31.08.2022	7,017,167	20.09.2022
Tetor	Faturë Nr.37/2022 dt.. 06.09.2022 (online)	01.09.2022-30.09.2022	1,964,548	07.10.2022
Dhjetor	Faturë Nr.60/2022 dt.. 15.12.2022 (online)	01.10.2022-30.11.2022	5,698,250	16.12.2022
		Total	98,906,391	

(Burimi: QSUNT Punoi: KLSH)

Nga auditimi u konstatua se:

QSUNT me shkresën Nr. 998/3 prot, datë 20.04.2022 ka dërguar Akt Rakordim për periudhën 15.11.2018 deri 01.03.2022, si dhe faturën për arkëtim Nr. 32/22, datë 22.04.2022 për arkëtimin në llogarinë e saj të së ardhurës dytësore të papërdorur në shumën 76,497,614 lekë. Akt Rakordimi mbështet në Akt Marrëveshjen e nënshkruar midis QSUNT dhe F., me Nr. 1242/41, datë 16.11.2018, ndryshuar me Amendamentin Nr. 1, protokolluar me Nr. 884/2, datë 12.04.2022, në zbatim të VKM Nr. 135/2022 “Për disa shtesa në vendimin Nr. 688, datë 14.11.2018 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga MSHMS të F., të objektit me emërtim “Oborr i QSUNT”” pika 4/1 ku citohet se: “Të ardhurat e krijuara nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit dhe të papërdorura kalojnë 80% si të ardhura dytësorë buxhetin e QSUNT...”. Fatura për arkëtim mbështet në Akt Akordim për periudhën 15.11.2018 deri 01.03.2022, dërguar nga “A.” shpk, me shkresën Nr. 65/1 port, datë 14.04.2022, se bashku me dokumentacion shoqërues mbi të ardhurat dhe investimet e kryera nga QSUNT (42%), në të cilin sipas përlllogaritjeve të A. deri 01.03.2022 rezulton se:

Pjesa takuese të ardhurave të papërdorura nga QSUNT (42%) rezulton në shumën 112,496,492 lekë; Sipas VKM 135/2022, pika 4/1 duhet të kalojnë drejt QSUNT (80% e vlerës se mbetur të papërdorur) shuma 89,997,194 lekë (112,496,492 *80%). Vlera e mbetur pakësohet me 15% tatim fitimi, në shumën 13,499,579 lekë. Vlera e rakorduar për tu kaluar për llogari të QSUNT mbetet 76,497,615 lekë. Të ardhurat e papërdorura qe duhet t’i kalojnë nga QSUNT (80%), pas hyrjes në fuqi të VKM Nr. 135/2022, nëpërmjet faturës për arkëtim Nr. 33/2, datë 22.04.2022 në vlerë 76,497,615 lekë, në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën si më poshtë vijon:

Të ardhura të papërdorura 15.15.2018- 01.03.2022 nga QSUNT

	QSUNT	Për pjesën takuese QSUNT (42%)	Shuma
1	Të ardhura	Nga 15.11.2018 deri 28.02.2021 (42%)	94,983,423
2	Investime	Nga 15.11.2018 deri 28.02.2021 (42%)	(12,330,096)
3	Të ardhura	Nga 01.03.2022 deri 01.03.2022 (42%)	41,483,905
4	Investime	Nga 01.03.2022 deri 01.03.2022 (42%)	(11,640,740)
		Vlere e papërdorur nga QSUNT (42%)	112,496,492
5	Të ardhura	Nga 15.11.2018 deri 01.03.2022 (80%)	89,997,194
6	Tatim fitimi	Pakësim me 15% tatim fitim	(13,499,579)
7		Vlera përfundimtare e të ardhurave të papërdorura prej QSUNT (80%)	76,497,615

(Burimi: QSUNT Punoi: grupi Auditivit)

Agjencia Ekonomike Mbështetëse (A.) përfaqësuese e F., nëpërmjet shkresës Nr.132, datë 04.10.2022, protokolluar me Nr. 998/7 port, datë 04.10.2022, ka dërguar Akt Akordim për periudhën 01 Shtator 2022 deri 30 Shtator 2022, në të cilin dokumenton se për këtë periudhë u realizuan të ardhura në total 10,711,667 mije lekë, nga e cila pjesa takuese QSUNT në vlerë 4,820,250 lekë (45%), nga e cila 25% ose 2,677,917 lekë duhet të kalojë për arkëtim në llogari të QSUNT. Në Akt Akordim cilësohet se për periudhën 01.09.2022 deri 30.09.2022 është kryer

zbritja e detyrimit të tatimit mbi fitimin prej 15% në shumën 713,369 lekë e cila i përket periudhës 02 Mars 2022 deri 30.04.2022, për shkak të hyrjes në fuqi të VKM 135/2022, pika 4/a. Vlera përlllogaritur që do ti kalohet QSUNT mbetet 1,964,548 lekë. Akt Rakordomi për periudhën 01.09.2022-30.09.2022 ka përfshire edhe periudhën 02.03.2022-30.04.2022, për të cilën QSUNT ka lëshuar faturë për arkëtim Nr. 37/2022, datë 06.10.2022 për arkëtim të shumën 1,964,548 lekë.

Akt Marrëveshje Nr. 1242/41, datë 16.11.2018, në nenin 6.5 përcakton: *“Pala e dyte F./A. do të derdhe në llogarinë e palës se parë, shumen prej 3% të të ardhurave sipas pikës 3 të VKM 688/2018, çdo 3-mujor, por jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës duke respektuar ligjet në fuqi në RSH”*. Referuar datës së pagesës rezultojnë se:

Sa më sipër u konstatua se:

Fatura tatimore Nr. 23/2022 datë 08.09.2022 (oleinë) është arkëtuar në shkelje të afatit përcaktuar në Akt Marrëveshje Nr. 1242/41, dt. 16.11.2018, nenin 6.5, i cili përcakton derdhjen në llogarinë e QSUNT jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës që përkon brenda datës. Nisur nga periudha që përfshihet në akt rakordim (01.05.2022-31.05.2022), që i përket 3-mujorit të II-2022, data e pagesës duhet të ishte brenda 20.07.2022. Në fakt pagesa mban datën 07.10.2022 ose tre muaj me vonesë, për shkak të lëshimit me vonesë të faturës për arkëtim. Fatura tatimore Nr.25, datë 25.03.2022 është arkëtuar 6 ditë me vonesë në shkelje të afatit të përcaktuar në nenin 6.5 të Akt Marrëveshjes Nr. 1242/41, datë 16.11.2018, përcakton derdhjen në llogarinë e QSUNT jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës, kjo për shkak të lëshimit me vonesë të faturës për arkëtim, e cila mban datën 25.03.2022. Në buxhetin e QSUNT nuk u kërkua dhe nuk u arkëtua shuma 13,499,579 lekë për faturën për arkëtim Nr. 33/2, datë 22.04.2022 dhe nëpërmjet faturës Nr. 37/2022, datë 06.10.2022 nuk u kërkua dhe nuk u arkëtua shuma 713,369 lekë, e konsideruar nga palët si 15%.tatim fitim. Pas momentit të hyrjes në fuqi të aktit normativ hyrjes në fuqi të VKM 135/2022 (botuar në FZ Nr. 37, datë 09.03.2022) detyrimi ligjor mbi palët është se deri në momentin e hyrjes në fuqi të VKM 135/2022, të ardhurat e krijuara dhe të papërdorura duhet të kalojnë në buxhetin e QSUNT në masën 80% si të ardhura dytësore për tu përdorur për investime në infrastrukturë, pajisje mjekësore ose investime të tjera etj.

Sa më sipër VKM 688 /2018 pika 3 dhe 4, ndryshuar me VKM 135/2022 pika 4/1, kane përcaktuar qartë raportet e ndarjes së të ardhurave midis palëve që kanë nënshkruar akt marrëveshje. Mbajtja e tatim fitimit në masën 15% mbi të ardhurat dytësore të QSUNT, bie ndesh me kërkesat VKM Nr. 135/2022, pika 4/1 dhe Akt- Marrëveshjes Nr. 1242/41, date 16.11.2018, të ndryshuar.

Për përcaktimin e fitimit të tatueshëm (mbajtja e tatimit mbi fitimin 15%) kërkon që subjekti të ketë përgjegjësi tatimore si subjekt i tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, i ndryshuar, si dhe dispozitat e Udhëzimit Nr.5, datë 30.01.2006 *“Për Tatimin Mbi të Ardhurat”*, i ndryshuar.

Në parim Ligji 8438/1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, i ndryshuar, dhe *Udhëzimi Nr. 4, date 21.02.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.23, date 26.02.2019*), përcakton se fitimi ose e ardhura neto e tatueshme, del si rezultat i diferencës midis të ardhurave totale (*të ardhurat nga aktiviteti normal dhe të ardhura të jashtëzakonshme*), përfshirë vlerën e përfitimeve dhe të avantazheve në natyrë, me shpenzimet e kryera me qëllim realizimin dhe ruajtjen e të ardhurave. QSUNT është ent publik shtetëror dhe jo person juridik i ngarkuar me përgjegjësi tatimore për tatimin mbi fitimin sipas Ligjit Nr. 8438/1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat”*.

Konkluzion: Sa më sipër veprimet e palëve QSUNT dhe F. (përfaqësuar nga A.) për mos arkëtimin shumës 13,499,579 lekë nuk gjejnë mbështetje në Ligjin Nr. 8438/1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat”* i ndryshuar dhe Udhëzimin Nr.5, datë 30.01.2006 *“Për tatimin mbi të ardhurat”*,

i ndryshuar, dalë në zbatim të tij. Për pasojë mos arkëtimi shumë 13,499,579 lekë, zbritur si 15% tatim fitim nga fatura për arkëtim Nr. 37/2022, datë 06.10.2022, nuk është në përputhje dispozitat ligjore të përcaktuara në Kreun III “Tatimi mbi Fitimin” të Ligjit Nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin Nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dalë në zbatim të tij, pasi QSUNT nuk është person juridik i ngarkuar me përgjegjësinë tatimore për tatimin mbi fitimin. *Personat përgjegjës:*

E.C.- në cilësinë e Specialist i Sektorit të Financës dhe Kontabilitetit në Drejtorinë Ekonomike dhe Planifikimin Financiar qe motorin dhe rakordon zbatimin e Akt Marrëveshje Nr. 1242/41, dt.. 16.11.2018.

E.U.(Z.) në cilësinë e Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar për përgjegjësinë për procesin e regjistrimit dhe rakordimit me thesarin për të ardhurat dytësore.

I.K.në cilësinë e ish Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar për përgjegjësinë për procesin e regjistrimit dhe rakordimit me thesarin për të ardhurat dytësore për periudhën 21.02.2022 deri më 11.11.2022.

Të ardhurat nga zëri “Shërbimet administrative” janë realizuar në shumën 1,372 mijë lekë në vitin 2022 kundrejt 1,191mijë lekë ose 180 mijë lekë më shumë se viti paraardhës. Aplikimi tarifave mbështetet në Urdhrin Nr. 196, datë 05.06.2018, protokolluar me Nr. 2932 prot, datë 05.06.2018 mbi aplikimin e tarifave me çmime të miratuara mbi disa shërbime të ofruara nga QSUNT si lëshimi kopjes e kartelës klinike për paciente 350 lekë/kopje; lëshim vërtetim page/punësimi 100 lekë/kopje, etj. Arkëtimi i shumave kryhet pranë arkave të vendosura pranë çdo PAI ku kërkohet shërbimi. Regjistrimi i kërkesës për arkëtim regjistrohet në mënyrë elektronike në sistemin SISP.

Të ardhurat nga “Shitja e mallrave e shërbimeve” paraqesin të ardhurat nga konsultat mjekësore të cilat rezultojnë në shumën 24,859 mijë lekë me një rritje prej më shumë se 4,777 mijë lekë nga viti 2021, ku këto të ardhura ishin realizuar në vlerën 20,082 mijë lekë.

QSUNT ka aplikuar tarifën e shërbimit të shëndetit shëndetësor publik miratuar me Urdhër të Ministrisë të Shëndetësisë Mbrotjtjes Sociale Nr.493, date 20.07.2019 “Për sistemin e referimit dhe tarifën e shërbimit shëndetësor publik”, protokolluar në QSUNT me Nr. 403, datë 22.02.2021, i ndryshuar më Urdhrin e MSHMS Nr. 310, datë 17.05.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhrin Nr. 493, datë 02.07.2019“Për sistemin e referimit dhe tarifën e shërbimit shëndetësor publik””.

Drejtorja e IT dhe Inxhinierisë Klinike me kërkesë Nr. 1544/1 prot, datë 01.06.2022, ka kërkuar nga ofruesi shërbimit “O.” shpk, (për dijeni MSHMS dhe AKSHI), ndryshimin e listës së shërbimeve me pagesë sipas listës së re.

Grupi auditimit verifikoi në sistemin SISP aplikimin e tarifave sipas Urdhrit të MSHMS Nr. 310/2022 sipas tarifave të përcaktuara për ekzaminime për: “Litotripsi”, “Tarifa hipertiroze me jod I-131”; “Shinografi tiroide”, tarifa për “tomografi aksiale e kompjuterizuar (CT) e regjioneve të tjera”, duke verifikuar arkëtimet dhe tarifën e ndryshuar, nga muajin Qershor 2022 e në vazhdim, duke gjeneruar mandat arkëtimet si më poshtë: për ekzaminim “Litotripsi”, me Mandat Arkëtimet Nr. 03532036, date 21.09.2022 pacienti ka paguar tarifë 1.500 lekë, tarife e pa ndryshuar në SISP sipas Urdhrit të MSHMS Nr. 310, date 17.05.2022. Për ekzaminim “Litotripsi”, me Mandat Arkëtimet Nr. 03538077, datë 26.09.2022 pacienti ka paguar tarifë 1.800 lekë, tarifë e ndryshuar dhe në përputhje me aneksin bashkëlidhur Urdhrit të MSHMS Nr. 310, date 17.05.2022. Për ekzaminim “Tarifa hipertiroze me jod I-131”; “Shinografi tiroide”, tarifa për “tomografi aksiale e kompjuterizuar (CT) e regjioneve të tjera”, pasqyrojnë tarifën e ndryshuar pas datës 26.09.2022 në Mandat Arkëtimet Nr. 03539579, datë 27.09.2022; Nr. 03543236, datë 29.09.2022; Nr. 03598783, datë 07.11.2022; Nr. 03582424, datë 26.10.2022; Nr. 03648694, datë

14.12.2022 në përputhje me aneksin bashkëlidhur Urdhrit të MSHMS Nr. 310, date 17.05.2022, datë e hedhjes në SISP të tarifave të ndryshuara.

Nga auditimi u konstatua se: deri në datë 26.09.2022 për ekzaminim “Litotripsi” në SISP është aplikuar tarifa 1.500 lekë tarifë e pa ndryshuar sipas Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë Mbrojtjes Sociale Nr.493, date 20.07.2019 “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik” dhe në datë 26.09.2022 është aplikuar tarifa 1.800 lekë, tarifë e miratuar në Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë Mbrojtjes Sociale Nr.493, date 20.07.2019 “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”.

Lidhur me datën e hedhjes se të dhënave në SISP, u kërkua sqarim në Drejtorinë Ekonomike, e cila e përcolli për kompetencë në Drejtorinë e IT dhe Inxhinierisë Klinike. Kjo e fundit me mail datë 04 Maj 2023, kërkon nga “O.” shpk, datën e ndryshimit të tarifave në SISP, sipas Urdhrit 310 datë 17.05.2022. Në përgjigjen tij z. A. M., administrator “O.” shpk, më datë 05 Maj 2023 me mail a.@gmail.com, midis parashtrimeve të tjera ka konfirmuar se: - “... Zhvillimet janë kryer fillimisht në server test dhe meqenëse QSUNT trajton një numër shumë të lartë rastesh vjetore, nga ana e specialistëve të O. shpk, u testuan të gjitha rastet e mundshme me një pool rastesh ambulatorëe e spitalore në sistemin test. ... Në përfundim janë kaluar zhvillimet në server prodhim (SISP dhe Pentaho) datë 25.09.2022, duke qenë në dispozicion ... për të gjithë përdoruesit në recepsione dhe pavijone”.

Mirëmbajtja e SISP, bazohet në Kontratën e Shërbimit lidhur me datë 09.10.2020 me objekt “Mirëmbajtje e sistemit të informacionit për shëndetin publik të QSUNT (SISP)” me palë: - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) në cilësinë “Porositësi” ose “Autoritetit Kontraktor”; O. shpk, me NIPT J...N në cilësinë e “Ofruesi Shërbimit” ose “Kontraktori” dhe Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT) në cilësinë e “Përfituesit të shërbimit”. Zbatimi i kontratës ka filluar datën e lidhjes se saj dhe ka vazhduar 24 (njëzetekatër) muaj. Kontrata e shërbimit ka përcaktuar: -“Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha shërbimet siç specifikohet tek oferta teknike” (nenin 8, pika 1). DST(bashkëlidhur kontratës), Aneksi 2, faqe 16-19, kanë përcaktuar se tarifat e shërbimit shëndetësor publik në QSUNT përdoren nëpërmjet sistemit SISP, nga recepsionistet, të cilët me anë të modulit të pranimit dhe modulit të referimit bëjnë hedhjen në sistem të të dhënave të pacientit. Pasi pranohet, për pacientin gjenerohet një faturë. Nëse pacienti ka zbatuar sistemin e referimit dhe është i siguar, vlera e kësaj faturë është zero. Nëse pacienti është i pa siguar, pavarësisht nëse e ka zbatuar sistemin e referimit apo jo) vlera e kësaj faturë është sipas tarifave të parashikuara nga MSHMS. Kjo faturë procesohet nga arkëtarët, të cilët kanë një menu të caktuar në modulën e pranimit, sipas të cilit sistemi proceson gjenerimin e Mandat-Arkëtimit, mbi të cilin behet pagesa e tarifës përkatëse.

“O.” shpk ka hedhur më vonesë në Sistemin e Informacionit të Shëndetit Publik (SISP), ndryshimet tarifore të shërbimeve ndaj pacienteve, miratuar me Urdhër të Ministrit të MSHMS Nr. 493, datë 02.07.2019 “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”, kërkuar nga QSUNT me shkresë Nr. 1544/1 prot, datë 01.06.2022. Sipas konfirmimit nga O. shpk, me mail datë 05.05.2023, në Sistemin e Informacionit të Shëndetit Publik (SISP), tarifat janë aplikuar pas datës 26 Shtator 2022, ose 4 muaj me vonesë, në kundërshtim me Kontratën e Shërbimit Nr. 5216, datë 09.10.2020 në nenin 8, pika 1, dispozitë e cila ka përcaktuar se Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha shërbimet siç specifikohet tek oferta teknike dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës neni 10 “Pranimi Shërbimeve”.

Mos hedhja në Sistemin e Informacionit të Shëndetit Publik (SISP) e tarifave të miratuara me Urdhër të Ministrit të MSHMS Nr. 310, datë 17.05.2022, ka ndikuar në mos faturim, mos arkëtim, të shërbimeve me pagesë që ofrohen nga QSUNT, në kundërshtim me piken 7 të Urdhrit

të MSHMS Nr. 310, date 17.05.2022., për shkak të mos faturim dhe mos arkëtim konform tarifave të reja, veprime në kundërshtim me nenin 10.2 germa “a” të Kontratës Nr. 5216, datë 09.10.2020 dhe Kushteve të Veçanta, pasi Përfituesi i shërbimit QSUNT nuk paraqiti njoftimin nga Kontraktuesit, mbi fillimin e testimin për aplikimin e tarifave të ndryshuara, kërkuar me shkresë Nr. 1544/1 prot, datë 01.06.2022; në kundërshtim me nenin 10.2 germa “f” të Kontratës Nr. 5216, datë 09.10.2020 dhe Kushteve të Veçanta, pasi Përfituesi i Shërbimit QSUNT nuk paraqiti njoftim me shkrim për Kontraktuesin mbi pranimin ose jo të dorëzimeve, kërkuar me shkresë Nr. 1544/1 prot, datë 01.06.2022.

Në zbatim të kontratës së furnizimit Nr. 5216, datë 09.10.2020, nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e sistemit të informacionit për shëndetin publik në QSUNT (SISP)”, verifikimi i urdhër-shpenzimeve të mësipërme, u konstatua se kontrata e furnizimi është realizuar:

Në vitin 2020 në shumën	8.060.004 lekë ose 8.33 % e vlerës së kontratës
Në vitin 2021 në shumën	48.360.024 lekë ose 50.00% e vlerës së kontratës
Në vitin 2022 në shumën	40.300.020 lekë ose 41.67 % e vlerës së kontratës
Paguar	96,720,048 (me tvsh)

Mos aplikimi në kohë tarifave të reja në SISP, sipas tarifave të miratuara Urdhër të MSHMS Nr. 310, date 17.05.2022, konsiderohet kryerje me vonesë në zbatim të mirëmbajtjes së Sistemit SISP nga O. shpk, me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e QSUNT, në kundërshtim me nenin 19.3 të Kontratës Nr. 5216, datë 09.10.2020 dhe Kushteve të Veçanta. Kontrata Nr. 5216, date 09.10.2020, në nenit 20 “*Likuidim i dëmeve për dorëzim të vonuar*”, germa c, për kontratat me periudhë zbatimi më shumë së 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% e vlerës së kontratës. Realizimi i kësaj kontrate paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Kontrata e shërbimit rezulton e realizuar në shumën 100% me pagesën e faturës Nr. 3446, datë 23.11.2022 është likuiduar faturimi i fundit për këtë kontratë shërbimi, në shumën 4.029.762 lekë. Për sa më sipër, në furnizimin e kryer nga O. SHPK në faturën tatimore Nr. 3446, datë 23.11.2022, QSUNT duhet të përlllogariste dhe mbante tarife ditore (dëm) për vonese në zbatim për kryerje me vonesë të shërbimit të kërkuar në Sistemit SISP në hedhjen e tarifave të reja të miratuara me Urdhrin e MSHMS Nr. 310, datë 17.05.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhrin Nr. 493, datë 02.07.2019“Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”, për 85 ditë (nga data 01.06.2022 deri në 25.09.2022) në vlerën 2,055,301 lekë (24,179,892 * 85 ditë pune * 1/1000), në zbatim të nenit 20, germa “c” të kontratës së furnizimit Nr. 5216, datë 09.10.2020.

Pagesa	Me Tvsh	Realizimi kontratës	Min penalitetit	Llogaritje Penaliteti
viti 2020	8,060,004	8.33%	25%	
viti 2021	48,360,024	50.00%	25%	
viti 2022	40,300,020	41.67%	25%	
	96,720,048	100%	25%	2,055,301

Komisioni i mbikëqyrjes dhe zbatimit të Kontratës Nr. 5216, datë 09.10.2020, i ngritur me AKSH-i për të verifikuar shërbimet e mirëmbajtjes dhe pranimin e realizimit të mirëmbajtjes nga “O.” shpk, me përbërje z. F.Dh. dhe z. S.H. për “Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacioni” dhe znj. B.M. Drejtor i IT dhe Inxhinierisë Klinike, zëvendësuar me Urdhër të titullarit nga z. E.K. Specialist/ Inxhinier Biomedikal i Sektorit të Inxhinierisë Klinike për QSUNT. Përgjegjësinë për këtë e mbajnë anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim të përbërë nga:

z. F.Dh. dhe z. S.H. për “Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacioni”, znj. B.M. ish Drejtor i IT dhe Inxhinierisë Klinike, për periudhën nga 01.04.2021 deri 07.09.2022.

Të ardhurat nga zëri “Shërbimi ambulatorë” janë realizuar në shumën 1,424 mijë lekë, kundrejt me 1,549 mijë lekë në vitin 2021 ose me pak të ardhura në shumën 125 mijë lekë, i cili përmban të ardhura nga shërbimi specializuar me sistem referimi për shërbim laboratorik, imazherik, të nevojshme për kryerjen e konsultës së specializuar në QSUNT. Kjo e ardhur vjen në ulje për shkak të përdorimit nga pacientët të sistemit të referimit.

QSUNT aplikon tarifa shërbimit për veprime administrative si lëshim kartele klinike, vërtetim page dhe punësim, vërtetim realizim kontrate dhe lëshime DVD për ekzaminime të kryera nga paciente, të miratuara nga MSHMS me shkresë Nr. 1627/1, datë 19.04.2018 protokolluar në institucion me Nr. 2932, datë 05.06.2018, Miratuar më Urdhër të titullarit të QSUNT Nr. 196, datë 06.06.2018 “Për aplikim e tarifave mbi disa shërbime të ofruara nga QSUNT”.

Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime, arkëtimi në shumën 414 mijë lekë, derdhur 100ë në buxhet, arkëtime me arke në shumën 58 mije lekë për detyrime të prapambetura me “P.C.” dhe 356 mije lekë arkëtime nga detyrime të prapambetura për paga etj. Të ardhura nga sponsorizime në shumën 1,672 mijë lekë janë kontribute financiar për studime klinike nga “Marrëveshja për studim klinik me Comac Medical”. Të ardhurat dytësore janë rakorduar me degën e thesarit sipas evidencës përkatëse mujore dhe progresive. Përdorimi i të ardhurave dytësore 2022. Në zbatim të VKM Nr.43 date 19.01.2022 "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2022 dhe të VKM 432 date 28.06.2006 "Për krijimin dhe administrimit të ardhurave qe krijojnë institucionet buxhetore", QSUNT ka kërkuar dhe MSHMS ka miratuar përdorimin e fondeve të të ardhurave dytësore me shkresat si më poshtë vijon:

Me shkresën Nr. 15/13 prot, datë 18.02.2022, sipas kërkesës së QSUNT me Nr. 564 prot, datë 03.02.2022 me destinacion paga (llog. 600) personeli për 1 (nje) punonjës, pozicioni punës “Mjek në shërbimin e onkohematologjisë pediatrike” deri në 03.04.2022 (kontratë e vitit 2021) deri në 685.346 lekë dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore (llog 601) për këtë pozicion pune deri në 114.452 lekë.

Me shkresën Nr. 15/36 prot, datë 28.03.2022, sipas kërkesës së QSUNT me Nr. 146/4 prot dhe 396/15 prot, datë 18.03.2022 me destinacion paga (llog. 231) për “Kolaudim për rikonstruksionin e godinës së arkivës së kartelave mjekësore” deri në 19.000 lekë me tvsh. Me shkresën Nr. 15/42 prot, datë 04.04.2022, sipas kërkesës së QSUNT me Nr. 396/15 prot, datë 18.03.2022 me destinacion paga (llog. 231) për “Kolaudim për punimet për rikonstruksionin e pediatriisë infektive” deri në 50.618 lekë me tvsh.

Me shkresën Nr. 15/67 prot, datë 03.06.2022, sipas kërkesës së QSUNT me Nr. 64/59 prot, date 01.06.2022; Nr. 64/62 prot, datë 01.06.2022; Nr. 64/61 prot, datë 01.06.2022; Nr. 64/60 prot, datë 01.06.2022 me destinacion paga (llog. 231) për “Sistemin e monitorimit fiziologjik të i-telemetries së pacientit” deri në 9.336.000 lekë me tvsh; për “Pajisje për infuzion” deri në 606.000 lekë me tvsh; për “Pajisje për intubim” deri në 150.000 lekë me tvsh; për “Eko kardiography” deri në 45.348.000 lekë me tvsh.

Me shkresën Nr. 15/68 prot, datë 08.06.2022 sipas kërkesës së QSUNT me shkresën Nr. 64/68 prot, datë 03.06.2022; Nr. 64/67 prot datë 03.06.2022 (llog 231), për “Pajisje të provës kardiake” deri në 5.316.000 lekë me tvsh; për “Pajisje mjekësore të spitalit të ri” deri në 3.651.120 lekë me tvsh.

Me shkresën Nr. 15/72 prot, datë 14.06.2022 (llog 231), sipas kërkesës së QSUNT me Nr. 625/29 prot, datë 10.06.2022 për “Loti 1- furnizim vendosje x-ray tube për skaner CT Brightspeed 16 prodhues GE ose ekuivalent” deri në 8.216.000 lekë me tvsh; për “Loti 2- furnizim

vendosje modul dedektori për pajisjen skaner CT Lightspeed 64 slice prodhues GE ose ekuivalent” deri në 5.636.000 lekë me tvsh. Me shkresën Nr. 15/136 prot, datë 29.09.2022 (llog 231), sipas kërkesës së QSUNT me Nr. 47/57 prot, datë 29.09.2022 për “Loti 19- radiologji portative ” deri në 2.619.560 lekë me tvsh.

Me shkresën Nr. 15/181 prot, datë 15.11.2022 (llog 231), sipas kërkesës së QSUNT me Nr. 280/28 prot, për “Kolaudim punimesh për rikonstruksionin e spitalit të ri në QSUNT ” deri në 462.296 lekë me tvsh.

Përdorimi i të ardhurave dytësore 2022 (mijë lekë)

Nr	Spitalet	Mbetur pa përdorur 31.12.2021	Realizuar 2022	Përdorur 2022			Përdorur gjithsej	Mbetur pa përdorur gjithsej
				Llog. 600	Llog. 602	Llog. 231		
1	Q.S.U. Nene Tereza	46,794	132,365	705		81,356	82,062	97,098
2	Sponsorizim Toksikologji	1,814					0	1,814
3	Sponsorizim Pediatri 2	2,838					0	2,838
4	Sponsorizim Pediatri 3	1,203					0	1,203
TOTALI		52,650	132,365	705	0	81,356	82,062	102,953

(Burimi: QSUNT)

Shpenzimet e QSUNT, financuar nga të ardhurat dytësore për vitin 2022 pas miratimit nga MSHMS dhe nivelin e realizimit deri në fund të vitit, paraqitet në shumën 82,062 mijë lekë, nga të cilat për paga në shumen 705 mije lekë dhe për shpenzime kapitale në shumën 82,062 mije lekë, si me poshtë vijon: nga përdorimi të ardhurave dytësore janë likuiduar faturat e furnitorëve sipas kontratave përkatëse si në tabelën si më poshtë vijon:

MIRATIM MSHMS	DATE MIRATIMI MSHMS	KONTRATE	DATE	KOD PROJEKTI	PROJEKTI	FURNITORI	PAGESAT E KRYERA
15/36	dt. 28.03.2022	146/18	21.04.2022	91304AD	Kolaudim për rikonstruksionin e godinës	N.G.shpk	16
15/42	dt. 04.04.2022	396/26	28.04.2022	19AH803	Kolaudim për rikonstruksionin e pediatriisë Infektive	V.I.shpk	37
15/72	dt. 14.06.2022	1655/10	27.07.2022	19AH807	Furnizim vendosje x-ray tube paisje mjekësore skaner CT	M.	8,216
15/72	dt. 14.06.2022	1655/11	27.07.2022	19AH807	Furnizim vendosje x-ray tube paisje mjekësore skaner CT	M.	5,636
15/67	dt. 03.06.2022	64/48	15.06.2022	19AH805	Furnizim me aparatura mjekësore loti 5	O. E ...	606
15/68	dt. 08.06.2022	64/87	16.06.2022	19AH805	Furnizim me aparatura mjekësore loti 2	O. E ...	3,651
15/67	dt. 03.06.2022	64/90	17.06.2022	19AH805	Furnizim me aparatura mjekësore loti 3	S.M.	150
15/67	dt. 03.06.2022	64/102	22.06.2022	19AH805	Furnizim me aparatura mjekësore loti 1	M.	45,348
47/59	dt. 29.09.2022	47/60	29.09.2022	19AH805	F.V aparatura mjekësore godinën e re pediatri	A.	2,620
15/67	dt. 03.06.2022	64/91	17.06.2022	19AH805	F.V aparatura mjekësore, mobilim për spitalin e ri	B.A.	9,336
15/68	dt. 08.06.2022	64/116	15.07.2022	19AH805	F.V aparatura mjekësore për spitalin e ri	M.	5,316
15/181	dt. 15.11.2022	280/37	25.11.2022	19AH803	Kolaudim i punimeve për rikonstruksion e spitalit ifektiv	F.A.	424
Totali							81,356

(Burimi: QSUNT)

Titulli i Gjetjes Nr.1	Projekt Buxheti për shpenzimet operative dhe realizimi tij
Situata:	Bordi Drejtues i QSUNT për periudhën objekt auditimi nuk ka miratuar projektbuxhetin apo raportin vjetor të veprimtarisë financiare të QSUNT, në kundërshtim me përcaktimet e VKM Nr. 66, datë 3.2.2017 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”, pika 10 germa “a” dhe “c”; me Statutin e QSUNT, Kreu III, pika 10 e tij. në kundërshtim me Statusin Nr. 709, datë 10.10.2018 miratuar me Urdhrin e Përbashkët të

MSHMS dhe MARS “Për miratimin e Statusit të QSUNT”, pika 10, germa “a”, si dhe Urdhrin e Ministrit të MSHMS Nr. 369, datë 24.08.2021 “Për ngritjen e bordit drejtues të spitalit universitar QSU “Nënë Tereza”” pika 3 germa “a”. Drejtori i përgjithshëm nuk ka propozuar dhe dërguar për miratim në Bordin Drejtues të QSUT projekt buxhetin për PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024 dhe Raportin Vjetor për vlerësimin e veprimtarisë financiare, në kundërshtim me Urdhrin e Përbashkët të MSHMS dhe MARS Nr. 709, datë 10.10.2018 “Për miratimin e Statusit të QSUNT”, pika 10, germa “ç”, dhe neni 15 germa “d”, si dhe Urdhrin e Ministrit të MSHMS Nr. 369, datë 24.08.2021 “Për ngritjen e bordit drejtues të spitalit universitar QSU “Nënë Tereza”” pika 3 germa “a”. Shpenzimet operative në PBA 2021-2023 parashikohen 16,140,429 mijë lekë. Buxheti alokuar me disa rishikime të përgjatë vitit buxhetor, paraqitet në shumën prej 8,728,088 mijë lekë ose 7,402,341 mijë lekë ose 45.86% më pak se kërkesat në PBA. Ndryshimi me i madh paraqitet në zërin e shërbimeve për 7,402,341 mijë lekë ose 58.11% më pak se parashikimi buxhetor. Struktura e ndarjes të zërave të shpenzimeve operative nuk është e njëjtë me strukturën e paraqitur në kërkesat buxhetore në fazën e PBA. Në totalin e buxhetit të QSUNT për vitin 2021 në shumën 8,815,600 mijë lekë, siç mund të konstatohet se pjesën më të madhe e zënë shpenzimet në llogarinë “Mallra dhe shërbime të tjera” me rreth 60.35%, pas tij llogaria “Paga” me rreth 34.13%, dhe “Sigurime shoqërore” me rreth 4.64%. “Shpenzimet kapitale” zënë një peshë mjaft të vogël në vetëm 0.88% të buxhetit të planifikuar. Në PBA 2022-2024, për vitin 2022 janë planifikuar 19,503,842 mijë lekë dhe deri në fund të vitit 2022 pas rishikimeve të buxhetit janë alokuar 9,346,328 mijë lekë ose 10,157,514 mijë lekë më pak se plani në PBA ose 47.92% më pak se kërkesat e institucionit të parashikuara në PBA. Ndryshimi me i madh paraqitet në zërin e shërbimeve prej 8,856,643 mijë lekë ose 40.18% më pak se parashikimi buxhetor. Diferenca vjen kryesisht në zërin “barna dhe materiale mjekësore” për shkak të fondeve më të ulëta të vendosura në dispozicion për QSUNT krahasuar kjo me kërkesat në PBA. Duke marrë në analizë peshën e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike në planin e shpenzimeve buxhetore mbi totalin e buxhetit të QSUNT për vitin 2022 në shumën 9,346,328 mijë lekë, mund të konstatohet në tabelën më lart pjesën më të madhe e zënë shpenzimet në llogarinë “Mallra dhe shërbime të tjera” me rreth 63.64%, pas tij llogaria “Paga” me rreth 29.05%, dhe “Sigurime shoqërore” me rreth 4.51%. “Shpenzimet kapitale” zënë një peshë mjaft të vogël në vetëm 2.69% të buxhetit të planifikuar. Për shpenzimet kapitale për investime, në PBA 2022-2024 është parashikuar një buxhet prej 599,104 mijë lekë dhe deri në fund të vitit 2022 nga MSHMS nga buxheti i rishikuar janë alokuar fonde në vlerën 250,836 mijë lekë ose 348,268 mijë lekë ose 41.87% më pak parashikimi në PBA. Shpenzimet operative për vitin 2021 u realizuan në masën 8,734,524 mijë lekë 99.98% dhe për vitin 2022 u realizuan në masën 9,077,894 mijë lekë ose në masën 99.84% ose brenda planit të rishikuar. Pavarësisht detajimit të planit të shpenzimeve të kryera nga

	<p>institucioni, u konstatua se në muajin dhjetor 2022 ka tejkalim të buxhetit të planifikuar të zërit “Barna, materiale mjekësore dhe laboratorët” i cili nga 456,409 mijë lekë të planifikuara, u rishpërnda dhe u realizua në shumën 947,355 mijë lekë ose 490,946 mijë lekë më shumë se detajimin mujor buxhetor në këtë llogari.</p> <p>Sa më sipër ndryshime buxhetit përgjatë vitit buxhetor dhe realizimi tij në vitin 2021 në masën 99.84 % dhe në vitin 2022 në masën 99.81%, nuk janë tregues të një planifikimi dhe financimi të mirë dhe të plotë të nevojave të mbulimit të shërbimeve shëndetësore spitalore nga fondet e buxhetit.</p>
Kriteri:	<p>VKM Nr. 66, datë 3.2.2017 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”;</p> <p>VKM Nr. 308, datë 21.05.2014, “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH në shërbimin spitalor”, i ndryshuar, pika 4;</p> <p>Statuti QSUNT miratuar me Urdhër i Përbashkët midis MSHMS dhe MARS Nr. 709, datë 10.10.2018 “Për miratimin e Statusit të QSUNT” pika 10, germa “a”;</p> <p>Urdhërin e Ministrit të MSHMS Nr. 369, datë 24.08.2021 “Për ngritjen e bordit drejtues të spitalit universitar QSU “Nënë Tereza”” pika 3 germa “a”;</p> <p>Rregullore Bazë QSUNT, pika 3.1 dhe 3.5;</p> <p>Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”,</p> <p>VKM Nr. 20, datë 20.01.2021 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021”;</p> <p>VKM Nr. 43, datë 19.01.2022 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2022”.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Ndryshimet e disa hershme të fondeve buxhetore përgjatë vitit ushtrimor dhe realizimi buxhetit në masën 99.84 % në vitin 2021 dhe 99.81% në vitin 2022, nuk janë tregues i mirëfilltë i një planifikimi dhe financimi të mirë dhe të plotë të nevojave të mbulimit të shërbimeve shëndetësore spitalore nga fondet e buxhetit.</p> <p>Diferencat e konsiderueshme mes kërkesave në PBA dhe fondeve të akorduara, si dhe ndryshimet e disa hershme gjatë vitit buxhetor nuk mundësojnë krahasimin e planifikimit të kërkesës së institucionit për fonde buxhetore dhe optimizimit të përmbushjes së nevojave sipas kërkesës së paraqitur.</p>
Shkaku:	<p>Mos përfshirja Bordit Drejtues i QSUNT në miratim projektbuxhetin raportit vjetor të veprimtarisë financiare të institucionit.</p> <p>Mos harmonizimi i kërkesave të shefave të shërbimeve të QSUNT për fondet e nevojshme për barna dhe materiale mjekësore, me alokimin real</p>

	<p>të FSDKSSH.</p> <p>Mungesa e një mënyrë apo model të njësuar për tu përdorur nga shefat e shërbimeve për parashikimin e fondeve buxhetore për vitin pasardhës në Rregulloren e Shërbimit Farmaceutik Nr. 2163/1, datë 17.06.2015.</p> <p>Formatet e hartimit të PBA përcjellë nga MSHMS, nuk janë të njëjta me ato sipas së cilave kryhet detajimi i financimit të paketave nga FSDKSSH.</p>
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	<ul style="list-style-type: none"> - Bordi Drejtues i QSUNT-së të programojë kalendarin e aktiviteteve në lidhje me miratimin e buxhetit dhe të raportit vjetor e pasqyrave financiare të llogaridhënies vjetore në përputhje me misionin dhe vizionin e QSUNT-së. - Drejtori i Përgjithshëm të marr masa për të dërguar për miratim në Bordin Drejtues të QSUNT-së projektbuxhetin e vitit pasardhës dhe vlerësimin e raportit vjetor të veprimtarisë financiare të institucionit.

Titulli i Gjetjes Nr. 2	Fondet buxhetore për shpenzime kapitale dhe rishikimet nga MSHMS
Situata:	<p>PBA 2021-2023 për shpenzimet kapitale për investime ka parashikuar një buxhet prej 608,213 mijë lekë, dhe deri në fund të vitit 2021 nga MSHMS sipas buxhetit të rishikuar janë alokuar fonde në vlerën 77,512 mijë lekë ose 530,701 mijë lekë më pak parashikimi në PBA. Investimet me fonde buxhetore për vitin 2021 u realizuan në shumën 73,764 mijë lekë ose realizuar në masën 95.16 % krahasuar me fondeve të çelura dhe ndryshuar gjatë vitit. Referuar ndryshimeve të fondeve gjatë vitit buxhetor 2021 rezulton se plani investimeve ka pësuar ndryshime me pakësimin të fondeve buxhetore deri në anulim të plotë të financimit të projekteve të miratuara si për investimin me kod projekti 18BB103, me kod 18BB137 për të cilin fillimisht alokohen 130,000 mijë lekë dhe në fund viti alokimi rezulton në shumën 37,983 mije për realizimin e investimit.</p> <p>Për shpenzimet kapitale për investime, në PBA 2022-2024 është parashikuar një buxhet prej 599,104 mijë lekë dhe deri në fund të vitit 2022 nga MSHMS sipas buxhetit të rishikuar fondet janë alokuar në vlerën 250,836 mijë lekë ose 348,268 mijë lekë ose 41.87% më pak parashikimi në PBA. Investimet me fonde buxhetore për në vitin 2022 u realizuan në shumën 250,836 mijë lekë ose realizuar 100% të fondeve të çelura. Referuar ndryshimeve të fondeve gjatë vitit buxhetor rezulton se plani i investimeve ka pësuar ndryshime të konsiderueshme nga MSHMS, të cilat nuk përputhen me kërkesën buxhetore të QSUNT në PBA 2022-2024. MSHMS ka financuar projekte të reja për investime në QSUNT të cilat duhet të ishin parashikuar në kohën e hartimit dhe miratimit të PBA 2022-2024, si projekte të vlerësuara domosdoshme për tu financuar përgjatë vitit buxhetor. Kjo dukuri u konstatua në realizimin e projektit të investimit me kod projekti 18BB103 i cili çelja e fondit 210,809 mijë lekë miratuar me shkresë Nr. 567/4,dt. 03.03.2022, u pakësua nga MSHMS me</p>

	<p>shkresa përkatëse duke u mbyllur me një fond investimi kapital prej 149,719 mijë lekë, thënë ndryshe për më pak për shumën 61,090 mijë lekë ose 28.98% se fondet e çelura në fillim të vitit 2022. Investimi me kod 18BB310, fondet e çelura për shumën 27,977 mijë lekë, deri në fund të vitit buxhetor bëhen zero, pra investimi nuk është kryer sipas planifikimit buxhetor etj.</p> <p>Sa më sipër fondet buxhetore për investime të akordura nga MSHMS, nuk përputhen plotësisht me kërkesën buxhetore të QSUNT në PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024. Financimet për projektet e miratuara përgjatë vitit buxhetor nga MSHMS pësojnë ndryshime me shtesa dhe pakësimeve deri në anulim të kryerjes së shpenzime kapitale.</p> <p><i>(Të dhënat analitike referuar në tabelat “Ndryshimet e fonde buxhetore për shpenzimet kapitale” për vitin 2021 dhe vitin 2022”)</i></p>
Kriteri:	Udhëzimi Nr.9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” VKM Nr. 66, datë 3.2.2017 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”, Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
Ndikimi/Efekti:	Ndryshimet në financimin e fondeve të investimeve, nuk paraqesin planifikimin efektiv të buxhetit të institucionit me ndikim negativ në treguesit e performancës së buxhetit.
Shkaku:	Mungesa e optimizimit bashkëpunimit ndër institucional mes QSUNT dhe MSHMS në planifikimin e investimeve me përfitues QSUN në fazën e hartimit të PBA. Rishikimet e shpeshta të fondeve që konsistojnë në shtime/pakësime për financimin e investimeve.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Në fazën e hartimit e miratimit final të projekt buxhetit, QSUNT të rrisë bashkëpunimin me MSHMS për listën e projekteve të investimeve për çdo program, duke dokumentuar në këtë fazë dhe në çdo rast procedurat e ndjekura për projektet me përfitues QSUNT, me qëllim shmangien e rishikimeve të fondeve buxhetore me impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit.

Titulli i Gjetjes Nr.3	Planifikimi i buxhetit për të përballuar shpenzimet për barna dhe materiale mjekësore 2021-2023
Situata:	Për periudhën objekt auditimi, planifikimit buxhetor për barna dhe materiale mjekimi, në PBA 2021-2023 parashikon në total 10,358,892 mijë lekë nga të cilat për barna parashikimi është 6,169,955 mijë lekë dhe për pajisje mjekësore 4,188,937 mije lekë. QSUNT sipas objektivave të MSHMS në PBA 2022-2024 ka parashikuar shtim të konsumit për barna dhe materiale mjekësore, duke parashikuar që fondi për barna dhe materiale mjekësor duke parashikuar që fondi për barna dhe materiale mjekësor për vitin 2022 të parashikohet në vlerën 10,637,812 mijë lekë, Për periudhën objekt auditimi, planifikimit buxhetor për barna dhe materiale mjekimi, për mbulimin e nevojave të QSUNT për fonde

	buxhetore, zhvillohet një procedurë e pa detajuar dhe e pa mirë analizuar nga shefat e shërbimeve. Hartimit dhe parashikimi i projekt buxhetit nga shefat e shërbimeve bazohet kryesisht në kërkesat e periudhave të mëparshme, dhe jo në kërkesat reale të fondeve për barna të tilla si konsum historik i llojit të barnave, nevojat për bana sipas mjekimit, numrit të sëmurëve në periudhat e mëparshme, sasia e barnave të akorduara sipas pacientëve, trendi të rritjes së sëmundshmërisë etj. Rregullorja e Shërbimit Farmaceutik Nr. 2163/1, datë 17.06.2015 nuk përcakton një mënyrë apo model të njësuar për tu përdorur nga shefat e shërbimeve për parashikimin e fondeve buxhetore për vitin pasardhës.
Kriteri:	Ligji Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Ligjet respektive për buxhetin e vitit 2021 dhe vitit 2022, Rregullorja e Brendshme e QSUNT, Rregullorja e Shërbimit Farmaceutik Nr. 2163/1, datë 17.06.2015.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e një mënyre apo modeli të njësuar për tu përdorur nga shefat e shërbimeve për parashikimin e fondeve buxhetore për vitin pasardhës, sjell në një parashikim jo real për me nevojat për barna spitalore.
Shkaku:	Parregullsi në hartimin e kërkesave për barna/materiale mjekësore nga shërbimet përkatëse në QSUNT; Mungesa e kuadrit rregullator për parashikimin projekt buxhetit për vitet pasardhëse.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Për parashikimin e fondeve buxhetore për vitin pasardhës, të përmirësohet Rregullorja e Shërbimit Farmaceutik Nr. 2163/1 datë 17.06.2015, duke përcaktuar procedura standarde lidhur me metodologjinë që duhet përdorur për parashikimin e shpenzimeve buxhetore për barna dhe materiale mjekësorë, për tu përdorur nga Farmacia Qëndrore dhe shefat e shërbimeve spitalore në QSUNT, bazuar në analizën e risqeve dhe masave për përballimin e tyre, sipas objektivave të MSHMS dhe QSUNT.

Titulli i Gjetjes Nr. 4	Mangësi në monitorimin dhe raportimin e buxhetit të QSUNT
Situata:	Në procedurat e monitorimit të buxhetit të QSUNT për vitin 2021-2022 ka mangësi në procedurat e monitorimit dhe raportimit të buxhetit sipas kërkesave të Ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenit 4, pika 23/1 Monitorimet dhe raportimet për realizimin e buxhetit mbështeten vetëm në rakordimet mujore me degën e thesarit, monitorim ky që kryhet vlerë dhe jo në produkt, duke pasqyruar realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre. Rakordimet nuk mundësojnë kryerjen e monitorimit të performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, për shkak të mos krahasimit të treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. Nuk bëhet i mundur evidentimi nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin, në mënyrë që të kryhen propozime, rekomandime për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese nëpërmjet

	<p>alokimit të burimeve. Nuk kryhet analiza krahasimore e realizimit të fondeve me periudhat e mëparshme. nuk sigurohet informacion për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit.</p> <p>Të dhënat lidhur me performancën financiare nuk rezultojnë të publikuara në faqen zyrtare të QSUNT, për pasojë nuk garantohej transparenca institucionale. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Statutin e QSUNT dhe Rregulloren bazë të QSUNT, dhe nenin 23/1 të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.</p>
Kriteri:	Ligji Nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjet respektive për buxhetin e vitit 2021 dhe 2022; Udhëzimi i Përhershëm Nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	<p>Si rezultat i mungesës së raporteve të monitorimit të buxhetit nuk bëhet e mundur ndjekja e arritjes së qëllimit dhe objektivave të synuar, sipas deklaratës së politikës së programit, për shkak të mos krahasimit të treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik; nuk bëhet e mundur evidentimi nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin, në mënyrë që të kryhen propozime/rekomandime për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese nëpërmjet alokimit të burimeve; nuk kryhet analiza krahasimore e realizimit të fondeve me periudhat e mëparshme.; nuk sigurohet informacion për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit; nuk garantohej transparenca institucionale, pasi të dhënat lidhur me performancën financiare nuk rezultojnë të publikuara në faqen zyrtare të QSUNT.</p> <p>Sa më sipër mungesa e raportit/ve të monitorimit 4-8-12 mujore, nuk evidenton nivelin e realizimit të fondeve buxhetore të QSUNT në krahasim me planin e miratuar, të detajuar në nivel treguesi performance.</p>
Shkaku:	Mungesa e përcaktimit në rregulloren e QSUNT të procedurave për monitorimin e buxhetit.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandime:	Organet Drejtuese të QSUNT të marrin masa për përgatitjen e raporteve të monitorimit 4 mujor dhe vjetor të zbatimit të buxhetit, i cili do të mundësojë institucionit orientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësimin e procesit të planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit, mbështetur mbi ato tregues të planifikuar gjatë hartimit të programit buxhetor afatmesëm.

Titulli i Gjetjes Nr. 5	Parashikimi dhe raportimin e shpenzimeve sipas kodeve të projekteve
Situata:	Nga auditimi u konstatua se QSUNT në parashikimin e fondeve buxhetore sipas PBA 2021-2023 drejtuar FSDKSH me shkresë Nr. 2129/76 prot, datë 08.07.2020 dhe PBA 2022-2024 drejtuar FSDKSH me Nr. 1955/1 prot, datë 15.07.2021, QSUNT nuk ka parashikuar shpenzimet buxhetore sipas paketave të shërbimeve shëndetësore të miratuara. Kjo bie ndesh me

	<p>kërkesat e VKM Nr. 308, datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH në shërbimin spitalor”, i ndryshuar, pika 4, sipas të cilës fondi financon paketat e shërbimeve shëndetësore, bazuar në koston e shërbimeve sipas shtojcave përkatëse. Gjithashtu, nuk përputhet edhe me kërkesën e FSDKSH në shkresën Nr. 460, datë 01.07.2020 “Për hartimin e treguesve të PBA 2021-2023”, protokolluar në QSUNT me Nr. 2129/74 prot, datë 08.07.2020, në të cilën për parashikimin e shpenzimeve për shërbimin shëndetësor në spital, duhet të plotësohen pasqyrat shtesë në të cilat kërkohet parashikimi i koston sipas paketave të shërbimeve të miratuara me VKM Nr. 308/2014, të ndryshuar.</p> <p>QSUNT rakordon me Degën e Thesarit për shpenzimet faktike të ndara në nivel produkti me kod thesari. Çeljet e buxhetit dhe shpenzimet faktike në thesar rezulton të jetë kryer i detajuar sipas kodeve të thesarit, sikundër paraqitet në akt rakordimet mujore. QSUNT nuk ka patur mundësinë objektive për të parashikuar shpenzimet buxhetore sipas paketave të shërbimeve shëndetësore të miratuara, sipas kërkesave të VKM Nr. 308, datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH në shërbimin spitalor”, i ndryshuar, pika 4, sipas të cilës fondi financon paketat e shërbimeve shëndetësore, bazuar në koston e shërbimeve sipas shtojcave përkatëse. Po kështu QSUNT nuk ka mundësi objektive të kostojë paketat e shërbimeve shëndetësore dhe të ndajë koston e shërbimeve sipas shërbimeve spitalore. Raportimi në degën e thesarit kryhet në kufirin e planit të çelur fillimisht për çdo paketë, sikundër paraqitet edhe në tabelat e hartuar nga grupi i auditimit.</p>
Kriteri:	<p>Ligjit Nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjet respektive për buxhetin e vitit 2019,2020,2021.</p> <p>Udhëzimi i Përhershëm Nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.</p> <p>VKM Nr. 308, datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH në shërbimin spitalor”, i ndryshuar, pika 4.</p>
Ndikimi/Efekti:	Nuk mundësohet pasqyrimi i saktë i shpenzimeve të destinuara sipas objektivave të projektit/produktit; Niveli i realizimit nuk paraqet situatën reale por ky realizim raportohet në kufirin e planit.
Shkaku:	QSUNT ka mungesa objektive si në programe informatike dhe në burime njerëzore, për kryerjen e llogaritjeve të sakta për të përfshirë gjithë shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me një paketë shëndetësore
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	QSUNT në bashkëpunim me FSDKSH dhe MSHMS, të marrin masa për përcaktimin e modaliteteve të parashikimit të shpenzimeve buxhetore, jo vetëm me zëra shpenzimesh sipas llogarive kontabël, por dhe buxhetim në kode të projekteve (paketave shëndetësore) të konform VKM Nr. 308, datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH në shërbimin spitalor”, i ndryshuar.

Titulli i Gjetjes Nr. 6	Parashikimi dhe realizimi për të ardhurat dytësore
Situata:	<p>Për vitin 2021, sipas PBA 2021-2023, janë parashikuar të ardhurat dytësore në vlerën 46,476 mijë lekë ose 11,433 mijë lekë më shumë se fakti vitit pasardhës, në të cilin të ardhurat faktike paraqiten në vlerën 35,043 mijë lekë. Realizimi i të ardhurave për vitin 2021 është në shumën 40,416 mijë lekë ose realizuar në masën 86.96% krahasuar me parashikim në PBA 2021-2023, në të cilin janë planifikuar 46,476 mijë lekë. Në total mosrealizimi të ardhurave kundrejt parashikimit rezulton në shumën 6,060 mijë lekë. Përdorimi i të ardhurave dytësore për vitin 2021, pas miratimit nga MSHMS deri në fund të vitit, paraqitet në total në shumën 9,063 mijë lekë me destinacion për investime në shumën 5,682 mijë lekë, për paga në shumën 2,480 mijë lekë dhe për shpenzime operative në shumën 900 mijë lekë. Për vitin 2022, të ardhurat dytësore janë planifikuar në vlerën 26,120 mijë lekë dhe janë realizuar 141,480 mijë lekë ose 96,725 mijë lekë më shumë se planifikimi sipas PBA 2022-2024 ose 115,360 mijë lekë më shumë se fakti vitit pasardhës, në të cilin të ardhurat faktike paraqiten në vlerën 44,755 mijë lekë.</p> <p>Nga auditimi u konstatua se VKM 688/2018 në nenin 4 germa “a” dhe “b”, përcakton modalitetin e ndarjes se të ardhurave të gjeneruara, sipas të cilës nga pjesa takuese (45%) QSUNT, nga e cila 3% do të kalojë në llogarinë e QSUNT me destinacion edukimin e vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe 42% do të investohet nga F., me kërkesë të QSUNT dhe pas miratimit paraprak të MSHMS. Pas ndryshimeve të VKM 688/2018 me VKM Nr. 135, datë 02.03.2022 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga MSHMS të FZHZH të objektit me emërtim “Oborr i QSUNT” Tiranë”, nenit 4 germa “a”, modaliteti përfitimit të të ardhurave dytësore për QSUNT ndryshohet dhe shtohet pikës 4/1, që përcakton kalimin 80% të ardhurave e krijuara të papërdorura në buxhetin e QSUNT-së, që nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit. QSUNT nga shërbimi parkimit për vitin 2022, bazuar në akt rakordime të firmosura nga përfaqësuesit e institucioneve, ka lëshuar fatura për arkëtim, në total të ardhura në shumën 98,906,391 lekë.</p> <p>QSUNT me shkresën Nr. 998/3 prot, datë 20.04.2022 ka dërguar Akt Rakordim për periudhën 15.11.2018 deri 01.03.2022 si dhe faturën për arkëtim Nr. 32/22, datë 22.04.2022 për arkëtimin në llogarinë e saj të së ardhurës dytësore të papërdorur në shumën 76,497,614 lekë. Akt Rakordimi mbështet në Akt Marrëveshjen e nënshkruar midis QSUNT dhe F., me Nr. 1242/41, datë 16.11.2018, ndryshuar me Amendamentin Nr. 1, protokolluar me Nr. 884/2, datë 12.04.2022, në zbatim të VKM Nr. 135/2022 “Për disa shtesa në vendimin Nr. 688, datë 14.11.2018 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga MSHMS të F., të objektit me emërtim “Oborr i QSUNT” pika 4/1 ku citohet se: “Të ardhurat e krijuara nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit dhe të papërdorura kalojnë 80% si të ardhura dytësorë buxhetin e QSUNT....”.</p> <p>Fatura për arkëtim mbështet në Akt Rakordim për periudhën <u>15.11.2018</u> deri <u>01.03.2022</u>, dërguar nga A. shpk, me shkresën Nr. 65/1 prot, datë</p>

	<p>14.04.2022, së bashku me dokumentacion shoqërues mbi të ardhurat dhe investimet e kryera nga QSUNT (42%), në të cilin sipas përlogaritjeve të A. deri 01.03.2022 rezulton se:</p> <p>Pjesa takuese të ardhurave të papërdorura nga QSUNT (42%) rezulton në shumën 112,496,492 lekë; Sipas VKM 135/2022, pika 4/1 duhet të kalojnë drejt QSUNT (80% e vlerës së mbetur të papërdorur) shuma 89,997,194 lekë (112,496,492 *80%), Vlera e mbetur pakësohet me 15% tatim fitimi, në shumën 13,499,579 lekë. Vlera e rakorduar për tu kaluar për llogari të QSUNT mbetet 76,497,615 lekë.</p> <p>Sipas Akt Rakordimi të ardhurat e papërdorura që duhet t'i kalojnë nga QSUNT (80%), pas hyrjes në fuqi të VKM Nr. 135/2022, nëpërmjet faturës për arkëtim Nr. 33/2, datë 22.04.2022 në vlerë 76,497,615 lekë.</p> <p>Sa më sipër VKM 688 /2018 pika 3 dhe 4, ndryshuar me VKM 135/2022 pika 4/1, ka përcaktuar qartë raportet e ndarjes së të ardhurave midis palëve që kanë nënshkruar akt marrëveshje. Nga QSUNT nuk u kërkua dhe nuk u arkëtua shuma 13,499,579 lekë për faturat për arkëtim Nr. 33/2, datë 22.04.2022 Nr. 37/2022, datë 06.10.2022, konsideruar nga palët si 15% tatim fitim për tu mbajtur nga pjesa takuese e të ardhurave të QSUNT. Pas momentit të hyrjes në fuqi të aktit normativ hyrjes në fuqi të VKM 135/2022 (botuar në FZ Nr. 37, datë 09.03.2022) detyrimi ligjor mbi palët është se deri në momentin e hyrjes në fuqi të VKM 135/2022, të ardhurat e krijuara dhe të papërdorura duhet të kalojnë në buxhetin e QSUNT në masën 80% si të ardhura dytësore për tu përdorur për investime në infrastrukturë, pajisje mjekësore ose investime të tjera , etj.... Mbajtja e tatim fitimit në masën 15% mbi të ardhurat dytësore të QSUNT, përben rrethana tjera të zbatimit të kërkesave të VKM Nr. 135/2022, pika 4/1 dhe Akt- Marrëveshjes Nr. 1242/41, date 16.11.2018, të ndryshuar.</p>
Kriteri:	Rregullorja e Brendshme e QSUNT; VKM 688 /2018 pika 3 dhe 4, ndryshuar me VKM 135/2022; Akt Marrëveshje QSUNT dhe F. datë 15.11.2018.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e një plani veprimi për përdorimin e të ardhurave dytësore në nivelin e këtij fondi, nuk mundëson kryerjen e investimeve në përputhje me objektivat afatgjatë të institucionit, duke mundësuar përdorimin e tyre rast pas rasti, për projekte që nuk janë realizuar dot nga buxheti i shtetit.
Shkaku:	Mungesa e një plani veprimi për përdorimin e të ardhurave dytësore në nivelin e këtij fondi.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandime:	-QSUNT për optimizimin e mundësive për rritjen e të ardhurave dytësore, të hartojë plan veprimi për gjenerimin, arkëtimin dhe përdorimin të tyre, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. -Mbështetur në Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, neni 10 , pika 2, QSUNT, t'i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për qëndrimin e saj zyrtar lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor për mbajtjen 15% të tatimit mbi fitimin nga pjesa takuese e të ardhurave të QSUNT-së në shumën 13,499,579 lekë, në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 135/2022, “Për disa shtesa në vendimin Nr. 688, datë 14.11.2018 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga

	MSHMS e F. të objektit me emërtim “Oborr i QSUNT” dhe zbatimin e aktmarrëveshjes së nënshkruar midis QSUNT-së dhe F.-së, me Nr. 1242/41, datë 16.11.2018, ndryshuar me Amendamentin Nr. 1, protokolluar me Nr. 884/2, datë 12.04.2022.
--	--

Titulli i Gjetjes Nr. 7	Të ardhurat nga zëri “Shërbimet administrative” për vitin 2022
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua QSUNT ka nënshkruar Kontratë Shërbimit Nr. 5216, datë 09.10.2020, me Kontraktorin O. shpk, me objekt “Mirëmbajtje e sistemit të informacionit për shëndetin publik të QSUNT (SISP)”. Neni 8.1 dhe 8.2 i kontratës parashikon se Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha shërbimet siç specifikohet të oferta teknike dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës neni 10 “Pranimi Shërbimeve”. Me shkresë Nr. 1544/1 prot, datë 01.06.2022, QSUNT i ka kërkuar nga Kontraktori hedhjen në SISP të tarifave të ndryshuara, miratuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 310, datë 17.05.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhërin Nr. 493, datë 02.07.2019 “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”. Kërkesa për dijëni i është drejtuar dhe AKSH-it dhe MSHMS. Kontrata e Shërbimit Nr. 5216, datë 09.10.2020, në nenin 8.1 dhe 8.2 ka parashikuar se Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha shërbimet siç specifikohet tek oferta teknike dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës neni 10 “Pranimi Shërbimeve”.</p> <p>Sipas kontratës së nënshkruar, kërkesa e QSUNT përbën detyrim kontraktual për t’u përmbushur nga Kontraktori. Kontraktori në sistemin SISP ka ndryshuar tarifat në datën 26 Shtator 2022 dhe jo brenda një afati të arsyeshëm, në kundërshtim me kërkesës me shkresën Nr. 1544/1 prot, datë 01.06.2022, dhe Urdhërin e MSHMS Nr. 310, datë 17.05.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhërin Nr. 493, datë 02.07.2019 “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”, <u>i cili në paragrafin e fundit kërkon zbatim të menjëhershëm të tij</u>. Kontraktori ka aplikuar me vonesë tarifat e reja, me efekt pas datës 26 Shtator 2022, në kundërshtim me Kontratën e Shërbimit Nr. 5216, datë 09.10.2020, neni 8.1 dhe 8.2 dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës neni 10. kërkesën e QSUNT me Nr. 1544/1 prot, datë 01.06.2022 dhe Urdhërin e MSHMS Nr. 310, datë 17.05.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhërin Nr. 493, datë 02.07.2019 “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”. Për pasojë QSUNT duhet të përlloragiste dhe mbante tarife ditore (dëm) për kryerjen me vonesë të shërbimit të kërkuar në hedhjen me vonesë të tarifave të reja në Sistemit SISP, sipas Urdhërit të MSHMS Nr. 310, datë 17.05.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhërin Nr. 493, datë 02.07.2019“Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”, për 85 ditë në vlerën 2,055,301 lekë (24,179,892 * 85 * 1/1000), në zbatim të nenit 20, germa “c” të kontratës së shërbimi Nr. 5216, datë 09.10.2020.</p>
Kriteri:	Urdhërin e MSHMS Nr. 310, datë 17.05.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhërin Nr. 493, datë 02.07.2019“Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”.

	<i>Kontratë shërbimit Nr. 5216, datë 09.10.2020, Shkresë Nr. 1544/1 prot, datë 01.06.2022.</i>
Ndikimi/Efekti:	Mos hedhja në Sistemin e Informacionit të Shëndetit Publik (SISP) e tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit të MSHMS Nr. 310, datë 17.05.2022, ka ndikuar në mos faturim, mos arkëtim, të shërbimeve me pagesë që ofrohen nga QSUNT, për shkak të mos faturim dhe mos arkëtim konform tarifave të reja, në kundërshtim me piken 7 të Urdhërit të MSHMS Nr. 310, date 17.05.2022.
Shkaku:	<i>Mos aplikimi në kohë tarifave të reja në SISP, sipas tarifave të miratuara Urdhër të MSHMS Nr. 310, date 17.05.2022.</i>
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Drejtori i Përgjithshëm i QSUNT-së në bashkëpunim me AKSH-in, të ngrenë një grup të përbashkët pune për të vlerësuar teknikisht nëse shërbimet e kërkuara me shkresën Nr. 1544/1 prot, datë 01.06.2022 për hedhjen në Sistemin Informacionit për Shëndetin Publik (SISP) të tarifave të ndryshuara të shërbimeve, kanë qenë pjesë e kontratës së shërbimit Nr. 5216, datë 09.10.2020, nënshkruar midis kontraktuesit dhe përfituesit. Pas verifikimit , nëse kushtet nuk ndryshojnë, të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 2,055,301 lekë, për mosmbajtje tarife ditore (dëm) në vlerën 2,055,301 leke.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit ka paraqitur observacion z. F.Dh. specialit në AKSHI, ne cilësinë e anëtarit te grupit të punës për ndjekjen e kontratës Nr. 5216, datë 09.10.2020 me operatorin O. shpk:

Në pretendimet e ngritura në shkresën e sipër cituara nga z. F.Dh. në cilësinë e anëtarit të grupit të punës të ngarkuar për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës së shërbimit Nr. 5216, datë 09.10.2020 “Mirëmbajtje e sistemit te informacionit për shëndetin publik të QSUNT (SISP)”, vazhdon ti qëndrojë të gjitha argumenteve dhe kundërshtimeve të parashtruara në observacionin Nr. 2729/3 prot., date 06.06.2023 pretendohet se:

1. Shërbimet e kërkuara nëpërmjet Urdhrit Nr. 310, datë 17.05.2022 nga QSUNT nuk janë trajtuar si pjesë e kontratës Nr.5216, date 09.10.2020 me objekt “Mirëmbajtje e sistemit te informacionit për shëndetin publik të QSUNT (SISP)”, duke argumentuar si më poshtë vijon:

- Ne lidhje me përditësimin e tarifave te ekzaminimeve imazherike dhe atyre laboratorike, ju bëjmë me dije se Urdhri Nr. 310, datë 17.05.2022 në asnjë rast nuk ngarkon për zbatim AKSH-in.

- QSUNT me shkresën Nr. 1544/1 prot., datë 01.06.2022 me lëndë “Kërkesë”, referuar urdhrit të MSHMS, dërguar operatorit O. shpk, dhe për dijeni MSHMS dhe AKSH-it, ka kërkuar ndryshimin e listës së çmimeve në Sistemin e Informacionit të Shëndetit Publik (SISP). QSUNT, nuk rezulton ti jetë referuar kontratës Nr.5216, date 09.10.2020 me objekt “Mirëmbajtje e sistemit te informacionit për shëndetin publik të QSUNT (SISP)”, ku të përcaktonte se ky shërbim bazohej mbi këtë kontratë, apo ishte një shërbim shtesë i rakorduar mes palëve, sikurse referohet në argumentet e O. shpk dhe përfaqësuesve të QSUNT.

- QSUNT nuk ka hartuar asnjë dokument ku të ketë përcaktuar detyrat që duhet të kryejë kontraktori, për të realizuar shërbimin e kërkuar dhe afatet për kryerjen e tyre. Urdhri Nr. 310, datë 17.05.2022, nuk përcakton afatet e kryerjes së shërbimit, i cili sikurse është e kuptueshme është një shërbim kompleks, që kërkon kohe për kryerjen e procedurave të duhura dhe nuk mund të realizohet brenda një dite.

2. Shërbimet e kërkuara nga QSUNT nëpërmjet urdhrin Nr. 310, datë 17.05.2022 nuk janë trajtuar si pjesë e kontratës Nr.5216, date 09.10.2020 me objekt “Mirëmbajtje e sistemit te informacionit për shëndetin publik të QSUNT (SISP)”, pasi nuk ka njoftuar palët në kontratë. Grupi për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi, për marrëveshje për të cilat nuk është vënë në dijeni dhe kur nuk ka asnjë problematikë të raportuar në lidhje me realizimin e kontratës. QSUNT në asnjë rast nuk ka njoftuar ndjekësit e zbatimit të kontratës, për problematika apo vonesa në zbatimin e shërbimeve, duke argumentuar si më poshtë vijon:

- QSUNT ne cilësinë e përfituesit të shërbimit nuk rezulton të ketë bërë me dije AKSHI-n dhe ndjekësit e zbatimit të kontratës, për shërbimet që duhet të kryheshin për implementimin e tarifave të reja në zbatim të urdhrin të MSHSHMS. Grupi i punës për ndjekjen e zbatimit të kontratës nuk ka patur asnjë informacion dhe nuk është vënë në dijeni për shërbimet dhe afatet për kryerjen e këtyre shërbimeve. Referuar sqarimeve të QSUNT rezulton se janë bërë takime në ambientet e saj, mes përfituesit të shërbimit dhe kontraktorit. Në këtë takime nuk është njoftuar dhe nuk ka marrë pjesë asnjë përfaqësues i AKSHI-t si AK, apo nga grupi i zbatimit të kontratës. Nuk ka asnjë njoftim nga QSUNT për diskutimet, vendimmarrjet dhe afatet për implementimin e tarifave të reja, apo vonesa në realizimin e kontratës. Për me tepër QSUNT ka vazhduar të operojë me tarifën e vjetra deri në implementimin e ndryshimeve në sistem, pa e trajtuar këtë si problematikë, apo moszbatim në kohë të urdhrin të ministrit, apo shkelje e shoqëruar me dëm ekonomik.

3. Grupi i ndjekjes së zbatimit të kontratës nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi jo vetëm për argumentet e parashtruara më lart (mos dijeni) por edhe për faktin se këto vonesa janë lejuar nga QSUNT, e cila ka vijuar të faturojë sipas tarifave të vjetra.

4. Përllogaritja e penaliteteve për vonesa të realizimit të kontratës është e pasakte dhe e pa argumentuar me argumentin se:

- grupi i auditimit periudhën e implementimit të shërbimeve shtesë e trajton si vonesa në realizimin e kontratës, ndërkohë që neni 19 dhe 20 i kontratës , duhet ti referohet shërbimeve dhe afateve të kontraktuara mes palëve.

- grupi i auditimit llogaritjen e vonesave e lidh me hyrjen në fuqi për zbatim të urdhrin të MSHMS me shkresë datë 31.05.2022, duke vendosur si datë arbitrare datën 01.06.2023, si afat për realizimin e shërbimit, ku në fakt kjo është data kur QSUNT ka njoftuar Kontraktorin për shërbimin e kërkuar. Nuk ka asnjë vlerësim apo argument teknik se sa duhet të ishte koha e nevojshme, për kryerjen e shërbimeve të kërkuara.

- observacioni thekson faktin se gjatë periudhës 4 -muajore , sistemi ka gjeneruar të ardhura për ekzaminime imazherike dhe laboratorike, që provon se sistemi ka funksionuar dhe kontraktori ka ofruar shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit sipas kontratës ne fuqi.

5. Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të realizimit të kontratës është përgjegjës për verifikimin dhe kontrollin e kryerjes së shërbimeve në përputhje me përcaktimet dhe afatet kontraktuale si dhe termat e referencës , qe janë pjesë integrale e kontratës së shërbimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Grupi i auditimit lexoi me vëmendje gjithë pretendimet e paraqitura nga z. F.Dh., duke arsyetuar si më poshtë:

Sistemi SISP mirëmbahet dhe përditësohet nga O. shpk, bazuar në kontratën Nr.5216, date 09.10.2020 me objekt “Mirëmbajtje e sistemit te informacionit për shëndetin publik të QSUNT (SISP), duke ngarkuar palët me te drejta dhe detyrime në përputhje me dispozitat ligjore te nënshkruara në të.

E përbashkëta që vihet re në observacionin/et dhe dokumentacionin e paraqitur është mos informimi dhe mos bashkëveprimi ndërmjet palëve kontraktuale lidhur me implementimin e ndryshimit të tarifave, për përmbushjen dhe realizimin e urdhrit të MSHMS Nr. 310, datë 17.05.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhrin Nr. 493, datë 02.07.2019 “Për sistemin e referimit dhe tarifën e shërbimit shëndetësor publik”, i cili nga QSUNT është kërkuar për përditësim në SISP me shkresën Nr. 1544/1 prot., datë 01.06.2022, dhe në paragrafin e fundit kërkon zbatim të menjëhershëm të tij.

QSUNT në dokumentacionin e paraqitur gjatë auditimit, në asnjë rast nuk paraqiti dokumentacion shkresor se gjatë periudhës 4 mujore që ka përfunduar implementimi tarifave të reja konform urdhrit të MSHMS Nr. 310, datë 17.05.2022, OE ka qenë në pamundësi të përditësimit të tarifave të reja, duke mos provuar pretendimeve të paraqitura nga Ju, si anëtar i grupit për zbatimin e kontratës.

Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të realizimit të kontratës mban përgjegjësi për verifikimin dhe kontrollin e kryerjes së shërbimeve në përputhje me përcaktimet dhe afatet kontraktuale si dhe termat e referencës, si pjesë integrale e kontratës së shërbimit. Por për grupin e auditimit mbetet e paqarte se si mund të implementohet një modul i ri, dhe grupi i punës që ndjek zbatimin e kontratës për mirëmbajtjen e sistemit SISP, ose institucionet përkatëse, nuk kanë dijeni për ndërhyrjet në sistemin SISP, për zhvillim e një programi i cili sipas jush nuk është parashikuar në kontratë (!?) dhe përfundimisht bëhet pa pagesë nga kontraktori.

Në këto kushte për verifikimin e çështjes, grupi i auditimit për qartësimin e rrethanave rekomandon verifikimin e rastit nga punonjës me njohuri të posaçme në fushën e teknologjisë dhe informacionit, për të vlerësuar nëse hedhja e tarifave në SISP nuk përbën përditësim të dhënash por zhvillim programi i parashikuar në kontratën e nënshkruar nga palët, sipas pretendimit tuaj në këtë observacion.

Në vartësi të konkluzioneve të specialisteve të fushës do të përlogariten penaltitetet për vonesa të realizimit të kontratës (në rast se ka) referuar kontratës Nr.5216, date 09.10.2020 me objekt “Mirëmbajtje e sistemit të informacionit për shëndetin publik të QSUNT (SISP) lidhur me implementimin e ndryshimit të tarifave.

Në kushtet kur operatori ekonomik ka një kontratë shërbimi për mirëmbajtjen e sistemit SISP dhe është faturuar periodikisht për shërbimin e ofruar deri në 100% të vlerës së kontratës, si dhe nuk jemi përpara fateve dhe rrethanave të reja të paraqitura gjatë auditimit dhe observacionit tuaj date Nr. 2729/3, date 06.06.2023, grupi i auditimit i qëndron pranimit të pjesshëm të ankimit deri në verifikimin e këtij rasti nga specialistë të fushës së teknologjisë dhe informacionit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit ka paraqitur observacion znj. M.R. në cilësinë e Drejtorit të Shërbimit Farmaceutik, me shkresën Nr. 175/136, datë 04.08.2023, protokollar në KLSH me Nr.1177/25prot, datë 14.08.2023.

Në pretendimet e ngritura në shkresën e sipër cituara nga znj. M.R. arsyetohet se parashikimi i lartë i fondeve buxhetore, sipas gjetjes tuaj, nuk vjen nga mos parashikimi i një modeli në rregulloren e farmacisë e cila parashikon organizimin e këtij shërbimi, por është tërësisht kompetencë e secilit prej shefave të shërbimit të parashikojnë referuar konsumeve ashtu si ju kërkohet edhe me shkresën e Titullarit bazuar në argumentet:

-Rregullorja e Shërbimit Farmaceutik 2163/1 datë 17.06.2015 përcakton rregulloren e funksionimit dhe organizimit të Shërbimit Farmaceutik, QSUNT, e cila nuk ka në vetvete detyrimin e përcaktimit të mënyrës sesi Shefat e Shërbimeve duhet të bëjnë një planifikim, pasi në të vendosen dhe përcaktohen vetëm detyrat e farmacistëve, mënyra e ruajtjes, qarkullimit të barnave etj., dhe nuk i shkon për dijeni Shefave të Shërbimeve. Pra rregullorja e SHF, është e

aplikueshme në mirëmenaxhimin dhe planifikimin e stokut pranë DSHF dhe jo barnat apo materiale të cilat nuk janë prokuruar akoma nga QSUNT.

-Parashikimi i fondeve buxhetore është një detyrë e mirë përcaktuar në detyrat funksionale të Shefit të Shërbimit të lidhura në Marrëveshje, përkatësisht Neni 3 “Pozicioni Punës dhe Detyrat”, ku specifikohet në pikën 3.3 “Shefi i Shërbimit ka detyrimin të bëjë planifikimin vjetor të barnave, materialeve mjekësore dhe aksesoreve të pajisjeve mjekësore të nevojshme për trajtimin e pacientëve referuar protokolleve të Diagnostikimit dhe Mjekimit” (psh në shkresën me Nr. 1398/3 datë 06.07.2023 me lëndë “Mbi hartimin e Projekt buxhetit të QSUNT për barna dhe materiale mjekësore për vitet 2024-2026” dhe 1845/36 datë 19.07.2022 me lëndë “Mbi hartimin e Projekt buxhetit të QSUNT për barna dhe materiale mjekësore për vitet 2023-2025”).

Qëndrimi i grupit të auditimit

Grupi i auditimit lexoi me vëmendje gjithë pretendimet e paraqitura nga znj. M.R., arsyeton si me poshtë:

Për reference në analizë do të marrim planifikimin e buxhetit për të përballuar shpenzimet për barna dhe materiale mjekësore 2022-2024.

Ne Projekt Raport Auditimi është cilësuar se Drejtori i përgjithshëm i QSUNT, me Urdhër Nr.322, datë 29.06.2021, prot., Nr.1789/2 prot., datë 29.06.2021 “Për hartimin e nevojave për barna dhe materiale mjekësore 2022-2024”, ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës të përbërë nga 7 anëtarë, për vlerësimin e nevojave për të gjithë shërbimeve mjekësore për barna dhe materiale mjekësore, bazuar në kërkesat e shërbimeve dhe vlerësimet e tyre.

Rregullorja e Shërbimit Farmaceutik 2163/1 datë 17.06.2015 përcakton rregulloren e funksionimit dhe organizimit të Shërbimit Farmaceutik në QSUNT, duke përcaktuar se shërbimi farmaceutik (Farmacia Qëndrore e QSUNT) është përgjegjëse për planifikimin vjetor të nevojave të QSUNT për barna dhe materiale mjekësore, bazuar në kërkesat nga shefat e shërbimeve dhe në analizën e konsumit vjetor (e cila është përgjegjësi e Farmacia Qëndrore)”

Shefi i shërbimit farmaceutik në Farmacinë Qendrore është përgjegjës për planifikim vjetor të nevojave të QSUNT për barna dhe materiale mjekësore, bazuar në kërkesat nga shefat e shërbimeve dhe analizën e konsumeve vjetore, dhe të trendit të rritjes së sëmundshmërisë dhe në bazë të buxhetit të miratuar nga Drejtoria e QSUNT-së dhe FSDKSH-së” dhe me anëtarët e grupit të punës të ngritur me urdhër të titullarit të institucionit. Hartimin dhe propozimin e projekt buxhetit për vitin pasardhës, bazuar në analizën e konsumeve vjetore, dhe të rritjes së trendit të sëmundshmërisë. Etj (Rregullorja e farmacisë, pika I.1):

Rregullorja e Farmacisë përcakton se Farmacia Qëndrore në hartimin e PBA ka detyrim për bashkëpunim me Drejtorinë e Drejtorisë së QSUNT-se dhe me shërbimet mjekësore, por nuk ka të +përcaktuar një metodologji se do të hartojë PBA referuar objektivave të MSHMS dhe QSUNT, diagnoza të reja, protokolle të tjera mjekimit, shtimit të konsumit për barna dhe materiale mjekësore etj.

Shkresat e grupit të punës (nuk ka një raport përmbledhës) në hartimin dhe propozimin e projekt buxhetit për vitin pasardhës, kanë mungesë të theksuar informacioni mbi metodologjinë e përdorur për parashikimin e shpenzimeve buxhetore, mungesë të analizës e efeteve financiare të shtimit të konsumit për barna dhe materiale mjekësore, mungon analiza e risqeve dhe masave për përballimin e efekteve nga diagnozat e reja dhe protokolleve për këto diagnoza.

2.2. Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.

Në mbështetje të ligjit Nr.10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në RSH”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, të VKM Nr. 66, datë 03.02.2017 “Për përcaktimin e kritereve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”, pika 8, VKM Nr. 654, datë 10.11.2017 “Për miratimin si strukturë universitare, të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Drejtimi administrativ i spitaleve universitare është në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa drejtimi institucional është në varësi të dyfishtë, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si organe që bashkërendojnë veprimtarinë e Spitaleve Universitare në zbatim të Statutit të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë me Nr. 2364, datë 25.06.2007 dhe nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës me Nr. 4564/1, datë, 26.06.2007, i cili pas ndryshimeve përkatëse zëvendësohet me Urdhrin e Përbashkët Nr. 709, datë 10.10.2018 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e Statutit të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë”, miratuar nga MSHMS me shkresë Nr. 5842/2 prot, datë 02.11.2018, protokolluar në institucion me Nr. 4820 prot, datë 06.11.2018. Organigrama pasqyron strukturën administrative dhe shërbimet mjekësore. Organigrama e QSUNT është miratuar nga Ministri i MSHMS me Urdhër Nr. 51/1, datë 21.06.2020 për protokolluar në QSUNT me Nr. 578/412 prot, datë 25.06.2020 për miratimin e numrit të punonjësve në 3,017 punonjës. Personeli i QSUNT përbehet nga personel mjekësor dhe mbështetës, të organizuar sipas një strukture të shpërndara në 8 Pole të Administrimit të Integruar (PAI). Numri i përgjithshëm i punonjësve për periudhën objekt auditimit nuk ka ndryshuar, por shpërndarja e kapaciteteve të burimeve njerëzore brenda strukturës së miratuar ka pësuar ndryshime, sipas vendimmarrjes së Bordit Drejtues në QSUNT. Organigrama e QSUNT është pjesë e statutit. Shpërndarja e numrit të punonjësve sipas strukturës paraqitet në tabelën si më poshtë vijon:

Shpërndarja e numrit të punonjësve sipas strukturës të QSUNT

STRUKTURA ADMINISTRATIVO-MJEKESORE QSUT		2020		2021		2022	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Administratë	Drejtoria e Përgjithshme	304	293	311	307	318	288
Administratë	Mjeke specializante	308	304	308	329	308	292
PAI 1	Spitali i Sëmundjeve të Brendshme	414	394	420	396	419	390
PAI 2	Spitali Polivalent	783	688	772	680	765	659
PAI 3	Spitali i Neuroshkencës	310	294	317	296	317	296
PAI 4	Spitali Francez	126	122	129	121	130	121
PAI 5	Spitali Pediatrik	386	367	386	367	386	363
PAI 6	Spitali Onkologjik	145	138	145	139	145	136
PAI 7	Spitali Infektiv	201	195	189	178	189	174
PAI 8	Konsultat	40	38	40	39	40	39
TOTALI		3017	2833	3017	2852⁷	3017	2758⁸
Ndryshimi fakt /plan			-184		-165		-259

(Burimi : QSUNT punoi: KLSH)

⁷ Mospërputhja është parë 3 punonjës të cilët janë me kontrate shërbimi per vitin 2021 të cilët nuk paguhen me fonde buxhetore


⁸ Mospërputhja është parë 1 punonjës të cilët janë me kontrate shërbimi per vitin 2021 të cilët nuk paguhen me fonde buxhetore

Lidhur me pozicionet e punës grupi i auditimit analizo shpërndarjen e punonjësve “Mjek”; “Infermier ” dhe të “Tjerë” pjesa tjetër e punonjësve. Të dhënat e analizuar paraqiten në tabelën dhe grafikët si më poshtë vijon:


Numri punonjësve për çdo 3-mujor QSUNT

3-mujori	MJEKE		INFERMIERE		TË TJERET		TOTALI	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
3 mujori I- 2021	381	314	1241	1209	381	314	3017	2845
3 mujori II- 2021	385	316	1250	1224	385	316	3017	2862
3 mujori III- 2021	386	318	1249	1224	386	318	3017	2863
3 mujori IV- 2021	386	316	1249	1215	386	316	3017	2849
3 mujori I- 2022	386	314	1250	1222	386	314	3017	2839
3 mujori II- 2022	386	314	1250	1211	386	314	3017	2782
3 mujori III- 2022	386	312	1250	1201	386	312	3017	2759
3 mujori IV- 2022	386	318	1250	1207	386	318	3017	2759


(Burimi : QSUNT)



(Burimi : QSUNT Punoi: KLSH)



(Burimi : QSUNT Punoi: KLSH)



(Burimi : QSUNT Punoi: KLSH)

Organigrama e QSUNT është miratuar nga ministri MSHMS me Urdhër Nr. 51/1, datë 21.06.2020, protokolluar në QSUNT me Nr. 578/412 prot, datë 25.06.2020 për 3,017 punonjës. Gjatë periudhës objekt auditimi struktura e QSUNT ka pësuar ndryshime me:

Me shkresë Nr. 5043/1, date 11.11.2020 të MSHMS, protokolluar me Nr. 578/642, date 12.11.2020, me të cilën ka miratuar kërkesën e QSUNT për punësim të përkohshëm të personelit mbështetës deri në 30 punonjës brenda vendeve vakant të organikës së miratuar, për një periudhë deri në 6-muaj për nevoja të spitaleve për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19. MSHM me shkresë Nr. 3517/1, datë 25.08.2021; shkresë Nr. 487/1 prot, datë 21.02.2022, shkresë Nr. 3160/1 prot, datë 15.08.2022 ka shtyrë afatin çdo gjashtë muaj, për personel të përkohshëm mbështetës në QSUNT. Punësimi i përkohshëm i punonjësve ka shtyrë efektet deri në 31.12.2022.

Me shkresë Nr. 596, datë 01.02.2021, MSHMS ka lejuar zëvendësimin e vendeve të shkurtuara për 65 laborante me 65 specializantë, si shtesë brenda numrit të përgjithshëm që QSUNT ka për kuotat e mbuluara nga specializantët, duke ndikuar në shtimin e numrit të “mjekeve specializantë” dhe tejkalar planifikimin për 21 mjeke në vitin 2021, por në total brenda numrin të miratuar të punonjësve. Ky ndryshim bazohet në VKM Nr. 555/2011 “Për miratimin e strukturës së pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe punonjësve të infermieristikës...”, dhe VKM Nr. 258, datë 24.04.2019 “Për miratimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat “Për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjë” sipas të cilës pushojnë së ekzistuari detyrat funksionale të ngarkuara 65 punonjësve në disa shërbime spitalore. Brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve të miratuar nga MSHMS, Bordi Drejtues i QSUNT ka miratuar ndryshime në strukturë, përkatësisht me Vendim Bordi Nr. 01, date 24.03.2021, me Vendim Bordi Nr. 02, date 26.07.2021; me Vendim Bordi Nr. 03, dt.. 30.12.2021 dhe Vendim Bordi Nr. 01, date 07.03.2022.

Ndryshimet në strukturë 2021-2022

Ndryshimet në strukturë 2021-2022		Vendimi Nr. 1, datë 24.03.2021		Vendimi Nr. 2, datë 26.07.2021		Vendimi Nr. 3, datë 30.12.2021		Vendimi Nr. 1, datë 07.03.2022	
		Ishte	Bëhet	Ishte	Bëhet	Ishte	Bëhet	Ishte	Bëhet
Administratë									
Spektori i Prokurimeve	Specialist	5	7						
Spektori i Marrëdhënieve Ligjore	Specialist	4	5						

Sektori i Kontrollit të Infeksioneve Spitalore				Mjek (epidemiolog)	Mjek				
Sektori Psikosocial	Psikolog/Punonjës Social PAI Neuroshkencë			2	3				
	Psikolog/Punonjës Social Klinika HIV/AIDS			0	2				
Sektori i Auditit	Specialist			2	3				
Koordinator i Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit						0	1		
Sektori Teknik	Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme (gazra mjekësor)					9	10		
	Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme (kaldaja dhe sisteme të ujit të pijshëm e sanitar)					11	12		
	Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme (sistemet elektrike)					7	9		
	Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme (motogenerator)					6	7		
Shërbimi i Statistikës dhe Regjistrave Spitalor Njësia e Regjistrave Spitalor	Specialist Arkivë					1	2		
PAI 1									
Shërbimi i Kirurgjisë Vaskulare	Mjek	4	6						
Klinika e Reanimacionit Kardiak	Infermier	33	37						
Shërbimi i Lab. Imunologjik	Laborant					2	1		
PAI 2									
	Sanitar					115	114		
Shërbimi i Lab. Anatomisë Patologjike	Laborant	11	9						
Shërbimi i Lab. Klinik Biokimik	Laborant	41	32						
	Laborant klinik biokimik					32	30		
	Laborant klinik biokimik					30	29		
Shërbimi i Lab. Mikrobiologjik	Laborant					16	14		
	kujdestar kafshësh							1	0
PAI 3									
	Kabineti i Neurofiziologjisë	Kryelaborant	Kryeinfermier						
		Laborant	Infermier						
PAI i Neuroshkencës	Shoqërues force			6	0				
Shërbimi i Psikiatrisë	Infermier pavijoni			0	27				
	Shoqërues force			0	6				
Njësia e Psikiatrisë së Përgjithshme	Infermier pavijoni			27	0				
Njësia e Urgjencës Psikiatrike	Infermier urgjence			17	24				
PAI 4									
Shërbimi i Okulistikës	Mjek	6	8						
	Specialist (Ortoptist)			0	1				
Infermier (logopedist)								1	2
PAI 7									
	Infermier pavijoni			77	69				
	Sanitare			50	47				

Klinika Ambulatorëe HIV/AIDS	Psikolog/Punonjës Social			2	0				
Shërbimi Reumatologjisë	Mjek			4	5				
TOTALI		0	0	0	0	0	0	0	0

(Burimi: QSUNT)

Sipas Rregullores bazë të QSUNT, paragrafi 2.2 “Rregulla të përgjithshme mbi veprimtarinë e strukturave dhe bashkëveprimi midis tyre” përcaktohet se aktiviteti i përgjithshëm i Q.S.U.T drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Çdo drejtori zhvillon veprimtarinë në baze të rregullores të saj të brendshme mbështetur në rregulloren baze të institucionit, në të cilat përfshihen objekti i punës, detyrat, struktura dhe detyrat funksionale të çdo punonjësi. Rregulloret e brendshme të sektorëve mjekësore dhe administrative miratohen me grup pune nga strukturat administrative (Titullari apo i deleguari prej tij).

QSUNT për periudhën objekt auditimi QSUNT ka zbatuar strukturën organike duke mos tejkaluar numrit të përgjithshëm prej 3,017 punonjësish, miratuar me Urdhrin Nr. 51/1, datë 21.06.2020 të Ministrit MSHMS, protokolluar në QSUNT me Nr. 578/412 prot, datë 25.06.2020.

Nga auditimi u konstatua se:

Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk ka një rregullore të saj si Drejtori e Burimeve Njerëzore në të cilin në të cilat përcaktohen objekti i punës, detyrat, struktura dhe detyrat funksionale të çdo punonjësi, kërkesë kjo e paragrafit 2.2 të Rregullores Bazë të QSUNT.

Plotësimi i vendeve vakant në QSUNT sipas strukturës administrative dhe e shërbimeve mjekësore, krahasuar me numrin e të punësuarve rezulton më mosrealizim , në fund të vitit 2021 rezulton me 165 vende vakante ose realizim 94.53% dhe për vitin 2022 rezulton me 259 vende vakante ose realizim në masën 91.42%. Referuar të dhënave statistikore të QSUNT, konstatohet numri i të punësuarve ka pësuar rënie të vazhdueshme nga 3-mujori II-të 2021 deri në 3-mujorin e IV të vitit 2022, duke arritur numrin më të ulët prej 2,759 punonjësish në 3-mujorin e IV 2022 të kundrejt 3017 punonjës të miratuar. Përsa i përket plotësimit të strukturës së miratuar me personel “Mjek” dhe “Infermier”, konstatohet se struktura organike për personel “Mjek” planifikuar për 386 vende, rezulton e plotësuar deri në 318 vende ose për 68 vende vakant, dhe personel “Infermier” ka planifikuar në strukturë 1250 vende pune, plotësuar deri në 1207 vende ose 33 vende vakant. Mungesat e stafit të specializuar mjekësor, rrisin rrezikun për t’ju përgjigjur plotësisht dhënies cilësore të shërbimit mjekësor të specializuar terciare pranë këtij institucioni.

DOSJET E PERSONELIT

Institucionet e administratës shtetërore janë të detyruara të krijojnë e të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuarit në institucionin e tyre, sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në VKM Nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit qendror të personelit”. Në kuptim të këtij vendimi, me “institucione të administratës shtetërore” përveç të tjerash kuptohen edhe institucionet në varësi të ministrave, ku bën pjesë edhe QSUNT.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore administron dhe plotëson dokumentacionin e dosjes së personelit për punonjësit e QSUNT.

Lidhur me përmbajtjen dhe administrimin e dosjeve të personelit, bazuar në metodën me përzgjedhje, grupi i auditimit përzgjedhi 50 dosje personeli punëmarrës për periudhën objekt auditimi, në pozicion pune “Shef shërbimi”, “Mjek”, “Profesionistë të Shkencave Mjekësore Teknike” dhe “Personeli Administratës”.

Nga auditimi u konstatua se:

Me Vendim Nr. 03, datë 02.12.2022 “Për disa ndryshime të statutit të QSUNT”, Bordi Drejtues i QSUNT ka miratuar ndryshimin e pikës 23 “Dosja e personelit”, duke përcaktuar se procedurat e

punësimi të stafit mjekësor dhe profesioneve të shkence mjekësore teknike, bazohen në legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi, si dhe Udhëzimet e portalit “Mjekë për Shqipërinë” dhe “Infermierë për Shqipërinë” të ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Procedurat e punësimi të punonjësve të tjerë, bazohen në dispozitat e Kodit të Punës dhe Rregulloren e Brendshme të QSUNT. Vendimi Bordit Nr.03/2022 në pikën 2 përcakton se ndryshimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, i përcillen MSHMS për ndjekjen e procesit të miratimit. QSUNT me shkresën Nr. 687 prot, datë 13.03.2023 ka kërkuar në MSHMS dhe MARS miratimin e ndryshimeve statusore, sipas pikës 2 të Vendimit të Bordit Nr. 03, datë 02.12.2022, ndryshime të cilat ende janë pa veprim nga institucionet përgjegjëse.

Titullari i institucionit me Urdhër Nr. 321, datë 09.10.2018 “Për miratimin e programit orientues për punonjësit e rinj dhe formularin e vlerësimit” dhe Urdhër të Brendshëm Nr. 179, datë 30.03.2023, protokolluar me Nr. 721/2 prot, datë 30.03.2023, në mbështetje të Statutit të QSUNT ka miratuar “Formularët e vlerësimit të performancës” për stafin “Shef shërbimi”, “Mjek”, “Imazherist”, “Profesionistë të Shkencave Mjekësore Teknike” dhe “Personeli Administratës dhe Sanitarë”.

Nga auditimi u konstatua se:

Vlerësimi i punës për vitin 2022 është kryer pas daljes Urdhrit të Brendshëm Nr.179, datë 30.03.2023 dhe jo brenda vitit kalendarik, në mospërputhje me Statutin e QSUNT Nr.709/2018, pika 23.3, germa “dh” sipas të cilit dosja e të punësuarit duhet të përmbajë citojmë “Vlerësimin e punës që bëhet në fund të çdo viti”. Në zbatim të statutit Titullari në pikën 2 të Urdhrit të Brendshëm Nr. 179, datë 30.03.2023, ka përcaktuar: “Formulari i vlerësimit të stafit të sipërcituar do të plotësohet 1 (një) herë në vit. Ky formular depozitohet pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe ruhet në dosjen e punëmarrësit”. Urdhri i Brendshëm Nr. 179, datë 30.03.2023, nuk përcakton një afat të vlerësimit të performancës vjetore dhe mungon shkalla hierarkike e vlerësimit nga miratimi nga eprori i drejtpërdrejtë deri tek aprovimi nga Drejtori i Përgjithshëm, si Titullari më i lartë ekzekutiv, drejtues, organizues dhe kontrollues i të gjithë veprimtarisë, konform Statutit dhe rregulloreve të brendshme të Q.S.U.T.

Dalja e Urdhrit të Brendshëm Nr. 179, datë 30.03.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUNT, standardizon procesin e vlerësimit të performancës së punës së punonjësve, me “Formular të miratuar të performancës në punë”. Sipas të Kodit të Punës, neni 142 “Koha e Provës”, QSUNT vlerëson performancën në punë për periudhën 3 mujore, por formularin e vlerësimit nuk e ka administruar në dosjen individuale të punonjësit, në mospërputhje me Statutin e QSUNT Nr.709/2018, pika 23.3, germa “ë”.

Në dosjet e përzgjedhura dokumentacioni i administruar është konform kërkesave të VKM 833/2020. Por DBNJ nuk ka rifreskuar “Fletën prezantuese” të dosjes sipas kriterëve të VKM Nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, por vazhdon të administrojë dhe mbajë dosjet e personelit sipas kërkesave të pikës 23 të Statutit të QSUNT-së. Konkretisht fleta e përmbledhjes së dokumenteve në dosje është e ndryshme nga flete inventari e dosjes së të punësuarit (lidhja 2) kriter i VKM Nr. 833/2020. Fleta aktuale nuk përmban të dhëna si: Informacion lidhur me të punësuarin si numër personal, datëlindje, certifikate personale/familjare, etj.; nuk përmban të dhëna mbi vendbanim të përkohshëm dhe të përhershëm; informacion lidhur me arsimin, informacion lidhur me grada/titull shkencor; informacion mbi gjuhët e huaja; informacion mbi masat disiplinore, veprime këto në mospërputhje me kërkesat e VKM Nr. 833/2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Statutin e QSUNT paragrafi 23.2, sipas të cilit Sektori i Personelit, strukturë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore është njësi përgjegjëse në QSUNT përmbajtjen e këtyre dosjeve më korrektësi, profesionalizëm dhe duke respektuar parimet e konfidencialitetit, nga punonjësit:

Znj. A.V. në cilësinë e Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për periudhën nga data e emërimit 24.01.2022 e në vazhdim, znj. S.Z. në cilësinë e ish Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për periudhën nga 01.04.2022 deri 30.12.2021, znj. S.A. Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Marrëdhëniet e punës

Marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Ligj Nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar duke lidhur kontrata individuale pune me punëmarrësit. Për periudhën objekt auditimi QSUNT ka lidhur Kontratë Kolektive Punës datë 30.03.2021 ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) me një afat kohor 3 vjeçar (2021-2023). Grupi i auditimit përzgjidhi 20 Kontrata Individuale të Punës të punonjësve pjesë e strukturës së QSUNT. Disa nga mangësitë e konstatuara në kontratat e punës janë evidentuar në tabelën si me poshtë vijon:

Punonjësi	Pozicioni i punës	Mangësitë në kontratën e punës, referuar Kodit të Punës
M.H.	Specialist (Asistent i Dr. Pergj)	Neni 8.1 (mungon data e dhënies se pagës); neni 15 (mungon referimi në kontratën kolektive në fuqi)-kontratë Nr. 731/1, dt.. 22.02.2022
A.F.	Drejtor Drejtorisë Juridike	Neni 8.1 (paga jo me vone se data 13 e muajit pasardhës) ; neni 15 (mungon referimi në kontratën kolektive në fuqi)- kontratë 619/1, dt.. 0209.2022
N.Ç.	Teknik i mesëm	Neni 8.1 (mungon data e dhënies se pagës); neni 15 (mungon referimi në kontratën kolektive në fuqi)- kontratë 1248/2, dt.. 29.04.2021
S.K.	Punonjës Social	Neni 8.1 (mungon data e dhënies se pagës); neni 15 (mungon referimi në kontratën kolektive në fuqi); mungon leja e ushtrimit të profesionit sipas dokumentit të listës e konkursit të shpallur për këtë vend pune (DBNJ-QSUNT)- kontratë ind. Nr.935/13, dt. 31.05.2021, certifikate personale
E.Z.	Punonjës Social	Neni 8.1 (mungon data e dhënies se pagës); neni 15 (mungon referimi në kontratën kolektive në fuqi); mungon leja e ushtrimit të profesionit sipas dokumentit të listës e konkursit të shpallur për këtë vend pune (DBNJ-QSUNT)- kontratë ind. Nr.935/13, dt.. 31.05.2021, certifikate personale
A.Gj.	Teknik I Mesëm	Neni 8.1 (mungon data e dhënies se pagës); neni 15 (mungon referimi në kontratën kolektive në fuqi))- kontratë 1504/2, dt.. 31.05.2021
A.P.	Teknik I Mesëm	Neni 8.1 (paga jo me vone se data 13 e muajit pasardhës)- kontratë 2950/2, dt. 27.12.2022
A.Ç.	Mjek	Neni 8.1 (mungon data e dhënies se pagës); neni 15 (mungon referimi në kontratën kolektive në fuqi)- kontratë Nr. 2518/7, dt.. 11.11.2021
M.B.	Mjek	Neni 8.1 (paga jo me vone se data 13 e muajit pasardhës) kontratë 2175/7, dt.. 11.10.2022
J.K.	Mjek	Neni 8.1 (paga jo me vone se data 13 e muajit pasardhës) kontratë 2236/7, dt.. 02.12.2022
M.D.	Infermier	Neni 8.1 (mungon data e dhënies se pagës); neni 15 (mungon referimi në kontratën kolektive në fuqi)- kontratë Nr. 1602/2, dt. 09.06.2021
E.S.	Infermier	Neni 8.1 (mungon data e dhënies se pagës); neni 15 (mungon referimi në kontratën kolektive në fuqi)- kontratë Nr. 489/2, dt.. 01.02.2022
D.M.	Infermier	Neni 8.1 (mungon data e dhënies se pagës); neni 15 (mungon referimi në kontratën kolektive në fuqi)- kontratë Nr. 1603/2, dt. 09.06.2021

(Burimi: QSUNT Punoi: KLSH)

Nga auditimi dosjeve të personit përzgjedhur me lart u konstatua se kontratat individuale të punës, përgjithësisht janë lidhur sipas kërkesave të Kodit të Punës me mangësi si me poshtë vijon:

- Kontrata individuale e punës për punëmarrësin nuk ka të përcaktuar datën të saktë të dhënies së pagës ose në kontratat e reja të vitit 2022 është përcaktuar si “*jo në vone se data 13 e muajit paraardhës*”. Kjo marrëdhënie kontraktuale punësimi, bie ndesh me kërkesat e nenit 21 pika 3 germa “j” të Kodit të Punës sipas të cilës kontrata e punës e lidhur me shkrim duhet të përmbajë sidomos elementet përbërës të pagës dhe datën e dhënies së saj”, si dhe nenin 15 pika 12 të Kontratës Kolektive të Punës Nr. 1528/1, datë 30.03.2021 e cila përcakton se “Paga jepet në monedhë shqiptare, në rrugë bankare, për çdo muaj deri në datën 10 të muajit paraardhës”; Kontrata individuale të punës deri në dhjetor 2022 nuk përcakton kontratës kolektive në fuqi me ekstremitet e saj (numri, data) por përmban fjalët “Kontrata Kolektive”, veprime në kundërshtim me nenin 21 pika 3 germa “j” të Kodit të Punës, sipas të cilit “kontrata e punës duhet të përmbajë dhe kontratën kolektive në fuqi”. Për punëmarrësit “punonjës social” mungon leja e ushtrimit të profesionit të punonjësit social, në mospërputhje me kërkesat e nenit 8 pika 1 të Ligjit Nr. 163/2014 “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Statutin e QSUNT paragrafi 23.2, sipas të cilit Sektori i Personelit, strukturë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore është njësi përgjegjëse në QSUNT përmbajtjen e këtyre dosjeve më korrektësi, profesionalizëm dhe duke respektuar parimet e konfidencialitetit dhe Rregullorja e Brendshme e QSUNT, në paragrafin 2.5 përcakton rregulla të përgjithshme të procedurës së punësimit për personelin mjekësor dhe administrativ nga punonjësit:

Znj. A.V. në cilësinë e Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për periudhën nga data e emërimit 24.01.2022 e në vazhdim, znj. S.Z. në cilësinë e ish Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për periudhën nga 01.04.2022 deri 30.12.2021.

Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.

Emërimet

Procedura e rekrutimit të personelit mjekësor në QSUNT mbështetet në Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të QSUNT, ku përshkruhen dispozitat kryesore për punësim, dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqitet pranë institucionit si dhe kriteret që duhet të plotësojnë stafi mjekësor, infermierë dhe administrativ në Spitalet Universitare. Shërbimi në institucionet shëndetësore universitare drejtohet nga drejtuesi i shërbimit. Procesi i përzgjedhjes së kandidatave bazohet në VKM Nr. 424, datë 10.05.2017 “Për përcaktimi i kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”. Kandidati konkurrues për një shërbim të caktuar vlerësohet nga një komision i posaçëm, i ngritur me urdhër të përbashkët të MSHMS, i cili ka në përbërje të tij përfaqësues nga Rektori, Dekani i IAL-së, struktura shëndetësore universitare, MARS. Komisioni i posaçëm vlerësim dhe dërgon rezultatet e vlerësimit ministrit të MARS dhe ministrit të MSHMS, të cilët bëjnë emërimin me shkresë të përbashkët. Shefi i shërbimit i shpallur fitues emërohet në detyrë me shkresë të përbashkët dërguar nga MARS dhe MSHMS. Shefi i shërbimit lidh “Marrëveshje Shërbimi” (tre pjesë), nënshkruar nga titullari QSUNT; Dekani Fakultetit Mjekësisë dhe Shefi i Shërbimit shpallur fitues. Drejtuari i shërbimit drejton shërbimin për 4 vjet, me të drejtë rikandidimi.

Procedura e punësimit të Personeli drejtues Shef Shërbimi bazohet në Ligjin Nr. 80 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, Statutin e Fakultetit të Mjekësisë, VKM Nr. 555, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e ministrisë së shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave

të armatosura”, Statutin e QSUNT (*Urdhri i përbashkët Nr. 709/2018*), Rregullore Bazë e Funksionimit të QSUNT dhe Udhëzimit Nr. 424 datë 10.05.2017 *“Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurës së përzgjedhjes dhe emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”*, i cili përcakton rregullat dhe procedurat për punësimin drejtuesve të shërbimeve spitalore në institucionet shëndetësore publike. Grupi i auditimit, auditori 8 (tetë) kontrata shërbimit për personel shefa shërbimit (mjekë–pedagogë), punonjës mjekësorë të korpusit akademik të Fakultetit të Mjekësisë, Universiteti Mjekësisë Tiranë, të cilët ofrojnë shërbim mjekësor në QSUNT, të cilët në pozicionin “Shef Shërbimi”, si më poshtë vijon:

Me shkresën Nr. 2700/2 prot, datë 02.12.2022, për mjekun z. A.Y. pranë Shërbimit të Sëmundjeve Infektive në Polin e Administrimit të Integruar të Spitalit Infektiv, si përgjegjës për monitorimin e punës në emërimin e përkohshëm të si përgjegjës për monitorimin e punës në Urgjencën e Shërbimit Infektiv. Struktura administrativo-mjekësore QSUT, Poli Administrimit të Integruar të Spitalit Infektiv PAI-8, në Urgjencën e Shërbimit Infektiv ka strukturë të plotësuar 100% për 2 mjek dhe 8 infermier, dhe nuk ka pozicion “Përgjegjës”.

Me shkresën Nr. 1842/2 prot, datë 20.07.2022, për mjekun z. A.Xh. pranë Njesisë së Radioterapisë dhe X-KNIFE në Polin e Administrimit të Integruar të Spitalit të Neuroshkencës, në pozicionin “Shef Shërbimi”, deri në përfundimin e përzgjedhjes së Shefit të Shërbimit në këtë pozicion pune.

Me shkresën Nr. 600 prot, datë 12.02.2021, për mjekun z. A.B. pranë Shërbimit të Kardiologjisë në Polin e Administrimit të Integruar të Spitalit të Sëmundjeve të Brendshme, në pozicionin “Shef Shërbimi”, deri në përfundimin e përzgjedhjes së shefit të shërbimit në këtë pozicion pune.

Me shkresën Nr. 3805/1 prot, datë 29.02.2020, për mjekun z. E.R. pranë Shërbimit Neurovaskular (Stroke dhe Post Stroke) në Polin e Administrimit të Integruar të Spitalit të Neuroshkencës, në pozicionin “Shef Shërbimi”, deri në përfundimin e përzgjedhjes së shefit të shërbimit në këtë pozicion pune.

Me shkresën Nr. 3515/2 prot, datë 24.10.2019, për mjekun z. A.T. pranë Shërbimit të Toksikologjisë Klinike në Polin e Administrimit të Integruar të Spitalit të Sëmundjeve të Brendshme, në pozicionin “Shef Shërbimi”, deri në përfundimin e përzgjedhjes së shefit të shërbimit në këtë pozicion pune.

Me shkresën Nr. 861/45 prot, datë 09.04.2019, për mjekun z. E.H. pranë Shërbimit të Urgjencave Polivalente në Polin e Administrimit të Integruar në Spitalin Polivalnet, në pozicionin “Shef Shërbimi”, deri në përfundimin e përzgjedhjes së shefit të shërbimit në këtë pozicion pune.

Me shkresën Nr. 861/43 prot, datë 09.04.2019, për mjekun z. A.J. pranë Shërbimit të Kirurgjisë Urologjike II në Polin e Administrimit të Integruar në Spitalin Polivalnet, në pozicionin “Shef Shërbimi”, deri në përfundimin e përzgjedhjes së shefit të shërbimit në këtë pozicion pune.

Me shkresën Nr. 861/44 prot, datë 09.04.2019, për mjekun z. A.Q. pranë Shërbimit të Kirurgjisë Maxilo Faciale në Polin e Administrimit të Integruar të Spitalit Francez, në pozicionin “Shef Shërbimi”, deri në përfundimin e përzgjedhjes së shefit të shërbimit në këtë pozicion pune.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua:

Në Statutin e QSUNT miratuar me urdhërin e Përbashkët të MSHMS dhe MASR Nr. 709, datë 10.10.2018, në paragrafin 24 “Procedurat e marrjes në punë” nuk janë amenduar procedurat e marrjes në punë drejtuesve të shërbimeve spitalore, në përputhje kriterëve të përcaktuara në VKM Nr. 424, datë 10.05.2017 *“Për përcaktimi i kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”*.

Procesi i përzgjedhjes së kandidaturave për shefat e shërbimeve spitalorë **8** vende vakant për shkak të ndërprerjes së parakohshme të mandatit të drejtuesit (dalje në pension ose vdekje) nuk është në përputhje me procedurën e përzgjedhjes së kandidaturave, pasi emërimi i përkohshëm

në detyrë është bërë nga Titullari i QSUNT dhe jo ministri i MSHMS dhe ministri i MARS, me shkresë të përbashkët, me shkresë të përbashkët të Ministri i MSHMS dhe Ministri i MARS, në mospërputhje me pikën 19 në VKM Nr. 424, datë 10.05.2017 *“Për përcaktimi i kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”*.

DBNJ në QSUNT nuk ka organizuar procesin e përzgjedhjes së drejtuesit të ri të shërbimit spitalor, brenda 6 muajve nga krijimi i vendit vakant, nga ushtrimi i së drejtës ushtrimit të detyrës të shef shërbimit spitalor me emërimit të përkohshëm në detyrë në 8 emërime të përkohshme, nga të cilat 3 emërime i përkasin datës 03.04.2019 (mandat i plotë 4 vjeçar) e drejta e ushtrimit të këtij funksioni bazuar të VKM 424/2017, në mospërputhje me pikën 19 në VKM Nr. 424, datë 10.05.2017 *“Për përcaktimi i kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”*. Me kërkesë të grupit të auditimit, QSUNT paraqiti dokumentacionin mbi konfliktin e interesit për pozicionin e punës *“Drejtuesit e shërbimeve”* për 36 raste. Nga dokumentacioni i paraqitur u konstatua se drejtuesit e shërbimeve kanë nënshkruar deklaratën *“Mbi Konfliktin e Interesit”*, sipas Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2015, neni 4, pika 1, germa “c” dhe “ç”, por të pashoqëruar me vërtetimin respektive të MSHMA, në mospërputhje me pikën 25.2 të Statutit të QSUNT miratuar me Urdhër të përbashkët ndërmjet MSHMS dhe MARS Nr. 709/2018, e cila kërkon:- *“Për të evituar konfliktin e mundshëm të interesave, shefat e shërbimit në QSUNT, nuk mund të jenë pjesë e organeve drejtuese në institucione shëndetësore private. Para emërimit të tyre, ata duhet të bëjnë pranë DBNJ deklaratën përkatëse të shoqëruar me vërtetim respektive nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.”*

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Statutin e QSUNT me paragrafin 19 të VKM Nr. 424, datë 10.05.2017 *“Për përcaktimi i kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”*, nga punonjësit:

znj. A.F. në cilësinë e Drejtor i Përgjithshëm në QSUNT për periudhën nga data 03.12.2022 deri 31.12.2022, z. E.J. në cilësinë e ish Drejtor i Përgjithshëm në QSUNT për periudhën nga data 01.04.2021 deri 30.11.2021, znj. A.V. në cilësinë e Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për periudhën nga data e emërimit 24.01.2022 e në vazhdim, znj. S.Z. në cilësinë e ish Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për periudhën nga 01.04.2022 deri 30.12.2021.

Personeli Mjek emërohet sipas Udhëzimit Nr. 499 dt..02.07.2019 *“Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në RSH nëpërmjet platformës elektronike”* (Fletore Zyrtare 109/2019). Udhëzimi ministrit të MSHMS Nr. 499, datë 02.07.2019 *“Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike”*, rregullon procedurat për punësimin e Mjekëve në institucionet shëndetësore publike, nëpërmjet portalit *“Mjeko për Shqipërinë”*.

Procedura punësimit sipas VKM 499/2019 kërkon identifikimin e vendeve vakant për mjek dhe dërgimin për shpalljen e vendeve të lira pranë DQOSHKSH e cila ka përgjegjësinë për ti publikuar në portalin *“Mjekë për Shqipërinë”*. Kandidatët e interesuar, regjistrohen në portal duke ngarkuar dokumentet e kërkuar dhe një kopje dërgohet në QSUNT me poste ose dorazi. Komisioni i vlerësimit vlerëson dokumentacionin e paraqitur dhe shpall emrat e kandidatëve që plotësojnë kriteret ja dërgon DQOSHKSH për publikim në portal *“Mjekë për Shqipërinë”* si dhe njofton për piket që ka marrë dhe vendin dhe datën e intervistës. Njëkohësisht njoftohen edhe kandidatët që nuk janë kualifikuar dhe shkaqet e mos kualifikimit dhe e drejta e ankimit. Në përfundim të procedurës Komisioni Vlerësimit pas intervistës, harton listën me piket totale për

çdo kandidat dhe brenda dy ditëve i njofton ata për rezultatin nëpërmjet postes elektronike si dhe të drejtën e ankimit.

QSUNT dokumenton procesin e zgjedhjes së vendeve të punës për çdo kandidat dhe raportin me mail dhe shkresë pranë DQOSHKSH dhe MSHMS për emërimet, refuzimet dhe mos konfirmimet e kandidatëve. Lista me emrin e fituesit publikohet nga DQOSHKSH në portalin “Mjekë për Shqipërinë”. Njësia e Burimeve Njerëzore në QSUNT është struktura përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të rekrutimit dhe hartimin dhe arkivimin e dokumentacionit përkatës. Lidhur me procedurën e emërimit grupi auditimit përzgjedhi për verifikim 10 dosje punësimi për personel mjek, për të cilat DBNJ paraqiti dosjet përkatëse së bashku me dokumentacion nga ku rezultoi se procedurën e pranimit dhe emërimit të personelit në QSUNT, nuk u konstatuan devijime nga procedura e përcaktuar në Udhëzimit Nr. 499 dt. 02.07.2019.

Nga auditimit u konstatua se:

Kuadri i brendshëm rregullator i procedurës së rekrutimit të personelit mjek në QSUNT, në Statutin e QSUNT miratuar me urdhrin të përbashkët të MSHMS dhe MARS Nr. 709/2018 (Statuti QSUNT) paragrafi 24 dhe Rregulloren Bazë të QSUNT, pika 2.5 “*Rregulla të përgjithshme të procedurës së punësimit për personelin mjekësor dhe administrativ*”, nuk përputhet me procedurën e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë me Udhëzim Nr. 499/2019 “*Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike*”, pasi procedura e rekrutimit referon në urdhrin e shfuqizuar të MSHMS Nr. 355, datë 18.08.2018 “*Për kriteret e punësimit të mjekëve në spitalet universitare*” dhe urdhrin Nr. 511, datë 13.12.2011 “*Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publik*”, (shfuqizuar) nuk përputhet me procedurën e Udhëzimit të Ministrisë të MSHMS Nr. 499, datë 02.07.2019 “*Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike*”.

Procedura e marrjes në punë të mjekëve- pedagog me status “personelit akademik”, bazohet në Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*” dhe Statutin e QSUNT Nr. 709/2018 dhe Rregulloren Bazë të QSUNT. Statutin e QSUNT miratuar me urdhrin e Përbashkët të MSHMS dhe MASR Nr. 709, datë 10. 10.2018, në procedurën e marrjes në punë të mjekëve “Pedagog”, në pikën 24.5 përcakton: - Pedagoget e ushtrojnë aktivitetin e tyre në bazë të një kontrate me QSUNT.

Kjo dispozitë ka gjetur zbatim nga DBNJ në QSUNT, për mjek personel akademik, të punësuar me kohë të plotë pranë Fakultetit të Mjekësisë, i cili angazhohet të ofrojë shërbimin mjekësor me kohë të pjesshme në shërbim spitalor në QSUNT, duke lidhur Kontratë së Shërbimit, bazuar në shkresën e Fakultetit të Mjekësisë mjeku- pedagog shërben me kohë të plotë.

Për spitalet universitare numri i përgjithshëm i mjekëve pedagog, miratohet nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bazuar në financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor sipas VKM përkatëse në çdo vit buxhetor, dhe nuk përshihet në numrin e përgjithshëm të punonjësve të QSUNT.

Konform këtij rregulli ministri i MSHMS me shkresën me Nr. 1579/1, datë 25.03.2016, protokolluar në QSUNT me Nr. 1151/1, datë 29.03.2016, ka miratuar lidhjen e kontratave të shërbimit për 160 mjekë pedagogë të cilët ofrojnë shërbim shëndetësor në QSUNT i cili është në fuqi edhe më miratimin e VKM 20/2021 dhe VKM 43/2022.

Numri faktik i mjekëve pedagogeve në QSUNT për vitin 2021 është 136 pedagoge dhe për vitin 2022 është 140 pedagogë. Pagesa e tyre bëhet nga buxheti dhe shpërblimit për orët e shërbimit

mjekësor jepet sipas kriterëve të VKM 555/2011, e ndryshuar, Lidhja 1.1, mbi cilat llogaritet dhe mbahet në burim mbi të ardhurat e përfituara nga shërbimi i ofruar.

Procedura e punësimit “Mjek Vullnetar”. Personeli “Mjek Vullnetar” në mbështetje të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.199 “Kodi Punës”, Rregullores së Brendshme të QSUNT, Urdhrit të Përbashkët Nr. 709/2018 (Statuti) , i ndryshuar, VKM 555, datë 11.08.2011 dhe Urdhrit Nr. 436, datë 18.09.2012 të Ministrit të Shëndetësisë, shefat e shërbimeve spitalore, paraqesin kërkesa për personel mjek për shërbim roje 24- orë, për nevoja të shërbimit të cilin ata drejtojnë, me emrin e mjekut të përzgjedhur nga ai vetë.

Kërkesa drejtohet titullarit të QSUNT dhe DBNJ, i cili me shkresë përcjellëse ja paraqet MSHMS për miratim, duke paraqitur nevojën e mbulimit të shërbimit roje 24 orë dhe propozuar miratimin e statusit “mjek vullnetar dhe lidhjen e akt marrëveshjes për ofrimin e shërbimit. MSHMS referuar kërkesës se QSUNT miraton ushtrimin e aktivitetit mjek vullnetar, pranë shërbimit shëndetësor që ka paraqitur kërkesën, bazuar në VKM Nr. 609, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të MSHMS”, miraton kërkesën e QSUNT duke aprovuar ushtrimin e aktivitetit si “Mjek Vullnetar për një periudhë ” për mjekun përkatës, periudhë e cila varijon nga 6 muaj deri në 1 vit. Titullari QSUNT merr vendim për lidhje kontrate me “Mjekun Vullnetar” për shërbim roje 24-ore për një periudhë 6-mujore ose 1-vjecare, përcaktuar në shkresën e MSHMS dhe lidh Akt- Marrëveshje e cila rregullon marrëdhëniet juridiko – financiare me ofruesin e shërbimit “mjeku vullnetar”. Grupi i auditimit përzgjedhi 8 raste të miratimit të mjekëve me status “Mjek vullnetar”, me qëllim mbulimin e shërbimit të mjekut të rojës 24-orë, pranë shërbimeve spitalore në QSUNT.

Nga auditimit u konstatua se:

QSUNT për mbulimin e shërbimit të roje 24-ore, bazuar në urdhrin e Ministrit të MSHMS Urdhër Nr. 145, datë 20.03.2013 “Për mbulimin e mjekut të rojës në QSUNT”, në kërkesën e paraqitur në MSHMS argumenton nevojat për mbulimin e këtij shërbimi.

Për mbulimin e shërbimit të mjekut të rojës në QSUNT, Ministri i MSHMS me Urdhër Nr. 145, datë 20.03.2013, ka urdhëruar sigurimin e këtij shërbimi duke përfshirë në këtë shërbim mjekët specializantë të vitit të tretë e lart si mjekët specializantë të viteve të para (si dublantë) dhe jo mjekë të pajisur me licencë për ushtrimin individual të profesionit miratuar nga Urdhri Mjekëve të Shqipërisë MSHMS aprovon statusin e mjekut vullnetar, në kundërshtim me fushën e përgjegjësisë shtetërore të përcaktuar në VKM Nr. 609, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të MSHMS”, i cili në fushat e përgjegjësisë nuk parashikon kompetencën e MSHMS për miratimit të ushtrimit të aktivitetit mjek vullnetar në shërbim spitalor. Statuti i QSUNT në pikën 24, dhe Rregullorja Bazë e QSUNT nuk përcakton rregull se si do të procedohet në përzgjedhjen e kërkesave për mbulimin e shërbimit 24-ore për mjek vullnetarë, të cilët gëzojnë licence për ushtrim aktiviteti nga Urdhri i Mjekut.

Praktikat e përzgjedhura nga grupi auditimit

Nr.	Emër	Mbiemër	Shërbimi	Profesioni	Marrëdhëniet Financiare	Përfundimi
1	D.	Gj.	Shërbimi i Hipertonisë dhe Mjekësisë Interne	Mjek vullnetar	16.06.2022	17.12.2022
2	F.	M.	Shërbimi i Kardiokirurgjisë	Mjek vullnetar	08.07.2022	08.07.2023
3	D.	P.	Shërbimi i Kardiokirurgjisë	Mjek vullnetar	08.07.2022	08.07.2023
4	M.	K.	Shërbimi i Okulistikës	Mjek vullnetar	19.10.2022	19.10.2023
5	M.	T.	Shërbimi i Psikiatrisë	Mjek vullnetar	20.10.2022	20.10.2023
6	G.	D.	Urgjenca e Sëmundjeve të Brendshme	Mjek vullnetar	20.10.2022	20.12.2022
7	Xh.	Gj.	Urgjenca e Sëmundjeve të Brendshme	Mjek vullnetar	04.11.2022	04.01.2023
8	D.	Gj.	Shërbimi i Hipertonisë dhe Mjekësisë Interne	Mjek vullnetar	17.12.2022	17.06.2023

Profesionistët shëndetësor, anëtar të Urdhrit të Infermierit, punësohen nëpërmjet platformës “Infermier për Shqipërinë”, sipas urdhrit të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Procedura për rekrutimit të personelit infermier bazohet Udhëzimin i Ministrit të MSHMS Nr. 481 dt..27.06.2019 "Për procedurat e punësimit për profesorët e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në RSH" i cili rregullon procedurat e punësimit të profesionistëve të shkencave mjekësore teknike në institucione shëndetësore publike , si dhe Statutit, Rregullores së Brendshme të QSUNT si dhe çdo Urdhër, Rregullore , Urdhëresë mbi bazën e të cilave rregullohet marrëdhënia e punës.

Shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve, si dhe emërimi në një vend të lirë pune realizohet nëpërmjet portalit “Infermierë për Shqipërinë”. Procedura e rekrutimit organizohet nga DRSJKSH Tirane. Thirrja për konkurrim shpallet sipas profileve të profesionisteve në përputhje kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi për ushtrimin e profesionit;DQOSHKSH-ja ka krijuar komisionet e vlerësimit dhe pas vlerësimit të dokumentacionin dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në DQOSHKSH dhe në MSHMS listën me pikët për çdo kandidat.

Komisioni i Vlerësimit pasi administron dosjet e kandidatëve, brenda dhjetë ditë pune pas përfundimit të afatit të pranimit të aplikimeve, vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe harton listën për çdo profil sipas çdo NJVKSH, renditja fillon me kandidatin me më shumë pikë dhe vijon në rend zbritës dhe i dërgon DQOSHKSH-së listën e përgatitur si më sipër, për ta publikuar në Portalin “Infermier për Shqipërinë”.

DQOSHKSH bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve totale, që nxirret nga shuma e pikëve të marra në vlerësimin e dosjes së aplikimit dhe pikëve të marra në testimin e informatizuar (Faza II). Rënditja fillon me kandidatin me më shumë pikë dhe vijon në rend zbritës. Lista publikohet në portalin “Infermierë për Shqipërinë”. DROSHKSH (Drejtoria Rajonale Tiranë) me mail dhe shkresë përcjellëse dërgon në QSUNT emërimin fituesve të shpallur në platformën “Infermiere për Shqipërinë”. Titullari i QSUNT merr vendim për lidhjen e marrëdhënieve të punës, pas marrjes së shkresës nga Drejtoria Rajonale Tiranë, dhe me Urdhër të Brendshëm vendos punonjësin në pozicionin përkatës të shërbimit spitalor dhe lidh kontratë individuale pune me afat të pacaktuar, pas kalimit të periudhës së provës (3 muaj).

Numri faktik i infermiereve më të cilët QSUNT ka lidhur kontratë pune në vitin 2021 është 1215 infermiereve dhe për vitin 2022 1207 infermiere. PAGESA e tyre bëhet nga buxheti dhe shpërblimit për orët e shërbimit mjekësor jepet sipas kriterëve të VKM 555/2011, e ndryshuar, Lidhja 1.1, mbi cilat llogaritet dhe mbahet në burim mbi të ardhurat e përfituara nga shërbimi i ofruar. Në lidhje me emërimet e reja për periudhën objekt auditimi, *u kërkuan me zgjedhje 5 dosje për kontratat individuale* Nr. 2471/1, dt.. 12.10.2022; Nr. 2472/2 dt.. 12.10.2022, Nr.2473/2 dt.. 12.10.2022; Nr. 2474/2, dt.. 12.10.2022; Nr. 2475/5, dt.. 12.10.2022 në pozicionin infermier të emëruar në tetor 2022. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dokumentacioni përgjithësisht ishte i plote, me mangësi të vogla si dokument fotokopje dokumente jo kryesor kryesisht për staf mbështetës.

Personel i përkohshëm: Bazuar në kërkesat e QSUNT, Ministria e Shëndetësisë me shkresat Nr. 5043/1 prot, datë 11.11.2020; me shkresë Nr. 3517/1 prot, datë 23.08.2021; me Urdhër të Ministrit të MSHMS Nr. 370, datë 25.08.2021, me shkresë Nr. 487/1, datë 21.02.202, më shkresë Nr. 3160/1, datë 15.08.2022, ka miratuar shfrytëzimin e vendeve vakante për punësim të përkohshëm për 30 (tridhjetë) punonjës, për një periudhë deri në 6 muaj, sipas nevojave të spitaleve Covid-19 dhe nevojave të tjera të strukturave të QSUNT.

Personeli Administrativ: DBNJ vlerëson në zbatim të strukturës së miratuar pozicionet vakante për personel administrativ të nivelit drejtues drejtorie, përgjegjës sektori dhe specialist në

strukturën administrative të QSUNT. Pozicionet e lira shpallen në faqen zyrtare të internetit (www.qsut.gov.al), në stendën e Zyrës së Informimit me Publikun në QSUT dhe në faqen zyrtare të shërbimeve të punësimit. Afati i njoftimit është 14 ditë kalendarike. Njoftimi përmban dokumentacionin e nevojshëm, kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët, vendin ku duhet të paraqitet, dokumentacionin si dhe afatin e njoftimit. Dokumentacioni, dosjet e aplikantëve dorëzohen në Zyrën e Informimit të Publikut sipas një formati i cili parashkruan të gjithë dokumentacionin në dosje të aplikantit dhe firmoset nga specialist i Zyrës së Informimit me Publikun dhe aplikanti. Pas përfundimit të afatit të aplikimit DBNJ shqyrton paraprakisht dosjet e kandidatëve duke kaluar dosjet të cilat plotësojnë kriteret e përcaktuara. DBNJ përcjell me anë të një Memo kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe harton Urdhrin mbi ngritjen e komisionit Ad Hoc për procedurën e shpallur duke njoftuar m ditën e kryerjes së vlerësimit, orën dhe vendin. Në përbërje të këtij komisioni është një punonjës i burimeve njerëzore, një drejtor drejtorie, specialist i Sektorit përkatës. DBNJ është struktura përgjegjëse për lajmërimin e aplikantëve për paraqitje. Më pas bëhet testimi i aplikantëve, fillimisht duke vlerësuar dosjet personale, si dhe vlerësimi me intervistë personale.

Largimet

Për periudhën 01.04.2021-31.12.2021, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 183 punonjësve, për arsyt e mëposhtme:

Largime nga QSUNT 01.04.2021-31.12.2021

ARSYEJA	LARGIME	%
Braktisje, mosparaqitje në vendin e punës	12	6.56%
Del në KEMP të plotë	5	2.73%
	42	22.95%
Del në pension		%
	83	45.36%
Me kërkesën e tij		%
Për mungesa të përsëritura dhe pa arsye në punë	10	5.46%
Ndërron jetë	3	1.64%
Pezullim i përkohshëm i spitaleve COVID	13	7.10%
Pamundësi për të zbatuar kontratën e punës (procedure)	3	1.64%
Punonjësi definitiv rikthehet leja e lindjes, raport i zgjatur	12	6.56%
Totali	183	

(Burimi: QSUNT)

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 269 punonjësve për arsyt e mëposhtme:

Largime 01.01.2022-31.12.2022

ARSYEJA	LARGIME	%
Braktisje e vendit të punës	8	2.97%
Del në KEMP të plotë	4	1.49%
Del në pension	61	22.68%
Me kërkesën e tij	148	55.02%
Për mungesa të përsëritura dhe pa arsye në punë	16	5.95%
Ndërron jetë	2	0.74%
Përfundon afati i kontratës	7	2.60%
Punonjësi definitiv rikthehet leja e lindjes, raport i zgjatur	22	8.18%
Njoftim largimi	1	0.37%
TOTALI	269	

(Burimi: QSUNT)

Për periudhën 01.04.2021-31.12. 2021, peshën specifike më të lartë e zënë largimet e punonjësve me kërkesën e tyre të cilat përbëjnë 45.36% të totalit të punonjësve të larguar. Në grup punonjësish të larguar me kërkesë individuale prej 83 punonjësish të larguar, 28 punonjës prej janë infermiere dhe 4 punonjës janë mjek dhe diferenca të tjerë. Për vitin 2022, peshën specifike më të lartë e zënë largimet e punonjësve me kërkesën e tyre të cilat përbëjnë 52.02% të totalit të punonjësve të larguar. Në grup punonjësish të larguar me kërkesë individuale prej 148 punonjësish të larguar, 68 punonjës prej janë infermiere dhe 10 punonjës janë mjek dhe diferenca të tjerë.

Vendimet Gjyqësore

Për vendosjen e marrëdhënies së punësimit punëdhënësi QSUNT lidh kontratë individuale pune me punëmarrësin, nëpërmjet të cilës palët pranojnë të respektojnë të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhëniet e punësimit në bazë të akteve ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës Ligji Nr. 7961, datë 12.05.1995 “Kodi i Punës”, Statuti Bazë i QSUNT, Rregullore e Brendshme e QSUNT, Kodi Etikës si dhe çdo urdhër, rregullore, urdhërese mbi bazën e të cilave rregullohet zbatimi i kontratës.

Çështjeve gjyqësore për ndërprerje të marrëdhënieve të punës 2021-2022

N r.	Paditës	I Paditur	Objekti	Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Tiranë	Ankim
1	B.H.	QSUNT	Dëmshpërblim 17 muaj page dhe 13 ditë page	Me vendimin Nr. 4246., datë 17.06.2021 gjykata ka vendosur pranimin e pjesshëm, dëmshpërblim 4 muaj page	Ankimuar
2	O.Ç.	QSUNT	Dëmshpërblim 1 vit e 6 muaj page dhe 6 ditë page	Me vendimin Nr. 1553 datë 29.03.2022 gjykata ka vendosur pranimin e pjesshëm, dëmshpërblim 13 muaj e 6 ditë page	Ankimuar
3	J.A.	QSUNT	Dëmshpërblim 1 vit page +vjetërsi pune	Me vendimin Nr.2811, datë29.04.2021 gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë	
4	L.H.	QSUNT	Shfuqizim vendimi për marrje mase disiplinore	Me vendimin Nr. 3534, datë 25.05.2021 gjykata ka vendosur pranimin e padisë	Ankimuar
5	I.H.	QSUNT	Dëmshpërblim 20.5 muaj page	Me vendimin Nr.5622, datë 11.11.2022 gjykata ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë duke I dhënë 7 paga mujore	Ankimuar
6	D.M.	QSUNT	Dëmshpërblim 1 vit page +vjetërsi pune 7 muaj	Me vendimi Nr. 334, datë 01.02.2023 gjykata ka vendosur pranimin e padisë duke I dhënë paditëses 19 paga mujore, si page referuese është marre paga e saj e fundit në vlerën 62.360 lekë	Ankimuar
7	Y.LI.	QSUNT	Dëmshpërblim 15 muaj page + 20 muaj page vjetërsi pune	Me vendimin Nr. 3888, datë 30.09.2020 Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë duke i dhënë 10 paga mujore +20 paga mujore për vjetërsi	Ankimuar
8	S.K.	QSUNT	Dëmshpërblim 17 muaj page + 6.5 muaj page vjetërsi pune	Në proces	
9	G.S.	QSUNT	Dëmshpërblim 5 muaj page+ 8.5 muaj paga për vjetërsi	Në proces	

(Burimi: Drejtoria Juridike në QSUNT)

Për periudhën objekt auditimi 01.04.2021deri 31.12.2022, për paditë e ngritura punëmarrësit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi QSUNT, në proces në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kanë qenë 9 çështje gjyqësore, duke kërkuar dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës nga punëmarrësi. Gjykata Administrative e Shkallës së Para nga 9 çështje gjyqësore ka vendosur pranimin e padisë për 5 çështje për të cilat QSUNT ka ushtruar e drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, ka vendosur rrëzimin e padisë në 1 çështje gjyqësore, dhe 2 çështje janë në proces gjykimi në këtë gjykatë.

Nga auditimi u konstatua se:

Ecuria e çështjeve gjyqësore në gjykatë, pavarësisht se vendimi nuk ka marrë formë të prerë pasi është ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit, gjykimi në themel i çështjeve nga gjykata tregon se punëdhënësi ka zgjidhur kontratën pa shkaqe të arsyeshme. Për pasojë punëdhënësit do ti lind detyrimi t'i japë punëmarrësit dëmshpërblim page që do ti shtohet pagës që ai duhet të merrte gjatë afatit të njoftimit, të cilat përveç anës sociale për punëmarrësin, përbejnë kosto shtesë për institucionin dhe për pasojë mungesë të eficiencës, efektivitetit dhe economicitet në përdorimit të fondeve publike.

Respektimi i dispozitave ligjore për pagat dhe shpërblimet e punonjësve.

Marrëdhëniet e pagave

Marrëdhëniet e punës në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza rregullohen nga Kodit të Punës miratuar me Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995, i ndryshuar, kontrata individuale të punës të lidhur me çdo punëmarrës. MSHMS dhe Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) më date 30.03.2021 ka lidhur “Kontrata Kolektive e Punës”, protokolluar në institucion me Nr. 1528/1 prot, datë 30.03.2021, me afat 3 vjet nga data e lidhjes se saj, duke e shtrire efektin për vitet 2021-2024. Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, bazohet në VKM Nr.555, datë 11.8.2011 “*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura*”, i ndryshuar. Sipas VKM Nr.555/2011 pagesa e punonjësve grupohet në:

Punonjës me pagë grupi si mjekë, specializante ,punonjës të urgjencës para spitalore, të cilët paguhen sipas VKM Nr. 555, datë 11.308.2011, Lidhja Nr.1, Kreu 1.1; Punonjës me pagë grupi infermierë, laborantë, mazokinesoterapeut, kujdestarë, të cilët paguhen sipas VKM Nr. 555, datë 11.308.2011, Lidhja Nr.2, Kreu 2.1; Punonjës me grada shkencore të cilët paguhen sipas VKM Nr. 555, datë 11.308.2011, Lidhja Nr.4; Punonjës të sistemit me klasa (operator, nëpunës informacioni, sanitar, teknik, llogaritar arke, sekretar, shofer, etj., të cilës paguhen sipas VKM Nr. 202, datë 15.03.2017. Grupi i auditimit ka kryer verifikimin e përlllogaritjes së pagës me të gjitha elementët e saj për një kampion prej 50 punonjësish, përzgjedhur nga listpagesat e punonjësve, borderotë e pagave dhe përmbledhëset mujore të pagave për muajt dhjetor 2021 dhe dhjetor 2022.

Llogaritja e pagave në QSUNT behet konform VKM Nr.555, datë 11.8.2011 “*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura*”, i ndryshuar; Listëprezencat e punonjësve janë dorëzuar rregullisht nga drejtorët, shefat e shërbimeve dhe përgjegjësit e sektorëve sipas varësisë.

Përlllogaritjet e dhënia e pagave janë kryer sipas bazës ligjore në fuqi. Listëpagesat e punonjësve ishin të rregullta e të përpiluara, sipas shërbimeve përkatëse në bazë të strukturës të miratuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe të plotësuar me gjithë ekstremitetet. Listëpagesat janë firmosur nga përgjegjësi i sektorit të pagave, përgjegjësi i sektorit të financës, drejtorit ekonomik dhe drejtori i përgjithshëm.

Pagat mujore të muajt dhjetor 2021 dhe dhjetor 2022, marrë si kampionim nga grupi i auditimit, rakordojnë me list pagesat dhe shumat neto të kaluara në bankë. Sektori Pagave ka zbatuar drejt Ligjin Nr. 7703, datë 11.05,1993 “*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*”, Ligjin Nr. 8438, datë 28.12,1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*”, i ndryshuar, si dhe UMF Nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*”. Ndalesat për sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe

tatimit mbi të ardhurat personale, janë derdhur rregullisht nga sektori i financës për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Nga auditimi i dokumentacionit sipërmendura nuk u konstatuan parregullsi në përlllogaritjen e elemeteve të pagës së punëmarrësit. Përmbledhëset mujore të listëpagesave të punonjësve, borderotë e pagave, numri i punonjësve dhe fondi i pagave paraqitet në tabelën si më poshtë vijon:

Numri i punonjësve dhe pagat e personelit të përhershëm, për vitin 2021 (në mijë lekë)

Viti 2021	Nr. Punonjësve (Fakt)	Paga të personelit të përhershëm	Paga baze	Raporte mjekësore të paguara nga punëdhënësi	Shtese page për vjetërsi në pune	Shtese page për turne të dyta e të treta	Shtesa page të tjera (mjek roje)
Janar	2,862	190,032	170,673	543	527	5,820	12,470
Shkurt	2,850	224,828	203,821	479	727	5,851	13,950
Mars	2,845	221,805	202,270	769	627	5,532	12,608
Prill	2,787	223,410	201,892	705	686	5,841	14,286
Maj	2,774	217,558	197,737	662	851	5,498	12,811
Qershor	2,862	214,575	195,734	515	160	5,530	12,636
Korrik	2,847	215,439	197,198	994	313	5,279	11,655
Gusht	2,863	211,063	193,030	832	87	5,205	11,910
Shtator	2,863	212,126	193,424	869	231	5,128	12,475
Tetor	2,852	215,485	195,974	1,223	351	5,337	12,600
Nëntor	2,852	212,338	192,131	1,588	168	5,489	12,961
Dhjetor	2,861	217,639	198,149	1,297	196	5,259	12,738
		2,576,297	2,342,031	10,474	4,924	65,768	153,099

(Burimi: QSUNT)

Numri i punonjësve dhe pagat e personelit të përhershëm për vitin 2022 (në mijë lekë)

Viti 2021	Numri Punonjësve (Fakt)	Paga të personelit të përhershëm	Paga baze	Raporte mjekësore të paguara nga punëdhënësi	Shtese page për vjetërsi në pune	Shtese page për turne të dyta e të treta	Shtesa page të tjera (mjek roje)
Janar	2,904	347,728	307,558	1,388	4,758	10,587	23,438
Shkurt	2,904	209,475	185,276	836	2,866	6,378	14,119
Mars	2,902	266,855	236,027	1,065	3,651	8,125	17,987
Prill	2,882	266,855	236,027	1,065	3,651	8,125	17,987
Maj	2,951	224,960	198,972	898	3,078	6,849	15,163
Qershor	2,834	224,960	198,972	898	3,078	6,849	15,163
Korrik	2,823	224,960	198,972	898	3,078	6,849	15,163
Gusht	2,795	224,960	198,972	898	3,078	6,849	15,163
Shtator	2,801	189,468	167,580	756	2,592	5,769	12,771
Tetor	2,798	197,847	174,991	790	2,707	6,024	13,335
Nëntor	2,794	143,763	127,155	574	1,967	4,377	9,690
Dhjetor	2,790	63,525	56,187	254	869	1,934	4,282
TOTALI		2,585,354	2,286,690	10,320	35,372	78,713	174,258

(Burimi: QSUNT)

Paga bazë përfshin pagën e grupit dhe shtesat për vjetërsi, kualifikim, pozicion e kushte pune. Shtesat mbi pagën janë të përcaktuara në VKM Nr.555, datë 11.8.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura”, i ndryshuar. Sa më sipër nga auditimi listpagesave të punonjësve, borderove të pagave dhe përmbledhëset mujore të pagave, për 50 punonjës të kampionuar për muajin dhjetor 2021 dhe dhjetor 2022, rezultoi se për periudhën objekt auditimi janë zbatuar drejt aktet ligjore dhe nënligjore në llogaritjen e pagave, mbajtjen dhe derdhjen e kontributeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga paga. Për llogaritjen e pagës mujore të personelit punonjësit e Sektorit të Pagave përdorin librat e pagave dhe si dhe dokumentacioni

shkresor i përcjellë nga DBNJ për punonjësit e shërbimet spitalore dhe administratës. Llogaritja e pagës kryhet në program Excel të krijuara nga eksperiencia e shumë vjeçare në punës, sipas elementëve të pagës si paga bazë, shtesë për pozicion pune, kushtet e punës, vështirësi pune, vjetërsi, përlllogaritje e cila mbart risk në saktësinë e llogaritjes se elementeve të pagës, sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga paga. Sektori i pagave mban dhe plotëson e regjistrin e indeksit si dhe regjistrat themeltarë të punonjësve të QSUT. Por regjistri themeltar i punonjësve të QSUNT nuk plotësohet sipas gjithë rubrikave që përmban formati i regjistrin që përdoret në QSUNT, pasi në të mungojnë të hedhura të dhëna mbi pagën vjetore, dite pune të punuara gjate vitit, arsimi profesional, arsimi përgjithshëm profesioni, shkalla e kualifikimit etj.

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e pagave me elementët e përbërës të saj QSUNT nuk ka mundësuar implementimin dhe përdorimin e Sistemit Informatikë të menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS), sipas dispozitave të VKM Nr. 833, datë 28.10.2020 *“Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrin qendror të personelit”* nëpërmjet përdorimit të Regjistrin Qendror të Personelit të administruar nga DAP, situatë e cila do të lehtësonte procesin e përlllogaritjes së pagës mujore dhe do të japë siguri lidhur me saktësinë dhe përditësimin e të dhënave lidhur elementet e saj. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka sjellë për përdorim modul për llogaritjen e pagave, për tu përdorur nga punonjësit përkatës, por ai nuk është efektiv, nuk është i certifikuar dhe në praktikë në disa raste nuk jep rezultat të saktë p.sh. për raporte mjekësore, tatim mbi page, etj. Drejtoria Ekonomike për kontabilizimin e transaksioneve financiare përdor sistemin financiar *“Alpha Buxhetor”* i cili si program financiar përmban një modul për hedhjen dhe kontabilizimin e pagave dhe nuk përdoret nga Sektori i Pagave.

Mbajtja dhe llogaritjes manuale e pagës dhe ndalesave, e regjistrin themeltar të punonjësve, e hedhjes së të dhënave në Librin e Pagave, rrit rrezikun për gabim njerëzor në përlllogaritjen, derdhjen e kontributeve dhe tatimit mbi të ardhura nga paga, mbajtjen, regjistrimin dhe administrim të dhënave të dhënave të pagave dhe kohën e marrëdhënies të punonjësit që punëmarrësit që kanë qenë punonjës të institucionit. Me ngritjen e sistemeve të informatizuar, krijimi i një moduli për menaxhimin e pagave dhe burimeve njerëzore, ose përdorimi i programit *“Alpha Buxhetor”* që përdoret nga Sektori i Financës, ose implementimi i Regjistrin Qendror të Personelit (disponuar nga DAP) do të kursente kohë dhe burime njerëzore, duke gjurmuar në çdo kohë të dhëna të sakta mbi marrëdhëniet e punësimit si për punëdhënësin dhe për punëmarrësin. Pagat janë kontabilizuar në librin e pagave dhe librin e madh. Urdhër Shpenzimi për kalimin e pagës neto në bankë rakordon listpagesat mujore për llogaritjen e pagës së punonjësve. Me Urdhrin e Brendshëm Nr. 271, datë 27.08.20214 *“Për plotësimin dhe dorëzimin e Listë-Prezencave të personelit të QSUT”*, ndryshuar me urdhrin Nr. 322, datë 28.10.2019, Drejtori i përgjithshëm i QSUNT ka urdhëruar që liste prezencat mujore duhet të dorëzohen pranë DBNJ brenda orarit të punës të datës 01 të çdo muaji. Kontrata Kolektive e Punës datë 30.03.2021, protokolluar në Institucion me Nr. 1528/1 prot, datë 30.03.2021, në nenin 15 pika 12 përcakton se *“Paga iu jepet në monedhë shqiptare, në rrugë bankare, për çdo muaj deri në datën 10 të muajit pasardhës.”*.

Kontrata individuale e punës datën përgjithësisht e përcakton jo më vonë se data 13 e çdo muaji. Në përfundim të procesit të kontrollit të liste prezencave nga DBNJ dhe Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit Financiar ka detyrim të kalojnë pagën mujore në llogarinë e punëmarrësit jo më vonë se data 13 e çdo muaji.

Nga auditimi u konstatua se:

Transaksionet bankare pagat e muajit janar 2021 janë kaluar në bankë në datë 11.02.2021, të muajit shkurt kaluar në datë 11.03.2021, pagat e prillit kaluar në 11.05.2021, pagat e muajit korrik kaluar në 11.08.2021 dhe pagat e muajit dhjetor 2020 kaluar në 17.01.2021. Për vitin 2022 pagesa e pagës për muajin shtator është kryer në datë 11.10.2022 dhe pagesat e pagës për muajin dhjetor 2022 u krye në datë 19.01.2023. Mos kryerja e pagesës së pagave të muajit dhjetor për punonjësit e QSUNT, vjen mungesë të fondeve buxhetore, akorduar me vonesë nga MSHMS pas miratimit të VKM Nr. 23, datë 18.01.2023 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2023”. QSUNT ka çelur llogaritë përkatëse në Degën e Thesarit Tiranë pas shkresës së FSDKSH Nr. 386/1 prot, datë 31.01.2023, duke financuar shërbimeve spitalore për vitin 2023, miratuar me Urdhër të Brendshëm Nr. 97, datë 08.02.2023 të fondeve të akorduar për llogarinë 600, 601 dhe 602.

Mungesa e fondeve buxhetore nuk është përgjegjësi e QSUNT, por kryerja e shpenzimeve për pagat neto për administratën dhe shërbimi shëndetësor pas datës 10 të muajit pasardhës, cenon kontratën individuale të punës ose shërbimit që palët kanë nënshkruar me QSUNT, shkel të drejtat e punëmarrësve dhe konsiderohet shkelje e nenit 15 pika 12 të Kontratës Kolektive të Punës, si dhe dispozitës përkatëse Kontratën Individuale të Punësimit ose Kontratën e Shërbimit.

Shpërblimet

VKM Nr.207, datë 10.3.2020 “Për dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë”, ka përcaktuar dhënien e shpërblimit mujor për personelin mjekësor, specialistë të shëndetit publik që merren me epidemiologjinë, infermierë dhe specialistë të shërbimit laboratorik, të angazhuar në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, si dhe për personelin mbështetës, të angazhuar në institucionet ku trajtohen personat e prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19. Shpërblimet janë dhënë në bazë të ditëve të angazhimit në punë, ku personeli mjekësor do të shpërblehet në masën 125,000 lekë, dhe personeli mbështetës në masën 65,000 lekë. VKM Nr. 40, datë 19.01.2022, ndryshoi piken 4 VKM Nr.207, datë 10.3.2020 “Për dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë”, duke sjelle ndryshime procedurën e përfitimit të shërbimit. Vendimi Nr. 40, i shtrin efektet nga data 01 janar 2022 duke i dhënë efekt prapaveprues.

Shpërblimet e dhëna dhe ditët e angazhimit në punë për stafin mjekësor, infermieror si dhe punonjësit e tjerë të shërbimit shëndetësor që janë angazhuar për trajtimin e personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19 jepen në tabelën e mëposhtme.

Shpërblime personeli për angazhim COVID për vitin 2021

(në lekë)

Nr.	Viti 2021	Nr. Punonjësve / angazhim për COVID			Dite pune / angazhim për COVID			Shpërblimet		
		Mjek, specialistë të shëndetit publik që merren me epidemiologjinë, infermierë dhe specialistë të shërbimit laboratorik	Personeli mbështetës, i angazhuar në institucionet ku trajtohen personat e prekur (shofer/sanitar)	TOTALI	Mjek, specialistë të shëndetit publik që merren me epidemiologjinë, infermierë dhe specialistë të shërbimit laboratorik	Personeli mbështetës, i angazhuar në institucionet ku trajtohen personat e prekur (shofer/sanitar)	TOTALI	Mjek, specialistë të shëndetit publik që merren me epidemiologjinë, infermierë dhe specialistë të shërbimit laboratorik	Personeli mbështetës, i angazhuar në institucionet ku trajtohen personat e prekur (shofer/sanitar)	Totali
1	Mars	596	203	799	11,790	3,733	15,523	64,375,000	10,653,217	75,028,217
2	Prill	561	194	755	8,783	3,027	11,810	50,096,590	9,005,455	59,102,045
3	Maj	406	125	531	5,317	1,831	7,148	31,967,721	5,727,381	37,695,102
4	Qershor	170	51	221	2,273	51	2,324	10,316,288	1,480,227	11,796,515
5	Korrik	136	35	171	1,543	460	2,003	8,767,045	1,359,091	10,126,136
6	Gusht	210	75	285	2,800	1,039	3,839	15,909,091	3,069,773	18,978,864
7	Shtator	352	61	413	5,154	997	6,151	29,285,714	2,945,682	32,231,396
8	Tetor	350	69	419	5,849	1,159	7,008	34,815,476	3,584,286	38,399,762
9	Nëntor	328	67	395	5,624	1,113	6,737	31,954,546	3,288,409	35,242,955

10	Dhjetor	321	64	385	5,821	1,175	6,996	31,635,870	3,320,652	34,956,522
TOTALI		3,019	944	4,374	54,954	14,585	69,539	309,123,341	44,434,173	353,557,514

(Burimi: QSUNT)

Shpërblime personeli për angazhim COVID për vitin 2022

(në lekë)

Nr.	Viti 2022	Nr. Punonjësve / angazhim për COVID			Dite pune / angazhim për COVID			Shpërblimet		
		Mjek, specialistë të shëndetit publik që merren me epidemiologjinë, infermierë dhe specialistë të shërbimit laboratorik	Personeli mbështetës, i angazhuar në institucionet ku trajtohen personat e prekur (shofer/sanitar)	Totale	Mjek, specialistë të shëndetit publik që merren me epidemiologjinë, infermierë dhe specialistë të shërbimit laboratorik	Personeli mbështetës, i angazhuar në institucionet ku trajtohen personat e prekur (shofer/sanitar)	Totale	Mjek, specialistë të shëndetit publik që merren me epidemiologjinë infermierë dhe specialistë të shërbimit laboratorik	Personeli mbështetës, i angazhuar në institucionet ku trajtohen personat e prekur (shofer/sanitar)	Totale
1	Janar	313	57	370	5,178	971	6,149	30,821,429	3,005,476	33,826,905
2	Shkurt	313	58	371	4,980	959	5,939	31,125,000	3,116,750	34,241,750
TOTALI 2022		626	115	741	10,158	1,930	12,088	61,946,429	6,122,226	68,068,655

(Burimi: QSUNT)

Grupi auditimit përzgjedhi për verifikim pagesën e shërbimit për muajin shkurt 2022, për efektet e zbatimit të VKM Nr. 40/2022.

Nga auditimi u konstatua se:

Sektori i Pagave ka vlerësuar listës emërore të përfituesve, sipas ditëve të angazhimit dhënien e shpërblimit për muajin Nëntor 2021 paguar në Dhjetor 2021 në shumën 35,242,955 lekë për 395 punonjës miratuar nga ministri MSHMS Urdhër Nr. 560, datë 22.12.2021, në përputhje me kërkesat e VKM 207/2020. Shërbimi Infektiv me shkresën Nr. 362, date 22.07.2022 ka dërguar listën e stafit të shërbimit shëndetësor të angazhuar për pacientët e hospitalizuar në muajin shkurt 2022. Lista është verifikuar nga DBNJ për ditët e punës sipas liste prezencës mujore. Me shkresën Nr. 125/32, datë 30.03.2022 QSUNT ka dërguar për miratim në MSHMS listën e plotë të për 382 punonjës . MSHMS me Urdhër Nr.431, datë 21.07.2022, protokolluar me Nr. 125/64, datë 21.07.2022, ka miratuar dhënien e shpërblimit për muajin shkurt 2022 sipas listës së miratuar nga QSUNT.

Ndryshimi i VKM 207/2020 me VKM Nr. 40, datë 19.01.2022, për piken 4 VKM Nr.207, datë 10.3.2020 “Për dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë”, solli ndryshime procedurën e përfitimit të shërbimit. VKM Nr. 40/2022 përcakton se shpërblimi i vlerësimit do të vlerësohet nga një Sekretariati i ngritur në MSHMS për përbërje 2 përfaqësues nga MSHMS, 1 përfaqësues nga ISHP. 1 përfaqësues nga OSHKSH, 1 përfaqësues nga FSDKSH,. Vendimi Nr. 40, i shtrin efektet nga data 01 janar 2022. MSHMS ka ngritur Sekretariati me Vendim Nr. 2, datë 21.07.2022 , i cili ka vendosur përfitimin e shpërblimit të muajit shkurt 2022 sipas listës emërore të miratuar nga QSUNT. Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit Financiar me shkresë Nr. 126/70, datë 02.08.2022 nuk ka përfshirë në listën e përfituesve 11 punonjës me pozicion pune laborante, fizioterapisë, psikologe, oksigjeniste. Përfundimisht Sektori i Pagave ka llogaritur shpërblimin për muajin Shkurt 2022 sipas listë pagesës së muajit Gusht 2022 për 371 punonjës në shumën 34,241,750 lekë, miratuar nga Sekretariati i MSHMS me vendim Nr. 2, datë 21.07.2022 dhe shkresës së QSUNT Nr. 126/70 prot, datë 02.08.2022 në zbatim të saj, në përputhje me kërkesat e VKM 40/2022/.

Emërim i përgjegjësit të sektorit të Auditit të Brendshëm

Me vendim Nr. 245, date 01.07.2021 të E.J. me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm është emëruar E. S. Ç. në detyrën e përgjegjësit të sektorit të Auditit të Brendshëm. Kontrata individuale e punës është lidhur më datë 01.07.2021, hynë në fuqi në datën e lidhjes së kësaj kontrate dhe është me afat(periudhë) të pa caktuar, me pagë grupi në vlerën 10,000 lekë, mastër profesional 14,000 lekë dhe vjetërsia në punë 2 %. Kontrata është e firmosur nga E.J. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm në cilësinë e punëdhënësit dhe E. S. Ç. në cilësinë e punëmarrësit. Baza ligjore e

përcaktuare në vendim mbi të cilën është bërë emërimi është Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës I Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr. 555, datë 11.08.2011, i ndryshuar, Vendimi i Bordit Drejtues Nr. 7, datë 21.09.2015 “Për miratimin e Rregullores të funksionimit të QSUT” , Vendimi i Bordit Drejtues Nr. 3, datë 05.02.2020, Vendimi i Bordit Drejtues Nr. 1, datë 24.03.2021, si dhe bazuar në procesverbalin e datës 29.06.2021, Nr.1264/3 prot., të ngritur me Vendim Nr. 340, datë 28.06.2021, Vendimi Qarkullues i Bordit Drejtues Nr. 5, datë 17.07.2020. Në këtë bazë ligjore nuk është përcaktuar dispozita ligjore specifike për këtë pozicion pune, që është Ligji Nr. 12/2023 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

- Për këtë pozicion pune:

Mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimit dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore.

-Nuk është bërë deklarimi për vende të lira pune në Zyrën e Punësimit Tiranë, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në këtë pozicionet pune (përgjegjës i sektorit të auditit).

-Mungon dokumentacioni i kërkuar nga QSUNT, që kandidati/kandidatët të plotësojnë kushtet për pozicionin e punës përgjegjës i sektorit të auditit të brendshëm. Referuar dosjes personale, e punësuar E. S. Ç. nuk ka certifikatën e “Auditues i brendshëm në sektorin publik” të lëshuar nga Ministria e Financave dhe përvojën 5-vjeçare për të Referuar dosjes personale, librezë e punës në pozicionet e punës ku ka punuar, pasqyron vetëm juriste, vërtetimi i lëshuar nga shoqëria “Progres 2013”, më datë 05.12.2020, ku është shprehur në ligjëratë të drejt “Vërtetohet se znj. E.Ç” është e punësuar pranë shoqërisë tonë për periudhën mars 2013 deri në nëntor 2020, me detyrë “Përgjegjëse e Departamentit Ligjor” por njëkohësisht merret edhe me ndjekjen e procedurave të auditit të brendshëm për interes të shoqërisë në bashkëpunimin me departamentin e financës”, vërtetimi i cili bie ndesh me librezën e punës, e cila ka të përcaktuar se puna e kryer në këtë shoqëri është administratore dhe juriste. Certifikata e lëshuar nga Instituti i Ekspertëve Fiskal, me Nr. Amze AB 289, datë 19.03.2022 “Ku cilësohet” Bazuar në diplomën Universitare dhe në programin e formimit profesional për Audit të Brendshme, është dokument që bie ndesh me ligjin e auditit të Brendshëm. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 12/2023 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”:

- Neni 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në nenin 4 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 7 ndryshohet si më poshtë: “7. “Auditues i brendshëm” është profesionisti, i cili është i certifikuar dhe regjistruar si i tillë, si dhe ka ndjekur trajnimin e vazhdueshëm profesional sipas kërkesave të këtij ligji”.

Neni 3, Në nenin 11 bëhen këto ndryshime dhe shtesa e mëposhtme: 1. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime: a) në shkronjën “a” fjalët “diplomë universitare të nivelit të dytë” zëvendësohen me fjalët “diplomë të arsimit të lartë të ciklit të dytë të studimeve”. b) shkronjat “b”, “c” dhe “ç” ndryshohen si më poshtë: “b) drejtuesi i njësisë së Auditimit të Brendshëm duhet të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion, nga të cilat jo më pak se 3 vjet në fushën e auditimit, dhe të jetë i certifikuar si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”.

Titulli i Gjetjes Nr.1	Mungesa e Rregullores në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe rënie e punësimeve
Situata:	Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk ka një rregullore të saj si Drejtori e Burimeve Njerëzore në të cilin në të cilat përcaktohen objekti i punës, detyrat, struktura dhe detyrat funksionale të çdo punonjësi, kërkesë kjo e

	<p>paragrafit 2.2 të Rregullores Bazë të QSUNT.</p> <p>Plotësimi i vendeve vakant në QSUNT sipas strukturës administrative dhe e shërbimeve mjekësore, krahasuar me numrin e të punësuarve rezultojn më mosrealizim, në fund të vitit 2021 rezultojn me 165 vende vakante ose realizim 94.53% dhe për vitin 2022 rezultojn me 259 vende vakante ose realizim në masën 91.42%. Referuar të dhënave statistikore të QSUNT, konstatohet numri i të punësuarve ka pësuar rënie të vazhdueshme nga 3-mujori II-të 2021 deri në 3-mujorin e IV të vitit 2022, <u>duke arritur numrin më të ulët prej 2,759 punonjësish në 3-mujorin e IV 2022 të kundrejt 3017 punonjës të miratuar</u>. Përsa i përket plotësimit të strukturës së miratuar me personel “Mjek” dhe “Infermier”, konstatohet se struktura organike për personel “Mjek” planifikuar për 386 vende, rezultojn e plotësuar deri në 318 vende ose për 68 vende vakant, dhe personel “Infermier” ka planifikuar në strukturë 1250 vende pune, plotësuar deri në 1207 vende ose 33 vende vakant. Mungesat e stafit të specializuar mjekësor, rrisin rrezikun për t’ju përgjigjur plotësisht dhënies cilësore të shërbimit mjekësor të specializuar terciare pranë këtij institucioni.</p>
Kriteri:	Rregullores Bazë të QSUNT, paragrafi 2.2 Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së 60 Shqipërisë” i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Mungesat e stafit të specializuar mjekësor, rrisin rrezikun për t’ju përgjigjur plotësisht dhënies cilësore të shërbimit mjekësor të specializuar terciare pranë këtij institucioni.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur institucionale në ushtrimin e përgjegjësive në menaxhimin e burimeve njerëzore. Rënia e interesit të personelit mjekësor për punësim në QSUNT.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	-Strukturat përkatëse në QSUNT të marrin masa për hartimin dhe miratimin nga bordi drejtues i spitalit të rregullores së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore mbështetur në rregulloren bazë të institucionit, me qëllim mbarëvajtjen e punës për funksionimin sa më të mirë të strukturës përkatëse. -QSUNT bazuar në fondet buxhetore dhe të ardhurat dytësore, për shërbimet e ofruara nga personeli mjekësor në bazë të indikatorëve performancës, të shqyrtojë mundësinë e hartimit të një rregulloreje të posaçme për shpërblimin e tyre në funksion të nxitjes dhe rritjes së interesit për punësim.

Titulli i Gjetjes Nr.2	Vlerësim vjetor i performancës së punës së punonjësve të QSUNT
Situata:	Vlerësimi i punës për vitin 2022 është kryer pas daljes Urdhrit të Brendshëm Nr.179, datë 30.03.2023 dhe jo brenda vitit kalendarik, në mospërputhje me Statutin e QSUNT Nr.709/2018, pika 23.3, germa “dh” sipas të cilit dosja e të punësuarit duhet të përmbajë citojmë “Vlerësimin e punës që bëhet në fund të çdo viti”. Në zbatim të statutit Titullari në pikën 2 të Urdhrit të Brendshëm Nr. 179, datë 30.03.2023, ka përcaktuar:

	<p>“Formulari i vlerësimit të stafit të sipërcituar do të plotësohet 1 (një) herë në vit. Ky formular depozitohet pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe ruhet në dosjen e punëmarrësit”. Urdhri i Brendshëm Nr. 179, datë 30.03.2023, nuk përcakton një afat të vlerësimit të performancës vjetore dhe mungon shkalla hierarkike e vlerësimit nga miratimi nga eprori i drejtpërdrejtë deri tek aprovimi nga Drejtori i Përgjithshëm, si Titullari më i lartë ekzekutiv, drejtues, organizues dhe kontrollues i të gjithë veprimtarisë, konform Statutit dhe rregulloreve të brendshme të Q.S.U.T.</p> <p>Në dosjet e përzgjedhura dokumentacioni i administruar është konform kërkesave të VKM 833/2020. Por DBNJ nuk ka rifreskuar “Fletën prezantuese” të dosjes sipas kriterëve të VKM Nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, por vazhdon të administrojë dhe mbajë dosjet e personelit sipas kërkesave të pikës 23 të Statutit të QSUNT-së. Konkretisht fleta e përmbledhjes së dokumenteve në dosje është e ndryshme nga fleta inventari e dosjes së të punësuarit (lidhja 2) kriter i VKM Nr. 833/2020. Fleta aktuale nuk përmban të dhëna si: Informacion lidhur me të punësuarin si numër personal, datëlindje, certifikate personale/ familjare, etj.; nuk përmban të dhëna mbi vendbanim të përkohshëm dhe të përhershëm; informacion lidhur me arsimin, informacion lidhur me grada/titull shkencor; informacion mbi gjuhët e huaja; informacion mbi masat disiplinore, veprime këto në mospërputhje me kërkesat e VKM Nr. 833/2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.</p>
Kriteri:	Statutin e QSUNT Nr.709/2018, VKM Nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.
Ndikimi/Efekti:	Risk për vendimmarrje të gabuara.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur institucionale.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandime:	<p>-Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa që vlerësimet vjetore të performancës në punë të punonjësve të bëhen brenda një afati të paracaktuar nga titullari dhe sipas shkallës hierarkike të vlerësimit nga miratimi nga eprori drejtpërdrejt deri tek aprovimi nga drejtori i Përgjithshëm.</p> <p>-Të ndryshojë “Fletën prezantuese” të dosjes sipas kriterëve të VKM Nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.</p>
Titulli i Gjetjes Nr.3	Mospërputhje mes kontratës kolektive dhe kontratës individuale në lidhje datën e përfitimit të pagës së punëmarrësit
Situata:	Kontrata individuale e punës për punëmarrësin nuk ka të përcaktuar datën të saktë të dhënies së pagës ose në kontratat e reja të vitit 2022 është përcaktuar si “jo në vone se data 13 e muajit paraardhës”. Kjo

	<p>marrëdhënie kontraktuale punësimi, bie ndesh me kërkesat e nenit 21 pika 3 germa “j” të Kodit të Punës sipas të cilës kontrata e punës e lidhur me shkrim duhet të përmbajë sidomos elementet përbërës të pagës dhe datën e dhënies së saj”, si dhe nenin 15 pika 12 të Kontratës Kolektive të Punës Nr. 1528/1, datë 30.03.2021 e cila përcakton se “Paga jepet në monedhë shqiptare, në rrugë bankare, për çdo muaj deri në datën 10 të muajit paraardhës”; Kontrata individuale të punës deri në dhjetor 2022 nuk përcakton kontratës kolektive në fuqi me ekstremitet e saj (numri, data) por përmban fjalët “Kontrata Kolektive”, veprime në kundërshtim me nenin 21 pika 3 germa “j” të Kodit të Punës, sipas të cilit “kontrata e punës duhet të përmbajë dhe kontratën kolektive në fuqi”. Për punëmarrësit “punonjës social” me <i>inicialet S.K. dhe E.Z.</i> mungon leja e ushtrimit të profesionit të punonjësit social, sipas kërkesave të nenit 8 pika 1 të Ligjit Nr. 163/2014 “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”.</p>
Kriteri:	<p>Kodi Punës Kontratës Kolektive të Punës Nr. 1528/1, datë 30.03.2021 Ligjit Nr. 163/2014 “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”</p>
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos menaxhimin e duhur të burimeve njerëzore.
Shkaku:	<i>Mos funksionimi i</i> Urdhrit të Punonjësve Social sipas kërkesave të Ligjit Nr. 163/2014 “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”, për pajisjen me leje ushtrimi profesioni të sociologut.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandime:	<p>-Nga Organet Drejtuese të QSUNT të merren masa për të bërë unifikimin e kontratës kolektive me kontratën individuale të punës në lidhje me përcaktimin e datës e së dhënies së saj. -Për punonjësit social në dosjen e të cilëve mungon leja e ushtrimit të profesionit të punonjësit social, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për pajisjen me licencë për ushtrimin individual të profesionit të punonjësit social të lëshuar nga Urdhri i Punonjësve Socialë.</p>

Titulli i Gjetjes Nr.4	Mos likuidim ne kohe i pagave te punonjësve
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e pagave me elementët e përbërës të saj QSUNT nuk ka mundur implementimin dhe përdorimin e Sistemit Informatikë të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS), sipas dispozitave të VKM Nr. 833, datë 28.10.2020 “<i>Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit</i>” nëpërmjet përdorimit të Regjistrit Qendror të Personelit të administruar nga DAP, situatë e cila do të lehtësonte procesin e përlllogaritjes së pagës mujore dhe do të japë siguri lidhur me saktësinë dhe përditësimin e të dhënave lidhur elementet e saj.</p> <p>Transaksionet bankare pagat e muajit janar 2021 janë kaluar në bankë në datë 11.02.2021, të muajit shkurt kaluar në datë 11.03.2021, pagat e prillit kaluar në 11.05.2021, pagat e muajit korrik kaluar në 11.08.2021</p>

	<p>dhe pagat e muajit dhjetor 2020 kaluar në 17.01.2021. Për vitin 2022 pagesa e pagës për muajin shtator është kryer në datë 11.10.2022 dhe pagesat e pagës për muajin dhjetor 2022 u krye në datë 19.01.2023. Mos kryerja e pagesës së pagave të muajit dhjetor për punonjësit e QSUNT, vjen mungesë të fondeve buxhetore, akorduar me vonesë nga MSHMS pas miratimit të VKM Nr. 23, datë 18.01.2023 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2023”.</p> <p>Transaksionet bankare të kalimit në bankë të pagës së punëmarrësve pas datës 10 të muajit pasardhës, veçanërisht pagat e muajit dhjetor 2022 në datë 17.01.2021 dhe për muajin dhjetor 2022 në datë 19.01.2023 konsiderohen shkelje e nenit 15 pika 12 të Kontratës Kolektive të Punës, si dhe dispozitës përkatëse Kontratën Individuale të Punësimit ose Kontratën e Shërbimit.</p>
Kriteri:	<p>Kodi Punës Kontratës Kolektive të Punës Nr. 1528/1, datë 30.03.2021 VKM Nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Mbajtja dhe llogaritjes manuale e pagës dhe ndalesave, e regjistrit themeltar të punonjësve, e hedhjes së të dhënave në Librin e Pagave, rrit rrezikun për gabim njerëzor në përlllogaritjen, derdhjen e kontributeve dhe tatimit mbi të ardhura nga paga, mbajtjen, regjistrimin dhe administrim të dhënave të dhënave të pagave dhe kohën e marrëdhënieve të punonjësit që punëmarrësit që kanë qenë punonjës të institucionit.</p>
Shkaku:	<p>Mos pas infrastrukturës së nevojshme për kryerjen informatizimin e llogaritjes se elementëve të pagës.</p>
Rëndësia:	<p>E mesme.</p>
Rekomandime:	<p>-QSUNT të marrë masa për menaxhimin e llogaritjes së pagave nëpërmjet implementimit të regjistrit qendror të personelit disponuar nga DAP ose përdorimit të programit te informatizuar që përdoret nga sektori i financës, për të siguruar në çdo kohë të dhëna të sakta dhe të sigurta mbi marrëdhëniet e punësimit si për punëdhënësin, dhe për punëmarrësin.</p>

Titulli i Gjetjes Nr.5	<p>Mos respektimi i procedurës së përzgjedhjes së drejtuesve të shërbimit spitalor</p>
Situata:	<p>Në Statutin e QSUNT miratuar me urdhrin e Përbashkët të MSHMS dhe MASR Nr. 709, datë 10. 10.2018, në paragrafin 24 “Procedurat e marrjes në punë ” <u>nuk janë amenduar procedurat e marrjes në punë drejtuesve të shërbimeve spitalore</u>, në përputhje kritereve të përcaktuara në VKM Nr. 424, datë 10.05.2017 “Për përcaktimi i kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”. Procesi i përzgjedhjes së kandidatave për shërbime spitalorë 8 vende vakant për shkak të ndërprerjes se parakohshme të mandatit të drejtuesit (dalje në pension ose vdekje) nuk është në përputhje më procedurën e përzgjedhjes së kandidatave, pasi</p>

	<p>emërimi i përkohshëm në detyrë nuk bërë nga ministri i MSHMS dhe ministri i MARS me shkresë të përbashkët të Ministri i MSHMS dhe Ministri i MAR, por nga Titullari i QSUNT dhe, në mospërputhje me pikën 19 në VKM Nr. 424, datë 10.05.2017 “Për përcaktimi i kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”. DBNJ në QSUNT nuk ka organizuar procesin e përzgjedhjes së drejtuesit të ri të shërbimit spitalor, brenda 6 muajve nga krijimi i vendit vakant, nga ushtrimi i së drejtës ushtrimit të detyrës të shef shërbimit spitalor me emërimin të përkohshëm në detyrë në 8 emërimet e përkohshme, nga të cilat 3 emërimet e përkasin datës 03.04.2019 (mandat i plotë 4 vjeçar) e drejta e ushtrimit të këtij funksioni bazuar të VKM 424/2017, në mospërputhje me pikën 19 në VKM Nr. 424, datë 10.05.2017 “Për përcaktimi i kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”. Nga dokumentacioni i paraqitur u konstatua se drejtuesit e shërbimeve kanë nënshkruar deklaratën “Mbi Konfliktin e Interesit”, sipas Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2015, neni 4, pika 1, germa “c” dhe “ç”, por të pashoqëruar me vërtetimin respektive të MSHMA, në mospërputhje me pikën 25.2 të Statutit të QSUNT miratuar me Urdhër të përbashkët ndërmjet MSHMS dhe MARS Nr. 709/2018. Procedura e rekrutimit të personelit “mjek” referon në urdhrin e shfuqizuar të MSHMS Nr. 355, datë 18.08.2018 “Për kriteret e punësimit të mjekëve në spitalet universitare” dhe urdhrin Nr. 511, datë 13.12.2011 “Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publik”(shfuqizuar). Procedura e emërimit nuk përputhet me procedurën e Udhëzimit të Ministrisë të MSHMS Nr. 499, datë 02.07.2019 “Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike”.</p>
Kriteri:	<p>VKM Nr. 424, datë 10.05.2017 “Për përcaktimi i kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”;</p> <p>Statuti QSUNT miratuar me urdhrin e Përbashkët të MSHMS dhe MASR Nr. 709, datë 10. 10.2018.</p>
Ndikimi/Efekti:	Risk për vendimmarrje të gabuara.
Shkaku:	E lartë.
Rëndësia:	Mos vëmendje e duhur institucionale.
Rekomandime:	<p>-Nga organet drejtuese t’i kërkohet ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të bashkërendojë dhe koordinojë veprimtarinë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për procedurat e marrjes në punë të drejtuesve të shërbimeve spitalore.</p> <p>-DBNJ në QSUNT për vendet vakante të organizojë procesin e përzgjedhjes së drejtuesve të shërbimit spitalor për ushtrimin e detyrës të drejtuesit të shërbimit spitalor.</p> <p>-Dosja e drejtuesve të shërbimeve të plotësohet me vërtetimin respektive të lëshuar nga MSHMA-së në përputhje me pikën 25.2 të statutit të QSUNT-së miratuar me urdher të përbashkët ndërmjet MSHMS dhe MARS Nr. 709/2018.</p>

	- Procedura e pranimit dhe emërimit të mjekëve në statutin e QSUNT-së miratuar me urdhrin të përbashkët të MSHMS dhe MARS Nr. 709/2018, (statuti i QSUNT) paragrafi 24 dhe rregulloren bazë të QSUNT-së, pika 2.5 “Rregulla të përgjithshme të procedurës së punësimit për personelin mjekësor dhe administrativ”, të harmonizohet me procedurën e miratuar nga ministri i Shëndetësisë, me udhëzim Nr. 499/2019, “Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike”.
--	--

Titulli i Gjetjes Nr.6	Mungesë e kuadrit rregullator për mbulimin e mjekut të rojës në QSUNT
Situata:	QSUNT për mbulimin e shërbimit të roje 24-ore, bazohet në urdhrin e Ministrit të MSHMS Urdhër Nr. 145, datë 20.03.2013 “ <i>Për mbulimin e mjekut të rojës në QSUNT</i> ”, duke paraqitur kërkesë në MSHMS mbi nevojat për mbulimin e këtij shërbimi. Urdhri Ministri i MSHMS Nr. 145, datë 20.03.2013, për mbulimin e shërbimit të mjekut të rojës në QSUNT, përcakton sigurimin e këtij shërbimi duke përfshirë në këtë shërbim mjekët specializantë të vitit të tretë e lart si mjekët specializantë të viteve të para (si dublantë) dhe jo mjekë të pajisur me licencë për ushtrimin individual të profesionit miratuar nga Urdhri Mjekëve të Shqipërisë. MSHMS aprovon statusin e mjekut vullnetar, në kundërshtim me fushën e përgjegjësisë shtetërore të përcaktuar në VKM Nr. 609, datë 20.10.2021 “ <i>Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të MSHMS</i> ”, i cili në fushat e përgjegjësisë nuk parashikon kompetencën e MSHMS për miratimin të ushtrimit të aktivitetit mjek vullnetar në shërbim spitalor. Statuti i QSUNT në pikën 24, dhe Rregullorja Bazë e QSUNT nuk përcakton rregull se si do të procedohet në përzgjedhjen e kërkesave për mbulimin e shërbimit 24- ore për mjek vullnetarë, të cilët gëzojnë licencë për ushtrim aktiviteti nga Urdhri i Mjekut.
Kriteri:	Urdhri Ministri i MSHMS Nr. 145, datë 20.03.2013; VKM Nr. 609, datë 20.10.2021 “ <i>Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të MSHMS</i> ”; Statuti QSUNT miratuar me urdhrin e Përbashkët të MSHMS dhe MASR Nr. 709, datë 10. 10.2018.
Ndikimi/Efekti:	Risk për vendimmarrje të gabuara.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur institucionale.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga organet drejtuese t’i kërkohet ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të bashkërendojë dhe koordinojë veprimtarinë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për përcaktimin e rregullave dhe procedurave në përzgjedhjen e kërkesave për mbulimin e shërbimit 24 ore për mjek vullnetarë mbi nevojat për mbulimin e këtij shërbimi.

Titulli i gjetjes Nr. 7	Emërim i përgjegjësit të sektorit të Auditit të Brendshëm i pa licencuar nga Ministria e Financave dhe pa përvojë 5-vjeçare në profesion
--------------------------------	--

Situata:	<p>Me vendim Nr. 245, date 01.07.2021 të drejtorit të përgjithshëm është emëruar përgjegjësi i Sektorit të Auditit të Brendshëm.</p> <p>Baza ligjore e përcaktuar në vendim mbi të cilën është bërë emërimi është Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, VKM Nr. 555, datë 11.08.2011, i ndryshuar, Vendimet e Bordit Drejtues Nr. 7, datë 21.09.2015, Nr. 3, datë 05.02.2020, Nr. 1, datë 24.03.2021 dhe Nr. 5, datë 17.07.2020.</p> <p>Në këtë bazë ligjore nuk është përcaktuar dispozita ligjore specifike për këtë pozicion pune, që është Ligji Nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” me ndryshimet vijuese të tij.</p> <p>- Për këtë pozicion pune:</p> <p>-Mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimit dhe të rregullave të parashikuara në statut ose rregullore.</p> <p>- Nuk është bërë deklarimi për vende të lira pune në Zyrën e Punësimit Tiranë, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në këtë pozicion pune (përgjegjës i sektorit të auditit).</p> <p>-Mungon dokumentacioni i kërkuar nga QSUNT, që kandidati/kanidatët të plotësojnë kushtet për pozicionin e punës përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm.</p> <p>Referuar dosjes personale, e punësuar E. S. Ç. nuk ka certifikatën si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”, të lëshuar nga Ministria e Financave dhe përvojën 5-vjeçare në profesion. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 12/2023 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 11.</p>
Kriteri:	Ligji Nr. 12/2023 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.
Ndikimi/Efekti:	Risk menaxherial.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur institucionale.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për emërimin e përgjegjësit të Sektorit të Auditit të Brendshëm, me qëllim që emërimi të bëhet me “Auditues të brendshëm në sektorin publik” të licencuar nga Ministria e Financave, por edhe me përvojë 5-vjeçare në profesion.

2.3. Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime etj.).

Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë dhe bankë

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua:

Auditimi u ushtrua me zgjedhje⁹, konkretisht u audituan urdhër shpenzimet (shpenzimet me anë të bankës), të kaluara nëpërmjet Degës së Thesarit Tiranë, të kryera për llogari të Qendrës Spitalore

⁹Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit”, i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen. Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: “Aplikimi i

Universitare “Nënë Tereza”, për muajin Gusht, Tetor, Dhjetor të vitit 2021 në total 1,009 transaksione (urdhër shpenzime) me vlerën totale prej 2,370,092,047 lekë dhe për muajin Janar, Mars, Tetor, Dhjetor të vitit 2022 në total 1,581 transaksione (urdhër shpenzime) me vlerë 4,008,014,587 lekë, të cilat rezultuan në përgjithësi se janë kryer në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Të shpërndara sipas muajve:

- Për muajin Janar 2022, u audituan 17 transaksione (urdhër shpenzime) me vlerë 282,076,832 lekë;
- Për muajin Mars 2022, u audituan 336 transaksione (urdhër shpenzime) me vlerë 689,849,378 lekë;
- Për muajin Gusht 2021, u audituan 238 transaksione (urdhër shpenzime) me vlerë 797,185,736 lekë;
- Për muajin Gusht 2022, u audituan 338 transaksione (urdhër shpenzime) me vlerë 792,892,022 lekë;
- Për muajin Tetor 2021, u audituan 149 transaksione (urdhër shpenzime) me vlerë 655,520,823 lekë;
- Për muajin Tetor 2022, u audituan 301 transaksione (urdhër shpenzime) me vlerë 683,462,329 lekë;
- Për muajin Dhjetor 2021, u audituan 341 transaksione (urdhër shpenzime) me vlerë 917,385,488 lekë;
- Për muajin Dhjetor 2022, u audituan 589 transaksione (urdhër shpenzime) me vlerë 1,559,734,026 lekë.

Urdhër shpenzimet janë nënshkruar nga personat urdhërues dhe zbatues, shoqëruar me dokumentacion justifikues. Plotësimi i tyre është bërë në të gjithë ekstremitetet, ku përcaktohet qartë objekti i shpenzimit, kreditori përfitues dhe dokumentet justifikuese. Veprimet financiare si arkëtime dhe pagesa nga QSUNT, kryhen nëpërmjet 10 bankave të nivelit të dytë dhe evidentimi bëhet nëpërmjet programit Alfa. Të gjitha urdhër pagesat e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.04.2021-31.12.2021 janë në vlerën totale 5,964,271,100 lekë (2684 transaksione) dhe për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 janë në vlerën totale 9,446,863,385 lekë (2952 transaksione).

Nga kryerja e disa sondazheve për shumatat e kaluara nga thesari në total për paga shpenzime operative dhe investimeve me totalin e librit të bankës dhe arkës nuk rezultuan diferenca. Pagesat janë kryer kryesisht për paga, shpenzime të ndryshme operative, blerje barna, materiale mjekësore, shpërblime, paga punonjësish, shërbim mirëmbajtje aparatura mjekësorë, shërbime lavanderie, shërbime ushqimi dhe detyrime kontraktuale, etj. Dokumentacioni i bankës është i plotësuar dhe veprimet janë pasqyruar kronologjikisht. Urdhër shpenzimet përgjithësisht janë të shoqëruara me dokumentacionin vërtetues dhe justifikues.

Shpenzime për lëndë djegëse: Urdhër-shpenzimet shoqërohen me aktet e dorëzimit nga shoqëria furnizuese, fletë hyrjet në magazinë, procesverbalet akt kolaudimi të firmosur nga pesë anëtarët e komisionit të pritjes, kolaudimit dhe administrimit të mallit, në të cilët përshkruhet orari i shkarkimit të botit, targa e mjetit transportues, faturat elektronike, llogaritjet e çmimit në bazë të bursës, kursi zyrtar dhe raporti i testimit.

procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampionët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur”.

Shpenzime udhëtime dieta: Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se për vitin 2021 dhe 2022 në QSUNT nuk janë kryer shpenzime dietash.

Pavarësisht nga sa u citua më sipër, u konstatuan disa shkelje dhe parregullsi ligjore ose rregullatore në 22 (njëzetë e dy) transaksione (urdhër-shpenzime), ku në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë:

-Në 14 (katërbëdhjetë) urdhra-shpenzime të kryera lidhur me procedurat e prokurimit blerje të vogla, bashkëlidhur urdhër-shpenzimeve mungon dokumentacioni i plotë justifikues për shpenzimin e kryer, përfshirë urdhër prokurimi, ftesa për ofertë, konfirmimi i operatorit fitues, kontrata etj. Gjithashtu, evidentohet në disa raste mungesa e marrëveshjes bazë, kontratave të cilat janë produkt i një procedure të caktuar prokurimi. Veprime në kundërshtim me nenin 52, ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, sipas së cilit “Procesi dhe përgjegjësitë për autorizimin dhe kryerjen e shpenzimeve publike përcaktohen në ligjin për kontrollin e brendshëm financiar publik. Shpenzimet e njëjësive të qeverisjes së përgjithshme verifikohen në bazë të dokumentacionit të plotë, që vërteton kryerjen e shpenzimit përkatës, sipas ligjit për kontrollin e brendshëm financiar publik”.

-Evidentohen 3 (tre) raste ku hyrja në magazinë e mallit është kryer në mungesë të dokumentacionit justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, proces-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj., veprime në kundërshtim me pikën 52, Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, sipas së cilit “Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, fletë hyrje origjinale, proces-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj.”.

-Në 5 (pesë) raste evidentohet fenomeni i pagesave të vonuara të furnitorëve të ndryshëm me vonesë mbi 2 muaj. Pagesat e kryera me vonesë risin riskun e penalteteve nga operatorët ekonomikë ndaj institucionit. Veprim, në kundërshtim me nenin 7, ligji Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, sipas së cilit “...Afati i parashikuar në paragrafin e parë, të këtij neni, i jep të drejtë kreditorit të kërkojë të marrë kamatëvonesë pas 60 ditëve kalendrike gjithsej, duke përfshirë 30 ditët kalendrike të vonesës nga thesari, në shtesë nga 30 ditët e vonesës së pagesës për shkak të autoritetit publik”.

Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë në QSUNT, u konstatua se në këtë institucion veprimet me arkë kryen për pagesa përfitim shërbimesh shëndetësore të tipit konsulta të specializuara (me ose pa pagesë), konsulta ambulatorëiale, si edhe për çështje administrative si për shembull tërheqje kopje ekzaminimesh mjekësore etj. Sa i takon ligjshmërisë dhe saktësisë së veprimeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë nga auditimi është konstatuar se pagesat për shërbimet e përfituara kryen pranë PAI – ve respektive sipas mandat arkëtimeve të cilët përmbajnë emrin e pacientit, emrin e mjekut referues nëse ka, kodin e pacientit, të dhëna për pacientin, shërbimin e përfituar, vlerën e tij, nëse pacienti është i siguar dhe i rekomanduar. Veprimet e mësipërme evidentohen në një procesverbal të mbajtur midis arkëtares së PAI-t dhe ekonomistes së financës. Nga auditimi me zgjedhje i mandat arkëtimeve dhe derdhjeve ditore për llogari të thesarit nga grupi i auditimit nuk janë konstatuar mangësi.

Të ardhura të gjeneruara në këtë institucion nga Shërbimi Ambulatorë, Konsulta Mjekësore dhe Shërbime Administrative për vitin 2021 janë në vlerën 22,822,250 lekë dhe për vitin 2022 janë në

vlerën 27,654,190 lekë. Nga auditimi me zgjedhje është konstatuar se janë mbajtur akt rakordimet mujore për të ardhurat e gjeneruara.

a. Mbi rregullshmërinë e kryerjes së procedurave të blerjeve me vlera të vogla

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua

Në vijim, në formë tabelore pasqyrohet informacion mbi realizimin e blerjeve të vogla (në numër dhe vlerë), për vitet 2021 dhe 2022 nga ana e QSUNT dhe praktikave të përzgjedhura për auditim.

Viti	Të realizuara		Përzgjedhur për auditim	
	numër	vlerë pa tvsh (lekë)	numër	vlerë pa tvsh (lekë)
prill 2021-dhjetor 2021	11	5,593,930	6	2,629,001
janar 2022-dhjetor 2022	14	8,054,495	7	3,788,076

Burimi: QSUNT

Disa prej problematikave të konstatuara në procedurat për prokurim me vlerë të vogël:

1.Në të gjitha praktikave të zgjedhura për auditim konstatohet:

1.1 Urdhri Prokurimit, nuk ka të përcaktuar natyrën dhe sasinë e mallrave/shërbimeve, të cilat do të jenë objekt prokurimi, gjithashtu në urdhër përcaktohet fondi limit i procedurës, veprime në kundërshtim me pikën 8, Udhëzimi Nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, sipas së cilit “*Titullari i autoriteti/entit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, nxjerr urdhrin e prokurimit, ku përcaktohet natyra dhe sasia e mallrave, shërbimeve dhe punëve, të cilat kërkohen të prokurohen në këtë procedurë...Në këtë urdhër nuk do të përcaktohet fondi limit për objektin konkret*”.

1.2 Në dosjen e prokurimit administrohen dokumentet e kërkuara sipas Ftesës për Ofertë nga ana e OE, por ato nuk rezultojnë të dorëzuara sipas formës së kërkuar nga ligji, në zyrën e Protokollit, në kundërshtim me pikën 17, Udhëzimi Nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, sipas së cilit “*Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik fitues, në Zyrën e Protokollit të autoritetit/entit kontraktor*”.

2.Në procedurën “F.V. Sinjalistika e brendshme për Godinën e Re të Pediatriisë, ndërtuar me kredi të bankës botërore”, u konstatuan problematikat si më poshtë:

-Sipas kërkesës të Ftesës për Ofertë, certifikata ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” rezulton e noterizuar më datë 14.12.2021. Kontrata rezulton e nënshkruar më datë 13.12.2021. Pra, Autoriteti kontraktor ka shpallur ofertën fituese dhe ka lidhur kontratë duke mos pasur sigurinë nëse operatori ekonomik i plotëson apo jo të gjitha kriteret, veprime në kundërshtim me parashikimet për ftesën për ofertë, sipas së cilës “*OE i renditur i pari, duhet të paraqitet pranë autoritetit kontraktor brenda ditës së nesërme të punës nga momenti i publikimit njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik*”.

-Në zbatim të urdhrin 86, datë 24.02.2021 dhe urdhrin 86/2, datë 09.04.2021 të titullarit të AK është ngritur komisioni për argumentimin e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike, ndër të tjera edhe për lotin “F.V të Sinjalistikës së Brendshme”. Në vijim, komisioni ka vijuar punën mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit dhe gjithashtu jashtë kompetencave të dhëna me anë të këtij urdhri ka vijuar edhe me përcaktimin e sasive të nevojshme.

3.Në procedurën “Blerje tonerash për 60 ditë, me kusht ndërprerje me ardhjen e autorizimit nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara për lidhjen e kontratës bazë me të njëjtin objekt prokurimi”,

2 procedura, përkatësisht për vitin 2021 dhe për vitin 2022, u konstatuan problematikat si më poshtë:

-Në të dyja rastet, në kriteret e kualifikimit është vendosur kriteri “*OE duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose Distributori i Autorizuar për zërat e tonerave me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon operatorin ekonomik të ofrojë këto artikuj në këtë procedurë prokurimi.*”. Kriter i vendosur në kundërshtim me vendimin Nr. 814, datë 02.09.2021 “Për disa rekomandime Agjencisë së Prokurimit Publik në lidhje me procedurat e prokurimit publik me objekt blerje tonera/bojra” të Autoritetit të Konkurrencës dhe pikës 12, të shkresës Nr. 7998 prot., datë 24.12.2021 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikimi për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”, sipas së cilit “... *autoritetet/entet kontraktore kërkojnë që operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesi, duke vërtetuar lidhjen midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit për pajisjen me markën konkrete të përcaktuar, kërkesë e cila mund të kufizojë pjesëmarrjen dhe vendos në kushte të pabarabarta konkurruese operatorët ekonomik.*”.

4.Në procedurën “Trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta për nevojat emergjente të QSUNT deri në 31 Dhjetor 2021”, u konstatuan problematikat si më poshtë:

-Në mbështetje të parashikimeve të kuadrit ligjor që rregullon procedurën e prokurimit publik, sipas së cilit kriteret e vendosura nga OE duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe në mbështetje të kuadrit ligjor rregullator të asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme, për realizimin e kësaj procedure duhet të ishin vendosur edhe kriteret e tjera kualifikuese. Gjithashtu, duke pasur në vëmendje pasojat që rrjedhin nga mos realizimi i këtij procesi në mënyrë të rregullt, si dhe cilësinë e QSUNT e cila në këtë proces është në cilësinë e prodhuesit të mbetjeve spitalore dhe si rrjedhojë është përgjegjëse për të gjithat dëmet që shkaktohen në mjedis dhe në shëndetin publik nga të gjitha hallkat e procesit deri në asgjësim të mbetjeve duhet të ishin vendosur gjithashtu edhe kriteret:

Në rast të transportit brenda vendit, Operatori duhet të paraqesë Certifikatë e miratimit për mjetet (vetëm për brenda vendit) që transportojnë disa mallra të rrezikshme. Detyrim që buron nga pika 9.7, udhëzim Nr. 6, datë 27.5.2015 “Për procedurat e inspektimit të mjeteve, lëshimit të certifikatës së miratimit ADR, kushtet që duhet të plotësojë personi juridik për inspektimin e mjeteve ADR dhe tarifën e shërbimit”;

Për mjetin e transportit duhet të ishte kërkuar gjithashtu vërtetim se mjeti është regjistruar në Ministri për kryerjen e transportit të mbetjeve të rrezikshme, bazuar në kërkesat sipas shkronjës c), pika 5, neni 10, Ligji 9537, datë 18.05.2006 “Mbi administrimin e mbetjeve të rrezikshme”;

Operatori duhet të ishte kërkuar të paraqiste Akt Miratimi Higjenu – Sanitar, të lëshuar nga Inspektorati Shëndetësor Shtetëror (ISHSH). Detyrim që buron nga pika 10.3, kreu IV, VKM Nr.798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore”;

Duhet të ishte kërkuar që personeli i përfshirë në ngarkimin e koshave/kontejnerëve transit duhet të jetë kompetent dhe i trajnuar siç duhet, detyrim që buron nga pika 9.3.2 e Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurtë të Mbetjeve;

Lidhur me procesin e vlerësimit të ofertave:

Nuk disponohet dokumentacion provues mbi pronësinë e impiantit, sipas kërkesës në ftesën për ofertë;

Certifikatat ISO të lëshuara në favor të OE, nga kompania K.C.I.C.Ltd, janë vlefshme për një periudhë 3-vjecare, por me kusht nëse ky sistem është mirëmbajtur në mënyrë efektive dhe të jenë kryer auditime mbikëqyrëse. Nga ana e AK nuk figurojnë e dokumentuar konfirmimi nëse këto certifikata janë apo jo të vlefshme.

Veprime në kundërshtim me pikën 2, 3 dhe 4, neni 21, ligji Nr. 10 463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, sipas së cilit “Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton kushtet e përgjegjësive dhe specifikon se në cilat raste krijuesi fillestar mban përgjegjësi për të gjithë zinxhirin e trajtimit dhe në cilat raste përgjegjësia ndahet mes tij dhe zotëruesit të mbetjeve apo u delegohet aktoreve të ndryshëm të zinxhirit të trajtimit... Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton rrethanat në të cilat përgjegjësia për organizimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve mbartet, plotësisht apo pjesërisht, nga prodhuesi i produktit që krijon mbetjet dhe rrethanat kur këto përgjegjësi mund të ndahen me shpërndarësit e këtij produkti... Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve, që transferon mbetjet të një tregtar ose person që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, nuk çlirohet nga përgjegjësia për operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit të tyre”. Si dhe në kundërshtim me shkronjën e), pika 5, kreu II, VKM 798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore””, sipas së cilit “Prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për të gjitha dëmet e shkaktuara në mënyrë direkte ose indirekte në mjedis dhe në shëndetin publik nga procesi i grumbullimit, magazinimit, transportimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore të krijuara prej tyre”. Mos vendosja e kriterëve sipërcituara, të cilat janë detyrim nga kuadri ligjor i posaçëm, si dhe duke njohur rrezikshmërinë e moskryerjes së këtij shërbimi në mënyrën e duhur, mund të sillnin përzgjedhjen e një OE i cili nuk e kishte mundësinë ta ofronte shërbimin e kërkuar në përputhje të plotë me parashikimet ligjore.

5. Në procedurën “Pajisje EKG për Urgjencën Polivalente dhe Sëmundjeve të Brendshme dhe Shërbimin e Neurokirurgjisë”, u konstatuan problematikat si më poshtë:

Me anë të shkresës Nr. 2586 prot., datë 28.10.2022 Poli i Aktivitetit të Integruar të Spitalit Polivalent, Urgjenca e Sëmundjeve të Brendshme i është drejtuar Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike (këtu e në vijim DITIK) dhe i arsyeton nevojën për vendosje në dispozicion të 3 EKG-ve gjatë ushtrimit të punës. Gjithashtu, me anë të shkresës Nr. 2586/2 prot., datë 8.11.2022 Poli i Administrimit të Integruar të Neuroshkencës, Shërbimi i Neurokirurgjisë i është drejtuar DITIK dhe i kërkon pajisjen me një EKG pasi pajisja që disponojnë është jashtë funksionit. Në vijim, bazuar në sa më sipër, DITIK me anë të shkresës Nr. 2640 prot., datë 04.11.2022 dhe shkresës Nr. 2640/1 prot., datë 09.11.2022 i është drejtuar Drejtorisë Juridike dhe titullarit të Institucionit për të vijuar procedurën e prokurimit për tu pajisur me pajisjet objekt kërkesë dhe gjithashtu informon se DITIK ka bërë përpjekjet maksimale për ti rikthyer pajisjet në gjendje të plotë funksionale, por ka qenë e pamundur. Lidhur me mosfunksionimin e EKG nuk disponohet asnjë gjurmë auditimi/dokumentare nga DITIK të jetë ngritur një grup pune mbi defektet e konstatuara dhe nxjerrjen jashtë funksionit, veprime në kundërshtim me parashikimet e detyrave dhe përgjegjësive specifikuar në Rregullore Bazë e Funkcionimit të QSUNT-Tiranë, sipas së cilës “Sektori i Inxhinierisë Klinike, DITIK ndjek mirëmbajtjen, kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve të aparaturave dhe pajisjeve mjekësore në bazë të Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 356, datë 10.09.2007 “Për miratimin e Politikave Kombëtare për Menaxhimin e Politikave Mjekësore në Shqipëri”, Sektori i Inxhinierisë Klinike, DITIK ndërmjet sektorit, mban regjistrin e rekordeve për çdo aparaturë sipas një sistemi inventarizimi dhe shërbimet e kryera për çdo aparaturë”. Në zbatim të Urdhrit të Brendshëm Nr. 463, datë 18.11.2022 të titullarit të Institucionit është ngritur komisioni për llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e nevojave për këtë procedurë, i përbërë nga E.B., sektori i Inxhinierisë Klinike, z. R.A., urgjenca e sëmundjeve të brendshme dhe zj. S.Sh., sektor i prokurimeve. Në vijim, grupi i punës ka hartuar specifikimet teknike dhe ka vijuar me përlllogaritjen e fondit limit, të cilat i ka argumentuar me anë të shkresës Nr. 2640/11 prot., datë 15.12.2022. Lidhur me specifikimet teknike, grupi i punës është bazuar në materialin e përcjellë

nga Shërbimi i Urgjencës së Sëmundjeve të Brendshme me shkresën Nr. 2640/4 prot., datë 23.11.2022.

Në specifikimet teknike të parametrave të pajisjes EKG janë referuar indirekt vetëm një prodhues i caktuar në treg "S.H.", duke eliminuar konkurrencën dhe duke preferuar një prodhues të vetëm bashkë me operatorët ekonomik që gëzojnë autorizimin e kompanisë prodhuese.

Karakteristikat teknike të EKG, 12 kanale, me ekran LCD jo më pak se 10" me tastierë alfanumerike, janë marrë njësoj me katalogun e produkteve të kompanisë "S.H.", duke orientuar procedurën e prokurimit drejt një prodhuesi, ku nuk është përcaktuar edhe karakteristikat "ekuivalente" ose në diapazone që të nxitet konkurrenca. Nga auditimi dhe kërkimi i produkteve të prodhuesve të ndryshëm, konstatohet se asnjë prodhues nuk është i përmbush **të plota 100 % specifikimet e DST** (përveç markës S.H.), ku nuk ekziston asnjë produkt i ngjashëm. Specifikimet teknike të hartuara e miratuara nga AK, janë në kundërshtim me nenin 36, ligji Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, i cili parashikon se "*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik ...*".

Ndër të tjera në kriteret e kualifikimit është vendosur kriteri: "*Në rast të shpalljes fitues, OE duhet të paraqesë nga një mostër për secilin artikull objekt të kësaj procedure prokurimi, të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në Ftesën për Ofertë*". Kjo kërkesë nuk është e argumentuar teknikisht se cilat nga specifikimet teknike është e nevojshme për tu verifikuar me anë të mostrave të kërkuara, në kundërshtim me shkronjën a), pika 6, neni 40, VKM 285/2021 të ndryshuar. Gjithashtu, kriteri i vendosur është në kundërshtim me rekomandimet e APP, përcjellë me shkresën Nr. 7998 prot., datë 24.12.2021 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikimi për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime", sipas së cilit "*Autoritetet Kontraktore mund të kërkojnë mostra të mallrave, në rast se vlerësojnë që paraqitja e tyre, i shërben Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për të verifikuar nëse mallrat e ofertuar i plotësojnë specifikimet teknike në dokumentet e tenderit dhe për të vlerësuar në këtë mënyrë ofertën teknike. Në këtë rast, AK duhet të argumentojë teknikisht vendosjen si kriter kualifikimi paraqitjen e mostrave, duke përcaktuar ndër të tjera edhe se cilat nga specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit janë të nevojshme për t'u verifikuar nëpërmjet mostrave.*" Në vijim, me anë të kërkesës Nr. 2640/12 prot., datë 16.12.2022 Drejtoria e IT dhe Inxhinierisë Klinike ka kërkuar hapjen e procedurës së prokurimit. Me Urdhër Prokurimi Nr. 17, datë 22.12.2022 titullari i Institucionit ka urdhëruar të vijohet procedura e prokurimit me vlerë të vogël për pajisjen me EKG. Në vijim është hartuar Ftesa për ofertë me Nr. 2640/18 prot., datë 22.12.2022. Në kërkesat për kualifikim pika 10, kërkohet në mënyrë eksplicite: "*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/MAH/ ose nga distributoti zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë pajisjet mjekësore objekt prokurimi*". Kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 36, ligji Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Në kriteret për kualifikim, nuk është parashikuar detyrimi që pajisja duhet të jetë e regjistruar në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore që mbahet nga Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, sipas parashikimeve të nenit 13, Ligj Nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore", duke rrezikuar që të merren në dorëzim katër pajisje mjekësore të pa certifikuar nga AKBPM-

ja. Referuar këtij ligji, AKBPM-ja duhet të vijoj me lëshimin e certifikatës brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aplikimit. Vendosja e autorizimit të prodhuesit në kërkesat për kualifikim, vendosja e specifikimeve teknike të prodhuesve dhe produkteve të vetëm, si dhe kërkesa për paraqitjen e një mostre (edhe pse janë kërkuar katalogë të produktit) kanë orientuar operatorët ekonomik drejtpërdrejtë një prodhuesi të caktuar në treg. Për pasojë operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik, është shpallur fitues i procedurës. Veprimet e mësipërme kanë ulur në mënyrë të ndjeshme konkurrencën duke favorizuar vetëm operatorët ekonomik të cilët gëzojnë autorizime prodhuesit të përcaktuar në ftesën për ofertë, çka do të thotë që procedura e prokurimit e ka eliminuar konkurrencën. *Në opinionin e grupit të auditimit, autorizimi i prodhuesit nuk është gjë tjetër veçse diskriminim de facto kundrejt shoqërive që, për shkak të fuqisë së tyre më të vogël në treg, nuk kanë lidhje direkt me prodhuesit dhe nuk janë distributorë ekskluzivë, por i përfitojnë produktet/shërbimet nëpërmjet distributoreve të tjerë ekskluzivë të prodhuesit dhe ofrojnë çmime më konkurruese për të njëjtin mal/shërbim, cilësia e të cilit mund të provohet shumë lehtë. "Autorizimi nga prodhuesi" si kriter kualifikues, nuk mund të jete i vetmi mjet që të mundësojë garantimin e origjinalitetit e mallit/shërbimit. Ky kriter për kualifikim ka bërë që Autoriteti kontraktor të duket sikur e ka parazgjedhur paraprakisht kandidatin fitues, çka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë dhe nuk është në qasje të plotë dhe me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës së Drejtësisë. Me hollësisht autorizimi i prodhuesit si kriter kualifikimi është trajtuar në pjesë të tjera të këtij projekt raporti.*

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi vlerësimin e ofertave u konstatua se:

Referuar Procesverbalit së vlerësimit të KPVV, datë 27.12.2022, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik si më poshtë vijon:

Nr.	Operatori Ekonomik	Vlera pa T.V.SH	Marka e Produkteve	Kualifikuar
1	"A.M." sh.p.k	799,799 Lekë	C.	S'kualifikuar
2	"O.3." sh.p.k	800,000 Lekë	F.M.	U tërhoq
3	"F.A." sh.p.k	920,000 Lekë	S.H.	Fituesi

1. "A.M." sh.p.k, është s'kualifikuar pasi:

"Operatori ekonomik nuk përmbush ndër të tjera kriteret vijuese të përcaktuara në ftesën për ofertë:

Operatori ekonomik nuk përmbush disa pika të specifikimeve teknike të kërkuara në Ftesën për Ofertë dhe konkretisht:

Operatori ekonomik nuk përmbush specifikimin sa i takon madhësisë së ekranit. Madhësia e kërkuar në Ftesën për Ofertë është jo më pak se 10", ndërsa OE nuk e përcakton madhësinë në dokumentacionin e përgatitur. Nga kërkimet e kryera për pajisje të EKG, për prodhuesin C. me të cilin oferton operatori, pajisja model ECG-1200 Firstmed rezulton me ekran të madhësisë 8" (inch). Në dokumentacionin e operatorit ekonomik ky fakt nuk pasqyrohet. Operatori ekonomik nuk përmbush specifikimin e shpejtësisë së printimit sa i takon shpejtësisë 6.25mm/s. Operatori ekonomik nuk përmbush specifikimin e ndjeshmërisë sa i takon ndjeshmërisë 2.5 mm/mV. Operatori ekonomik nuk përmbush specifikimin e ndërfaqes, sa i takon SD Card. Pajisja e pasqyruar në manualin e përgatitur nga OE ofron vetëm mundësinë e dy portave USB.

Në ftesë për ofertë kërkohet:

Filtrat:

- EMG Filtër 25 Hz/30 Hz/ 40Hz; DFT Filtër: 0.05 Hz/0.15 Hz/0.25 Hz /0.32 Hz/ 0.5 Hz/0.67Hz/ADS; AC Filtër: 50 Hz/60Hz; Low Pass Filter:75 Hz/100 Hz/150Hz.

Pajisja e ofruar nuk përmbush specifikimin EMG Filtër, konkretisht:

i. Në ftesë për ofertë kërkohet: EMG Filtër 25 Hz/30 Hz/ 40Hz. Pajisja e OE rezulton 35 Hz. OE nuk përmbush kërkesat për sa i përket specifikimeve teknike për EMG Filtër.

ii. Në ftesë për ofertë kërkohet: DFT Filtër: 0.05 Hz/0.15 Hz/0.25 Hz /0.32 Hz/ 0.5 Hz/0.67Hz/ADS. Pajisja e ofruar nuk rezulton me filtër DFT.

iii. Në ftesë për ofertë kërkohet: Low Pass Filtër: 75 Hz/100 Hz/150Hz. Pajisja e ofruar nuk e përmbush këtë kërkesë.

Për pajisjen e kërkuar, e cila është e një rëndësie të veçantë në shërbimin spitalor terciar, konkretisht në njësinë e urgjencës, është kërkuar standard sigurie: IEC I/CF. Pajisja e ofruar nuk e përmbush standardin IEC.

Pajisja e kërkuar, në specifikimet teknike duhet të përmbushë kërkesën për Detektim Pacemakeri si me poshtë:

Norma e 1 kampioni:

Detektimi i Pacemaker: 2+2 mV 0.1 ms - Normale: 1000sps/channel

- Me Pacemaker: 10,000sps/channel

Pajisja e ofruar nga OE nuk përmbush kërkesën për detektim pacemakeri. Për sa i përket ftesës për ofertë, pajisja që kërkohet duhet të ketë minimalisht bateri të rikarikueshme me kapacitet minimalisht 4400mAh. Pajisja e ofruar ka 3700mAh. OE me pajisjen e ofruar nuk përmbush kapacitetin e kërkuar.

2."Orthonet 360" sh.p.k është tërhequr nga procedura me arsyetimin se *"...Në pamundësi të respektimit të afateve kohore të lëvrimit të mallit, ju njoftojmë tërheqjen nga procedura..."*

Sa më sipër, dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" të ndryshuar, KPVV ka shpallur fitues OE "F.A."

Pra, nëse Autoriteti kontraktor nuk do kishte përcaktuar specifikimet teknike të produkteve të markës "S.H." dhe të vendoste parametra normal cilësie, duke vendosur kritere që të nxisin konkurrencën dhe duke zgjeruar tregun e produkteve, atëherë OE "A.M." sh.p.k., do të ishte shpallur fitues me vlerë 799,799 lekë, vlerë më të ulët se vlera 920,000 lekë e operatorit fitues "F.A.". Siç është përshkruar edhe më sipër, në specifikimet teknike, asnjë EKG tjetër, nuk mund ti plotësojë plotësisht **100 %** specifikimet teknike dhe diferenca midis 2 ofertave të EKG-ve të ndryshme në vlerën 120.201 lekë pa TVSH, përbën dëm ekonomik në buxhetin e QSUNT dhe Buxhetin e Shtetit .

Pas shpalljes së operatorit fitues, është lidhur kontrata e furnizimit me Nr. 2640/19 Prot., datë 31.12.2022 ndërmjet QSUNT e përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm Prof. Asc. A.F. dhe Shoqërisë "F.A.". Referuar kontratës, palët kanë rënë dakord që kohëzgjatja e kësaj kontrate të jetë nga data e nënshkrimit deri më datë 31.12.2022, si rrjedhojë dorëzimi i mallit sipas specifikimeve teknike të rena dakord ndërmjet palëve, duhet të bëhet më datë 31.12.2022. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konkretisht relacion mbi marrjen në dorëzim për pajisjet mjekësore EKG, me Nr. 378/1 prot., datë 06.04.2023, komisioni sqaron se *"Komisioni pasi kreu kontrollin e sasive, funksionimin, instalimin e pajisjeve si më sipër shpjeguar, konstatoi të ketë përputhje të plotë me të gjitha pikat e specifikimeve teknike të kontratës së sipërcituar"*. Gjithashtu është shprehur se *"Kjo procedurë është mbajtur e pambyllur për faktin se grupi i punës ka qenë në pritje të konfirmimit nga Operatori Ekonomik për regjistrimin e pajisjeve në Agjencinë e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Procedura e regjistrimit në këtë agjenci ka kaluar nga faza e dorëzimit manual të dokumentacioneve përkatëse, në dorëzim online dhe kjo ka sjellë vonesë në procedurë"*. Edhe pse ashtu siç deklarohet nga komisioni i marrjes në dorëzim pajisjet ende nuk kanë përfunduar në mënyrë të plotë fazën e regjistrimit pranë Agjencisë së Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, komisioni

deklaron se i ka marrë në dorëzim pajisjet më datë 10.01.2023 dhe në vijim është bërë hyrja në magazinë me fletë hyrje Nr. 01, datë 10.01.2023. Pra, kanë kaluar afërsisht 4 muaj, pajisjet janë bërë hyrje në magazinë edhe pse nuk janë regjistruar në ABPM dhe aktualisht ende nuk janë vendosur në punë, e si rrjedhojë nuk janë përmbushur qëllimet dhe objektivat e njësisë. Nga ana e operatorit të shpallur fitues, “F.A.” është përcjellë fatura elektronike me Nr. 15510/2022, me datë 31.12.2022, për vlerën 1,104,000 lekë pa TVSH.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 2, nenin 8 dhe nenin 52, të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, pika 5, Neni 21, Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pika 93, Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika b), Neni 19, Ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi Nr.30, datë 31.05.2023 dhe ngarkohen me përgjegjësi drejtor i përgjithshëm, në cilësinë e titullarit të institucionit, për periudhën 03.12.2021 dhe në vijim, E.B. , z. R.A. dhe zj. S.Sh., në cilësinë e anëtarëve të komisionit për hartimin e specifikimeve teknike.

c. Zbatim Kontrate “Shërbim Lalanderi”

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua:

Në zbatim të kontratës protokolluar me Nr.543/4 datë 27.01.2022 me objekt kontrate “Për ofrimin e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavijonet e QSUNT për 30.05 ditë/muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, më të drejtë rinovimi automatikisht çdo muaj deri në lidhjen e kontratës bazë, me vlerë 22,282,115.73 lekë pa TVSH dhe 26,738,538.88 lekë me TVSH, miratuar nga kontraktuesi A., administratori A.T. dhe Autoriteti kontraktor QSUNT në cilësinë e Titullarit të Institucionit E.J., grupi i auditimit kreu kontrollin e zbatimit të kontratës për periudhën objekt auditimit 05/2021 deri me 12/2022.

Në zbatim të urdhrit Nr. Nr. 32/3, datë 09.01.2020 “Për ngritjen e komisionit për argumentimin e fondit limit, si dhe hartimin e specifikimeve teknike, për procedurën e prokurimit “Për ofrimin e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavijonet e QSUT “Nënë Tereza” për plotësimin e nevojave për 30 ditë”, ka ngritur komisionin e përbërë nga B.S., E.J.dhe Gj.M., nga ku me anë të relacionit Nr. 32/4, datë 10.01.2020, grupi i punës ka përllogaritur fondin limit në vlerën 22,305,209 lekë, për sasinë mesatare 62,414,89 kg/muaj, me çmimin 357 lekë/kg.

Ndjekja dhe zbatimi i kësaj kontrate, sipas nenit 20 të saj, do kryhet nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse. Në nenin 20, të kontratës Nr. 543/4, datë 27.01.2020, parashikohet që: “Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, si strukturë përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj kontrate, të hartojë procedurat e monitorimit të kontratës dhe të ndjekë sipas specifikimeve teknike duke bashkëvepruar me sektorët e tjerë përkatës, si dhe të raportojë tek Titullari i Autoritetit Kontraktor për realizimin e kontratës deri në përfundimin e saj”.

Grupi i auditimit kërkoj nga DSHM, procedurën e monitorimit të kontratës për ndjekjen sipas specifikimeve teknike të saj, por nuk ju dorëzua asnjë procedurë, në kundërshtim me nenin 20 të kontratës Nr.543/4 datë 20.11.2019.

Me ndjekjen e kësaj kontrate është autorizuar nga Drejtori i DSHM L.C., shefja e sektorit të monitorimit të kontratave B.S. dhe specialiste Gj.M..

Gjithashtu, kërkoj nga DSHM nëse është bërë ndonjë raportim titullarit të institucionit për realizimin e kontratës për periudhën objekt auditimit. Grupi të auditimit nuk ju dorëzuar asnjë raport drejtuar titullarit të institucionit mbi realizimin e kontratës së shërbimit të lavanderisë.

QSUNT për periudhën objekt auditimi ka shkëmbyer një sërë kërkesash për marrje informacioni

në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor për procedurën e prokurimit me objekt “Për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavijonet e QSUNT, drejtuar ABP me shkresën Nr.92/9 datë 22.7.2021 (si organi kompetent për kryerjen e procedurës) si dhe Gjykatës Administrative me shkresën Nr.122/20 datë 17.12.2021 për shqyrtimin e çështjes brenda një kohe sa më të shkurtër, si pasojë e nevojës urgjente që spitali ka për këtë shërbim gjithashtu kërkesë edhe Gjykatës Administrative të Apelit me shkresën Nr.303/8 datë 16.02.2022, shkresa Nr.303/9 datë 06.04.2022 si dhe shkresa Nr.303/15 datë 29.07.2022 po me të njëjtin objekt kërkesë.

Gjykata Administrative e Apelit me shkresën Nr. 303/16 datë 04.2022 ka dërguar në QSUNT vendimin Nr.23 datë 27.06.2022 e cila ka vendosur “Ndryshimin e vendimit Nr. ska datë 05.08.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tirane dhe rrëzimin e Kërkesës”.

Me shkresën Nr.303/17 datë 09.08.2022, shkresën Nr.1083/2 datë 23.08.2022 dhe shkresën nr303/20 datë 03.10.2022 QSUNT i është drejtuar ASHPP në lidhje me masat e marra pas daljes së vendimit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Shërbimi i Lavanderisë”.

Me shkresën Nr.1083/3 datë 20.10.2022 ASHPP i është drejtuar QSUNT, nga ku citon se: *“QSUNT duhet të paraqesë pranë ASHPP kërkesën e plotë për prokurim....”*

Me shkresën Nr.172/2 datë 17.01.2023 QSUNT ka dërguar në ASHPP, argumentimin e fondit limit dhe specifikimet teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim lavanderie dhe Hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në QSUNT për 4 vjet.

Nëpërmjet e-mailit zyrtar, DSHM ka komunikuar me ASHPP në lidhje me procedurën e prokurimit nga ku janë njoftuar së me datë 19.04.2023 ora 12:00 është afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave.

Grupi i auditimit referuar kontratës protokolluar me Nr.543/4 datë 27.01.2022 me objekt kontrate “Për ofrimin e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavijonet e QSUNT për 30.05 ditë/muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, më të drejtë rinovimi automatikisht çdo muaj deri në lidhjen e kontratës bazë, së lidhur midis AK dhe OE “A.”, konstatoi se:

Referuar specifikimeve teknike, seksioni Makineri dhe Pajisje ku është citur se “Nisur nga kërkesat e bazës materiale që QSUT ka nevojë, si dhe nga sasia e larjes për ditë/muaj, Operatori Ekonomik në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe fillimit të shërbimit në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, duhet të zotërojë makineritë e mëposhtme për kryerjen e këtij shërbimi”. Referuar akt verifikimit Nr.1 Datë 31.03.2023, grupi i auditimit konstatoi si më poshtë:

Pajisjet për kryerjen e shërbimit të lavanderise			
Nr.	Përshkrimi	Sasia	Fakti
1	MAKINE LARESE PROFESIONALE	3	3
2	BARRIERA LARESE PROFESIONALE	2	2 jo në gjendje pune
3	MAKINE PASTRIMI KIMIK PROFESIONALE	1	1
4	MAKINE THARESE PROFESIONALE	3	3
5	TRASPORTUESA (KARRELA PËR TRASPORT RROBASH) PROFESIONALE	90	U verifikuan disa prej tyre
6	KOSHA METALIK (KARRELA PËR MBAJTJE MATERIAL I BUTE)	20	U verifikuan disa prej tyre
7	MAKINERI HEKUROSESE (RUL) PROFESIONAL	2	2
8	MAKINA PAKETIMI PROFESIONALE PËR PAKETIM INVENTARI I BUTE	1	1
9	KARROCA SHERBIMI STACIONARE PROFESIONALE NË PAVIONE	40	U verifikuan disa prej tyre
10	ÇANTA HIGJENIKE PËR TRASPORT MATERIALI BUTE	200	U verifikuan disa prej tyre
11	POMPA DIZINFECTANTE NË KARROCAT SHERBIMI NË	40	U verifikuan disa prej tyre

	PAVIONE		
12	PESHORE ELEKTRONIKE MBI 100 KG	2	1

Referuar tabelës së mësipërme, grupi i auditimit nga verifikimi në terren konstatoi se 2 nga barrierat larëse profesionale (të cilat shërbenin për proces larje), ishin magazinuar në një ambient brenda lavanderisë për të cilën nuk ishin në gjendje pune.

Referuar Termave të Referencës, **Rregullat për Qarkullimin e materialit të butë në pavijonet e QSUT-së, për parandalimin, eliminimin e infeksioneve spitalore**, seksioni Përkujdesje citohet se:

Thasët e thurur, me ngjyrat e poshtëshënuara dhe me siglën përkatëse, vendosen në një mbajtës me rrota (karrocë), dhe administrohen nga Sipërmarrësi.

Thasët e Verdhe **“material i kontaminuar”**- vendoset çarçafët, këllëfët e jastëkut, pizham-këmishat e të sëmurve.

Thasët Blu - **materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjekësinë nukleare.**

Thasët Jeshilë - **material i konsideruar “me rrezik mikrobiologjik”**

Thasët Gri - veshjet e personelit shëndetësor ndihmës (sanitare, barrelambajtës, etj.), pantallona dhe bluza.

Thasët Vishnje (Bordeaux) - mbulesa, mbrojtëse dysheku, bluza pambuku.

Thasët Blu – **“material i pisët”**.

Operatori Ekonomik “A.” dispononte vetëm thasë me ngjyre blu *“Për materialet e kontaminuara, nga një pacient pas ekzaminimit në mjekësinë nukleare”* dhe thasë me ngjyrë vishnje *“Për mbulesa, mbrojtëse dysheku, bluza pambuku”*, çka sjell mos ndarjen e materialeve me rreziqe të ndryshme, si materiale të kontaminuar, materiale me rrezik mikrobiologjik etje referuar specifikimeve të kontratës.

Referuar specifikimet teknike të materialit të butë dhe struktura e nevojshme logjistike citohet se *“Autoriteti kontraktor ka të drejtë të ushtrorë kontroll në ambientet e lavanderisë dhe depove të materialeve të buta nëpër pavijone, në prani të përfaqësuesit të Kontraktori”*. Grupi i auditimit kërkoj nga DSHM nëse gjatë periudhës 2 vjeçare (objekt auditimit) është ushtruar ndonjë kontroll për veprimtarinë e lavanderise.

Grupit të auditimit ju dorëzuan disa formate A4, të shkruara me shkrim dore si dhe të firmosura nga kryeinfermieri dhe specialisti i sektorit të monitorimit të kontratave dhe jo procesverbale të protokolluara me numër protokollit dhe datë, si dokumente vërtetues për verifikimin e kryer.

Referuar specifikimeve teknike, seksioni “Etapat e procesit të tërheqjes dhe dorëzimit të materialeve të buta çdo ditë:

-Çdo ditë, Kryeinfermieri harton forcën ditore totale për ditën e nesërme për material të bute dhe brenda orës 13:30 e dorëzon pranë Sektorit të Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara.

-Sektori i Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara, harton pasqyrën përmbledhëse, bazuar në fletë kërkesat ditore dhe ia dorëzon O.E. për zbatim.

-Procesi i marrjes në dorëzimi i inventarit në pavion, do të bëhet me dokument të rregullt të nënshkruar nga kryeinfermieri/ja i/e pavionit ose personi i autorizuar prej tij, pas numërimit, kontrollit për hekurosjen, cilësinë e materialit të butë të larë në lavanderi (në bazë të kërkesës të sjellë një ditë më parë në sektorin e hotelarisë). Ky dokument (proces-verbal) duhet të jetë në tre kopje, të miratuar nga “Autoriteti kontraktor” dhe “Sipërmarrësi”.

Grupi i auditimit përzgjodhi 11 materiale të buta për ti peshuar, nga 15 materiale në total për shërbimin e lavanderisë nga ku krahasuar peshave për të cilat QSUNT paguan referua situacioneve firmosura nga OE “A.” dhe grupi për monitorimin e kontratës përmbledhur në mënyrë tabelare peshat për secilin prej materialeve rezultuan si më poshtë:

Nr.	Materiali	Referuar peshave sipas situacioneve			Fakti		
		Dimensionet	Përbërja %	Pesha/kg	Dimensionet	Përbërja	Pesha/kg
1	këllëf dysheku	2.10x95x25	100 pambuk	1.1	2.10x95x25	E pa evidentuar	0.8
2	çarçaf zarf	1.90x1.50	100 pambuk	1.2	1.90x1.50	E pa evidentuar	1.2
3	jorgan vatine	1.40x1.80	mbushje vatine	2.2	1.40x1.80	E pa evidentuar	2.35
4	çarçaf shtrati I sipërm	1.60x2.40	75 pambuk & 25 polyester	0.75	1.60x2.40	E pa evidentuar	0.8
5	çarçaf shtrati I poshtëm	1.60x2.60	75% pambuk & 25% polyester	0.8	1.60x2.60	E pa evidentuar	0.8
6	jastëk	40x80	fibër sintetike	0.75	40x80	-	0.9
7	kostume salle	-	100 pambuk/blu	0.6	-	E pa evidentuar	0.45
8	përparëse mjeku	-	100 pambuk/bardhe	0.55	-	E pa evidentuar	0.45
9	pandofla pacienti	PVC antirreshkitese	100 pambuk/bardhe	0.4	PVC antirreshkitese	-	0.4
10	kostum personeli	-	65% pambuk-35% polyester/gri	0.6	-	75% pambuk 25% polyester	0.6
11	robdishan pacienti	-	100 pambuk	0.35	-	100% pambuk	0.35

(Në lidhje me sasitë faktike të mallrave dhe pajisjeve objekt i kësaj kontrate, nga grupi i auditimit u mbajt Akt-Verikimi Nr. 1, datë 31.03.2023.)

Referuar tabelës së mësipërme, grupi i auditimit konstatoi diferenca në peshë për **5 materiale**. Për këtë arsye kërkohet të gjitha urdhërat shpenzimet për periudhën objekt auditimit. Kontraktori "A." Shpk ka faturuar shërbimin e kryer edhe është likuiduar sipas urdhër-shpenzimeve.

Për periudhën 04-12.2021 kontraktori "A." Shpk ka faturuar shërbimin e kryer edhe është paguar sipas 11 urdhër-shpenzimeve në vlerë totale prej 232,560,435.41 lekë me TVSH.

Për vitin 2022 "A." Shpk ka faturuar shërbimin e kryer edhe është likuiduar sipas 13 urdhër-shpenzimeve në vlerë totale prej 284,564,961.17lekë me TVSH.

Bashkëlidhur urdhër shpenzimi i firmosur nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues është, situacioni mujor i specifikuar për çdo ditë të muajit për 15 materiale, akt-rakordimi mujor, proces verbali mbi shërbimet e kryera nga OE të firmosur nga përfaqësuesi i "A." Shpk znj. A.P. dhe për QSUNT Gj.M., B.S., si dhe miratimi nga Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse, si dhe Drejtori i Ekonomisë dhe Planifikimit Financiar, për të kryer pagesën e shërbimit.

Referuar situacioneve mujore, grupi i auditimit për çdo muaj për periudhën objekt auditimi kreu llogaritjen e tyre sipas peshave faktike, nga ku rezultoi se për periudhën prill-dhjetor 2021 OE "A." Shpk është likuiduar në vlerën 193,300,331.07 pa TVSH ndërkohë që referuar peshave reale duhej të likujdohej në vlerën 189,622,252.16 lekë, më një diferencë prej **3,678,078.91 lekë ose 4,413,693.82 lekë me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik për QSUNT dhe Buxhetin e Shtetit.**

Për vitin 2022 OE "A." Shpk është likuiduar/paguar në vlerën 259,913,157.42 lekë pa TVSH ndërkohë që referuar peshave reale duhej të likujdohej/paguhej në vlerën 254,397,274.03 lekë, më një diferencë prej **5,515,883.39 lekë pa tvsh ose 6,619,060.07 me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik për QSUNT dhe Buxhetin e Shtetit.**

OE "A." shpk për periudhën objekt auditimi ka përfutur pa të drejtë në total vlerën **9,193,961.57**

lekë ose 11,032,753.88 lekë me TVSH, duke shkaktuar dëm në QSUNT dhe Buxhetin e Shtetit.

Periodha	diferenca kg	çmimi/kg	demi ekonomik pa TVSH	demi ekonomik me TVSH
Viti 2022	15,450.65	357	5,515,883.39	6,619,060.07
Prill-Dhjetor 2021	10,302.74	357	3,678,078.18	4,413,693.82
Totali	25,753.39		9,193,961.57	11,032,753.88

Ps: Janë marrë diferencat çdo muaj referuar situacioneve mujore, duke kryer rillogaritjen e peshave faktike pas verifikimit në terren.

Veprime në kundërshtim me:

Kontratën me Nr. 543/4 prot, datë 27.01.2020 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga E.J. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shoqërisë “A.” Shpk në vlerën 26,738,538.88 lekë me TVSH me të drejtë rinovimi automatikisht çdo muaj, neni 3.

- Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 122 “Rregullat që zbatohen për kontratën”, pika 1. Kushtet e kontratës të lidhur sipas këtij ligji nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur kontraktori, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit, ofron me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

- Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur “...Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblimin e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguar”.

- Deklaratën datë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik “A.” Shpk.

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij.

Si pasojë e mos zbatimit të specifikimeve teknike për periudhën tetor 01.04.2021-31.12.2022, Shoqëria “A.” Shpk ka përfituar padrejtësisht vlerën 11,032,753.88 lekë me TVSH, duke krijuar në këtë mënyrë dëm ekonomik në të njëjtën vlerë dhe duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria “A.” Shpk.

Referuar sa mësipërm, ngarkohet me përgjegjësi L.C. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse për periudhën 01.04.2021-31.12.2022.

Titulli i Gjetjes Nr. 1	Parregullsi në zbatimin e kontratës së shërbimit të lavanderisë
Situata:	-Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për vitin 2021 & 2022, si strukturë përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës Nr. Nr.543/4 datë 27.01.2022 me objekt kontrate “Për ofrimin e shërbimit të lavanterisë dhe hotelarisë për pacientët e hospitalizuar në pavijonet e QSUNT për 30.05 ditë/muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, më të drejtë rinovimi automatikisht çdo muaj deri në lidhjen e kontratës bazë, nuk ka hartuar procedurat e monitorimit të saj, për ta kaluar në bashkëpunim sektorit të monitorimit të kontratës si dhe nuk ka raportuar për realizimin e kontratës tek Titullari i Institucionit. - Nga grupi i auditimit u konstatua se nga verifikimi në terren 2 (dy)

nga barrierat larëse profesionale (të cilat shërbenin për proces larje), ishin magazinuar në një ambient brenda lavanterisë për të cilën nuk ishin në gjendje pune, se bashku me disa material të tjera.

- Referuar specifikimeve teknike seksioni “Përkujdesje” Operatori Ekonomik “A.” duhet të disponojë 7 (shtatë) lloje thasësh për mbledhjen e materiale të buta në varësi të rrezikshmërisë së tyre. Nga auditimi u konstatua se OE dispononte vetëm thasë me ngjyre blu “Për materialet e kontaminuara, nga një pacient pas ekzaminimit në mjekësinë nukleare” dhe thasë me ngjyrë vishnje “Për mbulesa, mbrojtëse dysheku, bluza pambuku”, çka sjell mos ndarjen e materialeve me rreziqe të ndryshme, si materiale të kontaminuar, materiale me rrezik mikrobiologjik etje referuar specifikimeve të kontratës.

Referuar specifikimet teknike të materialit të butë dhe struktura e nevojshme logjistike citohet se “*Autoriteti kontraktor ka të drejtë të ushtrojë kontroll në ambientet e lavanterisë dhe depove të materialeve të buta nëpër pavijone, në prani të përfaqësuesit të Kontraktori*”. Grupit të auditimit ju dorëzuan disa formate A4, të shkruara me shkrim dore si dhe të firmosura nga kryeinfermieri dhe specialisti i sektorit të monitorimit të kontratave dhe jo procesverbale të protokolluara me numër protokolli dhe datë, si dokumente vërtetues për verifikimin e kryer. Të tre konstatimet në kundërshtim me specifikimet teknike të materialit të butë dhe struktura e nevojshme logjistike, Specifikimet teknike seksioni “Makineri dhe Pajisje”, Neni 20, i kontratës Nr.543/4 datë 27.01.2022 me objekt kontrate “Për ofrimin e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavijonet e QSUNT për 30.05 ditë/muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, më të drejtë rinovimi automatikisht çdo muaj deri në lidhjen e kontratës bazë.

-QSUNT ka lidhur kontratë . 543/4 prot, datë 27.01.2020 me Shoqërinë “A.” Shpk me objekt “*Për ofrimin e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavijonet e QSUNT për 30.05 ditë/muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, më të drejtë rinovimi automatikisht çdo muaj deri në lidhjen e kontratës bazë*” në vlerën 26,738,538.88 lekë me TVSH. Grupi i auditimit përzgjodhi 11 materiale të buta për ti peshuar, nga 15 materiale në total për shërbimin e lavanterisë nga ku krahasuar peshave për të cilat QSUNT paguan referuar stacioneve të firmosura nga OE “A.”, u konstatuan diferenca në peshë për **5 materiale**. Referuar stacioneve mujore, grupi i auditimit për çdo muaj për periudhën objekt auditimi kreu llogaritjen e tyre sipas peshave faktike, nga ku u konstatua se për periudhën prill-dhjetor 2021 OE “A.” Shpk është likuiduar në vlerën 193,300,331.07 pa TVSH, ndërkohë që referuar peshave reale duhej të likuidohej në vlerën 189,622,252.16 lekë, më një diferencë prej **3,678,078.91 lekë ose 4,413,693.82 lekë me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik për QSUNT dhe Buxhetin e Shtetit.**

Për vitin 2022 OE “A.” SHPK është likuiduar/paguar në vlerën 259,913,157.42 lekë pa TVSH ndërkohë që referuar peshave reale

	<p>duhej të likuidohej/paguhej në vlerën 254,397,274.03 lekë, më një diferencë prej 5,515,883.39 lekë pa TVSH ose 6,619,060.07 me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik për QSUNT dhe Buxhetin e Shtetit.</p> <p>OE “A.” SHPK për periudhën objekt auditimi ka përfituar pa të drejtë në total vlerën 9,193,961.57 lekë ose 11,032,753.88 lekë me TVSH, duke shkaktuar dëm për QSUNT dhe Buxhetin e Shtetit.</p>
Kriteri:	<p>-Specifikimet teknike të materialit të butë, Specifikimet teknike seksioni “Makineri dhe Pajisje”, Neni 20, i kontratës Nr.543/4 datë 27.01.2022, neni 3, pika 1.</p> <p>- Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 122,</p> <p>- Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690;</p> <p>- Deklarata datë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik “A.” Shpk.</p> <p>-Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij.</p>
Ndikimi/Efekti:	Risk në përmbushjen dhe zbatimin e kontratës së shërbimit të lavanderisë.
Shkaku:	Mos zbatim i kontratës nga ana e OE dhe DMSH se bashku me sektorin e ndjekjes se kontratave.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	<p>- Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të marri masa të menjëhershme në hartimin dhe miratimin e procedurës për monitorimin dhe ndjekjen e kontratës së Shërbimit të Lavanterisë, në mënyrë që secili nga personat përgjegjës të ndjekësit të kontratës të kenë një rregullore mbi të drejtat dhe detyrimet mbi kontrollat dhe raportimet si dhe shpeshësinë e tyre të cilat duhet të kryejnë.</p> <p>-Sektori i Monitorimit të Kontratës të marri masa të menjëhershme nga ku të kryej verifikime në ambientet e lavanterisë si dhe nëpër pavijone në bashkëpunim me Kryeinfermieret (<i>si përgjegjëse të materialeve të buta</i>) për tu siguruar se detyrat (<i>ku përfshihet procesi si dhe pajisjet</i>) e Kontraktuarit po zbatohen në mënyrë rigorozë, të saktë dhe në kohë prej tij si dhe të mbahet proces verbali me numër dhe datë protokolli. Të merren masa të menjëhershme ku OE “A.” të rivendosi në punë dy barrierat larëse për mos të cenuar punën në vazhdimësi si dhe të furnizojë AK më 5 (pesë) thasët për mbledhjen e materialeve të buta referuar specifikimeve teknike të kontratës së sipërpërmendur.</p> <p>-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 11,032,753.88 lekë nga shoqëria “A.” SHPK. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, si pasojë e diferencës së peshave të materialeve të buta të paguara me ato faktike.</p>

Titulli i gjetjes Nr. 2	Parregullsi në procedurat për prokurim me vlerë të vogël
Situata:	<p>-Nga auditimi është konstatuar se në të gjitha praktikatat e zgjedhura për auditim në procedurat për prokurim me vlerë të vogël:</p> <p>1.Urdhri i Prokurimit nuk ka të përcaktuar natyrën dhe sasinë e mallrave/shërbimeve, të cilat do të jenë objekt prokurimi, gjithashtu në urdhër përcaktohet fondi limit i procedurës.</p> <p>2.Në dosjen e prokurimit administrohen dokumentet e kërkuara sipas Ftesës për Ofertë nga ana e OE, por ato nuk rezultojnë të dorëzuara sipas formës së kërkuar nga ligji, në zyrën e Protokollit.</p> <p>-Lidhur me procedurën “F.V. Sinjalistika e brendshme për Godinën e Re të Peditrisë, ndërtuar me kredi të bankës botërore” është konstatuar parregullsi si më poshtë:</p> <p>Sipas kërkesës të Ftesës për Ofertë, certifikata ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” rezulton e noterizuar më datë 14.12.2021. Kontrata rezulton e nënshkruar më datë 13.12.2021. Autoriteti kontraktor ka shpallur ofertën fituese dhe ka lidhur kontratë duke mos pasur sigurinë nëse operatori ekonomik i plotëson apo jo të gjitha kriteret, veprime në kundërshtim me parashikimet për ftesën për ofertë.</p> <p>-Lidhur me procedurën “Blerje tonerash për 60 ditë, me kusht ndërprerje me ardhjen e autorizimit nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara për lidhjen e kontratës bazë me të njëjtin objekt prokurimi”, përkatësisht për vitin 2021 dhe për vitin 2022, u konstatua se në të dyja rastet, në kriteret e kualifikimit është vendosur kriteri “<i>OE duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose Distributori i Autorizuar për zërat e tonerave me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon operatorin ekonomik të ofrojë këto artikuj në këtë procedurë prokurimi.</i>”</p>
Kriteri:	<p>- Udhëzimi Nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pika 8, pika 17;</p> <p>- Vendimi Nr. 814, datë 02.09.2021 “Për disa rekomandime Agjencisë së Prokurimit Publik në lidhje me procedurat e prokurimit publik me objekt blerje tonera/bojra”.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>-Mos përcjellja e dokumentacionit provues të OE të shpallur fitues sipas kërkesave të ligjit sjell mungesë transparence në kryerjen e procedurave dhe mundësi për abuzim.</p> <p>-Vendosja e autorizimit të prodhuesit në kriteret kualifikuese sjellë kufizim të pjesëmarrjes dhe vendos në kushte të pabarabarta konkurruese operatorët ekonomik.</p>
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur institucionale.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandim:	<p>- Komisioni i blerjeve me vlera të vogla të marrë masa që në procedurat për prokurim me vlerë të vogël, në hartimin e urdhrin të prokurimit të përcaktohet natyra dhe sasia e mallrave/shërbimeve të cilat do të jenë objekt prokurimi.</p> <p>- Komisioni i blerjeve me vlera të vogla të procedojë me shpalljen e OE</p>

	fitues pasi të sigurohet se i gjithë dokumentacioni i kërkuar është depozituar dhe është në përputhje të plotë me kërkesat e AK.
--	--

Titulli i gjetjes Nr. 3	Parregullsi në procedurën e prokurimit “Pajisje EKG për Urgjencën Polivalente dhe Sëmundjeve të Brendshme dhe Shërbimin e Neurokirurgjisë”
Situata:	<p>-Lidhur me mosfunksionimin e EKG nuk disponohet asnjë gjurmë auditimi/dokumentare nga DITIK të jetë ngritur një grup pune mbi defektet e konstatuara dhe nxjerrjen jashtë funksionit, veprime në kundërshtim me parashikimet e detyrave dhe përgjegjësive specifikuar në Rregulloren bazë e funksionimit të QSUNT-Tiranë.</p> <p>- Në specifikimet teknike të parametrave të pajisjes EKG janë referuar indirekt vetëm një prodhues i caktuar në treg "S.H.", duke eliminuar konkurrencën dhe duke preferuar një prodhues të vetëm bashkë me operatorët ekonomik që gëzojnë autorizimin e kompanisë prodhuese.</p> <p>-Karakteristikat teknike të EKG, 12 kanale, me ekran LCD jo më pak se 10” me tastierë alfanumerike, janë marrë njësoj me katalogun e produkteve të kompanisë "S.H.". Nga auditimi dhe kërkimi i produkteve të prodhuesve të ndryshëm, konstatohet se asnjë prodhues nuk i përmbush të plotë 100 % specifikimet e DST, përveç markës S.H.. Specifikimet teknike të hartuara e miratuara nga AK, janë në kundërshtim me nenin 36, ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.</p> <p>-Në kriteret për kualifikim, nuk është parashikuar detyrimi që pajisja duhet të jetë e regjistruar në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore që mbahet nga Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, sipas parashikimeve të nenit 13, Ligj Nr. 89/2014 ”Për pajisjet mjekësore”, duke rrezikuar që të merren në dorëzim katër pajisje mjekësore të pa certifikuar nga AKBPM-ja.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar , neni 36;</p> <p>-Ligji Nr. 89/2014 ”Për pajisjet mjekësore”, neni 13;</p> <p>- Rregullore bazë e funksionimit të QSUNT-Tiranë.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>-Mos dokumentimi nga strukturat përkatëse mbi defektet e konstatuara dhe nxjerrjen jashtë funksionit sjell mungesë transparence në ndjekjen e procedurave nga DITIK.</p> <p>-Vendosja e autorizimit të prodhuesit në kërkesat për kualifikim si dhe vendosja e specifikimeve teknike të prodhuesve dhe produkteve të vetëm, si dhe kërkesa për paraqitjen e një mostre (edhe pse janë kërkuar katalogë të produktit) kanë orientuar operatorët ekonomik drejtpërdrejtë një prodhuesi të caktuar në treg.</p>
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur institucionale.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandim:	- Drejtoria e IT dhe Inxhinierisë Klinike të marrë masa që në rastet e mosfunksionimit të pajisjeve mjekësore të ngrejë grup pune me qëllim identifikimin e defekteve të konstatuara duke përcaktuar nëse pajisja ka nevojë për mirëmbajtje apo nxjerrjen jashtë funksionit të tyre dhe vetëm pas kryerjes së kësaj procedure të vijoj me procedurën për blerjen e

	<p>pajisjeve zëvendësuese sipas rastit.</p> <p>- Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, i ngritur sipas rastit të marrë masa që në çdo procedurë të blerjeve të pajisjeve mjekësore, në kriteret për kualifikim të vendosë si kriter që pajisja duhet të jetë e regjistruar në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore që mbahet nga Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.</p>
--	--

Me shkresën nr.1177/24 datë 14.08.2023 protokolluar në KLSH, QSUNT ka paraqitur observacionin për gjetjen nr.52 nga Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse nga ku trajtuar si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ka filluar me marrjen e masave për rregullimin e disa hapave që ndiqet gjatë procesit të ofrimit të shërbimit të lavanderisë.

Kontrata me nr.543/4 datë 27.01.2020 me objekt “Për ofrimin e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavijonet e QSUNT për 30.05 ditë/muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, më të drejtë rinovimi automatikisht çdo muaj deri në lidhjen e kontratës bazë, mbaroi me datë 26 korrik 2023, pasi Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qëndror Blerës, dërgoi pranë QSUT, Marrëveshjen Kuadër me Nr.26/10 Prot., date 27.06.2023, lidhur midis Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqëndruara dhe shoqërisë “A.” Sh.p.k. për ofrimin e shërbimit me objekt: “Shërbim lavanderie për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” me afat të marrëveshjes kuadër për 48 muaj”.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Nga QSUNT nuk është sjellë asnjë dokumentacion shtese nga sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga ky observacion nuk do të merret parasysh.

2.4. Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit, plotësimi i pasqyrave financiare në afat, si dhe dërgimi dhe miratimi në organet e vartësisë.

A. Pasqyrat financiare

a. Auditimi i bilancit kontabël dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në zbatim të ligjit Nr.25/2018 “Për Kontabilitetin Dhe Pasqyrat Financiare” si dhe UMF Nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me UMF Nr. 5, datë 21.02.2022.

b. Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve.

c. Vlerësimi nëse aktiviteti dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

ç. Auditimit të pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare.

Për hartimin e Pasqyrave Financiare të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, përgjithësisht janë respektuar rregullat dhe kriteret e përcaktuara në:

- Ligjit Nr.25/2018 “Për Kontabilitetin Dhe Pasqyrat Financiare” .

- Udhëzimit Nr.8 dt..09.03.2018 të MFE “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar.

- Bilanci i vitit 2021(me të gjitha pasqyrat financiare përkatëse) është hartuar dhe depozituar më shkresën Nr.946 datë 16.03.2022 brenda afatit ligjor, i miratuar edhe nga Dega e Thesarit Tiranë.

- Bilanci i vitit 2022(me të gjitha pasqyrat financiare përkatëse)është hartuar dhe depozituar më shkresën Nr.700 datë 15.03.2023 brenda afatit ligjor, i miratuar edhe nga Dega e Thesarit Tiranë.

Pasqyrat Financiare të Bilancit janë sigluar nga Nëpunësi Autorizues (Drejtori i QSUNT) dhe nga hartuesi i tyre Shef i Sektorit të Financës, bazuar në Nenin 42 të Ligjit 9936 dt..26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë". Pasqyrat e llogaridhënies vjetore kanë të plotësuar pasqyrat si vijon: Pasqyra e Pozicionit Financiar(Formati 1), Pasqyra e Performancës Financiare (Formati 2), (mungon) Pasqyra e Flukseve Monetare(Formati 3), Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivitet Neto/Fondet Neto (Formati 4), Pasqyra Investimet dhe Burimet e Financimit (Formati 6), Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Formati 7/a dhe 7/b), Pasqyra Numri i Punonjësve dhe Fondi i Pagave (Format 8) si dhe pasqyrat dhe anekset përkatëse mbi shpenzimet e të ardhurat e ushtrimit, investimet sipas Pyetësori dhe Shënime Shpjeguese (Formati 5).

Veprimet janë mbartur nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Përgatitja e të dhënave për Pasqyrat Financiare të vitet 2021, 2022 është bërë duke kryer paraprakisht regjistrimin në mënyrë kronologjike sipas natyrës të të gjitha veprimeve financiare të realizuara nga QSUNT gjatë vitit, rakordimi i llogarive analitike me ato sintetike si dhe përmbledhja në centralizator.

a. Llogaritë e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

- Në Pasqyrën e Performanca Financiare Grupimi A – Format 2 janë të pasqyruara të Ardhurat e Institucionit të realizuara në vitin 2021 dhe 2022. Ato janë të ndara në 7 Kategori (sipas zërave përkatës), ku paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Në lekë

Llog	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI 2020	VITI 2021	Viti 2022	Ndryshimi 2022/2021
A	TË ARDHURAT	7,260,305,881	9,078,804,447	9,246,714,040	167,909,593
70	I.TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	0	0	0	0
75	II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE	0	0	0	0
71	III.TË ARDHURA JO TATIMORE	21,309,568	29,840,415	132,364,952	102,524,537
711	Shërbime Administrative dhe të Ardhura Sekondare	7,860,968			0
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	13,448,600	9,758,515	104,710,762	94,952,247
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve		20,081,900	27,654,190	7,572,290
76	IV.TË ARDHURA FINANCIARE	0	0	0	0
72	V.GRANTE KORENTE	7,238,996,313	9,048,964,032	9,114,349,088	65,385,056
720	I.Grant korent i Brendshëm	7,238,996,313	9,048,964,032	9,114,349,088	65,385,056
7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	6,821,199,195	8,294,486,741	8,330,084,800	35,598,059
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	417,722,311	750,138,298	784,264,288	34,125,990
7207	Sponsorizime të brendshme (nga atë trete)	74,807	4,338,993	0	(4,338,993)
	VI.TË ARDHURA TË TJERA	0	0	0	0
73	VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TË PRODUKTEVE	0	0	0	0

Burimi i të dhënave: QSUNT/përpunuar nga grupi i auditimit

Për vitin 2021

Për vitin 2021 të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit janë, në vlerën 9,078,804,447 lekë e cila në krahasim me vitin 2020 është shtuar në vlerën 1,818,498,556 lekë, analizuar si më poshtë:

Në postin 71 "Të ardhura jo tatimore" janë paraqitur në vlerën 29,840,415, me një shtesë nga viti 2020 në vlerën 8,530,847 lekë.

Të ardhurat tatimore vijnë nga zëri Shërbime administrative dhe të ardhura sekondare nga ku në vlerën 9,758,515 lekë të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh dhe të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve në vlerën 20,081,900 lekë.

Në zërin të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh në vlerën 9,758,515, janë të ardhura të cilat vijnë nga qira për kontrata qiraje (kontrata nën 200m2) në vlerën 4,251,805 lekë, nga shërbimi

ambulatorë në vlerën 1,548,900 lekë, nga shërbimi Administrativ në vlerën 1,191,450 si dhe të ardhura nga kontrata e parkingut në administrim të F. në vlerën 2,766,360 lekë.

Në zërin Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve në vlerën 20,081,900 lekë, janë kontabilizuar të ardhura nga konsultat mjekësorë, të cilat vijnë në rritje nga viti 2021.

Në postin 72 “Grante Korrente” shuma 9,048,694,032 lekë paraqet transfertat nga buxheti i shtetit (7200) për QSUNT në vlerën 8,294,741 lekë ku në krahasim me vitin 2020 është shtuar në vlerën 1,473,287,546 lekë, Financimi i pritshëm nga buxheti (7206) në vlerën 750,138,298 lekë e cila në krahasim me vitin 2020 është shtuar në vlerën 332,415,987 lekë kryesisht të ardhura që i takojnë njësisë për shpenzimet e periudhës Dhjetor 2021 dhe paguhen në vitin 2022, vlerë e cila përputhet me llogarinë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” si dhe nga “Sponsorizime të brendshme (nga të tretë) në vlerën 4,338,993 lekë e cila krahasuar me vitin 2020 ka pasur një rritje në vlerën 4,264,186 lekë e cila ka të bëjë kryesisht për studime klinike.

Në Pasqyrën Formati 2 “Të ardhurat jo tatimore”, përfaqësojnë të ardhura sekondare, të cilat vijnë nga të ardhura nga qiratë, të ardhura nga shërbimet ambulatorë mjekësor, nga konsulta mjekësore, nga shërbime administrative, sponsorizime nga subjekte shtetërore dhe private, sekuestrime dhe zhdëmtime si dhe qira parkingu, ku më poshtë paraqesim akt rakordimin me thesarin i të ardhurave për vitin 2021 me shkresën nr96/3 datë 20.01.2022 i cili rakordon me regjistrimin në kontabilitet:

Në lekë

N r	Emërtimi i llogarisë	Të ardhurat mujore	Të ardhurat progresive	Pjesa e Institucionit	Derdhur në buxhet	Mbeten për tu trashëguar
1	Qira (Kontrata mbi 200 m2)	603,930	7,602,947		7,602,947	0.00
2	Qira (Kontrata nën 200 m2)	324,530	6,074,009	4,251,806	1,822,202	4,251,806
3	Shërbim Ambulatorë Mjekësor	136,000	1,548,900	1,548,900		1,548,900
4	Të tjera	0.00	0.00	0.00		0.00
5	Konsulta Mjekësore	1,882,000	20,081,900	20,081,900		20,081,900
6	Shërbime Administrative	105,650	1,191,450	1,191,450		1,191,450
7	Sponsorizime nga subjekte shtetërore dhe private	0.00	4,338,993	4,338,993		4,338,993
8	Sekuestrime dhe zhdëmtime	17,895	1,150,583		1,150,583	0.00
9	Qira Parkingu	827,630	2,766,360	2,766,360		2,766,360
		3,897,635	44,755,143	34,179,410	10,575,733	34,179,410

Burimi i të dhënave: QSUNT/përpunuar nga grupi i auditimit

Për vitin 2022

Për vitin 2022 të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit janë, në vlerën 9,246,710,0401 lekë e cila në krahasim me vitin 2021 është shtuar në vlerën 167,909,593 lekë, analizuar si më poshtë:

Në postin 71 “Të ardhura jo tatimore” janë paraqitur në vlerën 132,364,952 lekë me një shtesë nga viti 2021 në vlerën 102,524,537 lekë.

Të ardhurat jo tatimore vijnë nga zëri “Shërbime administrative dhe të ardhura sekondare” ku nga të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh në vlerën 104,710,762 lekë dhe të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve në vlerën 27,654,190 lekë.

Në zërin të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh në vlerën 104,710,762 lekë me një rritje nga vitin 2021 në vlerën 94,952,247 lekë. Njësia ka gjeneruar arkëtime nga ambientet e lëshuara me qira në shumën 4,132 mijë lekë. Sponsorizimet nga subjektet private e shtetërore janë në vlerën 1,672 mijë lekë si dhe qira parkingu në vlerën 98,906 mijë lekë.

Të ardhurat nga parkingu në administrim të F. janë afro 98,906 mijë lekë e cila ka një dhe rritje të konsiderueshme në zbatimin të VKM-së Nr. 135 datë 02.03.2022 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 688 datë 14.11.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale tek Fondi Shqiptar i

Zhvillimit, të objektit, me emërtim “Oborr i Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë ndryshimi i vlerës përsa i takon QSUNT-së nga 3% në 22%”.

Në zërin Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve në vlerën 27,654,190 lekë, janë kontabilizuar të ardhura nga shërbime ambulatorë mjekësor në vlerën 1,423 mijë lekë, konsultat mjekësore në vlerën 24,858 mijë lekë si dhe nga shërbime administrative në vlerën 1,371 mijë lekë , të cilat vijnë në rritje nga viti 2021 në vlerën 7,572,290 lekë më shumë.

Në postin 72 “Grante Korrente” shuma 9,114,349,088 lekë paraqet transfertat nga buxheti i shtetit (7200) për QSUNT në vlerën 8,330,084,800 lekë ku në krahasim me vitin 2021 është shtuar në vlerën 35,598,059 lekë, Financimi i pritshëm nga buxheti (7206) në vlerën 784,264,288 lekë e cila në krahasim me vitin 2021 është shtuar në vlerën 34,125,990 lekë, vlerë e cila nuk përputhet me llogarinë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” me një diferencë prej 72,208,736 lekë.

Në Pasqyrën Formati 2 “Të Ardhurat Jo Tatimore”, përfaqësojnë të ardhura sekondare, të cilat vijnë nga të ardhura nga Qiratë, të ardhura nga shërbimet ambulatorë Mjekësor, nga Konsulta Mjekësore, nga Shërbime Administrative, sponsorizime nga subjekte shtetërore dhe private, sekuestrime dhe zhëmtime si dhe Qira Parkingu, ku më poshtë paraqesim akt rapordimin me thesarin i të ardhurave për vitin 2022 me shkresën Nr.422 datë 07.02.2023 i cili rakordon me regjistrimin në kontabilitet:

Në lekë

Nr.	Emërtimi i llogarisë	Të ardhurat mujore	Të ardhurat progresive	Pjesa e Institucionit	Derdhur në buxhet	Për tu trashëguar
1	Qira (Kontrata mbi 200 m2)	286,900.00	6,930,130.00		6,930,130.00	0.00
2	Qira (Kontrata nën 200 m2)	283,535.30	5,902,725.50	4,131,907.85	1,770,817.65	0.00
3	Shërbim Ambulatorë Mjekësor	113,460.00	1,423,850.00	1,423,850.00		0.00
4	Konsulta Mjekësore	1,688,000.00	24,858,500.00	24,858,500.00		0.00
5	Shërbime Administrative	89,650.00	1,371,840.00	1,371,840.00		0.00
6	Sponsorizime nga subjekte shtetërore dhe private	0.00	1,672,463.50	1,672,463.50		0.00
7	Sekuestrime dhe zhëmtime	4,580.00	413,842.00		413,842.00	0.00
8	Qira Parkingu	5,698,250	98,906,391.00	98,906,391.00		0.00
	Totali	8,164,375.30	141,479,742.00	132,364,952.35	9,114,789.65	0.00

Burimi i të dhënave: QSUNT/përpunuar nga grupi i auditimit

Përsa i përket shpenzimeve të QSUNT Grupi B “Shpenzimet”, për vitin 2021, 2022 paraqitet si më poshtë, nga ku të analizuar sipas llog. janë si më poshtë vijon:

Në lekë

Ilog	Përshkrimi I Operacionit	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	2022/2021
B	Shpenzimet	7,052,286,340	9,447,191,940	8,882,058,412	-565,133,528
600	I. Pagat Dhe Përfitimet E Punonjësve	2,451,650,961	3,009,367,808	2,678,435,483	-330,932,325
601	Ii. Kontribute Të Sigurimeve	343,222,751	414,548,328	421,537,006	6,988,678
602	Iii. Blerje Mallra E Shërbime	4,478,335,670	5,622,270,941	5,952,001,340	329,730,399
603	Iv. Subveçione	0	0	0	0
	V. Transferime Korente	1,616,354	1,640,000	38,169,000	36,529,000
606	3.Transferime Për Buxhetet Familjare E Individe	1,616,354	1,640,000	38,169,000	36,529,000
	Vi. Shpenzime Financiare	0	0	0	0
	Vii. Kuota Amortizimi Dhe Shuma Të Parashikuara	0	0	0	0
63	Viii.Ndryshimi I Gjendjes Se Inventarit	-306,390,826	399,420,117	-289,440,569	-688,860,686
	Ix. Shpenzime Të Tjera	83,851,430	-55,254	81,356,152	81,411,406
85	Teprica Ose Deficiti i Periudhës	208,019,541		364,655,628	733,043,122
	(Rezultati i Veprimtarisë se vitit Ushtrimor)		-368,387,494		

Burimi i të dhënave: QSUNT/përpunuar nga grupi i auditimit

Grupimit B “SHPENZIMET” për vitin 2021 janë në vlerën 9,447,191,940 lekë me shtesë prej 2,394,905,600 lekë me shumë se viti 2020, nga ku të ndara sipas zërave janë si më poshtë vijon:
Llog.600 “Paga e shpenzime personeli” për 3,009,367,808 lekë, në këtë post janë paraqitur pagat e personelit, gjatë vitit ushtrimor 2021, nga ku në krahasim me vitin 2020 janë me një shtesë në vlerën 557,716,847 lekë, kjo shtesë vjen referuar VKM Nr.207 date 10.03.2020 “Për dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë”, për personelin e përfshirë në luftën anti COVID-19.

Llogaria.601 “Kontribute të Sigurimeve Shoqërore” për 414,548,328 lekë, që paraqet shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e paguar nga punëdhënësi, ku në krahasim me vitin 2020 ka një shtesë në vlerën 71,325,577 lekë , referuar VKM së sipërpërmendur.

Llogaria.602 “Mallra dhe shërbime të tjera” për 5,622,270,941 lekë që paraqet shpenzimet për blerje mallrash dhe shërbimesh ku në krahasim me vitin 2020 ka një shtesë në vlerën 1,143,935,271 të analizuar si më poshtë:

-Materiale dhe shërbime speciale në vlerën 3,932,368,274 lekë, me një rritje në vlerën 858,612,391, zë i cili ka dhe peshën më të madhe për shpenzimet për blerje barnash e materiale mjekësore, gjithashtu janë kontabilizuar edhe shpenzimet e rimbursimit të dializave me një vlerë totale vjetore në vlerën 10,604 mijë lekë si dhe shpenzimet për testimet laboratorike në shumën 696,771 mijë lekë.

-Shërbime nga të tretë në vlerën 1,160,170 mijë lekë, më një rritje prej 162,320 mijë lekë nga ku vlerat më të larta janë për shpenzime shërbim i lavanderisë në vlerën 312,692 mijë lekë, shërbimi i kuzhinës në vlerën 189,665 mijë lekë, punonjës me kontrate shërbimi në vlerën 129,185 mijë lekë, shërbime të sigurimit dhe ruajtjes në vlerën 140,845 mijë lekë etj.

-Shpenzime për mirëmbajtje nga të tretë në vlerën, 371,673 mijë lekë, më një rritje në vlerën 109,204 mijë lekë, nga ku janë kryer shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore në vlerën 42,928 mijë lekë, për mirëmbajtjes e pajisjeve mjekësore në vlerën 298,502 mijë lekë, për mirëmbajtjen e impiantistike në vlerën 9,009 mijë lekë, për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore...në vlerën 20,038 mijë lekë si dhe për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit në vlerën 1,193 mijë lekë.

-Zëri shpenzime transporti në vlerën 89,600lekë më një rritje në vlerën 29,032 lekë e vlerën më të lartë është shpenzime për ngrohje në vlerën 82,038 lekë si dhe karburanti për automjete në vlerën 4,091 lekë.

-Shpenzime udhëtimi në vlerën 440 mije lekë me një rritje në vlerën 352 mijë lekë, ku i përkasin dieta dhe shpenzime transporti brenda vendit.

-Shpenzime për detyrime e kompensime ligjore në vlerën 12,386 mijë lekë, e cila vjen me një rritje nga viti 2020 në vlerën 6,088 mijë lekë e cila përbehet nga vendimet gjyqësore për detyrimet kontraktuale prej 11,566 mijë lekë dhe shpenzime detyrimeve për vendimet gjyqësore për largim nga puna në vlerën 821 mijë lekë.

Kateg. V- Transferime Korente për vitin 2021 në vlerën 1,640 mijë lekë, nga ku për vitin paraardhëse kanë qenë në vlerën 1,616 mijë lekë.

Llog.606 -“Transferta për buxhete familjare e individët” në vlerën 122,064 lekë e cila përfaqëson transfertat dhe pagesat për punonjësit për shpërblim dalje në pension prej 495 mijë lekë dhe për raste fatkeqësisht në vlerën 1,145 mijë lekë.

Llog.63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në vlerën 399,420,114 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve.

-Shpenzime të tjera- në vlerën -55,254 lekë, kjo vlerë përfaqëson mbylljen në datë 01.01.202021, të vlerës 55,254, lekë të një pagesë të datës 31.12.2019 mbetur pa ekzekutuar nga sistemi i thesarit, nga ku ka mbetur për vitin 2020 si gjendje në thesar.

Nga auditimi rezultoi se formatet e miratuara nga Ministria e Financave janë zbatuar.

Ndryshimi i gjendjes së inventarit në Grupimin B është i barabartë me diferencën e Klasës 3 në Aktiv të Bilancit.

Nga grupi i auditimit u bë rakordimi i shpenzimeve të Pasqyrës së Performancës Financiare për vitin 2021 me thesarin ku konstatohet se:

Në lekë

Nr. Llog	Shpenzimet e ushtrimit 2021	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente	9,447,191,940	8,739,544,589	707,647,351
600	Paga përfitime të punonjësve	3,009,367,808	3,008,810,660	557,148
601	Kontrib.të sig.shoq.e shëndet.	414,548,328	408,960,249	5,588,079
602	Mallra dhe shërbime të tjera	5,622,270,941	5,320,133,680	302,137,261
604	Transferime korente të brendshme	0	0	0
605	Transferta korente me jashtë	0	0	0
606	Transferta për buxhetet familjare e individe	1,640,000	1,640,000	0

Burimi i të dhënave: QSUNT/përpunuar nga grupi i auditimit

-Vlerat e paraqitura në pasqyrën financiare me vlerat e paraqitura në Akt rakordimin me Degën e Thesarit Tiranë llog.602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, sipas bilancit në vlerën 5,622 milion lekë, ndërsa Akt rakordimit me Degën e Thesarit vlera është 5,320 milion lekë.

-“Paga, shpërblime e të tjera personeli” sipas bilancit paraqiten në vlerën 3,009 milion lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 3,008 milion lekë, ku diferenca prej 557 mijë lekë vjen si rezultat diferencës së pagës dhjetor 2021 me atë të janar 2022.

Në thesar në muajin janar të vitit 2022 kanë kaluar pagat e dhjetor 2021, ndërsa në pasqyrë vlera e Paga, përfitime të punonjësve është totali për periudhën Janar-Dhjetor 2021, ku vlera e pagave Dhjetor 2021 kalon në thesar në janar të 2022. I njëjti fenomen ndodh dhe me Llog. 601 “Kontribut të sig. shoq. e shëndetësisë” ku kemi një difference në vlerën 5,588 mijë lekë.

Grupimit B SHPENZIMET për vitin 2022 janë në vlerën 8,882,058 mijë lekë me një pakësim prej 565,133 mijë lekë me pak se viti 2021, nga ku të ndara sipas zërave janë si më poshtë vijon: Llog (600) “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në vlerë totale prej 2,678,435 mijë lekë, me një ulje prej 330,932 mijë lekë nga viti i mëparshëm (2021) e cila është ndikuar nga ulja e zërit shpërblime, gjatë vitit 2022.

Llog (601) “Kontribute të sigurimeve” në vlerën 421,537 mijë lekë me një rritje prej 6,988 mijë lekë nga viti i mëparshëm.

Llog (602) Blerje mallra e shërbime që përfaqëson shpenzimet e llogarisë 602 rezulton me një vlerë totale 5,952,001 mijë lekë me një rritje 329,730 mijë lekë, analizuar sipas shpenzimeve shprehur si më poshtë:

Zëri Materiale zyre e të përgjithshme me një vlerë prej 28,416 mijë lekë kryesisht i përberë nga shtypshkrime, kancelari, materiale për pastrim etj. dhe krahasimisht ka një ulje prej 13,022 mijë lekë nga viti 2021.

Materiale dhe shërbimet speciale. Ky zë i cili ka edhe peshën më të madhe në shpenzimet e periudhës përfaqëson shpenzimet për blerje barnash e materialesh mjekësore. Po në këtë zë janë kontabilizuar si dhe shpenzimet për testimet laboratorike në shumën 764,638 mijë lekë. Në total për vitin kemi një rritje me 407,362 mijë lekë nga viti 2021.

Shërbime nga të tretë për 1,188,339 mijë lekë, me një rritje 28,169 mijë lekë nga viti paraardhës.

Shpenzime transporti me vlerë 24,480 mijë lekë me rritje prej 65,121 mijë lekë nga viti 2021. Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme me një pakësim 26,724 mijë lekë nga viti paraardhës. Shpenzime për detyrime e kompensime ligjore me vlerë 3,876 mijë lekë përbëhet nga shpenzimet e detyrimeve për vendime gjyqësore gjatë vitit 2022.

Zëri Shpenzime të tjera operative për vitin 2022 është në vlerën 22,212 mijë lekë. Ky zë gjatë vitit 2022 ka rritje në vlerën 8,018 mijë lekë.

Kateg. V- TRANSFERIME KORENTE për vitin 2022 janë në vlerën 38,169 mijë lekë, më një rritje nga viti 2021 në vlerën 36,529 mijë lekë, nga ku analizuar si më poshtë:

Llog.606 -“Transferata për buxhete familjare e individët” në vlerën 38,169 mijë lekë, e cila përfaqëson transfertat për mbështetje financiare në baze të VKM-së Nr. 898 datë 29.12.2022 “Për mbështetjen financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e krizës” për shumën 36,456 mijë lekë si dhe pagesat për punonjësit nga llogaria 606 për shpërblime për daljet në pension dhe për raste fatkeqësish prej 1,713 mijë lekë.

Llog.63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në vlerën 289,440 mijë lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve. Si rrjedhim i shtimit të gjendjeve inventarëve për 289,441 mijë lekësh, ka pakësuar shpenzimet e vitit në të njëjtën shumë. Peshën më të madhe në këtë zë për afro 259,206 mijë lekë e zënë barnat e materialet mjekësore. Shtimi tjetër prej 30,235 mijë lekë vjen si efekt në ndryshimin e gjendjeve të tjera inventariale dhe materiale.

-Shpenzime të tjera- për vlerën 81,356 mijë lekë përbëhet nga fondet e të ardhurave dytësore të përdorura për investime. Ndryshimi i gjendjes së inventarit në Grupimin B është i barabartë me diferencën e Klasës 3 në Aktiv të Bilancit.

Nga grupi i auditimit u bë rakordimi i shpenzimeve të Pasqyrës së Performancës Financiare për vitin 2022 me thesarin ku konstatohet se:

Në lekë

Nr. Llog	Shpenzimet e ushtrimit 2022	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente	8,882,058,412	8,739,544,589	142,513,823
600	Paga përfitime të punonjësve	2,678,435,483	2,709,555,604	(31,120,121)
601	Kontrib.të sig.shoq.e shëndet.	421,537,006	420,588,138	948,868
602	Mallra dhe shërbime të tjera	5,952,001,340	5,947,749,846	4,251,494
604	Transferime korente të brendshme	0	0	0
605	Transferata korente me jashtë	0	0	0
606	Transferata për buxhetet familjare e individuale	38,169,000	38,169,000	0

Burimi i të dhënave: QSUNT/përpunuar nga grupi i auditimit

-Vlerat e paraqitura në pasqyrën financiare me vlerat e paraqitura në Akt rakordimin me Degën e Thesarit Tiranë llog.602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, sipas bilancit në vlerën 5,952 milion lekë, ndërsa Akt rakordimit me Degën e Thesarit vlera është 5,947 milion lekë.

-“Paga, shpërblime e të tjera personeli” sipas bilancit paraqiten në vlerën 2,678 milion lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 2,709 milion lekë, ku diferenca prej 31, 120 mijë lekë vjen si rezultat diferencës së pagës dhjetor 2022 me atë të janar 2023.

Në thesar në muajin janar të vitit 2023 kanë kaluar pagat e dhjetor 2021, ndërsa në pasqyrë vlera e Paga, përfitime të punonjësve është totali për periudhën Janar-Dhjetor 2022, ku vlera e pagave Dhjetor 2022 kalon në thesar në janar të 2023. I njëjti fenomen ndodh dhe me Llog. 601 ”Kontrib të sig shoq e shëndetësisë” ku kemi një diferencë në vlerën 948 mijë lekë.

c. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Bilanci kontabël për vitet 2021, 2022 për QSUNT është përpiluar nga hartuesi i pasqyrave financiare, miratuar nga Nëpunësi zbatues (Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimi Financiar) dhe miratuar nga Titullari i Institucionit. Kopje e gjithë pasqyrave financiare është dërguar në Degën e Thesarit Tiranë për vitin 2021 me shkresën Nr. 946 datë 16.03.2022, dhe për vitin 2022 me shkresën Nr.700 datë 15.03.2023 Nga Dega e Thesarit Tiranë është bërë edhe vulosja e bilancit dhe formateve të pasqyrave financiare; Pasqyrimi kontabël i QSUNT për periudhën objekt auditimi është i përbërë nga pasqyrat financiare sipas formateve të miratuara nga Ministria e Financave si dhe është respektuar afati i dorëzimit të tij në thesar. Nga auditimi u konstatua se në bilancin për vitin 2021, mungon formati Nr.2 Pasqyra e Performancës Financiare, e cila nuk rezultoi as e dorëzuar dhe as e miratuar nga thesari. Grupi i auditimit ka punuar mbi të dhënat elektronike, referuar materialeve të dorëzuar nga ish punonjësi i hartuesit të pasqyrave financiare. Përmbledhja e llogarive vjetore për vitin 2021 dhe vitin 2022 dhe krahasimi i tyre.

Aktivi - Pasqyra e Pozicionit Financiar për vitin 2021, 2022

Në lekë

Llog	Përshkrimi	Viti 2022	Viti 2021	2022/2021
A	A K T I V E T	10,060,884,148	10,259,921,117	(199,036,969)
	I. Aktivët Afat shkurtër	2,312,357,169	2,012,558,088	299,799,080
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	109,005,251	58,576,870	50,428,381
520	Disponibilitete në Thesar	109,005,251	58,576,870	50,428,381
	2.Gjendje Inventari qarkullues	941,414,350	651,973,781	289,440,569
31	Materiale	888,790,880	629,584,845	259,206,035
32	Inventar i imët	50,235,779	21,845,501	28,390,278
35	Mallra	2,387,691	543,435	1,844,256
	3.Llogari të Arkëtueshme	1,104,679,756	1,143,765,196	-39,085,440
411	Kliente e llogari të ngjashme	0	545,930	-545,930
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	282,023	282,023	0
468	Debitorë të ndryshëm	392,342,181	392,798,945	-456,764
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	712,055,552	750,138,298	-38,082,746
	4.Të tjera aktive afatshkurtra	157,257,812	158,242,242	-984,430
409	Parapagime	33,091,445	34,075,875	-984,430
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	124,166,367	124,166,367	0

Burimi i të dhënave: QSUNT/përpunuar nga grupi i auditimit

Grupimi A – AKTIVET, përfaqëson shumën: Aktivët Afatshkurtra (Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre, Gjendje Inventari qarkullues, Llogari të Arkëtueshme dhe Të tjera aktive afatshkurtra) me Aktivët Afatgjata (Aktive Afatgjata jo materiale, Aktive Afatgjata materiale, Aktive Afatgjata Financiare dhe Investime) .

Për vitin 2021

Nga të dhënat përmbledhëse të Aktivit për vitin ushtrimor 2021 rezultoi se totali i Aktivit me 31.12.2020 ka vlerën 10,259,921,117 lekë dhe se në krahasim me vitin 2020 është 638,364,486 lekë më pak se viti 2021.

“Aktivët Afatgjata”(AAGJJM, AAGJM dhe AAGJF) në vlerën 8,247,363,029 lekë zënë 80% të vlerës totale të aktivit.

Aktivët Afatshkurtra zënë 20% të vlerës totale në vlerën 2,012,558,088 lekë.

Aktivët Afatgjata në krahasim me vitin 2020, janë ulur në vlerën 570,958,540 lekë, ndërsa Aktivët Afatshkurtra janë ulur në vlerën 66,805,946 lekë.

Për vitin 2022

Nga të dhënat përmbledhëse të Aktivit për vitin ushtrimor 2022, rezulton se totali i Aktivit me 31.12.2022 ka vlerën 10,060,884,148 lekë dhe se në krahasim me vitin 2021 është 199,036,969 lekë më pak.

“Aktivet Afatgjata”(AAGJMM, AAGJM dhe AAGJF) në vlerën 7,748,526,979 lekë zënë 77% të vlerës totale të aktivit.

Aktivet Afatshkurtra zënë 23 % të vlerës totale në vlerën 2,312,357,169 lekë.

Aktivet Afatgjata në krahasim me vitin 2021, janë ulur në vlerën -498,836,050 lekë, ndërsa Aktivet Afatshkurtra janë ulur në vlerën -984,430 lekë.

I. Aktivet Afatshkurtra

1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre në vlerën 58,576,870 lekë

- Llog.520 “Disponibilitete në Thesar” për vitin 2021 pasqyrohet në vlerën 58,576,870 lekë me një rritje nga vitit 2020 në vlerën 15,747,852 lekë. Kjo llogari përbehet nga të Ardhurat Dytësore të trashëgueshme për 52,650 mijë lekë dhe Mjetet në ruajtje (për garanci punimesh ndaj furnitorëve) për 5,927 mijë lekë.

2.Gjendja e Inventarit qarkullues në vlerën 651,973,781 lekë

-llog.31 “Materiale” për vitin 2021 në vlerën 629,584,845 lekë, llog. 32 “Inventar i imët” në vlerën 21,845,501 lekë si dhe llog.35 “Mallra” në vlerën 543,435 lekë, nga ku në total nga viti 2020 ka një rënie në vlerën 399,420 mijë lekë. Zëri Materiale në të cilin janë kontabilizuar barnat e materialet mjekësore, si edhe materiale të tjera që i shërbejnë aktivitetit mjekësor, ka një rënie prej afro 397,343 mijë lekë, nga përdorimi i barnave e materialeve gjendje në 31.12.2020 gjatë vitit 2021, përveç atyre të blera gjatë 2021.

3.Llogari të Arkëtushme në total në vlerën 1,143,765,196 lekë

Llog.411 “Klient e llogari të ngjashme” paraqitet për vitin 2021 në vlerën 545,930 lekë. Zëri Klientë përfaqëson detyrimin në 31.12.2021 të dy klientëve (për ambiente me qira), që sipas kontratave përkatëse pagesën e muajit Dhjetor 2021 kanë kryer në muajin pasardhës të datës së mbylljes së vitit ushtrimor.

- Llog.423 “Personeli, paradhënie, deficite gjoba” në vlerën 282,023 lekë, përbehet nga detyrime të punonjësve për paradhënie të marra, mbartur ndër vite për blerje furnizime e shërbime të kryera me to, nga të cilën edhe pse janë bërë përpjekje për ti mbledhur, detyrimet janë mbartur që prej vitit 2013.

Llog.468 “Debitorë të ndryshëm” për vitin 2021 përbëhet nga vlera 392,798,945 lekë, me një rënie nga viti 2020 në vlerën 1,259,626 lekë. Ulja në këtë zë konsiston kryesisht në pagesën e shumave të detyrimeve nga punonjës dhe ish punonjës për pagesën e kryer ndaj kompanisë “P.C.” për detyrime telefonike, sipas vendimit përkatës gjyqësor. Përmbledhur në mënyre tabelare në aneksin Nr. I. Pjesa tjetër e debitorëve konsiston që prej vitit 2013-2020. Nga grupi i auditimit u kërkua së cilat janë masat për të cilat Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse si dhe Drejtoria Juridike ka marrë në lidhje me këto debitorë. Grupi të auditimit nuk ju dorëzua asnjë dokumentacion.

Vlera 392,792,945 lekë përbën të ardhura të munguara si dhe efekt negativ financiar për buxhetin e shtetit.

Llogaria.4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” paraqitet për vitin 2021 në vlerën 750,138,298 lekë me një diference nga vitin 2020 në vlerën 328,666,655 lekë.

Kjo llog. paraqet shumat e detyrimeve të njohura dhe kontabilizuara në muajin Dhjetor 2021, të cilat paguhen në fondet buxhetore të vitit pasardhës, dhe përbëhen nga:

Lloji	Shuma/lekë
Furnitorë (401-408)	496,303,461

parapagime 31.12.2021 (409)	34,075,875
paga, sigurime, tatime	287,910,712
totali	750,138,298

Burimi i të dhënave: QSUNT/përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi i llogarisë analitike grupi i auditimit u konstatoi se kjo llogari nuk pasqyron vlerës e saktë të të drejtave të institucionit si janë të drejtat ndaj furnitorëve, të pagave, sigurimeve, tatimeve si dhe regjistrimin e parapagime në këtë llogari, vlerë e cila duhet të ishte e njëjtë me llogarinë Financimi i pritshëm nga buxheti (7206). Referuar llog të kontabilizuara për furnitorë, paga sigurime totali i kësaj llogarie duhet të ishte:

Lloji	Shuma/lekë
Furnitorë (401-408)	496,303,373
Detyrime ndaj personelit	209,456,791
paga, sigurime, tatime	78,629,126
totali	784,389,290

Burimi i të dhënave: QSUNT/përpunuar nga grupi i auditimit

4. Të tjera aktive afatshkurtra në vlerën totale prej 158,242,242 lekë

Llog. 409 “Parapagime” në shumën 34,076 mijë lekë paraqet kryesisht pagesa të kryera në avancë sipas marrëveshjeve përkatëse, ndaj IAEA dhe UNICEF, respektivisht si pagesë për blerje radioizotope e burime radioaktive për mjekësinë nukleare, projekte për mjekësinë nukleare, si dhe për pagesat që kryhen për blerjen e medikamenteve antiretrovirale që mundësohet nga Unicef.

Llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në vlerën 124,166,367 lekë janë të kontabilizuar si kundërparti detyrimet e njësisë të mbartura kryesisht nga vitet 2010 – 2013, të cilat për arsye të ndryshme në vitet 2014 – 2015 kanë mbetur të papaguara nga fondet e përcaktuara në Buxhetet e këtyre dy viteve për këtë qëllim, si edhe detyrime për disa vendime gjyqësore të mëvonshme. Ky zë, në zbatim të Udhëzimit Nr.5, datë 21.02.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në datë 31.12.2021 është në debit me të njëjtën vlerë të llogarisë 467, dhe konsiderohet si detyrime të prapambetura të trashëguara nga vitet e kaluara.

I. Aktivet Afatshkurtra Për vitin 2022

1. Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre në vlerën 109,005,251 lekë

- Llog.520 “Disponibilitete në Thesar” për vitin 2022 pasqyrohet në vlerën 109,005,251 lekë me një rritje nga vitit 2021 në vlerën 50,428,381 lekë kryesisht si pasojë e rritjes së të ardhurave dytësorë nga qiraja e parkimit . Kjo llogari përbehet nga të Ardhurat Dytësore të trashëgueshme për 6,052 mijë lekë dhe Mjetet në ruajtje (për garanci punimesh ndaj furnitorëve) për 6,052 mijë lekë.

2. Gjendja e Inventarit qarkullues në vlerën 941,414,350 lekë

-llog.31 “Materiale” për vitin 2022 në vlerën 888,790,880 lekë, llog. 32 “Inventar i imët” në vlerën 50,235,779 lekë si dhe llog.35 “Mallra” në vlerën 2,387,691 lekë, nga ku në total nga viti 2021 ka një rritje në vlerën 289,440 mijë lekë.

Zëri Materiale në të cilin janë kontabilizuar barnat e materialet mjekësore, si edhe materiale të tjera që i shërbejnë aktivitetit mjekësor, ka një rritje nga viti 2021 në vlerën 259,206 mije, ashtu si dhe zëri inventar i imët në vlerën 28,390 mijë si dhe zëri mallra në vlerën 1,844 mijë.

3. Llogari të arkëtushme në total në vlerën 1,104,679,756 lekë

- Llog.423 “Personeli, paradhënie, deficite gjoba” në vlerën 282,023 lekë, përbehet nga detyrime të punonjësve për paradhënie të marra, mbartur ndër vite për blerje furnizime e shërbime të kryera me to, nga të cilën edhe pse janë bërë përpjekje për ti mbledhur, detyrimet janë mbartur që prej vitit 2013 (e pandryshuar si vlerë).

Llog.468 “Debitorë të ndryshëm” për vitin 2022 përbëhet nga vlera 392,342,181 lekë me një diferencë nga vitin 2021 në vlerën 456,764 lekë e cila i përket detyrimit nga disa punonjësit për pagesën e kryer ndaj kompanisë “P.C.” për detyrimin telefonik sipas vendimit gjyqësor. Vlera 392,792,945 lekë përbën të ardhura të munguara si dhe efekt negativ financiar për buxhetin e shtetit.

Llogaria.4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” paraqitet për vitin 2022 në vlerën 712,055,552 lekë me një diferencë nga vitin 2021 në vlerën 38,082,748 lekë. Kjo llog. paraqet shumat e detyrimeve të njohura dhe kontabilizuara në muajin Dhjetor 2022, të cilat paguhen në fondet buxhetore të vitit pasardhës, dhe përbëhen nga:

Lloji	Shuma/lekë
Furnitorë	447,875,873
Detyrime Ndaj Personelit	185,202,254
Sigurime, Tatime	78,977,425
Totali	712,055,552

Burimi i të dhënave: QSUNT/përpunuar nga grupi i auditimit

4. Të tjera aktive afatshkurtra në vlerën totale prej 157,257,812 lekë

Llog. 409 “Parapagime” në shumën 33,091,445 mijë lekë paraqet kryesisht pagesa të kryera në avancë sipas marrëveshjeve përkatëse, ndaj IAEA dhe UNICEF, respektivisht si pagesë për blerje radioizotope e burime radioaktive për mjekësinë nukleare, projekte për mjekësinë nukleare, si dhe për pagesat që kryhen për blerjen e medikamenteve antiretrovirale që mundësohet nga Unicef.

Llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në vlerën 124,166,367 lekë janë të kontabilizuara si kundërparti detyrimet e njësisë të mbartura kryesisht nga vitet 2010 – 2013, të cilat për arsye të ndryshme në vitet 2014 – 2015 kanë mbetur të papaguara nga fondet e përcaktuara në Buxhetet e këtyre dy viteve për këtë qëllim, si edhe detyrime për disa vendime gjyqësore të mëvonshme. (vlerë e pandryshuar nga viti i mëparshëm).

Auditimi i Aktiveve Afatgjata:

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

- Aktivitet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit;
- janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte
- është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme;
- informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe e korrekte.

b. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivitetet e qëndrueshme;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.
- U verifikua rregullshmëria e procedurës së kalimeve kapitale të AAGJM.

c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e Aktiveve Afatgjata:

1. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- Aktivitetet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Aktivitetet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostos së tyre të prodhimit.
- Aktivitetet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivitetet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes. (UMF Nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar).

Nr.	Përshkrimi	Viti 2021	Viti 2022	2022/2021
	II. Aktivitet Afat gjata	8,247,363,029	7,748,526,979	-498,836,050
20	1. Aktivitet Afatgjata jo materiale	18,521,635	11,576,021	-6,945,614
201	Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	18,521,635	11,576,021	-6,945,614
203	Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme	0	0	0
21	2. Aktivitet Afatgjata materiale	8,151,452,446	7,656,535,544	-494,916,902
210	Toka, Troje, Terene	0	0	0
212	Ndërtesa e Konstruksione	5,396,192,698	5,126,383,064	-269,809,634
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	231,747,077	226,618,109	-5,128,968
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	2,210,556,070	1,875,746,406	-334,809,664
215	Mjete Transporti	36,934,552	43,764,270	6,829,718
216	Rezerva Shtetërore	0	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0
218	Inventar ekonomik	276,022,049	383,993,696	107,971,647
24	Aktivitet afatgjata të dëmtuara	0	0	0
28	Caktimet të Aktivitet Afatgjata	0	0	0
25-26	3. Aktivitet Afatgjata Financiare	0	0	0
	4. Investime	77,388,948	80,415,415	3,026,467
230	Për Aktivitet Afatgjata jo materiale	6,915,712	6,915,712	0
231	Për Aktivitet Afatgjata materiale	70,473,236	73,499,703	3,026,467

Burimi i të dhënave: QSUNT/përpunuar nga grupi i auditimit

Në mënyrë analitike llogaritë financiare të aktivitetit të pasqyrës financiare paraqiten si më poshtë vijon:

II. Aktivitet Afatgjata

1. Aktivitet afatgjatë jo materiale janë në vlerën 18,521,635 lekë me një rënie nga viti 2020 në vlerën 6,945,612 lekë si dhe me një rënie për vitin 2022 në vlerën 498,368,050 lekë, nga ku:

-Llog.202 “Studime dhe kërkime” paraqitet për vitin 2021 në vlerën 18,521,635 lekë nga ku në krahasim me vitin 2020 e cila i përket kemi një zbritje në vlerën 6,945,612 lekë, e cila në fund të vitit 2021 ka një vlerë bruto prej 46,304 mijë lekë dhe një amortizim të akumuluar prej 27,782 mijë lekë. Pra diferenca prej viteve përbën vetëm amortizimim vjetor prej 15 %. Për vitin 2022, ndryshimi i përket vetëm amortizimit në vlerën 6,945,614 lekë.

2. Aktivitet afatgjatë materiale janë në vlerën 8,151,452,446 lekë me një rënie nga viti 2020 në vlerën 570,572,884 lekë, nga ku:

-Llog.210 “Toka, Troje, Terene” paraqitet në vlerën 0 lekë pa ndryshuar nga viti i mëparshëm, 2021 ashtu si dhe për vitin 2022. Nga auditimi rezultoi se, për vitet 2021 dhe 2022, mungon pasqyrimi në kontabilitet i vlerës së tokës-truall në administrim të QSUNT, më konkretisht në formatin Nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Aktivitet afatgjata materiale”, llogaria 210 “Toka troje terren” është pasqyruar në mënyrë jo të saktë, në vlerën 0 lekë, në kundërshtim me UMF Nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar. Kjo çështje për grupin e auditimit është konsideruar materiale, pasi, bazuar në VKM Nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, referuar vlerës së pasurisë së paluajtshme të llojit tokë truall për qytetin e Tiranës, (referuar çmimeve të referencës), QSUNT duhet të përcaktojë çmimin përkatës.

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se QSUNT nuk ka një regjistër kontabël të pronave publike për të cilat ka në administrim si dhe nuk ka një regjistër të veçante për secilën nga pronat e dhëna

me qira, me të dhënat; sipërfaqja e objektit në m2, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qerases, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik në kundërshtim me pikën 26, 27 dhe 31 të udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011 “Menaxhimi i Aktiveve të NJSP”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi Nëpunësi Autorizues i QSUNT (Titullari i Institucionit).

-Llog.212 “Ndërtime e konstruksione”, paraqitet në fund të vitit 2021 paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën 5,396,192,698 lekë në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, ndërsa në pasqyrën 7/b “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 5,400,541,988 lekë.

Në vlerën bruto gjatë vitit 2021 ka pasur një rritje prej 37,220 mijë lekë, që përfaqëson 30,770 mijë lekë shtesë nga sistemimi i vlerës së një ndërtese të bërë në vitin paraardhës gabimisht dy herë dalje nga nxjerrja jashtë përdorimi, 624 mijë lekë si investim i kryer me fonde buxhetore në ndërtesën e rikonstruktuar të pediatriisë, 5,826 mijë lekë shtesa nga kryerja nga F. i një investimi në rehabilitimin e ambientit të skanerit të infektivit.

Rënia prej 249,707 mijë lekë në vlerën neto rrjedh si pasojë e shtimit të këtyre aktiveve si më sipër pakësuar me amortizimin vjetor (mbështetur në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.8, datë 09.03.2018, Pika 36, prej vitit 2018 norma e amortizimit prej 5%, krahasuar me 1% në periudhat paraardhëse) prej 282,295 mijë lekë.

Për vitin 2022 nuk ka pasur ndryshime në vlerën brutot të llogarisë. Rënia në vlerën neto vjen si pasojë e amortizimit vjetor prej 269,810 mijë lekë.

-Llog.213 “Rruge, rrjete vepra ujore” paraqitet për 231,747 mijë lekë në vlerë neto. Kryesisht përbëhet nga konstruksione të rrugëve në Q.S.U.T dhe rrjete të ndryshëm në funksion të aktivitetit të saj. Në vlerën bruto të tyre gjatë vitit 2021 ka pasur shtesë në vlerën 6,504 mijë lekë si investim i F. në sistemim dhe rehabilitim të hapësirave. Pakësimi i tyre vjen prej amortizimit të akumuluar në vlerën 51,296 mijë lekë.

Për vitin 2022 paraqitet për 226,618 mijë lekë në vlerë neto. Në vlerën bruto të tyre gjatë këtij viti kemi shtesa në vlerë 6,458 mijë. Pakësimi i tyre në vlerë bruto vjen prej amortizimit të akumuluar që është në vlerën 62,884 mijë lekë.

- Llog.214 “Instalime Teknike makineri, pajisje”, paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën 2,210,556,070 lekë në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, ndërsa në pasqyrën 7/b “Gjendja dhe Ndryshimi i aktiveve Afatgjata (vlera neto)” në vlerën 2,213,235,407 lekë.

Vlera prej 2,213,235,407 lekë përfaqëson shumën e llogarisë 214 dhe 2186 (pajisje kompjuterike) përlllogaritjen me vlerën bruto të këtyre aktiveve në vlerën 7,249,147,948 lekë duke zbritur amortizimin e akumuluar të tyre për 5,035,912,541 lekë. Gjatë vitit 2021 vlera neto e tyre ka patur një rritje prej 219,300 mijë lekë nga viti 2020 si rezultat i shtesave, pakësimeve dhe amortizimit të akumuluar.

Gjatë vitit 2021 vlera bruto e pajisjeve ka pasur një rritje prej 232,645 mijë lekë që përbëhet nga blerje nga të ardhurat dytësore prej 5,391 mijë lekë, dhurime për 22,281 mijë lekë, hyrje të tjera (gjetje nga inventarizimet) për 1,174 mijë lekë, transferime nga brenda sistemit kryesisht kryer nga MSHMS për 134,317 mijë lekë, si edhe investime buxhetore për pediatriinë në shumën 34,685 mijë lekë.

Shtesat gjatë vitit janë në total prej 232,897,776 lekë nga ku blerje krijuar me pagesë në vlerën 40,075,820, shtesa pa pagesë jashtë sistemit në vlerën 58,504,760 lekë si dhe shtesa pa pagesë brenda sistemit në vlerën 134,317,196.

Pakësimet në këtë zë të aktiveve për vitin 2022 janë në vlerën 13,597 mijë lekë dhe konsistojnë në transferime brenda sistemit.

Për vitin 2022 në vlerë neto prej 1,875,746 mijë lekë përfaqëson shumën e llogarisë 214 dhe 2186 (pajisje kompjuterike) përlllogaritur nga diferenca me vlerën bruto të këtyre aktiveve prej 7,331,440,530 lekë duke zbritur amortizimin e akumuluar të tyre për 5,455,694,125 lekë. Gjatë vitit 2022 vlera neto e tyre ka patur një rënie prej 337,489 mijë lekë nga viti 2021 si rezultat i shtesave, pakësimeve dhe amortizimit të akumuluar.

Shtesat e krijuara nga blerjet prej 157,901 mijë lekë kryesisht për pajisje për Spitalin e Ri të Sëmundjeve të Brendshme (Godina A2). Shtesat brenda dhe jashtë sistemit për 87,545 mijë lekë dhe 13,934 mijë lekë për gjetje nga inventarizimet dhe saktësimet e diferencave inventariale nga relacioni. Pakësimet që përbëhen nga daljet jashtë përdorimit me vlerë historikë 30,975 mijë lekë, dhe transferimet brenda dhe jashtë sistemit me vlerë 147,783 mijë lekë.

- Llog.215 “Mjete Transporti”, paraqitet në bilanc në fund të vitit 2021 në vlerën 36,934,552 lekë vlerë e cila nuk rakordon me pasqyrën 7/b “Gjendja dhe Ndryshimi i aktiveve Afatgjata (vlera neto)” për të njëjtën llogari, e cila paraqitet në vlerën 29,905,925 lekë.

Për vitin 2021 ka pasur shtesa pa pagesë brenda sistemit transferime nga MSHMS në vlerën 25,534,080 lekë si dhe pakësime 19,637,100 lekë të cilat i përkasin transferimeve drejt spitaleve të tjera.

Për vitin 2022 paraqitet në vlerën 43,794,420 lekë, nga ku krahasuar me 2022 spitali ka pasur një transferim nga MSHMS të një automjeti në vlerën 14,246,628 lekë. Amortizimi i akumuluar për vitin për vitin 2022 është 45,853 mijë lekë.

- Llog.218 “Inventar ekonomik”, paraqitet në vlerën prej 276,022,049 lekë dhe ku krahasuar me vitin 2020 kemi një rënie në vlerën 17,949,205 lekë. Janë kontabilizuar aktive si orendi dhe të tjera pajisje zyresh në fund të periudhës me një vlerë neto prej 276,467 mijë lekë që përbëhet nga vlera bruto e tyre prej 656,072 mijë lekë dhe amortizimi i akumuluar në zbritje për 379,605 mijë lekë. Në vlerën bruto të tyre shtesat gjatë vitit janë në shumën 42,171 mijë lekë dhe përbëhen kryesisht nga dhurime për 9,168 mijë lekë, blerje nga të ardhurat dytësore 292 mijë lekë, transferime për 266 mijë lekë, hyrje të tjera (gjetje nga inventarizimet) për 551 mijë lekë, si edhe investime buxhetore për pediatri në shumën 31,895 mijë lekë. Në këtë zë ka pakësime në vlerë bruto për 1,547 mijë lekë për nxjerrje jashtë përdorimi. Amortizimi i periudhës për këtë zë me ndikim në pakësimin e vlerës neto është në shumën 58,574 mijë lekë.

Për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 ka një rritje në vlerën 107,971,647 lekë ku janë të kontabilizuara aktive si orendi dhe të tjera pajisje zyresh në fund të periudhës ka një vlerë neto prej 383,994 mijë lekë shprehur në rritje krahasuar me vitin e kaluar prej 107,972 mijë lekë e cila përlllogaritet nga diferenca midis vlerës bruto të tyre prej 656,072 mijë lekë dhe amortizimi të akumuluar për 434,891 mijë lekë dhe shtesave dhe pakësimeve të ndodhura gjatë vitit. Shtesat e krijuara nga blerjet prej 161,815 mijë lekë kryesisht për pajisje për Spitalin e Ri të Sëmundjeve të Brendshme (Godina A2). Shtesat brenda dhe jashtë sistemit për 596 mijë lekë dhe 440 mijë lekë për gjetje nga inventarizimet dhe saktësimet e diferencave inventariale nga relacioni. Pakësimet për 40 mijë lekë për gjetje nga inventarizimet dhe saktësimet e diferencave inventariale nga relacioni.

3. Investimet paraqiten në total për vitin 2021 në vlerën prej 77,388,948 lekë me një rritje nga viti 2020 në vlerën prej 6,559,956 lekë si dhe rritje për vitin 2022 në vlerën 3,026,467 lekë.

- Llog. Nr.230 “Për aktivet afatgjatë jo materiale” në vlerën prej 6,915,712 e pa ndryshuar prej vitit 2020, paraqet 3 Projekt Preventiva për rikonstrukcione, të cilat vazhdojnë të mbeten si Aktive jo materiale në proces, trashëguar nga periudha paraardhëse, pasi kryerja e investimeve akoma nuk është kryer që këto zëra shpenzimesh të kapitalizohen.

- Llog. Nr.231 “Për aktivet afatgjatë material” në vlerën 70,473,236 lekë, e cila ka një rritje nga viti 2020 në vlerën 6,559,956 lekë nga ku shtesa në këtë zë konsiston në investimin në proces të

Rikonstruksionit të godinës së kartelave mjekësore me fonde investimesh buxhetore përveç 3 investimeve të cilat vijnë që prej vitit të mëparshëm.

Për vitin 2022 ka një rritje në vlerën 3,026,467 lekë ë cila ka të bëjë me një shtesë në vlerën 2,602,464 lekë për rikonstruksionin e godinës së arkivës së kartelave, në vlerën 424,002 lekë shtesë për blerje pajisje mjekësore dhe spitalore si dhe në vlerën 37,277 lekë.

Grupimi B - PASIVET

Passive Afatshkurtra

Nga llogaritë e pasivit për vitin 2021, konstatohet se pasivi përbëhet 100% nga pasive afatshkurtra në vlerën 1,308,109,754 lekë dhe për vitin 2022 në vlerën 1,234,627,879 lekë.

	Llog	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
67		1. Llogari të Pagueshme	1,308,109,754	1,234,627,879
68	401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	496,303,373	447,875,873
69	42	Detyrime ndaj personelit	209,456,791	185,202,254
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	20,598,731	19,323,236
75	435	Sigurime Shoqërore	50,856,272	52,349,305
76	436	Sigurime Shëndetësore	7,174,123	7,304,884
81	466	Kreditorë për mjete në ruajtje	5,927,197	6,052,199
82	467	Kreditorë të ndryshëm	124,166,367	124,166,367
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	393,626,900	392,353,761

Burimi i të dhënave: QSUNT/përpunuar nga grupi i auditimit

- Llog.401“Furnitorë e llogari të lidhura me të”, për vitin 2021 në vlerën 496,303,373 lekë, për vitin 2022 në vlerën 496,303,373, paraqet detyrimet ndaj tyre për blerje të kryera në muajin dhjetor të vitit 2021, paguar në periudhën aktuale dhe për të cilat është kërkuar Financim i pritshëm nga buxheti në datë 31.12.2021 si dhe më datë 31.12.2022.

- Llog.42 “Detyrime ndaj Personelit” për vitin 2021 në vlerën 209,456,791 lekë për vitin 2022 në vlerën 209,456,791 lekë, kjo llogari përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2021; si dhe tatimi i pagave të muajit Dhjetor 2021 të cilat likuidohen në Janar të vitit 2022. (e njëjta edhe për vitin 2022)

- Llog.435 & 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore“ përfaqëson kontributet e sigurimit shoqëror në shumën 50,856,272 lekë dhe sigurimit shëndetësor në shumën 7,174,123 lekë të muajit Dhjetor 2021, të cilat likuidohen në muajin Janar 2022. (e njëjta edhe për vitin 2022)

- Llog. 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” për vitin 2021 në vlerën 5,927,197 lekë ndërsa për vitin 2022 në vlerën 6,052,199 me një diferencë në vlerën 125,002 lekë më shumë. Kjo llog përfaqëson detyrimet për garanci punimesh të cilat janë mbajtur për kontrata të ndryshme sipërmarrje. Ky zë gjatë vitit 2021 është shtuar me 325 mijë lekë për garanci të mbajtura për investime kryer me fonde buxhetore dhe pakësuar për 9,748 mijë lekë për garanci të dhëna.

Për vitin 2022 shtesa prej 125 mijë lekë i takon garancisë së mbajtur për shtesë investimi.

-Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 124,166,367 lekë ë njëjtë për të dyja vitet (2021,2022), janë paraqitura në bilancin e datës 31.12.2021 për 124,166 mijë lekë detyrimet e njësisë ndaj të tjerëve. Këtu konsistojnë detyrimet e njësisë të mbartura kryesisht nga vitet 2010 – 2013, të cilat për arsye të ndryshme në vitet 2014 – 2015 kanë mbetur të papaguara nga fondet e përcaktuara në buxhetet e këtyre dy viteve për këtë qëllim, si edhe detyrime për 3 vendime gjyqësore të mëvonshme, të cilat zënë peshën më të madhe në vlerën 73,390,454 lekë. Gjatë vitit 2021 kemi një ulje prej rreth 20,595 mijë lekë krahasuar me vitin 2020, që rrjedh kryesisht si pasojë e pagesës së një pjese vendimesh gjyqësore (20,207 mijë lekë), dhe heqjes së detyrimeve për një pjesë tjetër (388 mijë lekë) në zbatim të rekomandimeve të KLSH.

- Llog.4341 “Të tjera operacione me shtetin (kreditor)” në shumën prej 393,627 mijë lekë për vitin 2021, ndërsa për vitin 2022 në vlerën 392,353,761 lekë nuk rakordon. Kjo llogari ka si kundërpartit llog.423 & llog.429,411,468.

Nga auditimi u konstatua se totali i llog. të sipërpërmendura si dhe përmbledhur në mënyre tabelare si më poshtë është 392,624,204 me një diferencë prej 270,443 lekë me pak.

	Llog.	Viti 2021 Vlera / lekë	Viti 2022 lekë
Llogaria 4341 Operacione me shtetin (detyrime)		0	0
Kundraparti			
Llogaria 423 ,429 personel paradhënie deficite gjoba	423/429	282,023	282,023
Debitorë të ndryshëm	468	392,798,945	392,342,181
Klient dhe llogari të ngjashme	411	545,930	0
	Total	393,626,898	392,624,204

Burimi i të dhënave: QSUNT/përpunuar nga grupi i auditimit

Aktivitet neto/ fondet

Ilog	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022	2022/2021
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	8,951,811,363	8,826,256,270	-125,555,093
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	8,951,811,363	8,826,256,270	-125,555,093
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	9,087,536,876	8,675,655,840	-411,881,036
12	Rezultatet e mbartura	155,273,032	-294,470,613	-449,743,645
85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	-368,387,494	364,655,628	733,043,122
115	Nga Fondet e veta të investimeve	44,555,002	33,311,578	-11,243,424
105	Teprica e Granteve kapitale Të Brendshme	32,833,946	47,103,837	14,269,891
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	10,259,921,117	10,060,884,149	-199,036,968

Burimi i të dhënave: QSUNT/përpunuar nga grupi i auditimit

Për vitin 2021 Nga të dhënat përmbledhëse të Pasivit të Pasqyrës Financiare rezulton se për vitin 2021 totali i pasivit me 31.12.2021, paraqitet me vlerën 10,259,921,117 lekë, ku me C-“AKTIVET NETO/FONDET” janë në vlerën 8,951,811,363 lekë e njëjtë në vlerë me D-“FONDI I KONSOLIDUAR” dhe zënë respektivisht 87% të vlerës totale të pasivit ndërsa B-“DETYRIMET” janë në vlerën 1,308,109,754 lekë e njëjtë në vlerë me “Pasivet Afatshkurtra” zënë rreth 13 %.

Për vitin 2022 totali i pasivit me 31.12.2022, paraqitet me vlerën 10,259,321,117 lekë, ku me C-“AKTIVET NETO/FONDET” janë në vlerën 8,951,811,363 lekë e njëjtë në vlerë me D-“FONDI I KONSOLIDUAR” dhe zënë respektivisht 87 % të vlerës totale të pasivit ndërsa B-“DETYRIMET” janë në vlerën 1,234,627,879 lekë e njëjtë në vlerë me “Pasivet Afatshkurtra” zënë rreth 13 %.

-Teprica (Fondi i akumuluar) për 8,675,656 mijë lekë paraqet në mënyrë të përmbledhur tepricën e fondeve të veta të kapitalizuara. Konstatohet një rënie prej afro 411,881 mijë lekë, ndikuar kryesisht nga amortizimi i vitit 2022 dhe dalja jashtë përdorimit miratuar në këtë vit dhe transferimet brenda sistemit.

Rezultatet e mbartura paraqet rezultatet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit rezulton me një vlerë pozitive prej 364,656 mijë lekë.

Zëri Nga Fondet e veta të investimeve për 33,312 mijë lekë paraqet shpenzimet për investime që janë kryer me të ardhurat dytësore dhe që janë në proces.

Teprica e granteve kapitale të brendshme për 47,104 mijë lekë përfaqëson tepricën në fund të periudhës për grante kapitale (investime nga buxheti) për AAM që janë në proces.

Rakordimet e Pasqyrave Financiare për vitin 2021:

Auditimi u bë me zgjedhje për këto llogari, formate e pasqyra financiare:

- Auditimi për barazimin e vlerës totale të Pasivit me Aktivin:

-Totali i aktiveve A është i barabartë me totalin e pasiveve E(B+C) të bilancit kontabël (Format1), në shumën 10,259,321,117 lekë.

Në pasiv të bilancit janë paraqitur me C “Aktivet Neto/Fondet” të institucionit që arrijnë në vlerën 8,951,811,363 lekë, e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së Aktivit të bilancit A – 10,259,321,117 lekë dhe grupeve B “Detyrimeve” 1,308,109,754 lekë.

- Llog.85 “Rezultati i veprimtarisë së Vitit Ushtrimor” në Formatin 2 është në vlerën - 368,387,494 lekë e njëjtë në vlerë me Llog.85 “Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore” në Grupimin D të Pasqyra e Pozicionit Financiar (Format1).

- Llog. 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit”, evidentuar në Pasqyrën Format 2 për 399,420,117 lekë në fund të vitit 2021, rakordon me ndryshimin e gjendjes së magazinës dhe është sa diferenca e klasës 3 “Gjendja e Inventarit Qarkullues” në aktivin e bilancit. Pra, janë të barabarta që të dyja me vlerën prej 399,420,117 lekë.

- Pasqyra e Flukseve Monetare Formati 3.

Pasqyra financiare e flukseve monetare jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë paraqet shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të institucionit, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.

Nga auditimi i zërave të pasqyrës rezulton se totali i flukseve të mjeteve monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e shfrytëzimit në vlerën 33,874,876 lekë është i barabartë me shumën e totalit të zërave: akordim fondesh buxhetore për shpenzime korrente në vlerën 8,738,088,000 lekë, arkëtime e të hyra gjatë vitit ushtrimor në vlerën 45,080,141 lekë dhe pagesa për detyrime e shpenzime korrente në vlerën 8,749,293,265 lekë.

Rubrika II, e cila pasqyron flukset monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e investimeve të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përbëhet nga zëra: akordim fondesh buxhetore për shpenzime kapitale për zërat 230 & 231 për vitin 2021 në vlerën 77,511,820 lekë dhe pagesa për detyrime e investime të vitit ushtrimor në vlerën -79,446,224 lekë e cila përbëhet nga pagesat e kryera nga përdorimi i Fondeve Buxhetore për shpenzime kapitale për 73,763,624 lekë dhe përdorimi i të ardhurave të trashëguara të njësisë për shpenzime kapitale për 5,682,600 lekë.

Rubrika III pasqyron flukset monetare që rrjedhin nga transfertat dhe transaksionet e tjera. Derdhje e transferime e të ardhurave në buxhet përfaqëson pjesën e të ardhurave që mblidhen nga njësia për llogari të buxhetit të shtetit për 10,575,733 lekë. Transferime në buxhet të fondeve të veta për pjesën e fondeve buxhetore të akorduara e të papërdorura në vlerën 5,672,138 lekë.

Nga auditimi i zërave rezulton se Rubrika IV në vlerën 15,747,851 lekë, e cila përfaqëson rritjen neto të mjeteve monetare në krahasim me vitin paraardhës, e cila është e barabartë me shumën algjebrike të rubrikave I, II dhe III.

Rubrika V dhe rubrika VI përfaqësojnë respektivisht gjendjen e mjeteve monetare në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor të mbyllur. Diferenca algjebrike e këtyre rubrikave është e barabartë me shumën e evidentuar në rubrikën IV.

Teprica e likuiditeteve në fund të vitit rakordon me llogarinë 520 “Disponibilitet në thesar” të pasqyrës së pozicionit financiar në shumën 42,829,018 lekë Rritja e likuiditeteve – për 15,747,851 lekë rakordon me diferencën midis mjeteve monetare në fillim të periudhës me ato në fund të periudhës.

Nga auditimi rezulton se “Akordimi i Fondeve Buxhetore për Shpenzime korrente”, Vlerat në lekë e Arkëtimeve është e njëjtë me vlerat respektive të llogarive në Pasqyrën Format 1 për vitin 2021 në vlerën 8,738,088,000 lekë; “Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime Kapitale” për vitin 2021 është në vlerën 77,511,820 lekë.

”Transferime në Buxhet të Fondeve të pa përdorura” në vlerën prej 5,672,138 lekë;

Rezulton me Rritje të vlerës monetare në shumën 15,747,851 lekë;

Teprica në fillim të vitit 2021 është e njëjtë në vlerë me atë të mbylljes së vitit 2020 në shumën prej 42,829,018 lekë;

Teprica e Likuiditeteve të vitit 2021 është 58,576,869 lekë e njëjtë në vlerë me Llog.520 “Disponibilitete në Thesar” + Llog.512,56 “Mjete monetare në bankë” të Pasqyra Format 1.

Rakordimet e Pasqyrave Financiare për vitin 2022:

Auditimi u bë me zgjedhje për këto llogari, formate e pasqyra financiare:

- Auditimi për barazimin e vlerës totale të Pasivit me Aktivin:

-Totali i aktiveve A është i barabartë me totalin e pasiveve E(B+C) të bilancit kontabël (Format1), në shumën 10,060,884,148 lekë.

Në pasiv të bilancit janë paraqitur me C “Aktivet Neto/Fondet” të institucionit që arrijnë në vlerën 8,826,256,270 lekë, e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së Aktivit të bilancit A – 10,060,884,148 lekë dhe grupeve B “Detyrimeve” 1,234,627,879 lekë.

- Llog.85 “Rezultati i veprimtarisë së Vitit Ushtrimor” në Formatin 2 është në vlerën - 364,655,628 lekë e njëjtë në vlerë me Llog.85 “Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore” në Grupimin D të Pasqyra e Pozicionit Financiar (Format1).

- Llog. 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit”, -289,440,569 evidentuar në Pasqyrën Format 2 për 289,440,569 lekë në fund të vitit 2021, rakordon me ndryshimin e gjendjes së magazinës dhe është sa diferenca e klasës 3 “Gjendja e Inventarit Qarkullues” në aktivin e bilancit. Pra, janë të barabarta që të dyja me vlerën prej 289,440,569 lekë.

- Pasqyra e Flukseve Monetare Formati 3.

Pasqyra financiare e flukseve monetare jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë paraqet shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të institucionit, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.

Nga auditimi i zërave të pasqyrës rezulton se totali i flukseve të mjeteve monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e shfrytëzimit në vlerën 158,328,735 lekë është i barabartë me shumën e totalit të zërave: akordim fondesh buxhetore për shpenzime korrente në vlerën 9,133,492,000 lekë, arkëtime e të hyra gjatë vitit ushtrimor në vlerën 141,604,744 lekë dhe pagesa për detyrime e shpenzime korrente në vlerën 9,116,768,009 lekë.

Rubrika II, e cila pasqyron flukset monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e investimeve të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përbëhet nga zëra: akordim fondesh buxhetore për shpenzime kapitale për zërat 230 & 231 për vitin 2022 në vlerën 250,836,421 lekë dhe pagesa për detyrime e investime të vitit ushtrimor në vlerën -332,192,571 lekë.

Rubrika III pasqyron flukset monetare që rrjedhin nga transfertat dhe transaksionet e tjera. Derdhje e transferime e të ardhurave në buxhet përfaqëson pjesën e të ardhurave që mbliidhen nga njësia për llogari të buxhetit të shtetit për -9,114,790 lekë. Transferime në buxhet të fondeve të veta për pjesën e fondeve buxhetore të akorduara e të papërdorura në vlerën -17,429,413 lekë.

Nga auditimi i zërave rezulton se Rubrika IV në vlerën 50,428,382 lekë, e cila përfaqëson rritjen neto të mjeteve monetare në krahasim me vitin paraardhës, e cila është e barabartë me shumën algjebrike të rubrikave I, II dhe III.

Rubrika V dhe rubrika VI përfaqësojnë respektivisht gjendjen e mjeteve monetare në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor të mbyllur. Diferenca algjebrike e këtyre rubrikave është e barabartë me shumën e evidentuar në rubrikën IV

Teprica e likuiditeteve në fund të vitit rakordon me llogarinë 520 “Disponibilitet në thesar” të pasqyrës së pozicionit financiar në shumën 109,005,251 lekë Rritja e likuiditeteve – për 50,428,382 lekë rakordon me diferencën midis mjeteve monetare në fillim të periudhës me ato në fund të periudhës.

Nga auditimi rezulton se “Akordimi i Fondeve Buxhetore për Shpenzime korrente”, Vlerat në lekë e Arkëtimeve është e njëjtë me vlerat respektive të llogarive në Pasqyrën Format 1 për vitin 2022 në vlerën 9,133,492,000 lekë; “Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime Kapitale” për vitin 2022 është në vlerën 250,836,421 lekë.

”Transferime në Buxhet të Fondeve të pa përdorura” në vlerën prej 17,429,413 lekë;
 Rezulton me Rritje të vlerës monetare në shumën 50,428,382 lekë;
 Teprica në fillim të vitit 2022 është e njëjtë në vlerë me atë të mbylljes së vitit 2021 në shumën prej 58,576,869 lekë;
 Teprica e Likuiditeteve të vitit 2022 është 109,005,251 lekë e njëjtë në vlerë me Llog.520 “Disponibilitete në Thesar” + Llog.512,56 “Mjete monetare në bankë” të Pasqyra Format 1.
 - Pasqyra Pyetësor dhe Shënime Shpjeguese Format 5.
 Kjo pasqyrë është plotësuar pjesërisht duke mos e përmbushur qëllimin e saj. Plotësimi i të gjitha posteve të kësaj pasqyre do të sillte një lehtësi në verifikimin e çdo llogarie dhe dhënien e opinionit mbi saktësinë, plotësinë dhe qartësinë e pasqyrave financiare.
 - Pasqyra e Investimeve dhe Burimet e Financimit Format 6.
 Nga Grupi i Auditimit u bënë verifikimet:
 Llog.105 e F6 është e barabartë me Llog.105 në F1;
 Llog.106 e F6 është e barabartë me Llog.106 në F1;
 Llog.111 e F6 është e barabartë me Llog.111 në F1;
 Llog.115 e F6 është e barabartë me Llog.115 në F1;
 Llog.12 e F6 është e barabartë me Llog.12 në F1;
 Llog.16+17 e F6 është e barabartë me Llog.16+17 në F1;
 Llog.230 & Llog.231 e F6 janë të barabarta me Llog.230 & Llog.231 në F1;
 Llog.25/26 e F6 është e barabartë me Llog.25/26 në F1.
 -Pasqyrat financiare vjetore nuk janë miratuar nga Bordi i QSUNT (miratimi i raportit vjetor të veprimtarisë financiare), veprim në kundërshtim Urdhrin e Përbashkët Nr. 709, datë 10.10.2018, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e Statutit të QSUNT "Nënë Tereza", KREU III “ORGANIZIMI”, pika 10 “Bordi i QSU "Nene Tereza" ka këto funksione dhe përgjegjësi”, pika c ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Miraton raportin vjetor të veprimtarisë financiare”.
 Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi Bordin e QSUNT.

Titulli i Gjetjes Nr.1	Mos pasqyrim i sakte i llog.210
Situata:	Sipërfaqet e trojeve në llogarinë 210 si dhe vlerat e tyre në vitin 2021 dhe 2022 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vleftën 0 lekë. Nga Institucioni disponohet dokumentacion dhe planimetri (genplan) për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve, që ka në dispozicion subjekti për periudhën objekt auditimit, por rezulton se nuk është regjistruar kjo sipërfaqe në zyrat e kadastrës shtetërore dhe në hipotekë, në bazë të përcaktimeve të ligjit Nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe ligjit Nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Sipërfaqja totale e tokës prej 165,000m ² , që ka QSUNT në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet.
Kriteri:	Pikën 3.3 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci)”, paragrafi 62, dhe paragrafi 91, të Udhëzimit të MFE me Nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Mos pasqyrim i saktë i llogarisë 210.

Shkaku:	Mos zbatim i ligjit mbi inventarizimit dhe regjistrimin e pronës shtetërore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	<p>Nga QSUNT të ngrihet një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe mbi këtë bazë të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore dhe të aplikohet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të institucionit.</p> <p>Nga QSUNT të merren masa për përlogaritjen e vlerave nga ekspertët e fushës, dhe më pas Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të ndërmarr veprimet e nevojshme të regjistrimit të pasurisë në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.</p>

Titulli i Gjetjes Nr.2	Mos saktësimi i debitorëve pa shpresë arkëtimi
Situata:	<p>Në pasqyrën e pozicionit financiar të institucionit më 31.12.2022, gjendja debitorë (klasa 4) paraqitet në vlera të konsiderueshme përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” paraqitet në vlerën 392,342,181 lekë, e cila përbëhet nga detyrime të lëna nga KLSH ndër vite (2009-2019), për shkeljet e konstatuara: <ul style="list-style-type: none"> - për vitin 2009 në shumën prej 52,854,614 lekë - për vitin 2011 në vlerën 201,053 lekë - për vitin 2013 në vlerën 1,009,125 lekë - për vitin 2016 në vlerën 32,320,512 lekë - për vitin 2019 në vlerën 284,220,030 lekë -për vitin 2020 në vlerën 12,740,164 lekë. <p>Nga auditimi rezulton se nga QSUNT nuk është bërë një ndarje e detyrimeve për të përcaktuar se, sa janë me shpresë arkëtimi apo likuidimi, sa prej tyre kanë një vjetërsi mbi 10 vjet, si dhe nuk janë marrë masat për zhvlerësimin e të drejtave.</p> <ul style="list-style-type: none"> -Llogaria 486“Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në vlerën 124,166,367 lekë përfaqëson detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara,, të cilat i ka ndarë sipas natyrës së tyre në: <ul style="list-style-type: none"> - “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për shërbime dhe mirëmbajtje” në vlerën 7373,lekë, “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për investime” në vlerën 2,862,616 lekë, si dhe kreditorë të ndryshëm për blerje barnash në vlerën 30,786,399 lekë, detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, të cilat i përkasin periudhave 2009-2013; si dhe -“Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore” në vlerën 73,390,454 lekë.
Kriteri:	Udhëzimi i MFE Nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes,

	Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, ndryshuar me UMF nr. 5, datë 21.02.2022 pika 15, seksioni 3.1 paragrafi dytë.
Ndikimi/Efekti:	Mos pasqyrim i saktë i llogarisë 468 Debitor të ndryshëm.
Shkaku:	Mos seleksionim debitorëve me debitorë pa shprese arkëtimi si dhe reflektimi në llog.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	<p>-QSUNT të marrë masa, duke krijuar grup pune të veçantë me përfaqësues të fushës së financave dhe fushës juridike për analizimin e hollësishëm të debitorëve. Të bashkëpunohet me PAI – et, për gjetjen e saktë të të dhënave të debitorëve fizik (ish-punonjës) dhe të subjekteve fizik e juridik, për të identifikuar shumat pa shpresë arkëtimi të klientëve dhe debitorëve të ndryshëm, pasi të jenë ezauruar më parë të gjitha rrugët e mundshme ligjore për arkëtimin e tyre.</p> <p>- Organet Drejtuese të QSUNT duhet të sigurojnë iniciimin e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha të drejtat me palët e treta të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin dhe likuidimin e tyre, si dhe të propozojë masa konkrete, duke mos e përjashtuar masat administrative dhe të tjera nëse është e nevojshme.</p> <p>-Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit në çdo rast të ndjekë dhe zbatojë me përpikmëri parimin FIFO, gjatë likuidimit të detyrimeve të prapambetura.</p> <p>- Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të marrë masa për krijimin e provizioneve për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme, pasi të jenë evidentuar të dhënat për klientët, si shumën e detyrimit, vjetërsinë e tyre (datën e lidhjes së kontratës) dhe situatën aktuale të tyre, si dhe pasi të jenë kaluar më parë të gjitha rrugët e mundshme ligjore për mbledhjen e tyre, duke prekur llogarinë 49 “Shuma të parashikuara për zhvlerësim”.</p>

Me shkresën nr.1177/24 prot. Datë 14.08.2023 nga QSUNT janë paraqitur observacionet ne KLSH, në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit nga Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse, L.C..

Pretendimi i Subjektit:

Sqarojmë se, për dy rekomandimet e mësipërme (47.1; 47.2) jemi në proces.

Referuar bazës ligjore, VKM-së nr.782, datë 07.10.2020, korrespondencave me e-mail me MSHMS në vijim të procesit të inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, metodologjinë e punës për inventarizim dhe realizimin e këtij procesi, shkresës së Drejtorisë Juridike me nr.902/4 prot., datë 30.05.2023, nepermjet shkreses me nr.902/5 prot., date 01.06.2023 i jemi drejtuar UPT ku i kërkojmë të vijohet me hapat e mëtejshëm per planin e rilevimit për pronat e QSUT sipas aneksit 4 të VKM-se nr.782, datë 07.10.2020 i cili do të bëhet nga inxhinier topograf të licensuar për hartim plan rilevimesh sipas modelit dhe në përputhje me standartet teknike si dhe më pas me inventarizimin e cdo godine dhe trualli dhe më pas do të aplikohet në ASHK. Është lidhur kontrata midis QSUT dhe UPT për rilevimin topografik dhe aktualisht është dorëzuar gjithë materiali që QSUT ka, tek topografi i licensuar, i cili pasi do përfundojë punën, do të na vëri në dispozicion dokumentacionin, ku QSUT do merret me hapat e mëtejshme.

Pra, i gjithë ky proces nuk varet vetëm nga QSUT, por po punohet që të bëhet e mundur inventarizimi i pronës në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Për sa më sipër trajtuar nga subjekti nuk është sjellur asnjë dokumentacion shtesë.

B. Inventarizimi i pronës shtetërore

Për vitin 2020. në zbatimit të ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuara, dhe Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, me urdhrin Nr. 134, datë 15.04.2020 “Mbi nxjerrjen e aktiveve të SUNT-së nga përdorimi, të vlerësuara si jashtë përdorimit”, i ndryshuar me urdhrin Nr.134/1 datë 16.05.2020 “ Për një ndryshim në urdhrin Nr.134 datë 15.04.2020. urdhri Nr.134/1/1 datë 18.09.2020 Për shtyrjen e afatit të dorëzimit të relacionit përmbledhës, urdhrin Nr.134/2 datë 30.11.2020 dhe urdhrin Nr.134/3 datë 22.12.2020 “Për shtyrjen e afatit të dorëzimit të relacionit përmbledhës”, grupi i punës ka paraqitur raportin përmbledhës mbi vlerësimin për nxjerrjen jashtë përdorimit të A.A.M të institucionit, i përbërë nga 7 anëtarë ka paraqitur raportim përmbledhës “Mbi procedurën Përfundimtare mbi procesin e nxjerrjes së aktiveve të QSUNT-së nga përdorimi të vlerësuara si jashtë përdorimit”.

Në zbatim të vendimit Nr.04 datë 05.02.2020¹⁰ “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të A.A.M për vitet 2016,2017,2018,2019” si dhe shkresën Nr.448/11 datë 02.02.2020 nga ku është miratuar nga titullari i konstitucionit grupi përgjegjës prej 7 anëtarësh, ku grupi me shkresën Nr.679/1 datë 27.05.2021 ka hartuar përmbledhjen mbi masat e marra për aktivet e vlerësuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit nga ku janë mbajtur Proces verbale për nxjerrjen e materialeve jashtë përdorimit, bashkëlidhur me fotot përkatëse. Në total referuar relacioneve përkatëse si dhe përmbledhjes tabelare më poshtë, janë marre masa për, asgjësim apo ndryshuar forma, një pjesë janë rregulluar me iniciativë të vetë personelit, një pjesë kishin kaluar dy herë proces vlerësimi si dhe një pjesë për të cilat pas rivlerësimit janë trajtuar si mallra konsumi.

Në lekë

Përshkrimi	kosto historike	amortizim i akumuluar	vlera e mbetur
Total	900,030,779	561,946,277	338,048,501
Të asgjësuara/ndryshuar forma	896,627,129	559,925,326	336,701,803
Janë në gjendje pune	2,024,941	1,121,753	903,188
Vlerësuar dy herë	710,752	492,109	218,643
Sistemuar në relacion	667,957	407,087	260,870

Punuar nga grupi i auditimit

Për vitin 2021 Drejtori i Përgjithshëm, (në cilësinë e titullarit të institucionit) me urdhrat Nr.588 datë 06.12.2021 “Për inventarizimin e pajisjeve, aparaturave mjekësore dhe inventarit ekonomik në të gjitha Polet Administrative të Integruar në QSUNT për vitin 2021”, (përveç spitalit infektiv, spital covid-4 dhe në shërbimet polivalent që ushtron funksionin e covid-3, për shkak të cilat do kryhen në një moment të dyte), shkresa Nr.587, datë 06.12.2021 “Për inventarizimin e pasurive të paluajtshëm (ndërtesa) dhe automjete në QSUNT për vitin 2021”, ka ngritur grupet e punës për mbi procesin e vërtetimit, saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të aseteve, në të gjithë shërbimet e QSUNT-së. Struktura e Shërbimit Mjekësor të QSUNT organizohet në tetë pole shërbimesh, të quajtura Polet e Administrimit të Integruar nga ku si më poshtë vijon:

¹⁰Ps.Grupi i auditimit edhe pse procedura e nxjerrjes jashtë përdorimit është kryer për aktivet e vitit 2016,2017,2018,2019 si rezultat i përfundimit të tij me 27.05.2021, u auditua për rregullshmërinë ligjore mbi hapat e marrë për këtë procedurë referuar bazave ligjore si dhe reflektimit të tyre ne pasqyrat financiare të viti 2021 të cilat janë objekt auditimi.

1. Poli i Aktivitetit të Integruar të Sëmundjeve të Brendshme
2. Poli i Aktivitetit të Integruar të Spitalit Polivalent
3. Poli i Aktivitetit të Integruar të Spitalit të Neuroshkencës
4. Poli i Aktivitetit të Integruar të Spitalit Francez
5. Poli i Aktivitetit të Integruar të Spitalit Pediatrik
6. Poli i Aktivitetit të Integruar të Spitalit Onkologjik
7. Poli i Aktivitetit të Integruar të Spitalit Infektiv
8. Poli i Aktivitetit të Integruar të Konsultave

Të gjitha PAI-ve i është dorëzuar lista e aktiveve për inventarizim e cila i është bashkëlidhur praktikës së inventarizimit, nga ku secili prej tyre ka hartuar relacionin përfundimtar mbi inventarizimin fizik të pajisjeve dhe aparaturave inventarin e imët si dhe inventarin ekonomik.

Nga auditimi i raporteve përmbledhëse për 8 PAI-it si dhe dokumenteve bashkëlidhur grupi i auditimit ka konstatuar:

1.PAI i Sëmundjeve të Brendshme

Grupi i punë i përbërë nga M. A., L.H., Daniel Lufri, I.H. dhe M.R. ka hartuar relacionin përmbledhës Nr.3057/1 datë 30.12.2021.

-Në inventarin e aparaturave është konstatuar se në disa shërbime ka mospërputhje të gjendje fizike me Inventarin Ekonomik nga ku:

PI-01/34 DR/E. P. në vlerën 85,000 lekë, grupi i punës ka raportuar se personi përgjegjës është i pezulluar nga puna dhe ambienti që disponon është i mbyllur, nga ku komisioni nuk mund të procedoje me inventarin.

Grupi i auditimit konstatoi se, grupi i punës nuk ka zbatuar urdhrin e titullarit për inventarizimin e aktiveve të cilat ndodhen në përgjegjësi/apo ambientin përkatës.

PI-01/28 Laboratori Imunologjisë në vlerën 22,128,362 lekë dhe për inventarin ekonomik në vlerën 1,569,074 lekë. Ambientet dhe aktivitet sipas marrëveshjes midis QSUNT i kanë kaluar në administrim Akademisë së Shkencave.

Me shkresën Nr.456/1 datë 08.03.2021 Zëvendësministri znj. M.R., ka autorizuar QSUNT të lidhi marrëveshjen me Akademisë e Shkencave, për kalimin e ambienteve dhe kalimin e aseteve me kalim kapitali të ish laboratorit të imunologjisë, për krijimin prej ASH të një qendre laboratorike për studime në fushën e imuno-gjenetike, duke qenë se nuk prek mbarëvajtjes e shërbimit laboratorik (kaluar në shërbim koncesione) dhe të aktivitetit spitalor të QSUNT.

Me marrëveshjen e Bashkëpunimit Nr.364/3 datë 12.04.2021, midis QSUNT dhe ASH është lidhur kontrata dypalëshe me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara. Kjo marrëveshje është rinovuar për vitin 2022 më kontratën protokolluar me Nr.1203/1 datë 06.05.2022, po me të njëjtat kushte. Me shkresën Nr.364/7 datë 25.05.2021 grupi i punës i ngritur nga titullari i institucionit ka informuar titullarin mbi kalimin e inventarit dhe ambienteve të ish laboratorit të imunologjisë të Akademia e Shkencave nga ku është mbajtur proces verbali, firmosur nga përfaqësuesit e QSUNT dhe përfaqësuesit e marrjes në dorëzim nga ASH.

Konstatime nga grupi i auditimit

-Grupi i auditimit nga sa më sipër trajtuar konstatoi se vendimi në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit midis ASH dhe QSUNT është marre nga zv/ministri i MSHMS dhe jo nga bordi i Spitalit në kundërshtim me pikën 10/ë të Kreut III të Statusit të QSUT miratuar me urdhrin e përbashkëti Nr.709 datë 10.10.2018, e cila citon se Bordi i QSUNT vlerëson dhe miraton procedurën mbi përdorimin e Aktiveve të QSUNT.

-Gjithashtu grupi i auditimit konstatoi se nga ana e QSUNT nuk është marrë asnjë masë për shkëputjen nga detyrimet si energjike (KESH) dhe ato të uji (UKT), nga QSUNT dhe kalimin e tyre në ASH, duke renduar mbi shpenzimet e QSUNT.

-PI-01/09 Reaminacioni i Kardiologjisë, për artikullin “Dollap rrobash me 16 ndarje karrige” 2 cope e cila pas vlerësimit nga grupi përkatës është rregulluar për shkak të lapsusit në regjistrim të gabuar në inventar nga ku është mbajtur dhe proces verbali përkatës.

2. Poli i Aktivitetit të Integruar të Spitalit Polivalent

Grupi i punës i përberë nga E.T., E.K., A.L., A.V. dhe A.Th., referuar relacionit përmbledhës Nr.3057/5 datë 31.12.2021 drejtuar titullarit të institucionit dhe drejtorisë ekonomike nga ku ka konstatuar si më poshtë:

Inventari i Pajisjeve Mjekësore dhe Aparaturave

-Në disa shërbime për shkak të pandemisë së Covid-19 nuk ka qenë e mundur të bëhet inventarizimi fizik, për disa pavione.

-Në shërbimin PI_02/33-Pavioni salla operacionit në vlerën 34,259,962 lekë, asetet përputhen me verifikimin fizik por nuk i nevojiten shërbimit, nga ku propozohet ti kaloj një shërbimi tjetër.

-Në shërbimin PI_02/43 në vlerën **18,833,609 lekë Radiologji Onkologji, janë** verifikuar setet fizikisht, po personi përgjegjës Gjergj Golemi nuk firmos pasi aparatura “Aparat Radiografisë” është çmontuar dhe lëvizur nga vendi. (trajtuar në observcion)

-Në shërbimin PI_02/46- Echo Abdimunale Spitali 5, në vlerën 1,968,000 lekë, përputhet me asetet e verifikuara fizikisht. Por ECHO Doppler (collor) nuk është në gjendje pune.

-Në shërbimin pl_02/61 Pavioni intermediar në vlerën 319,327 lekë përputhet me asetet e verifikuara fizikisht por nuk i nevojiten shërbimit, nga ku propozojmë ti kalojnë një shërbimi tjetër.

3.Poli i Aktivitetit të Integruar të Spitalit të Neuroshkencës

Grupi i punës i përberë nga K.K., F.C., A.M., E.K.dhe E.S., ka hartuar relacion përmbledhës Nr.3057/7 datë 31.12.2021. Pas inventarizimit fizik dhe kontabël, grupi i punës ka rezultuar se nuk ka pasur probleme gjatë verifikimit të tyre, nga ku kemi rakordance. Ka shumë materiale që duhet të nxirren jashtë përdorimit, të cilat zënë ambientet dhe dhomat në pavione. *Nga grupi i auditimit u konstatua se propozimet se për cilat materiale behet fjale nuk janë saktësuar dhe evidentuar nga grupi i inventarizimit.*

4.Poli i Aktivitetit të Integruar të Spitalit Francez

Grupi i punës i përberë nga A.M., O.M., M.C., E.K. dhe Gj.M.ka hartuar relacionin përmbledhës me Nr.3057/3 datë 31.12.2021 nga ku është konstatuar se duhet bërë një sistemim në PL_07/42 me emërtim blloku operator sistemimin e artikujve nga inventar i aparaturave në inventar ekonomik pasi janë, një kompjuter, nje munitor dhe një printer.

Inventari i Aparaturave

-Në shërbimin PI_07/24 me vlerë 203,297 lekë, nuk është kryer inventarizimi pasi ambienti ndodhet i mbyllur për arsye pushimit vjetor të personi. *Grupi i auditimi konstatoi se grupi i punës nuk e ka zbatuar të plotë urdhrin e titullarit, për këtë shërbim.*

5.Poli i Aktivitetit të Integruar të Spitalit Pediatrik

Grupi i punës i përberë nga B.R., S.B., E.S., A.G., S.Ll., të cilët kanë hartuar relacionin përmbledhës drejtuar titullarit dhe drejtorisë së financave me shkresën Nr.3057/6 datë 31.12.2021. Problematikat e hasura janë si më poshtë vijon:

-Në kodin PI_03/17 për inventarin ekonomik është gjendur teprice në vlerën 7,926 lekë, grila rolles.

-Në kodin PI_03/23 për inventarin ekonomik gjetur ,mungese grilla rolës në vlerën 7,926 lekë.

Në kodin PI_03/34 janë kërkuar të kalohen disa asete të kalojnë në inventar ekonomik në vlerë totale prej 131,000 lekë, si dhe për dy pajisje të specifikohet përshkrimi.

Gjithashtu grupi ka shprehur problematikën se duhet të mundësohet nxjerrja jashtë përdorimit e të gjitha asetëve që nuk përdoren apo janë jashtë funksionit në mënyrë që të lirohen ambientet e zëna nga to dhe të vihen në shërbim të pavioneve përkatëse.

6.Poli i Aktivitetit të Integruar të Spitalit Onkologjik

Gupi i punës i përbërë nga A.I., J.S., E.Gj., E.Sh.dhe L.S., ka hartuar relacionin përmbledhës me Nr.3057/4 datë 31.12.2021. Pas përfundimit të numërimit fizik me rakordimin e fletëve të inventarit grupi i punës ka konstatuar:

-Inventari ekonomik PL_06/01 në vlerën 33,000 lekë e cila përputhet me gjendjen fizike, por fizikisht është jashtë funksionit.

-Inventari i imët Pl_06/3 në vlerën 3,960 lekë përputhen me gjendjen fizike por asetet janë të prishura.

-Inventari i aparaturave Pl_06/09 përputhet me gjendjen fizike , me përjashtim të PMS0125 të cilat gjendjen të prishura në vlerën 5,0105,880 lekë.

-Inventari Ekonomik me kod magazine Pl_06/16 për aktivin Aparat telefoni në vlerën 2,940 lekë është gjendur i prishur për nxjerrje jashtë përdorimi.

-Inventari i laboratorit me kod magazine Pl_06/16 Kompjuterë HP 500 HT në vlerën 99,000 lekë është gjendur fizikisht i prishur për nxjerrje jashtë përdorimit.

-Inventari i Aparaturave me kod Pl_06/37 për 4 aktive të ndryshme në vlerën total prej 69,421,642 lekë, janë gjendur jashtë funksionit.

7.Poli i Aktivitetit të Integruar të Konsultave Ambulatorëe dhe Farmacisë Qendrore

Grupi i punës me përbërje R.G., M.K., J.Q., E.K., E.N. pasi kanë kryer inventarizimin fizik në prezencë të personave përgjegjës si dhe referuar fletëve të inventarit kontabël kanë hartuar relacionin përmbledhës Nr.3057/2 datë 30.12.2021, nga ku çdo gjë ka rezultuar e kuadruar përveç teprica e tre fikëse zjarri në Pl_08/06 1 copë, Pl_08/7 1 cope dhe Pl_08/08 1 copë.

8.Drejtoria e Përgjithshme dhe Urgjencat

Grupi i punës me përbërje, E.J., N.K., D.M., G.S. dhe M.H. kane përgatitur raportin përmbledhës Nr.3057/8 datë 31.12.2021 mbi rezultatet për inventarizimin e kryer në polin e drejtorisë së përgjithshme dhe urgjencës, nga ku ka rezultuar:

-Fleta e inventarit të sektorit të It-se A.K.Pl_09/1 në vlerën 8,246,904 lekë, është e pafirmosur pasi A.K.është larguar pa kryer dorëzimet.

Lidhur me sa më sipër (problematik e mbartur që prej vitit 2013 dhe evidentuar edhe nga grupi i mëparshëm i auditimit)rezulton se përgjegjësi material (A.K.) nuk ka bërë dorëzimet në momentin e lënies së detyrës për materiale inventar ekonomik në vlerën 8,246,904 lekë, në kundërshtim me pikën 13, udhëzimit 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Fleta e inventarit të Drejtorisë Juridike “Pl_09/99 në vlerën 431,722 lekë, është e pa firmosur pasi nuk ka person përgjegjës, por asetet ndodhen fizikisht në zyrën e drejtorit juridik.

9.Invetarizimi i Magazinave (IN1, M1 dhe M2)

Me urdhrin Nr.627 datë 30.12.2021 miratuar nga titullari i institucionit dhe protokolluar me Nr.3257 datë 30.12.2021, janë ngritur 3 grupe pune për inventarizimin e vlerave materiale në magazinën IN1, M1 dhe M2 të QSUT. Të tre grupet e punës kanë hartuar relacione përkatëse mbi problematikën e hasura, nga ku si më poshtë vijon:

-Me shkresën Nr.97 datë 06.01.2022 grupi i punës i përbërë nga M.H., E.S. dhe A.L. kanë kryer inventarizimin fizik bazuar mbi atë kontabël ka ku nuk kanë gjetur diferenca.

-Me shkresën Nr.97/1 datë 07.01.2021 grupi i punës i përberë nga D.L, P.C. dhe A.M. kanë hartuar relacionin e tyre nga ku nuk janë konstatuar mungesa por një pjesë e materialeve gjendje në magazinën M2 janë vlerësuar jashtë përdorimit.

Grupi i auditimit konstatoi se gjate procesit të inventarizimit, në asnjë prej aktiveve të regjistruara nuk është shënuar gjendja e tyre cilësore, edhe pse janë shprehur se shumë materiale janë jashtë përdorimit, nuk janë cilësuar se për cilat materiale bëhet fjale.

-Me shkresën Nr.97/2 grupi i punës i përberë nga E.S., E.Th. dhe Gj.M., kanë hartuar relacionin e tyre mbi inventarizimin e magazinës IN1, nga ku nuk janë gjetur diferenca por janë konstatuar materiale të cilat janë jashtë përdorimit. *Grupi i auditimit konstatoi se gjate procesit të inventarizimit, në asnjë prej aktiveve të regjistruara nuk është shënuar gjendja e tyre cilësore, edhe pse janë shprehur se shumë materiale janë jashtë përdorimit, nuk janë cilësuar se për cilat materiale bëhet fjale.*

10. Inventari i Pasurisë së Paluajtshme dhe Ndërtesat

Me urdhrin Nr.587 datë 06.12.2021 titullari i institucionit ka ngritur grupin e punës të përbërë nga E.N., G.K., Y.K., E.C. dhe P.C. “Për inventarizimin e pasurive të paluajtshme (ndërtesa) dhe automjete në të gjithë QSUNT për vitin 2021. Me shkresën Nr.3056/1 datë 30.12.2021 grupi i punës ka hartuar raportin përfundimtar nga ku ka raportuar problematikat si më poshtë:

-Grupi i punës ka rezultuar se godina Mjekësore Ligjore në vlerën 2,023,676 lekë është në përdorim të Ministrisë së Drejtësisë si dhe stafi që punon. Kjo godinë ndodhet në fletët e inventarit , nga ku propozohet të kalojë për kalim kapitali në Ministri. Godina e Laboratorit të Pediatrisë në vlerën 15,768,705 lekë është në përdorim të Telemjekësisë, nga ku propozojmë të rishikohet dokumentacioni për kalim inventari Telemjekësisë.

-Godina e Informacionit me Nr. pasurie 1/259 dhe godina e regjistruar me Subjekt person privat fizik “K.Gj.” me Nr. pasurie 1/313 dalin si tepriçë në inventar, ku propozojmë që *Drejtoria e Shërbimeve mbështetëse dhe Drejtoria ekonomike dhe Planifikimit Financiar të bëjë verifikimet.* Inventari i Automjeteve

-Nga verifikimi në terren tre makina të cilat me urdhrin e Ministrit Nr.564 dt..27.12.2006, janë në përdorim të Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, 1 prej tyre Autoambulanca me targë TR1806C nuk ndodhej në ambientet e NJVKSH.

-Grupi i inventarizimit referuar kartelave si dhe gjendjes fizike të automjeteve rezultoi se QSUNT ka 21 makina në përdorim (tre prej NJVKSH), nga ku 8 makina janë propozuar për tu nxjerre jashtë përdorimit pasi janë jashtë funksionit.

Grupi i auditimit konstatoi se për një nga makinat (në përdorim të NJVKSH) e cila nga grupi i punës nuk është gjendur fizikisht, është propozuar për tu nxjerre nga përdorimi, nga ku makina me targa TR/1806 C në vlerën 750,000 lekë. Gjithashtu edhe fleta e inventarit është e firmosur nga grupi i punës(rregulluar në vitin 2022, lapsus i grupit të inventarizimit).

Me shkresën Nr.1270 prot., datë 29.04.2022 “Raporti përmbledhës mbi procesin e inventarizimit të vlerave materiale, aparatura, pajisje...për vitin 2021” grupi i punës i përberë nga S.D. specialiste në sektorin e financës, D.Sh. përgjegjës në sektorin e financës dhe I.K. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar, ka hartuar përmbledhjen e raporteve të PAI-ve drejtuar Titullarit të Institucionit, në zbatim të urdhrin të titullarit janë relatuar problematikat vetëm për tepriçat dhe mungesat e konstatuara nga grupet e inventarizimit.

Kostatime nga grupi i auditimit

-QSUNT nuk ka një regjistër të hartuar dhe miratuar si dhe kartela të punonjësve, të aktiveve në varësi të llojit që ka në pronësi apo përdorim, nga ku të përmbajë *datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit në kundërshtim me kapitullin III, pika 26,28,30 të udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011 të MFE “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.*

-QSUNT gjithashtu nuk ka hartuar dhe miratuar regjistrin kontabël mbi pronat publike që ka në

administrim apo pronat të cilat ka dhënë me qira dhe siguron të ardhura në kundërshtim me kapitullin III, pika 26, 31 të udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011 të MFE “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

-Pjesa më e madhe e grupeve të inventarizimit, kanë kryer kontrollin fizik referuar inventarit kontabël nga sektori i financës, duke u shprehur vetëm për gjendjen fizike të tyre dhe jo për gjendjen cilësore në kundërshtim me pikën 85/a të udhëzimit Nr.30 “Menaxhimin i Aktiveve të NJSP” e cila citon se “Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit.”.

Disa nga grupet e inventarizimit nuk janë shprehur në lidhje me verifikimin cilësor të aktiveve por vetëm verifikimin fizik.

-Gjithashtu në disa raste grupet e inventarizimit, janë shprehur në mënyre narrative për disa aktive të cilat duhet të nxirren jashtë përdorimit pasi janë jashtë funksionit dhe kanë zënë hapësirat e pavijoni, por nuk kanë evidentuar se cilat janë këto pajisje në kundërshtim me bazën ligjore të sipërpërmendur.

-Grupi i auditimit konstatoi se në disa raste, grupi i inventarizimit shprehet se personat përgjegjës të materialeve kanë qenë me leje, apo zyra ka qenë e mbyllur nga ku nuk është bërë e mundur inventarizimi i aktiveve, duke mos zbatuar urdhrin e titullarit i cili ka lënë një afat pothuajse një muaj për të kryer inventarizimet, nga ku lejet një ditore apo javore nuk janë justifikim për mos të zbatuar urdhrin e titullarit në një moment të dytë gjatë harkut kohor të përcaktuar.

-Grupi i auditimit konstatoi se grupi i inventarizimit për polin e drejtorisë së përgjithshme dhe urgjencës, është shprehur se “Fleta e inventarit të sektorit të It-se A.K.Pl_09/1 në vlerën 8,246,904 lekë, është e pafirmosur pasi z. A.K. është larguar pa kryer dorëzimet”, duke mos zbatuar urdhrin e titullarit mbi inventarizimin e aktiveve si dhe marrjen e një rezultati se cilat nga aktivet ndodhën fizikisht por duke e lënë si problematike siç ka rezultuar prej vitesh.

Për veprimet dhe mosveprimet e konstatimeve të mësipërme, mbajnë përgjegjësi: Grupi i punës për inventarizimin e PAI i Sëmundjeve të Brendshme; Poli i Aktivitetit të Integruar të Spitalit të Neuroshkencës; Poli i Aktivitetit të Integruar të Spitalit Francez; Drejtorja e Përgjithshme dhe Urgjencat ;Grupi i punës për inventarizimin e magazinën IN1 & M2, dhe Nëpunësi Zbatues znj. I.K..

Mbi saktësimin e diferencave të inventarëve

Me urdhrin Nr.170 datë 09.05.2022 protokolluar me shkresën Nr. 1270/1, datë 09.05.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për saktësimin e diferencave të inventarëve”, titullari i institucionit ka ngritur grupin e punës mbi saktësimin e diferencave të inventarëve për vitin 2021.

QSUNT ka proceduar me verifikimin, saktësimin dhe vlerësimin e diferencave të inventarëve fizik dhe kontabël për vitin 2021.

Sipas këtij urdhri grupi i punës ka dorëzuar relacion përkatës përmbledhës brenda datës 31.05.2022. Me shkresën Nr. 1270/4, datë 31.05.2022 grupi i punës ka hartuar “Relacionin përmbledhës mbi saktësimin e diferencave të rezultuara nga procesi i inventarizimit të QSUNT për vitin 2021”.

Në relacion evidentohen problematikat e hershme në QSUNT sa i takon menaxhimin të aktiveve që kanë të bëjnë me dublimet e shkaktuara nga regjistrimi si teprica i aseteve të cilave ju është ndërruar vendndodhja pa i shoqëruar me dokumentacionin përkatës, pasaktësia e përshkrimeve, donacionet individuale në vite të pa dokumentuara. Grupi i Punës ka verifikuar problematikat, saktësuar sasinë dhe vendodhjen se objekteve të inventarit, të cilat kanë rezultuar tepricë. Vlerësimi i këtyre tepricave është bërë duke u bazuar në çmimet e objekteve të ngjashëm. Për

asetet që janë klasifikuar gabim në momentin e hyrjes si aktive materiale afatgjate, duke u nisur nga vlerësimi i personave specialiste, është bërë riklasifikimi i tyre në grupin e duhur. Nisur nga rezultatet e inventarizimit, grupi i punës ka proceduar me vlerësimin e tepërcave në inventarët e secilit PAI me vlerat përkatëse si dhe janë kryer sistemet përkatëse në kontabilitet.

Me shkresën Nr.1270/5 datë 12.08.2022 “Propozimet mbi diferencat e rezultuara nga procesi i inventarizimit për vitin 2021” drejtuar titullarit të institucionit, grupi i punës përsa i përket 3 çështjeve i është drejtuar për zgjidhjen e problematikës drejtorive si më poshtë:

1.Për problematikën e Pl_02/43 Radiologji Onkologjiku, në vlerën 18,833,609 lekë aparatura “Aparat Radiografise”, kalimin për ndjekje të mëtejshme nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse L.C. dhe Drejtoria e IT & Inxhinierisë Klinike, ish-punonjëse B.M..

2.Për problematikën PL_09/01 “A.K.” në vlerën 8,246,904 lekë, kalimin për ndjekjen nga Drejtoria Juridike, B.L.(i komanduar)

3.Në lidhje me inventarizimin e Covid-1, covid-3 dhe covid-4 propozojmë inventarizimin e tyre në një moment të përshtatshëm duke qenë se është shtuar numri i rasteve me covid-19 në fund të këtij viti.

Konstatimet nga grupi i auditimit

-Nga Titullari i Institucionit, nuk është marrë asnjë masë për pajisjet laboratorike apo materialet të ndryshme në vlerë 55,380,898 lekë nga ku grupi i inventarizimit është shprehur se nuk i nevojiten pavijonit, duke i lenë aktivet të përdorshëm në pavijonet respektive, pa kryer një ri grumbullim, vlerësim të tyre dhe si dhe shpërndarjen e tyre në pavijonet apo spitalet të cilat mund ti nevojiten. Përmbledhur në mënyrë tabelare si më poshtë:

Pajisjet e vlerësuar si të panevojshëm për pavjonin	në lekë
Pavioni salla operacionit,Pl_02/33	34,259,962
Radiologji Onkologji “Aparat Radiografise” Pl_02/43	18,833,609
Pl_02/46- Echo Abdimunale spitali 5	1,968,000
pl_02/61 Pavioni intermediar	319,327
Totali	55,380,898

Punuar nga grupi i auditimit

-Titullari i Institucionit nuk ka marrë asnjë masë për aktivet të cilat nga grupi i inventarizimit janë vlerësuar si jashtë përdorimit, ashtu si dhe në disa pavijone kanë zënë ambientet për të cilat pavijonet kanë nevojë të shfrytëzojnë për shërbim dhe jo magazinim të aktiveve të përdorshme.

-Në lidhje me problematikën e inventarizimit të ndërtesave (trajtuar më sipër është sugjeruar bashkëpunim midis Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtorisë Juridike, nga ku *nuk është marrë asnjë masë na vazhdim për zgjidhjen e problematikave.*

-Procesi i inventarizimit nuk është finalizuar nga ku Titullari i Institucionit nuk ka ngritur grupin e punës “Për vlerësimin e aktiveve si dhe komisionin për nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre në kundërshtim me pikën 99,100 të udhëzimit Nr. 30 të MFE datë 27.12.2011 “*Menaxhimi i aktiveve të NJSP*”.

Për veprimet dhe mosveprimet e konstatimeve të mësipërme, mbajnë përgjegjësi: Titullari i Institucionit znj. A.F., nëpunësi zbatues I.K., B.L. me detyrë Drejtor i Komanduar i Drejtorisë Juridike, L.C. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

Për vitin 2022. Me urdhrin Nr.397 datë 10.10.2022 “Për inventarizimin e pajisjeve, aparaturave mjekësore dhe inventarit ekonomik në të gjitha Polet Administrative të Integruar në QSUNT për vitin 2022”, Nr.505 datë 12.12.2022 “Për një ndryshim në Urdhrin Nr.397 dt.. 10.10.2022”, Nr.500,datë 06.12.2022 “Për inventarizimin e pasurive të paluajtshëm (ndërtesa) dhe automjete në QSUNT për vitin 2022”,Nr.542 datë 30.12.2022 “Për inventarizimin e vlerave materiale në magazinën IN1,M1,M2 të QSUNT-së për vitin 2022” grupet e punës kanë realizuar procesin e saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të aseteve, në të gjithë shërbimet e QSUNT-së. Referuar

problematikave të konstatuara nga grupi i punës i përberë me shkresën Nr.93/3 datë 03.02.2023 drejtuar titullarit të institucionit është hartuar përmbledhja e tyre nga S. D., L. T. miratuar nga E.U. drejtuar titullarit të institucionit nga ku trajtuar si më poshtë vijon:

1.Poli i Administrimit të Integruar të Sëmundjeve të Brendshme grup i përbërë nga: M.A., L.H., I.H., A.R., Gj.M. ka dorëzuar përmbledhjen me shkresën Nr.2450/6 datë 29.12.2022 nga ku ka konstatuar:

Në Pl_01/32 Kabineti i Kardiokirurgjisë ECO ka rezultuar teprice asetesh, Nr.Inv /35006 Sonde kardiake P/Ge Modeli 3SC-RS me nr. seriali 936167 WX6–1 cope dhe PL-01/21 Salla Kardiokirurgjise teprice asetesh -Shtrat operator Prodhuesi M. me Model HyBase 6100 – 1 cope dhe Llamp operatore Prodhuesi K.M.– 1 copë.

Grupi i inventarizimit gjithashtu ka lënë një shënim ku citon se *“Në një relacion tjetër do ju informojmë për inventarin ekonomik dhe të aparaturave se cilat nuk janë jo funksionale meqenëse PAI i Sëmundjeve të brendshme është në pragun e kalimit tek godina e re A2”*.

Grupi i auditimit konstatoi se grupi i inventarizimit nuk i ka zbatuar urdhrin e titullarit Nr.397 dt..10.10.2022 për vlerësimin e gjendjes fizike të aktiveve.

2.Poli i Administrimit të Spitalit Polivalent grup i përbërë nga: E.T. , E.K., M.R., E.B., A.K. ka dorëzuar raportin përmbledhës me shkresën Nr.2450/8 datë 30.12.2022 nga ku ka konstatuar:

Se në disa shërbime janë gjetur dyert e hapura me dhunë (të dëmtuara) nga ku një pjesë e aktiveve nuk janë gjetur (nga ku përgjegjësit e materialeve nuk pranojnë të firmosin), si dhe një pjesë e aktiveve janë vlerësuar si të papërdorshme.

Për këtë nga ky grup është mbajtur procesverbali Nr.2450/2 datë 21.12.2022 firmosur nga E.K., E.B., A.K. nga administratorja E.T., procesverbal të cilin ja kanë drejtuar E.U. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar, Drejtorit të Përgjithshëm A.F., zv Drejtorit të Përgjithshëm A.S. dhe N.S., Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse L.C. si dhe Drejtorit të IT dhe Inxhinierisë Klinike R.H., prej të cilëve nuk është marre asnjë masë për konstatimin e dhënë.

E.U. me detyrë Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar me shkresën/relacion Nr.93/3, prot, datë 03.02.2023, ka njoftuar znj. A.F. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, për këtë fakt të konstatuar nga grupi i inventarizimit *(se në disa shërbime janë gjetur dyert e hapura me dhunë (të dëmtuara) nga ku një pjesë e aktiveve nuk janë gjetur (nga ku përgjegjësit e materialeve nuk pranojnë të firmosin) si dhe një pjese e aktiveve janë vlerësuar si të papërdorshme dhe të dëmtuara).*

R.D., me detyrë Kryeinfermiere, në cilësinë e përgjegjëses së materialeve të sipërcituara sqaroi se *“Për shkak të transferimit të kirurgjisë (KLI) në ambiente të reja në dhjetor të vitit 2019, në godinën e re janë transferuar vetëm disa pajisje (jo me dokument autorizues, por në gjykimin e saj duke qenë se mungonin në kirurgjinë e re) dhe pjesa tjetër e aktiveve mbeten në këtë shërbim. Përgjegjësja e materialit mbylli dyert duke mbajtur çelësin e këtij shërbimi, (jo me funksional, por me aktive funksionale). Kjo godine nga ku brenda ishte dhe ky shërbim i kaloj COVID-3 si dhe COVID-1.*

Me urdhrin Nr.307, datë 21.06.2021, titullari i institucionit ngriti grupi e punës për inventarizimin e pajisjeve dhe aparaturave, si dhe inventarin ekonomik në spitalet COVID3 dhe COVID4 në QSUNT për vitin 2020”. Me datë 30.06.2021 me shkresën Nr.1739/1 datë 30.06.2021 grupi i punës ka kryer inventarizimin nga ku ka cituar se *“komisioni pas verifikimit nuk ka konstatuar diferenca”*.

Konstatimi i dyerve të dëmtuara dhe aktive të munguara është kryer me datë 21.12.2022, çka do të thotë se ka ndodhur para kësaj date që në opinionin e grupit të auditimit mund të ketë ndodhur në periudhën 30.06.2021 – 21.12.2022, fakt i cili nuk është denoncuar apo lajmëruar as nga punonjësit e shërbimit COVID 3 të cilët kanë qenë në atë ambient as nga punonjësi roje i

operatorit ekonomik I.G., i cili ka për detyrë ruajtjen dhe sigurimin e objektit si dhe as nga Titullari i Institucionit.

Grupi i auditimit kërkoj Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar dokumentet autorizues dhe vërtetues mbi kalimin e aktiveve të kirurgjisë 1, në kirurgjinë e re, si dhe arsytet se pse këto aktive duke qenë në funksion janë lënë të mbyllura në një ambient duke i kthyer në të papërdorshme, por grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë dokument, çka sjell nga ana e titullarit të institucionin si person përgjegjës për përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësive që mbulojnë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre nuk është marrë asnjë masë në zbatim të pikës 7,8,9 të udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011 “Menaxhimi i Aktiveve të NJSP”.

Nga Institucioni nuk janë marrë masa për përdorimin e pajisjeve të ndodhura në godinën e vjetër kirurgjia 1 në vlerë totale **108,640,529 lekë** por i kanë mbyllur duke i quajtur të vjetra edhe pse kanë qenë të përdorshme.

Pajisjet me vlerë totale **108,640,529 lekë**, nuk janë evidentuar në Inventarin pajisjeve mjekësore të papërdorshme (të pariparueshme apo me kosto të lartë riparimi), si dhe procedura e nxjerrjes jashtë përdorimit.

Nuk ka urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm për këtë status të pajisjeve (arsyet e mos shpërndarjes në shërbim), si dhe përse këto pajisje nuk janë magazinuar me listë emërore.

Si nuk janë në inventarin e pajisjeve mjekësore.

Referuar sa më sipër në opinionin e grupit të auditimit nuk është e arsyetuar (argumentuar) domosdoshmëria e blerjes së pajisjeve të reja për kirurgjinë e re e cila ka filluar të funksionojë në dhjetor të viti 2019, pra bëhet fjalë për të njëjta pajisje të cilat janë me status të papërdorshme.

Në mënyrë të detajuar tabela aktivet e dëmtuara dhe aktivet e humbura si më poshtë vijon:

Janë vlerësuar nga grupi i inventarizimit si të papërdorshëm, të dëmtuara për tu vlerësuar për nxjerje jashtë përdorimit 165 aktive në vlerën totale prej **86,754,536 lekë**, si më poshtë:

Nr.	Shërbimi	Magazina	Nr. Aktivi	Vlera/në lekë
1	Salla Klinikës	PL_02/02	10	21,673,616
2	Salla klinikës II urologji	PI_02/14	139	64,790,561
3	Klinika Urologji	PI_02/16	11	73,177
4	Reaminacion	PI_02/58	5	217,182
	Totali		165	86,754,536

Nga grupi i inventarizimit **nuk janë gjendur 192 aktive** në vlerë totale prej **21,885,993 lekë** nga ku përmbledhur në mënyrë tabelare si më poshtë vijon:

Nr.	Kodi	Emërtimi	Çmimi	Sasia	Vlefte	Prgj.Materiali
1	PM0138	Wired network laser printer with additional toner cartridge (printer hp-m201)	203,297	1.00	203,297.42	R.D.
2	PM0187	Shishe aspiratori	21,600	5.00	108,000.00	R.D.
3	PMS1/0324	Monitor	1,356,760	1.00	1,356,760.00	R.D.
4	PMS2/0070	Aspirator aesculap,sn:586125,nr inv11544	25,000	1.00	25,000.00	R.D.
5	PMS2/0344	Oksimeter tip spejllav	50,000	1.00	50,000.00	R.D.
6	PMS2/0346	Aspirator tip es2	13,740	2.00	27,480.00	R.D.
7	PMS2/0347	Elektrobisturi(elektrosugary)	1,003,101	1.00	1,003,101.00	R.D.
8	PMS2/0354	Komplet i madh(veglash-sete)	10,000	1.00	10,000.00	R.D.
9	PMS2/0355	Llampe surgical mount	2,061,023	2.00	4,122,045.20	R.D.
10	PMS2/0356	Llampe surgical flour mount	591,352	1.00	591,352.00	R.D.
11	PMS2/0361	Sistem laporoscopi me vegla endoscopi sony	12,214,874	1.00	12,214,873.5	R.D.

12	PMS2/0365	Vegla kirurgjikale(set i vogël)	64,615	2.00	129,229.50	R.D.
13	PMS2/0371	Gërshërë	240	10.00	2,400.00	R.D.
14	PMS2/0372	Klema	270	95.00	25,650.00	R.D.
15	PMS2/0373	Pinca	220	48.00	10,560.00	R.D.
16	PMS2/0380	Kubël zgjatues	12,000	2.00	24,000.00	R.D.
17	PMS2/0382	Tub lidhes për manshet	13,800	2.00	27,600.00	R.D.
18	PMS2/0389	Aparat anestezie dameca nr 9401064	1,275,300	1.00	1,275,300.00	R.D.
19	PMS2/0390	Marsheta tensioni	32,968	2.00	65,936.00	R.D.
20	PMS2/0392	Kuti kontrolli	24,218	1.00	24,218.00	R.D.
21	PMS2/0394	Elektrobisturi	196,200	2.00	392,400.00	R.D.
22	IE0158	Kompjuter dell optiplex 760	21,511	1.00	21,511.20	R.D.
23	IEK2/0006	Aparat telefoni	2,940	1.00	2,940.00	R.D.
24	IEK2/0009	Barele të sëmurësh	36,000	2.00	72,000.00	R.D.
25	IEK2/0010	Karroce të sëmurësh	28,000	2.00	56,000.00	R.D.
26	IEK2/0018	Karrige me rrota portokalli	13,440	2.00	26,880.00	R.D.
27	IE0469	Karroca me rrota	8,730	2.00	17,460.10	R.D.
		Totali		192	21,885,993	R.D.

Drejtori i përgjithshëm në zbatim të kompetencave dhe detyrimeve ligjore që janë përcaktuar në Statut, si dhe të legjislacionit specifik për administrimin e pronës shtetërore, nuk ka marrë asnjë masë përse i përket denoncimit të aktit në organet kompetente (prokurori, polici etj.), nxjerrjes së përgjegjësive për aktive e humbura, si dhe dëmshpërblimin e vlerës **21,885,993 lekë për 192 aktivet e humbura**.

Grupi i inventarizimit ka evidentuar disa teprica si në PL_02/34 Reanimacioni i Përgjithshëm, sonde Kardiake GE (2 copë) dhe në PL_02/74 Ekografi Sonde Kardiake GE (1 cope).

-Shërbimi “Klinika I Kirurgji” - PL_02/14 në vlerën - *Pajisjet janë në vend dhe duhen hequr sepse janë jashtë funksionit.*

-Shërbimi “SALLA OPERACIONIT”- PL_02/33 në vlerën 12,707,062 lekë për inventarin ekonomik dhe në vlerën 34,259,962 lekë për inventarin e aparaturave, i cili ka vite që nuk funksionon dhe personi përgjegjës refuzon ti firmose përsëri sepse ai nuk është më në atë shërbim. Pajisjet janë të magazinuar në një prej ambienteve të Urgjencës Kirurgjikale. Sipas verifikimit të kryer në këtë ambient rezultoi që pajisjet janë aty sipas fletës së inventarit. (e njëjta problematike edhe për vitin 2021). Grupi i auditimit konstatoi se këto pajisje gjatë inventarizimit për vitin 2021, grupi është shprehur se “*Asetet përputhen me verifikimin fizik por nuk i nevojiten shërbimit, nga ku propozohet ti kaloj një shërbimi tjetër*”. Titullari i institucionit nuk ka marrë asnjë masë për shpërndarjen e tyre në shërbimet apo spitalet për të cilat ato mund të kenë nevojë, duke i lënë të papërdorshme çka rrezikojnë amortizimin e tyre si dhe mos arritjen e qëllimit për të cilin janë blerë. (trajtuar në konstatimin për vitin 2021)

Vlera 21,885,993 lekë përbën dëm ekonomik për QSUNT dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.

Vlera prej 86,754,536 lekë për 165 aktivet e dëmtuara përbën një shpenzim për të cilin nuk është arritur plotësisht qëllimi i blerjes, pasi nuk janë përdorur deri në amortizimin apo mos funksionimin plotë të tyre, por janë dëmtuar duke u nxjerrë jashtë funksioni.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre nuk kanë maksimalizuar plotësisht efikasitetin dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, veprim në kundërshtim me: Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe Neni 8, pika 1, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në

njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 93, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19.

Me shkesën nr.1177/25 prot datë 14.08.2023 ne KLSH janë protokolluar observacionet e dërguara nga QSUNT, nga ku ngrihen pretendimet si më poshte vijon nga Drejtori i Përgjithshëm znj.A.F. dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike z.B.L.;

*Siç i kemi referuar Drejtorisë së Policisë Tiranë në shkresën nr. 912 prot., datë 18.04.2023 ‘Dërgim Informacioni’, nga QSUNT me nr. 93/3 prot., datë 03.02.2023 u hartua raporti përmbledhës mbi procesin e inventarizimit...; Në këtë kuadër nga Komisariati i Policisë nr. 4 janë kryer një sërë veprimesh, si dhe korrespondenca shkresore, ku së fundi i kemi përcjellë informacion me shkresën nr. 912/5 prot., datë 03.08.2023 ‘Kthim përgjigje...’. Për sa i përket marrjes së masave nga QSUNT si dhe evidentimi i përgjegjësive duke marrë vendim për zhdëmtim, sqarojmë se referuar ndodhemi përpara faktit të përgjegjësisë penale dhe përgjegjësisë administrative. Për sa i përket përgjegjësisë civile prë kërkimin e dëmshpërblimit, sqarojmë se referuar parashikimeve Nenit 120 të Kodit Civil të RSH, ku parashikohet se: Për kërkimin e shpërblimit të dëmit jokontraktor, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar **dhe për personin që e ka shkaktuar**, QSUNT nuk ka dijeni për personin që e ka shkaktuar dëmin, në mënyrë që të vijojë per procedurat përkatëse për zhdëmtim.*

Sqarojmë se referuar Nenit 4 të Kodit të Procedurës Penale ku në pikën 1 dhe 2 parashikohet se: 1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. 2. Gjykata jep vendim fajësie kur i pandehuri rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Nenit 390, pika 1 ku parashikohet se: 1. Kur fajësia e të pandehurit provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, gjykata jep vendim dënimi, duke caktuar llojin dhe masën e dënimit, QSUNT është në pritje të kryerjes së të gjitha procedurave përkatëse nga organet ligjzbatuese dhe përfundimin e hetimeve, që të identifikohen personat përgjegjës. Kjo me qëllim marrjen e masave civile dhe administrative për punonjësit, duke respektuar parashikimet e Kodit të Punës në Nenin 27, pika 1, 2 dhe 3 ku citohet se: 1. Punëmarrësi përgjigjet ndaj punëdhënësit për dëmin që i shkakton kur shkel detyrimet kontraktuale me dashje ose nga pakujdesia. 2. Shkalla e kujdesit, që duhet të tregojë punëmarrësi në punë, varet nga njohuritë teknike, të nevojshme për të kryer punën e caktuar, duke pasur parasysh aftësitë dhe cilësitë e punëmarrësit, që punëdhënësi i njihet ose duhet t’i kishte njohur. Dëmi, që lidhet në mënyrë të qenësishme me kryerjen e punës, përballohet nga punëdhënësi. 3. Dëmi përfshin dëmin real dhe fitimin e munguar, si dhe afatet e përcaktuara në Nenin 203 ku citohet se: 1. Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet. Ky afat fillon nga data e lindjes të së drejtës. Kur e drejta bazohet në shkeljen e një dispozite të Kodit Penal, afati i parashkrimit për veprën penale është i zbatueshëm edhe për veprën civile., kjo duke marrë parasysh që aplikimi i pikës 2 të këtij neni, është i aplikueshëm në momentin e marrjes dijeni të punëdhënësit, mbi punëmarrësin i cili ka shkaktuar dëmin [ref. neni 120 i KC].

Qëndrimi i Audituesit

Nga sa trajtuar më sipër, nga subjekti nuk është paraqitur asnjë dokument apo argument shtesë nga sa trajtuar në observacionet e trajtuara ne Projekt Raportin e Auditimit, nga ku ky observacion nuk do të merret parasysh.

3.Inventarizimi i aparaturave, pajisjeve dhe inventari ekonomik i PAI-t Infektiv, grupi i përbërë nga: O.M., S.S., B.V., S.C., A.R. ka dorëzuar relacionin përmbledhës me shkresën Nr.2450/7 datë 30.12.2022 nga ku ka rezultuar:

Në Pl_04/25 Kabineti i Fibrokolonoskopise me vlerën 18,388,900 lekë rezultoi se në këtë shërbim nuk është bërë inventar pasi Aparati i Skanimit Hepatik (Elastografia) me kod PMS4/0096 dhe vlerën 14,140,000 lekë ndodhet në PAI-n e Konsultave.

Në datë 12 Maj 2022, në PAI-n e Qendrës së Konsultave Ambulatore, u transferua nga PAI i Spitalit Infektiv, Aparatura e Elastografisë në vlerë **14,140,000 lekë** në përgjegjësi të M.S. me detyre infermiere, me Nr. inventari të B.-it 19235. Nga B.-i u konstatua se aparaturës i mungonte Sonda.

Më datë 20 korrik nga PAI i Spitalit Infektiv, është sjellë në PAI-n e Konsultave Ambulatore një sondë, e cila nuk ka lidhje me sondën e inventarizuar të kësaj pajisje. Fakt i konstatuar në datë 9 Gusht nga B., me interpretimin se sonda e sjellë nuk është ajo e inventarit bazuar në numrin serial dhe datën e kalibrimit të realizuar të prodhuesit, me Mirëmbajtjen Preventive 2021. Kjo është e vërtetuar nëpërmjet e-maileve, të këmbëzera me të gjithë shefat të përfshirë, në transferimin e Aparaturës së Elastografisë.

Në lidhje me këtë çështje znj. R.G. me detyrë administratore e PAI-t të Konsultave ka deklaruar/sqaruar se momentalisht aparatura Elastografi në vlerën 14,1140,000 lekë është e vetmja në QSUNT si dhe rajon, e cila shërben për të nxjerrë analizat e funksionimit të mëlçisë kryesisht për pacientët me Hepatit B & C, aparaturë së cilës i është vendosur një sondë tjetër, dhe se kjo sondë duke mos qenë e saj, shpesh herë aparatura kërkon Kalibrimin e Pajisjes. Referuar pikës 13.6.4 të VKM Nr. 731, datë 2.9.2015 “Për Miratimin e Rregullit Teknik “Për Kërkesat Thelbësore, Vlerësimin e Konformitetit, Klasifikimin dhe Markimin CE të Pajisjeve Mjekësore” kalibrimi i pajisjeve mjekësore është i detyrueshëm për të siguruar dhe vërtetuar se rezultatet të cilat vijnë nga këto pajisje janë të sakta dhe të sigurta.

Në opinionin e grupit të auditimi modifikimi i aparaturë me sondë tjetër, jo bashkohore në përshatje të plotë me specifikat teknike Aparaturës së Elastografisë, jo vetëm është shpenzim i tepër, por është risk i lartë për kryerjen e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për jetën e pacientëve.

Për posë sa më sipër transferimi i Aparaturës së Elastografisë është bërë jo vetëm i mangët, por edhe me tre muaj me vonesë, duke bërë kështu mos dhënien e shërbimit për pacientet për tre muaj radhazi (shërbim i llojit të veçantë).

Fakt i provuar nga komunikimet e shumta me e-maili ndërmjet Administratores së Qendrës së Konsultave Ambulatore, R.G. dhe B.M. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike.

Konkretisht më datë 29.04.2022 është bërë njoftimi me e-mail nga drejtoresha e Drejtorisë së IT dhe inxhinierisë Klinike drejtuar Administratores së QKA R.G., se do bëhet kalimi i aparatit elastografisë brenda ditës, **kalim i cili është bërë tre muaj me vonës dhe kalimi nuk është i plotë dhe i saktë, pra me sondë të munguar.**

Më datë 20 korrik 2022 është sjell nga shërbimi i **infektivit një sondë tjetër, nga ku biomedikali ka konstatuar se nuk është e njëjta sondë për të cilën kjo pajisje është blerë si dhe kalibruar.**

Grupi i auditimit kërkoj nga Drejtoria e IT dhe Inxhinierisë Klinike (Biomedikali, si drejtori në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm), si dhe sektorit të Inxhinierisë klinike si sektor të cilin ka nën përgjegjësi, regjistrin e rekordeve të aparaturës për shërbimet e kryera, dokumentin autorizues për lëvizjen e aparaturës, dokumentet vërtetues, si dhe procesverbalet e mbajtura për të tre ndodhitë e sipërcituar, nga ku procesverbali për kalimin e aparaturës nga një shërbim në tjetrin, **procesverbali për konstatimin e mungesës së sondës, procesverbalin për konstatimin se sonda e ardhur nga Infektivi nuk është e njëjta me sondën e ardhur, procesverbalin për vendosjen e sondës së re, si dhe 2 kalibrimet e pajisjes, në momentin e kalibrimit të saj nga prodhuesi, si dhe kalibrimi i pajisjes po nga prodhuesi pas vendosjes së sondës së re.** Grupit të auditimit nuk

ju vu në dispozicion asnjë nga dokumentet e kërkuara.

Edhe pse në të gjitha e-maillet të cilat janë shkëmbyer nga Drejtoria e IT dhe Inxhinierisë Klinike dhe Administratores se QKA, si dhe Administratores së Infektivit, njëkohësisht është njoftuar edhe titullari i institucionit, me relacionin Nr.2450/5 datë 29.12.2022, pas mbylljes së inventarizimit është vënë në dijeni përsëri Titullari i Institucionit A.F., i cili nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për vjedhjen e sondës aparatit elastografisë, si denoncim në organet e rendit dhe të prokurorisë, nxjerrjen e urdhër zhdëmtim, vënien para përgjegjesisë së personave përkatës, si dhe marrjen e menjëhershme të masës së blerjes së sondës nga prodhuesi/ekuivalent, kalibrimi me personat të licencuar të pajisjes dhe vënien në funksion.

Në opinionin e grupit të auditimit duhet të ishte kryer “Prova e funksionit”, duke zbatuar procedura sipas të cilave çdo pajisje mjekësore e rregulluar për t’u përdorur tek pacienti për diagnostikim apo terapi, duhet të kontrollohet para çdo përdorimi. Prova e funksionimit duhet të bëhet në përputhje me manualin e përdoruesit ose në përputhje me udhëzimet e inxhinierit klinik. Pajisjet mjekësore që kanë nevojë për aksesore duhet të kenë në dispozicion gjatë përdorimit të tyre furnizim të mjaftueshëm me to. Duhet të përdoren si aksesore vetëm ato që rekomandohen nga prodhuesi. Mund të përdoren aksesore të ndryshëm nga ato që rekomandon prodhuesi vetëm nëse siguria dhe ruajtja e performancës së pajisjes mjekësore garantojnë.

Gjithashtu grupi ka theksuar faktin se disa nga materialet e inventarit ekonomik janë të dëmtuara dhe jashtë funksionit (shënuar nga grupi në fletët e inventarizimi për secilin nga aktivet) pasi u përdoren si njësi COVID 3 në Pandemi si dhe Infektiv në momentin e rikonstruksionit të këtij spitali.

Raporti përmbledhës nuk ka evidentuar se cilat nga aktivet janë propozuar për tu vlerësuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

Vlera 14,140,000 lekë përbën dëm ekonomik për QSUNT dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet. Për dëmit shëndetësor që është i pa llogaritshëm, pasi shërbimi përveçse nuk i është dhënë për tre muaj kryesisht pacienteve me diagnozë (Hepatit B & C), por që prej datës 21.08.2022 e në vazhdim, analizat e kësaj pajisje janë të pasigurta pasi nuk është kryer kalibrimi i kësaj pajisje. (pas vendosjes së sondës së re)

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” KREU II “Përgjegjësitë e shtetit dhe të shtetasve” Neni 4, pika 1.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre, nuk kanë maksimalizuar plotësisht eficientën dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike.

Me shkresën nr.1177/24 datë 14.08.2023, nga QSUNT është paraqitur observacioni i ardhur nga Drejtori i IT & Inxhinierisë Klinike, z.R.H. i cili ngre pretendimin si më poshtë vijon:

Sqarojmë se vlera prej 14,140,000 lekësh është vlera e të gjithë pajisjes së Elastografisë dhe jo e sondës që ka kjo pajisje.

Sipas vlerësimit teknik, inxhinierë të fushës kanë konstatuar se edhe pse sonda nuk është me të njëjtin numër serial, kryen të njëjtin funksion, kjo e konfirmuar edhe nga shërbimi mjekësor përkatës, i cili vazhdon të kryejë ekzaminime. Nëse kjo sondë nuk do të ishte kompatibël me pajisjen, kjo pajisje nuk do të funksiononte fare. Vlera financiare e sondës është e njëjtë me sondat e tjera kompatibël dhe duke qenë se pajisja e Elastografisë është e kompletuar me të gjithë aksesoret e saj, përfshirë edhe sondën, kjo nuk përbën asnjë dëm ekonomik.

Qëndrimi i Audituesit:

Nga sa trajtuar më sipër, nga subjekti nuk është paraqitur asnjë dokumentacion shtesë nga sa trajtar në Projekt Raportin e Auditimit, prandaj ku observacion nuk do të merret parasysh.

4. Inventarizimi i aparaturave, pajisjeve dhe inventari ekonomik i PAI-t Francez, grupi i përbërë nga: E.Th., O.M., G.K., A.G., A.R. ka dorëzuar relacionin me shkresën Nr.2450/3 date 23.012.2022, drejtuar Titullarit të Institucionit dhe Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimi financiar nga ku janë konstatuar problematikat e mëposhtme:

Për disa shërbime si PL_07/33; Pl_07/18. Pl_07/47 dhe Pl_04/37 të cilat janë trajtuar në raportin përmbledhës së cilat prej tyre është kërkuar të ndryshohet emri i personave përgjegjës duke qenë se janë marrë në ngarkim nga punonjësit e rinj. Gjithashtu grupi i inventarizimit nga verifikimi cilësor i aktiveve ka propozuar për inventarin e aparaturave të vlerësohen për tu nxjerr jashtë përdorimit aktivet në vlerë totale 1,929,250 lekë, dhe për inventarin ekonomik aktivet në vlerë totale 77,920 lekë nga ku janë specifikuar 29 aktivet me kod artikulli, kod magazine, sasia dhe çmimi.

5. Polit të Drejtorisë të Përgjithshme dhe Urgjencës së Tiranës, grup i përbërë nga: E.J., E.S., I.J., A.K., A.M., ka dorëzuar relacionin drejtuar Titullarti të Institucionit dhe Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar me shkresën Nr.2450/10 datë 30.12.2022 nga ku ka konstatuar:

-Fleta e inventarit të Sektorit të IT-së A.K. "PL 09/01" në vlerën 8,246,904 është e pa firmosur pasi nuk ka person përgjegjës, në vazhdimësi të problematikës së shfaqur edhe në Relacionin e Saktësimi të Diferencave të Inventarizimit Fizik 2021. Aktualisht i ka shkuar Drejtorisë Juridike për ndjekje të mëtejshme. Grupi i auditimit konstatoi se kjo është një problematikë e mbartur në vite, nga ku nga Drejtoria Juridike nuk është marrë asnjë masë.

-Në fletën e inventarit të Pajisjeve Mjekësore të Magazinës "PL 09/20" për asetin me kod PMS1/0586 të shtohet përshkrimi, Panel Kontrolli.

-Në fletën e inventarit të Pajisjeve Mjekësore të Magazinës "PL 09/21" për asetin me kod PMS1/0592 të shtohet përshkrimi, Rampa Prodoksidi.

-Në fletën e inventarit të Pajisjeve Mjekësore të Magazinës "PL 09/25" për asetin me kod: PMS2/0916 të ndryshohet përshkrimi nga Ekzogen në Ekzagon, PMS2/0917 të ndryshohet përshkrimi nga Fico në Fiso, PMS2/0937 të ndryshohet përshkrimi nga Torx në Trokez, PMS2/0976 të ndryshohet përshkrimi nga Trekez në Trokez.

Grupi i auditimit konstatoi se nga grupi i inventarizimit nuk është kryer inventarizimi cilësor i aktiveve duke lënë shënimin nga grupi i inventarizimit si citon: "*Për asetet jashtë përdorimit do të bëjmë një relacion të dytë , sipas shënimeve që kemi mbajtur në fletët e inventarit*", duke mos zbatuar urdhrin e titullarit si dhe në kundërshtim të udhëzimit Nr.30.

6.1 Në magazinën IN1, grupi i përbërë nga E.S., E.S. dhe E.K., grupi ka dorëzuar relacionin përmbledhës Nr.93/2 datë 09.01.2023 nga ku ka konstatuar problematikat si më poshtë:

-Gjati procesit të inventarizimit është konstatuar një sonde kardiace (GE) me kod Sn:937138WX6 që ishte e pa dokumentar.

-Grupi i punës ka konstatuar së në këtë magazinë ka pajisje që duhet të nxirren jashtë përdorimi. Raporti përmbledhës nuk ka identifikuar në total grupin e aktiveve për të cilat sugjerojnë të nxirrej janë përdorimit (duke përshkruar gjendjen cilësore të konstatuar), por është mjaftuar vetëm më analizën në krah të inventarit kontabël.

6.2 Në magazinën M2, grupi i përbërë nga M.Sh., M.C. dhe A.L., me shkresën Nr.93 është dorëzuar raporti përmbledhës nga ku grupi ka konstatuar:

Grupi i punës ka konstatuar së në këtë magazinë ka pajisje që duhet të nxirren jashtë përdorimi. Grupi i auditimit konstatoi se grupi i inventarizimit në përmbledhësen e raportit nuk ka identifikuar në total grupin e aktiveve për të cilat sugjerojnë të nxirrej jashtë përdorimit (duke përshkruar gjendjen cilësore të konstatuar), por është mjaftuar vetëm më analizën në krah të inventarit kontabël.

6.3 Në magazinën M1, grupi i punës i përbërë nga E.K., G.K. dhe D.L., më shkresën Nr. 93/1 datë 09.01.2023 ka raportuar se:

Komisioni pasi kontrollon mallrat në gjendje nuk pati vërejtje apo mungesa në këtë magazine. Grupi i auditimit konstatoi se grupi i inventarizimit nuk ka kryer verifikimin e gjendjes cilësore ta aktivitet duke mos zbatuar plotësisht urdhrin e titullarit si dhe udhëzimin.

7. Inventarizimi i godinave dhe automjeteve në pronësi apo përdorim të QSUNT grup i përbërë nga E.N., P.C., A.D., E.C. dhe F.R. nga ku me shkresën Nr.2854/1 datë 30.12.2022 ka dorëzuar raportin përmbledhës mbi problematikat e hasura gjatë inventarizimit ku ka konstatuar:

-Për inventarizimin e godinave:

Godina me emërtimin **Mjekësi Ligjore** është në përdorim të Ministrisë së Drejtësisë, propozohet të shikohet dokumentacioni për të bërë kalimin e inventarit pranë kësaj Ministrie.

Godina me emërtimin **Laboratori i Pediatrisë** është në përdorim të Telemjekësisë, propozohet të shikohet dokumentacioni për të bërë kalimin e inventarit pranë Telemjekësisë.

Godina e **Informacionit** me Nr. pasurie 1/259 dhe godina e regjistruar me Subjekt Person Fizik "K.Gj." me Nr. pasurie 1/313 dalin si teprice inventari, nuk ka emërtime të ndara për këto dy objekte. Kërkohet nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit Financiar të kryejë verifikime të mëtejshme.

Nga auditimi rezultoi se këto problematika janë konstatuar edhe nga grupi i mëparshëm i inventarizimit, nga ku dy drejtoritë përkatëse nuk kanë marrë asnjë masë në lidhje me saktësimin dhe zgjidhjen e tyre.

-Për inventarizimin e automjeteve në pronësi të QSUNT, grupi i inventarizimit ka konstatuar të njëjtën problematikë si të një viti më përpara, nga ku propozon për nxjerrje jashtë përdorimi 7 makina në vlerën 5,778,410 lekë nga ku 5 autoambulanca dhe 2 vetura. (e raportuar edhe në relacionin e një viti më përpara)

8. Polit të Administrimit të Integruar të Spitalit Pediatrik, grupi i punës i përbërë nga: L.S., S.B., E.K., A.K., M.S. ka dorëzuar me shkresën nr. 2450/9 datë 30.12.2022 raportin mbi problematikat e hasura gjatë inventarizimit ka ku kanë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit të përcaktuara me nr. kodit, emërtim, çmim sasi dhe vlerë si dhe kanë propozuar disa materiale të kalojnë shërbimeve të tjera, pasi nuk i nevojitet shërbimit të tyre. Gjithsej janë 414 aktive në vlerën 69,620, 928 lekë për të cilat kanë propozuar për tu vlerësuar për tu nxjerrë jashtë përdorimi si dhe 2 aktive "EKG" në vlerën 45,126 lekë për të cilën pavijoni sugjeron të kalojë një shërbim tjetër, pasi shërbimit të tyre nuk ju nevojitet, përmbledhur në mënyrë tabelare si më poshtë:

Nr.	Magazina	Shërbimi	Nr. Aktivi	Vlera/Lekë
1	PL_03/01	Urgjenca	10	257,544.60
2	PL_03/02	Informacioni	2	94,640.00
3	PL_03/04	Konsulta	50	687,990.00
4	PL_03/06	EEG EZHE	1	56,670.00
5	PL_03/07	Audiometro	5	23,277,480.00
6	PL_03/08	Nefrologji	3	116,820.00
7	PL_03/14	Kirurgji	6	443,071.50
8	PL_03/15	Sekretari	1	110,240.00
9	PL_03/17	Pavion 2+3	79	2,567,848.80
10	PL_03/19	Pavion 4+6	53	11,863,516.78
11	PL_03/20	Dhoma e Diabetit	9	54,360.00
12	PL_03/22	EKG	1	21,540.00
13	PL_03/23	Pediatri e Përgjithshme	38	1,211,756.66
14	PL_03/24	Pavioni 8+11	107	886,497.19

15	PL_03/27	Bronkoskopi	7	5,647,012.00
16	PL_03/28	EMG Pediatri	3	10,859,540.00
17	PL_03/29	REA Kirurgji	20	7,224,209.00
18	PL_03/32	Dhoma e Nenave	4	18,000.00
19	PL_03/34	Laboratori gjenetikes	5	929,990.00
20	PL_03/35	Shërbimi Gastro Hepatologji	5	3,174,646.76
21	PL_03/39	Konsulta/Neurologji	1	6,000.00
22	PL_03/43	Konsulta/Preumo	4	111,555.00
	Totali		414	69,620,928
Aktive qe duhen transferuar në shërbime të tjera				
Nr.	Magazina	Shërbimi	Nr. Aktivi	
1	PL_03/22	EKG	2	45,126.00
	Totali		2	45,126.00

9.Polit të Administrimit të Integruar të Spitalit Neuroshkence, grupi i përbërë nga: O.J., F.C., A.R., E.K., E.N., me shkresën Nr.2450 datë 30.12.2022 ka dorëzuar relacionin mbi problematikat e evidentuara nga ku janë konstatuar të njëjtat problematika si vitin e kaluar nga ku:

-K/infermierja e reanimacionit të Neurologjisë (Strok) PL-05/28 A.D. nuk i firmos fletët e inventarit me arsyen se ka shume asete për të nxjerre jashtë përdorimit të cilat kanë shumë vite që magazinohen në ambientet e Konsultave të Neurologjisë.

-A.L.K/infermierja e Post Strok PL 05/58 nuk i firmos me pretendimin se fletët e inventarit janë në emër të ish K/Infermieres File Sula e cila ka dale në pension në gusht të këtij viti. Grupi ka relatuar se ka shumë materiale që duhen nxjerrë jashtë përdorimit, të cilat kanë zënë ambientet dhe dhomat në pavijone.

Nga grupi i auditimit u konstatua se grupi i inventarizimit nuk ka hartuar përmbledhjen e aktiveve për të cilat kanë propozuar për tu vlerësuar pasi janë jashtë funksionit.

10.Polit të Administrimit të Integruar të Spitalit Onkologjik, grupi i përbërë nga: A.I., J.S., E.L., E.Sh., A.R. më shkresën Nr.2450/4 datë 27.12.2022 ka dorëzuar relacionin mbi inventarizimin dhe problematikat e hasura nga ku nuk ka pasur diferenca por grupi ka evidentuar 116 aktive në vlerën 35,027,383 lekë të cilat janë konstatuar jo në gjendje pune ku kanë propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit, përmbledhur në mënyrë tabelare si më poshtë vijon:

Nr.	Shërbimi	Magazina	Nr. aktivi	Vlera/në lekë
1	Kirurgji	PL_06/01	5	399,471
2	Gjinekologji	PL_06/02	9	48,160
3	Rrezatimi	PL_06/03	22	83,760
4	Punkti Onkologji	PL_06/05	1	2,940
5	Salla Operacionit	PL_06/06	2	9,283,422
6	Kimioterapi	PL_06/07	2	8,778
7	Kyrio Terapi	PL_06/08	2	5,000
8	Kimioterapi Ditore	PL_06/09	4	17,800
9	Punkti Kimioterapisë	PL_06/10	4	9,640
10	Farmaci	PL_06/12	5	215,732
11	Punkti Kirurgjisë	PL_06/13	1	2,940
22	Punkti Rrezatimit	PL_06/14	1	2,940
13	Pavioni Kimioterapish	PL_06/17	16	685,770
14	Sekretarja	PL_06/20	4	17,400
15	Dr. A. Y.	PL_06/23	1	3,500
16	Dhoma Narkozistëve	PL_06/25	3	13,500
17	Dr. M. B.	PL_06/27	2	2,640

18	Holli	PL_06/30	4	655,751
19	Kryeinf. E pergjith.	PL_06/35	1	2,040
20	Dr. A. Y.	PL_06/38	3	384,646
21	Laboratori Biopsisë	PL_06/34	10	22,513,287
22	Informacioni	PL_06/46	1	111,600
23	Akselerator Radioterapi O.S.	PL_06/47	2	27,600
24	A. K., E. C.	PL_06/58	1	4,200
25	B. K.	PL_06/59	3	384,646
26	Dhoma e Kartelave të Kyroterapise-Follow Up	PL_06/62	3	111,000
27	Hapja e Fishave të Kimioterapisë	PL_06/65	2	6,900
28	Zyra e Psikologeve kati i katër	PL_06/67	2	22,320
	Totali		116	35,027,383

11. Polit të Integruar të Konsultave Ambulatorëe dhe Farmacisë Qendrore grupi i përbërë nga: R.G., M.K., A.R., A.R., E.B. nga ku referuar relacionit NR.2450/5 datë 29.12.2022 drejtuar titullarit të institucionit ka konstatuar se:

- Nga grupi i inventarizimit janë raportuar si asete të dëmtuara në PAI-në qendrës së konsultave ambulatorëe 9 aktive në vlerën 612,194 lekë ndërsa për inventarizimit ekonomik në farmacinë qendrore nga grupi është raportuar si asete të dëmtuara 20 aktive në vlerën 327,074 lekë.

Konstatime:

-Grupi i auditimit ka konstatuar se pjesa më e madhe e problematikave të konstatuara nga grupet e inventarizimit janë të njëjtat me konstatimet e tyre gjatë inventarizimit të aktiveve për vitin 2021 nga për të cilat Titullari i Institucionit nuk ka marrë masa për ngritjen e grupi të punës për vlerësimin për nxjerrje jashtë përdorimit apo grupi e punës për asgjësimin e tyre, në kundërshtim me udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011, gjithashtu titullari i institucionit nuk ka marrë masa për ngritjen e një grupi punë për aktivet e raportuara nga grupi i inventarizimit si të panevojshme për shërbimin, e të sugjeruara prej tyre për t'ju kaluar një shërbimi tjetër, çka sjell amortizimin e aktiveve si dhe mos plotësimin e nevojave nga shërbimet e tjera (apo spitale të tjera) për të cilën këto pajisje laboratorike mund ti nevojiten. (trajtuar në konstatimet e grupit të auditimit për inventarizimin e aktiveve për vitin 2021.

-Pjesa më e madhe e grupeve të inventarizimit kanë kryer vetëm inventarizimin fizik të tyre duke mos u shprehur për gjendjes cilësore të aparaturave, si dhe disa prej tyre janë shprehur se në një moment të dyte do shprehen për gjendjen e pajisjeve duke mos zbatuar pikën 6 të urdhrit Nr.397 datë 10.10.2022 të titullarit të institucionin mbi inventarizimin fizik dhe cilësor të aktiveve si dhe pikës 85 të udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011.

Grupi i auditimit përmbledhi në mënyre tabelare referuar raporteve të grupeve të inventarizimit për propozimin për vlerësim për nxjerrje jashtë përdorimi, në total prej **760** aktivesh në vlerë **130,506,767** lekë, si më poshtë:

Nr	Poli i Administrimit së Integruar	Nr. Aktivesh	Vlera
1	Poli i Administrimit të Spitalit Polivalent	165	86,754,536
2	PAI-t Francez	29	2,007,170
3	Inventarizimi i godinave dhe automjeteve në pronësi apo përdorim të QSUNT	7	5,778,410
4	Polit të Administrimit të Integruar të Spitalit Pediatrik	414	69,620, 928
5	Polit të Administrimit të Integruar të Spitalit Onkologjik	116	35,027,383
6	Polit të Integruar të Konsultave Ambulatorëe dhe Farmacisë Qendrore	29	939,268
	Totali	760	130,506,767

Punuar nga grupi i auditimit

Grupi i auditimit konstatoi se nga 11 grupe të ngritura për inventarizimin e aktiveve, vlerësimin cilësor dhe fizik, vetëm 6 prej tyre kanë zbatuar urdhrin e titullarit duke kryer edhe vlerësimin cilësor të aktiveve si dhe duke i evidentuar ato, pjesa tjetër janë mjaftuar duke shkruar se do bëhen në një moment të dytë, ose e kanë shkruar si konstatim por pa evidentuar se cilat aktive.

- Në shumë raste personat përgjegjës të materialeve refuzojnë të firmosin aktivet të cilat kanë në përgjegjësi, për shkaqe si, transferimi i tyre nëpër shërbime të tjera, lëvizja e tyre pa pasur dijeni nga personi përgjegjës.

-Nga titullari i institucionit edhe pse raportet përmbledhëse mbi problematikat e konstatuara nga grupi i inventarizimit për secilin nga shërbimet janë dorëzuar me datë 30.12.2022 deri në afatin e auditimit (faza në terren) 28.04.2023 nuk ka vazhduar procesin e inventarizimit të aktiveve, për sa i përket, ngritjes se grupit të punës për konstatimet e raportuara, ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e aktiveve të propozuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit, urdhër zhdëmtimet përkatëse për tepricat apo mungesat e konstatuara duke nxjerrë personat përgjegjës dhe marrjen e masave kundrejt tyre si dhe ngritjen e grupit të punës për asgjësimin e aktiveve të cilat do të vlerësoheshin për tu nxjerre jashtë përdorimit në kundërshtim me pikën 87,88,89,90,93 të udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011.

Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër mbajnë përgjegjësi, znj. A.F. titullari i institucionit, *B.L. me detyre Drejtor i Komanduar i Drejtorisë Juridike*, R.H. Drejtor i Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike, L.C. Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse.

Për vitin 2021, me urdhrin Nr. 626, datë 30.12.2021, “Për inventarizimin e vlerave materiale barna dhe materiale të konsumit mjekësor në farmacinë qendrore dhe periferike të QSUNT” është ngritur komisioni përkatës me qëllim inventarizimin e vlerave materiale, barna dhe materiale të konsumit mjekësor që ndodhen në Shërbimin e Farmacisë Qendrore dhe Farmacitë Periferike në QSUNT, grup i përbërë nga M. M., Th. K., L.Sh., D.B. dhe J. S.. Me shkresën Nr. 148/6, prot., datë 11.01.2022 është dorëzuar relacioni i komisionit nga ku është konstatuar se në total janë inventarizuar 37 fletë inventari në vlerën **577,636,842.56** lekë. Nga inventarizimi ka rezultuar se ka 5 fletë inventari me barna dhe materiale mjekësore të skaduara në vlerën totale prej **24,785,832** lekë më datë 31.12.2021,

Për vitin 2022, me urdhrin Nr. 543, datë 31.12.2022 për “Inventarizimin e vlerave materiale, barna dhe materiale të konsumit mjekësor në Farmacitë në QSUNT” është ngritur komisioni i përbërë nga E.N., Th.K., L.Sh., D.B. dhe J.S. i cili ka kryer inventarizimin e vlerave materiale, barna e materiale të konsumit mjekësor që ndodhen në farmacitë e QSUNT-së. Me shkresën Nr.94/7, prot., datë 09.01.2023 është dorëzuar relacioni përmbledhës i hartuar nga grupi i inventarizimit nga ku është konstatuar se vlera reale e barnave në momentin e inventarizimit (datë 31.12.2022) është **859,144,009.936** lekë, e cila është e njëjtë me vlerën e inventarizimit nga ku barna dhe materiale mjekësore të skaduara në vlerën **25,662, 025.24** lekë, të ndara si më poshtë:

1. Barna të skaduar në vlerën 9,343,691.53 lekë
2. Materiale Mjekësore të skaduara në vlerën 11,823,647.71 lekë
3. Laborator kite/reagent të skaduara në vlerën 4,494,414 lekë

Grupi i auditimit i ka kërkuar Farmacisë Qendrore vendosjen në dispozicion të listës së medikamenteve të skaduara nga data 01.04.2021-31.12.2022 (periudha e auditimit), nga ku rezultoi se vlera e barnave/ materialeve/kite reagentë të skaduar është **7,363,487.07** lekë nga ku:

1. Barna të skaduar në vlerën 3,203,763.39 lekë
2. Materiale mjekësore të skaduara në vlerën 619,351.68 lekë
3. Kite/reagent të skaduara në vlerën 3,540,372 lekë

Masat e marra nga përgjegjësi i Farmacisë qendrore në lidhje me njoftimet për afrimin e skadencave të medikamenteve apo të medikamenteve të skaduara, janë si më poshtë vijon: Barna të skaduara janë në vlerën sipas tabelës:

Në lekë

Nr.	Emërtimi i Përgjithshëm	Operatori ekonomik	Sherb. qe i kane plan.	Njësia	Skandenca	Çmimi	Sasia	Vlera
1	Abacavir Sulfate + Lamivudine	U.C.	Pediatria infektive	Box	31/05/2021	15.63	720	11,253
2	Atazanavir	U.C.	Infektiv	Kapsule	31/08/2021	64.24	47,500	3,051,400
3	Beclomethasone	O.	Doancion	Spray	30/04/2022	762.61	89	67,872
4	Benzylpenicillin Sodium	F.N.A.	Infektiv/peditri	Flakon	30/04/2022	262.5	279	73,237
	Totali							3,203,763

Për secilin nga barna e skaduar, apo prag skadence janë marrë masat si më poshtë:

- shkresë Shërbimit Infektiv si dhe titullarit të institucionit Nr. 229/85 prot., date 02.08.2021 dhe shkresë Shërbimit Infektiv me Nr.229/67 prot., date 04.05.2021, thirrje për tërheqje të medikamentit.

-shkresë Shërbimit Infektiv Pediatrik si dhe titullarit të institucionit Nr. Prot. 229/76 date 31.05.2021; si dhe shkresë Shërbimit Infektiv Pediatrik Nr. 229/100 date 05.10.2021 thirrje për tërheqje të medikamentit.

-Donacion nga O. nëpërmjet MSHMS, shkresë shërbimit infektiv si dhe titullarit të institucionit Nr.504/25 prot., date 05.04.2022,& kërkesë për qarkullim MSHMS Nr. 3504 prot., date 20.11.2020 dhe Nr.96/2 prot., date 11.01.2021.

-shkresë Shërbimit Infektiv si dhe titullarit të institucionit Nr. Prot.504/24 date 05.04.2022 si dhe shkresë OE për zbatim të detyrimeve kontraktore dhe zëvendësim barnash Nr.523/2 prot., dt. 26.05.2022.

Materiale të skaduara janë sipas tabelës:

Në lekë

Nr .	Emërtimi i Pergj.	Shërbimet qe i kane planifikuar	OE	Njësia	Skandenca	Çmi mi	Sasia	Vlera
1	Dren Abdominal - Double Drain Me Kateter Të Brendshem	Kirurgji e përgjithshme, kirurgji digjестive	M. + B. kontrata viti 2017	Cope	09/06/2022	408	1,270	518,160
2	Suture Silk, Age 1/2 Rreth, Prerëse, 5/0, 70/90 Cm, 17/22 Mm	Kirurgji e përgjithshme,	E.+ OE S.	Cope	11/04/2021	87.8	1,152	101,191.68
	Totali							619,351.68

Për secilin nga materialet e skaduar, apo prag skadence janë marrë masat si më poshtë:

- Shkresë Shërbimit Kirurgjia e Përgjithshme si dhe titullarit të institucionit Nr.504/26 prot. date 26.05.2022; Nr. 504/27 prot., date 26.05.2022 për shërbimin e kirurgjisë se përgjithshme e

digestive.

-Shkresë shërbimit kirurgji e përgjithshme e digestive si dhe titullarit të institucionit Nr.229/51prot., datë 12.04.2021; dhe shkresë Nr. 229/52 prot., për Shërbimin e Kirurgjisë së Përgjithshme date 12.04.2021.

Kite dhe reagent janë sipas tabelës:

Emërtimi i Përgjithshëm	Njesia	Skandenca	Çmimi	Sasia	Vlera
Abx Miniclean 1l	Cope	22/04/2021	4,680	70	327,600
Abx-Micros-60 / Abx Mini Dil Lmg Bp 7290	bidonx10 liter	28/08/2021	6,888	55	378,840
Abx-Micros-60 / Abx Mini Dil Lmg Bp 7290	bidonx10 liter	17/10/2021	6,888	110	757,680
Abx-Micros-60 / Abx Minilyse Lmg	Bidon x1 LITER	11/8/2021	14,280	22	314,160
Abx-Micros-60 / Abx Minilyse Lmg	Bidon x1 LITER	23/10/2021	14,280	20	285,600
Acl 9000 / Pt Fib - Hs	2 x (5 + 5 x 8 ml) Kuti	31/07/2021	6,840	13	88,920
Acl 9000 / Pt Fib - Hs	2 x (5 + 5 x 8 ml) Kuti	30/09/2021	6,840	55	376,200
Acl9000 / Aptt - Sp (Liquid)	KUTI (5*9ml APTT R, 5*8ml CaCl2)	31/07/2021	6,000	3	18,000
Acl9000 / F Ix - Deficient Plasma (Included Abnormal And Normal Plasma)	KUTI (10*1 ml)	31/05/2022	39,000	1	39,000
Acl9000 / F Viii - Deficient Plasma (Included Abnormal And Normal Plasma) 4x1ml	KUTI (10*1 ml)	30/04/2021	49,620	1	49,620
Acl9000 / Factor Diluent	100 ml	31/07/2022	3,600	1	3,600
Anti - E Coli O26 (Monovalent) 1 Ml Njesia FI	Flakon	31/10/2021	6,240	1	6,240
Anti - E Coli O86 (Monovalent) 1 Ml	Flakon	31/08/2021	6,240	1	6,240
Blu Cresyl Brillant	Shishe 100 gr	30/04/2021	6,600	6	39,600
Chloramphenicol	Disk	28/02/2022	6	150	900
Coagulase Test	Test	31/08/2021	6,240	3	18,720
Eppendorfr Tube Conical Mikro- Tub Me Tap 1.5 Ml	COPE	31/12/2022	2	1,200	2,880
Ertapenem	Disk	30/09/2021	7	50	360
Ertapenem 10mcg	Disqe	31/05/2021	6	100	600
Hemoglobina Electrophoresi 150 Test	KUTI	31/07/2021	372	150	55,800
Hemosil Wash R-Emulsion	COPE	30/06/2021	3,000	27	81,000
Hemosil Wash R-Emulsion	COPE	31/01/2022	3,000	37	111,000
Nutrient Agar	Kg	30/06/2022	19,800	1	19,800
Olympus Au640/Au2700 - Mid	KUTI 4x2000 ml	5/4/2021	14,400	1	14,400
Olympus Au640/Au2700 - Alp	KUTI 4X (R1 53ml, R2 53 ml)	1/4/2021	22,800	3	68,400
Olympus Au640/Au2700 - Alp	KUTI 4X (R1 53ml, R2 53 ml)	1/8/2021	22,800	2	45,600
Olympus Au640/Au2700 - Amylaze	KUTI 4X (R1 40 ml, R2 10 ml)	1/5/2021	39,000	1	39,000
Olympus Au640/Au2700 - Amylaze	KUTI 4X (R1 40 ml, R2 10 ml)	1/7/2021	39,000	2	78,000
Olympus Au640/Au2700 - Buffer	KUTI 4 x 2000 ml	7/5/2021	14,400	1	14,400

Olympus Au640/Au2700 - Cholesterol	KUTI 4X (R1 45 ml)	1/8/2021	39,000	1	39,000
Olympus Au640/Au2700 - Control Sera 2	KUTI 20x5 ml	1/6/2021	34,440	1	34,440
Olympus Au640/Au2700 - Creatinine	KUTI 4X (R1 51ml, R2 51 ml)	1/11/2021	6,000	6	36,000
Olympus Au640/Au2700 - Creatinine	KUTI 4X (R1 51ml, R2 51 ml)	1/2/2022	6,000	7	42,000
Olympus Au640/Au2700 - Phosphorous	KUTI 4X (R1 15 ml, R2 15 ml)	1/5/2021	8,760	1	8,760
Olympus Au640/Au2700 - System Calibrator	KUTI (20 x 5 ml)	1/5/2021	29,520	1	29,520
Olympus Au640/Au2700 - Triglyceride	KUTI 4X (R1 50 ml, R2 12,5 ml)	1/7/2021	36,960	1	36,960
Piperacilline	Disk	30/09/2021	7	50	360
Salmonella Anti O 9	Mililitra	31/08/2021	2,652	3	7,956
Sebia Hydrasis - Destaining Solution [Kite, Reagente Konsumabile Lab. Biokimik-Klinik]	Kuti	30/09/2021	6,000	1	3,000
Shigella Boydii	Mililitra	31/08/2021	2,652	1	2,652
Shigella Dysanteriae	Mililitra	30/04/2021	2,652	1	2,652
Shigella Flexneri Polyvalent	Mililitra	31/08/2021	2,652	1	2,652
Streptomycine	Disk	30/09/2021	7	300	2,160
Terren Transporti Për Viruset Chlamidia Mycoplasma Dhe Ureaplasma	Tuba	30/09/2021	60	45	2,700
Teste Për Gjak Okult Në Fece [Kite-Reagente-Konsumabile Lab Biokimik]	TEST	31/12/2021	300	120	36,000
Tetracycline	Disk	31/07/2021	7	150	1,080
Tetracycline	Disk	31/03/2022	6	850	5,100
Trimethoprim + Sulfomethoxazole	Disk	31/10/2021	7	100	720
Trimethoprim + Sulfomethoxazole (1.25 Mcg + 23.75 Mcg)	Disqe	30/04/2022	6	50	300
Ëash Solution Hydrasis 10*80ml	KUTI	28/02/2022	8,400	0.5	4,200
Totali			548,917	3777.5	3,540,372

Për secilin nga kite/reagent të skaduar, apo në prag skadence janë marrë masat si më poshtë: - Shkresa Nr. prot. 12/288 dt.. 23.12.2020 drejtuar MSHMS "Kërkesa për të lëvruar kite, reagente dhe materiale laboratorike si pasoje e implementimit të efekteve të kontratës Koncesionare me Nr. 1924/2 date 10.04.2020.

-Shkrese Nr. Prot. 96/1 dt.. 11.01.2021; shkrese Nr. prot 2578/3 dt.. 05.11.2021;shkresë me Nr. 55/350 prot., datë 01.10.2021; shkresa me Nr.961/1prot., datë 04.04.2022 si dhe shkresa Nr. 245/83 prot., datë 10.10.2022, të gjitha drejtuar MSHMS si dhe për dijëni titullarit të institucionit.

Për sa i përket skadencave të kiteve/materialeve laboratorike është vënë në dijeni me anën të shkresave të përsëritura MSHMS, si rezultat i kalimit të laboratorit në koncesion, një pjesë e tyre është shpërndarë nëpër rrethe, një pjesë tjetër ka skaduar dhe pjesa e mbetur është në Farmaci, nga ku edhe pse janë dërguar disa shkresa nga ana e QSUNT drejtuar MSHMS, nuk është marrë asnjë masë në lidhje me to.

Konstatime nga grupi i auditimit:

-Edhe pse nëpërmjet shkresave nga përgjegjësjë nga Farmacia Qendrore drejtuar, pavijoneve për të cilën kanë bërë dhe planifikimin e nevojave për medikamente (Pediatria infektive, Infektivi, kirurgjia e përgjithshme, kirurgji digjестive), drejtuar titullarit të institucionit për informim dhe marrje masash, MSHMS si institucion epror si dhe OE referuar kontratave të lidhura, nuk është marrë asnjë masë prej tyre për të tërhequr nga pavijonet medikamentet në prag skadence, për të marrë masa nga titullari i institucionit për shpërndarjen e tyre nëpër pavijonet e tjera, apo për të marrë masa nga institucioni Epror për mundësinë e plotësimit të nevojave për ato spitale të cilat i kanë në mungesë.

Si rrjedhojë e mosveprimeve nga grupet e punës për planifikimin e medikamenteve për Pediatria infektive, Infektivi, kirurgjia e përgjithshme, kirurgji digjестive, ish-titullari i institucionit E.J., titullari i institucionit A.F., MSHMS, ka rezultuar në skadencën e barnave/materialeve mjekësorë/kite®ente në vlerën totale 25,662,025 lekë nga ku vetëm për periudhën e auditimit 01.04.2021-31.12.2022 skadencat kanë në vlerën 7,363,487 lekë, vlerë e cila përbën efekt negativ (menaxhim jo efektiv) për QSUNT dhe Buxhetin e Shtetit.

-Që prej vitit 2018 nuk është marrë asnjë masë, nga titullari i institucionit për asgjësimin e medikamenteve, duke krijuar kështu stok prej 5 vitesh në magazine me ilaçe të skaduara që prej vitit 2018 në kundërshtim me udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011 si dhe ligjit 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre, nuk kanë maksimalizuar plotësisht eficientë dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike.

Titulli i Gjetjes Nr. 1	Mos pasje e regjistrimit të aktiveve & pronave të institucionit
Situata:	-Grupi i auditimit konstatoi se QSUNT nuk ka një regjistër të hartuar dhe miratuar si dhe kartela të punonjësve, të aktiveve në varësi të llojit që kanë pronësi apo përdorim, nga ku të përmbajë <i>datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, etj.</i> -Gjithashtu QSUNT nuk ka hartuar dhe miratuar regjistrin kontabël mbi pronat publike që ka në administrim apo pronat të cilat ka dhënë me qira dhe siguron të ardhura.
Kriteri:	Kapitullin III, pika 26,28,30 të udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011 të MFE “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. kapitullin III, pika 26, 31 të udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011 të MFE “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
Ndikimi/Efekti:	Mos njohje të aktiveve të institucionit si një ndër vlerat me të rëndësishme të institucionit si dhe mos pasqyrim i gjendjes reale të tyre.
Shkaku:	Mos njohje si dhe neglizhence zbatimit të bazës ligjore dhe urdhrimit të titullarit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme në caktimin e nëpunësit zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrimit të të gjitha aktiveve të institucionit si dhe pronave të cilat ka në administrim në formë kartele ose të sintetizuar të miratuar prej Tij ku të përcaktoj në varësi të llojit të tyre afatgjatë ose afatshkurtër, datën e hyrjes ose

	<p>marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.</p> <p>Ndërsa përsa i përket regjistrimit të pronave, si dhe pronave të dhëna me qira duhet të krijojë dhe miratojë regjistrin ku të përcaktojë: emërtimi i pronës, NIPT-i dhe vendndodhja (shoqëri koncesionare, objekti i dhëna me qira, shoqëri tregtare), Sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qerases, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qerases, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.</p>
--	---

Titulli i Gjetjes Nr. 2	Parregullsi në procedurën e inventarizimit
Situata:	<p>Grupi i auditimit ka konstatuar se pjesa më e madhe e grupeve të inventarizimit, kanë kryer kontrollin fizik referuar inventarit kontabël nga sektori i financës, duke u shprehur vetëm për gjendjen fizike të tyre dhe jo për gjendjen cilësore.</p> <p><i>Disa nga grupet e inventarizimit nuk janë shprehur në lidhje me verifikimin cilësor të aktiveve por vetëm verifikimin fizik.</i></p> <p>-Gjithashtu në disa raste grupet e inventarizimit, janë shprehur në mënyrë narrative për disa aktive të cilat duhet të nxirren jashtë përdorimit pasi janë jashtë funksionit dhe kanë zënë hapësirat e pajoni, por nuk kanë evidentuar se cilat janë këto pajisje.</p> <p>-Grupi i auditimit konstatoi se në disa raste, grupi i inventarizimit shprehet se personat përgjegjës të materialeve kanë qenë me leje, apo zyra ka qenë e mbyllur nga ku nuk është bërë e mundur inventarizimi i aktiveve, duke mos zbatuar urdhrin e titullarit i cili ka lënë një afat pothuajse një muaj për të kryer inventarizimin, nga ku lejet një ditore apo javore nuk janë justifikim për mos të zbatuar urdhrin e titullarit në një moment të dytë gjatë harkut kohor të përcaktuar.</p>
Kriteri:	<p>Pika 85/a të udhëzimit Nr.30 “Menaxhimi i Aktiveve të NJSP” e cila citon se “Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, I cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit.” pika 82 e udhëzimit Nr.30 “Menaxhimi i Aktiveve të NJSP, urdhri i titullarit Nr.588 datë 06.12.2021 “Për inventarizimin e pajisjeve, aparaturave mjekësore dhe inventarin ekonomik në të gjitha Polet Administrative të Integruar në QSUNT për vitin 2021”.</p>
Ndikimi/Efekti:	Mos njohje të aktiveve të institucionit si një ndër vlerat më të rëndësishme të institucionit si dhe mos pasqyrim i gjendjes reale të tyre.
Shkaku:	Mos njohje si dhe neglizhence e zbatimit të bazës ligjore dhe urdhrimit të Titullarit.
Rëndësia:	E lartë

Rekomandime:	Personat përgjegjës të përmbyllin procesin e inventarizimit duke u shprehur për gjendjen fizike e cilësore të aktiveve, me qëllim përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre.
---------------------	--

Titulli i Gjetjes Nr. 3	Mos finalizimin i inventarizimit të Pronës Shtetërore
Situata:	Nga auditimi u konstatua se titullari i institucionit edhe pse raportet përmbledhëse mbi problematikat e konstatuara nga grupi i inventarizimit për secilin nga shërbimet janë dorëzuar me datë 30.12.2022 deri në afatin e auditimit (faza në terren) 31.05.2023 nuk ka vazhduar procesin e inventarizimit të aktiveve, për sa i përket, ngritjes së grupit të punës për konstatimet e raportuara, ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e aktiveve të propozuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit, urdhër zhdëmtimet përkatëse për tepricat apo mungesat e konstatuara duke nxjerrë personat përgjegjës dhe marrjen e masave kundrejt tyre si dhe ngritjen e grupit të punës për asgjësimin e aktiveve të cilat do të vlerësoheshin për tu nxjerre jashtë përdorimit.
Kriteri:	Pika 87,88,89,90,93,99,100 të Udhëzimit Nr.30 “Menaxhimin i Aktiveve të NJSP”.
Ndikimi/Efekti:	Mos zbatim i bazës ligjore, mbi inventarizimin e Pronës Shtetërore.
Shkaku:	Mos finalizim i procesit të inventarizimit të Pronës Shtetërore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Titullari i Institucionit të marrë masa të menjëhershme ku për aktivet të cilat nga shërbimet deklarohen se nuk i nevojiten pavjonit, të ngrejë një grup punë i cili të merret me shpërndarjen e tyre në pajvonet të cilat kanë nevojë, duke rritur kështu cilësinë e shërbimit si dhe duke minimizuar riskun që këto pajisje mjekësore të amortizohen pa u përdorur. Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme ku të ngrejë grupet e punës për “Vlerësimin e Aktiveve” si dhe grupin e punës për “Nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të cilat janë vlerësuar për të nxjerr jashtë funksionit duke bërë të mundur lirin e ambienteve të pavijoneve në shërbim të qytetarit dhe jo pajisjeve të nxjerra jashtë funksionit.

Titulli i Gjetjes Nr. 4	Diferenca në inventar
Situata:	- Nga inventarizimi në Polin e Administrimit të Spitalit Polivalent janë konstatuar 192 aktive të munguara në vlerën 21,885,993 lekë . Referuar raportit përmbledhës të inventarit me shkresën Nr.2450/8 datë 30.12.2022 “ <i>Mbi rezultatet për inventarizimin e aktiveve të QSUNT</i> ”, grupi i inventarizimit i përbërë nga E.T., E.K., M.R., E.B., A.K., deklaroi se janë gjetur dyert e hapura me dhune (të dëmtuara) nga ku një pjesë e aktiveve nuk janë gjetur. Drejtori i përgjithshëm në zbatim të kompetencave dhe detyrimeve ligjore që janë përcaktuar në Statut, si dhe të legjislacionit specifik për administrimin e pronës shtetërore, nuk

	ka marrë asnjë masë përsa i përket denoncimit të aktit në organet kompetente (prokurori, polici etj.), nxjerrjes së përgjegjësive për aktive e humbura, si dhe dëmshpërblimin e vlerës 21,885,993 lekë për 192 aktivet e humbura. Drejtori i përgjithshëm i është drejtuar policisë së shtetit 4 muaj me vonesë në kundërshtim me pikën 93 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.
Kriteri:	-Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe Neni 8; - Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 93.
Ndikimi/Efekti:	Aktive të munguara në vlerën 21,885,993 lekë.
Shkaku:	Keq menaxhim i aktiveve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Bordi i Spitalit të analizojë vlerën 21,885,993 lekë, vlerë e cila ka të bëjë 192 aktive të munguara në Polin e Administrimit të spitalit Polivalent, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për zhvendim, vlerë e cila për QSUNT dhe Buxhetin e Shtetit përbën dëm ekonomik.

Titulli i Gjetjes Nr. 5	Diferenca në inventar
Situata:	<p>- Në datë 12 Maj 2022, në PAI-n e Qendrës së Konsultave Ambulatorëe, u transferua nga PAI i Spitalit Infektiv, Aparatura e Elastografisë në vlerë 14,140,000 lekë. Më datë 20 korrik nga PAI i Spitalit Infektiv, është sjellë në PAI-n e Konsultave Ambulatore një sondë, e cila nuk ka lidhje me sondën e inventarizuar të kësaj pajisje. Fakt i konstatuar në datë 9 Gusht nga B., me interpretimin se Sonda e sjellë nuk është ajo e Inventarit bazuar në numrin serial dhe datën e kalibrimit të realizuar të prodhuesit, me Mirëmbajtjen Preventive 2021. Në lidhje me këtë çështje znj. R.G. me detyrë Administratore e PAI-t të Konsultave ka deklaruar/sqaruar se momentalisht aparatura Elastografi në vlerën 14,1140,000 lekë është e vetmja në QSUNT si dhe rajon, e cila shërben për të nxjerrë analizat e funksionimit të mëlçisë kryesisht për pacientët me Hepatit B & C, aparaturë së cilës i është vendosur një sondë tjetër, dhe se kjo sondë duke mos qenë e saj, shpesh herë aparatura kërkon Kalibrimin e Pajisjes. Referuar pikës 13.6.4 të VKM Nr. 731, datë 2.9.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore, vlerësimin e konformitetit, klasifikimin dhe markimin të pajisjeve mjekësore” Kalibrimi i pajisjeve mjekësore, është i detyrueshëm për të siguruar dhe vërtetuar se rezultatet të cilat vijnë nga këto pajisje janë të sakta dhe të sigurta.</p> <p>Modifikimi i pajisjes mjekësore me sondë tjetër, jo bashkohore në përshtatje të plotë me specifikat teknike pajisjes së Elastografisë, jo vetëm është shpenzim i tepër, por është risk i lartë për kryerjen e këtij</p>

	shërbimi kaq të rëndësishëm për jetën e pacientëve. Për posë sa më sipër transferimi i Aparaturës së Elastografisë, është bërë jo vetëm i mangët, por edhe me tre muaj me vonesë, duke bërë kështu mos dhënie e shërbimit për pacientet për tre muaj radhazi (shërbim i llojit të veçantë).
Kriteri:	-Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe Neni 8; - Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 93.
Ndikimi/Efekti:	Aktive të munguara në vlerën 14,140,000 lekë.
Shkaku:	Keq menaxhim i aktiveve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Bordi i Spitalit të analizojë vlerën 14,140,000 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me diferencë inventari (sondë) të pajisjes së Elastografisë në PAI-n e Qendrës së Konsultave Ambulatorëe, jo vetëm që modifikimi me sondë tjetër është shpenzim i tepër, por është risk i lartë për kryerjen e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për jetën e pacientëve. Të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për zhdëmtim, vlerë e cila për QSUNT dhe Buxhetin e Shtetit përbën dëm ekonomik. Dëmi shëndetësor është i pa llogaritshëm, pasi shërbimi përveçse nuk i është dhënë për tre muaj kryesisht pacienteve me diagnozë (Hepatit B & C), por që prej datës 21.08.2022 e në vazhdim, analizat e kësaj pajisje janë të pasigurta pasi nuk është kryer Kalibrimi i kësaj pajisje (pas vendosjes së sondës së re).

Titulli i Gjetjes Nr. 6	Diferenca në inventar
Situata:	- Nga inventarizimi në Polin e Administrimit të Spitalit Polivalent janë konstatuar 165 aktive të papërdorshëm, të dëmtuara për tu vlerësuar për nxjerje jashtë përdorimit në vlerën 86,754,536 lekë. Ky fakt është pasqyruar në raportin përmbledhës të inventarit me shkresën Nr.2450/8 datë 30.12.2022 “ <i>Mbi rezultatet për inventarizimin e aktiveve të QSUNT</i> ”, grupi i inventarizimit i përbërë nga E.T., E.K., M.R., E.B., A.K. Vlera prej 86,754,536 lekë për 165 aktivet e dëmtuara përbën një shpenzim për të cilin nuk është arritur plotësisht qëllimi i blerjes, pasi nuk janë përdorur deri në amortizimin apo mos funksionimin plotë të tyre, por janë dëmtuar duke u nxjerrë jashtë funksionit.
Kriteri:	-Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe Neni 8; - Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 93.
Ndikimi/Efekti:	Aktive të munguara në vlerën 86,754,536 lekë.
Shkaku:	Keq menaxhim i aktiveve.
Rëndësia:	E lartë

Rekomandime:	Bordi i Spitalit të analizojë vlerën 86,754,536 lekë , vlerë e cila ka të bëjë 165 aktive të papërdorshëm, të dëmtuara për tu vlerësuar për nxjerje jashtë përdorimit në Polin e Administrimit të spitalit Polivalent, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për zhdëmtim, vlerë e cila për QSUNT dhe Buxhetin e Shtetit është shpenzim pa ekonomikitet, eficence dhe efektivitet nga QSUNT.
---------------------	---

2.5. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

Auditimi u krye me zgjedhje¹¹.

Për periudhën 01.04.2021-31.12.2021 janë zhvilluar 210 procedura prokurimi me vlerë 1,936,964,483 lekë.

Për vitin 2022, janë zhvilluar 180 procedura prokurimi me vlerë 6,321,073,801 lekë.

Në total për periudhën objekt auditimi janë zhvilluar 390 procedura me vlerë 8,258,038 mijë lekë.

Në mënyrë të detajuar pasqyra si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktor dhe procedurat e zgjedhura	Vlera në mijë/lekë		Vlera në mijë/lekë e kontratës tvsh	Diferenca	
		Sasi	Fondi limit		Në Vlerë	Në %
A	Periudha 01.04-31.12. 2021					
	Procedurë e hapur	10	309,981,486	235,387,900	74,593,586	75.9
	Procedurë e kufizuar	-				-
	Procedurë konkurruese me negociim, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave të sektorit klasik;	-				-
	Partneritet për inovacion					-
	Dialogu konkurrues					-
	Kërkesë për propozim	-				-
	Procedurë me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	-				-
	Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	-				-
	Procedurë e hapur e thjeshtuar	4	38,947,140	25,890,607	13,065,553	33.5
	Shërbim konsulence	-				-
	Prokurim me vlerë të vogël	11	4,946,691	4,490,309	456,382	9.23
	Sistem dinamik blerje (Blerje bileta për udhëtim)	-				-
	Modifikim kontrate					-
	Procedurat e zhvilluara nga MSHM/zbatuar QSNUT	3	821,192,495	707,145,126	114,047,369	19.9
	Procedurat e zhvilluara nga ABP/zbatuar QSNUT	6	277,910,965	162,051,265	115,859,700	41.7
	Minikontratat e nënshkruara në zbatim të	176	483,985,706	483,985,706	-	-

¹¹ Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit”, i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.

Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: “Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampionët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur”

	marrëveshjeve kuadër të viteve të më përparshme					
	Shuma	210	1,936,964,483	1,618,950,913	318,022,590	16.41
B	Viti ushtrimor buxhetor 2022					-
	Procedurë e hapur	6	730,176,247	442,892,847	287,283,400	39.3
	Procedurë e kufizuar	-				-
	Procedurë konkurruese me negocim, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave të sektorit klasik;	-				-
	Partneritet për inovacion	-				-
	Dialogu konkurrues	-				-
	Procedurë me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	-				-
	Procedurë me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	2	71,394,322	55,918,030.00	15,476,292	21.68
	Procedurë e hapur e thjeshtuar	13	425,167,547	216,758,127	208,409,421	49
	Shërbim konsulence	-				-
	Prokurim me vlerë të vogël	13	7,184,235	5,192,905	1,991,330	27.72
	Modifikim kontrate	-				-
	Sistem dinamik blerje (Blerje bileta për udhëtim)	-				-
	Procedurat e zhvilluara nga MSHM/zbatuar QSNUT	4	2,779,487,950	2,404,791,261	374,696,689	13.5
	Procedurat e zhvilluara nga ABP/zbatuar QSNUT	2	159,822,935	87,936,282	71,886,653	45
	Minikontratat e nënshkuara në zbatim të marrëveshjeve kuadër të viteve të më përparshme	140	2,147,840,565.	2,147,840,565	-	-
	Shuma	180	6,321,073,801	5,361,330,017	959,743,785	15.2

Burimi i të dhënave: QSUNT

Në procedurat e audituara, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimi në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se përgjithësisht është zbatuar Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në funksion të tyre, në lidhje me përzgjedhjen e procedurave të prokurimit, llogaritjen e vlerës së kontratave, argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim, kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomik, si dhe lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

Pavarësisht nga sa u citua më sipër u konstatuan dhe shkelje dhe parregullsi ligjore ose rregullatore, të cilat në mënyrë të detajuar për çdo procedurë prokurimi paraqiten si më poshtë vijon:

1. Vendosija në kërkesat për kualifikim Autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin)."

-Në të gjitha procedurat e prokurimit për periudhën objekt auditimi, për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, blerjen e pajisjeve mjekësore dhe barnave, vendosja në kërkesat për kualifikim Autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), argumentimi i kësaj kërkesë është në keq interpretim me:

-Nenet 3, dhe 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 93 të VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet shprehimisht se Autoritetet kontraktore gjatë përcaktimit të kritereve të veçanta, duhet të shmangin çdo kërkesë apo procedurë që lidhet me kualifikimin e operatoreve ekonomik, e cila përbën diskriminim ndaj

ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. Por në përcaktimin apo në vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoritetit kontraktor brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë që përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe (ii) jodiskriminues, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Gjatë përshkrimit të objektit të prokurimit publik, autoritetet kontrakturë përdorin "Kriterë të veçanta kualifikimi", në të cilat përfshihen specifikimet teknike, që zakonisht, kupton tërësinë e kërkesave teknike. Këto specifikime teknike përcaktojnë karakteristikat e kërkuara nga punët, mallrat ose shërbimet që plotësojnë përdorimin të cilin ato synojnë nga Autoriteti kontraktor. Kërkesat/specifikimet teknike shpesh përfshin nivelin e cilësisë, performancës, sigurisë apo përmasave, garantimin e cilësisë, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat e testimit si dhe të paketimit, markën dhe etiketimin etj.

Referuar sa mësipër, kërkesa specifike e kualifikimi (kushtet teknike), në pikën 2.3.c "Aftësitë teknike dhe profesionale" është përcaktuar se, operatorët duhet të paraqesin: Autorizim nga prodhuesi/MAH/ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), është në kundërshtim edhe me jurisprondencën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian në Çështjen Procuroeur du Roi v. Dassnville, 1974.

Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim, vendosja e prodhuesve dhe produkteve të vetëm, kanë orientuar operatorët ekonomik drejtpërdrejtë një prodhuesi të caktuar në treg. Për pasojë operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik, është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme kanë ulur në mënyrë të ndjeshme konkurrencën, duke favorizuar vetëm operatorët ekonomik të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

- Ligjin Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite "Pika1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale*".

Autoritetet dhe entet kontraktore, nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar". Neni 77 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës".

-VKM Nr. 285/2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 93, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, "Autoriteti/enti kontraktor duhet të marrë masa të sigurojë pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomikë dhe konkurrencë të drejtë në procedurat e prokurimit".

Për autorizimin e prodhuesit është shprehur dhe Autoriteti i Konkurrencës me Vendim Nr. 851, datë 03.12.2021 "Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e

konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Nga vlerësimi i këtij rasti, rezulton se auditimi i kryer në Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse pranë DPPSH ka konstatuar mungesë të konkurrencës në procedurat prokuruese të mirëmbajtjes së disa aparaturave, kryesisht të Institutit të Policisë Shkencore, për shkak të **kufizimit në lëshimin e autorizimit të prodhuesit vetëm për një operator**, konstatim i cili ka të bëjë me përcaktimin e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve në DST, të cilat vendosen nga vetë Autoriteti kontraktor. Vendosija e këtyre kriterëve, në respektim të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duhet të mirë argumentohet në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet”.

Pika 3, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Referuar në nenin 3, pika 2 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sanksionohet qartë detyrimi që kanë autoritetet dhe entet kontraktore për të mos shmangur fushën e zbatimit të këtij ligji dhe për të mos ngushtuar/kufizuar në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar”.

Me vendosjen e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike, nuk janë zbatuar gjithashtu dhe parimet e përgjithshme të së drejtës administrative sipas Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i transparencës, parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, parimi i drejtësisë dhe i paanshmërisë, parimi i objektivitetit dhe parimi i barazisë dhe mos diskriminimit të përcaktuara KREU II “Parime të përgjithshme”, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.

Duke qenë se specifikimet teknike përbëjnë rrezik potencial për krijimin e pengesave në konkurrencën, për shkak të “Specifikimit të tepërt” apo “Super specifikimit” Kolegji Administrativë i Gjykatës së Lartë me vendim Nr.00-2015-315, datë 23.01.2015, është shprehur në lidhje me këtë çështje tepër të rëndësishme, pasi Autoritetet Kontraktore tentojnë të abuzojnë me “Specifikimin e tepërt” apo “Super specifikimin” në mënyrë që të mënjanojnë operatorët ekonomikë të caktuar në favor të operatorit të preferuar, çka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë.

Në opinionin e grupit të auditimit, autorizimi i prodhuesit nuk është gjë tjetër veçse diskriminim de facto kundrejt shoqërive që, për shkak të fuqisë së tyre më të vogël në treg, nuk kanë lidhje direkt me prodhuesit dhe nuk janë distributorë ekskluzivë, por i përftojnë produktet/shërbimet nëpërmjet distributoreve të tjerë ekskluzivë të prodhuesit dhe ofrojnë çmime më konkurruese për të njëjtin mal/shërbim, cilësia e të cilit mund të provohet shumë lehtë. Kurse nga ana tjetër, shoqëritë që kanë në dispozicion autorizimin e prodhuesit, kanë krijuar një oligopol të rrezikshëm dhe nuk shqetësohen të ofrojnë çmime konkurruese por abuzojnë me këtë fakt në dëm të fondeve publike dhe konsumatorëve.

Autorizimi nga prodhuesi” si kriter kualifikues, nuk mund të jete i vetmi mjet që të mundësojë garantimin e origjinalitetit e mallit/shërbimit. Ky kriter për kualifikim ka bërë që Autoriteti kontraktor të duket sikur e ka parazgjedhur paraprakisht kandidatin fitues, ç’ka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë dhe nuk është në qasje të plotë dhe me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës së Drejtësisë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 2.

-Ligjin Nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” pika 5.

Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19.

Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, neni 2,8 dhe 52.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre, nuk kanë maksimalizuar plotësisht eficientën dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike.

2. Procedura e prokurimit me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me objekt: “Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore për përballimin e nevojave ekstreme, deri në lidhjen e kontratës bazë të procedurave konkurruese (me të drejtë shkëputje pa pasoja për Autoritetin Kontraktor, me lidhjen e kontratës së shërbim për procedurën bazë (procedurën konkurruese)”, REF-18901-02-07-2022, në vlerën 61,002,230 lekë, viti 2021.

<p>1. Urdhër Prokurimi Nr. 581 prot., datë 03.02.2022</p>	<p>3. Hartuesit e dokumenteve të tenderit - B.Q.-Kryetar , zv/drejtori i përgjithshëm, mjekë -B.M.-Anëtare(Drejtori i IT dhe inxhinierisë klinike/inxhinier) -A.V.-Anëtar , specialist në sektorin e inxhinierisë klinike/inxhinier -H.C.-Anëtare (Specialiste në sektorin e prokurimeve/juriste) - H.C.-Anëtare, specialist sekt. Financës dhe Kontabilitetit/ekonomiste</p>	<p>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 581/1 datë 03.02.2022 - E.K.,Kryetare (Përgjegjës në sektorin inxhinierisë klinike/inxhinier) -E.Sh. -Anëtar (specialist në sektorin inxhinierisë klinike/inxhinier) -D.V.-Anëtar, përgjegjës i sekt.e prokurimeve/jurist -F.C.-Anëtare (specialiste në sektorin e prokurimeve/juriste) -E.J.-Anëtare(Përgjegjës në sektorin e planifikimit buxhetor/ekonomiste)_</p>
<p>5. Fondi Limit (pa tvsh) 61,002,230.87</p> <p>Lot1 1,476,885.21 Lot2 2,120,350.68 Lot3 2,021,917.81 Lot4 230,136.98 Lot5 516,328.77 Lot6 1,923,282.74 Lot7 320,005.48 Lot8 2,465,753.42 Lot9 620,383.56 Lot10 2,417,424.66 Lot11 2,884,931.51 Lot12 1,096,767.12 Lot13 877,808.22 Lot14 5,720,547.95 Lot15 2,561,917.81 Lot16 99,946.30 Lot17 1,060,273.97 Lot18 887,178.08 Lot19 591,780.82 Lot20 437,917.32 Lot21 2,269,033.20 Lot22 1,269,720 Lot23 2,415,747.95 Lot24 84,330.94 Lot25 355,068.49 Lot26 2,254,487.67 Lot27 263,515.07 Lot28 658,795.07 Lot29 1,141,148.71 Lot30 939,600 Lot31 1,923,287.67</p>	<p>6. Oferta fituese (pa tvsh) 57,655,474.76</p> <p>1,435,527.36 2,120,000 2,021,400 230,040 516,240 1,885,500 262,800 2,465,640 619,200 2,417,400 2,884,000 1,094,400 864,000 5,720,400 2,561,760 94,932 990,000 887,178 591,780 1,837,911.60 1,269,000 2,415,000 354,996 2,253,240 262,800 657,000 1,116,000 1,890,000</p>	<p>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 977,148.78</p> <p>41,357.85 350.68 517.81 96.98 88.77 37,782.74 57,205.48 113.42 1,183.56 24.66 931.51 2,367.12 13,808.22 147.95 157.81 5,014.30 70,273.97 0.08 0.82 431,121.60 720.00 747.95 84,330.94 72.49 1,247.67 715.07 1,795.07 25,148.71 33,287.67</p>

Lot40 25.02.2022	1,100,217.60	
Lot41 01.03.2022	1,143,000.00	
Lot42 04.03.2022	839,226.96	
Lot43 25.02.2022	1,432,036.80	
Lot44 28.02.2022	5,028,480.00	
Lot45 01.03.2022	532,080.00	
Lot46 28.02.2022	1,581,120.00	
Lot47 Anuluar		
Lot48 25.02.2022	1,242,648.00	
Lot49 01.03.2022	1,308,960.00	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Autoriteti kontraktor, ka zhvilluar procedurën e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me objekt “Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore për përballimin e nevojave ekstreme, deri në lidhjen e kontratës bazë të procedurave konkurruese (me të drejtë shkëputje pa pasoja për Autoriteti kontraktor me fond limit në vlerën 61,002,230 lekë pa tvsh për periudhën nga shkurt-shtator 2022, të ndarë në 49 lote sipas prodhuesve të pajisjeve mjekësore.

Përdorimi i kësaj procedure ka ardhur si rezultat i anulimit të procedurës së prokurimit, marrëveshje kuadër me fond limit 645,887,199 lekë pa TVSH me referencë REF-97398-06-04-2021 me objekt “Menaxhim dhe mirëmbajtje e aparaturave mjekësore në QSU “Nene Tereza” me afat 4 vjet (48 muaj), marrëveshje kuadër me një operator ekonomik.

Autoriteti kontraktor me relacionin Nr. 373/8 datë 02.02.2022, marrëveshjen kuadër me një operator ekonomik e ka argumentuar “AK duke marrë shkas nga problematikat më të mëdha që vinin nga kombinimet në të njëjtin shërbim mjekësor të pajisjeve të ndryshme dhe për të njëjtin kategori pajisjesh të instaluar në të njëjtin shërbim duke u përballur me administrimin e kontratave të mirëmbajtjes me operatore të ndryshëm ekonomike të lidhura në kohë të ndryshme dhe situata shumë e vështirë për tu administruar nga AK, si dhe me qëllimin e vetëm për të optimizuar këtë proces, përfshirjen në të njëjtin afat kohor të të gjitha pajisjeve dhe kontaktin vetëm me një operator ekonomik, si dhe duke qenë se objekti i kontratës është mirëmbajtje (dhe menaxhim, në procedurën konkurruese), pra objekti për të gjitha pajisjet pavarësisht prodhuesit është mirëmbajtje pajisjesh mjekësore, siç është përmendur dhe më sipër, me qëllim mirë administrimin, optimizimin e menaxhimit dhe rritjen efiçencës, uljen e kostos së mirëmbajtjes ,u vlerësuar mundësia e grupimit në një lot të vetëm dhe lidhja e kontratës me një operator ekonomik”.

Referenca ligjore për procedurën e prokurimit negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës VKM-se 285/2021 “Rregullat e prokurimit publik, pika 1, germa c, ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti/enti, afatet kohore për procedurat e hapura, procedurat e hapura të thjeshtuara, procedurat e kufizuara, shërbimet e konsulencës, procedurat konkurruese me negociim, ose procedurat me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit në kontratat sektoriale, nuk mund të respektohen. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga autoriteti/enti kontraktor” .

Në fakt referuar udhëzimit të APP-së Nr. 6 datë 16.07.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprak të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 10 /c, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, mund të përdoret në rastin e një nevojë ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, që nuk i ngarkohen autoritetit/entit kontraktor.

Në këtë rast, për përdorimin e kësaj lloji procedure prokurimi duhet të ekzistojnë njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

i) *Shkaktimi i një ngjarje të paparashikuar.*

ii) *Autoriteti kontraktor nuk ka përgjegjësi për ngjarjen.*

iii) *Ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshëm të një komuniteti të gjerë.*

iv) *Nuk është e mundur të ndiqen procedurat standarde mbi ose dhe nën kufirin e ulët monetar.*

Trajtimi si emergjencë, nuk ka ardhur për shkaqet e parashikuara si më lart, por si pasojë e mos vëmendjes së duhur institucionale dhe përgjegjësisë ndaj detyrës e strukturave të përfshirë në këtë proces, duke filluar nga Menaxhmenti i lartë drejtues, me argumentet si më poshtë:

-Kontratat e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore përfundonin në datën 31.12.2021 .

-Në nëntor të vitit 2020, Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, procedurë e hapur me objekt “Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore për vitin 2021”, me afat nga nënshkrimi i kontratës deri me 31.12.2021 me vlere totale 167,000,000, lekë me TVSH, për periudhën nga shkurti 2021 deri me 31.12.2021, afërsisht 10 muaj.

Që 3-mujorin e fundit të vitit 2020 nga Autoriteti kontraktor, duhet të ishin marrë masa për zhvillimin e procedurës marrëveshje kuadër me afat mbi një vit, ose të ishte zbatuar shkresa e MSHMS Nr. 3839/3 prot., datë 23.09.2020 e administruar pranë QSUNT me Nr. 616/58 prot., datë 23.09.2020, ku është shprehur në mënyrë eksplicite “...ndërkohë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, mund të procedoni me kryerjen e procedurës së prokurimit të kërkuar me afat 12 muaj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rekomandimet e APP-së”.

Para shpalljes së kësaj procedure Autoriteti kontraktor duhet të kishte hartuar planin e mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore për çdo vit, plan i miratuar nga komisioni mjekësor.

Referuar Statutit të QSUNT, miratuar në zbatim të Urdhrit të Përbashkët Nr. 709, datë 10.10.2018, i Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e Statutit të QSU "Nënë Tereza". Në këtë statut KREU III, pika "ORGANIZIMI", pika 8 "Organet Drejtuese", 18/1 "Komisioni Mjekësor i QSU "NËNË TEREZA", është shprehur në mënyrë eksplicite se "Komisioni Mjekësor është organ këshillimi teknik i Drejtorisë së Përgjithshme dhe përbëhet nga drejtorët e spitaleve, që funksionojnë brenda autoritetit spitalor të qarkut dhe shefat e shërbimeve ose përfaqësues të zgjedhur nga vetë shërbimet e këtyre spitaleve, pika 18.3, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "Komisioni Mjekësor përbëhet nga 26 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Bordi, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme, sipas formulës: Drejtoria i propozon Bordit kandidaturat për anëtarë të Komisionit Mjekësor të QSU "NËNË TEREZA"-se, me një listë jo me të vogël se dyfishi i numrit të vendeve që duhet të plotësohen, në të cilën kandidatet shefa shërbimesh nuk mund të jenë me shumë se 50 për qind”.

Pika 18.4, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "Komisioni Mjekësor konsulton lidhur me aspektet mjekësore të punës, me përshkrimin e detyrave sipas funksioneve, dhe organizimin e shërbimeve mjekësore”.

Kjo për faktin se numri i pajisjeve për nevoja mirëmbajtje është shumë i madh dhe nuk mbulohen nga fondet e QSUNT-së.

Mos hartimi i planit të mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore, si dhe përlllogaritja jo e drejtë e fondit limit, argumentohet me faktin e llogaritjes së vlerës 61,000,000 lekë për periudhën 6-mujore, që për një vit është në vlerën 122,000,000.00 lekë, ndërsa për 4 vite është në vlerën 488,000,000 lekë (61,000,000*2=122,000,000*4 vite =488,000,000 lekë).

Ndërsa në:

- marrëveshjen kuadër për 4 vite, fondi limit i llogaritur është në vlerën 645,887,198.99 lekë, me një diferencë në vlerën 157,887,198 lekë, vlerë e cila në qoftëse do të ishte nënshkruar marrëveshja kuadër, ishte me risk të lart për të krijuar dëm të mundshëm ekonomik.

- procedurën e prokurimit në shtator 2022 Mirëmbajtje full risk e pajisjeve mjekësore, 24 muaj me 62 lote në vlerën 312,443,222 lekë, pra po ti llogarisim për 4 vite shkon vlera 624,886,444.00 lekë, me një diferencë në vlerën 136,886,444.00 lekë.

- Autoriteti kontraktor edhe pse në dokumentet e tenderit (termat e referencës) ka përcaktuar afatin 180 ditë me kushtin e ndërprerjes së kontratës pa pasoja për Autoritetin Kontraktor, në momentin e realizimit të procedurës konkurruese, deri në përfundimin e kontratave të nënshkuara nga kjo procedurë, nuk ka iniciuar asnjë procedure prokurimi, duke provuar dhe njëherë se Autoriteti kontraktor e kishte paracaktuar zhvillimin e një procedure me negociim pa shpallje, veprim në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 52, pika 1/c ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “.....*Me krijimin e nevojës ekstreme, autoriteti/enti kontraktor duhet njëkohësisht, të marrë të gjitha masat për realizimin e procedurave normale të prokurimit*”.

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), në parimet për rritjen e integritetit në prokurimin publik, ka parasysh që respektimi në një shkallë të lartë apo jo i parimeve kryesore ka efekte të drejtpërdrejt në konkurrencën, në çmimin e paguar nga administrata publike për blerjen e një malli, shërbimi apo kryerjen e një pune, të cilat kanë efekt të drejtpërdrejt në shpenzimet e shtetit, pra në burimet e taksapaguesve. Një nga parimet është dhe transparenca dhe konkretisht “Maksimizimi i transparencës së garës konkurruese dhe marrja e masave mbrojtëse për të rritur integritetin, në mënyrë të veçantë për rastet përjashtimore nga tenderi konkurrues. Ky parim i referohet rasteve përjashtimore kur nuk procedohet me procedurë të hapur, si për shembull rastet e një nevoje urgjente apo ato të sigurisë kombëtare.

Që autoritetet kontraktore të mos abuzojnë me këto, procedura konkurrencte përjashtimore, është e nevojshme që në legjislacionet kombëtare të përcaktohen në mënyrë të qartë dhe univoqe, rastet, kushte në prani të të cilave është e mundur të zgjidhen këto forma procedure prokurimi.

Me Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 47, pika 1/ c) është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti ose enti kontraktor, afatet kohore për procedurat e hapura, procedurat e hapura të thjeshtuara, procedurat e kufizuara, shërbimet e konsulencës, procedurat konkurruese me negociim ose procedurat me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit, nuk mund të respektohen. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga autoriteti ose enti kontraktor*”.

VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 52, pika 1/c ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “.....*Në këtë rast, duhet të plotësohen njëkohësisht të gjitha kushtet e mëposhtme:*

- i. *Konstatimi i një ngjarjeje të paparashikuar;*
- ii. *Autoriteti/enti kontraktor nuk ka përgjegjësi për ngjarjen;*
- iii. *Ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshme të një komuniteti të gjerë;*
- iv. *Nuk është e mundur të ndiqen procedurat konkurruese mbi ose nën kufirin e ulët monetar.*

Në të gjitha rastet, autoriteti/enti kontraktor duhet të vërtetojë, të argumentojë dhe të dokumentojë se nevoja ekstreme e konstatuar, nuk është shkaktuar nga veprimi a mosveprimi i tij.

Neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe, që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure.

Kjo procedurë nuk mund të zbatohet për të justifikuar lidhjen e kontratave afatgjata, por vetëm për përballimin e nevojës ekstreme.

Me krijimin e nevojës ekstreme, autoriteti/enti kontraktor duhet njëkohësisht, të marrë të gjitha masat për realizimin e procedurave normale të prokurimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim edhe me:

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 2 dhe neni 21.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, neni 2,8 dhe 52.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre, nuk kanë maksimalizuar plotësisht eficientën dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike.

3. Zbatimi i kontratës “Mobilimi i spitalit të ri të ndërtuar (A2), fond limit 147,864,531 lekë pa TVSH.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua:

Auditimi u ushtrua me zgjedhje¹²

Agjencia Shtetërore e blerjeve të përqendruara me shkresën Nr. 119/26 prot., datë 15.07.2022, protokolluar me Nr. 35/33 prot., datë 15.07.2022, ka njoftuar Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza"(QSUNT) Tiranë, për lidhje kontrate, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash, me afat të marrëveshjes 1 vit, me fond limit 147,864,531 lekë pa TVSH.

Me deklaratë datë 03.05.2022 shoqëria “R.A.” shpk, ka deklaruar se me nënshkrimin e kontratës dhe dorëzimin e artikujve krahas mallrave objekt prokurimi, do paraqes pranë AK raport testimet përkatëse për çdo produkt, certifikatat e konformitetit ose të cilësisë CE/ekuivalent, si dhe certifikatën e origjinës. Për këtë paraqesim detyrimisht këtë deklaratë se çdo produkt do të shoqërohet me raportin përkatës ,si dhe certifikimet përkatëse, të cilat do të jenë sipas kërkesave/specifikimeve të AK. Raport i testeve përkatëse do të jetë lëshuar nga organet kompetente të akredituara jo më herët se ditën e nënshkrimit të kontratës pranë AK.

Me shkresën Nr. 62/162 prot., datë 29.09.2022 L.C. me detyrë drejtor i Shërbimeve Mbështetëse, i ka bërë kërkesë drejtorisë juridike, për dijëni Drejtorit të Përgjithshëm, për lidhje kontratë furnizimi Nr.3 me objekt loti 5, blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash., duke bashkëlidhur kësaj kërkesë listën e artikujve me Nr. rendor Nr. 33, me vlerë 59,736,000 lekë.

Me shkresën Nr. 62/118 prot., datë 28.07.2022 L.C. me detyrë drejtor i Shërbimeve Mbështetëse, i ka bërë kërkesë drejtorisë juridike, për dijëni Drejtorit të Përgjithshëm, për lidhje kontratë furnizimi Nr.1 me objekt loti 5, blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash., duke bashkëlidhur kësaj kërkesë listën e artikujve me Nr. rendor Nr. 33, me vlerë 8,013,00 lekë.

Kontrata Nr. 1, është lidhur me Nr. 62/127 prot., datë 16.08.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shoqërisë “R.A.” Shpk në vlerën 59,736,000 lekë me tvsh, përfaqësuar nga administratori R.K., kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve me afat 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Në nenin 5 të kësaj kontrate është përcaktuar “Specifikimet teknike” mallrat që do të furnizohet nga kontraktuesi, do të kenë specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit, katalogëve dhe skedave teknike të paraqitjes dhe deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, të pasqyruara në aneskin Nr.2, bashkëlidhur kësaj kontrate.

¹² *Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit”, i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.*

Përkuftizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: “Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj., në atë mënyrë që të gjithë kampionët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur”.

“Certifikimi” Çdo artikull mobile duhet të dorëzohet së bashku me certifikimin e garancisë dhe sigurisë”.

Neni 6 “Afatet e lëvrimin dhe marrja në dorëzim”. Malli do të shoqërohet me faturë ku do të nënshkruhet dhe procesverbali i marrjes në dorëzim dhe kolaudimit në lidhje me sasinë dhe specifikimet teknike për secilin nga mjetet dhe pajisjet objekt kontrate. Neni 6 “Afatet e lëvrimin dhe marrja në dorëzim”. Malli do të shoqërohet me faturë ku do të nënshkruhet dhe procesverbali i marrjes në dorëzim dhe kolaudimit në lidhje me sasinë dhe specifikimet teknike për secilin nga mjetet dhe pajisjet objekt kontrate. Pjesë e kësaj kontrate janë dhe specifikimet teknike për çdo artikull të përcaktuara në neni 5 të kontratës, si dhe aneksi Nr.1 i kontratës.

Plani i zbatimit të kontratës është me Nr. 62/113 prot., datë 10.10.2022, me persona përgjegjës/struktura të ngarkuar për ecurinë e zbatimit të kontratës E.T., me detyrë administrator i PAI-t polivalent, E.Th. me profesion infermier me detyrë përgjegjës i sektorit të infermierisë, G.K. me profesion akuakultur me detyrë specialist në sektorin logjistikes, I.J. ing. mekanik me detyrë specialist në sektorin e ndjekjes së investimeve, M.A. me profesion ekonomiste me detyrë specialiste në sektorin e financës, D.L. me profesion administrim biznes me detyrë specialist në sektorin e kostos.

Procesverbal i kolaudimit dhe marrjes në dorëzim Nr. 2370/12, datë 30.09.2022, për 14 artikuj për vlerën 8,013,000 lekë i firmosur nga D.L., G.K., E.Th., M.A., E.T. dhe E.K.. Dokument justifikues bashkëlidhur këtij procesverbal faturë elektronike Nr. 67/2022, date 30.09.2022, fletë hyrje Nr. 114, datë 30.09.2022.

Në këtë procesverbal është cituar në mënyrë eksplicite se “Komisioni pasi kontrolloj këto mallra sipas specifikimeve teknike dhe dokumentacionit të kërkuar vendosi ti bëjë hyrje në magazinë”.

Në këtë procesverbal janë kolauduar dhe marrë në dorëzim:

-Dollap për dhome pacienti Min 50x50x200 cm; Max 60x60x210 cm, copë 84 x 13,200 lekë/copë = 1,108,800 lekë.

-Dollap medikamentesh me xham Min 90x55x190 cm; Max100x60x200 cm, copë 40 x 21,620 lekë/copë= 864,000 lekë.

-Dollap veshje/zhveshje Garderop Min 90x45x190 cm; Max 100x50x200 cm, copë 30 x 27,600 lekë/copë= 828,000 lekë.

-Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): Min 115 x 70 x 72 cm; Max 120 x 75 x 77 cm, copë 17 x 17,352 lekë/copë =295,000 lekë.

-Tavoline pune për 1 post Min 180x70x75cm; Max 190x75x80cm, copë 34 x 21,600 lekë/copë=734,400 lekë.

- Tavoline ngrënie Min 130x60x70cm; Max 140x65x80cm, copë 4 x 12,000 lekë/copë =48,000 lekë.

Shuma lekë =3,879,000 lekë.

Me urdhër shpenzimin Nr. 3154, datë 27.10.2022 për vlerën 8,013,000 lekë, është likuiduar shoqëria “R.A.” Shpk. Ky shpenzim (likuidim) ka të bëjë me blerje dhe orendi dhe pajisje për mobilim zyra. Dokumentet vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi, faturë elektronike Nr. 67/2022, date 30.09.2022, fletë hyrje Nr. 114, datë 30.09.2022.

Me shkresën Nr. 62/128 prot., datë 17.08.2022, L.C. me detyrë Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse, i ka bërë kërkesë drejtorisë juridike, për dijëni Drejtorit të Përgjithshëm, për lidhje kontratë furnizimi Nr.2 me objekt loti 5, Blerje oredi dhe pajisje për mobilim zyresh., duke bashkëlidhur kësaj kërkesë listën e artikujve me Nr. rendor Nr. 83, me vlerë 81,970,200 lekë.

Kontrata furnizimi II, lidhur me Nr. 62/142 prot., datë 22.08.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shoqërisë “R.A.” Shpk në vlerën

81,970,200 lekë me tvsh, përfaqësuar nga administratori R.K., kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve me afat 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Në nenin 5 të kësaj kontrate është përcaktuar “Specifikimet teknike”, është përcaktuar në mënyrë eksplicite se “*Mallrat që do të furnizohen nga kontraktuesi, do të kenë specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit, katalogëve dhe skedave teknike të paraqitura në deklaratën për përmbushjen e specifikimeve teknike*”.

Neni 6 “Afatet e lëvrimin dhe marrja në dorëzim”. Malli do të shoqërohet me faturë ku do të nënshkruhet dhe procesverbali i marrjes në dorëzim dhe kolaudimit në lidhje me sasinë dhe specifikimet teknike për secilin nga mjetet dhe pajisjet objekt kontrate.

Kontrata shoqërohet me aneksin Nr. 2, me 83 artikuj me vlerë 81,970,200 lekë.

Plani i zbatimit të kontratës është me Nr. 62/145 prot., datë 02.09.2022, me persona përgjegjës/struktura të ngarkuar për ecurinë e zbatimit të kontratës E.T., me detyrë administrator i PAI-t polivalent, E.Th. me profesion infermier me detyrë përgjegjës i sektorit të infermierisë, G.K. me profesion akuakultur me detyrë specialist në sektorin e logjistikës, I.J. ing. mekanik me detyrë specialist në sektorin e ndjekjes së investimeve, M.A. me profesion ekonomiste me detyrë specialiste në sektorin e financës, D.L. me profesion administrim biznes me detyrë specialist në sektorin e kostos.

Me urdhër shpenzimit Nr. 3257, datë 07.11.2022 për vlerën 81,970,200 lekë, është likuiduar shoqëria “R.A.” Shpk. Ky shpenzim (likuidim) ka të bëjë me blerje dhe orendi dhe pajisje për mobilim zyra. Dokumentet vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi, faturë elektronike Nr. 68/2022, date 05.10.2022, fletë hyrje Nr. 116, datë 05.10.2022.

Procesverbal i kolaudimit dhe marrjes në dorëzim Nr. 2370/13 prot., datë 05.10.2022, për 83 artikuj për vlerën 81,970,200 lekë i firmosur nga D.L., G.K., E.Th., E.T. dhe E.K.. Dokument justifikues bashkëlidhur këtij procesverbalit faturë elektronike Nr. 65/2022, date 05.10.2022, fletë hyrje Nr. 116, datë 05.10.2022.

Në këtë procesverbal është cituar në mënyrë eksplicite se “Komisioni pasi kontrolloj këto mallra sipas specifikimeve teknike dhe dokumentacionit të kërkuar vendosi ti bëjë hyrje në magazinë.

Në këtë procesverbal janë kolauduar dhe marrë në dorëzim:

-Dollap medikamentesh me xham Min 90x55x190 cm;Max100x60x200 cm copë 63 x 21,600 lekë/copë = 1,260,800 lekë.

-Dollap personeli me çelës Min 90x50x72-216 cm; Max 100x55x77-220 cm copë 170 x 27,600 lekë/copë = 4,692,000 lekë.

-Dollap metalik me dyer Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min 90 x 40 x 195 cm; Max 100 x 50 x 205 cm copë 109 x 34,800 lekë/copë= 3,793,200 lekë.

-Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): Min 115 x 70 x 72 cm;Max 120 x 75 x 77 cm copë 74 x 17,400 lekë/copë= 1,287,600 lekë.

-Dollap për dhome pacienti Min 50x50x200 cm; Max 60x60x210 cm, copë 197 x 13,200 lekë/copë = 2,600,400 lekë.

Dollap veshje/zhveshje Garderop Min 90x45x190 cm;Max 100x50x200 cm copë 8 x22,800 = 182,400 lekë.

Tavoline pune për 1 post Min 180x70x75cm; Max190x75x80cm copë 6 x =129,600 lekë.

Shuma =13,916,400 lekë.

Kontrata furnizimi III, lidhur me Nr. 62/166 prot., datë 30.09.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F.në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë “R.A.” shpk në vlerën 59,736,000 lekë me tvsh, përfaqësuar nga administratori R.K., kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve me afat 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Në nenin 5 të kësaj kontrate është përcaktuar “Specifikimet teknike” mallrat që do të furnizohet nga kontraktuesi, do të kenë specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit, katalogëve dhe skedave teknike të paraqitjes dhe deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, të pasqyruara në aneksin Nr.2, bashkëlidhur kësaj kontrate.

Certifikimi. Çdo artikull mobilje duhet të dorëzohet së bashku me certifikimin e garancisë dhe sigurisë”.

Neni 6 “Afatet e lëvrimit dhe marrja në dorëzim”. Malli do të shoqërohet me faturë ku do të nënshkruhet dhe procesverbali i marrjes në dorëzim dhe kolaudimit në lidhje me sasinë dhe specifikimet teknike për secilin nga mjetet dhe pajisjet objekt kontrate.

Bashkëlidhur kontratës janë dhe specifikimet teknike për çdo artikull të firmosur nga shoqëria “R.A.” dhe jo nga njësia e prokurimit, të vërtetuara me vulën e sekretarisë të Agjencisë Shtetërore e blerjeve të përqendruara, m.q.s procedura e prokurimit është bërë nga kjo Agjenci.

Plani i zbatimit të kontratës është me Nr. 62/170 prot., datë 10.10.2022, me persona përgjegjës/struktura të ngarkuar për ecurinë e zbatimit të kontratës E.T., me profesion infermiere, me detyrë administrator i PAI-t polivalent, E.Th. me profesion infermier me detyrë përgjegjës i sektorit të infermierisë, G.K. me profesion akuakultur me detyrë specialist në sektorin logjistikes, I.J.me profesion ing. mekanik me detyrë specialist në sektorin e ndjekjes së investimeve, M.A.me profesion ekonomiste me detyrë specialiste në sektorin e financës, D.L. me profesion administrim biznes me detyrë specialist në sektorin e kostos.

Procesverbal i kolaudimit dhe marrjes në dorëzim Nr. 2370/15, datë 14.11.2022, për 31 artikuj për vlerën 46,976,400 lekë, i firmosur nga D.L., G.K., E.Th., M.A., M.A., E.T. dhe E.K.. Dokument justifikues bashkëlidhur këtij procesverbal faturë elektronike Nr. 78/2022, date 14.11.2022, fletë hyrje Nr. 147, datë 14.11.2022.

Në këtë procesverbal është cituar në mënyrë eksplicite se “Komisioni pasi kontrolloj këto mallra sipas specifikimeve teknike dhe dokumentacionit të kërkuar vendosi ti bëjë hyrje në magazinë”.

Në këtë procesverbal janë kolauduara dhe marrë në dorëzim:

-Dollap për dhome pacienti min 50x50x200 cm; max 60x60x210 cm copë 135 x 13.200 lekë/copë = 1,782,000 lekë.

-Dollap medikamentesh me xham min 90x55x190 cm; max100x60x200 cm copë 151 x 21,600 lekë/copë =1,101,600 lekë.

-Dollap veshje/zhveshje Garderop min 90x45x190 cm; max 100x50x200 cm, copë 50 x 22,800 lekë/copë=1,140,000 lekë.

-Dollap personeli me çelës min 90x50x72-216 cm; max 100x55x77-220, copë 127 x 27,600 lekë/copë = 3,505,200 lekë.

-Tavoline pune për 1 post min 180x70x75cm; max 190x75x80cm, copë 13 x 21,600 lekë/copë= 280,800 lekë.

Shuma 7,809,600 lekë.

Shuma për kontratën Nr.1,2,3 = 25,605,000 lekë (13,916,400 +7,809,600+3,879,000 =25,605,000).

Nga verifikimi fizik i kryer në Spitalin A2 (Urgjencës), më datë 27 dhe 28.03.2023 në prani të E.N. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore dhe E.K. me detyrë Specialist/ Inxhinier Biomedikal i Sektorit të Inxhinierisë Klinike, u konstatua se për pajisjet e sipërpërmendura në vlerën 25,605,000 lekë me TVSH, nuk janë zbatuar specifikimet teknike. Nga grupi i auditimit është realizuar gjurma e auditimit, e cila është pjesë e dosjes së auditimit.

Menaxhmenti dhe personat e përfshire në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre, nuk kanë maksimalizuar plotësisht eficientë dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike.

Me urdhër shpenzimin Nr. 3490, datë 02.12.2022 për vlerën 12,759,600 lekë, është likuiduar shoqëria “R.A.” shpk. Ky shpenzim (likuidim) ka të bëjë me blerje dhe orendi dhe pajisje për mobilim zyra. Dokumentet vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi, faturë elektronike Nr. 76/2022, date 01.11.2022, fletë hyrje Nr. 146, datë 01.11.2022.

Me urdhër shpenzimin Nr. 3678, datë 14.12.2022 për vlerën 46,976,400 lekë, është likuiduar shoqëria “R.A.” shpk. Ky shpenzim (likuidim) ka të bëjë me blerje dhe orendi dhe pajisje për mobilim zyra. Dokumentet vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi, faturë elektronike Nr. 78/2022, date 14.11.2022, fletë hyrje Nr. 147, datë 14.11.2022.

Formaliteti i marrjes në dorëzim të pajisjeve mjekësore provohet dhe me faktin se, për çdo kontratë data e faturës elektronike, procesverbali i kolaudit dhe marrjes në dorëzim dhe fletëhyrja janë bërë në një datë.

Me urdhrin Nr. 285 datë 28.07.2022, administruar me Nr. 16/120 prot., datë 28.07.2022 të drejtorit të përgjithshëm është ngritur grupi i punës për kolaudit dhe marrjen në dorëzim të blerje oredi dhe pajisje për mobilim zyrash, i përbërë nga E.T., me profesion infermiere me detyrë administrator i PAI-t polivalent, E.Th. me profesion infermier me detyrë përgjegjës i sektorit të infermierisë, G.K. me profesion akuakultur me detyrë specialist në sektorin e logjistikës, I.J. me profesion ing. mekanik me detyrë specialist në sektorin e ndjekjes së investimeve, M.A. me profesion ekonomiste me detyrë specialiste në sektorin e financës, D.L. me profesion administrim biznes me detyrë specialist në sektorin e kostos.

Referuar artikujve të kontratës dhe specifikimeve teknike, asnjë prej tyre nuk është specialist i fushës, inxhinier druri.

Në të tre kontratat e lidhura si më sipër nuk është përcaktuar se mobiljet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së pajisjeve dhe test raport fabrike (raportet e testeve) në zbatim të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqërues të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.*

Veprim që ngarkon me përgjegjësi A.F. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike për periudhën 01.04.20221- 09.02.2022.

Në të tre kontratat për 137 artikuj me vlerë 149,719, 200 lekë, mobiljet janë të pa shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat.

Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës (raportet e testeve), që të konfirmohet që këto mobilje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën shoqëria “R.A.” sh.p.k ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

Për pasojë grupi i auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të jap opinionin e tij, që këto mobilet janë të njëjta me ato të prokuruar dhe për të cilat shoqëria “R.A.” sh.p.k , ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

Në të tre kontratat e lidhura si më sipër nuk është raportuar në APP për çdo fazë të realizimit të kontratës në kundërshtim me:

VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës”, pika 5 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Autoriteti/enti kontraktor duhet raportojë në APP për çdo fazë: për modifikimin/modifikimet e çdo kontrate, ndërprerjen, përfundimin (me sukses apo penaltet) apo shpalljen e pavlefshme të saj, duke pasqyruar në formularin përkatës, arsyet, rrethanat dhe argumentimin përkatës, mbi bazën e dispozitave ligjore që është bërë modifikimi, ndërprerja, përfundimi, apo shpallja e pavlefshme e kontratës”*.

Pika 6, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“... Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i kontratës, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin”*.

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Neni 125 “Detyrimet e autoritetit kontraktor ndaj Agjencisë së Prokurimit Publik”.

Pika 3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Në përfundim të zbatimit të një kontrate, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrim të dërgojë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik formularin e raportimit për zbatimin e kontratës, jo më vonë se 30 ditë nga data e përfundimit të kontratës”*.

Veprim që ngarkon me përgjegjësi A.F. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike për periudhën 01.04.20221- 09.02.2022 dhe B.L. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike për periudhën 13.09.20221- 31.12.2022.

Zbatimi i kontratës.

Në procesverbalet e marrjes në dorëzim si më sipër, grupi i kolaudimit dhe marrjes në dorëzim i përbërë nga D.L., G.K., M.A., I.J.E.T. , E.K. kanë marr në dorëzim mobiljet, duke cilësuar se *“Komisioni pasi kontrollon këto mallra sipas specifikimeve teknike dhe dokumentacionit të kërkuar vendosi ti bëjë hyrje në magazinë”*.

Nga verifikimi fizik i orendive dhe pajisje për mobilim zyrash u konstatua:

Kati 0 (infirmieri).

Tavolinë pune për 2 poste.

Në specifikimet teknike është përcaktuar: Tavolinë pune me suprinë MDF të veshur me melaninë. Pjesa anësore të paneleve MDF janë veshura me material ABS (tenije) sipas ngjyrës së panelit. Nën tavolinë janë vendosur sirtarë me të njëjtin material. Struktura metalike është e lyer me bojë epoksi me fibra minerale ngjyrë argjendi. Në fundin e këmbëve vendosen tapa plastike ngjyrë zezë.

Në fakt tavolina nuk ka sirtar, profili metalik është 40x20 është me ngjyrë të zezë, nuk është e lyer me bojë epoksi me fibra minerale ngjyrë argjendi. Materiali është MDF, nuk është MDF e veshur me melaninë, tenije, metalike. Në fundin e këmbëve nuk janë vendosur tapa plastike ngjyrë zezë.

Pra tavolina është në kundërshtim me specifikimet teknike.

Dollap për dhomë pacienti.

Në specifikimet teknike është përcaktuar:

Organizimi i dollapit: E ndarë në 3 hapësira. Dollapi është me një kanat të mbyllur me çelës dhe pjesa e hapësirës së mezit është me varëse për rrobat. Hapësira e sipërme dhe e poshtme është si në figurë. Materiali është melaminë i plastifikuar me PVC.

Aksesoret metalik.

Element plastik kundër- gërvishtje për mbështetjen në tokë.

Dimensione: Min 50x50x200 cm; Max 60x60x210 cm.

Në fakt ka dy dollap, me dimensioni 200 cm, 44.45 i thellë, i gjerë 90.5 cm. Në specifikimet teknike dimensionet janë Min 50x50x200 cm; Max 60x60x210 cm. Nuk ka element plastik kundër- gërvishjeve për mbështetjen në tokë.

Në specifikimet teknike nuk janë përcaktuar:

Trashësia e skeletit dhe sergjenet, si dhe spesoret e kapakëve. Dorezat e kanateve dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë.

Montimi dhe zmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

Në fakt në kontratë nuk është përcaktuar ngjyra.

Duke u nisur nga ky fakt të gjithë dollapët e pacientëve janë në kundërshtim me specifikimet teknike.

Kati 0: Dhomë pacienti observimi Infermiera.

Dollap për dhomë pacienti

Në specifikimet teknike është përcaktuar

Organizimi i Dollapit: E ndarë në 3 hapësira. Dollapi është me një kanat të mbyllur me çelës dhe pjesa e hapësirës së mezit është me varëse për rrobat. Hapësira e sipërme dhe e poshtme është si në figure. Materiali është melaminë i plastifikuar me PVC.

Aksesoret metalik.

Element plastik kundër- gërvishjeve për mbështetjen në tokë.

Dimensione: Min 50x50x200 cm; Max 60x60x210 cm.

Në fakt ka dy dollap, me dimensioni 200 cm, 44.45 i thellë, i gjerë 90.5 cm. Në specifikimet teknike dimensionet janë Min 50x50x200 cm; Max 60x60x210 cm. Nuk ka element plastik kundër- gërvishjeve për mbështetjen në tokë. Nuk ka aksesoret metalik, por ca vrima për të hapur kanatet.

Në specifikimet teknike nuk janë përcaktuar:

Trashësia e skeletit dhe sergjenet, si dhe spesoret e kapakëve. Dorezat e kanateve dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë.

Montimi dhe zmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

Në fakt në kontratë nuk është përcaktuar ngjyra.

Duke u nisur nga ky fakt të gjithë dollapët e pacientëve janë në kundërshtim me specifikimet teknike.

Kati I, kardiologji 1 “Dhomë izolimi”.

Planimetria e mobilimit nuk ka kolltuk, nuk ka dollap.

Në fakt tek lista e projektit (listë mobilimi) është përcaktuar që çdo dhomë 1 dollap për çdo shtratë, 1 tavolinë ngrënieje, 1 kolltuk për familjarët.

Në specifikimet teknike është përcaktuar:

Tavolinë ngrënie

Të përgjithshme: Një tryezë me 4 këmbë, syprina është jashtëzakonisht e qëndrueshme.

Struktura: Dru i fortë ahu të llakuara; Lloji i këmbëve: katror.

Syprina: jo me pak se $t=25$ mm, e veshur me melaminë ose e veshur me HPL; Buzë: ABS (tenije).

Dimensione: Min 130x60x70cm Max 140x65x80cm.

Në fakt, 135.3 x65x70 cm, suprina 25 mm, aq sa është dhe në specifikimet teknike. Këmbët nuk janë katrorë, vinë të ngushtë nga mesi i këmbesë deri në fund.

Kati I, Infermeria.

Tavolinë pune + komodine. Në specifikimet teknike është përcaktuar:

Përbëhet nga 2 pjesë kryesore: Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): Min 115 x 70 x 72 cm; Max 120 x 75 x 77 cm; Min 40 x 60 x h-68 cm; Max 50 x 70 x h-75 cm.

Karakteristikat kryesore të produktit: Syprina melaminë me trashësi jo me pak se 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Në pjesën e brendshme në njërin krah ndodhet posti i tastierës e fiksuar me shina rrëshqitëse, në krahun tjetër ndodhen dy sirtarë me gjerësi 45 cm ku sirtari i parë të jetë i mbyllur me çelës. Montimi i tastierës duhet të jetë i thjeshtë dhe me mundësi zgjedhje të krahut të punës. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kablllove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues.

Karakteristikat kryesore të komodinës: Përbëhet nga 3 sirtarë me rrota lëvizëse, materiali të jetë i njëjtë me tavolinën.

Në fakt: Dimesionet 115x70x75 cm. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve nuk janë rrethuara me material plastik PVC. Në planin e punës është e hapur një vrimë, në të cilën nuk është fiksuar një mekanizëm plastik në formë cilindri që të bëjë të mundur kalimin e kablllove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët nuk kanë mekanizëm nivelues.

Duke u nisur nga ky fakt të gjitha tavolinat e punës janë në kundërshtim me specifikimet teknike.

Kati I, Infermeria.

Dollap medikamentesh me xham. Në specifikimet teknike është përcaktuar:

Kabineti me strukturë bilaminat. Struktura është bërë tërësisht nga bilaminat (trashësia 20mm) me buzë të bardha ABS. Ana e pasme në bilaminat. Ndarja e brendshme është e pajisur me 4-5 raftë të rregullueshme të bëra nga dy ndarje bilamineti. Dyert janë me cilës dhe janë bërë nga bilaminat i bardhë me buzë ABS dhe janë furnizuar me 4 mentesha me të paktën Hapja 270 °. Pjesa e brendshme e secilës derë e pajisur me ndarje fikse prej polistireni termoformuar, përfshirë këtu 10 ndarje (dimensioni i përafërt me një ndarje: 35x10x15cm). Baza e pajisur me këmbët e bëra nga tuba çeliku, të lyera epoksi, me hekura plastike.

Përmasat totale të përafërta: Min 90x55x190 cm Max 100x60x200 cm.

Në fakt: Ka dy dollapë medikamentesh me dimensione 192x55x90. Në specifikimet teknike është përcaktuar, struktura është bërë tërësisht nga bilaminat (trashësia 20mm) me buzë të bardha ABS, në fakt është 15 mm dhe jo 20 mm. Dyert nuk janë të bëra nga bilaminat i bardhë me buzë ABS, siç është përcaktuar në specifikimet teknike. Pjesa e brendshme e secilës derë nuk është e pajisur me ndarje fikse prej polistireni termoformuar, përfshirë këtu 10 ndarje (dimensioni i përafërt me një ndarje: 35x10x15cm). Baza nuk është e pajisur me këmbët e bëra nga tuba çeliku, të lyera epoksi, me hekura plastike, në kundërshtim me specifikimet teknike, por është me plastik vetëm.

Kardiologji 1, urgjenca, dhomë trajtimi.

Dollap metalik me dyer. Në specifikimet teknike është përcaktuar:

Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min 90 x 40 x 195 cm; Max 100 x 50 x 205 cm.

Karakteristikat kryesore të produktit: Dollap metalik me dyer duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës.

Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira. Sergjenet ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Këmbët e dollapit duhet të kenë mundësi nivelimi.

Në fakt dyer nuk kanë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korozionit dhe përkuljes, por metalik, ndërsa dollapi përbëhet nga llamarinë jo nga material metalik. Nuk ka këmbë për mundësi nivelimi, detyrime të përcaktuara në specifikimet teknike.

Kardiologji 1, dhomë skaneri.

Skaner i përdorur, i sjell nga urgjenca, viti i prodhimit 2010, i pajisur me çertifikatën e re, pasi ka kaluar afati 5-vjeçar, VKM.

Angiograf, aparati Philips, i transferuar.

Dollap i ri metalik me dy kanate, ardhur nga shërbimi i hemodializës, me Nr. Inventari 20178

Dollap metalik me dyer, 3 copë.

Në specifikimet teknike është përcaktuar

Dollap metalik me dyer.

Përmasat (gjërësi x thellësi x lartësi): Min 90 x 40 x 195 cm; Max 100 x 50 x 205 cm.

Karakteristikat kryesore të produktit: Dollap metalik me dyer duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës. Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira. Sergjenet ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Këmbët e dollapit duhet të kenë mundësi nivelimi.

Elementë të tjerë shtesë: Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

Dollapët duhet të ishin të rinj, në fakt janë të përdorur, llamarinë e lyer me bojë, portat nuk mbyllën lehtësisht, por bëjnë shumë zhurmë.

Kardiologji, reaminacioni 2.

Kati zero, dhomë komandimi.

Dollap metalik me dyer.

Përmasat (gjërësi x thellësi x lartësi): Min 90 x 40 x 195 cm; Max 100 x 50 x 205 cm.

Karakteristikat kryesore të produktit: Dollap metalik me dyer duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës. Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira. Sergjenet ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Këmbët e dollapit duhet të kenë mundësi nivelimi.

Elementë të tjerë shtesë: Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

Në fakt dollapët duhet të ishin të rinj, në fakt janë të përdorur.

Kati zero, dhomë angiograf. aparati i ri, dhuruar nga unopsi.

Vo: Në dhomën e komandimit. Janë katër dollap metalik, të ardhur nga shërbimet e tjetra (jo të blera), të cilat duhet të ishin modeli i të gjithë dollapëve të tjerë metalik të blerë për Spitalin e Ri A2. Pra ato plotësojnë plotësisht specifikimet e kërkuara për dollapët metalik, të cilat janë pjesë e kontratës.

Në këtë dhomë është dhe dollap medikamentesh me xham.

Në specifikimet teknike është përcaktuar:

Kabineti me strukturë bilaminat. Struktura është bërë tërësisht nga bilaminat (trashësia 20mm) me buzë të bardha ABS. Ana e pasme në bilaminat. Ndarja e brendshme është e pajisur me 4-5

rafte të rregullueshme të bëra nga dy ndarje bilamineti. Dyert janë me çelës dhe janë bërë nga bilaminat i bardhë me buzë ABS dhe janë furnizuar me 4 mentesha me të paktën hapja 270 °. Pjesa e brendshme e secilës derë e pajisur me ndarje fikse prej polistireni termoformuar, përfshirë këtu 10 ndarje (dimensioni i përafërt me një ndarje: 35x10x15cm). Baza e pajisur me këmbët e bëra nga tuba çeliku, të lyera epoksi, me hekura plastike.

Përmasat totale të përafërta: Min 90x55x190 cm; Max 100x60x200 cm.

Në fakt: Ka dy dollapë medikamentesh me dimensione 192x55x90. Në specifikimet teknike është përcaktuar, struktura është bërë tërësisht nga bilaminat (trashësia 20mm) me buzë të bardha ABS, në fakt është 15 mm dhe jo 20 mm. Dyert nuk janë të bëra nga bilaminat i bardhë me buzë ABS, siç është përcaktuar në specifikimet teknike. Pjesa e brendshme e secilës derë nuk është e pajisur me ndarje fikse prej polistireni termoformuar, përfshirë këtu 10 ndarje (dimensioni i përafërt me një ndarje: 35x10x15cm). Baza nuk është e pajisur me këmbët e bëra nga tuba çeliku, të lyera epoksi, me hekura plastike, në kundërshtim me specifikimet teknike, por është me plastik vetëm.

Kati zero, dhomë ekzaminimi.

Treatmil për zemrën. Kontraktuesi M. Nuk ka etiket në shqip, etiketa në letër, jo në trupë, pa markimin CE.

Tavolinë pune + komodine. Në specifikimet teknike është përcaktuar

Përbëhet nga 2 pjesë kryesore: Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): Min 115 x 70 x 72 cm; Max 120 x 75 x 77 cm; Min 40 x 60 x h-68 cm; Max 50 x 70 x h-75 cm .

Karakteristikat kryesore të produktit: Syprina melaminë me trashësi jo më pak se 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Në pjesën e brendshme në njërin krah ndodhet posti i tastierës e fiksuar me shina rrëshqitëse, në krahun tjetër ndodhen dy sirtarë me gjerësi 45 cm ku sirtari i parë të jetë i mbyllur me çelës. Montimi i tastierës duhet të jetë i thjeshtë dhe me mundësi zgjedhje të krahut të punës. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kablllove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues.

Karakteristikat kryesore të komodinës: Përbëhet nga 3 sirtarë me rrota lëvizëse, materiali të jetë i njëjtë me tavolinën.

Në fakt: Dimensionet 115x70x75 cm. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve nuk janë rrethuara me material plastik PVC. Në planin e punës është e hapur një vrimë, në të cilën nuk është fiksuar një mekanizëm plastik në formë cilindri që të bëjë të mundur kalimin e kablllove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët nuk kanë mekanizëm nivelues.

Dollap metalik me dyer. Në specifikimet teknike është përcaktuar:

Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min 90 x 40 x 195 cm; Max 100 x 50 x 205 cm.

Karakteristikat kryesore të produktit: Dollap metalik me dyer duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës. Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira. Sergjenet ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Këmbët e dollapit duhet të kenë mundësi nivelimi.

Në fakt dyer nuk kanë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korrozionit dhe përkuljes, por metalik, ndërsa dollapi përbëhet nga llamarinë jo nga material metalik. Nuk ka këmbë për mundësi nivelimi, detyrime të përcaktuara në specifikimet teknike.

Dhomë ekzaminimi.

Tavolinë pune për 2 poste.

Në specifikimet teknike është përcaktuar: Tavolinë pune me supinë MDF të veshur me melaminë. Pjesa anësore të paneleve MDF janë veshura me material ABS (tenije) sipas ngjyrës së panelit. Nën tavolinë janë vendosur sirtarë me të njëjtin material. Struktura metalike është e lyer me bojë epoksi me fibra minerale ngjyrë argjendi. Në fundin e këmbëve vendosen tapa plastike ngjyrë zezë.

Në fakt tavolina nuk ka MDF, profili metalik është 40x20 është me ngjyrë të zezë, nuk është e lyer me bojë epoksi me fibra minerale ngjyrë argjendi. Materiali është MDF, nuk është melaminë. Në fundin e këmbëve nuk janë vendosur tapa plastike ngjyrë zezë. Pra tavolina është në kundërshtim me specifikimet teknike.

Dollap metalik me dyer. Në specifikimet teknike është përcaktuar:

Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min 90 x 40 x 195 cm; Max 100 x 50 x 205 cm.

Karakteristikat kryesore të produktit: Dollap metalik me dyer duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korrozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës. Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira. Sergjenet ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Këmbët e dollapit duhet të kenë mundësi nivelimi.

Në fakt janë dy dollapë, dyer nuk kanë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korrozionit dhe përkuljes, por metalik, ndërsa dollapi përbëhet nga llamarinë jo nga material metalik. Nuk ka këmbë për mundësi nivelimi, detyrime të përcaktuara në specifikimet teknik.

Kardiologjia Nr.1, Dhomë ekzaminimi.

Dollap për dosje dy kanatesh. Në specifikimet teknike është përcaktuar:

Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min 80 x 45 x 180 cm; Max 90 x 50 x 200 cm.

Karakteristikat kryesore të produktit: Skeleti dhe kanatet duhet të jenë prej materiali melaminë me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Sergjenet do jenë prej materiali melaminë me trashësi 2.5 cm. Materiali të ketë veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishjeve dhe njollave. Xokula do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njëjtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kanateve të jenë të veshura (bordura) me material plastik PVC. Kanatet të mbyllën me çelës. Pjesa e brendshme të ndahet në 5 (pesë) hapësira me sergjenë me mundësi regjistrimi sipas nevojës. Dorezat e kanateve dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë.

Elementë të tjerë shtesë: Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

Në fakt. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kanateve nuk janë të veshura (bordura) me material plastik PVC. Nuk ka doreza fare të kanateve dhe aksesorët e përdorur nuk janë cilësorë.

Në planimetrinë e mobilimit është përcaktuar 1 dollap i madh metalik. Në fakt nuk është metalik por melaminë.

Kardiologjia Nr. 1, Dhoma pacienti Nr. 1, 2, Nr.3, Nr.4 dhe Nr. 5.

Dollap për dhomë pacienti

Në specifikimet teknike është përcaktuar

Organizimi i Dollapit: E ndare në 3 hapësira. Dollapi është me një kanat të mbyllur me çelës dhe pjesa e hapësirës së mezit është me varëse për rrobat. Hapësira e sipërme dhe e poshtme është si në figure. Materiali është melamin i plastifikuar me PVC.

Aksesoret metalik.

Element plastik kundër- gërvishjeve për mbështetjen në toke.

Dimensione: Min 50x50x200 cm; Max 60x60x210 cm.

Në fakt ka dy dollap, me dimensionin 200 cm, 44.45 i thellë, i gjerë 90.5 cm. Në specifikimet teknike dimensionet janë Min 50x50x200 cm; Max 60x60x210 cm. Nuk ka element plastik kundër- gërvishjeve për mbështetjen në tokë.

Në specifikimet teknike nuk janë përcaktuar:

Trashësia e skeletit dhe sergjenet, si dhe spesoret e kapakëve. Dorezat e kanateve dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë.

Montimi dhe zmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

Në fakt në kontratë nuk është përcaktuar ngjyra.

Dhomë Ekzaminimi

Dollap për dosje dy kanatesh. Në specifikimet teknike është përcaktuar:

Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min 80 x 45 x 180 cm; Max 90 x 50 x 200 cm.

Karakteristikat kryesore të produktit: Skeleti dhe kanatet duhet të jenë prej materiali melaminë me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Sergjenet do jenë prej materiali melaminë me trashësi 2.5 cm. Materiali të ketë veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishjeve dhe njollave. Xokula do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njëjtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kanateve të jenë të veshura (borduar) me material plastik PVC. Kanatet të mbyllën me çelës. Pjesa e brendshme të ndahet në 5 (pesë) hapësira me sergjenë me mundësi regjistrimi sipas nevojës. Dorezat e kanateve dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë.

Elementë të tjerë shtesë: Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

Në fakt. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kanateve nuk janë të veshura (borduar) me material plastik PVC. Nuk ka doreza fare të kanateve dhe aksesoret e përdorur nuk janë cilësorë.

Tavolinë pune + komodine. Në specifikimet teknike është përcaktuar

Përbëhet nga 2 pjesë kryesore: Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): Min 115 x 70 x 72 cm; Max 120 x 75 x 77 cm; Min 40 x 60 x h-68 cm; Max 50 x 70 x h-75 cm.

Karakteristikat kryesore të produktit: Syprina melaminë me trashësi jo më pak se 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Në pjesën e brendshme në njërin krah ndodhet posti i tastierës e fiksuar me shina rrëshqitëse, në krahun tjetër ndodhen dy sirtarë me gjerësi 45 cm ku sirtari i parë të jetë i mbyllur me çelës. Montimi i tastierës duhet të jetë i thjeshtë dhe me mundësi zgjedhje të krahut të punës. Aksesoret që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kabllave nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues.

Karakteristikat kryesore të komodinës: Përbëhet nga 3 sirtarë me rrota lëvizëse, materiali të jetë i njëjtë me tavolinën.

Në fakt: Dimensionet 115x70x75 cm. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve nuk janë rrethuara me material plastik PVC. Në planin e punës është e hapur një vrimë, në të cilën nuk

është fiksuar një mekanizëm plastik në formë cilindri që të bëjë të mundur kalimin e kablllove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët nuk kanë mekanizëm nivelues. eko kardikake me dy sonda.

Pa asnjë etiketë as në letër as në ngjitur në trup, furnitori “M. ”.

Kardiologjia Nr. 2.

Dhomë ekzaminimi

Tavolinë pune + komodine. Në specifikimet teknike është përcaktuar

Përbëhet nga 2 pjesë kryesore: Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): Min 115 x 70 x 72 cm; Max 120 x 75 x 77 cm; Min 40 x 60 x h-68 cm; Max 50 x 70 x h-75 cm.

Karakteristikat kryesore të produktit: Syprina melaminë me trashësi jo me pak se 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishetjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Në pjesën e brendshme në njërin krah ndodhet posti i tastierës e fiksuar me shina rrëshqitëse, në krahun tjetër ndodhen dy sirtarë me gjerësi 45 cm ku sirtari i parë të jetë i mbyllur me çelës. Montimi i tastierës duhet të jetë i thjeshtë dhe me mundësi zgjedhje të krahut të punës. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kablllove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues.

Karakteristikat kryesore të komodinës: Përbëhet nga 3 sirtarë me rrota lëvizëse, materiali të jetë i njëjtë me tavolinën.

Në fakt: Dimesionet 115x70x75 cm. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve nuk janë rrethuara me material plastik PVC. Në planin e punës është e hapur një vrimë, në të cilën nuk është fiksuar një mekanizëm plastik në formë cilindri që të bëjë të mundur kalimin e kablllove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët nuk kanë mekanizëm nivelues.

Dollap metalik me dyer. Në specifikimet teknike është përcaktuar:

Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min 90 x 40 x 195 cm; Max 100 x 50 x 205 cm.

Karakteristikat kryesore të produktit: Dollap metalik me dyer duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korrozionit dhe përkuļjes. Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës. Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira. Sergjenet ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Këmbët e dollapit duhet të kenë mundësi nivelimi.

Në fakt dyert nuk kanë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korrozionit dhe përkuļjes, por metalik, ndërsa dollapi përbëhet nga llamarinë jo nga material metalik. Nuk ka këmbë për mundësi nivelimi, detyrime të përcaktuar në specifikimet teknike.

Dhomë ekzaminimi

Treatmil (PIST) për zemrën. Kontraktuesi ontal. Nuk ka etiketë në shqip, etiketa në letër, jo në trupë, pa markimin CE.

Tavolinë pune + komodine. Në specifikimet teknike është përcaktuar

Përbëhet nga 2 pjesë kryesore: Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi); Min 115 x 70 x 72 cm; Max 120 x 75 x 77 cm; Min 40 x 60 x h-68 cm; Max 50 x 70 x h-75 cm.

Karakteristikat kryesore të produktit: Syprina melaminë me trashësi jo me pak se 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishetjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë

të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Në pjesën e brendshme në njërin krah ndodhet posti i tastierës e fiksuar me shina rrëshqitëse, në krahun tjetër ndodhen dy sirtarë me gjerësi 45 cm ku sirtari i parë të jetë i mbyllur me çelës. Montimi i tastierës duhet të jetë i thjeshtë dhe me mundësi zgjedhje të krahut të punës. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kabllave nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues.

Karakteristikat kryesore të komodinës: Përbëhet nga 3 sirtarë me rrota lëvizëse, materiali të jetë i njëjtë me tavolinën.

Në fakt: Dimensionet 115x70x75 cm. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve nuk janë rrethuara me material plastik PVC. Në planin e punës është e hapur një vrimë, në të cilën nuk është fiksuar një mekanizëm plastik në formë cilindri që të bëjë të mundur kalimin e kabllave nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët nuk kanë mekanizëm nivelues.

Dollap metalik me dyer. Në specifikimet teknike është përcaktuar:

Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min 90 x 40 x 195 cm; Max 100 x 50 x 205 cm.

Karakteristikat kryesore të produktit: Dollap metalik me dyer duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korrozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës. Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira. Sergjenet ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Këmbët e dollapit duhet të kenë mundësi nivelimi.

Në fakt dyert nuk kanë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korrozionit dhe përkuljes, por metalik, ndërsa dollapi përbëhet nga llamarinë jo nga material metalik. Nuk ka këmbë e dollap për mundësi nivelimi, detyrime të përcaktuara në specifikimet teknike.

Kati i tretë, “dermatologji), dhomë pacienti Nr. 1.

Dollap për dhomë pacienti. Në specifikimet teknike është përcaktuar

Organizimi i Dollapit: E ndare në 3 hapësira. Dollapi është me një kanat të mbyllur me çelës dhe pjesa e hapësirës së mezit është me varëse për rrobat. Hapësira e sipërme dhe e poshtme është si në figurë. Materiali është melamin i plastifikuar me PVC.

Aksesorët metalik.

Element plastik kundër gërvishjeve për mbështetjen në toke.

Dimensione: Min 50x50x200 cm; Max 60x60x210 cm.

Në fakt ka dy dollap, me dimensionin 200 cm, 44.45 i thellë, i gjerë 90.5 cm. Në specifikimet teknike dimensionet janë: Min 50x50x200 cm; Max 60x60x210 cm. Nuk ka element plastik kundër- gërvishje për mbështetjen në tokë. Nuk ka aksesorët metalik, por ca vrima për të hapur kanatet.

Në specifikimet teknike nuk janë përcaktuar:

Trashësia e skeletit dhe sergjenet, si dhe spesorët e kapakëve. Dorezat e kanateve dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë.

Montimi dhe zmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paketohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

Në fakt në kontratë nuk është përcaktuar ngjyra.

Kati i tretë, dermatologji, “rematologjia”; krevat metalik, copë 2 të përdorur; Kati i V. Gastrohepatologjia, kabineti endoskopisë.

Pajisja Vidiokolonoskop, pajisje re, kontraktori A. F..

Pajisja nuk ka video procesorin, pasi është marr dhe i është kaluar shërbimit vjetër tek numri i inventarit 21916, pajisje e vjetër që është në shërbim dhe nuk është mirëmbajtur.

Kati i V, gastrohepatologjia, dhomë ndrim stafi femra.

Dollap metalik, copë 4, dyert të dëmtuar nuk puthiten. Dollapët janë me llamarinë dhe hapen nga lartë, pa çelës, dhe po të kishin çelës, çelësi nuk do të kryente asnjë funksion.

Infermierët e pranishme thanë se nuk kemi ku lëmë rrobat. Dollapët nuk janë metalik, por llamarinë e lyer me bojë.

Kati i V, gastrohepatologjia, dhomë ndrim stafi meshkuj.

Dollap metalik, copë 4, dyert të dëmtuar nuk puthiten. Dollapët janë me llamarinë dhe hapen nga lartë, pa çelës, dhe po të kishin çelës, çelësi nuk do të kryente asnjë funksion.

Infermierët e pranishme thanë se nuk kemi ku lëmë rrobat. Dollapët nuk janë metalik, por llamarinë e lyer me bojë.

Referuar sa më sipër, shoqëria “R.A.” Shpk në cilësinë e kontraktorit nuk ka zbatuar specifikimet teknike, specifikime të përcaktuara në dokumentet e tenderit, që janë pjesë integrale e kontratave. Autoriteti kontraktor në “Kriteret e veçanta për kualifikim” në të cilat përfshihen specifikimet teknike, ka përcaktuar tërësinë e kërkesave teknike. Konkretisht karakteristikat e kërkuara për mallrat, duke përfshirë nivelin e cilësisë, performancës, sigurisë apo përmasave, garantimin e cilësisë, termoplegjinë, simbolet, testimet dhe metodat e testimit, si dhe paketimin dhe etiketimin, të cilat nuk janë zbatuar nga shoqëria “R.A.” Shpk.

Veprime në kundërshtim me:

- Marrëveshjen kuadër të lidhur me Nr. 7/26 prot., datë 17.07.2020 ndërmjet QSUNT dhe operatorit ekonomik “R.A.” shpk, ku është përcaktuar “Kontraktori , me an të ofertës së tij, bie dakort të furnizoj mallra, ashtu siç janë specifikuar në kushtet e përcaktuara në kontratë, formularin e deklaramit të ofertës, specifikimet teknike, formulari i çmimit të ofertës dhe dokumentet standard të tenderit”.

-Kontratën Nr. I, është lidhur me Nr. 62/127 prot., datë 16.08.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shoqërisë “R.A.” Shpk në vlerën 59,736,000 lekë me TVSH, neni 5.

-Kontratën e furnizimit II, lidhur me Nr. 62/142 prot., datë 22.08.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shoqërisë “R.A.” Shpk në vlerën 81,970,200 lekë me TVSH, neni 5.

-Kontratën e furnizimit III, lidhur me Nr. 62/166 prot., datë 30.09.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shoqërisë “R.A.” Shpk në vlerën 59,736,000 lekë me TVSH.

- Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 122 “Rregullat që zbatohen për kontratën”, pika 1. Kushtet e kontratës të lidhur sipas këtij ligji nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur kontraktori, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

-Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur “...Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblyerimin e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguar”.

-Deklaratën datë 03.05.2022 mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik “R.A.” Shpk.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre, nuk kanë maksimalizuar plotësisht efikasitetin dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, veprim në kundërshtim me:

-Ligjin Nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” pika 5.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II, neni 2, 8 dhe 52.

Si pasojë e mos zbatimit të specifikimeve teknike, shoqëria “R.A.” shpk ka përfituar padrejtësisht vlerën 25,605,000 lekë, duke krijuar në këtë mënyrë dëm ekonomik në të njëjtën vlerë.

4. Zbatimi i kontratës “Furnizim vendosje të aparaturave mjekësore për spitalin e ri të ndërtuar (A2), loti 10, viti 2022.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua:

Auditim me zgjedhje¹³

Me urdhër shpenzimin Nr. 3489, datë 01.12.2022 për vlerën 23,064,000 lekë, nëpërmjet Credins Bankë është likuiduar shoqëria “B.A.” shpk në vlerën 23,064,000 lekë me tvsh. Dokumentacioni vërtetues: Relacioni Nr. 64/157 prot., datë 30.11.2022 marrjes në dorëzim për 130 Shtrat pacienti me kontroll manual për vlerën 10,400,000 pa tvsh, 12,480,000 lekë me TVSH, 84 krevat spitalor ICU me 3 motor për vlerën 8,820,000 lekë pa tvsh dhe 10,584,000 lekë me Tvsh, me vlerë totale 23,064,000 lekë i firmosur nga A.S., I.H., E.B., A.D., D.Ç., E.T. , M.A. dhe L.H. ekonomiste/PAI sëmundjeve të brendshme.

Procesverbal mbi të dhënat e kontrollit të pranimit (nëntor 2022) ku në pikën 4 është cituar në mënyrë eksplicite se “Komisioni i ngritur me urdhrin Nr. 229, datë 21.06.2022, kreu kontrollin e sasisë, funksionit instalimin dhe vënien në punë të pajisjeve mjekësore, nga ku rezultoi që të ketë përputhje të plotë me kontratën e furnizimit loti 10 me Nr. 64/124 prot., datë 26.07.2022 dhe faturave Nr. 1202/2022 datë 22.11.2022 dhe Nr. 1219/2022 datë 25.11.2022 bashkëlidhur këtij procesverbal” .

Faturë elektronike Nr. 1202/2022 datë 22.11.2022 për vlerën 17,016,000 lekë, fletë hyrje Nr. 152, datë 22.11.2022.

Faturë elektronike Nr. 1219/2022 datë 25.11.2022 për vlerën 6,048,000 lekë, fletë hyrje Nr. 155, datë 25.11.2022.

Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 6300/2 prot, datë 23.09.2022, me subjekt që ka vendosur pajisjen në treg “B.A.” sh.p.k për pajisjen Motor ICDU Bed: T8050, T8030; Crank Manual Patient Bed: T 1130; Basic Emergency Stretcher: T-Express Basic; Foldable Examination Table: TH6011, me prodhues SFA Titanyum Medikal , Turqi me numër 12829.

Në kontratën e furnizimit Nr. 64/124 prot., datë 26.07.2022, nuk është përcaktuar se pajisjet/shtretërit do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së pajisjeve dhe test raport fabrike (raportet e testeve) në zbatim të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.

¹³ *Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit”, i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.*

Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: “Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampionët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur” .

2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqëruar të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.*

Veprim që ngarkon me përgjegjësi A.F. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike për periudhën 01.04.20221- 09.02.2022.

Në kontratën e lidhur si më sipër nuk është raportuar në APP për çdo fazë të realizimit të kontratës në kundërshtim me:

VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës”, pika 5 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Autoriteti/enti kontraktor duhet raportojë në APP për çdo fazë: për modifikimin/modifikimet e çdo kontrate, ndërprerjen, përfundimin (me sukses apo penaltet) apo shpalljen e pavlefshme të saj, duke pasqyruar në formularin përkatës, arsyet, rrethanat dhe argumentimin përkatës, mbi bazën e dispozitave ligjore që është bërë modifikimi, ndërprerja, përfundimi, apo shpallja e pavlefshme e kontratës”.*

Pika 6, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“.....Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i kontratës, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin”.*

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Neni 125 “Detyrimet e autoritetit kontraktor ndaj Agjencisë së Prokurimit Publik”, pika 3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Në përfundim të zbatimit të një kontrate, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrim të dërgojë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik formularin e raportimit për zbatimin e kontratës, jo më vonë se 30 ditë nga data e përfundimit të kontratës”.*

Veprim që ngarkon me përgjegjësi A.F. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike për periudhën 01.04.20221- 09.02.2022 dhe B.L. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike për periudhën 13.09.20221- 31.12.2022.

Pajisjet/shtretërit janë të pa shoqëruara me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test raportin e fabrikës), veprim në kundërshtim me Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqëruar të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.*

Koment i grupit të auditimit:

Mos shoqërimi me raportet e testeve (test raportin e fabrikës) për pajisjet /shtretërve, dokument i rëndësishëm për të bërë verifikimi dokumentar të specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës (raportet e testeve), që të konfirmohet që pajisjet /shtretërit janë të njëjtë me ata të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën shoqëria “B.A.” Shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

Grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e shtretërve.

Nga verifikimi fizik i kryer në Spitalin A2 (Urgjencës), më datë 27 dhe 28.03.2023 në prani të E.N. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore

dhe E.K. me detyrë Specialist/ Inxhinier Biomedikal i Sektorit të Inxhinierisë Klinike, u konstatua se 130 shtretër pacienti me kontroll manual për vlerën 10,400,000 pa tvsh, 12,480,000 lekë me TVSH, nuk janë të rinj, por të përdorur. Nga grupi i auditimit është realizuar gjurma e auditimit, e cila do të jetë pjesë e dosjes së auditimit.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre, nuk kanë maksimalizuar plotësisht eficientën dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, veprim në kundërshtim me:

Kontratën me Nr. 64/124 prot., datë 26.07.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë “B.A.” shpk në vlerën 23,064,000 lekë me tvsh, neni 5.1.

- Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 122 “Rregullat që zbatohen për kontratën”, pika 1. Kushtet e kontratës të lidhur sipas këtij ligji nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur kontraktori, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

- Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi civil” nenet 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur “... Mos përbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblimin e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguar”.

-Deklaratën datë 18.10.2021 mbi përbushjen e Specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik “B.A.” shpk.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19.

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 2 është shprehur në mënyrë eksplicite se neni 2.

-Ligjin Nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” pika 5.

Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2, 8 dhe 52.

Vlera 12,480,000 lekë përbën dëm ekonomik për QSUNT dhe Buxhetin e Shteti dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria “B.A.” shpk.

5. Procedura e prokurimit me objekt “Furnizim vendosje të aparaturave mjekësore për spitalin e ri “kabineti i endoskopisë”, viti 2022.

Furnizim vendosje të aparaturave mjekësore për Spitalin e RI “Kabineti i Endoskopisë”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 1387 prot, datë 13.05.2022	3. Njësia e prokurimit Urdhër Nr. 1387/28 prot., datë 18.10.2022 -A.S.; mjeke. -E.K.; Përgjës sekt IT dhe ing. Klinike -M.B.; juriste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 179, datë 13.05.2022, ndryshuar me Nr. 294 prot., datë 05.08.2022 -B.Q.; mjeke -G.S.; përgj.sekt.IT -B.L.; jurist
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur , marrëveshje kuadër”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 18,882,000lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 14,320,000 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 4,456,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 05.07.2021	9. Burimi Financimit Fond nga Të ardhurat e shoqërisë	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 2 OE b) S’kualifikuar - OE, c) Kualifikuar 2 OE
11. Ankimime-	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik

		-
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 1387/28 prot., datë 18.10.2022,	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 17,184,000 lekë	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Hartimi i kërkesave për kualifikim

Në pikën I. kriteret e veçanta të kualifikimit, 2.1.c “Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale”, është përcaktuar c) Operatori ekonomik ofertues në rastet kur nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë auto deklaratë që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi është konform standarteve të cilësisë ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose EN ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose SSH EN ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetë deklaratimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Ky kriter nuk është plotësisht në përpjesëtim dhe në përputhje me kontratën, pasi nuk ka përcaktuar detyrimisht paraqitjen e certifikatave EN ISO 13485:2016 dhe SSH EN ISO 13485:2016 të lëshuar nga një organ certifikues mjekësor, për projektim, prodhim dhe shpërndarje të pajisjeve mjekësore, por e lë në vlerësim të operatorëve ekonomik.

Në kërkesat për kualifikim nuk janë kërkuar edhe: EN ISO 14971:2019 “Menaxhimi i rrezikut për pajisjet mjekësore”, MEDDEV 2.7/1 Rev 4 “Vlerësimi Klinik”, EN ISO 1041:2008 +A1:2013 “Informacion i dhënë nga prodhuesi për pajisjet mjekësore”, ISO 10993-1:2009 “Vlerësimi biologjik i pajisjeve mjekësore që ka të bëjë me vlerësimin dhe kontrollin brenda një procesi të menaxhimit të rrezikut, ISO 10993-5:2009 “Vlerësimi biologjik i pajisjeve mjekësore që ka të bëjë me kontrollin për citoksicitetin in vitro, ISO 10993-10:2010 “Vlerësimi biologjik i pajisjeve mjekësore që ka të bëjë me kontrollin për acarim dhe sensitivitetin e lëkurës, BS EN ISO 62366-1:2015 “Zbatimi i inxhinierisë në pajisjet mjekësore”.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 36 dhe 77, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndryshuar, neni 40, çka ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit e përbërë nga A.S., B.Th. dhe D.V..

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi njësinë e prokurimit e përbërë nga A.S., B.Th. dhe D.V..

Zhvillimi i procedurës së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët ekonomik.

- “A.” me ofertë në vlerën 14,320,000 lekë.

- “M.” shpk me ofertë në vlerën 14,800,000 lekë.

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues operatori ekonomik “A.” shpk, me ofertë në vlerën 14,320,000 lekë.

Në 2.3.d “Kapaciteti teknik”, të kërkesave për kualifikim është përcaktuar Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për pajisjen objekt prokurimi bashke me aksesoret përkatës, në forme tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emërtimi i katalogut të pajisjes/produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet përkatëse për produktet.

Ky operator nuk provohet ta ketë përmbushur këtë kërkesë, pasi nuk ka paraqitur certifikatën e origjinës së pajisjes.

Në kërkesat për kualifikim të pikës 2.3.d (proces verbali i argumentimit të kërkesave për kualifikim) është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në këtë kontekst është kërkuar dhe oferta teknike, me ane të së cilës do të bëhet e mundur verifikimi më i sakte i artikujve të ofertuar, specifikimeve të tyre, origjina, konformiteti, etj., me dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga ofertuesi”. Pra KVO me dorëzimin e dokumentacionit shkresor duhet të kishte kërkuar përveç të tjerave dhe certifikatat e origjinës për të 19 pjesët e pajisjes, para se ta shpallte fitues.

Në pikën 2.3.dh “Kapaciteti teknik”, të kërkesave për kualifikim është përcaktuar Operatori ekonomik duhet të paraqesë një autodeklaratë, ku deklaron se pajisjet do të jenë të shoqëruara me manualët e përdorimit, manualin e vendosjes sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe manualët e servisit/shërbimit.

Ky operator nuk provohet ta ketë përmbushur këtë kërkesë, pasi edhe pse me deklaratën datës 15.07.2022 (deklaratë dokument tenderi), ka deklaruar se pajisjet do të jenë të shoqëruara me manual përdorimi, manualin e vendosjes sipas rekomandimit të prodhuesit dhe manualët e servisit/shërbimit, referuar procesverbalit të dorëzimit të dokumentacionit (procesverbal i pa datuar) i firmosur dhe vulosur nga shoqëria “A.” shpk dhe nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave B.Q., G.S. dhe B.L., këto manuale nuk janë dorëzuar. Për mos plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik “A.” shpk, nuk duhet të ishte kualifikuar por duhet të ishte skualifikuar.

Në pikën 2.3.i “Kapaciteti teknik”, të kërkesave për kualifikim është përcaktuar Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë paraprake, për garantimin e regjistrimit të pajisjes mjekësore të AKBPM-ja, pas shpalljes fitues, sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

Referuar dokumentacionit të paraqitur: Pajisjet të paraqitura në ofertën teknike, kanë ardhë në Republikën e Shqipërisë dhe regjistruar në QKBPM secila më vehte në data dhe vite të ndryshëm nga viti 2021-2022, me prodhues të ndryshëm dhe operator të ndryshëm, pra jo me një prodhues dhe jo nga një operator i vetëm.

Çka vërteton/provon se pajisja nuk ka ardhë e kompletuar nga një prodhues me vehte origjine, ose i procesuar ose mbledhur mjaftueshëm të komponentëve duke rezultuar në një pajisje, nga shoqëri e certifikuar/licensuar për këtë qëllim, por është asambluar në Shqipëri.

Operatori fitues shoqëria “A.” nuk e ka tagrin ligjor/teknik për ta kryer këtë asamblim, pasi Autorizimi për tregtim me shumicë të pajisjeve mjekësore Nr. 41/11 datë __/__/2022, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale përcakton “...të tregtojë me shumicë pajisje mjekësore, pasi plotëson kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për pajisjet mjekësore”.

Referuar pikës 13.6.4 të VKM Nr. 731, datë 2.9.2015 “Për Miratimin e Rregullit Teknik “Për Kërkesat Thelbësore, Vlerësimin e Konformitetit, Klasifikimin dhe Markimin CE të Pajisjeve Mjekësore”, kalibrimi i pajisjeve mjekësore është i detyrueshëm për të siguruar dhe vërtetuar se rezultatet të cilat vijnë nga këto pajisje janë të sakta dhe të sigurta.

Për këtë pajisje nuk është mbajtur raport instalimi, funksionimi dhe trajnimi i stafit mjekësor.

Në opinionin e grupit të auditimi, asamblimi i pajisjes Vidioendoskop, si dhe mos mbajtja e raportit të instalimit, funksionimit dhe trajnimit të stafit mjekësor jo vetëm është shpenzim i tepër, por është risk i lartë për kryerjen e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për jetën e pacientëve.

Në mënyrë të detajuar regjistrimi i pjesëve të kësaj pajisjeje:

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 2232/6 prot., datë 22.04.2021, për pajisjen Procesor:Ep-6000, klasa II A, regjistruar nga shoqëria "A." me Nr. regjistri 9267.

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 2378/2 prot., datë 21.04.2021, për pajisjen Vidio Endoscope; EC-760-V/L; EG-760R, klasa II A, regjistruar nga shoqëria "A." me Nr. regjistri 9254.

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 7851/2 prot., datë 17.11.2022, për pajisjen Vidio Endoscope; EG-760CT, klasa II A, regjistruar nga shoqëria "A." me Nr. regjistri 13076.

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 7738/2 prot., datë 17.11.2022, për pajisjen Vidio Endoscope; ED-580XT, klasa II A, regjistruar nga shoqëria "A." me Nr. regjistri 13064.

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 6261/2 prot., datë 21.09.2022, për pajisjen Electrosurgical unit;, klasa II b. Prodhuesi i pajisjes EMED sp.0.0, regjistruar nga shoqëria "A." me Nr. regjistri 12811.

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 2233/2 prot., datë 21.09.2021, për pajisjen Endoscope washer and Disinfektor Device; Detrowashunit; klasa I, regjistruar nga shoqëria "A." me Nr. regjistri 9269.

-Certifikata e garancisë të lëshuar nga shoqëria "A." për 36 muaj duke filluar nga data 30.09.2021, furnizimi është bërë në nëntor 2022.

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 4291//2 prot., datë 02.07.2021, për pajisjen LCD Color Display; FS-L2702D, prodhuesi Foreseeson Costum Displays USA, regjistruar nga shoqëria "A." me Nr. regjistri 9718.

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 4290//2 prot., datë 02.07.2021, për pajisjen IID Softo Station, prodhuesi SOFTOMED MEDIKAL SAN.TIC, Turqi, regjistruar nga shoqëria "A." me Nr. regjistri 9717.

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 3112//2 prot., datë 01.06.2021, për pajisjen Operating table/Surgery 8500, prodhuesi Dixik Vertrieb. Gjermani, regjistruar nga shoqëria "A." me Nr. regjistri 9530.

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 2232/7 prot, datë 22.04.2021, për pajisjen Digital Image transferim Archiving System; Endocam, prodhuesi Dixik Vertrieb. Gjermani, regjistruar nga shoqëria "A." me Nr. regjistri 9266.

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 6262/2 prot., datë 20.09.2022, për pajisjen Disposable Non-electric Biopsy Forceps, prodhuesi Jiangsu Vedkang Kine, regjistruar nga shoqëria "F." me Nr. regjistri 12800.

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 6263/2 prot., datë 20.09.2022, për pajisjen Injection Needles, prodhuesi Jiangsu Vedkang Kinë, regjistruar nga shoqëria "F." me Nr. regjistri 12801.

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 4287/2 prot., datë 02.07.2021, për pajisjen Aier leak Tester LT-7F; Cleaning Accessorries =EB7024 FW, regjistruar nga shoqëria "A." me Nr. regjistri 9716.

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 4282/2 prot., datë 02.07.2021, për pajisjen Endoscopic Bite Block Non Sterile: ED01, prodhuesi Technocast Otomotiv San ve Tic A.S, Turqi, regjistruar nga shoqëria "A." me Nr. regjistri 9719.

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 7367/2 prot., datë 11.05.2022, për pajisjen DETRO OPA -STR DIS 1005 . Prodhuesb , prodhuesi Detro Healthcere Kimya Sanai .Turqi.

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 6435/2 prot., datë 03.10.2022, për pajisjen DETROX-Detro Enzym: 1L,5L, prodhuesi Detro Turqi, regjistruar nga shoqëria “A.” me Nr. regjistri 12862.

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 6751/2 prot, datë 03.11.2022, për pajisjen Polypectomy snare, prodhuesi Medinova Endosys 6-12 G Indi, regjistruar nga shoqëria “A.” me Nr. regjistri 12924.

Nuk ka asnjë dokument si kontratë/faturë që shoqëria ‘F.’ i ka shitur/ose dhuruar shoqërisë “A.s” pajisjet e regjistruara me:

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 6262/2 prot., datë 20.09.2022, për pajisjen Disposable Non-electric Biopsy Forceps, prodhuesi Jiangsu Vedkangng Kine, regjistruar nga shoqëria “F.” me Nr. regjistri 12800.

-Certifikatë e regjistrimit lëshuar nga AKBPM Nr. 6263/2 prot., datë 20.09.2022, për pajisjen Injection Needles, prodhuesi Jiangsu Vedkangng Kinë, regjistruar nga shoqëria “F.” me Nr. regjistri 12801.

Pajisje të cilat janë asambluar tek pajisja e Videoendoskopit që shoqëria “A.” ja ka shitur QSUNT.

Në pikën I. kriteret e veçanta të kualifikimit, 2.1.c, Operatori ekonomik ofertues në rastet kur nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë auto deklaratë që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi është konform standarteve të cilësisë ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose EN ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose SSH EN ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ky operator nuk provohet ta ketë përmbushur këtë kërkesë, pasi nga Kompania RIG CERT, filiali Shqipëri është lëshuar për operatorin ekonomik “A.” shpk, ISO 9001:2015 me Nr. 1710AL714Q, datë lëshimi 19.05.2022 me afat përfundimi të certifikimit 18.07.2025. Nga verifikimi në dastabazën e Drejtorisë së Përgjithshme e Akreditimit, u konstatua se ky filial nuk është i akredituar nga DPK, veprim në kundërshtim me:

- Ligjin Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” , i ndryshuar, neni 3, pika 1, neni 5, pika 1/b, për pasojë Certifikata ISO 9001:2015 është dokument i pa besueshëm për tu marr në konsideratë për kualifikimin e operatorit ekonomik “A.”.

-Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 3330 prot., datë 20.03.2018 dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit Nr. 145 prot., datë 16.03.2018, pika 5, për pasojë është dokument i pabesueshëm për tu marre në konsideratë në vlerësimin e këtij operatori ekonomik.

Në pikën 2.3.a Kapaciteti teknik, të kërkesave për kualifikim është përcaktuar operatori ekonomik duhet të paraqesë “Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Ky operator nuk provohet ta ketë përmbushur këtë kërkesë, pasi: Operatori ekonomik ka paraqitur faturë tatimore shitje me Nr. 829, datë data 10.10, 2019 për vlerën 5,420,800 lekë, me blerës Banka O.A. Sha, me zëra (artikuj) që janë të pa dallueshëm si në sistemin SPE, por edhe në dokumentin fizik. Fatura është e pa firmosur nga shitësi dhe transportuesi (pra nuk është firmosur nga shitësi) në kundërshtim me Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij neni 123 pika 1.ç, për pasojë nuk është dokument i besueshëm. Lidhur më këtë fakt KVO nuk ka kërkuar sqarim nga operatori ekonomik “A.” në zbatim të nenit 82, pika të VKM 285. Për pos sa më sipër për pasojë nuk është dokument i besueshëm. Bankat nuk kanë lidhje me pajisjet mjekësore të endoskopisë.

Marrëveshja Kuadër është lidhur me Nr. 1387/15 prot., datë 12.09.2022, ndërmjet QSUNT sha të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “A.” shpk përfaqësuar nga administrator E.Xh. për vlerën 14,320,000 lekë me TVSh, me afat të zbatimit të kontratës afat 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Kontrata është lidhur me Nr. 1387/28 prot., datë 18.10.2022, ndërmjet QSUNT sha të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “A.” shpk përfaqësuar nga administrator E.Xh. për vlerën 17,184,000 lekë me TVSh, me afat të zbatimit të kontratës afat 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Plani i zbatimit të kontratës është bërë me Nr. 1387/28 prot., datë 18.10.2022 i firmosur ndërmjet QSUNT përfaqësuar nga Drejtori i përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “A.” shpk me administrator E.Xh. në të cilën citohet ndër të tjera: Burimi i financimit “Të ardhurat dytësore” me afat të zbatimit të kontratës afat 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Plani i zbatimit të kontratës është dërguar në APP me shkresën Nr. 1387/29 prot., datë 20.10.2022.

Shoqëria “F.” shpk, me autorizim datë 16 Qershor 2022 (autorizim i pa shfaqur në SPE, por i dorëzuar me dokumentacion shkresor) shprehet se shoqëria “F.” është distributor i autorizuar në Shqipëri i kompanive: Faned Zywiec sp, z0.0, Poloni, Emed SP.Z.O.O.SP.K Poloni, M/S Medinova Endosys, Indi dhe Jiangsu Vedkang Medical Science & Technology, Ltd, Kinë, e vërtetuar me autorizimet përkatëse dhe autorizon Shoqërinë “A.” të marr pjesë, të negocioj dhe në vazhdimësi të firmos kontratën me QSUT.

Referuar sa më sipër: Kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik “A.”, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” nenet 77, 87, 89, 90, 92 dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82. Në opinionin e grupit të auditimit duhet të ishte shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorin ekonomik “M.” shpk me ofertë në vlerën 14,800,000 lekë.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë B.Q., G.S. dhe B.L..

Zbatimi i kontratës

Me urdhrin Nr. 229, datë 21.06.2022, administruar me Nr. 64/95 prot., datë 21.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm A.F., është ngritur grupi i punës për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të pajisjeve mjekësore, i përbërë nga A.S., me profesion mjek, me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm, I.H. me profesion specialiste ing/klinike, E.B. specialiste ing. Klinike, A.D. mjek, D.Ç. mjek, E.T. administratore e PAI Polivalent, M.A. administratore e PAI sëmundje të brendshme.

Me urdhrin Nr. 489 datë 30.11.2022, administruar me Nr. 64/156 prot., datë 30.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm A.F., janë bërë ndryshime në urdhrin Nr. 229, datë 21.06.2022, duke

shtuar A.G. me detyrë specialist/sektori i inxhinierisë klinike, L.H. me detyrë ekonomist/PAI i sëmundjeve të brendshme.

Me urdhër shpenzimin Nr. 3510, datë 02.12.2022 për vlerën 17,184,000 lekë, nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare është likuiduar Shoqëria "A." Shpk. Ky shpenzim (likuidim) ka të bëjë me blerje pajisje mjekësore të endoskopisë. Dokumentet vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi, faturë elektronike Nr. 291/2022, date 23.11.2022 për vlerën 17,184,000 lekë, fletë hyrje Nr. 153, datë 23.11.2022.

Relacioni Nr. 1387/35 prot., datë 23.11.2022 i marrjes në dorëzim për 1 pajisje për vlerën 17,184,000 lekë i firmosur nga A.S., I.H., E.B., A.D., D.Ç., E.T., M.A..

Procesverbal mbi të dhënat e kontrollit të pranimit (nëntor 2022), ku në pikën 4 është cituar në mënyrë eksplicite se "Komisioni i ngritur me urdhrin Nr. 229, datë 21.06.2022, kreu kontrollin e sasisë, funksionit instalimin dhe vënien në punë të pajisjeve mjekësore, nga ku rezultoi që të ketë përputhje të plotë me kontratën së furnizimit loti 6 me Nr. 1387/22 prot., datë 27.09.2022 dhe faturës Nr. 855/2022 datë 11.08.2022 bashkëlidhur këtij procesverbal".

Certifikatat e regjistrimit lëshuar nga AKBPM të përmendura në zhvillimin e procedurës së prokurimit, si më lart.

Nuk ka raport instalimit/funksionimi të pajisjes dhe formular trajnimi të personelit mjekësor që do ta përdor pajisjen.

Në kontratën e furnizimit, për lotin 6, lidhur me Nr. 1387/28 prot., datë 18.10.2022, nuk është përcaktuar se pajisjet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së pajisjeve dhe test raport fabrike (raportet e testeve) në zbatim të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 "Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli", pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi "Kushtet e dorëzimit" të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqëruar të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat", që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor".

Veprim që ngarkon me përgjegjësi B.L.me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike.

Në kontratën e lidhur si më sipër nuk është raportuar në APP për çdo fazë të realizimit të kontratës në kundërshtim me:

VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 107 "Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës", pika 5 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "Autoriteti/enti kontraktor duhet raportojë në APP për çdo fazë: për modifikimin/modifikimet e çdo kontrate, ndërprerjen, përfundimin (me sukses apo penaltet) apo shpalljen e pavlefshme të saj, duke pasqyruar në formularin përkatës, arsyet, rrethanat dhe argumentimin përkatës, mbi bazën e dispozitave ligjore që është bërë modifikimi, ndërprerja, përfundimi, apo shpallja e pavlefshme e kontratës".

Pika 6, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se ".....Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i kontratës, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin".

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar; neni 125 "Detyrimet e autoritetit kontraktor ndaj Agjencisë së Prokurimit Publik", pika 3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "Në përfundim të zbatimit të një kontrate, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrim të dërgojë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik formularin e raportimit për zbatimin e kontratës, jo më vonë se 30 ditë nga data e përfundimit të kontratës".

Veprim që ngarkon me përgjegjësi B.L. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike.

Pajisjet janë të pa shoqëruara me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test raportin e fabrikës), veprim në kundërshtim me Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqëruar të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.*

Koment i grupit të auditimit:

Mos shoqërimi i pajisjeve me raportet e testeve (test raportin e fabrikës) për pajisjen Videoendoskop, dokument i rëndësishëm për të bërë verifikimi dokumentar të specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës (raportet e testeve), që të konfirmohet që kjo pajisje është e njëjtë me atë të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “A.” sh.p.k ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

Grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjes.

Vlera 17,184,000 lekë përbën dëm ekonomik për QSUNT dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria “A.” sh.p.k. Ndërsa dëmi shëndetësor ndaj pacientëve është i pallogaritshëm (pra shumë herë më i madh), pasi shërbimi ndaj pacientëve me këtë pajisje të asambeluar në Shqipëri nga persona të palicënsuar, të pa kalibruar, pa raport instalimi dhe funksionimi, pa raport trajnimi për personelin, pa manuale shërbimi dhe përdorimi, pa raportet e testeve (test raportin e fabrikës) është me risk të lart për shëndetin e pacientëve.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre, nuk kanë maksimalizuar plotësisht eficientësinë dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, ndërsa dëmi shëndetësor ndaj pacientëve është i pallogaritshëm pasi shëndeti dhe jeta e pacientëve/njeriut nuk ka çmim), dhe nuk ka pse të varet nga formalitetet burokratike të administratës.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, KREU II “Përgjegjësitë e shtetit dhe të shtetasve” Neni 4, pika 1 “Përgjegjësitë e shtetit”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Shteti ushtron veprimtarinë e tij lidhur me kujdesin shëndetësor në mbështetje të këtij ligji dhe zotohet për të rregulluar dhënien, mbikëqyrjen dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor”.*

-Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 4,6,7 dhe 8.

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 2 dhe 21.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2, neni 8 dhe neni 52.

Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19.

Nuk është raportuar në APP për çdo fazë të realizimit të kontratës në kundërshtim me:

VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës”, pika 5 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Autoriteti/enti kontraktor duhet raportojë në APP për çdo fazë: për modifikimin/modifikimet e çdo kontrate, ndërprerjen, përfundimin (me sukses apo penaltet) apo shpalljen e pavlefshme të saj, duke pasqyruar në formularin përkatës, arsyet, rrethanat dhe argumentimin përkatës, mbi*

bazën e dispozitave ligjore që është bërë modifikimi, ndërprerja, përfundimi, apo shpallja e pavlefshme e kontratës”.

Pika 6, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “...Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i kontratës, si dhe mund t’i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin”.

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Neni 125 “Detyrimet e autoritetit kontraktor ndaj Agjencisë së Prokurimit Publik”, pika 3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përfundim të zbatimit të një kontrate, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrim të dërgojë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik formularin e raportimit për zbatimin e kontratës, jo më vonë se 30 ditë nga data e përfundimit të kontratës”.

Veprim që ngarkon me përgjegjësi B.L.me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike.

6. Procedura e prokurimit me objekt, procedure e hapur e thjeshtuar me objekt “Furnizim vendosje kokë goditëse për pajisjen mjekësore ESWL, prodhuesi S.M./ekuivalent”, me REF - 42106-09-16-2022, viti 2022.

1. Urdhër Prokurimi Nr. 356 datë 15.09.2022	3. Hartuesit e dokumenteve të tenderit Urdhër Nr. 421/12 datë 15.09.2022 -M.B., sektori i prokurimeve specialiste/juriste -E.K.sektr.i IT dhe inxhinierisë klinike,Përgjegjës/Inxhinier -E.K. sektori i inxhinierisë klinike /Ekonomist	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 357 datë 15.09.2022 - B.Q.,Kryetare (ZV.Drejtor i përgjithshëm/. Sektorit të Kostove dhe Ekonomise -M.J.-Anëtar (Pergjegjese SML /Jurist -E.B.Anetar (specialiste sektr. Ing.Klinike /Fizikante
Titullari A.F.		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 2,869,500	6. Oferta fituese (pa tvsh) 2,869,500	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0
8. Data e hapjes së tenderit 30.09.2022	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër <u>1</u> OE b) S’kualifikuar ska OE, c) Kualifikuar <u>1</u> OE
11. Ankimime Pranë AK - nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës të Shërbimeve		
14. Lidhja e kontratës Nr.421/18, datë 31.10.2022 Amendim Nr. 1 i kontratës Nr. .421/24 date 11.11.2022 (ndryshim i afatit të kontratës) Amendim Nr. 1 i kontratës Nr. .421/24 date 11.11.2022 (ndryshim i afatit të kontratës)	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 3,443,400 lekë	16. Afati i kontratës në dite Deri me 15.11.2022 45 dite nga lidhja e kontratës Deri me 31.12.2022

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Me shkresën me Nr.421/12 prot., me datë 15.09.2022, Autoriteti kontraktor ka nxjerrë urdhrin e prokurimit për procedurën e prokurimit- Procedure e hapur e thjeshtuar “Furnizim vendosje kokë goditëse për pajisjen mjekësore E.S.W.L prodhuesi Storz Medical/ose ekuivalent” më fond limit 2,869,500 lekë pa TVSH dhe 3,443,400 lekë me TVSH.

Llogaritja e fondit limit është mundësuar nga komisioni i ngritur me urdhër brendshëm Nr. 299 prot., datë 10.08.2022, “për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike” në relacionin e paraqitur pranë drejtorisë me Nr.421/10 prot., datë 12.09.2022.

Përlllogaritja është bërë në bazë të një kontrate të më përparshme me Operatorin Ekonomik “M.” shpk kontrata Nr. 261/8 prot., më datë 16.03.2021 me objekt “F.V e kokës goditëse për pajisjen mjekësore E.S.W.L, prodhuesi S.M./ose ekuivalent”:

Në relacionin e hartuar për argumentimin e fondit limit dhe specifikimet teknike, grupi i punës argumenton se është kërkuar oferta nga operatore ekonomik të ndryshëm, por është arritur në konkluzionin që vlera e kontratës së më përparshme me të njëjtin OE ekonomik, jep një fond limit më të ulët.

Në llogaritjen e fondit limit, nuk është kërkuar nga spitale të tjera private ose shtetërore sa është çmim i këtyre mirëmbajtjeve, veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i llogaritjes së vlerës së fondit limit dhe specifikimeve teknike i ngritur me urdhër të brendshëm numër 299 datë 10.08.2022 i përbërë nga E.K., E.K., I.H..

Hartimi i kërkesave për kualifikim

Nga NJHDT në DST “Aftësitë teknike dhe profesionale” pika 2.1.1 është përcaktuar se,

Operatorët duhet të paraqesin: Autorizim nga prodhuesi/MAH/ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), për të garantuar mirëmbajtjen cilësore, të sigurte dhe pjesë origjinale të pajisjeve mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Autorizimi duhet të jete origjinal ose kopje e përkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshëm në momentin e hapjes se ofertave.

Argumentimi i kësaj kërkesë është në keq interpretim me:

-Nenet 3, dhe 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 93, VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet shprehimisht se

“Autoritetet kontraktore gjatë përcaktimit të kriterëve të veçanta duhet të shmangin çdo kërkesë apo procedurë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomik, e cila përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”. Por në përcaktimin apo në vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoritetit kontraktor brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë që përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe (ii) jodiskriminues, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Gjatë përshkrimit të objektit të prokurimit publik, autoritetet kontraktore përdorin "Kritere të veçanta kualifikimi", në të cilat përfshihen specifikimet teknike, që zakonisht, kupton tërësinë e kërkesave teknike. Këto specifikime teknike përcaktojnë karakteristikat e kërkuara nga punët, mallrat ose shërbimet që plotësojnë përdorimin të cilin ato synojnë nga Autoriteti kontraktor. Kërkesat/specifikimet teknike shpesh përfshin nivelin e cilësisë, performancës, sigurisë apo përmasave, garantimin e cilësisë, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat e testimit si dhe të paketimit, markën dhe etiketimin etj.

Referuar sa mësipër, kërkesa specifike e kualifikimi (kushtet teknike), në pikën 2.3.c “Aftësitë teknike dhe profesionale” është përcaktuar se, operatorët duhet të paraqesin: Autorizim nga prodhuesi/MAH/ ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin). Kjo kërkesë për kualifikim është kriter i kualifikimi favorizues. Më gjerësisht është përcaktuar në pikën 2.5.1.

Nga NJHDT në DST, pika 2.3.2 për kapacitetin teknik, Autoriteti kontraktor ka përcaktuar se:

“Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf 2 inxhinierë/specialistë në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore të cilët do të kryejnë shërbimin dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, çertifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës”. Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetë deklaratimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Nga NJHDT në DST, pika 2.3.4 për kapacitetin teknik, Autoriteti kontraktor ka përcaktuar se :

“Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf një inxhinier të çertifikuar për pajisje mjekësore. Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST”.

Në procesverbalin për hartimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit njësisia e prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e këtyre kriterëve, kjo në kundërshtim me Ligjin 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 78, dhe në kundërshtim me rekomandimin e APP-se me Nr. 1797/1 prot., datë 10.03.2022, ku shprehet se:

“Gjatë asistimit të vazhdueshëm të procedurave të prokurimit, APP ka konstatuar se Autoritetet/entet kontraktore në procesverbalin e hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, cilësojnë vetëm referimin ligjor të kriterëve të përcaktuara, duke cituar në procesverbal vetëm nenin përkatës të LPP, duke mos dhënë argumentimin teknik konkret të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në raport me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Sjellim në vëmendje të autoriteteve/enteteve kontraktore që, bazuar në pikën 2, të nenit 78, të RRPP: "Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si me sipër bëhet nga njësisia e prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit".

Për sa më sipër, për shembull në lidhje me kërkesat për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë edhe nga ana teknike çdo kriter të përcaktuar. Në rastin e kriterit të fuqisë punëtore të nevojshme për zbatimin e kontratës, autoritetet/entet kontraktore duhet të hartojnë analiza teknike, ku të parashikohet fuqia punëtore dhe mjetet/makineritë që nevojiten për secilin zë punimesh, sipas afateve të parashikuara në grafikun e punimeve dhe, mbi bazën e analizave përkatëse të përcaktohet numri minimal punonjësve të domosdoshëm, për realizimin e punimeve, objekt kontrate".

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit të përberë nga M.B., E.K. dhe E.K..

Me datë 01.03.2022 Autoriteti kontraktor, ka nënshkruar kontratën me afat 180 ditë për mirëmbajtjen full risk, me objekt: "Lot 15 Mirëmbajtje e pajisjeve Lithotripter prodhuesi S.M./ose ekuivalent", me OE "M. shpk" me vlerë 3,074,122 lekë me TVSh .

Me datën 22.08.2022 është mbajtur procesverbali i konstatimit ndërmjet punonjësve të inxhinierisë klinike të QSUNT dhe operatorit ekonomik "M." shpk, (që është operatori që kryen mirëmbajtjen e pajisjes së sipërcituar sipas kontratës 581/28 datë 01.03.2022), si me poshtë vijon:

"Përshkrimi i konstatimit; Shërbimi konstatoi që pajisja sinjalizon që numri i goditjeve të kokës goditëse është drejt përfundimit; Konstatimi u krye me pas nga inxhinieret e kompanisë M. dhe Njësia inxhinierike Klinike; Nevojitet ndërrimi i kokës goditëse; Pajisja është në gjendje të plotë pune aktualisht".

Ndërkohe nga Shefi i Shërbimit të Urologjisë, është paraqitur kërkesa për marrje masash për zëvendësimin e pjesës kokë goditëse që më datë 22.07.2022.

Si rrjedhojë e detyrimeve kontraktuale të kontratës me Nr. 581/28 prot. date 01.03.2022 operatori ekonomik i kontraktuar për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes në zbatim të termave të referencës së kontratës së sipërcituar, duhet të bënte zëvendësimin e pjesëve të pajisjes Lithotripter të prodhuesit S.M./ose ekuivalent.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit kërkesë me propozim me objekt "F. V kokë goditëse për pajisjen mjekësore ESWL, prodhuesi S.M./ekuivalent", me REF -42106-09-16-2022, viti 2022, kontraktuar dhe likuiduar për vlerën 3,443,400 lekë shkaktonte mbivendosje, (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e mirëmbajtjes në vlerën 3,074,122 lekë me TVSH, e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik "M." shpk dhe Autoritetit Kontraktor QSUNT me numër prot., 581/28 date 01.03.2022, ku specifikohet në termat e referencës se: *"Operatori ekonomik fitues do të kryej mirëmbajtje full risk, mirëmbajtja parandaluese/preventive e pajisjeve mjekësore, mirëmbajtja korrigjuese e pajisjeve mjekësore, furnizimi me pjesë këmbimi dhe aksesore, inspektimi i sigurisë së pajisjeve mjekësore".*

Për veprimin e mësipërm, është shkelur koncepti i "Bëgatimit pa shkak", i ardhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të personave të përfshirë në këtë proces me përfitues padrejtësisht shoqëria "M." Sh.p.k në vlerën 3,074,122 lekë. Referuar Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 655 "Bëgatimit pa shkak", ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: "Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm

të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të begatimit”.

Vlera 3,443,400 lekë përbën dëm ekonomik për QSUNT dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet, nga shoqëria “M.” Shpk.

b. Në të gjitha kontratat e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore, pjesët e zëvendësuara të raportuara në procesverbalet e mirëmbajtjes, nuk i janë lënë Autoritetit Kontraktor.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre, nuk kanë maksimalizuar plotësisht efikasitetin dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, veprim në kundërshtim me:

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 19, pika 23/f, g.

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 2 dhe 21.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2, neni 8 dhe neni 52.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19.

7. Procedura e prokurimit me objekt “Kërkesë me propozim me objekt “F. V koke goditëse për pajisjen mjekësore ESWL, prodhuesi S.M./ekuivalent”, me REF -84075-01-14-2021, viti 2021”.

Me pasojë: Dublimi shërbimit të mirëmbajtjes me pajisje mjekësore të zëvendësuara me procedurë tjetër dhe me fond të shpenzuar tjetër.

1. Urdhër Prokurimi Nr. 261 prot datë 13.01.2021	3. Hartuesit e dokumenteve të tenderit Urdhër Nr. 261 datë 13.01.2021 -B.M., me detyrë Drejtor i It dhe inxhinierisë klinike /Inxhinierë -L.V., me detyrë specialiste në sektorin e kostove /ekonomiste -M.M., specialist sekt. Prokurimeve/Jurist	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 261/1 datë 13.01.2021 - E.S., Kryetare (Pergj. Sektorit të Kostove dhe Ekonomisë -K.L.-Anëtar (specialist sekt.Marrëdhënieve ligjore /jurist -A.K.specialist sekt.Ing.Klinike /Inxhinier
5. Fondi Limit (pa tvsh) 5,739,000	6. Oferta fituese (pa tvsh) 5,730,000	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 9000
8. Data e hapjes së tenderit 15.02.2021	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 1 OE b) S’kualifikuar ska OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime Pranë AK - ka Formulari i ankesës me Nr. 360 date 20.01.2021	12. Përgjigje Ankesës nga AK - ka Kthim përgjigje me shkresën numër 360/4 date 22.01.2021	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës të Shërbimeve		
14. Lidhja e kontratës Nr.261/8, datë 16.03.2021 Amendim Nr. 1 i kontratës Nr. 261/9 date 23.03.2021 (ndryshim i vlerës kontratës)	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 6,886,800 lekë Vlera e kontratës (me tvsh) 6,876,000 lekë	16. Afati i kontratës në dite Deri me 31.12.2021

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Me shkresën me Nr.261 prot., me datë 13.01.2021 Autoriteti kontraktor ka nxjerr urdhrin e prokurimit për procedurën e prokurimit- Kërkese për propozim me objekt “Furnizim vendosje koke goditëse për pajisjen mjekësore E.S.W.L prodhuesi S.M./ose ekuivalent” me fond limit 5,739,000 lekë pa TVSH dhe 6,886,800 lekë me TVSH.

Llogaritja e fondit limit është mundësuar nga komisioni i ngritur me urdhër Nr. 439 prot., datë 07.12.2020, “për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknikë” në relacionin e paraqitur pranë drejtorisë me Nr.3354/7 prot., datë 15.12.2020.

Përlllogaritja e fondit limit është hartuar me çmim reference, çmimin e kontratës së mëparshme, kontrata Nr. 85/21 prot me datë 07.03.2019 me objekt “Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore në QSUT për vitin 2019” e ndare në lote:

Lot 65 F.V e kokës goditëse të lithotripterit Moduli SLX-F2/ose ekuivalent me numër inventari 19241, me çmim/njësi 2,869,500 lekë pa tvsh me vlere totale 5,739,000 lekë pa tvsh.

Në relacionin e hartuar për argumentimin e fondit limit dhe specifikimet teknike grupi i punës argumenton se ka dërguar ftesë për ofertë disa operatoreve ekonomike por ka marre përgjigje për ofertë ekonomike vetëm nga OE M. ShPK. Vlëra e paraqitur në ofertën ekonomike nga OE “M.” shpk është 5,800,000 lekë pa TVSh dhe 6,960,000 lekë me TVSh.

Në llogaritjen e fondit limit, nuk është kërkuar nga spitale të tjera private ose shtetërore sa është çmim i këtyre mirëmbajtjeve, veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i llogaritjes së vlerës së fondit limit dhe specifikimeve teknike i ngritur me urdhër të brendshëm numër 439/1 date 11.12.2020 i përbërë nga B.M., E.B., E.J..

Hartimi i kërkesave për kualifikim

Nga NJHDT në DST “Aftësitë teknike dhe profesionale”, pika 2.3/c është përcaktuar se, operatorët duhet të paraqesin: Autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), për të garantuar mirëmbajtjen cilësore, të sigurt dhe pjesë origjinale të pajisjeve mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Autorizimi duhet të jetë origjinal ose kopje e përkthyer dhe noterizuar si

dhe i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave.). Kjo kërkesë për kualifikim është “Super/specifikim”. Më gjerësisht është përcaktuar në pikën 2.5.1.

Nga NJHDT në DST , Pika 2.3.gj) për kapacitetin teknik ,është përcaktuar se “Operatori ekonomik fitues duhet të paraqesin Certifikatën ISO 9001:2015 mbi Sistemet e menaxhimit të cilësisë ose SSH EN ISO 13485:2016 mbi Sistemet e menaxhimit të cilësisë për pajisjet mjekësore, të prodhuesit/distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi, në përputhje me objektin e prokurimit ,lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizma ndërkombëtare akreditues .Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit .

Përsa i përket kësaj kërkesë Agjencia e Prokurimit Publik është shprehur në mënyrë eksplicite në Rekomandimin me Nr. .8197 të datës 03.02.2018.

Autoritetet Kontraktore në dokumentet e tenderit për mallra apo edhe në rastin e punëve publike, kërkojnë që operatorët ekonomike të paraqesin përveç autorizimit të prodhuesit, katalogjeve, skedave teknike apo raporteve të testimit, edhe certifikata të ndryshme ISO që prodhuesi (i cili nuk ka lidhje me procesin) duhet të disponojë, veçanërisht certifikatë të menaxhimit të cilësisë së prodhuesit të mallit .

Në nenin 30 të VKM-se Nr. 914,datë 29.12.2014 parashikohet se: AK për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt i prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”.

Operatorët ekonomike ofertues në një procedurë, në varësi të objektit të prokurimit ,mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit, dhe e sigurojnë mallin/shërbimin nga këta të fundit, apo distributoret e autorizuar prej tyre. Në këtë rast kërkesa për paraqitjen e certifikatës ISO të prodhuesit rezulton ti adresohet palëve të treta (prodhuesit/distributorit), të cilat nuk janë konkurrent/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit të përbër nga B.M., L.V. dhe M.M..

Procedura e prokurimit kërkesë me propozim me objekt “F. v koke goditëse për pajisjen mjekësore ESËL, prodhuesi S.M./ekuivalent”, me REF -84075-01-14-2021, viti 2021, kontraktuar dhe likuiduar për vlerën 6,886,800 lekë.

Ndërkohë që Autoriteti kontraktor ka në fuqi edhe një kontratë të tipit “Full risk” me numër 173/36 prot., datë 04.02.2021 me operatorin ekonomik “M.” shpk me objekt "Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore në QSUT për vitin 2021" .

Loti 16: Mirëmbajtje e pajisjeve Lithotripter prodhuesi S.M./ose ekuivalent me vlere 5,636,219.18 lekë me TVSH.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit kërkesë me propozim me objekt “F. v kokë goditëse për pajisjen mjekësore ESËL, prodhuesi S.M./ekuivalent”, me REF -84075-01-14-2021, viti 2021, kontraktuar dhe likuiduar për vlerën 6,886,800 lekë shkakton mbivendosje, (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e mirëmbajtjes në vlerën 5,636,219.18 lekë me TVSH, e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik “M.” shpk dhe Autoritetit Kontraktor QSUNT me numër prot., 173/36 datë 04.02.2021, ku specifikohet në termat e referencës se: “*Operatori ekonomik fitues do të kryej mirëmbajtje full risk, mirëmbajtja parandaluese/preventive e pajisjeve mjekësore, mirëmbajtja korrigjuese e pajisjeve mjekësore, furnizimi me pjesë këmbimi dhe aksesore, inspektimi i sigurisë së pajisjeve mjekësore*”.

Për veprimin e mësipërm, është shkelur koncepti i “Bëgatimit pa shkak”, i ardhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të personave të përfshirë në këtë proces me përfitues padrejtësisht shoqëria “M.” sh.p.k në vlerën 6,886,800 lekë referuar Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi

Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 655 “Bëgatimit pa shkak”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të bëgatimit”.

Vlera 6,886,800 lekë përbën dëm ekonomik për QSUNT dhe Buxhetin e Shteti dhe duhet të dëmshpërblehet shoqëria “M.” Sh.p.k.

b. Në të gjitha kontratat e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore, pjesët e zëvendësuar të raportuara në procesverbalet e mirëmbajtjes, nuk i janë lënë Autoritetit Kontraktor.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre, nuk kanë maksimalizuar plotësisht efijencën dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, veprim në kundërshtim me:

- Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 19, pika 23/f, g.

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 2 dhe neni 21.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 , neni 8 dhe neni 52.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19.

8. Procedura e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje full-risk e pajisjeve mjekësore, për nevojat e QSUNT për 24 muaj” 62 lote, marrëveshje kuadër me fond limit 312,443,222 lekë, viti 2022.

Procedura e prokurimit me objekt Mirëmbajtje Full-Risk e pajisjeve mjekësore, për nevojat e QSUNT për 24 muaj” 62 lote, marrëveshje kuadër.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 264/56 prot, datë 10.08.2022	3. Hartimi i dokumenteve të tenderit Urdhër Nr. 264/56 prot, datë 10.08.2022 - B.Q.; mjeke. -B.M.; Drejt.Drej. IT dhe Ing. Klinike. -E.Sh., specialist sekt Drej. IT dhe Ing. Klinike -E.J., spec. Shef,sekt/planifikimi financiar. -B.L., specialist/jurist/sekt.juridik.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 264/57 prot, datë 10.08.2022 -E.K.; Pergj.sekt.ing.Klinuike dhe IT -M.B.; Juriste; Spec. prokurimeve -E.U.; ekonomiste,pergj.sekt.finances
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur , marrëveshje kuadër”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 312,443,222 lekë Fondi limit për lotët e realizuara 195,591,960 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 195,591,960 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 29.09.2022	9. Burimi Financimit Fond nga Të ardhurat	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 2__OE b) S’kualifikuar __-__OE, c) Kualifikuar __1__OE
11. Ankimime-	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik -
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës, loti 53 Nr. 264/86prot., datë 21.11.2022	15. Vlera e kontratës (me tvsh), 44,139,888 lekë Të 62 lotet 234,710,350	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Me vendim anulimi Nr. 264/2, datë 17.01.2022 Titullari i Autoritetit Kontraktor ka vendosur anulimit të procedurës së prokurimit marrëveshje kuadër me fond limit 645,887,199 lekë pa

TVSH me referencë REF-97398-06-04-2021 me objekt “Menaxhim dhe mirëmbajtje e aparaturave mjekësore në QSU “Nene Tereza” me afat 4 vjet (48 muaj), marrëveshje kuadër me një operator ekonomik.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 63/1, datë 29.04.2022 administruar nga QSUNT me 264/16 prot., datë 29.04.2022, është ngritur grupi i punës (komisioni) për riargumentimin e specifikimeve teknike/termat e referencës, zërave, periudhën e mbulimit dhe përlllogaritjen e fondit limit për sigurimin e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore të klasifikuara të vogla dhe të mesme, i përbërë nga B.Q., kryetare, me detyrë Zv/Drejtoresë të Përgjithshme, B.M., anëtare me detyrë drejtoresë të Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike, E.Sh., anëtare, me detyrë specialiste të IT dhe Inxhinierisë Klinike, E.J. anëtare, me detyrë përgjegjëse të sektorit/Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit Financiar, D.V., anëtar, përgjegjës sektori/Drejtoria Juridike.

Me shkresën Nr. 264/46 prot., datë 14.06.2022 grupi i punës i ka kërkuar Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike, listën përfundimtare të pajisjeve mjekësore, pjesë e marrëveshjes kuadër, termat e referencës dhe specifikimet teknike, kontrata e ngjashme të 3 viteve të fundit, për pajisjet e reja ditën e fundit të përfundimit të garancisë/ose ditën që parashikohet të hyjnë në shërbimin e mirëmbajtjes.

Me shkresën Nr. 264/48 prot., datë 20.06.2022, Drejtoria e IT dhe Inxhinierisë Klinike i kthen përgjigje grupit të punës për sa kërkuar, duke cilësuar “.....Drejtoria e IT dhe Inxhinierisë Klinike e pa të rëndësishme të përfshijë dhe të mos përjashtojë nga kjo listë aparatet e sallave të kirurgjisë, reminacionit, pajisjet diagnostikuese, të Imazherisë, pajisjet e frymarrjes, pajisjet ekzaminuese dhe kuruese të kardiologjisë duke përfshirë dhe pajisjet mjekësore të covid dhe post covid, të cilat garantojnë një cilësi të lartë shërbimi dhe jetike për pacientët”.

Autoriteti kontraktor, para shpalljes së kësaj procedure duhet të kishte hartuar planin e mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore për çdo vit, plan i miratuar nga komisioni mjekësor, si klasifikimin pajisjeve mjekësore në të vogla dhe të mesme. Por nevoja për mirëmbajtje të pajisjeve mjekësore është marr nga çdo PAI sipas shërbimeve përkatëse.

Referuar Statutit të miratuar në zbatim të Urdhrit të Përbashkët Nr. 709, datë 10.10.2018, i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e Statutit të QSU "Nënë Tereza". Në këtë statut KREU III, pika “ORGANIZIMI”, pika 8 “ Organet Drejtuese”, 18/1 “Komisioni Mjekësor i QSU "NENE TEREZA", është shprehur në mënyrë eksplicite se “Komisioni Mjekësor është organ këshillimi teknik i Drejtorisë së Përgjithshme dhe përbëhet nga drejtorët e spitaleve, që funksionojnë brenda autoritetit spitalor të qarkut dhe shefat e shërbimeve ose përfaqësues të zgjedhur nga vet shërbimet e këtyre spitaleve, Pika 18.3, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Komisioni Mjekësor përbëhet nga 26 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Bordi, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme, sipas formulës: Drejtoria i propozon Bordit kandidaturat për anëtarë të Komisionit Mjekësor të QSUNT "Nënë Tereza"-se, me një listë jo më të vogël se dyfishi i numrit të vendeve që duhet të plotësohen, në të cilën kandidatët shefa shërbimesh nuk mund të jenë me shumë se 50 për qind.

Pika 18.4, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Komisioni Mjekësor konsulton lidhur me aspektet mjekësore të punës, me përshkrimin e detyrave sipas funksioneve, dhe organizimin e shërbimeve mjekësore”.

Kjo për faktin se numri i pajisjeve për nevoja mirëmbajtje është shumë i madh dhe nuk mbulohen nga fondet e QSUNT-se.

Procedura e prokurimit me objekt mirëmbajtje full-risk e pajisjeve mjekësore, për nevojat e QSUNT për 24 muaj” 62 lote, marrëveshje kuadër me fond limit 312,443,222 lekë. Procedura e prokurimit e hapur mbi kufirin e lart monetar me mjete elektronike, është ndarë në lote sipas

prodhuesve të pajisjeve mjekësore dhe operatorët fitues, janë ata që kanë autorizim nga prodhuesi për blerje/shërbim mirëmbajtje pajisje mjekësore.

Autoriteti kontraktor me këtë procedurë prokurimi ka kryer një formalitet burokratik dhe jo procedurë të mirëfilltë prokurimi, duke mos maksimizuar efikasitetin dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, në kundërshtim me legjislacionin në Republikën e Shqipërisë për këtë qëllim, por edhe kundërshtim me parimet për rritjen e integritetit në prokurimin publik të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), parime që kanë efekt të drejtpërdrejtë në konkurrencë, në çmimin e paguar nga administrata publike për blerjen e një malli, shërbimi apo kryerjen e një pune, të cilat nga ana tjetër kanë efekt të drejtpërdrejtë në shpenzimet e shtetit, pra në burimet e taksapaguesve.

Autorizimi i Prodhuesit nuk është gjë tjetër veçse diskriminim de facto kundrejt shoqërive që, për shkak të fuqisë së tyre më të vogël në treg, nuk kanë lidhje direkt me prodhuesit dhe nuk janë distributorë ekskluzivë, por i përftojnë produktet/shërbimet nëpërmjet distributoreve të tjerë ekskluzivë të prodhuesit dhe ofrojnë çmime më konkurruese për të njëjtin mal/shërbim, cilësia e të cilit mund të provohet shumë lehtë. Kurse nga ana tjetër, shoqëritë që kanë në dispozicion autorizimin e prodhuesit, kanë krijuar një oligopol të rrezikshëm dhe nuk shqetësohen të ofrojnë çmime konkurruese por abuzojnë me këtë fakt në dëm të fondeve publike dhe konsumatorëve.

Autorizimi nga prodhuesi, si kriter kualifikues, nuk mund të jete i vetmi mjet që të mundësojë garantimin e origjinalitetit e mallit/shërbimit. Ky kriter për kualifikim ka bërë që Autoriteti kontraktor të duket sikur e ka parazgjedhur paraprakisht kandidatin fitues, çka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë dhe nuk është në qasje të plotë dhe me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës së Drejtësisë.

Përlllogaritja e vlerës së kontratës është në vlerën 312,443,222 lekë, duke e ndarë në 62 lote, referuar kontratave më të afërt në kohë për çdo pajisje.

Përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera/spitaleve privat, veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 76.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i llogaritjes së vlerës së fondit limit dhe specifikimeve teknike i përbërë nga B.Q., B.M., E.Sh., E.J., D.V., A.Q. anëtar, përfaqësues nga Qendra Teknike Bio-Mjekësore dhe B.P. përfaqësues nga Qendra Teknike-Biomjekësore.

Me Urdhër Prokurimi Nr. 264/56 prot., datë 10.08.2022, Drejtori i përgjithshëm ka urdhëruar të kryhet prokurimi me fond limit 312,443,222 lekë, procedurë e hapur mbi kufirin e lart monetar, marrëveshje kuadër me disa operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për hartimin e dokumenteve të tenderit grupi përbëhet nga: B.Q., B.M., E.Sh., E.J.dhe B.L..

Për argumentimin dhe miratimin e specifikimet teknike dhe kërkesave për kualifikim nga njësia e prokurimit/hartuesit e dokumenteve të prokurimit është mbajtur procesverbali i datës 29.06.2022.

Në specifikimet teknike nuk është përcaktuar:

Manuali i shërbimit, por vetëm rekomandimi i prodhuesit, Koha e llogaritur për përdorim, Shpeshtësia e kontroleve nga inxhinieri; Eksperienca teknike e dokumentuar; Nevojat klinike, Analiza e rrezikut; Çfarë lloj mirëmbajtjeje kërkohet nga inxhinieri klinik i QSUNT; Çfarë lloj mirëmbajtjeje dhe/ose pastrimi kërkohet nga ai që punon me të, mjeku; A ka pjesë këmbimi kritike që duhen zëvendësuar rregullisht, sipas manualit të shërbimit dhe rekomandimit të prodhuesit, përcaktimi konkret; A i disponon operatori/kontraktori pjesë këmbimi kritike që duhen zëvendësuar rregullisht, sipas manualit të shërbimit dhe rekomandimit të prodhuesit,

përcaktimi konkret; A kërkon pajisja kalibrim dhe nëse po si bëhet ai? Po kite kalibrimi nevojiten dhe a ka, sipas manualit të shërbimit dhe rekomandimit të prodhuesit, përcaktimi konkret. Për sa vite nga data e fundit e prodhimit të pajisjes është i garantuar furnizimi me pjesë këmbimi; A përfshin pajisja programe, dhe nëse po në çfarë gjuhe për përdoruesin, sipas manualit të shërbimit dhe rekomandimit të prodhuesit, përcaktimi konkret; Ofron Eprogrami gjetjen e defektit, sipas manualit të shërbimit dhe rekomandimit të prodhuesit, përcaktimi konkret; A ka shërbime mirëmbajtjeje apo funksione që kërkojnë fjalëkalime që nuk zotërohen, sipas manualit të shërbimit dhe rekomandimit të prodhuesit, përcaktimi konkret; A bëhen përditësime për pajisje që varen nga programet ? A janë ato falas, apo blihen; A përfshin manuali i shërbimit diagramat e qarqeve, afatet kohore të mirëmbajtjes parandaluese, arsyet e defektit/zgjidhjen, procedurat e riparimit, listën e pjesëve të këmbimit, veglat e veçanta; A është manuali i përdoruesit në shqip dhe i përshtatshëm për çdo përdorues; Pas shërbimit të mirëmbajtjes të pajisjet mjekësore etiketimi me kohën e mirëmbajtjes tjetër parandaluese; Vënia në dijeni e përdoruesit kur duhet kryer mirëmbajtja parandaluese si dhe mbi rezultatet e shërbimit të mirëmbajtjes.

Në dokumentet e tenderit dhe në QSUNT:

Nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM), i QSUNT, në letër ose në kompjuter historinë (kartelën) e plotë të pajisjes, ku të jete identifikuar:

Prodhuesi ose furnizuesi, numrin serial, data e blerjes, vlera (reale ose të vlerësuar), të dhënat e historisë së riparimeve dhe të mirëmbajtjes. Emri i personit që ka kryer riparimin, mirëmbajtjen. Emri i personit që ka raportuar një problem me pajisjen mjekësore. Përshkrimi i përgjithshëm i problemit ose i shërbimit të nevojitur. Pjesët e këmbimit të përdorura gjatë riparimit/mirëmbajtjes, por ka vetëm numrin e inventarit.

Komisioni i Vlerësimit Ofertave është ngritur Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 264/57 prot, datë 10.08.2022 dhe Nr. 264/61 prot, datë 03.11.2022.

Në pikën I. kriteret e veçanta të kualifikimit, 2.1.a Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë/Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme); Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Ky kriter nuk është plotësisht në përpjesëtim dhe në përputhje me kontratën, pasi nuk ka përcaktuar detyrimisht paraqitjen e certifikatave EN ISO 13485:2016 dhe SSH EN ISO 13485:2016 të lëshuar nga një organ certifikues mjekësor, Për projektim, prodhim dhe shpërndarje të pajisjeve mjekësore, por e lë në Ose/ose në vlerësim të operatorëve ekonomik.

Në kërkesat për kualifikim nuk janë kërkuar edhe: EN ISO 14971:2019 “Menaxhimi i rrezikut për pajisjet mjekësore”, MEDDEV 2.7/1 Rev 4 “Vlerësimi Klinik”, EN ISO 1041:2008 +A1:2013 “Informacion i dhënë nga prodhuesi për pajisjet mjekësore”, ISO 10993-1:2009 “Vlerësimi biologjik i pajisjeve mjekësore që ka të bëjë me vlerësimin dhe kontrollin brenda një procesi të menaxhimit të rrezikut, ISO 10993-5:2009 “Vlerësimi biologjik i pajisjeve mjekësore që ka të bëjë me kontrollin për citoksicitetin in vitro, ISO 10993-10:2010 “Vlerësimi biologjik i pajisjeve mjekësore që ka të bëjë me kontrollin për acarim dhe sensibilitetin e lëkurës, BS EN ISO 62366-1:2015 “Zbatimi i inxhinierisë në pajisjet mjekësore”.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 36 dhe 77, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”ndryshuar, neni 40, çka ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit e përbërë nga B.Q., B.M., E.Sh., E.J.dhe B.L..

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët ekonomik.

- “H. & L.” Shpk me ofertë në vlerën 36,783,240 lekë.

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues operatori ekonomik “H. & L.” Shpk, me ofertë në vlerën 36,783,240 lekë.

Oferta ekonomike e operatorit ekonomik “H. & L.” Shpk e datës 28.09.2022 mban shënimin: Pjesët e dëmtuara pas zëvendësimit me të reja do të merren nga “H. & L.” Shpk, shënim i cili është në kundërshtim me dokumentet e tenderit/Njoftimi i shkurtuar i kontratës, që nuk e parashikon këtë klauzol.

Referuar sa më sipër: Kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik “H. & L.” Shpk si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” nenet 77, 87, 89, 90, 92 dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO/ dhe në veçanti E.K. me detyrë Specialist/ Inxhinier Biomedikal i Sektorit të Inxhinierisë Klinike.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre, nuk kanë maksimalizuar plotësisht eficientë dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, veprim në kundërshtim me :

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” , neni 2 dhe neni 21.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, neni 2, 8, dhe 52.

9. Zbatimi i kontratës “Furnizim vendosje të aparaturave mjekësore për spitalin e ri të ndërtuar (A2), loti 8, 10 dhe 11, viti 2022.

Auditimi u krye me zgjedhje¹⁴

Me urdhrin Nr. 229 datë 21.06.2022, administruar me Nr. 64/95 prot., datë 21.06.2022 të Drejtorit të përgjithshëm A.F. është ngritur grupi i punës për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të pajisjeve mjekësore, i përbërë nga A.S., me profesion mjek, me detyrë zv/Drejtor i Përgjithshëm, I.H. me profesion specialiste ing/klinike, E.B. specialiste ing. Klinike, A.D. mjek, D.Ç. mjek, E.T. administratore e PAI Polivalent, M.A. administratore e PAI sëmundje të brendshme.

Me urdhrin Nr. 489, datë 30.11.2022, administruar me Nr. 64/156 prot., datë 30.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm A.F., janë bërë ndryshime në urdhrin Nr. 229, datë 21.06.2022, duke shtuar A.G. me detyrë specialist/sektori i inxhinierisë klinike, L.H. me detyrë ekonomist/PAI i sëmundjeve të brendshme.

Me urdhër shpenzimin Nr. 3219, datë 03.11.2022 për vlerën 9,336,000 lekë, është likuiduar shoqëria “B.A.” shpk. Ky shpenzim (likuidim) ka të bëjë me blerje pajisje mjekësore. Dokumentet vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi, faturë elektronike Nr. 855/2022, date 11.08.2022 për vlerën 9,336,000 lekë, fletë hyrje Nr. 99, datë 12.08.2022. Relacioni Nr. 64/149

¹⁴ *Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit”, i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.*

Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: “Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampionët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur” .

prot., datë 27.10.2022 marrjes në dorëzim për 7 pajisje për vlerën 9,336,00 lekë i firmosur nga A.S., I.H., E.B., A.D., D.Ç., E.T., M.A..

Kontrata furnizimi, për lotin 8, lidhur me Nr. 64/91 prot., datë 17.06.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë “B.A.” Shpk. në vlerën 9,336,000 lekë me TVSH, përfaqësuar nga administratori A. K..

Procesverbal mbi të dhënat e kontrollit të pranimit, ku në pikën 4 është cituar në mënyrë eksplicite se “Komisioni i ngritur me urdhrin Nr. 229, datë 21.06.2022, kreu kontrollin e sasisë, funksionit instalimin dhe vënien në punë të pajisjeve mjekësore, nga ku rezultoi që të ketë përputhje të plotë të sasive dhe vlerave sipas kontratës së furnizimit loti 8 me Nr. 64/91 prot., datë 17.06.2022 dhe faturës Nr. 855/2022 datë 11.08.2022 bashkëlidhur këtij procesverbalit” .

Për këtë pajisje nuk është mbajtur raport instalimi, funksionimi dhe trajnimi i stafit mjekësor.

Me urdhër shpenzimin Nr. 3220, datë 03.11.2022 për vlerën 5,316,000 lekë, nëpërmjet Bankës Credins është likuiduar shoqëria “M.” shpk. Ky shpenzim (likuidim) ka të bëjë me blerje pajisje mjekësore të provës kardiake. Dokumentet vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi, faturë elektronike Nr. 1029/2022, date 29.09.2022 me vlerë 5,316,000 lekë, fletë hyrje Nr. 113, datë 30.09.2022.

Dokument justifikues: Relacioni Nr. 64/150 prot., datë 27.10.2022 marrjes në dorëzim për 3 pajisje për vlerën 5,316,000 lekë i firmosur nga A.S., I.H., E.B., A.D., D.Ç., E.T., M.A..

Kontrata furnizimi, për lotin 11, lidhur me Nr. 64/116 prot., datë 15.07.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë “M.” shpk në vlerën 5,316,000 lekë me tvsh, përfaqësuar nga administratori S.L., kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve me afat 60 ditë nga lidhja e kontratës.

Plani i zbatimit të kontratës është me Nr. 64/118 prot., datë 15.07.2022, me persona përgjegjës/struktura të ngarkuar për ecurinë e zbatimit të kontratës A.S., me profesion njeke, me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm, I.H. me profesion specialiste ing/klinike, E.B. specialiste ing. klinike, A.D. mjek, D.Ç. mjek, administratore e PAI Polivalent, M.A. administratore e PAI sëmundje të brendshme.

Procesverbal dorëzimi datë 30.09.2022, çertifikatë e garancisë e pa datuar, për periudhë 3-vjeçare, me datë nisje të garancisë nga data e instalimit të pajisjeve sipas procesverbaleve të instalimit. Në të cilësohet “Deklarojmë se të gjitha mallrat objekt kontratës Nr. 64/116, datë 15.07.2022 “Do të mbulohen për periudhën 3-vjeçare, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Në nenin 5 të kontratës është përcaktuar garancia 3-vjeçare.

Për këto pajisje nuk është mbajtur raport instalimi, funksionimi dhe trajnimi i stafit mjekësor.

Me urdhër shpenzimin Nr. 3585, datë 09.12.2022 për vlerën 6,552,000 lekë, nëpërmjet Credins Bankë është likuiduar shoqëria “B.A.” shpk. në vlerën 6,552,000 lekë me tvsh.

Relacioni Nr. 64/158 prot., datë 07.12.2022 marrjes në dorëzim për 1shtratë spitalor ICDU me tre motor për vlerën 6,552,000 me TVSH, firmosur nga A.S., I.H., E.B., A.D., D.Ç., E.T., M.A.dhe L.H. ekonomiste/PA i sëmundjeve të brendshme.

Procesverbal mbi të dhënat e kontrollit të pranimit (dhjetor 2022), ku në pikën 4 është cituar në mënyrë eksplicite se “Komisioni i ngritur me urdhrin Nr. 489, datë 30.11.2022, kreu kontrollin e sasisë, funksionit instalimin dhe vënien në punë të pajisjeve mjekësore, nga ku rezultoi që të ketë përputhje të plotë me kontratën së furnizimit loti 10 me Nr. 64/124 prot., datë 26.07.2022 dhe faturave Nr. 1255/2022 datë 07.12.2022 bashkëlidhur këtij procesverbalit” .

Faturë elektronike Nr. 1255/2022 datë 07.12.2022 për vlerën 6,552,000 lekë, fletë hyrje Nr. 169, datë 07.12.2022.

Me urdhër shpenzimin Nr. 3677, datë 14.12.2022 për vlerën 8,214,000 lekë, nëpërmjet C.B., është likuiduar shoqëria “B.A.” shpk në vlerën 8,214,000 lekë me tvsh,

Relacioni Nr. 64/159 prot., datë 12.12.2022 kolaudim dhe marrje në dorëzim për 29 shtretër spitalor ICDU me tre motor për vlerën 3,045,000 lekë pa TVSH, 40 shtrat ekzaminimi me vlerë 440,000 lekë pa tvsh dhe 20 shtrat spitalor ICDU me katër motor me vlerë 2,400,000 lekë, barelë e lëvizshme me mbajtje anësore me aksesor 16 copë me vlerë 960,000 lekë firmosur nga A.S., I.H., E.B., A.D., D.Ç., E.T., M.A. dhe L.H. ekonomiste/PAI sëmundjeve të brendshme.

Procesverbal mbi të dhënat e kontrollit të pranimit (dhjetor 2022), ku në pikën 4 është cituar në mënyrë eksplicite se “Komisioni i ngritur me urdhrin Nr. 489, datë 30.11.2022, kreu kontrollin e sasisë, funksionit instalimin dhe vënien në punë të pajisjeve mjekësore, nga ku rezultoi që të ketë përputhje të plotë me kontratën së furnizimit loti 10 me Nr. 64/124 prot., datë 26.07.2022 dhe faturave Nr. 1290/2022 datë 12.12.2022 bashkëlidhur këtij procesverbal”.

Faturë elektronike Nr. 1290/2022 datë 12.12.2022 për vlerën 8,214,000 lekë, fletë hyrje Nr. 173, datë 12.12.2022.

-Në kontratën e furnizimit loti 8 me Nr. 64/91 prot., datë 17.06.2022.

-Në kontrata furnizimi, për lotin 11, lidhur me Nr. 64/116 prot., datë 15.07.2022.

-Në kontratën së furnizimit loti 10 me Nr. 64/124 prot., datë 26.07.2022.

Nuk është përcaktuar se pajisjet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së pajisjeve dhe test raport fabrike (raportet e testeve) në zbatim të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqërues të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.*

Veprim që ngarkon me përgjegjësi A.F. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike për periudhën 01.04.20221- 09.02.2022.

Në të tre kontratat për vlerën 29,418,000 lekë, pajisjet janë të pa shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat.

Për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës (raportet e testeve), që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën shoqëria “M.” shpk dhe shoqëria “B.A.” shpk ka fituar tenderin dhe janë likuiduar.

Për veprimet dhe mosveprimet e kolaudimit dhe marrjes në dorëzim ngarkohen me përgjegjësi; grupi i marrjes në dorëzim dhe në veçanti I.H. me detyrë specialiste/ inxhinier Biomedikal i Sektorit të Inxhinierisë Klinike dhe E.B. me detyrë specialiste/ inxhinier Biomedikal i Sektorit të Inxhinierisë Klinike.

Specialistët e Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike nuk janë trajnuar nga QSUNT për njohjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, duke qenë në këtë mënyrë në kushte të pabarabarta me specialistët e kontraktorëve, duke krijuar risk të lart në monitorimin e kontratave dhe marrjes në dorëzim të shërbimit të mirëmbajtjes.

Në të tre kontratat e lidhura si më sipër nuk është raportuar në APP për çdo fazë të realizimit të kontratës në kundërshtim me:

-VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës”, pika 5. pika 6.

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Neni 125 “Detyrimet e autoritetit kontraktor ndaj Agjencisë së Prokurimit Publik”, pika 3.

Veprim që ngarkon me përgjegjësi A.F. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike për periudhën 01.04.20221- 09.02.2022 dhe B.L. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike për periudhën 13.09.20221- 31.12.2022.

10. Procedura e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje full-risk e pajisjeve mjekësore prodhues GE (ose ekuivalent), për nevojat e QSUNT për 24 muaj” me fond limit 21,999,999,926 për 24 muaj lekë, viti 2021.

1. Urdhër Prokurimi Nr. 2919 prot datë 16.11.2021	3. Hartuesit e dokumenteve të tenderit Urdhër Nr. 697 datë 10.05.2021 - A.S.; me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm - E.K.; me detyrë specialist ing. klinike - H.C.; specialist sekt. prokurimeve	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 2985/1 datë 24.11.2021 - B.M.; Drejt.ing.klinike&IT - A.V.; specialist sekt. Ing.Klinike - I.H.; specialist sekt. Ing.Klinike - F.Ç. specialist ekonomiste.; - K.L.; specialist i marrëdhënieve ligjore.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lart monetar”; marrëveshje kuadër		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 15,209,9991 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 15,209,999 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0
8. Data e hapjes së tenderit 27.05.2019	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër <u>2</u> OE b) S’kualifikuar ska OE, c) Kualifikuar <u>1</u> OE
11. Ankimime Pranë AK - nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës të Shërbimeve		
14. Lidhja e kontratës Nr.104/7, datë 21.01.2022 Nr. 40/1 prot, date 05.01.2023	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 8,621,550 lekë Vlera e kontratës (me tvsh) 9,621,150 lekë	16. Afati i kontratës në dite 730 dite

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Autoriteti kontraktor, para shpalljes së kësaj procedure duhet të kishte hartuar planin e mirëmbajtës së pajisjeve mjekësore për çdo vit, plan i miratuar nga komisioni mjekësor, si klasifikimin pajisjeve mjekësore në të vogla dhe të mesme.

Kjo për faktin se numri i pajisjeve për nevoja mirëmbajtje është shumë i madh dhe nuk mbulohen nga fondet e QSUNT-se.

Procedura e prokurimit me objekt Mirëmbajtje Full-Risk e pajisjeve mjekësore prodhues GE (ose ekuivalent), për nevojat e QSUNT për 24 muaj” me fond limit 21,999,999,926, sipas prodhuesve të pajisjeve mjekësore GE dhe jo ekuivalent dhe operatorët fitues është ai që ka autorizim nga prodhuesi GE për blerje/shërbim mirëmbajtje pajisje mjekësore.

Autoriteti kontraktor me këtë procedurë prokurimi ka kryer një formalitet burokratik dhe jo procedurë të mirëfilltë prokurimi, duke mos maksimizuar eficienten dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, në kundërshtim me legjislacionin në Republikën e Shqipërisë për këtë qëllim, por edhe kundërshtim me parimet për rritjen e integritetit në prokurimin publik të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), parime që kanë efekt të drejtpërdrejtë në

konkurrencë, në çmimin e paguar nga administrata publike për blerjen e një malli, shërbimi apo kryerjen e një pune, të cilat nga ana tjetër kanë efekt të drejtpërdrejtë në shpenzimet e shtetit, pra në burimet e taksapaguesve.

Autorizimi i Prodhuesit nuk është gjë tjetër veçse diskriminim de facto kundrejt shoqërive që, për shkak të fuqisë së tyre më të vogël në treg, nuk kanë lidhje direkt me prodhuesit dhe nuk janë distributorë ekskluzivë, por i përftojnë produktet/shërbimet nëpërmjet distributoreve të tjerë ekskluzivë të prodhuesit dhe ofrojnë çmime më konkurruese për të njëjtin mal/shërbim, cilësia e të cilit mund të provohet shumë lehtë. Kurse nga ana tjetër, shoqëritë që kanë në dispozicion autorizimin e prodhuesit, kanë krijuar një oligopol të rrezikshëm dhe nuk shqetësohen të ofrojnë çmime konkurruese, por abuzojnë me këtë fakt në dëm të fondeve publike dhe konsumatorëve.

Autorizimi nga prodhuesi, si kriter kualifikues, nuk mund të jete i vetmi mjet që të mundësojë garantimin e origjinalitetit e mallit/shërbimit. Ky kriter për kualifikim ka bërë që Autoriteti kontraktor të duket sikur e ka parazgjedhur paraprakisht kandidatin fitues, çka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë dhe nuk është në qasje të plotë dhe me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës së Drejtësisë.

Kërkesa për zhvillimin e kësaj procedure prokurimi është dërguar nga Drejtori i IT dhe Inxhinierisë Klinike me shkresën Nr. 2453/25, datë 23.11.2021, drejtuar Drejtorisë Juridike dhe për dijeni drejtorit të përgjithshëm.

Me urdhër Nr. 474, datë 13.10.2021 protokolluar në QSUNT me Nr. 2453/5 prot., datë 13.10.2021, ndryshuar me urdhrin Nr. 474/1, datë 26.10.2021 Nr. 2453/13 prot., datë 26.10.2021 të E.J. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm është ngritur grupi i punës për argumentimin e fondit limit si dhe hartimin e specifikimeve teknike nga A.S. kryetar, me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm me profesion mjekë, E.K. anëtar, me profesion specialist në sektorin e inxhinierisë klinike, E.K. anëtar, me profesion specialist në sektorin e inxhinierisë klinike, J.S. anëtar, me profesion specialist në sektorin e inxhinierisë klinike dhe J.S. anëtar specialist/ekonomie PAI Enkologjik, M.P. anëtar, me detyrë specialist në sektorin e prokurimeve.

Me relacion të protokolluar Nr.2453/24 prot., datë 22.11.2021, grupi i punës për riargumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike, i përbërë nga E.K., E.K., J.S., M.P dhe A.S., për mirëmbajtje full-risk e pajisjeve mjekësore Scanner CT të prodhuesit GE; Mediso/ ose ekuivalent ka përcaktuar vlerën 37,209,999 lekë pa TVSH.

Loti 1. Fondi limit për 24 muaj në vlerën 21,999,999.90 lekë pa TVSH për mirëmbajtje full-risk e pajisjeve mjekësore Scanner CT të prodhuesit GE/ ose ekuivalent si më poshtë.

Skeneri CT 64 Slice, Lightspeed 64 SL

Skeneri CT 16 Slice, Bright Speed 16 SL

Loti 2. Loti 2. Fondi limit për 24 muaj në vlerën 15,209,999.9 lekë pa TVSH për mirëmbajtje full-risk e pajisjeve mjekësore prodhues Mediso/ ose ekuivalent si më poshtë.

-Spect Dual Gama Camera +CT System

-Spect Dual Gama Camera +CT System

Bashkëlidhur këtij relacioni, me shkresën Nr. 2453/3 prot., datë 08.10.2021. E.J.me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i kërkon informacion shoqërisë “M.” shpk, kontrata me Nr. 173/21, datë 01.02.2021 me objekt: mirëmbajtje pajisjeve mjekësore në QSUNT për vitin 2021”, e ndarë në lote: Loti 55 Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore Scanner CT të prodhuesit GE/ose ekuivalent për pajisjet :Skeneri CT 32 Slite, lightspeed 16 Sl, Skeneri CT 64 Slice, lightspeed 64 Sl, skeneri CT 16 Slite, brigh Speed 16 Sl.

Sa më sipër kërkojmë nga ana e juaj, si distributor zyrtar i prodhuesit GE, të shpreheni nëse ndonjë prej pajisjeve, të mësipërme kalon në “end-of-support”, brenda vitit 2022, për marrjen e

masave nga QSUNT dhe garantimin pa ndërprerje të mirëmbajtjes full-risk, për këto pajisje të rëndësishme të veçantë.

Me shkresën Nr. 211117 prot., datë 17.11.2021, protokolluar në QSUNT me Nr. 2453/21, datë 17.11.2021, shoqëria "M." shpk i drejtohet QSUNT, në vëmendje B.M. me detyrë drejtor i IT dhe Inxhinierisë klinike, duke përcaktuar:

Mirëmbajtje skaneri CT 16 Slite, Nr. Inventari 20250, çmimi 6450,00 xe 2 vjet = 12,900,000 lekë.

Mirëmbajtje skaneri CT 64 Slice, Nr. Inventari 20705, çmimi 10,350,000 lekë x 2 vjet = 20,700,000 lekë.

Kjo ofertë është e vlefshme për një periudhë jo më të shkurtër se 2-vjeçare. Ju informojmë që në kontrata e ardhshme, konsolat aktuale të skanerve si më sipër, kanë dalë nga prodhimi dhe nuk suportohen më me pjesë nga prodhuesi i tyre, kështu që GE Healthcarte, nuk garanton furnizimin me pjesë për ta. Për një mirëmbajtje full-risk të këtyre sistemeve, GE Healthcarte rekomandon zëvendësimin e tyre men konsola bashkëkohore. Zëvendësimi është i kushtueshëm dhe është reflektuar në çmimin e dhënë më sipër.

Mirëmbajtje Skaneri CT 16 Slice, inventari 21734 prodhim i GE Healthcare, duke filluar nga janari i vitit 2022, nuk suportohet më nga prodhuesi GE. Për këtë arsye ju informojmë që nuk mund të mirëmbajmë në vazhdim dhe rrjedhimisht, nuk mund të ofrojmë më shërbimin e kërkuar për këtë sistem.

Në specifikimet teknike dhe në kontratë dhe në raportet mujore të kontrollit periodikë nuk është përcaktuar/realizuar, informacion i shoqërisë "M." shpk i dhënë me shkresën Nr. 211117 prot., datë 17.11.2021, protokolluar në QSUNT me Nr. 2453/21, datë 17.11.2021, ku është përcaktuar në mënyrë eksplicite se "Ju informojmë që në kontrata e ardhshme, konsolat aktuale të skanerve si më sipër, kanë dalë nga prodhimi dhe nuk suportohen më me pjesë nga prodhuesi i tyre, kështu që GE Healthcarte, nuk garanton furnizimin me pjesë për ta. Për një mirëmbajtje full-risk të këtyre sistemeve, GE Healthcarte rekomandon zëvendësimin e tyre men konsola bashkëkohore. Zëvendësimi është i kushtueshëm dhe është reflektuar në çmimin e dhënë më sipër".

Në relacionin datë 2453/16 prot., datë 05.11.2021, për argumentimin e fondit limit, është shprehur në mënyrë eksplicite se "...Këto pajisje janë komplekse në strukturën dhe funksionimin e tyre, pasi qëllimi i tyre i synuar nga prodhuesi arrihet nëpërmjet koordinimit të një numri të madh pjesësh përbërëse si mekanizma elektronik, elektrik, mekanik dhe jo vetëm. Përveç pjesëve materiale, pajisjet mjekësore janë pajisur me sisteme të posaçme software për kryerjen e ekzaminimeve përkatëse të cilat përditësohen periodikisht".

Riparimi i këtyre aparaturave mund të kryhet vetëm me specialist të kualifikuar, trajnuar dhe certifikuar nga kompanitë prodhuese. parametrizimet, kalibrimet dhe kontrollet e këtyre pajisjeve kërkojnë programe (software) të cilat vetëm prodhuesi (ose të autorizuarit e prodhuesit) i disponojnë dhe nuk i jepet klientit fundor.

Me shkresën Nr. 2453 prot., datë 24.09.2021 QSUNT, i kërkon informacion Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke cituar se këto pajisje të mos jenë pjesë e kësaj procedure, referuar natyrës specifike të tyre, funksionaliteteve dhe fushave në të cilat operojnë, si dhe nga ngjashmëria me pajisjet e mëdha Philips dhe Siemens, për të cilën Ministria ka realizuar procedurën "Mirëmbajtja e përqendruar e pajisjeve të mëdha mjekësore".

Me shkresën Nr. 3958/1 prot., datë 05.10.2021 Ministria i kthen përgjigje QSUNT "Procedoni me kryerjen e procedurës së prokurimit të kërkuar me shkresën e sipërcituar, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor" sipas legjislacionit në fuqi. Lutemi të merren masa në mënyrë të menjëhershme me qëllim zhvillimin e procedurës së prokurimit për mbulimin në kohë dhe pa vonesë, brenda tavaneve të parashikuara buxhetore.

Në specifikimet teknike nuk është përcaktuar:

Manuali i shërbimit, por vetëm rekomandimi i prodhuesit, Koha e llogaritur për përdorim; Shpeshësia e kontroleve nga inxhinieri; Eksperienca teknike e dokumentuar; Nevojat klinike, Analiza e rrezikut; Çfarë lloj mirëmbajtjeje kërkohet nga inxhinieri klinik i QSUNT; Çfarë lloj mirëmbajtjeje dhe/ose pastrimi kërkohet nga ai që punon me të, mjeku; A ka pjesë këmbimi kritike që duhen zëvendësuar rregullisht, sipas manualit të shërbimit dhe rekomandimit të prodhuesit, përcaktimi konkret; A i disponon operatori/kontraktori pjesë këmbimi kritike që duhen zëvendësuar rregullisht, sipas manualit të shërbimit dhe rekomandimit të prodhuesit, përcaktimi konkret; A kërkon pajisja kalibrim dhe nëse po si bëhet ai? Po kite kalibrimi nevojiten dhe a ka, sipas manualit të shërbimit dhe rekomandimit të prodhuesit, përcaktimi konkret. Për sa vite nga data e fundit e prodhimit të pajisjes është i garantuar furnizimi me pjesë këmbimi; A përfshin pajisja programe, dhe nëse po në çfarë gjuhe për përdoruesin, sipas manualit të shërbimit dhe rekomandimit të prodhuesit, përcaktimi konkret; Ofron programi gjetjen e defektit, sipas manualit të shërbimit dhe rekomandimit të prodhuesit, përcaktimi konkret; A ka shërbime mirëmbajtjeje apo funksione që kërkojnë fjalëkalime që nuk zotërohen, sipas manualit të shërbimit dhe rekomandimit të prodhuesit, përcaktimi konkret; A bëhen përditësime për pajisje që varen nga programet ? A janë ato falas, apo blihen; A përfshin manuali i shërbimit diagramat e qarqeve, afatet kohore të mirëmbajtjes parandaluese, arsyet e defektit/zgjidhjen, procedurat e riparimit, listën e pjesëve të këmbimit, veglat e veçanta; A është manuali i përdoruesit në shqip dhe i përshtatshëm për çdo përdorues; Pas shërbimit të mirëmbajtjes të pajisjet mjekësore etiketimi me kohën e mirëmbajtjes tjetër parandaluese; Vënia në dijeni e përdoruesit kur duhet kryer mirëmbajtja parandaluese si dhe mbi rezultatet e shërbimit të mirëmbajtjes.

Në dokumentet e tenderit dhe në QSUNT:

Nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM), i QSUNT, në letër ose në kompjuter historinë (kartelën) e plotë të pajisjes, ku të jene identifikuar:

Prodhuesi ose furnizuesi, numrin serial, data e blerjes, vlera (reale ose të vlerësuar), të dhënat e historisë së riparimeve dhe të mirëmbajtjes. Emri i personit që ka kryer riparimin, mirëmbajtjen. Emri i personit që ka raportuar një problem me pajisjen mjekësore. Përshkrimi i përgjithshëm i problemit ose i shërbimit të nevojitur. Pjesët e këmbimit të përdorura gjatë riparimit/mirëmbajtjes, por ka vetëm numrin e inventarit.

Me shkresën Nr. 2453/4 prot., datë 29.10.2021 E.D. me detyrë drejtor i Departamentit Ekonomik dhe planifikimit financiar, me autorizim të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Nr. 1141, datë 27.02.2020, i është drejtuar 13 operatorëve ekonomik ftesë për ofertë për llogaritjen e fondit limit, prej të cilëve nuk është shfaqur interes.

Përlllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar, referuar kontratave më të afërt në kohë për çdo pajisje. Konkretisht kontrata Nr. 173/21 prot., datë 01.02.2021 me operatorin ekonomik "M." Mirëmbajtje pajisje mjekësore Scanner CT të prodhuesit GE/ose ekuivalent me vlerë 14,569,890 lekë me TVSH 17,483,868 lekë, me afat 333 ditë, nga data 02.02.2021 deri me 31.12.2021.

Inventari 20705, pajisja Skaneri CT 64 Slice, lloji i pajisjes Scanner CT, Spitali i urgjencë pranimit Shërbimi i mazherisë , sasia 1, çmimi për njësi në ditët 8493, total 6,199,890 lekë.

Në përlllogaritjen e fondit limit është përcaktuar 730 ditë x 21,506,8493 lekë/ditë = 15,699.999 lekë.

Inventari 20250, pajisja Skaneri CT 16 Slice, lloji i pajisjes Scanner CT, Spitali i urgjencë pranimit. Shërbimi i mazherisë , sasia 1, Çmimi për njësi në ditët 8630.1, totali 2,873,835 lekë.

Në llogaritjen e fondit limit është përcaktuar 730 datë x 8,630.1 lekë/ditë = 6,299,999 lekë.

Kontratë me Nr. 173/22 prot., me operatorin ekonomik “H. & L.” me vlerë 6,938,260 lekë pa TVSH dhe me TVSH 8,325,912 me objekt “Mirëmbajtje pajisje mjekësore të prodhuesit MEDISO/ose ekuivalent. Në këtë kontratë është përcaktuar: Inventari 21197, emri i pajisjes SPECT/CT System, lloji i pajisjes Spect Dual, Gama Camera System, Spitali i Sëmundjeve të Brendshme sasia 1, çmim për njësi 13,698.6301 vlera 4,561,643.82 lekë.

Inventari 21854, pajisja SPECT System, lloji i pajisjes Spect Dual, Gama Camera System, Spitali i Sëmundjeve të brendshme sasia 1, çmimi për njësi 7,136, 9863 , Çmimi total 2,376,616 lekë.

Përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, i Spitale e tjera private ose shtetërore) veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i llogaritjes së vlerës së fondit limit dhe specifikimeve teknike i përbërë nga E.K., E.K., J.S., M.P. dhe A.S..

Me shkresën Nr. 2453/26 prot, datë 23.11.2021 të firmosur nga D.V. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, E.J. me detyrë përgjegjës i sektorit të planifikimit të buxhetit dhe E.D.me detyrë Drejtor i drejtorisë Ekonomike është shprehur në mënyrë eksplicite se “Akordimi i fondit limit në procedurën me objekt të sipërcituar me shkresën Nr. 2453/20 prot., datë 12.11.2021, ç fuqizohet pasi është ndryshuar vlera e fondit limit (pakësuar) sipas shkresave ët sipërcituar”.

Urdhri i prokurimit Nr. 2985 prot., datë 24.11.2021 firmosur nga zv/Drejtori i përgjithshëm S.R.me vlerë 37,209,999 lekë.

Me procesverbal datë 24.11.2021 njësia e prokurimit ka përcaktuar kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike.

Njoftimi i shkurtuar i kontratës është bërë me shkresën Nr. 2985/2 prot., datë 24.11.2021 nga zv/Drejtori i Përgjithshëm, duke përcaktuar si afat të fundit të paraqitjes së ofertave datë 13.12.2021 ora 10.00, është bërë në gjuhën angleze është publikuar në Buletinin e APP Nr. 171, datë 01.12.2021.

Në pikën 2.3.c “Aftësitë teknike dhe profesionale” është përcaktuar se, operatorët duhet të paraqesin: Autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), për të garantuar mirëmbajtjen cilësore, të sigurtë dhe pjesë origjinale të pajisjeve mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Autorizimi duhet të jetë origjinal ose kopje e përkthyer dhe noterizuar, si dhe i vlefshëm në momentin e hapjes se ofertave.

Kjo kërkesë për kualifikim është “Super/specifikim”. Më gjerësisht është përcaktuar në pikën 2.5.1.

Për sa mësipër ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga A.S., me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm, E.K., me detyrë specialist ing. Klinike dhe H.C., specialist sekt. Prokurimeve.

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues për lotin e dytë “Mirëmbajtje full-risk të pajisjeve mjekësore të prodhuesit MEDISO/ose ekuivalent shoqëria “S.M.” shpk me vlerë të pritshme të kontratave 15,202,250 lekë pa TVSH dhe u s’kualifikua shoqëria “M. ” për lotin e parë “Mirëmbajtje pajisje full risk të pajisjeve mjekësore të prodhuesit GE/ose ekuivalent.

Në këtë procedurë prokurimi morën pjesë dy operator ekonomik për të dy lotët, njëri u s'kualifikua dhe tjetri u kualifikua.

Me vendim Nr. 2985/3 prot., datë 28.12.2021 Titullari i Autoritetit Kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit "Mirëmbajtje pajisje full risk të pajisjeve mjekësore të prodhuesit GE/ose ekuivalent. Loti 1, me vlerë 21,999,999 lekë, pasi nuk është kualifikuar asnjë operator ekonomik.

Formulari i njoftimit të anulimit është bërë me shkresën Nr. Nr. 2985/4 prot., datë 28.12.2021 nga Titullari i autoritetit Kontraktor dhe është publikuar në Buletinin e APP Nr. 192, datë 31.12.2021.

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit, është hartuar me datë 06.01.2021, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor.

Në datën 28.12.2021 në S.P.E. e A.P.P, është kryer njoftimi i fituesit, nga ku A.P.P e ka bërë aktive publikimin e njoftimit të fituesit po në këtë datë, si dhe ka bërë shpalljen në buletin e APP Nr. 29, datë 22.07.2019.

Marrëveshja kuadër është lidhur me Nr. 104/2 prot., datë 18.01.2022, ndërmjet QSUNT përfaqësuar nga A.F.në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe operatorit ekonomik "S.M." shpk.

Kontrata Nr. 1 është lidhur me Nr. 104/2 prot., datë 18.01.2022 ndërmjet QSUNT përfaqësuar nga A.F.në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe operatorit ekonomik "S.M." shpk përfaqësuar nga E.K. në vlerën 7,184,625 lekë pa tvsh dhe në vlerën 8,621,550 lekë, me afat 345 ditë nga periodha 21.01.2022-31.12.2022.

Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar bërë me Nr. 104/8 prot., datë 11.02.2022.

Në datën 11.02.2022 në S.P.E. e A.P.P, është kryer publikimi i njoftimit të lidhjes së kontratës, nga ku A.P.P. e ka bërë aktive këtë publikim në buletin Nr. 19, datë 14.02.2022.

Kontrata Nr.2 është lidhur me Nr. 104/1 prot., datë 05.01.2022 ndërmjet QSUNT përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe operatorit ekonomik "S.M." shpk përfaqësuar nga E.K. në vlerën 8,017,625 lekë pa tvsh dhe në vlerën 9,621,150 lekë, me afat 385 ditë nga dita e lidhjes së kësaj kontrate.

Lidhja e kontratave është realizuar mbi bazën e marrëveshjes kuadër, e cila pavarësisht se ka marrëveshje kuadër, si shpenzim ka shkuar tek fondi limit, pa pasur pakësimin jo vetëm të fondit limit por edhe as të vlerës së prokuruar, duke mos arritur në këtë mënyrë uljen kostove të blerjeve/shërbimeve. Veprime në kundërshtim me Udhëzim e APP Nr. 6, datë 16.01.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", me ndryshimet vijuese të tij, pikat 7.1,7.2 dhe 7.3.

Lidhja e kontratave mbi bazën e marrëveshjeve kuadër, duhet konsideruar si rast i veçantë dhe Autoriteti kontraktor nuk duhet në asnjë rast të abuzojë me përdorimin e këtij instrumenti, me qëllim shtrembërimin e konkurrencës. Përdorimi i kësaj forme prokurimi detyrimisht duhet të arrij reduktimin e kostove transaksionale, përmirësimin e vazhdueshëm në harkun e marrëdhënieve afat-gjatë ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Operatorëve Ekonomik, në interes të konsumatorit, në rastin konkret përmirësimin e shërbimit të shëndetësor për qytetarët.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre, nuk kanë maksimalizuar plotësisht eficientësinë dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, veprim në kundërshtim me:

11. Procedura e prokurimit me objekt "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar" me objekt "Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj", me REF -42319-09-19-2022, viti 2022.

1. Urdhër Prokurimi Nr. 352 prot datë 14.09.2022	3. Hartuesit e dokumenteve të tenderit -M.R.-Kryetare , me detyrë Drejtor pranë Drejtorisë së Farmacisë -F.C.-Anëtare , me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve /juriste - E.K.-Anëtare, specialist sekt. Financës dhe Kontabilitetit/ekonomiste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 261/1 datë 13.01.2021 - B.L.,Kryetare (Drejtori i drejtorisë juridike/Jurist -V.P.-Anëtar (Përgjegjëse e sektorit të materialeve mjekësore -E.S.-Anëtar, përgjegjëse e sektorit të kostos/ekonomiste
5. Fondi Limit (pa tvsh) 89,972,500	6. Oferta fituese (pa tvsh) 75,452,800	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 14,519,700
8. Data e hapjes së tenderit 21.10.2022	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 2 OE b) S'kualifikuar ska OE, c) Kualifikuar 2 OE
11. Ankimime Pranë AK - nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës të Shërbimeve		
14. Lidhja e kontratës Drafti i Marrëveshjes kuadër Nr.1310/36, datë 17.11.2022 Kontrata I nr .1310/42 date 25.11.2022	15. Vlera e kontratës 89,972,500 lekë pa tvsh Vlera e kontratës I (me tvsh) 16,416,000 lekë	16. Afati i kontratës në dite Nga nënshkrimi me afat 4 muaj.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Fondi limit

Fondi i këtij i këtij investimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.

Më shkresën me Nr.352 prot., me datë 14.09.2022 Autoriteti kontraktor ka nxjerrë urdhrin e prokurimit për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me REF -42319-09-19-2022, viti 2022, me fond limit 89,972,500 lekë pa TVSH.

Llogaritja e fondit limit është mundësuar nga komisioni i ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm numër 258 prot. 1310/11, datë 02.09.2022, “Për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike” në relacionin e paraqitur pranë drejtorisë me numër.1310/22 prot., datë 02.09.2022.

Përlllogaritja e fondit limit është hartuar me çmim reference çmimin e tregut.

Specifikimet teknike dhe kërkesat për kualifikim

Hartimi i kriterëve dhe specifikimeve teknike të DST-ve, pas hedhjes në SPE janë ndryshuar sipas rekomandimeve të APP-së.

Nga NJHDT në DST “Aftësitë teknike dhe profesionale”, pika 2.1/ç është përcaktuar se:

ç) Operatori ekonomik ofertues në rastet kur nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë auto deklaratë që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi është i

certifikuar konform standardeve të cilësisë ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetë deklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit dhe në rastin kur OE ofertues shpallet fitues, duhet të paraqesë certifikatën në fjalë.

Për këtë kërkesë Agjencia e Prokurimit Publik është shprehur në mënyre eksplicite në Rekomandimin me Nr. 8197 të datës 03.02.2018 “Autoritetet Kontraktore në dokumentet e tenderit për mallra apo edhe në rastin e punëve publike, kërkojnë që operatorët ekonomike të paraqesin përveç autorizimit të prodhuesit ,katalogjeve , skedave teknike apo raporteve të testimit ,edhe certifikata të ndryshme ISO që prodhuesi (i cili nuk ka lidhje me procesin) duhet të disponojë, veçanërisht certifikatë të menaxhimit të cilësisë së prodhuesit të mallit.

Në nenin 30 të VKM-se Nr. 914,datë 29.12.2014 parashikohet se: AK për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt i prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë ,mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit ,i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”.

Operatorët ekonomike ofertues në një procedurë, në varësi të objektit të prokurimit, mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit, dhe e sigurojnë mallin/shërbimin nga këta të fundit, apo distributorët e autorizuar prej tyre. Në këtë rast kërkesa për paraqitjen e certifikatës ISO të prodhuesit rezulton ti adresohet palëve të treta (prodhuesit/distributorit), të cilat nuk janë konkurrent/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit”.

Nga NJHDT në DST ,Pika 2.3 c është përcaktuar se: “Nga ofertuesi kërkohet Autorizimi nga prodhuesi /MAH/ distributori i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë pajisje/materiale mjekësore në këtë procedurë prokurimi, të përkthyer dhe të noterizuar. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar (kohëzgjatjen e kontratës lidhur)”.

Kjo kërkesë është në kundërshtim me nenet 3, dhe 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 93 VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet shprehimisht se Autoritetet Kontraktore gjatë përcaktimit të kriterëve të veçanta duhet të shmangin çdo kërkesë apo procedurë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomik, e cila përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. Por në përcaktimin apo në vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoritetit kontraktor brenda diskrecionit që ka në përzgjidhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë që përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe (ii) jodiskriminues, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve ofertues.

Gjatë përshkrimit të objektit të prokurimit publik, autoritetet kontraktore përdorin "Kriterë të veçanta kualifikimi", në të cilat përfshihen specifikimet teknike, që zakonisht, kupton tërësinë e kërkesave teknike. Këto specifikime teknike përcaktojnë karakteristikat e kërkuara nga punët, mallrat ose shërbimet që plotësojnë përdorimin të cilin ato synojnë nga Autoriteti kontraktor. Kërkesat/specifikimet teknike shpesh përfshijn nivelin e cilësisë, performancës, sigurisë apo përmasave, garantimin e cilësisë, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat e testimit si dhe të paketimit, markën dhe etiketimin etj.

Referuar sa me sipër, kërkesa specifike e kualifikimi (kushtet teknike), Në pikën 2.3.c “Aftësitë teknike dhe profesionale” është përcaktuar se, operatorët duhet të paraqesin: Autorizim nga prodhuesi /MAH/ ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), është në kundërshtim edhe me jurispodencën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian në Çështjen Procuroeur du Roi v. Dassnoville, 1974.

Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim, vendosja e prodhuesve dhe produkteve të vetëm, kanë orientuar operatorët ekonomik drejtpërdrejtë prodhuesve të caktuar në treg. Për pasojë operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik, është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme kanë ulur në mënyrë të ndjeshme konkurrencën duke favorizuar vetëm operatorët ekonomik të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.). Kjo kërkesë për kualifikim është “Super/specifikim”. Më gjerësisht është përcaktuar në pikën 2.5.1.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit të përbërë nga M.R., F.C., E.K..

Njësia e prokurimit është ngritur me urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor Nr. 352 datë 14.09.2022, e përbërë nga M.R.-Kryetar, me detyrë Drejtor pranë Drejtorisë së Farmacisë/farmaciste, F.C.-Anëtare, me profesion juriste me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve /juriste dhe E.K.-Anëtar, specialist sekt. Financës dhe Kontabilitetit/ekonomiste. Në këtë njësi nuk ka specialistë të fushës/ specialist biokimist etj., veprim në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74, çka ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Kontraktor.

Nga KVO është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave më datë 21.10.2022. Referuar këtij procesverbali, ka rezultuar se kanë paraqitur ofertë 2 Operatore Ekonomike, përkatësisht: Operatori ekonomik “E.” me formular ofertë në vlerën 75,452,800 lekë pa Tvsh.

Operatori ekonomik “M.” shpk me formular ofertë në vlerën 79,424,000 lekë pa Tvsh.

Në përfundim, mbi bazën e raportit përmbledhës me numër prot. 261/6 datë 02.03.2022, dhe formularit të njoftimit të fituesit, janë kualifikuar të dy operatorët ekonomik ofertues për këtë procedure prokurimi dhe është shpallur fitues operatori ekonomik “E.” për vlerën 74,452,800 lekë pa TVSH.

Zbatimi i kontratës

Në keq interpretim të kontratës numër 1310/42 date 25.11.2022 neni 5 ku është shprehur në mënyre eksplicite “Afati i skadencës për kitet ,data e skadencës, në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës ose (minimalisht)një vit” .

Grupi i marrjes në dorëzim ka realizuar marrjen në dorëzim të mallit “set për analize” dhe jo sipas artikujve pjesë përbërëse e setit ,artikuj të cilët kane data skadencë të ndryshme, veprim ky në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Kapitulli 5, neni 659 e në vijimësi.

Urdhër shpenzimin Nr.3941, datë 29.12.2022 për vlerën 547,200 lekë, nëpërmjet R.B., është likuiduar Shoqëria “E.” SHPK., me objekt shpenzimi “Materiale mjekesorë”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 28055/2022, datë 28.12.2022, procesverbal, akt-kolaudim, fletë-hyrje nga farmacia.

Shkelja e dispozitës ligjore të përmendur si më sipër ngarkon me përgjegjësi anëtarët e komisionit të kolaudimit i përbërë nga J. S., D. B., I. N., Th.K..

12. Procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me objekt “Blerje barna për trajtimin e pacienteve me Morbus Gaucher e ndarë në lote për nevojat 12 mujore”, me REF -40644-09-02-2022, viti 2022.

1. Urdhër Prokurimi Nr. 341 prot datë 02.09.2022	3. Hartuesit e dokumenteve të tenderit -E.B.-Përgjegjëse e sekt. të plan.barna dhe MM -M.A.-Specialiste pranë Drejtorisë Ekonomike/ekonomistë - M.B. -Specialiste e prokurimeve, person përgjegjës për prokurim	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 342 datë 02.09.2022 - N.S., Kryetare (Zv.Drejtor i përgjithshëm/Farmacist -B.L. -Anëtar (Përgjegjëse e sektorit të prokurimeve/jurist -D.V.-Anëtar, farmacist pranë DSH farmaceutik
5. Fondi Limit (pa tvsh) Lot 1 205,821,000 Lot 2 68,718,339.36 Lot 3 63,171,757.44	6. Oferta fituese (pa tvsh) 205,821,000 68,718,000 63,158,400	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 339.16 13,357.44
8. Data e hapjes së tenderit 10.10.2022	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 3 OE b) S'kualifikuar ska OE, c) Kualifikuar 3 OE
11. Ankimime Pranë AK - nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës të Shërbimeve		
14. Lidhja e kontratës Drafti i Marrëveshjes kuadër Nr.1933/21, datë 31.10.2022 Kontrata 1 Nr. 1933/27 date 31.10.2022 Drafti i Marrëveshjes kuadër Nr.1933/20, datë 31.10.2022 Kontrata Nr. 1 Nr. 1938/42 date 22.11.2022 Drafti i Marrëveshjes kuadër Nr.1933/20, datë 31.10.2022 Kontrata 1 Nr. 1933//48 date 25.11.2022	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 205,821,000 lekë 67,920,930 lekë 68,718,339.36 lekë 22,848,735 lekë 63,171,757.44 lekë 15,789,600 lekë	16. Afati i kontratës në dite Nga nënshkrimi me afat 4 muaj. Nga nënshkrimi me afat 4 muaj. Nga nënshkrimi me afat 4 muaj.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Fondi limit

Fondi i këtij i këtij investimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.

Me shkresën me Nr. 341 prot., me datë 02.09.2022 Autoriteti kontraktor ka nxjerrë urdhrin e prokurimit për procedurën e prokurimit “Procedura e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me objekt “Blerje barna për trajtimin e pacienteve me Morbus Gaucher e ndare në lote për nevojat 12 mujore”, me REF -40644-09-02-2022, me fond limit 337,711,096.80 lekë pa TVSH.

Llogaritja e fondit limit është mundësuar nga komisioni i ngritur me urdhër numër 319 prot. 1933/8, datë 23.08.2022, “për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike” në relacionin e paraqitur pranë drejtorisë me numër 1933/10 prot., datë 01.09.2022.

Përlllogaritja e fondit limit është hartuar me çmim reference çmimet CIF ,sipas përcaktimeve të ligjit 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”

Specifikimet teknike dhe kërkesat për kualifikim

Hartimi i kriterëve dhe specifikimeve teknike të DST-ve, pas hedhjes në SPE nuk janë ndryshuar.

Nga NJHDT në DST “Aftësitë teknike dhe profesionale”, pika 2.3/b është përcaktuar se:

-Në rastin e parashikuar në pikën “b” të kriterëve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose distributori i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja e këtij të fundit me MAH) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre. Autorizimi duhet të jete i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar

Kjo kërkesë është në kundërshtim me nenet 3, dhe 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 93 VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet shprehimisht se Autoritetet kontraktore gjatë përcaktimit të kriterëve të veçanta duhet të shmangin çdo kërkesë apo procedurë që lidhet me kualifikimin e operatoreve ekonomik, e cila përben diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. Por në përcaktimin apo në vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoritetit kontraktor brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë që përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe (ii) jodiskriminues, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertues.

Gjatë përshkrimit të objektit të prokurimit publik, autoritetet kontraktore përdorin "kriterë të veçanta kualifikimi", në të cilat përfshihen specifikimet teknike, që zakonisht, kupton tërësinë e kërkesave teknike. Këto specifikime teknike përcaktojnë karakteristikat e kërkuara nga punët, mallrat ose shërbimet që plotësojnë përdorimin të cilin ato synojnë nga Autoriteti kontraktor. Kërkesat/specifikimet teknike shpesh përfshijn nivelin e cilësisë, performancës, sigurisë apo përmasave, garantimin e cilësisë, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat e testimit si dhe të paketimit, markën dhe etiketimin etj.

Referuar sa me sipër, kërkesa specifike e kualifikimi (kushtet teknike), Në pikën 2.3.c “Aftësitë teknike dhe profesionale” është përcaktuar se, operatorët duhet të paraqesin: Autorizim nga prodhuesi /MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), është në kundërshtim edhe me jurispodencën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian në Çështjen Procuroeur du Roi v. Dassnville, 1974.

Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim, vendosja e prodhuesve dhe produkteve të vetëm, kanë orientuar operatorët ekonomik drejtpërdrejtë prodhuesve të caktuar në treg. Për pasojë operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik, është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme kanë ulur në mënyrë të ndjeshme konkurrencën duke favorizuar vetëm operatorët ekonomik të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.

Kjo kërkesë për kualifikim është “Super/specifikim”. Më gjerësisht është përcaktuar në pikën 2.5.1.

Në procesverbalin e mbajtur për hartimin dhe miratimin e dokumenteve standarde të tenderit njësia e prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e këtyre kritereve, kjo në kundërshtim me Ligjin 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 78, dhe në kundërshtim me rekomandimin e APP-se me Nr. 1797/1prot. datë 10.03.2022, ku shprehet se:

“Gjatë asistimit të vazhdueshëm të procedurave të prokurimit, APP ka konstatuar se Autoritetet/entet kontraktore në procesverbalin e hartimit të kritereve të veçanta të kualifikimit, cilësojnë vetëm referimin ligjor të kritereve të përcaktuara, duke cituar në procesverbal vetëm nenin përkatës të LPP, duke mos dhënë argumentimin teknik konkret të kritereve të veçanta të kualifikimit, në raport me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Sjellim në vëmendje të autoriteteve/enteve kontraktore që, bazuar në piken 2, të nenit 78, të RRPP: "Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushë, hartimi i kërkesave si me sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit ".

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura sa më sipër ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit të përberë nga E.B., M.A., M.B.

Nga KVO është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave më datë 10.10.2022. Sipas këtij procesverbali, ka rezultuar se kanë paraqitur ofertë 3 Operatore Ekonomike, nga 1 operator ekonomik ofertues për secilin lot, përkatësisht:

Lot 1 Operatori ekonomik “M.” Shpk me formular ofertë 205,821,000 lekë pa Tvsh.

Lot 2 Operatori ekonomik “L.” Shpk me formular ofertë 68,718,000lekë pa Tvsh.

Lot 3 Operatori ekonomik “F.” Shpk me formular ofertë 63,158,400 lekë pa Tvsh.

Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës me numër prot. 1933/19 datë 25.10.2022, dhe formularit të njoftimit të fituesit, janë kualifikuar të 3 (tre) operatorët ekonomikë ofertues për këtë procedure prokurimi dhe shpallur fitues.

Autoriteti kontraktor ka nënshkruar minikontratat e para për këtë procedure prokurimi sipas përcaktimeve në draftin e marrëveshjes kuadër përkatës për secilin lot.

Për lot 1 Autoriteti kontraktor ka nënshkruar kontratën e furnizimit, “Kontrate 1” me numër prot 1933/27 datë 31.10.2022 në vlerën 67,920,930 lekë me TVSH.

Për lot 2 Autoriteti kontraktor ka nënshkruar kontratën e furnizimit, “Kontrate 1” me numër prot 1938/42 datë 22.11.2022 në vlerën 67,920,930 lekë me TVSH.

Për lot 3 Autoriteti kontraktor ka nënshkruar kontratën e furnizimit, “Kontrate 1” me numër prot 1933/48 datë 25.11.2022 në vlerën 22,848,735 lekë me TVSH.

13. Zbatimi i kontratës “Rikonstruksioni pediatrikë infektive në QSUNT” me fond limit 34,187,187 lekë pa TVSH, viti 2021. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua:

a. Mbi projektin e zbatimit

- Projektuesi i objektit është shoqëria “A.” shpk, më përfaqësues A.E. Shoqëria “A.” është kontraktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) për Kontratën e Shërbimeve Konsulente me Nr. 236/2 prot., datë 16.01.2020, për "Vlerësim teknik, hartim projektesh arkitektonike dhe inxhinierike, specifikimet teknike, përlllogaritje kostoje për

“Ndërtesa e Pediatriisë së Përgjithshme në QSUT”. Projekti është hartuar *në Prill 2020*. Qëllimi i Projektimit të shërbimit të konsulencës është vlerësimi teknik i ndërtesave ekzistuese dhe hartimi i projekteve arkitektonike e inxhinierike, specifikimet teknike dhe kostot e llogaritura.

- Ndërtesa e Pediatriisë Infektive, përbëhet nga 3 kate mbi tokë dhe një gjysmë kati teknik mbi soletën e katit të fundit me lartësi 1.95 m, duke krijuar një interkapet mes tarracës dhe katit të dytë.

Spitali i Pediatriisë së Infektive ka një lartësi kati prej 3.25 m dhe arrin një sipërfaqe totale ndërtimi 3,191 m², Kati përdhe 1,075 m², Kati i parë 1,058 m², Kati i dytë 1,058 m².

Të dhëna funksionale Pediatria e Përgjithshme QSUT		Të dhënat teknike	Nr shtretërve aktual
Kati përdhe	Kardiologji dhe Reumatologji, Radiologji, Talasemi, Urgjenca Pediatriisë	1,075 m ² ,	3 shtretër dhe stafi
Kati parë	Departamenti i infektivit, Reanimacion Infektiv, Pediatria e përgjithshme	1,058 m ²	33 shtretër dhe 4 mjek
Kati dytë	Infektiv	1,058 m ²	32, aktualisht bosh

Ndërhyrjet restauruese të fundit janë bërë kryesisht rreth viti 2006, të cilat konsistojnë në ndërhyrje pjesore arkitektonike dhe inxhinierike (sistemi elektrik/ impiant mekanik). Referuar situatës së tërmetit të 26.11.2019, nga analiza e grupit të projektuesve pas situatës së tërmetit, vihen re dëmtime në muraturë kryesisht në katin e dytë të godinës të cilat vijnë si pasojë e dëmtimeve në strukturat konstruktive të mureve mbajtës perimetralë dhe plasaritje të lehta në suvanë e jashtme dhe të dukshme në rifiniturat e brendshme. Kati i fundit i godinës është i evakuar, për çështje sigurie ky kat është i boshatisur.

Në vlerësimin struktural të projektuesit konstatohet se dëmtimet konsistojnë në strukturat konstruktive të mureve mbajtëse perimetrale në anën Lindore dhe Jugore në katin e dytë Teknik të godinës. Përveç katit + 2, në katet e ulëta (Kati 0, Kati +1 dhe tarraca e godinës) nuk vërehen dëmtime konstruktive.

Në kushtet e emergjencës për vazhdimin e funksionimit të tij projektuesi rekomandon puntelimin dhe nxjerrjen nga puna të komplet katit të dytë teknik të objektit.

- Në mënyrë që të zgjidhen problematikat kryesore të ndërtesës, opsioni përfundimtar i sugjeruar nga projektuesi për Spitalin e Pediatriisë së Përgjithshme parashikon zgjatjen e jetëgjatësisë së objektit ekzistues deri në 2-3 vjet dhe më vonë ndoshta ri konceptimi i një objekti të ri, i cili do të zhvillohet në prishjen e objektit ekzistues dhe ndërtimi i një objekti të ri të Spitalit të Pediatriisë së Përgjithshme me parametra bashkëkohore.

Nga pikëpamja rikonstruksionit, projekti do të përfshijë ndërhyrje të shpërndara në; prishje të vogla, riorganizime të tualeteve, riparim të sistemit të ujit të ngrohtë dhe të ftohtë, përforcim të rrjetit elektrik, suvatime apo riparime minimale, lysterje të mureve të brendshme e të jashtme, riparime në sistemime të jashtme etj. (Pra kryesisht sipërfaqësore).

Përforcimi i ndërtesës dhe rikonstruksioni i saj, do të mundësojë përmirësimin e kushteve të ndërtesës aktuale të përdorimit të ndërtesës, por ky është vetëm ***një proces i përkohshëm***.

Për shkak të ndërhyrjeve në *katin e dytë teknik me puntela*, pavijoni i infektivit i pozicionuar në këtë kat do të zhvendoset në dy katet e para, përkohësisht. Në projektin e rikonstruksionit të godinës ekzistuese së Pediatriisë së Përgjithshme, ndërhyrjet do të konsistojnë kryesisht në riformulimin e nyjeve higjieno /sanitare të dhomave të shtrimit, nyjet sanitare të vizitorëve dhe nyjet sanitare të dhomave të mjekëve, pa ndërhyrë në zgjidhjen funksionale aktuale.

- Me shkresën e MSHMS Nr. 2089/3 prot., datë 29.05.2020, protokolluar në QSUNT Nr. 1991 prot., datë 03.06.2020, delegohet e drejta e kryerjes së procedurave të prokurimit. Për investimin e “Rikonstruksionit të pediatriisë infektive”, dokumentacioni i nevojshëm për procedurën e

prokurimit, do të vihen në dispozicion pasi të përfundojë kryerja e oponencës teknike. Në këtë shkresë citohet se lidhje e kontratës dhe likuidimi i tyre do të realizohet nga MSHMS.

- Me shkresën e MSHMS Nr. 282/43 prot., datë 24.06.2020, protokolluar në QSUNT Nr. 1991/3 prot., datë 24.06.2020, dërgohet dokumentacioni teknik për kryerjen e procedurës së prokurimit për “Rikonstruksionin e pediatrikë Infektive në QSUNT. *Auditimi i procedurës së prokurimit, është realizuar nga KLSH, ku janë lënë rekomandimet përkatëse sipas Vendimit të Kryetari të KLSH Nr. 174 datë 19.10.2021.*

Referuar oponencës teknike drejtuar MSHMS me Nr. 1190/2 prot., datë 06.06.2020, janë paraqitur reflektime të projektit, ku grupi i oponencës del në përfundim se projekti plotëson kushtet teknike të projektimit dhe konkluzionet e dhëna në oponencën teknike, të plotësohen përpara zbatimit të punimeve. Në vërejtjet dhe rekomandimet përfundimtare të oponencës konstatohet:

Në faqen 16 pika 6 citohet në mënyrë eksplicite “*Projekti konstruktiv i përforcimeve është i paplotë, pasi nxirren vetëm problemet e shkaktuara në objekt dhe masat konstruktive përforcuese, por nuk bëhet përforcimi i tyre*”.

Në faqen 16 pika 15 citohet “*Oponenca vëren se nuk duket shumë e kuptimtë të Investosh në rikonstruksionin e një objekti ekzistues me skemë konstruktive muraturë, pa marrë masa përforcuese dhe ndërhyrjet e duhura strukturore, duke e lënë katin e dytë të mbështetur në puntela, pra duke konsideruar si jo probabël riskun e një tërmeti tjetër të madh brenda një periudhe dy vjeçare. Të kihet parasysh që objekti do të jetë në shfrytëzim për kurimin e fëmijëve, dhe pasojat do të ishin të pariparueshme*”.

Sa më sipër, referuar komenteve, konkluzioneve dhe të arritura nga oponenca teknike e realizuar nga Instituti i Ndërtimit, me Nr. 1190/2 prot., datë 06.06.2020, konstatohet se oponenca teknike është kontradiktore, ka paqartësi ose mos dhënie e përfundimeve të sakta të oponencës teknike, realizuar nga Ing. Konstr. E.D., Ark. Xh.E., Ing. Hidro. M.Sh. dhe Ing. Elektrik. A.S., Ing. M.Sh.dhe Drejtore Drejtorisë Ing. V.P..

- Me shkresën e MSHMS Nr. 282/33 prot., datë 09.06.2020, drejtuar shoqërisë projektuese “A.” shpk, dërgohen vërejtjet dhe reflektimet e realizuara nga Instituti i Ndërtimit për rikonstruksionin e pediatrikë Infektive.

- Me shkresën e projektuesit “A.” shpk, Nr. 3027/2 prot., datë 18.06.2020, drejtuar MSHMS, kthehet përgjigje për Oponencën Teknike. Në përgjigje të projektuesit citohen se MSHMS ka rënë dakord dhe aprovuar, që gjatë kësaj faze, të bëhet vlerësimi i strukturës për mundësinë e vazhdimësisë së funksionit për një periudhë 2 vjeçare. Nga projektuesi citohet se duke konsideruar që risku sizmik për dy vjet është shumë i ulët (Llogaritur nga viti 2020), objekti në katet e mëposhtme nuk ka probleme në elementet strukturore; ngarkesat e objektit nuk ndryshojnë, përkundrazi ulet ngarkesa e shfrytëzueshme e katit të fundit; themelet e objektit nuk kanë cedime apo probleme të tjera, mendojmë që rikonstruksioni i objektit për dy vjet është i panevojshëm.

Pra, në detyrën e Projektimit nga (MSHMS) është kërkuar vlerësimi i strukturës në kushtet e dëmtimit pas tërmetit për një periudhë 2 vjeçare. Sipas projektuesit kjo është e mundur sepse:

Risku sizmik është më i ulët se risku minimal për të cilin janë të nevojshme llogaritjet, objekti, me përjashtim të katit të tretë nuk ka probleme të tjera strukturore dhe ngarkesa e objektit është ulur (me nxjerrjen nga puna të katit të tretë). Nëse gjatë llogaritjeve dhe arsyetimeve do të dilte e kundërta, grupi i projektimit do të sugjeronte projektin konstruktiv për masat përforcuese ose prishjen e tij, pavarësisht se kjo do të ishte subjekt i një detyre tjetër projektimi.

Në opinionin e grupit të auditimit, referuar dokumentacioneve të vëna në dispozicion, nga MSHMS konstatohet se nuk ka vlerësuar drejt Investimin e rikonstruksionit të një objekti

ekzistues, pa marrë masa përforcuese dhe ndërhyrjet e duhura strukturore, duke e lënë katin e dytë të mbështetur në puntela dhe një investim për një periudhë shfrytëzimi prej 2 vitesh, c'ka do të thotë që për një vit Buxheti i Shtetit ka paguar 13,319,442 lekë me TVSH (26,638,885 lekë me tvsh / 2) ose për 2 vite 26,638,885 lekë me TVSH, në një kohë kur ky projekt është hartuar në kundërshtim me Kushtet teknike të Projektimit KTP dhe zbatimit KTZ, miratuar me VKM Nr. 68, datë 15.2.2001 “Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit” si dhe Leja e ndërtimit Nr. 14544/4 datë 04.08.2021, është dhënë në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

Referuar zgjidhjes teknike paraqitet një risk shumë i madh në rast të një tërmeti tjetër brenda një periudhe dy vjeçare (e cila ka kaluar), ku ambienti shfrytëzohet për hospitalizimin e fëmijëve. Gjithashtu zgjidhja e dhënë në projekt me puntelimin e katit të fundit, nuk zgjidh ose përforon muret perimetral mbajtës, të cilët kanë patur shkoputje në një zonë me muret ndarës të brendshëm. Pra ky investim nuk ka arritur zgjidhjen e qëndrueshmërisë së godinës edhe në rastin e menduar prej 2 vite me puntela (ku mbahet soleta), ku nuk është menduar zgjidhja e qëndrueshmërisë së mureve perimetralë, cka do të kërkojë rikonstruksionin e plotë të godinës. Pra Buxheti i Shtetit/ QSUNT do të harxhojë fonde përsëri që godina të jetë e shfrytëzueshme dhe e sigurt për funksion spitalor. Nga MSHMS dhe nga QSUNT, nuk është parashikuar asnjë Investim për Pediatri të Infektive, për ndërtimin e ndonjë objekti të ri apo edhe për rikonstruksion përfundimtar të godinës së vjetër mbi katin e dytë të mbajtur me puntela provizore.

Referuar sa më sipër, vlera prej 26,638,885 lekë me TVSH për Rikonstruksionin të pediatri të Infektive, përbën efekt negativ të konstatuar në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.

Koment i grupit të auditimit

Në morinë e veprave të Inxhinierisë Civile, një vend të rëndësishëm zënë ndërtesat socialkulturore, midis tyre dhe ato të sistemit Shëndetësor. Rëndësia e ruajtjes së integritetit strukturor të tyre nuk lidhet vetëm me sigurimin e jetës së përdoruesve në rast tërmeti, por edhe me funksionin e dobishëm, madje pothuaj të pazëvendësueshëm, të tyre në situatën pas tërmetit. Ky shërbimi i dyfishtë si dhe vjetërsia (mosha) faktike e këtyre ndërtesave e bën të domosdoshme njohjen dhe vlerësimin e kapacitetit sizmik dhe metodikat për riaftësimin strukturor të tyre. *Fakt i cili anashkalohet nga Instituti i Ndërtimit në Oponencën teknike.*

b. Mbi zbatimin e kontratës së punimeve

- Objekti i kontratës “Rikonstruksioni Pediatri të Infektive në QSUNT”, është kryer sipas kontratës për punë publike Nr. 5280/1 prot., datë **07.12.2020**, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me përfaqësues G.P. dhe operatorit ekonomik “K.C.” shpk, me përfaqësues L.Gj. Vlera e kontratës është 22,199,071 lekë pa TVSH. Afati i realizimit është 3 muaj nga fillimit të punimeve.

- Me shkresën e QSUNT Nr. 1991/18 prot., datë 28.12.2020, drejtuar MSHMS, kërkohet informacion mbi fazën e miratimit të lejes së ndërtimit. Me shkresën e QSUNT Nr. 170/1 prot., datë 21.05.2021, drejtuar MSHMS, ri kërkohet informacion dhe ri kujtesë mbi fazën e miratimit të lejes së ndërtimit.

Në lidhje me procedurat e miratimit të lejes së ndërtimit, konstatohet se është refuzuar disa herë leja e ndërtimit nga Bashkia Tiranë dhe përsëri janë realizuar aplikime për leje pa asnjë ndryshim të projektit.

- Me vendimin Nr. A-16300/1 datë 14.09.2020, është vendosur refuzimi i lejes së ndërtimit për “Leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar, pa shtim apo ndryshim vëllimi” për objektin “Spitalin e Pediatriisë së Përgjithshme” Tiranë, për arsye se:

Projekti i përforcimeve strukturore është i paplotë pasi nxirren vetëm problem e shkaktuara në objekt dhe masat konstruktive përforcuese por nuk bëhet realizimi i tyre

Shkresa informuese nga ISTN për plotësimin e vërejtjeve në opionencën teknike Nr. 1190/2 datë 06.06.2020 për projektet teknike me objekt “Spitalin e Pediatriisë së Përgjithshme brenda territorit të QSUNT.

- Me vendimin Nr. A-25738/1 datë 10.02.2021, është vendosur përsëri refuzimi i lejes së ndërtimit për “Leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar, pa shtim apo ndryshim vëllimi” për objektin “Spitalin e Pediatriisë së Përgjithshme” Tiranë, për arsye se:

Në bazë të aktit normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 dhe vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019, cilësohet se për objektet të cilat konsiderohen si Infrastrukturë publike duhet të aplikohet nëpërmjet procedurës “Leje ndërtimi apo rikonstruksioni të infrastrukturës publike apo kritike në zonat e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore dhe në zonat e reja për zhvillim”.

- Me vendimin Nr. A-5521/1 datë 31.05.2021, është vendosur përsëri refuzimi i lejes së ndërtimit për “Rikonstruksion dhe riparim të ndërtesës së dëmtuar, pa shtim apo ndryshim vëllimi” për objektin “Spitalin e Pediatriisë së Përgjithshme” në pasurinë Nr. 1/1301, z.k. 8130, në pronësi Shtet, ndodhur në rrugën “Kongresi i Manastirit”, njësia administrative Nr.3 për arsye se:

Punimet e kërkuara sipas aplikimit të sipërcituar *nuk janë në përputhje me opionencën teknike* Nr. 1190/2 prot., datë 06.06.2020 hartuar nga Instituti i Ndërtimit.

Pas 3 herë aplikim dhe refuzim të lejes së ndërtimit me arsyet e sipërcituara, në përfundim merret vendimi 14544/4 datë 04.08.2021, ku miratohet leja e ndërtimit si më poshtë:

1. Miratohet leja e ndërtimit për “Leje ndërtimi apo rikonstruksioni të infrastrukturës publike për “Rikonstruksion i spitalit të pediatriisë së Përgjithshme brenda territorit të QSUT”.

2. Afati i lejes së ndërtimit është 3 muaj, sipas grafikut të punimeve, nga data e fillimit të punimeve.

3. Bazuar në nenin 23 të aktit normativ Nr. 9, përjashtohen nga taksa në infrastrukturë.

4. Për çdo ndërhyrje në rrjet të infrastrukturës, të kontaktohet me institucionet përkatëse.

5. Gjatë fazave të ndërtimit do të kryhen kontrole dhe në përfundim të punimeve Autoriteti vendor verifikon konformitetin e akteve të kontrollit sipas përcaktimeve të VKM-së Nr. 887 datë 24.12.2019 i ndryshuar me VKM-në Nr. 714 datë 10.09.2020.

6. Pas përfundimit të punimeve të kthehet territori në gjendjen e mëparshme, të riparohen dëmtimet.

7. Të mos bëhen ndryshime nga projekti i hartuar nga projektues të licencuar, pa miratim paraprak nga Bashkia Tiranë, sipas legjislacionit në fuqi.

Sa më sipër konstatohet veprime kontradiktore nga Bashkia Tiranë, pas 3 herë refuzime për miratim të lejes së ndërtimit dhe më pas miratohet, kur projekti i rikonstruksionit nuk ka pësuar ndryshime apo korrigjime nga reflektimet e opionencës realizuar nga Instituti i Ndërtimit.

Pra, projekti është realizuar në Prill 2020, kontrata e zbatimit është nënshkruar në Dhjetor 2020 dhe Leja e ndërtimit është miratuar në Gusht 2021.

- Për Mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është nënshkruar kontrata e shërbimit Nr. 5473/1 prot., Datë 21.12.2020, midis Autoritetit Kontraktor Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me përfaqësues G.P. dhe Bashkimit të operatorit ekonomik “A.M.P.M.” shpk & “T.N.S.”, me përfaqësues të bashkimit shoqërinë “A.M.P.M.” shpk me përfaqësues A.P.. Përfaqësues i QSUNT është përcaktuar z. E.N. sipas autorizimit Nr. 170/20 prot., datë 01.09.2021.

- Për Kolaudimin e kontratës së zbatimit është nënshkruar kontrata e shërbimit Nr. 396/26 prot., Datë 28.04.2022, me operatorit ekonomik “V.E.” shpk, me përfaqësues M.Sh..

Rikonstruksioni ka patur vështirësi në lirime të pjesshme të ambienteve, për shkak të transferimit të urgjencës nga godina ekzistuese. Pra sipërmarrësi i punimeve ka punuar vetëm në ambientet e udhëzuara nga QSUNT dhe mbikëqyrësi, pasi godina e pediatriisë infektive nuk duhet të punohej në zonën e urgjencës pasi marrin shërbim fëmijët dhe zona duhej të mbahej pastër. Punimet janë pezulluar disa herë nga QSUNT për shkak të vështirësisë në këto ambiente. Me shkresën e kontraktorit Nr. 170/30 prot., datë 13.10.2021, drejtuar MSHMS, QSUNT dhe mbikëqyrësit njoftohen për disa ndryshime në volume për diferenca që zbriten dhe shtohen, referuar ambienteve të godinës. Me shkresën e mbikëqyrësit Nr. 170/21 prot., datë **02.09.2021**, njoftohet fillimi i pjesshëm i punimeve në ambientet ku sheshi i ndërtimit është liruar pjesërisht, pasi urgjenca e pediatriisë nuk disponon hapësira për transferimin e shërbimit deri në zgjidhjen përfundimtare. Më pas akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët me Nr. 396/1 prot., datë 21.01.2022. Njoftimi i fillimit të punimeve nga mbikëqyrësi është realizuar me Nr. 396 prot., Datë **21.01.2022**. Njoftimi i përfundimit të punimeve është me Nr. 396/10 prot., Datë **07.03.2022**. Akti i kolaudimit është realizuar datë 09.05.2022. Procesverbali i marrjes i përkohshëm në dorëzim është realizuar me Nr. 396/35 prot., Datë 13.06.2022. Pra sa më sipër konstatohet se nga 3 muaj të parashikuar fillimisht për realizimin e rikonstruksionit, ky rikonstruksion ka zgjatur në total për 7 muaj, pa llogaritur edhe vonesat për nxjerrjen e lejes së ndërtimit.

(Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimi Nr. 28, datë 31.05.2023, dorëzuar me protokoll në QSUNT).

14. Procedura e prokurimit në objekt: “F.V të aparaturave mjekësore për spitalin e ri të ndërtuar në QSUNT me kredi të CEB (Kontribut i Qeverisë Shqiptare)” Loti 1 “Ekokardiography” me fond limit 39,700,000 lekë pa TVSH , viti 2021.

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Prokurimit me objekt: “F.V të aparaturave Mjekësore Loti 1 “Ekokardiography”		
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E Hapur mbi kufijtë e lartë monetar” REF-04463-09-02-2021 Lot 1	2 Njësia e Prokurimit 1. I.O. 2. D.V. 3. E.K. 4. A.D. 5. M.P. 6. H.C. 7. B.M.	3 KVO dhe KSHA 1. G.S. 2. E.Sh. 3. E.J. 4. A.V. 5. M.M.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 158.031.554 lekë total 12 lotë Lot 1 39,700,000	5. Oferta fituese (pa tvsh) 21,270,000 lekë M. Shpk	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 18,430,000 lekë por realizimi nga marrëveshja kuadër shkon në vlerë 37,790,000 lekë ose 1,910,000
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data : 05.10.2021 ndryshuar 18.11.2021	8. Burimi Financimit QSUNT	9. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj		

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

a. Dokumentet e tenderit.

Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të

tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”. Neni 40, Pika 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

b. Zhvillimi i procedurës së prokurimit

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë pa Tvsh	Kualifikuar
1	M. Sh.p.k	21,270,000	Kualifikuar/ Fituesi
2	H.& L. Sh.p.k	23,500,000	S’Kualifikuar

Janë s’kualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

I. Operatori Ekonomik H.& L. Sh.p.k, për arsyet e mëposhtme:

Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të paraqitur dhe vlerësimi/verifikimi i dokumentacionit, i operatorit ekonomik, nuk i plotëson specifikimet teknike për kualifikim.

1. Lloji i Pajisjes: Eko Kardio-Vaskulare (transezofageale me 2 sonda)

Këndi i skanimit maksimal duhet të arrije deri në të paktën 120° në varësi të sondës së përdorur.

Në katalogun e paraqitur këndi maksimal i skanimit arrin në 111 gradë.

2. Lloji i Pajisjes: Eko Radiologjike me sondë abdominale konvekse dhe Lineare

Këndi i skanimit maksimal duhet të arrije deri në të paktën 160° në varësi të sondës së përdorur.

Sqarim: Këndi i skanimit maksimal i referohet aftësisë së pajisjes për të arritur një fushëpamje të caktuar. *Sonda e versionit C5-1 këndin maksimal të skanimit e ka 111 gradë.*

Referuar katalogut të paraqitur nga OE i mësipërm, nuk përmbushen specifikimet teknike të kërkuara në DST për të cilën operatori ekonomik duhet të plotësojë specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që të merret në konsideratë nga KVO si ofertë e vlefshme.

Mbështetur në nenin 92/3 të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet se:

“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të refuzoj ofertën e Operatorit Ekonomik “H. & L.” Shpk me për arsye se nuk përmbush specifikimet teknike sipas DST.

Nga auditimi i shtojcave të ndryshuara Nr. 2279/24 datë 11.10.2021, konstatohet se:

1. Lloji i Pajisjes: Eko Kardio-Vaskulare (transezofageale me 2 sonda)

Fushëpamja minimale duhet të garantohet deri në të paktën 90° ose me shumë dhe OE në katalogun e paraqitur këndi maksimal i skanimit arrin në 111 gradë, kështu që e plotëson këtë kriter.

2. Lloji i Pajisjes: Eko Radiologjike me sondë abdominale

Këndi i skanimit maksimal duhet të arrijë deri në të paktën 100° në varësi të sondës së përdorur

dhe OE në katalog ka paraqitur Sonda e versionit C5-1 këndin maksimal të skanimit e ka 111 gradë, i cili e përmbush këtë kriter. Sa më sipër, konstatohet se operatori ekonomik “H. & L.”

Shpk, i plotëson specifikimet teknike dhe nuk duhet të ishte s’kualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Raporti përmbledhës miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm me Nr. 64/14 prot., Datë 24.01.2022.

(Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimi Nr. 27, datë 31.05.2023, dorëzuar me protokoll në QSUNT).

15.Procedura e prokurimit me objekt “Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta, për QSUNT, për 12 muaj”, viti 2021.

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta, për QSUNT, për 12 muaj.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 949 prot., datë 24.03.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 93, datë 25.02.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 949/1 prot., datë 24.03.2021 B.S. M.P. F.C.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim-Marrëveshje kuadër”	M.H.-specialiste/sektori i monitorimit të shërbimeve të kontraktuara L.S.-specialiste/sektori i monitorimit të shërbimeve të kontraktuara A.H.-specialiste/sektori i kontrollit të infeksioneve spitalore 3/1. Hartuesi i termave të referencës Urdhër Nr. 949 prot., datë 24.03.2021 M.H.- specialiste/sektori i monitorimit të shërbimeve të kontraktuara E.K.-ekonomiste/sektori i kostove M.M.-specialist/sektori i prokurimeve	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2,070,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 1,980,000 lekë (95.7%)	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 90,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 12.04.2021	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK- s’ka; KPP- s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigje Ankesës nga KKP
b. Zbatimi i Kontratës		
14. Lidhja e kontratës M.K Nr. 949/7 prot., datë 20.05.2021 K.SH Nr.949/14 prot., datë 26.05.2021	15. Vlera e kontratës (pa tvsh) 660,000 lekë	
16.Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli Nr. 144, dt. 01.09.2021 -Vlera me tvsh 112.781 lekë -Vlera pa tvsh 93.984 lekë Nr. 207, dt. 15.10.2021 -Vlera me tvsh 121.783 lekë -Vlera pa tvsh 101.486 lekë Nr. 45, dt. 01.06.2021 -Vlera me tvsh 126,007 lekë -Vlera pa tvsh 105,005 lekë Nr. 65, dt. 01.07.2021 -Vlera me tvsh 211,174 lekë -Vlera pa tvsh 175,979 lekë Nr. 71, dt. 02.08.2021 -Vlera me tvsh 131,437 lekë -Vlera pa tvsh 109,534 lekë	17.Afat i kontratës në ditë Parashikuar 120 ditë/Zbatuar 83 ditë ¹⁵	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij shpenzimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit me vlerë 2.070.000 lekë.

¹⁵Për shkak të përjashtimit të OE për të fituar kontrata publike me afat 10 (dhjetë) muaj e 7 (shtatë) ditë.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Me kërkesën Nr. 101/11 Prot., datë 24.02.2011 drejtorja e shërbimeve mbështetëse i është drejtuar drejtorisë juridike, për të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën “Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta, për QSUNT, për 12 muaj”. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUNT Nr. 93, datë 25.02.2021, është ngritur komisioni për argumentimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe nevojave, të cilët me anë të relacionit Nr. 101/17 Prot., datë 04.03.2021 i kanë përcjellë drejtorit të përgjithshëm të QSUNT informacion mbi përlllogaritjen e fondit limit, specifikimeve teknike dhe sasinë orientuese për mbetjet e vitit 2021.

Lidhur me përlllogaritjen e fondit limit, grupi ka argumentuar se pas komunikimit elektronik me INSTAT për çmimet e referencës për këtë shërbim, rezultoi se INSTAT nuk dispononte çmime reference për këtë procedurë. Grupi punës ka vijuar me studimin e tregut dhe me anë të shkresës Nr. 101/13 prot., datë 01.03.2021 ka dërguar ftesë për ofertë 3 shoqërive me qëllim marrjen e ofertave ekonomike. Në përgjigje të së cilës të treja shoqëritë kanë përcjellë ofertat ekonomike, përkatësisht shoqëria “M.-T.” sh.p.k., “E.R.” sh.p.k. dhe “V.A.L.E.R.” sh.p.k.. Gjithashtu, grupi i punës analizoi kontrata të mëparshme me objekt prokurimi të njëjtë, përkatësisht Marrëveshjen Kuadër Nr. 544/7 Prot., datë 30.04.2020 dhe pasi krahasoi vlerat me vlerat për njësi të llogaritura si mesatarja e ofertave, rezultoi se vlera për njësi e kontratës së fundit është më e ulët dhe gjithashtu gjatë zbatimit nuk ka patur problematika. Si rrjedhojë, për llogaritjen e fondit limit ka shërbyer çmimi për njësi i kontratës së fundit, i cili u llogarit në vlerën totale 2,484,000 lekë me tvsh, për sasinë 9.000 kg.

Lidhur me sasinë e mbetjeve të parashikuara për vitin 2021, grupi i punës ka argumentuar se: *“Nga të dhënat që kemi regjistruar në Repartin e Hidroklavës, u mor pesha e mbetjeve anatomike të dorëzuara nga sallat operatore të shërbimeve të Neurokirurgjisë, Pediatriisë, ORL-së, OMF-së, Okulistikës, Djegje Plastikës, Urgjencës Kirurgjikale, Onkologjikut, Kirurgjisë së Përgjithshme, Urologjisë, Kirurgjisë Digjestrive, Kardiokirurgjisë etj., përsa më sipër, sasia referuese për këtë procedurë është parashikuar 9.000 kg në vit, duke iu referuar kontratave të mëparshme”*. Grupi i ngritur me urdhër Nr. 93, datë 25.02.2021, në mbështetje të argumentimit të sasisë së mbetjeve që parashikohen të gjenerohen përgjatë vitit 2021, i është referuar sasisë së mbetjeve të gjeneruara në vitin 2020.

Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të QSUNT me Nr. 949 prot., datë 24.03.2021, është përcaktuar procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim-Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, me të gjitha kushtet e përcaktuara” për një periudhë 12-mujore, është ngritur njësia e prokurimit.

Zhvillimi i procedurës

Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave të datës 12.04.2021, si dhe sistemit elektronik të APP, konstatohet se në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 2 (dy) operator ekonomik “P.-M.” sh.p.k., me ofertë në vlerë 1,980,000 lekë pa TVSH dhe “E.R.” sh.p.k., me ofertë me vlerë 4,320,000 lekë pa TVSH. Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar me Nr. 949/4 prot., datë 28.04.2021, raport i cili është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik “P.-M.” sh.p.k., me ofertë në vlerën 1.980.000 lekë pa TVSH.

Në vijim është lidhur marrëveshja kuadër me Nr. 949/7 prot., datë 20.05.2021, ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga z. E.J., në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm dhe operatorit/shoqërisë “P.-M.” sh.p.k. në vlerën 1,980,000 lekë pa TVSh, kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër është me afat 12

(dymbëdhjetë) muaj, me datë fillimi nënshkrimin e saj. Referuar Buletinit Nr. 140, datë 20.09.2021 nga ana e AK është konstatuar se OE “P.-M.” sh.p.k. është përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike me afat 10 (dhjetë) muaj e 7 (shtatë) ditë (duke filluar nga data 14.07.2021-21.05.2022). Në këto kushte, OE i është drejtuar APP lidhur me udhëzime se si duhet të vijoj për zbatimin e Marrëveshjes kuadër të lidhur me operatorin. Me anë të email-it të datës 28.09.2021 APP, konfirmon se nuk mund të vijohet me lidhjen e kontratave publike me këtë operator për shkak të statusit të saj si e përjashtuar. Në këto kushte, AK i është drejtuar operatorit ekonomik me anë të shkresës Nr. 949/25 prot., datë 30.09.2021, me anë të së cilës e ka njoftuar për zgjidhjen e marrëdhënies kontraktuale të krijuar bazuar në Marrëveshjen Kuadër me Nr. 949/7 prot., datë 20.05.2021. Për periudhën e pambuluar me shërbim, AK ka vijuar me një procedurë blerje të vogël (*trajtuar më hollësisht në materialin për blerjet e vogla*).

Zbatimi i kontratës

Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar, dokumentacioni që shërben për shlyerjen e faturës dhe që i bashkëlidhet urdhër shpenzimeve përkatëse janë situacioni, proces-verbal, konfirmim mbi asgjësimin e tyre. Në zbatim të kriterit mbi procedurën që vijon për depozitimin e hirit, në të gjitha konfirmimet, OE shprehet se “...*kg mbetje anatomike të lëngëta dhe të ngurta të cilat janë asgjësuar të gjitha brenda 30 ditëve nga marrja në dorëzim e tyre*”. Në kuptim të sa mësipër, asgjësimi i hirit do të kryhet nga shoqëria “A.E.” sh.p.k., me të cilën OE ka lidhur marrëveshje të datës 23.11.2020, me afat 6 (gjashtë) muaj duke filluar nga data e nënshkrimit të saj me të drejtë ripërtëritje në momentin që kushtet e kësaj kontrate nuk janë shkelur. Në vijim të akt marrëveshjes sipërcituar, OE nuk përcjell asnjë dokument justifikues për të vërtetuar se marrëveshja është ende në fuqi. Si rrjedhojë, edhe pse shërbimi i kërkuar dhe i paguar nga ana e AK është trajtim dhe asgjësim, pra përfshirë edhe trajtimin e hirit të prodhuar, nuk dokumentohet përmbushja e detyrimeve.

Në mungesë të dokumentacionit të depozitimit të hirit të përfituar nga procesi i trajtimit të mbetjeve spitalore, nuk dihet ku derdhen këto mbetje, të cilat, nisur nga specifikat, mund të kenë ndikim të lartë në mjedis e në shëndetin publik. Nuk konstatohen gjurmë auditimi/dokumentacioni me qëllim vërtetimin e asgjësimit të mbetjeve, shiritat e incineratorit për të vërtetuar realizimin e kontratës, në përputhje me pikën 14, specifikimet teknike, DST “*Marrësi në dorëzim, dërgon një informacion në sektorin që ndjek kontratën mbi realizimin e asgjësimit të mbetjeve anatomike të lëngëta dhe të ngurta, në çdo fund muaji*”. AK ka shlyer në mënyrë të plotë detyrimet që kanë rrjedhur si pasojë e zbatimit të kontratës, edhe pse nuk ka marrë siguri lidhur me realizimin e shërbimit të kërkuar, por është mjaftuar vetëm në konfirmimet e përcjella nga OE, të cilat janë në formë vetëdeklarimi.

Likuiduar me:

- Urdhër shpenzimin Nr.1405, datë 30.06.2021 për vlerën 126,007 lekë, nëpërmjet Fibank, është likuiduar Shoqëria “P.-M.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 48/2021, datë 01.06.2021, procesverbal, situacion, konfirmim nga OE;
- Urdhër shpenzimin Nr.1652, datë 26.07.2021 për vlerën 211,174 lekë, nëpërmjet Fibank, është likuiduar Shoqëria “P.-M.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 65/2021, datë 01.07.2021, procesverbal, situacion, konfirmim nga OE;
- Urdhër shpenzimin Nr.1881, datë 25.08.2021 për vlerën 109,534 lekë, nëpërmjet Fibank, është likuiduar Shoqëria “P.-M.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme

spitalore”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 71/2021, datë 02.08.2021, procesverbal, situacion, konfirmim nga OE;

- Urdhër shpenzimin Nr.2209, datë 28.09.2021 për vlerën 93.984 lekë, nëpërmjet Fibank, është likuiduar Shoqëria “P.-M.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 144/2021, datë 01.09.2021, procesverbal, situacion, konfirmim nga OE;

- Urdhër shpenzimin Nr. 2356, datë 21.10.2021 për vlerën 101.486 lekë, nëpërmjet Fibank, është likuiduar Shoqëria “P.-M.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 207/2021, datë 15.10.2021, procesverbal, situacion, konfirmim nga OE.

16. Procedura e prokurimit me objekt “Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta, për QSUNT për vitin 2022”.

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta, për QSUNT për vitin 2022”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 3215, datë 23.12.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 3215, datë 23.12.2021 M.H.-sektori i monitorimit të shërbimeve të kontraktuara D.L.-ekonomist/sektori i kostos M.M.-specialist/sektori i prokurimeve	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 3215/1, datë 23.12.2021 S.Xh.-zv. drejtor i përgjithshëm E.K.-ekonomiste/sektori i kostos Gj.M.-specialiste/ sektori i monitorimit të shërbimeve të kontraktuara
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”	3/1. Hartuesi i termave të referencës Urdhër Nr. 470, datë 07.10.2021 A.H.-specialiste/sektori i kontrollit të infeksioneve spitalore L.S.-specialiste/sektori i monitorimit të shërbimeve të kontraktuara M.H.-specialiste/sektori i monitorimit të shërbimeve të kontraktuara	
5. Fondi Limit (pa tvsh) 1,980,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 1,764,000 lekë (89%)	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 216,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 17.01.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK- s’ka; KPP- s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigje Ankesës nga KKP
b. Zbatimi i Kontratës Mallrave		
14. Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli Nr. 1082, dt.. 20.04.2022 -Vlera me tvsh 225,603.84 lekë -Vlera pa tvsh 188,003.20 lekë Nr. 1544, dt.. 19.05.2022 -Vlera me tvsh 170,425.92 lekë -Vlera pa tvsh 142,021.60 lekë Nr. 1876, dt.. 16.06.2022 -Vlera me tvsh 195,569 lekë -Vlera pa tvsh 162,974 lekë Nr. 2074, dt.. 05.07.2022 -Vlera me tvsh 114,001 lekë	15. Afati i kontratës në ditë Parashikuar 350 ditë Zbatuar 350 ditë	

<p>-Vlera pa tvsh 95,001.20 lekë Nr. 2074, dt.. 05.07.2022</p> <p>-Vlera me tvsh 114,001 lekë</p> <p>-Vlera pa tvsh 95,001.20 lekë Nr. 2286, dt.. 29.07.2022</p> <p>-Vlera me tvsh 253,875 lekë</p> <p>-Vlera pa tvsh 211,562.40 lekë Nr. 2675, dt.. 06.09.2022</p> <p>-Vlera me tvsh 135,169 lekë</p> <p>-Vlera pa tvsh 112,641.20 lekë Nr. 3096, dt.. 18.10.2022</p> <p>-Vlera me tvsh 135,193 lekë</p> <p>-Vlera pa tvsh 112,660.80 lekë Nr. 3294, dt.. 09.11.2022</p> <p>-Vlera me tvsh 124,350 lekë</p> <p>-Vlera pa tvsh 103,625.20 lekë Nr. 3576, dt.. 07.12.2022</p> <p>-Vlera me tvsh 54,496 lekë</p> <p>-Vlera pa tvsh 45,413.20 lekë Nr. 3631, dt.. 12.12.2022</p> <p>-Vlera me tvsh 80,674 lekë</p> <p>-Vlera pa tvsh 67,288 lekë Nr. 4111, dt.. 30.12.2022</p> <p>-Vlera me tvsh 139,332 lekë</p> <p>-Vlera pa tvsh 116,110 lekë</p>	
---	--

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij shpenzimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit me vlerë 1.980.000 lekë.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Me shkresën Nr. 949/27 Prot., datë 04.10.2021, drejtorja e shërbimeve mbështetëse i është drejtuar drejtorisë juridike me qëllim marrjen e masave për ngritjen e grupit të punës për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për këtë objekt prokurimi për vitin 2022. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUNT Nr. 470, datë 07.10.2021, është ngritur komisioni për argumentimin e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike, i cili me anë të relacionit Nr. 949/33 Prot., datë 13.10.2021 i ka përcjellë drejtorit të përgjithshëm të QSUNT informacion mbi përlllogaritjen e fondit limit, specifikimeve teknike dhe sasinë orientuese për mbetjet e vitit 2022.

Lidhur me përlllogaritjen e fondit limit, grupi ka argumentuar se pas komunikimit elektronik me INSTAT lidhur me çmimet e referencës për këtë shërbim, rezultoi se INSTAT nuk dispononte çmime reference për këtë procedurë. Grupi punës ka vijuar me studimin e tregut dhe me anë të shkresës Nr. 949/29 prot., datë 09.10.2021 ka dërguar ftesë për ofertë 3 shoqërive me qëllim marrjen e ofertave ekonomike. Në përgjigje të së cilës të treja shoqëritë kanë përcjellë ofertat ekonomike, përkatësisht shoqëria “M.-T.” sh.p.k., “E.R.” sh.p.k. dhe “V.A.L.E.R.” sh.p.k.. Gjithashtu, grupi i punës analizoi kontrata të mëparshme me objekt prokurimi të njëjtë, përkatësisht Marrëveshjen Kuadër Nr. 949 Prot., datë 20.05.2021 dhe pasi krahasoi vlerat me vlerat për njësi të llogaritura si mesatarja e ofertave, rezultoi se vlera për njësi e kontratës së fundit është më e ulët dhe gjithashtu gjatë zbatimit nuk ka patur problematika. Si rrjedhojë, për llogaritjen e fondit limit ka shërbyer çmimi për njësi i kontratës së fundit, i cili u llogarit në vlerën totale 2.376.000 lekë, për sasinë 9.000 kg.

Lidhur me sasinë e mbetjeve të parashikuara për vitin 2022, grupi i punës ka argumentuar se: *“Referuar sasisë së mbetjeve anatomike të lëngëta dhe të ngurta që gjenerojnë shërbimet spitalore/sallat operatore të: Neurokirurgjisë, Pediatriisë, ORL-së, OMF-së, Okulistikës, Djegje*

Plastikës, Urgjencës Kirurgjikale, Onkologjikut, Kirurgjisë së Përgjithshme, Urologjisë, Kirurgjisë Digjестive, Kardiokirurgjisë, Laboratorit Anatomi-Aatologjisë, Laboratori Histo-Patologjisë etj., ku depozitimi i tyre bëhet në pikën e grumbullimit pranë hidroklavës dhe monitorohen nga grupi i punës i ngritur me Urdhër të brendshëm, si dhe kontratave të mëparshme, dhe monitorimeve të kryera për këtë shërbim, sasia mesatare ditore e mbetjeve anatomike të ngurta dhe të lëngëta që gjenerojnë shërbimet e sipërcituara janë 24.6 kg/ditë (9.000 kg për një vit pjesëtim për 365 ditë është e barabartë me përafërsi 24.6 kg/ditë)”. Grupi i ngritur me urdhër Nr. 470, datë 07.10.2021, në kundërshtim me detyrat e përcaktuara në urdhër ka vijuar me llogaritjen e sasisë së mbetjeve për tu trajtuar përgjatë vitit 2022, edhe pse nuk ka qenë detyrë e tyre. Gjithashtu, edhe pse jashtë kompetencave grupi i punës, i është referuar sasisë së mbetjeve të gjeneruara në vitin 2021. Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të QSUNT me Nr. 3215 prot., datë 23.12.2021, është përcaktuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me fond limit 1,980,000 lekë, si dhe gjithashtu është ngritur njësia e prokurimit.

Zhvillim i procedurës

Në këtë procedure prokurimi ka marrë pjesë vetëm operatori ekonomik “V.A.L.E.R.” sh.p.k., me ofertë në vlerë 1,764,000 lekë.

Komisioni i vlerësimit të ofertave i ngritur me urdhër Nr. 3215/1 prot., datë 23.12.2021, ka, ka shqyrtuar ofertën e vetme që ka marrë pjesë në procedure dhe e ka kualifikuar si ofertë të vlefshme. Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar me Nr. 405/1 prot., datë 25.01.2022, raport i cili është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik “V.A.L.E.R.” Shpk, me ofertë në vlerën 1,764,000 lekë. Marrëveshja kuadër është lidhur me Nr. 405/2 prot., datë 31.01.2022, ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga zj.A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “V.A.L.E. R.” sh.p.k. në vlerën 1,764,000 lekë pa TVSh, kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër është 12 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër, përkatësisht 31.01.2022.

Me urdhër Nr. 3215/1, datë 23.12.2021 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO). Konstatohet se Certifikatat ISO të lëshuara në favor të OE, nga kompania K.C.I.C.Ltd, janë valide për një periudhë 3-vjecare, por me kusht nëse ky sistem është mirëmbajtur në mënyrë efektive dhe të jenë kryer auditime mbikqyrëse. Nga ana e KVO nuk figuron e dokumentuar konfirmimi nëse këto certifikata ishin apo jo valide në momentin e kualifikimit si OE fitues.

Zbatimi i kontratës

Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar, dokumentacioni që shërben për shlyerjen e faturës dhe që i bashkëlidhet urdhër shpenzimeve përkatëse janë situacioni, grafiku mujor i evadimit, informacion mbi realizimin e trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve konform kushteve të kontratës dhe deklaratë magazinimi. Në të gjitha deklaratat e magazinimit, OE shprehet se “... mbetjet do të asgjësohen pranë subjekteve të licencuara sipas kontratës së lidhur me shoqërinë B.A.”. Në kuptim të sa mësipër, asgjësimi i hirit do të kryhet nga shoqëria B.A.

OE, në zbatim të pikës 15, të termave të referencës DST, sipas së cilës “O.E duhet të dorëzojë mbetjet e dala nga përpunimi, në një subjekt të licencuar për depozitimin e hirit” ka paraqitur pranë AK Kontratë transferimi, rekuperimi dhe/ose asgjësimi të mbetjeve të lidhur ndërmjet “V.A.L.E.R.” shpk dhe “B.” Srl. Për të cilën ka përcjellë dhe dokumentacionin provues që vërteton se subjekti është i licencuar për të trajtuar produktin e dal nga incenerimi (hi) dhe në vijim nuk ka përcjellë asnjë dokument tjetër justifikues (kontratë, licencë) për marrëdhënien e krijuar me shoqërinë B.A. Si rezultat është e paqartë ecuria e procesit të hirit të krijuar, nëse ai dorëzohet pranë një subjekti të licencuar për ta trajtuar apo jo. Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në fund të çdo muaji OE përcjellë

konfirmimin e asgjësimit të cilin e shoqëron me shiritat e incineratorit për të vërtetuar realizimin e kontratës, në përputhje me pikën 14, specifikimet teknike, DST “Marrësi në dorëzim, dërgon një informacion në sektorin që ndjek kontratën mbi realizimin e asgjësimit të mbetjeve anatomike të lëngëta dhe të ngurta, në çdo fund muaji.” Më poshtë në formë tabelare paraqitet informacioni i përmbledhur për periudhën Prill-Gusht 2022 mbi sasi të tërhequra dhe sasi të asgjësuar me incinerim nga ana e OE.

Periudha 2022	Sasi		diferenca e pa asgjësuar
	tërhequr	asgjësuar ¹⁶	
Prill	831.5	199	1,708.1
Maj	484.7	418	
Qershor	1079.4	382	
Korrik	574.7	594	
Gusht	574.8	244	
TOTAL	3,545.1	1,837	

Burimi: QSUNT përpunuar nga grupi i auditimit

Diferenca prej 1,708.1 kg nuk provohet e asgjësuar, si rrjedhojë AK nuk merr sigurinë e duhur që shërbimi i kërkuar dhe i paguar gjithashtu është ofruar sipas kushteve të rëna dakord.

Likuiduar me:

- Urdhër shpenzimin Nr. 1082, datë 20.04.2022 për vlerën 188,003.20 lekë, nëpërmjet Banka Kombëtare Tregtare, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” shpk, me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore të lëngëta dhe të ngurta”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 548/2022, datë 03.03.2022, grafiku mujor i evadimit, situacion, informacion dhe deklaratë nga OE;
- Urdhër shpenzimin Nr. 1544, datë 19.05.2022 për vlerën 142,021.60 lekë, nëpërmjet Banka Kombëtare Tregtare, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” shpk, me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore të lëngëta dhe të ngurta”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 794/2022, datë 05.04.2022, grafiku mujor i evadimit, situacion, informacion dhe deklaratë nga OE;
- Urdhër shpenzimin Nr. 1876, datë 16.06.2022 për vlerën 162,974 lekë, nëpërmjet Banka Kombëtare Tregtare, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” shpk, me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore të lëngëta dhe të ngurta”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 1036/2022, datë 12.05.2022, grafiku mujor i evadimit, situacion, informacion dhe deklaratë nga OE;
- Urdhër shpenzimin Nr. 2074, datë 05.07.2022 për vlerën 95,001.20 lekë, nëpërmjet Banka Kombëtare Tregtare, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” shpk, me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore të lëngëta dhe të ngurta”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr.1229/2022, datë 03.06.2022, grafiku mujor i evadimit, situacion, informacion dhe deklaratë nga OE;
- Urdhër shpenzimin Nr. 2286, datë 29.07.2022 për vlerën 211,562.40 lekë, nëpërmjet Banka Kombëtare Tregtare, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” shpk, me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore të lëngëta dhe të ngurta”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 1563/2022, datë 15.06.2022, grafiku mujor i evadimit, situacion, informacion dhe deklaratë nga OE;
- Urdhër shpenzimin Nr. 2286, datë 29.07.2022 për vlerën 211,562.40 lekë, nëpërmjet Banka Kombëtare Tregtare, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” shpk, me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore të lëngëta dhe të ngurta”. Dokumentacion vërtetues: fatura

¹⁶Referuar informacionit nga shiritat e incineratorit

elektronike Nr. 1563/2022, datë 15.06.2022, grafiku mujor i evadimit, situacion, informacion dhe deklaratë nga OE;

- Urdhër shpenzimin Nr. 2675, datë 06.09.2022 për vlerën 112,641.20 lekë, nëpërmjet Banka Kombëtare Tregtare, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” shpk, me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore të lëngëta dhe të ngurta”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 1791/2022, datë 08.08.2022, grafiku mujor i evadimit, situacion, informacion dhe deklaratë nga OE;

- Urdhër shpenzimin Nr. 3096, datë 18.10.2022 për vlerën 112,660.80 lekë, nëpërmjet Banka Kombëtare Tregtare, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” shpk, me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore të lëngëta dhe të ngurta”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 2080/2022, datë 12.09.2022, grafiku mujor i evadimit, situacion, informacion dhe deklaratë nga OE;

- Urdhër shpenzimin Nr. 3294, datë 09.11.2022 për vlerën 103,625.20 lekë, nëpërmjet Banka Kombëtare Tregtare, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” shpk, me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore të lëngëta dhe të ngurta”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 2376/2022, datë 11.10.2022, grafiku mujor i evadimit, situacion, informacion dhe deklaratë nga OE;

- Urdhër shpenzimin Nr. 3576, datë 07.12.2022 për vlerën 54.496 lekë, nëpërmjet Banka Kombëtare Tregtare, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” shpk, me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore të lëngëta dhe të ngurta”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 2713/2022, datë 14.11.2022, grafiku mujor i evadimit, situacion, informacion dhe deklaratë nga OE;

- Urdhër shpenzimin Nr. 3631, datë 12.12.2022 për vlerën 80.674 lekë, nëpërmjet Banka Kombëtare Tregtare, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” shpk, me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore të lëngëta dhe të ngurta”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 2714/2022, datë 14.11.2022, grafiku mujor i evadimit, situacion, informacion dhe deklaratë nga OE;

- Urdhër shpenzimin Nr. 2074, datë 05.07.2022 për vlerën 95,001.20 lekë, nëpërmjet Banka Kombëtare Tregtare, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” shpk, me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore të lëngëta dhe të ngurta”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike nr1229/2022, datë 03.06.2022, grafiku mujor i evadimit, situacion, informacion dhe deklaratë nga OE;

- Urdhër shpenzimin Nr. 4111, datë 30.12.2022 për vlerën 116,110 lekë, nëpërmjet Banka Kombëtare Tregtare, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” shpk, me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore të lëngëta dhe të ngurta”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 2979/2022, datë 10.12.2022, grafiku mujor i evadimit, situacion, informacion dhe deklaratë nga OE.

17. Procedura e prokurimit me objekt “Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19, marrëveshje kuadër me afat 12 muaj”.

Metoda e trajtimit të mbetjeve

QSUNT për të realizuar trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19 ka vendosur që këtë shërbim ta prokurojë. QSUNT ka në pronësi të saj një pajisje “Hidroklavë” me Nr. Serial HSC-091215112, Model H-15, Prodhues Hydroclave Inc., me qëllim trajtimin e mbetjeve. Si rrjedhojë, QSUNT është pajisur me Akt Miratimi, Leje Mjedisi Tipi B, me Nr. identifikimi të lejes 1819, datë 26.03.2015. Bazuar në lejen sipërcituar, QSUNT i është njohur e drejta për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme për vecicenerimit ose lëndfillit. Ndër të tjera, objekt i kësaj leje është edhe asgjësimi i mbetjeve me

kod 18 01 02 (pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut) dhe kod 18 01 03 (Mbetjet grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet).

Me anë të shkresës Nr. 578/65 prot., datë 11.03.2020 QSUNT i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor dhe Institutit të Shëndetit Publik lidhur me mbetjet e spitalore të prodhuara nga rastet e pacientëve me COVID-19, të cilat i ka konsideruar potencialisht të rrezikshme, përkatësisht: Pajisjet personale mbrojtëse (PPE) të stafit që ekspozohet ndaj COVID-19 dhe ambalazhet ushqimore njëpërdorimshme, shishet plastike dhe çdo lloj mbetje tjetër që gjenerohet nga kontakti me pacientin e konfirmuar me COVID-19. Gjithashtu, me anë të kësaj shkrese ka bërë me dije se referuar specifikimeve teknike të aparaturës së trajtimit të mbetjeve (Hidroklavë), që disponojnë nuk është i mundur trajtimi i tyre. Nga auditimi u konstatua se shkresa nuk mbështetej në asnjë relacion që të pasqyronte arsyet e mos realizimit dot të kësaj procedure me anë të Hidroklavës e cila disponohet dhe është në gjendje pune nga QSUNT, edhe pse punonjës të QSUNT deklaruan se Hidroklava ishte testuar për ta kryer këtë proces paraprakisht, por nuk kishte rezultuar e suksesshme (për këtë testim nuk rezultoi i mbajtur asnjë procesverbal).

Në përgjigje të saj, Instituti i Shëndetit Publik, me anë të shkresës 578/67 prot., datë 12.03.2020 ka bërë me dije se trajtimi i këtyre mbetjeve duhet të bëhet me metodën e Hidroklavimit dhe Incinerimit. E iniciuar nga informacioni i përcjellë nga QSUNT, se bazuar në specifikimet teknike të Hidroklavës që disponohet nga QSUNT, nuk është i mundur trajtimi dhe menaxhimi i tyre, sugjeron që këto mbetje duhet të trajtohen me incinerim dhe kuadrit ligjor që rregullon këtë proces (rekomandimet e O.), ISHP orienton QSUNT drejt përdorimit të Hidroklavës dhe në pamundësi të përdorimit të saj drejt Incinerimit, pra nënkupton që mjafton një prej metodave dhe jo detyrimisht të dyja.

Mbështetur në sa mësipërm, si dhe referuar informacionit të përfituar nga regjistri i mirëmbajtjes se pajisjeve mjekësore nga shërbimi i ofruar nga OE “M.”, rezultoi se pajisja Hidroklavë me Nr. Serial HSC-091215112 nuk ka shfaqur asnjëherë problematika përgjatë vitit 2022 dhe ka rezultuar në gjendje normale pune në përputhje me rekomandimet e prodhuesit. Procesverbalet për mirëmbajtjen funksionale janë firmosur nga përfaqësues të OE dhe Përgjegjësi i Sektorit Teknik pranë QSUNT.

Si rrjedhojë, ndodhur në kushtet e mësipërme QSUNT i kishte të gjitha mundësitë për ta kryer procesin me anë të Hidroklavës që disponon dhe të mos vijonte procedurat e prokurimit, e cila i ka kushtuar në total 2.678.780 lekë (hidroklavë dhe incinerim).

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19, marrëveshje kuadër me afat 12 muaj”		
1.Urdhër prokurimi Nr. 2495 prot., datë 29.09.2021.	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr.200/27 prot., datë 20.08.2021 M.H.-specialiste/ sektori i monitorimit të shërbimeve të kontraktuara E.K.-ekonomist/PAI Polivalent M.M.-specialist/sektori i prokurimeve	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.2495/1 prot., datë 29.09.2021 L.S.- specilaiste/ sektori i monitorimit të shërbimeve të kontraktuara H.C.-specialist/sektori i prokurimeve H.C.-specialist/sektori i financës
2.Lloji i procedurës “Procedurë e hapur e thjeshtuar – Marrëveshje Kuadër”	3/1. Hartuesi i termave të referencës Urdhër Nr. 382/1, datë 20.08.2021 B.S.-Përgjegjëse/sektori i monitorimit të shërbimeve të kontraktuara	

	M.H.-specilaiste/ sektori i monitorimit të shërbimeve të kontraktuara M.A.-specialiste/sektori i financës A.H.-specialiste higjene/sektori i kontrollit të infeksioneve spitalore M.M.-specialist/sektori i prokurimeve	
5.Fondi limit (pa tvsh) 9,811,200 lekë	6.Oferta Fituese (pa tvsh) 7,592,000 lekë (78%)	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,219,200 lekë
8.Data e hapjes së tenderit: 30.11.2021	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatoret Ekonomike Pjesëmarrës në tender: 3 OE Skualifikuar 0 OE Kualifikuar 3 OE
11. Ankimime AK- s'ka; KPP- s'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigje Ankesës nga KKP
b. Zbatimi i Kontratës		
14. Lidhja e kontratës M.K Nr. 145/29 prot., datë 19.10.2022 K.SH 1, Nr.145/8 prot., datë 19.01.2022 K.SH 2, Nr.145/18 prot., datë 19.05.2022 K.SH 3, Nr.145/26 prot., datë 12.09.2022 K.SH 4, Nr.145/33 prot., datë 01.11.2022	15. Vlera e kontratës (pa tvsh) 7,592,000 lekë	
16.Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli Nr.2093, dt.. 07.07.2022 -Vlera me tvsh134,441 lekë -Vlera pa tvsh112,034 lekë Nr.1875, dt.. 16.06.2022 -Vlera me tvsh380,266 lekë -Vlera pa tvsh316,884 lekë Nr.1029, dt.. 15.04.2022 -Vlera me tvsh331,469 lekë -Vlera pa tvsh276,224 lekë Nr.1034, dt.. 19.04.2022 -Vlera me tvsh336,038 lekë -Vlera pa tvsh280,032 lekë Nr.1545, dt.. 19.05.2022 -Vlera me tvsh328,037 lekë -Vlera pa tvsh273,364 lekë Nr.3483, dt.. 30.11.2022 -Vlera me tvsh89,950 lekë -Vlera pa tvsh74,959 lekë Nr.2423, dt.. 16.08.2022 -Vlera me tvsh267,041 lekë -Vlera pa tvsh222,534 lekë Nr.2112, dt.. 12.07.2022 -Vlera me tvsh115,066 lekë -Vlera pa tvsh95,884 lekë Nr.2673, dt.. 06.09.2022 -Vlera me tvsh220,085 lekë -Vlera pa tvsh183,404 lekë Nr.3097, dt.. 18.10.2022 -Vlera me tvsh282,922 lekë -Vlera pa tvsh235,769 lekë Nr.3577, dt. 07.12.2022 -Vlera me tvsh194,064 lekë -Vlera pa tvsh161,720 lekë Nr.3484, dt.. 30.11.2022 -Vlera me tvsh125,143 lekë	17.Afati i kontratës në ditë Parashikuar 120 ditë	

<p>-Vlera pa tvsh 104,286 lekë Nr.3484, dt.. 30.11.2022</p> <p>-Vlera me tvsh 125,143 lekë</p> <p>-Vlera pa tvsh 104,286 lekë Nr.4113, dt.. 30.12.2022</p> <p>-Vlera me tvsh 263,203 lekë</p> <p>-Vlera pa tvsh 219,336 lekë</p>	
--	--

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij shpenzimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit me vlerë 7,592,000 lekë.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Me shkresën Nr.200/33 prot., datë 17.09.2021, Zv. Drejtori i Përgjithshëm, i drejtohet Drejtorisë Juridike, duke i kërkuar hapjen e procedurës së prokurimit “Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19, marrëveshje kuadër me afat 12 muaj” marrëveshje kuadër me afat 12 muaj, me fond limit 9,811,200 lekë pa tvsh, bazuar në relacionin Nr. 200/32 prot., datë 30.08.2021 për argumentimin e fondit limit dhe specifikimet teknike. Me shkresën Nr. 200/34 prot., datë 27.09.2021 nga Drejtoria Juridike, drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar kërkohet akordim fondi për procedurën e prokurimit me vlerë 9,811,200 lekë, miratuar nga Drejtori Ekonomik dhe pranuar nga Shefi i Sektorit të Planifikimit Buxhetor.

Në zbatim të urdhrin të brendshëm Nr.382/1, datë 20.08.2021 “Për një ndryshim në urdhrin Nr. 382 Prot., datë 12.08.2021, për ngritjen e komisionit për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën me objekt “Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me COVID 19, marrëveshje kuadër me afat 12 muaj”, është përcaktuar komisioni, me anë të relacionit Nr. 200/32 prot., datë 30.08.2021, drejtuar Titullarit të AK, ka paraqitur argumentimin e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19, marrëveshje kuadër me afat 12 muaj”. Grupi i punës për përlllogaritjen e fondit limit është bazuar tek kontrata e ngjashme me Nr. 200/122 prot., datë 09.07.2021 dhe gjithashtu ka parashikuar sasinë totale prej 29.200 kg që nevojiten të trajtohen. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konstatohet se në DST (Shtojcë për ndryshime në DST) është kërkuar:

Leje Mjedisore Tipi B (Kodi III.1.B) ku të ketë të përfshirë metodën e **Autoklavimit / Hidroklavimit**, për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore, ose stacion transferimi mbetjesh në rastin kur OE/BOE deklaron se këto mbetje do të transferohen/asgjësohen jashtë territorit të RSHM.

dhe/ose

Leje Mjedisore të Tipit A (Kodi III.1.C) ku të ketë të përfshirë metodën e **Inceneratorit**, për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore ose stacion transferimi mbetjesh në rastin kur OE/BOE deklaron se këto mbetje do të transferohen/asgjësohen jashtë territorit të RSHM.

Gjatë hartimit të kriterëve të kualifikimit AK sqaron në procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim se: “...ka marrë për bazë shkresën e ISHP, e cila i ka drejtuar që trajtimi dhe asgjësimi të kryhet me metodën e Hidroklavës/Autoklavës dhe Incinerimit...”. Edhe pse është bazuar në këtë shkresë, ka kërkuar që OE ti paraqesë të dyja Lejet ose njëren prej tyre, pra duke e lënë në diskrecion të OE. Ndërkohë që meqenëse OE kërkon të kryhen të dyja proceset pra hidroklave/autoklavë dhe incenerim, referuar kuadrin ligjor në fuqi detyrimisht të dyja OE duhet të jetë i pajisur me të dyja

lejet për kodin përkatës 18 01 02. Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të QSUNT me Nr. 3215 prot., datë 23.12.2021, është përcaktuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me fond limit 1,980,000 lekë, si dhe gjithashtu është ngritur njësi e prokurimit. Sipas raportit përmbledhës Nr. 2495/8 prot., të datës 28.12.2021, si dhe sistemit elektronik të APP, konstatohet se në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 3 (tre) operator ekonomik “V.A.L.E. R.” sh.p.k., me ofertë në vlerë 7,592,000 lekë pa TVSH, dhe “E.R.” sh.p.k., me ofertë me vlerë 9,168,800 lekë pa TVSH dhe “M.-T.” sh.p.k., me ofertë me vlerë 10,161,600 lekë pa TVSH.

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik “V.A.L.E. R.” sh.p.k., me ofertë në vlerë 7,592,000 lekë pa TVSH. Në vijim është lidhur marrëveshja kuadër me Nr. 145 prot., datë 10.01.2022, ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga zj. A.F., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “V.A.L.E. R.” sh.p.k. në vlerën 7,592,000 lekë pa TVSh, kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër është me afat 12 (dymbëdhjetë) muaj, me datë fillimi nënshkrimin e saj. Gjatë shqyrtimit të dokumenteve të depozituar nga OE fitues rezulton se në Lejen e Mjedisit tipi B, me Nr. identifikimi 1780/3, datë 06.04.2021 nuk e ka të drejtën e asgjësimit/trajtimit të mbetjeve me kod 18 01 02 (referuar tabelës 8.1.2). Referuar mungesës së Lejes për trajtimin e mbetjeve me kod 18 01 02 me hidrokalvë/autoklavë, si dhe në mbështetje të faktit se OE nuk ka përcjellë asnjë dokument vërtetues se janë kryer të dyja proceset (printim gjatë procesit të punës me hidrokalvë/autoklavë dhe incenerim), konsiderohet se procesi i hidrokalvës nuk kryhet nga ana e OE, edhe pse QSUNT e paguan si shpenzim të plotë.

Zbatimi i kontratës

Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar, dokumentacioni që shërben për shlyerjen e faturës dhe që i bashkëlidhet urdhër shpenzimeve përkatëse janë situacioni, grafiku mujor i evadimit, informacion mbi realizimin e trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve konform kushteve të kontratës dhe deklaratë magazinimi.

Në të gjitha deklaratat e magazinimit, OE shprehet se “Referuar pikës 1.5.29, të Lejes Mjedisore ... mbetjet do të asgjësohen pranë subjekteve të licencuara sipas kontratës së lidhur me shoqërinë B.A.”. Në kuptim të sa mësipër, asgjësimi i hirit do të kryhet nga shoqëria B.A.

OE, në zbatim të pikës 12, të termave të referencës DST, sipas së cilës “O.E duhet të dorëzojë mbetjet e dala nga përpunimi, në një subjekt të licencuar për depozitimin e hirit” ka paraqitur pranë AK Kontratë transferimi, rekuperimi dhe/ose asgjësimi të mbetjeve të lidhur ndërmjet “V.A.L.E.R.” shpk dhe “B.” Srl. Për të cilën ka përcjellë dhe dokumentacionin provues që vërteton se subjekti është i licencuar për të trajtuar produktin e dal nga incenerimi (hi) dhe në vijim nuk ka përcjellë asnjë dokument tjetër justifikues (kontratë, licencë) për marrëdhënien e krijuar me shoqërinë Ambiente. Si rezultat është e paqartë ecuria e procesit të hirit të krijuar, nëse ai dorëzohet pranë një subjekti të licencuar për ta trajtuar apo jo.

Në kuptim të marrëveshjes kuadër Nr. 145 Prot., datë 10.01.2022 të lidhur ndërmjet AK dhe OE, si dhe të prezantimit të ofertës ekonomike të Operatorit Ekonomik, në çmim është përfshirë mbulimi i shpenzimeve për transport, ruajtje, përpunim dhe asgjësim të mbetjeve, në përputhje me nenin 10, ligji Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”. Me urdhër Nr. 2495/1 prot., datë 29.09.2021 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO). Konstatohet se Certifikatat ISO të lëshuara në favor të OE, nga K.C.I.C.Ltd, janë të vlefshme për një periudhë 3-vjecare, por me kusht nëse ky sistem është mirëmbajtur në mënyrë efektive dhe të jenë kryer auditime mbikëqyrëse. Nga ana e AK nuk figuron e dokumentuar

konfirmimi nëse këto certifikata ishin apo jo te vlefshme në momentin e kualifikimit si OE fitues.

Likujduar me:

- Urdhër shpenzimin Nr.4113, datë 30.12.2022 për vlerën 263,203 lekë, nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, pacient me covid 19”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 2974/2022, datë 10.12.2022, procesverbal, situacion, konfirmim nga OE;
- Urdhër shpenzimin Nr.3577, datë 07.12.2022 për vlerën 194,064 lekë, nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, pacient me covid 19”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 2712/2022, datë 14.11.2022, procesverbal, situacion, konfirmim nga OE;
- Urdhër shpenzimin Nr.3484, datë 30.11.2022 për vlerën 125,143 lekë, nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, pacient me covid 19”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 2595/2022, datë 07.11.2022, procesverbal, situacion, konfirmim nga OE;
- Urdhër shpenzimin Nr.3483, datë 30.11.2022 për vlerën 89,950 lekë, nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, pacient me covid 19”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 2594/2022, datë 07.11.2022, procesverbal, situacion, konfirmim nga OE;
- Urdhër shpenzimin Nr.2423, datë 16.08.2022 për vlerën 267,041 lekë, nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, pacient me covid 19”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 1555/2022, datë 11.07.2022, procesverbal, situacion, konfirmim nga OE;
- Urdhër shpenzimin Nr.2112, datë 12.07.2022 për vlerën 115,066 lekë, nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, pacient me covid 19”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 1285/2022, datë 09.06.2022, procesverbal, situacion, konfirmim nga OE;
- Urdhër shpenzimin Nr.2673, datë 06.09.2022 për vlerën 220,085 lekë, nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, pacient me covid 19”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 1790/2022, datë 08.08.2022, procesverbal, situacion, konfirmim nga OE;
- Urdhër shpenzimin Nr.3097, datë 18.10.2022 për vlerën 282,922 lekë, nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, pacient me covid 19”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 2079/2022, datë 12.09.2022, procesverbal, situacion, konfirmim nga OE;
- Urdhër shpenzimin Nr.2093, datë 07.07.2022 për vlerën 134,441 lekë, nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, pacient me covid 19”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 1284/2022, datë 09.06.2022, procesverbal, situacion, konfirmim nga OE;
- Urdhër shpenzimin Nr.1875, datë 16.06.2022 për vlerën 380,266 lekë, nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, pacient me covid 19”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 1035/2022, datë 12.05.2022, procesverbal, situacion, konfirmim nga OE;
- Urdhër shpenzimin Nr.1029, datë 15.04.2022 për vlerën 331,469 lekë, nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, pacient me covid 19”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 345/2022, datë 07.02.2022, procesverbal, situacion, konfirmim nga OE;

- Urdhër shpenzimin Nr.1034, datë 19.04.2022 për vlerën 366,038 lekë, nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, pacient me covid 19”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 547/2022, datë 03.03.2022, procesverbal, situacion, konfirmim nga OE;

- Urdhër shpenzimin Nr.1545, datë 19.05.2022 për vlerën 328,037 lekë, nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria “V.A.L.E. R.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, pacient me covid 19”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike Nr. 795/2022, datë 05.04.2022, procesverbal, situacion, konfirmim nga OE.

Në procedurat e prokurimit me objekt: Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta, për QSUNT për vitin 2021 dhe 2022, si dhe trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19, janë konstatuar edhe problematikat si më poshtë vijon:

1. Lidhur me përcaktimin e specifikimeve teknike të cilat janë reflektuar edhe në DST, për të treja procedurat konstatohet në mbështetje të parashikimeve të kuadrit ligjor që rregullon procedurën e prokurimit publik, sipas së cilit kriteret e vendosura nga OE duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe në mbështetje të kuadrit ligjor rregullator të asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme, për realizimin e kësaj procedure duhet të ishin vendosur edhe kriteret tjerë kualifikuese. Gjithashtu, duke pasur në vëmendje pasojat që rrjedhin nga mos realizimi i këtij procesi në mënyrë të rregullt, si dhe cilësinë e QSUNT e cila në këtë proces është në cilësinë e prodhuesit të mbetjeve spitalore dhe si rrjedhojë është përgjegjëse për të gjithat dëmet që shkaktohen në mjedis dhe në shëndetin publik nga të gjitha hallkat e procesit deri në asgjësim të mbetjeve duhet të ishin vendosur gjithashtu edhe kriteret:

Në rast të transportit brenda vendit, Operatori duhet të paraqesë **Certifikatën e miratimit për mjetet (vetëm për brenda vendit) që transportojnë disa mallra të rrezikshme**. Detyrim që buron nga pika 9.7, udhëzim Nr. 6, datë 27.5.2015 “Për procedurat e inspektimit të mjeteve, lëshimit të certifikatës së miratimit ADR, kushtet që duhet të plotësojë personi juridik për inspektimin e mjeteve ADR dhe tarifën e shërbimit” (**konstatuar vetëm në procedurën e vitit 2022 dhe asgjësimi i mbetjeve ku marrin trajtim pacientët me Covid-19**);

Për mjetin e transportit duhet të ishte kërkuar gjithashtu vërtetim se mjeteve është regjistruar në Ministri për kryerjen e transportit të mbetjeve të rrezikshme, bazuar në kërkesat sipas shkronjës c), pika 5, neni 10, Ligji 9537, datë 18.05.2006 “Mbi administrimin e mbetjeve të rrezikshme”;

Operatorit duhet ti ishte kërkuar të paraqiste Akt Miratimi Higjieno – Sanitar, të lëshuar nga Inspektorati Shëndetësor Shtetëror (ISHSH), detyrim që buron nga pika 10.3, kreu IV, VKM Nr.798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore";

Duhet të ishte kërkuar që personeli i përfshirë në ngarkimin e koshave/ kontejnerëve transit duhet të jetë kompetent dhe i trajnuar siç duhet, detyrim që buron nga pika 9.3.2 e Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurtë të Mbetjeve;

Duhet të ishte kërkuar se O.E duhet të dorëzojë mjetet e dala nga përpunimi, në një subjekt të licencuar për depozitimin e hirit, detyrim që buron nga neni 21 të ligjit Nr. 9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (**konstatuar vetëm në procedurën e vitit 2021**).

Veprime në kundërshtim me pikën 2, 3 dhe 4, neni 21, ligji Nr. 10 463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, sipas së cilit “*Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton kushtet e përgjegjësisë dhe specifikon se në cilat raste krijuesi fillestar mban përgjegjësi për të gjithë zinxhirin e trajtimit dhe në cilat raste përgjegjësia ndahet mes tij dhe zotëruesit të mbetjeve apo u delegohet aktoreve të ndryshëm të zinxhirit të trajtimit.*

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton rrethanat në të cilat përgjegjësia për organizimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve mbartet, plotësisht apo pjesërisht, nga prodhuesi i produktit që krijon mbetjet dhe rrethanat kur këto përgjegjësi mund të ndahen me shpërndarësit e këtij produkti. Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve, që transferon mbetjet të një tregtar ose person që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, nuk çlirohet nga përgjegjësia për operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit të tyre”. Si dhe në kundërshtim me shkronjën e), pika 5, kreu II, VKM 798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores ”Për administrimin e mbetjeve spitalore””, sipas së cilit “Prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për të gjitha dëmet e shkaktuara në mënyrë direkte ose indirekte në mjedis dhe në shëndetin publik nga procesi i grumbullimit, magazinimit, transportimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore të krijuara prej tyre”.

3.Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për të treja procedurat konstatohet se nuk argumentohet kërkesa e AK për instalimin e një frigoriferi me të dhëna: kapacitet 200-250 kg, temperaturë ngrirje deri në minus -18 gradë celsius. Instalimi i një frigoriferi është detyrim ligjor që rrjedh nga pika 10.2.15, rregullorja “Mbi administrimin e mbetjeve spitalore në QSUNT”, por kjo rregullore nuk ka përcaktuar temperaturën e frigoriferit apo kapacitetin mbajtës, si rrjedhë ky kriter konsiderohet i paargumentuar. Veprim në kundërshtim me pikën 2, neni 78, VKM 285/2020, e cila parashikon se “*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar...*”.

4.Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezultoi se QSUNT, në cilësinë e prodhuesit të mbetjeve të rrezikshme nuk ka marrë asnjë masë për të hartuar një program për uljen e vëllimit, të sasive dhe toksicitetit të mbetjeve të rrezikshme, në kundërshtim me shkronjën a), pika 3, neni 7, ligji Nr. 9537, 18.05.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”, i cili parashikon se “*Çdo prodhues brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e planit kombëtar për administrimin e mbetjeve të rrezikshme dhe në përputhje me të, harton dhe zbaton një program të shkruar për uljen e vëllimit, të sasisë dhe toksicitetit të mbetjeve të rrezikshme.*”.

5. Gjithashtu, rezultoi se nga ana e QSUNT nuk është marrë asnjë masë për ngritjen e grupit të administrimit të mbajtjeve spitalore (GAMS), duke ndikuar kryesisht në monitorimin e zbatimit të Planit të Administrimit të Mbetjeve Spitalore, në kundërshtim me nënpikën 10.2.3, pika 10.2.2. e rregullores “Mbi administrimin e mbetjeve spitalor”.

6.Rakordimi ndërmjet regjistrimit të mbetjeve dhe sasisë së trajtuar nga OE: Në zbatim të Urdhrit Nr. 40, datë 13.02.2014 “Për ndarjen e mbetjeve spitalore në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza””, protokolluar me Nr. 699 Prot., datë 13.02.2014, i gjithë personeli infermier është përgjegjës për garantimin e ndarjes, manipulimit dhe trajtimit përfundimtar të mbetjeve të rrezikshme spitalore të gjeneruara si rezultat i trajtimit të pacientëve, në përputhje me legjislacionin kombëtar. Gjithashtu, pika 4 e këtij urdhri ka parashikuar se duhet të evidentohet dhe dokumentohet lloji dhe sasia e mbetjeve të dorëzuara në procesverbalet përkatëse, firmosur nga dërguesi dhe pritësi. Në vijim të urdhrit sipërcituar, Drejtoresha e Burimeve Njerëzore me anë të njoftimit Nr. 358 prot., datë 15.01.2018 i ka ri sjellë edhe njëherë në vëmendje kryeinfermierëve të shërbimeve mjekësore dhe administratorëve spitalorë pasojat administrative dhe penale që mbart moszbatimi i urdhrit sipërcituar. Në cilësinë e strukturës përgjegjëse për ndarjen dhe dorëzimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme, ju kërkua kryeinfermierëve përgjegjës për mbetjet e rrezikshme, vënia në dispozicion të dokumentacionit provues se si mbetjet e

rrezikshme dorëzohen pranë magazinës së QSUNT, përpara peshimit nga grupi i punës dhe marrja nga OE për trajtim. Dorëzimi i mbetjeve në magazinë për të treja procedurat kryhej me anë të regjistrave, në pjesën më të madhe të cilëve **nuk plotësohej origjina e mbetjeve, lloji i materialit dhe sasia në kg e mbetjeve**, veprime në kundërshtim me urdhrin Nr. 40/2014. Duke mos u pasqyruar në formën e kërkuar, bëhet i pamundur rakordimi ndërmjet peshës së dorëzuar nga secili shërbim dhe peshës së dorëzuar operatorit ekonomik.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre, nuk kanë maksimalizuar plotësisht eficientën dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, veprim në kundërshtim me nenin 2, nenin 8 dhe nenin 52, të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Pikën 5, Neni 21, Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

18. Procedura e prokurimit me objekt: “Sigurimi i ageve të skleroterapisë për trajtimin e pacientëve me hemorragji digjестive dhe ageve të biopsisë për diagnozën e pacientëve me patologji të traktit tretës, si dhe materiale mjekësore për endoskopi”

Të dhëna mbi objektin e prokurimit

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit		
1. Urdhër Prokurimi Nr.66, datë 06.01.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr.66, datë 06.01.2021 J.S.(specialiste ekonomiste inventarizuese PAI Spitali Onkologjik) Xh.Z.(farmaciste në drejtorinë e shërbimit farmaceutik) F.C. (specialiste në sektorin e prokurimeve /juriste) 3/1. Hartuesi i termave të referencës Urdhër Nr. 311, dt..15.09.2020, i ndryshuar A.B.(shef i shërbimit të gastro-hepatologjisë) Xh.Z.(farmaciste në drejtorinë e shërbimit farmaceutik) R.G.(specislist në sektorin ligjor)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 66/1 dt.. 06.01.2021 E.B. (përgjegjës i farmacisë qëndrore/farmaciste) B.L. (specialist në sektorin e prokurimeve) M.A. (specialiste në sektorin e financës dhe kontabilitetit /ekonomiste)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur- Marrëveshje kuadër me nje operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 18,796,810 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 17,472,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,324,810 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 04.02.2021, ndryshuar	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër3 OE b) Kualifikuar1 OE c) S’kualifikuar 2 OE
11. Ankimime OE “M.” sh.p.k Drejtuar AK :Shkresa Nr. 334 prot., datë 18.01.2021 Drejtuar KPP :Formulari i ankesës administruar në QSUNT Nr.334/5 prot., dt. 05.02.2021	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa Nr. 334/5 prot., datë 04.02.2021	13. Përgjigje Ankesës nga KKP Vendim K.P.P 100/2021 dt. 19.02.2021
b. Zbatimi i Kontratës Mallrave		
14. Lidhja e kontratës M.K Nr.66/15 prot., dt. 27.04.2021 K.F Nr.1 – Nr.66/20 prot., dt..25.05.2021 K.F Nr.2 – Nr.384/6 prot., dt. 21.02.2022	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 22,381,204 lekë - 8,954,976 lekë - 13,421,880 lekë	

<p>17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli *K.F Nr.1 – Nr.66/20 prot., dt..25.05.2021 Nr. 1367, dt. 25.06.2021 -Vlera me tvsh 5,573,976 lekë -Vlera pa tvsh 4,644,980 lekë Nr.1438, 06.07.2021 -Vlera me tvsh 2,931,360 lekë -Vlera pa tvsh 2,442,800 lekë Nr.2167, 22.09.2021 -Vlera me tvsh 371,520 lekë -Vlera pa tvsh 309,600 lekë Nr.1763, 04.08.2021 -Vlera me tvsh 78,120 lekë -Vlera pa tvsh 65,100 lekë</p> <p>*K.F Nr.2 – Nr.384/6 prot., dt..21.02.2022 Nr. 1096, dt. 21.04.2022 -Vlera me tvsh 1,329,384 lekë -Vlera pa tvsh 1,107,820 lekë Nr. 1141, dt. 22.04.2022 -Vlera me tvsh 10,995,096 lekë -Vlera pa tvsh 9,298,580 lekë Nr. 1145, dt. 22.04.2022 -Vlera me tvsh 880,800 lekë -Vlera pa tvsh 734,000 lekë Nr. 2036, dt. 04.07.2022 -Vlera me tvsh 216,600 lekë -Vlera pa tvsh 180,500 lekë</p>	<p>18. Afati i kontratës në ditë Parashikuar 123 ditë\Zbatuar 120 ditë¹⁷</p> <p>Parashikuar 120 ditë\Zbatuar 135 ditë¹⁸</p>
--	---

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Hartimi i dokumenteve të tenderit

-Në hartimin e nevojave për age ose e materialeve mjekësore për endoskopi, nga Shërbimi i Kirurgjisë së Përgjithshme dhe nga Shërbimi i Gastro-Entero-Hepatologjis, nuk shprehet qartë se sa është sasia e nevojshme për zhvillimin e procedurës së prokurimit.

Farmacia qendrore nga informacioni i kërkuar konfirmon se gjendja ka qenë “0” por nuk është evidentuar se për cilën kategori nga këto materiale mjekësore, e po ashtu nuk dihet numri i daljeve të materialeve mjekësore që ka bërë për shërbimin e kirurgjisë së përgjithshme dhe shërbimin e gastro-entero-hepatologjisë, me qëllim planifikimin e saktë të nevojave.

-Me anë të Urdhër Prokurimit Nr.66 prot., datë 06.01.2021, titullari i AK ka urdhëruar nisjen e procedurës me objekt “*Sigurimi i ageve të skleroterapisë për trajtimin e pacientëve me hemorragji digjестive dhe ageve të biopsisë për diagnozën e pacientëve me patologji të traktit tretës, si edhe materiale mjekësore për endoskopi*” për vitin 2020-2021. Me Procesverbalin e datës 11.01.2021, NJP ka miratuar Dokumentet e Tenderit. Në datë 18.01.2021 pezullohet procedura e prokurimit për shkak të shqyrtimit të një ankese të administruar për kriteret e DST. Pas shqyrtimit të ankesës dhe vendimit të KPP me Nr.100/1 prot., datë 19.02.2021, u vendos të mos pranohet ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik “M.” sh.p.k si dhe AK i lejohet të vijojë me hapat e tjerë, ku hiqet pezullimi i procedurës si dhe ndryshon afatin për dorëzimin e ofertave me datë 16.03.2021, ora 10:00.

¹⁷Zbatimi i kontratës konsiderohet data e dorëzimit të të gjithë mallit të plotë.

¹⁸Zbatimi i kontratës konsiderohet data e dorëzimit të të gjithë mallit të plotë.

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në datën e hapjes së ofertave, konstatohet se ka paraqitur ofertë:

OE "O.D." sh.p.k me ofertë ekonomike me vlerë 17,472,000 lekë pa tvsh.

OE "B.A." sh.p.k, pa dokumentacion teknik e ligjor dhe pa ofertë ekonomike.

OE "M." sh.p.k pa dokumentacion teknik e ligjor dhe pa ofertë ekonomike.

KVO kualifikon vetëm ofertën e "O.D." sh.p.k si të vlefshme pjesëmarrëse dhe shpall fituese ofertën e OE "O.D." Shpk me ofertë ekonomike me vlerë 17,472,000 lekë pa tvsh.

- Në këtë procedurë është tejkaluar afati i vlerësimit të ofertave deri në njoftimin e fituesit. Dorëzimi i ofertave nga OE është bërë në datë 12.01.2021, ndërkohë që njoftimi i fituesit është bërë në datë 20.04.2021. Vlerësimi i ofertave nuk duhet të kalojë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla.

KVO dërgon procesverbalin për shtyrje afati ku citon se: duke qene se anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave janë të angazhuara edhe në detyra të tjera institucionale, korrespondencave të nevojshme për vlerësimin e kësaj procedurë.

Por ndërkohe ligji nuk e parashikon shtyrjen e afati për shkak të detyrave të tjera funksionale që kanë anëtarët e KVO.

-Marrëveshja Kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara Nr. 66/15, datë 27.04.2021, me shumatore çmimesh për njësi në vlerën 4,301,650 lekë me tvsh, me afat 12 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes, është nënshkruar nga titullari i AK. Në zbatim të kësaj marrëveshje kuadër, janë nënshkruar kontratat e furnizimit si më poshtë. Kontrata e Furnizimit Nr.1, nr 66/20 prot., datë 25.05.2021, me vlerë 7,462,480 lekë pa tvsh, me afat 4 muaj nga nënshkrimi i kontratës. Formulari i sigurimit të kontratës Nr. 0016243, datë 24.05.2021, me vlerë 895,498.00 lekë.

Likuiduar me:

Urdhër shpenzimi Nr. 1367, dt. 25.06.2021

-Vlera me tvsh 5,573,976 lekë

-Vlera pa tvsh 4,644,980 lekë

Urdhër shpenzimi Nr.1438, 06.07.2021

-Vlera me tvsh 2,931,360 lekë

-Vlera pa tvsh 2,442,800 lekë

Urdhër shpenzimi Nr.2167, 22.09.2021

-Vlera me tvsh 371,520 lekë

-Vlera pa tvsh 309,600 lekë

Urdhër shpenzimi Nr.1763, 04.08.2021

-Vlera me tvsh 78,120 lekë

-Vlera pa tvsh 65,100 lekë

Kontrata e Furnizimit Nr.2, Nr.384/20 prot., datë 21.02.2022, me vlerë 11,320,900 lekë pa tvsh, me afat 4 muaj nga nënshkrimi i kontratës. Formulari i sigurimit të kontratës Nr. 00174500, datë 16.02.2022, me vlerë 1,342,188.00 lekë.

Likuiduar me:

Urdhër shpenzimi Nr. 1096, dt. 21.04.2022

-Vlera me tvsh 1,329,384 lekë

-Vlera pa tvsh 1,107,820 lekë

Urdhër shpenzimi Nr. 1141, dt. 22.04.2022

-Vlera me tvsh 10,995,096 lekë

-Vlera pa tvsh 9,298,580 lekë

Urdhër shpenzimi Nr. 1145, dt. 22.04.2022

- Vlera me tvsh 880,800 lekë
- Vlera pa tvsh 734,000 lekë
- Urdhër shpenzimi Nr. 2036, dt. 04.07.2022
- Vlera me tvsh 216,600 lekë
- Vlera pa tvsh 180,500 lekë.

Marrja në dorëzim e materialeve mjekësore është bërë sipas kushteve të kontratës dhe brenda afateve të përcaktuara.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi komisioni i vlerësimit të ofertave: E.B. B.L. dhe M.A.

19.Procedura e prokurimit me objekt: “Furnizim Vendosije X-Ray Tube për rikthimin në gjendje të plotë funksionale të pajisjes mjekësore Skaner CT Brightspeed 16 slice prodhues GE ose ekuivalent, për nevoja emergjente në Urgjencën Covid dhe Furnizim Vendosije modul detektorit për rikthimin në gjendje të plotë funksionale të pajisjes mjekësore Skaner CT Lightspeed 64 slc prodhues GE ose ekuivalent”, të ndarë në lote.

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 200, datë 06.06.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 200, datë 06.06.2022 B.M. (Drejtori i IT dhe Inxhinierisë Klinike/Inxhinier) E.K. (Përgjegjës i sektorit të Inxhinierisë Klinike/Inxhinier) D.V. (specialist në sektorin e prokurimeve/jurist)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.201 dt.. 06.06.2022, i ndryshuar N.S. (zv.drejtor i përgjithshëm/ farmacist) T.H. (sektori i prokurimeve/ jurist) E.B. (sektori i inxhinierisë klinike/inxhinier)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur – prokurim me mjete elektronike”	3/1. Hartuesi i termave të referencës Urdhër Nr.129 dt.. 25.03.2022, i ndryshuar B.M. (Drejtori i IT dhe Inxhinierisë Klinike/Inxhinier) E.K. (sektori i inxhinierisë klinike) I.H. (sektori i inxhinierisë klinike) K.L. (sektori juridik/drejtoria juridike) S.S. (ekonomiste/PAI Infektiv).	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 11,543,333.34 lekë Loti 1 – 6,846,666.67 lekë Loti 2 -4,696,666.67 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) Loti 1 - 6,846,600 lekë Loti 2 - 4,696,600 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) Loti 1 – 66 lekë Loti 2 – 66 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 06.07.2022	9.Burimi Financimit Të ardhurat dytësore	10. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër1 OE b) Kualifikuar1 OE
11. Ankimime AK- s’ka; KPP- s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigjenga KPP
b. Zbatimi i Kontratës Mallrave		
14. Lidhja e kontratës K.F Nr.1655/10 prot., dt.. 27.07.2022 K.F Nr.1655/11 prot., dt.. 27.07.2022	15. Vlera e kontratës (me tvsh) Vlera e kontratës (me tvsh) 8,215,920 lekë Vlera e kontratës (me tvsh) 5,635,920 lekë	
17-Situacioni	18.Afati i kontratës në ditë	

Përfundimtar/Faturë Malli *K.F Nr.1655/10 prot., dt. 27.07.2022 Nr. 2655, dt. 02.09.2022 -Vlera me tvsh8,215,920lekë -Vlera pa tvsh6,846,600lekë * K.F Nr.1655/11 prot., dt. 27.07.2022 Nr. 2682, dt. 07.09.2022 -Vlera me tvsh5,635,920lekë -Vlera pa tvsh4,696,600 lekë	Parashikuar15 ditë \Zbatuar 9 ditë ¹⁹ Parashikuar15 ditë \Zbatuar 9 ditë ²⁰
--	--

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Indicia/Nevoja për një procedurë prokurimi.

-Në katin 0 të urgjencës kirurgjikale, është njoftuar për mosfunksionim të skanerit (brightspeed 16 slc/Nr.ivn 20250), i cili ka bërë defekt dhe është jashtë funksioni në datën 09.04.2022, ku në datë 18.04.2022 është mbajtur procesverbali i konstatimit të defektit duke cilësuar se pajisja nuk mund të kryej ekzaminime. Po ashtu edhe njoftimi në datë 11.04.2022 për shërbimin e imazherisë (urgjenca) në katin -1 (lightspeed 64 slc), ku njëri nga skanerat ka qenë jashtë shërbimi, është mbajtur një procesverbal në datën 14.04.2022, ku dokumentohet se pajisja nuk është në gjendje pune.

Nga QSUNT, u konstatua se gjendja aktuale e pajisjes nuk mund të kryejë ekzaminime dhe në mënyrë të tillë që të vendoset në gjendje normale pune, ka nevojë që tubi i mbaruar të zëvendësohet me një tub të ri. Ndërkohë për skanerin 64 slc përgjegjës për mosfunksionim është një modul i detektorit përkatësisht ai me numër 20. Në mënyrë të tillë që cilësia e imazhit të rivendoset në kushte normale të punës nevojitet që të paktën ky modul të zëvendësohet.

Operatori ekonomik “M.” sh.p.k që nga fillimi i 2018, është i kontraktuar për mirëmbajtjen e pajisjeve të prodhuesit GE Healthcare. Referuar nga historiku i shërbimit të pajisjes, vetëm në skanerin Brightspeed janë ndryshuar 10 tuba të rrezeve X të konsumuar nga përdorimi, si rrjedhim i numrit të lartë të ekzaminimeve. Në një përlllogaritje të thjeshtë, rezulton që kohëzgjatja mesatare e një tubi me rreze X për këtë sistem është më pak se 5 muaj (4.9 muaj). Kohëzgjatja ka ardhur duke u zvogëluar në vijim nga rritja e ekzaminimeve të kryera përgjatë dy viteve të COVID-19, duke mbërritur në më pak se 4 muaj (3.8 muaj) për një tub.

Gjatë zbatimit të kontratës 11-mujore të shërbimit të mirëmbajtjes me Nr.173/21 prot., filluar kjo në datë 01.02.2021 dhe përfunduar me datë 31.12.2021, janë ndërruar 3 tuba me rreze-x. Këto të dhëna janë marrë nga komunikimi elektronik dhe shkresor mes QSUNT dhe “M.”, por nga dokumentacioni i sjellë shtesë gjatë fazës së observacioni konstatohet se janë ndërruar vetëm 2 tuba me rreze-x nga kontrata 11-mujore e shërbimit të mirëmbajtjes.

- Në gjithë procesverbalet e mbajtur për kontratën e shërbimit Nr.173/21 datë 01.02.2021, mungojnë specifikimet, se cilat janë pjesët e skanerit të cilat janë mirëmbajtur, sipas veçorive që ato kanë, në kundërshtim me kontratën Nr.173/21 datë 01.02.2021, ku detyron që në përfundim të çdo kontrolli duhet të mbahet një raport faktit.

Ndërkohë, nga shqyrtimi i dokumentacionit të marrëveshjes full-risk 11 mujore Nr.173/21, konkretisht të urdhër-shpenzimeve dhe procesverbaleve të mbajtur gjatë kohës së mirëmbajtje, vihet re se në të gjitha procesverbalet citohet i njëjti paragraf “*është kryer mirëmbajtje e pajisjes*”, duke mos zbatuar detyrimet e marrëveshjes kuadër full risk si dhe nuk është ë përcaktuar qartë në shumicën e procesverbaleve se për kë nga skanerat është mbajtur. Në këtë

¹⁹Zbatimi i kontratës konsiderohet data e dorëzimit të të gjithë mallit të plotë.

²⁰Zbatimi i kontratës konsiderohet data e dorëzimit të të gjithë mallit të plotë.

mënyrë nuk mund të evidentohet kur është ndërruar tubi i fundit, ose pjesët e tjera mjekësore të cilat janë mallra konsumi, në kundërshtim dhe neni 124 i LPP. Duke qenë se QSUNT si autoritet kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit

-Me Urdhër shpenzimi Nr.1852, datë 24.08.2021 me vlerë 5,029,781 lekë, është likuiduar fat.73/2021 datë 30.07.2021, e cila i referohet kontratës së shërbimit Nr.173/21 të datës 01.02.2021, pra kontratës 11 mujore të mirëmbajtjes të skanerave GE.

-Situacioni i punimeve dhe procesverbali i mirëmbajtjes funksionale i përkasin kontratës së shërbimit Nr.173/36 , datë 04.02.2021, mirëmbajtje që janë faturuar kontratës së shërbimit të prodhuesve GE, në fakt është bërë për aparataturat EMG të prodhuesit Micromed, pajisjet të Endoskopisë të prodhuesit KARL STORZ, pajisje Fibroscan prodhues ECHOSENS dhe Hidroklave me prodhues Hidroklave, në kundërshtim me pikën 54 të Udhëzimit 30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Ndërkohë që procesverbali bashkëlidhur urdhër shpenzimit i mbajtur nga drejtoria e IT dhe e Inxhinierisë Klinike në datën 28.07.2021 për periudhën 02.04.2021 deri më 01.07.2021 ku shprehet se punimet janë kryer brenda afateve kohore dhe kushteve të kontratës dhe në prani të inxhinierëve të I.K për të 3 skanerat GE, është firmosur nga Drejtori i IT dhe I.K. znj. B.M. dhe përfaqësuesi i “M.”. Veprime të cilat tregojnë se mirëmbajtja e paisjeve nuk bëhet sipas kushteve të kontratës dhe për pajisjet mjekësore të cilat janë të përcaktuara, në kundërshtim me udhëzimin Nr.2 datë 18.03.2022“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Urdhër shpenzimi Nr.1852, datë 24.08.2021 është në kundërshtim me pikën 54 të Udhëzimit 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Ftesa për ofertë e dërguar nga grupi i punës Nr.129/1 për studimin e tregut me Nr.625/17 datë 29.04.2022, ku janë ftuar 13 OE për të dërguar ofertën në lekë (pa TVSH dhe me TVSH) “Për riparimin dhe kthimin në gjendje të plotë funksionale të pajisjes mjekësore skaner CT Brightspeed 16 slc prodhues GE ose ekuivalent, për nevoja emergjente në urgjencën Covid dhe pajisjes mjekësore skaner VCT Lightspeed 64 slc prodhues GE ose ekuivalent, në QSUNT”. Në ftesën për ofertë objekti i kësaj procedure prokurimi ka qenë riparimi dhe kthimi në gjendje pune..., dhe jo objekti i saj furnizim-vendosje ndërkohë që procedura ka vazhduar të zhvillohet për F.V, po ashtu nuk është përcaktuara nëse kjo procedurë do të kryhej e ndarë në lote, duke u bërë shkak për ulje të transparencës dhe barazisë në procedurën e prokurimit.

-Konstatohet se ka një tej zgjatje të procedurës pavarësisht nevojave emergjente, dhe është zgjatur më shumë se 6 muaj. Pra nuk lidhen së bashku nevoja emergjente me tejzgjatjen në kohë.

-Nuk është mbajtur një vendim përsa i përket paqartësisë nëse do të vendoset procedura e prokurimit me dy lote ose jo, pavarësisht se Drejtoria e I.Klinike,ka propozuar të vlerësohet nga Njësia e Prokurimit Publik me anëtarë jurist nëse procedura do të ndahej në dy lote, në kundërshtim me nenin 39, pika 2 e LPP dhe pika 4 e nenit 42 VKM 285.

-Për këtë procedurë prokurimi janë lidhur për secilën nga lotet nga një kontratë furnizimi. Për lotin 1 është lidhur kontrata e furnizimit me Nr.1655/10 prot., datë 27.07.2022 “Furnizim Vendosje X-Ray Tube për Skaner CT Brightspeed 16 slc prodhues GE ose ekuivalent” me vlerë totale 6,846,600 lekë pa tvsh dhe 8,215,920 lekë me tvsh.

Kontrata e furnizimit për lotin 2 është lidhur po në 27.07.2022 me Nr.1655/11 prot.,“Furnizim Vendosje modul detektorit për pajisjen skaner CT Lightspeed 64 slc prodhues GE ose ekuivalent” me vlerë 4,696,600 lekë pa tvsh dhe 5,635,920 lekë me tvsh.

Mbi zbatimin e kontratës.

Për çdo skaner që ka QSUNT mbahet një regjistër skanerësh i veçantë, ku regjistrohen të gjitha ekzaminimet që kryhen. Në mënyrë të tillë evidentohet koha kur skanerat kanë qenë në gjendje pune, ekzaminimi i fundit i kryer e po ashtu se kur ka rifilluar të punoj përsëri të punojë pas vendosjes së pjesëve të reja.

Nga auditimi i regjistrave u konstatua se:

Për skanerin CT Brightspeed 16 slc ka vetëm një regjistër për vitin 2022 i cili është i datës 17.02.2022-08.03.2022, pra deri në momentin që është konstatuar se skaneri nuk mund të ishte funksional, por nuk ekziston një regjistër se kur ka filluar përsëri të punojë dhe të mund të kryhen ekzaminimet. Ndërkohë nga konfirmimi i marrë me email, nga karburant G.A., citon se: *“Ju bëjmë me dije se, Scaneri BrightSpeed-16, kryente funksionin e tij normal për Shërbimin e Urgjencës Polivalente deri në fund të muajit Shkurt 2022.*

Në muajin Mars 2022, Scaneri kaloi në funksion të Spitalit Covid, pasi Spitali Infektiv mbylli aktivitetin e tij për rikonstruksionin e godinës dhe u transferua në Spitalin Covid 3, dhe si rrjedhojë Scaneri i kaloi stafit të Imazherisë të Spitalit Infektivit.

Gjate muajit Mars 2022, scaneri pësoi defekt dhe u riparua në Muajin gusht 2022, ku gjate kesaj periudhe ka qene jashte funksionit.

Në muajin Gusht2022, rifilloi serish aktivitetin e tij drejtuar nga stafi teknik i Spitalit Infektiv, por me fluks të reduktuar ,pasi situata e covidit po vinte drejt normalizimit.

Pas muajit Nentor 2022, ky staf u shperngul për të ushtruar funksionin e tij normal në Spitalin e Ri të Infektivit.

Ambientet ku ishte i vendosur skaneri u lane për tu dizifektuar deri në momentin qe skaneri të transferoheshe tek Spitali I RiA-2.

Për shkak të këtyre ndryshimeve, nuk janë mbajtur evidenca të sakta për këtë scanner gjatë kësaj periudhe.”

-Nuk ka gjurmë auditimi/dokumentacioni se skaneri ka kaluar tek Spitali Covid 3 dhe është zhvendosur për të kryer funksionin e tij në një pavion tjetër, e po ashtu as në relacionin e marrjes në dorëzim nuk është evidentuar ky veprim. Në këtë mënyrë nuk ka gjurmë se kur i janë rikthyer normalitetit të aktivitetit të punës të dy skanerat për të cilët është kryer kjo procedurë prokurimi. Ndërkohë që në relacionin për marrjen në dorëzim janë shprehur se është verifikuar malli dhe janë vënë në gjendje pune pajisjet.

-Pra, mungon dokumentacioni justifikues, nëse skanerat janë transferuar në një PAI tjetër dhe për shkaqe të tilla nuk kanë punuar, në këto kushte rezulton se kontrata nuk është realizuar brenda afateve të përcaktuara ose nuk është zbatuar, në kundërshtim me Udhëzimin Nr.2 datë 18.03.2022.

-Në vazhdimësi të gjithë analizës për nevojën dhe rëndësinë e kryerjes së procedurës së mirëmbajtjes për vitin 2022, gjatë auditimit është konstatuar se procedura “Mirëmbajtje Full-Risk të pajisjeve mjekësore prodhues GE (ose ekuivalent) dhe prodhues Medison (ekuivalent) për nevojat e QSUNT për 24 muaj”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratës Kuadër për 24 muaj: **37,209,999** lekë pa TVSH; dhe 44,651,999lekë me TVSH, e cila ka filluar në fund të vitit 2021 është anuluar, pra anuluar loti 1 me Nr. REF-12984-11-24-2021 në 29.12.2021, ndërkohë që operatori i vetëm i cili ka qenë pjesëmarrës është “M. ” sh.p.k, i cili ka paraqitur ofertën ekonomike për mirëmbajtje ne skanerave CT 16 slc dhe 64 slc.

Me shkresën Nr. 2453/25 prot., datë 23.11.2021, Drejtoria e IT dhe Inxhinierisë Klinike, kërkon nga drejtoria juridike riargumentim të fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje Full-Risk e pajisjeve mjekësore prodhues GE (ose ekuivalent) dhe Mediso (ose ekuivalent) për nevojat e QSUNT për 24 muaj”, bazuar në shkresën e OE “M.” sh.p.k si

distributor zyrtar i RSH i prodhuesit GE dhe si OE, i cili aktualisht mbulon shërbimin e mirëmbajtjes për pajisjet mjekësore, ku sqaron se për pajisjen mjekësore skaner CT Brightspeed 16 slc përfundon suporti i pajisjes me datë 31.12.2021.

-Në këtë mënyrë konfirmohet përsëri se QSUNT është në dijeni të nevojës për të ndërruar tubin X-Ray si rezultat konsumi dhe moduli 20, por nuk ka marrë masa për një procedurë prokurimi mirëmbajtje, me qëllim vazhdimin e punës së skanerave në shërbim të pacientëve dhe mirëmenaxhimin e fondeve publike duke mos lejuar mbivendosje në kohë të procedurave të prokurimit.

-Në kontratën e shërbimit Nr.173/21 prot., datë 01.02.2021 me vlerë 17,483,868 me TVSH në detyrimet e OE përcaktohet mirëmbajtja parandaluese/preventive e pajisjeve mjekësore. Ku me mirëmbajtjes parandaluese apo preventive të pajisjeve mjekësore do të thotë se duhet të kryejë mirëmbajtjen parandaluese/ preventive sikurse e cilëson prodhuesi për të parandaluar defektet që lidhen me përdorimin e tyre dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilesinë dhe besueshmërinë e rezultateve, për të evidentuar përkeqësimin e performancës.

-Procedura për lotin 1 u anulua me vendim anulimi Nr.2985/3 prot., datë 28.12.2021, duke ju referuar germës b) të pikës 1, neni 98 i LPP Nr. 162/2020, ku citohet se: *Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur : b) në procedurën me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;*

OE “M.”, si operator i vetëm i cili ka marrë pjesë në këtë procedurë me lote, ka përcjellë në SPE ofertën ekonomike duke cituar se : *“M. sh.p.k si distributor i kompanisë GE Healthcare, dhe si kompania e cila ka realizuar me sukses prej disa vitesh kontrata të ndryshme të mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore të prodhuesit GE, edhe me institucionin tuaj, e ka të pamundur që me kushtet e specifikuar në DST e kësaj procedure të vijojë me të njëjtën vlerë mirëmbajtjen e pajisjeve CT skaner të prodhuesit GE. Fondi limit prej 21,999,999.9260 Lekë(pa tvsh) i llogaritur për Lotin 1 është i pamjaftueshëm për ofrimin e shërbimit Full- Risk për periudhën 24muajore të kontratës, vlera totale e fondit limit vetëm për shërbimin e mirëmbajtjes për te dy zërat e Lot 1 “Mirëmbajtje Full/Risk e [pajisjeve mjekësore prodhues GE (ose ekuivalent) duhet të ishte 25,640,000 Lekë (pa tvsh).”*

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre nuk kanë maksimalizuar plotësisht eficientë dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike.

20. Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje materiale mjekësore, sisteme transfuzioni gjaku” marrëveshje kuadër për një periudhë 12 muaj.

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Blerje materiale mjekësore, sisteme transfuzioni gjaku		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 118, datë 24.03.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 118, datë 24.03.2022 J.S. (specialiste në drejtorinë e shërbimit farmaceutik/farmaciste) F.C. (specialiste/ sektori i prokurimeve) B.K. (specialiste në drejtorinë ekonomik)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.119 dt.. 24.03.2022 E.Q. (specialiste në drejtorinë e shërbimit farmaceutik/ farmacistë) M.A. (specialiste në sektorin e financës) B.L. (specialiste/ sektori i prokurimeve)

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar-Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik”	3/1. Hartuesi i termave të referencës Urdhër Nr.06 dt..06.01.2022 J.S. (specialiste në drejtorinë e shërbimit farmaceutik/farmaciste) Xh.H. (specialiste/ sektori i marrëdhënieve ligjore) M.M. (specialist/ sektori i financës)	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1,251,530 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 1,149,431.50 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 102,009 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 08.04.2022	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 1 OE b) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK- s’ka; KPP- s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigje nga KPP
b. Zbatimi i Kontratës Mallrave		
14. Lidhja e kontratës M.K Nr.988/5 prot., dt. 13.04.2022 K.F Nr.1 – Nr.988/10 prot., dt..26.04.2022 K.F Nr.2 – Nr.988/18 prot., dt. 10.10.2022 K.F Nr.3 – Nr.179/4 prot., dt. 26.01.2023	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 1,501,836 lekë Vlera e kontratës (me tvsh) 456,492 lekë Vlera e kontratës (me tvsh) 456,492 lekë Vlera e kontratës (me tvsh) 586,320 lekë	
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli *K.F Nr.1 – Nr. 988/10 prot., dt..26.04.2022 Nr. 1764, dt. 08.06.2022 -Vlera me tvsh16,752lekë -Vlera pa tvsh13,960 lekë Nr.1765, dt. 08.06.2022 -Vlera me tvsh 184,272 lekë -Vlera pa tvsh 153,560 lekë Nr.1858, dt. 15.06.2022 -Vlera me tvsh 255,468 lekë -Vlera pa tvsh 212,890lekë *K.F Nr.2 – Nr. 988/18 prot., dt. 10.10.2022 Nr. 3278, dt. 09.11.2022 -Vlera me tvsh16,752lekë -Vlera pa tvsh13,960 lekë Nr.3657, dt. 14.12.2022 -Vlera me tvsh 62,820lekë -Vlera pa tvsh 52,350 lekë Nr.120, dt. 15.02.2022 -Vlera me tvsh 25,128 lekë -Vlera pa tvsh 20,940 lekë *K.F Nr.3 – Nr.179/4 prot., dt..	18.Afati i kontratës në ditë Parashikuar 60 ditë\ Zbatuar 83 ditë ²¹	

²¹Zbatimi i kontratës konsiderohet data e dorëzimit të të gjithë mallit të plotë.

26.01.2023

Nr.335, dt. 15.03.2023

-Vlera me 293,160lekë

-Vlera pa tvsh 244,300 lekë

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

-Drejtorja e shërbimeve mbështetëse, kërkon ngritjen e grupit të punës me objekt prokurimi: “Blerje materiale mjekësore, sisteme të transfuzionit të gjakut”, ku kjo kërkesë referuar gjendjes së Farmacisë Qendrore që sipas tyre ka qenë drejt përfundimit, si dhe duke pasur në vëmendje që marrëveshja kuadër 12 mujore ka përfunduar me datë 01.09.2021.

-Për përcaktimin e çmimit, kjo referuar vlerësimin të bërë nga specialistë të fushës (farmacistja/anëtare e grupit), është bazuar në çmimet e kontratave të më përparshme të realizuara nga vetë apo nga autoritetet e tjera kontraktore. Referuar kontratës së furnizimit Nr.1 të datës 09.02.2021 me Nr.201/7 prot., po ashtu kontratës së furnizimit Nr.2 të datës 05.07.2021 me Nr. 201/12 prot., dhe marrëveshjes kuadër me Nr.2257/10 prot., me datë 01.09.2020 për nevoja të QSUNT. Po ashtu për sa u përket sasive të kërkuara , grupi i punës ka gjykuar të merret për bazë për hartimin e relacionit marrëveshjes kuadër me Nr.2257/10 prot., me datë 01.09.2020, duke qenë se sasitë e kësaj marrëveshje kanë mbuluar më së miri nevojat e QSUNT përsa i përket këtij materiali mjekësor. Grupi i punës arrin në përfundimit që vlera e fondit limit është 1,251,530.00 (një milion e dyqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh, dhe 1,501,836.00 (një milion e pesëqind e një mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë me tvsh.

Argumentim i nevojave.

-Grupi i punës Nr.06 datë 06.01.2022 ka bërë argumentimin e nevojave të “Blerje materiale mjekësore, sisteme transfuzioni të gjakut”, në bazë të marrëveshjes kuadër aktuale Nr.2257/10 datë 01.09.2020, duke u shprehur se sasitë e kësaj marrëveshje kanë mbuluar më së miri nevojat e shërbimeve të QSUNT përsa i përket këtij materiali.

Në analizë të argumentimit të nevojave dhe të fondit për Marrëveshjen kuadër Nr.2257/10 datë 01.09.2020 ka pasur 2 kontrata shërbimi në vazhdim të saj. Konkretisht atë me Nr.201/7 datë 09.02.2021 dhe kontrata Nr.201/12 datë 05.07.2021.

Gjatë shqyrtimit të urdhër shpenzimeve, konkretisht ato me Nr. 385 datë 09.03.2021, në bazë të kontratës me Nr.201/7 datë 09.02.2021. Fletë hyrje në magazinë në datë 10.02.2021, ku janë blerë gjithsesi 11000 copë. Gjithashtu urdhër shpenzimi Nr. 1658 datë 27.07.2021 , në bazë të kontratës së furnizimit me Nr. 201/12 më datë 05.07.2021. Fletë hyrje në farmacinë qendrore me datë 05.07.2021 ku janë blerë gjithsesi 16000. Njësitë totale të prokuruar gjatë marrëveshjes kuadër janë 27000 sisteme të transfuzionit të gjakut.

Referuar konfirmimit të ardhur në mënyrë elektronike nga ana e znj. M.R. drejtore e Drejtorisë Farmaceutike QSUNT, pas kërkesës nga ana jonë për të verifikuar gjendjen reale në magazinë për mallin e prokuruar. Citohet se: “Në periudhën 01.09.2021 sisteme transfuzioni për gjakun kishim 12920 copë; 01.10.2021 sisteme transfuzioni për gjakun kishim 10390 copë;

01.11.2021 sisteme transfuzioni për gjakun kishim 8370 copë;

01.12.2021 sisteme transfuzioni për gjakut kishim 5870 copë;

Konsumi mujor për periudhën 01.09 .2021 deri 31.12.2021 është 2455 cope në muaj”.

-Por do të merret në analizë vetëm gjendja që ka qenë në përfundim të marrëveshjes kuadër, pra vetëm ajo e datës 01.09.2021.

- Konstatohet se gjatë periudhës 12 mujore njësitë totale të cilat janë 27000 sisteme të transfuzionit të gjakut, duke mbetur kështu gjendje 10390 sisteme në datën 01.10.2021. Pra nevoja gjatë një viti ka qenë 16610 sisteme të transfuzionit të gjakut, kjo shifër duke ju referuar

prokurimi të mallit dhe gjendjes në magazinë. Një mesatare përafërsisht prej konsumit të 1384 sisteme transfuzioni në muaj. Ndërkohë sasia e kërkuar në procedurën e prokurimit të marrëveshjes kuadër të 2021 është po 32,935, të cilat janë 5935 copë më shumë se sa janë furnizuar gjate vitit, duke pasur në vëmendje dhe gjendjen e mbetur në magazinë pas përfundimit të marrëveshjes kuadër. Grupi i punës i cili është shprehur se sasia e kërkuar edhe për marrëveshjen kuadër të 2022 është bazuar në nevoja reale të institucionit.

- Malli që prokurohet nuk është i njëjtë me sasinë reale që i nevojitet institucionit. Një prokurim i një sasi më të madhe se sa nevojat largon OE nga gara.

-Nuk kemi një argumentim të nevojave, sipas tendencave reale, duke prokuruar për një sasi më të madhe se sa ka qenë e nevojshme. Procesverbali i argumentimit të nevojave, nuk kanë një argumentim se sa është kërkesa mesatare e konsumit mujor nga pavianët përkatëse. Ndërkohë që nga konstatimi gjendjes reale të këtij malli në magazinën qendrore të QSUNT, nuk përputhen tendencat për nevojën e këtij malli me sasinë që kërkohet të prokurohet.

-Konstatohet fenomeni i diferencave të theksuar ndërmjet fondit limit dhe vlerës së kontratës. Mos llogaritja e saktë nevojave, në vlerë të konsiderueshme më të lartë se konsumi real, ndikon në uljen në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës duke favorizuar vetëm OE të cilët gëzojnë mundësinë e plotësimit të kërkesave lidhur me gjenden teknike dhe si rrjedhojë atë financiare. Çka do të thotë se eliminon në mënyrë indirekte konkurrencën, duke cenuar në këtë rast një ndër parimet më të rëndësishme të fushës së prokurimit publik. Pra një vlerë jo sa më reale ndikon në plotësimin e kriterëve klasifikuese.

Procedura e prokurimeve REF-23140-03-25-2022 , ku data e fundit e pranimit të ofertave do të ishte 08.04.2022. KVO bëri hapjen/dorëzimin e ofertave në datën dhe orën e përcaktuar, duke verifikuar operatorët pjesëmarrës në SPE, si dhe duke pasqyruar procesin e administrimit dhe verifikimit të mostrave për OE pjesëmarrëse të cilat kanë paraqitur mostra. Mostrat janë paraqitur nga OE “E.” sh.p.k . Oferta e paraqitur nga OE ishte me ofertë ekonomike 1,149,431.50 (një milion e njëqind e dyzet e nëntëmijë e katërqind e tridhjetë e një pikë pesë) lekë pa tvsh. Ku do të konsiderohet si ofertë e vlefshme ajo e paraqitur nga “E.”, dhe si të pavlefshme nuk ka një të tillë. Po ashtu KVO mbajti procesverbalin e dorëzimit të mostrave ku referohet se për të gjithë artikujt e ofertuar janë paraqitur mostra të vulosura me shënimin përkatës të specifikuar sipas DST.

Operatori ekonomik “E.” sh.p.k me NIPT K.....P renditet në vend të parë si e vetmja ofertë e vlefshme. Pasi u bë kalimi i hapave në SPE pas kalimit të afateve që na dikton LPP, u lidh marrëveshja kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara. Marrëveshja me Nr. 988/5 prot., u lidh më datë 13.04.2022 , ku kohëzgjatja e kontratës do të jetë 12 muaj. QSUNT do të lidhë kontratën në bazë të nevojave të saj në çdo 4 muaj, 15% e sasi e barit duhet të lëvrohet brenda 20 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Kontrata furnizimi Nr.1 me Nr.988/10 prot., datë 26.04.2022 nga AK i cili ka marrë 10900 njësi sasi, me vlerë 380,410 lekë pa tvsh.

Kontrata furnizimi Nr.2 me Nr.988/18 prot., datë 10.10.2022 nga AK i cili ka marrë 10900 njësi sasi, me vlerë 380,410 lekë pa tvsh.

Kontrata furnizimi Nr.3 me Nr.179/4 prot., datë 26.01.2023 nga AK i cili ka marrë 14000 njësi sasi, me vlerë 488,600 lekë pa tvsh.

-Marrja e materialeve mjekësore në dorëzim është bërë sipas kushteve të kontratës dhe afateve të parashikuara.

Menaxhmenti dhe personat e përfshire në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre nuk kanë maksimalizuar plotësisht efikasitetin dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike.

20. Në procedurat e prokurimit si më poshtë nuk u konstatuan shkelje ligjore ose parregullsi, përveç disa devijimeve të vogla nga kuadri rregullator që nuk cenojë procedurën e prokurimeve.
- Rikonstruksioni i godinës së arkivës së kartelave mjekësore në QSUNT, me fond limit 11,999,840 lekë pa tvsh , viti 2021.
 - F.V pajisje teknologjike, elektrike për godinën ekzistuese të Pediatrisë në QSUNT, me fond limit 113,529,374 lekë pa tvsh , viti 2022.
 - Blerje veshje të plumbuara të stafit që punon në burime të rrezatimit jonizues, me fond limit 6,691,851,lek137 pa tvsh, viti 2022.
 - Blerje materiale mjekësore doreza josterile për mbulimin e nevojave deri në 31.12.2022, me fond limit 5,096,289.2 lekë, viti 2021.

Titulli i gjetjes Nr.1	Mos zbatim i specifikimeve teknike në kontratën “Mobilimi i Spitalit të Ri të Ndërtuar (A2), fond limit 147,864,531 lekë pa TVSH.
Situata:	<p>-Zbatimi i kontratës “Mobilimi i Spitalit të Ri të Ndërtuar (A2), fond limit 147,864,531 lekë pa TVSH.</p> <p>Agjencia Shtetërore e blerjeve të përqendruara me shkresën Nr. 119/26 prot., datë 15.07.2022, protokolluar me Nr. 35/33 prot., datë 15.07.2022, ka njoftuar Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza"(QSUNT) Tiranë, për lidhje kontrate, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash, me afat të marrëveshjes 1 vit, me fond limit 147,864,531 lekë pa TVSH.</p> <p>Nga verifikimi fizik i kryer në Spitalin A2 (Urgjencës), më datë 27 dhe 28.03.2023 në prani të E.N. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore dhe E.K. me detyrë Specialist/ Inxhinier Biomedikal i Sektorit të Inxhinierisë Klinike, u konstatua se në 1312 copë për 6 artikuj në vlerën 25,605,000 lekë me TVSH, nuk janë zbatuar specifikimet teknike, si dhe mobiljet janë të pa shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat.</p> <p>Për pasojë vlera 25,605,000 lekë për Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria “R.A.” sh.p.k.</p>
Kriteri:	<p>-Marrëveshje kuadër të lidhur me Nr. 7/26 prot., datë 17.07.2020 ndërmjet QSUNT dhe operatori ekonomik “R.A.” Shpk.</p> <p>Kontrata Nr. I, është lidhur me Nr. 62/127 prot., datë 16.08.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shoqërisë “R.A.” Shpk në vlerën 59,736,000 lekë me TVSH, neni 5.</p> <p>-Kontrata furnizimi II, lidhur me Nr. 62/142 prot., datë 22.08.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shoqërisë “R.A.” Shpk në vlerën 81,970,200 lekë me TVSH, neni 5.</p> <p>-Kontrata furnizimi III, lidhur me Nr. 62/166 prot., datë 30.09.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shoqërisë “R.A.” Shpk në vlerën 59,736,000 lekë me TVSH.</p>

	<p>- Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 122“.</p> <p>- Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690.</p> <p>-Deklaratën datë 03.05.2022 mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik “R.A.” Shpk.</p>
Ndikimi/Efekti:	Përfitim padrejtësisht vlera 25,605,000 lekë nga “R.A.” Shpk.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 25,605,000 lekë nga “R.A.” Shpk Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëria, si pasojë e moszbatimit të specifikimeve teknike në kontratën “Mobilimi i Spitalit të Ri të Ndërtuar (A2), me fond limit 147,864,531 lekë pa TVSH.

Titulli i gjetjes Nr.2	Mos zbatim i specifikimeve teknike në kontratën “Mobilimi i Spitalit të Ri të Ndërtuar (A2), fond limit 147,864,531 lekë pa TVSH.
Situata:	<p>Për furnizim vendosje të aparaturave mjekësore për Spitalin e Ri të Ndërtuar (A2), loti 10, viti 2022 është lidhur kontrata me Nr. 64/124 prot., datë 26.07.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shoqërisë “B.A.” Shpk në vlerën 23,064,000 lekë me tvsh.</p> <p>Nga verifikimi fizik i kryer në Spitalin A2 (Urgjencës), më datë 27 dhe 28.03.2023 në prani të E.N. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore dhe E.K. me detyrë Specialist/ Inxhinier Biomedikal i Sektorit të Inxhinierisë Klinike, u konstatua se 130 shtretër pacienti me kontroll manual për vlerën 10,400,000 pa tvsh, ose 12,480,000 lekë me TVSH, nuk janë të rinj, por të përdorur.</p> <p>Pajisjet/shtretërit janë të pa shoqëruara me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test raportin e fabrikës), veprim në kundërshtim me Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1.</p>
Kriteri:	<p>Kontrata me Nr. 64/124 prot., datë 26.07.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shoqërisë “B.A.” Shpk në vlerën 23,064,000 lekë me tvsh, neni 5.1.</p> <p>- Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 122 “Rregullat që zbatohen për kontratën”, pika 1.</p> <p>- Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690 .</p> <p>- Deklarata datë 18.10.2021 mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik “B.A.” Shpk.</p>
Ndikimi/Efekti:	Përfitim padrejtësisht 12,480,000 lekë nga “B.A.” Shpk.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lartë

Rekomandime:	Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 12,480,000 lekë nga “B.A.” Shpk. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëria, si pasojë e mos zbatimit të specifikimeve teknike në kontratën “Mobilimi i Spitalit të Ri të Ndërtuar (A2), fond limit 147,864,531 lekë pa TVSH.
---------------------	--

Titulli i gjetjes Nr.3	Pajisja e videoendoskopisë është e asambluar dhe e pa kalibruar.
Situata:	<p>Furnizim vendosje të pajisjes mjekësore për Spitalin e Ri “Kabineti i Endoskopisë”, viti 2022. Pjesët përbërëse të pajisjes të paraqitura në ofertën teknike kanë ardhur në Republikën e Shqipërisë dhe regjistruar në QKBPM, secila më vete në data dhe vite të ndryshme nga viti 2021-2022, me prodhues të ndryshëm dhe operatorë të ndryshëm, çka dëshmon se pajisja është asambluar në Shqipëri. Procesimi/mbledhja (asamblimi) në një pajisje është bërë nga shoqëria “A.” Sh.p.k e cila nuk e ka tagrin ligjor/teknik për ta kryer këtë asamblim, referuar pikës 13.6.4 të VKM Nr. 731, datë 2.9.2015 “Për miratimin e rregullit teknik” Për Kërkesat Thelbësore, Vlerësimin e Konformitetit. Asamblimi, i pajisjes Videoendoskop, si dhe mosmbajtja e raportit të instalimit, funksionimit dhe trajnimit të stafit mjekësor, jo vetëm është shpenzim që nuk ia ka arritur qëllimit, por është risk i lartë për kryerjen e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për jetën e pacientëve. Pajisjet janë të pashoqëruara me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test-raportin e fabrikës).</p> <p>Vlera 17,184,000 lekë përbën dëm ekonomik për QSUNT-në dhe Buxhetin e Shteti dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria “A.” sh.p.k. Ndërsa dëmi shëndetësor ndaj pacientëve është i pallogaritshëm (pra shumë herë më i madh), pasi shërbimi ndaj pacientëve me këtë pajisje të asambluar në Shqipëri nga persona të palicensuar, pajisje pa kalibruar, pa raport instalimi dhe funksionimi, pa raport trajnimi për personelin, pa manuale shërbimi dhe përdorimi, pa raportet e testeve (test-raportin e fabrikës) është me risk të lartë për shëndetin e pacientëve.</p>
Kriteri:	-VKM Nr. 731, datë 2.9.2015 “Për Miratimin e Rregullit Teknik “Për Kërkesat Thelbësore, Vlerësimin e Konformitetit, Klasifikimin dhe Markimin Ce Të Pajisjeve Mjekësore”, pika 13.6.4. Rekomandimi i Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1.
Ndikimi/Efekti:	Përfitim padrejtësisht vlera 17,184,000 lekë nga “A.” Shpk.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 17,184,000 lekë nga shoqëria “A.” Sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, pasi pajisja është asambluar në Shqipëri. Procesimi/mbledhja (asamblimi) i pjesëve në një pajisje është bërë nga një shoqëri e pa certifikuar/licencuar për këtë qëllim.

Titulli i gjetjes Nr. 4	Pagesë e dubluar
Situata:	<p>Zhvillimi i procedurës së prokurimit kërkesë me propozim me objekt “F. v kokë goditëse për pajisjen mjekësore ESWL, prodhuesi S.M./ekuivalent”, me REF -84075-01-14-2021, viti 2021, kontraktuar dhe likuiduar për vlerën 6,886,800 lekë shkaktonte mbivendosje (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e mirëmbajtjes në vlerën 5,636,219.18 lekë me TVSH, e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik “M.” shpk dhe QSUNT me numër prot., 173/36 datë 04.02.2021, ku specifikohet në termat e referencës se: “Operatori ekonomik fitues do të kryejë mirëmbajtje full risk, mirëmbajtja parandaluese/ preventive e pajisjeve mjekësore, mirëmbajtja korrigjuese e pajisjeve mjekësore, furnizim me pjesë këmbimi dhe aksesore, inspektimi i sigurisë së pajisjeve mjekësore”.</p> <p>Për veprimin e mësipërm është shkelur koncepti i “Bëgatimit pa shkak”, i ardhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të personave të përfshirë në këtë proces me përfitues padrejtësisht shoqërinë “M.” sh.p.k në vlerën 6,886,800 lekë. Referuar Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 655, “Bëgati pa shkak”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të bëgatimit”.</p> <p>Vlera 6,886,800 lekë përbën dëm ekonomik për QSUNT-në dhe buxhetin e shteti dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria “M.” shpk.</p>
Kriteri:	Kontrata me numër prot., 173/36 datë 04.02.2021.
Ndikimi/Efekti:	Përfitim padrejtësisht vlera 6,886,800 lekë nga “M.” Shpk.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 6,886,800 lekë nga shoqëria “M.” Sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, pasi shkaktonte mbivendosje, (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e mirëmbajtjes në vlerën 5,636,219.18 lekë me TVSH, e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik “M.” shpk dhe QSUNT me numër prot., 173/36 datë 04.02.2021.

Titulli i gjetjes Nr.5	Pagesë e dubluar
Situata:	<p>Zhvillimi i procedurës së prokurimit kërkesë me propozim me objekt “F. V kokë goditëse për pajisjen mjekësore ESWL, prodhuesi S.M./ekuivalent”, me REF 42106-09-16-2022, viti 2022, kontraktuar dhe likuiduar për vlerën 3,443,400 lekë shkaktonte mbivendosje (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e mirëmbajtjes në vlerën 3,074,122 lekë me TVSH, e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik “M.” shpk dhe QSUNT-së me numër prot., 581/28 date 01.03.2022, ku specifikohet në termat e referencës se: “Operatori</p>

	<p>ekonomik fitues do të kryejë mirëmbajtje full risk, mirëmbajtje parandaluese/preventive e pajisjeve mjekësore, mirëmbajtje korrigjuese e pajisjeve mjekësore, furnizim me pjesë këmbimi dhe aksesore, inspektim i sigurisë së pajisjeve mjekësore”.</p> <p>Për veprimin e mësipërm është shkelur koncepti i “Bogatimit pa shkak”, i ardhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të personave të përfshirë në këtë proces me përfitues padrejtësisht shoqëria “M.” Sh.p.k në vlerën 3,074,122 lekë. Referuar Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 655 “Bogatimit pa shkak”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të bogatimit”.</p> <p>Vlera 3,443,400 lekë përbën dëm ekonomik për QSUNT-në dhe buxhetin e shteti dhe duhet të dëmshpërblehet, nga shoqëria “M.” shpk.</p>
Kriteri:	Kontrata me numër prot., 581/28 date 01.03.2022.
Ndikimi/Efekti:	Përfitim padrejtësisht vlera 3,074,122 lekë nga “M.” Shpk.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 3,074,122 lekë nga shoqëria “M.” shpk . Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, pasi shkakton mbivendosje (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik “M.” shpk dhe QSUNT-së me numër prot., 581/28, datë 01.03.2022.

Titulli i gjetjes Nr.6	Në specifikimet teknike është vendosur si “specifikim i tepërt” apo “Super specifikim”, autorizimi nga prodhuesi.
Situata:	<p>Në të gjitha procedurat e prokurimit për periudhën objekt auditimi, për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, blerjen e pajisjeve mjekësore dhe barnave, është vendosur është kriter i kualifikimit favorizues autorizim nga prodhuesi.</p> <p>Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim, ka orientuar operatorët ekonomik drejtpërdrejtë një prodhuesi të caktuar në treg. Për pasojë operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik, është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme ulin në mënyrë të ndjeshme konkurrencën, duke favorizuar vetëm operatorët ekonomik të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.</p>
Kriteri:	- Rekomandimi Nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore”, rekomandim i cili është përforcuar me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), Nr. 7988 prot., datë 24.12.2021, pika 12.

	<p>Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 3 dhe 77, t VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 93.</p> <p>Vendimi i Autoriteti i Konkurrencës Nr. 851, datë 03.12.2021 “Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”, pika 2.</p> <p>Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.</p> <p>Vendimi Nr.00-2015-315, datë 23.01.2015 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.</p>
Ndikimi/Efekti:	Ulje në mënyrë të ndjeshme e konkurrencën.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Autoriteti kontraktor, në vijimësi duhet të hartojë kërkesat e veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë.

Titulli i gjetjes Nr.7	Negocim pa shpallje ardhur si pasojë e mos vëmendjes së duhur institucionale
Situata:	<p>Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me objekt “Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore për përballimin e nevojave ekstreme, deri në lidhjen e kontratës bazë të procedurave konkurruese (me të drejtë shkëputje pa pasoja për Autoritetin kontraktor me fond limit në vlerën 61,002,230 lekë pa TVSH për periudhën shkurt-shtator 2022, të ndarë në 49 lote sipas prodhuesve të pajisjeve mjekësore.</p> <p>Përdorimi i kësaj procedure ka ardhur si rezultat i anulimit të procedurës së prokurimit, marrëveshje kuadër me fond limit 645,887,199 lekë pa TVSH me referencë REF-97398-06-04-2021 me objekt “Menaxhim dhe mirëmbajtje e aparaturave mjekësore në QSUNT” me afat 4 vjet (48 muaj), marrëveshje kuadër me një operator ekonomik.</p> <p>Trajtimi si emergjencë nuk ka ardhur për shkaqet e parashikuara si më lart, por si pasojë e mosvëmendjes së duhur institucionale dhe përgjegjësisë ndaj detyrës së strukturave të përfshirë në këtë proces, duke filluar nga menaxhimi i lartë drejtues.</p> <p>-Autoriteti kontraktor, edhe pse në dokumentet e tenderit (termat e referencës) ka përcaktuar afatin 180 ditë me kushtin e ndërprerjes së kontratës pa pasoja për autoritetin kontraktor, në momentin e realizimit të procedurës konkurruese, deri në përfundimin e kontratave të nënshkruara nga kjo procedurë, nuk ka iniciuar asnjë procedurë prokurimi, duke provuar dhe njëherë se autoriteti kontraktor e kishte paracaktuar zhvillimin e një procedure me negocim pa shpallje, veprim në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 52, pika 1/c ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “....Me krijimin e nevojës ekstreme, autoriteti/enti</p>

	kontraktor duhet njëkohësisht të marrë të gjitha masat për realizimin e procedurave normale të prokurimit”.
Kriteri:	VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 52, pika 1/c.
Ndikimi/Efekti:	Risk në rritjen e çmimit të paguar për blerjen e një malli.
Shkaku:	Risk për shmangie të konkurrencës.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	-Procedura e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, duhet konsideruar si rast i veçantë dhe Autoriteti kontraktor, nuk duhet në asnjë rast të abuzojë me përdorimin e këtij instrumenti, me qëllim shtrembërimin e konkurrencës, por duhet të konsiderohet procedurë konkurrencte përjashtimore. -Autoriteti kontraktor nëpërmjet procedurave të tjera të prokurimit duhet të çoj në rritjen e integritetit në prokurimin publik, me efekt të drejtpërdrejt në konkurrencën, në çmimin e paguar nga administrata publike për blerjen e një malli, shërbimi apo kryerjen e një pune, të cilat kanë efekt të drejtpërdrejt në shpenzimet e shtetit, pra në burimet e taksapaguesve.

Titulli i gjetjes Nr.8	Risk të lartë mbi qëndrueshmërinë dhe integritetin strukturor të godinës Pediatriisë Infektive.
Situata:	Ndërtesa e Pediatriisë Infektive, përbëhet nga 3 kate mbi tokë dhe një gjysmë kati teknik mbi soletën e katit të fundit me lartësi 1.95 m, duke krijuar një interkapet mes tarracës dhe katit të dytë. Spitali i Pediatriisë së Infektive ka një lartësi kati prej 3.25 m dhe arrin një sipërfaqe totale ndërtimi 3,191 m ² , Kati përdhe 1,075 m ² , Kati i parë 1,058 m ² , Kati i dyte 1,058 m ² . Referuar situatës së tërmetit të 26.11.2019, nga analiza e grupit të projektuesve pas situatës së tërmetit, vihen re dëmtime në muraturë kryesisht në katin e dytë të godinës të cilat vijnë si pasojë e dëmtimeve në strukturat konstruktive të mureve mbajtës perimetralë dhe plasaritje të lehta në suvanë e jashtme dhe të dukshme në rifiniturat e brendshme. Kati i fundit i godinës është i evakuar, për çështje sigurie ky kat është i boshatisur. Në kushtet e emergjencës për vazhdimin e funksionimit të tij projektuesi ka rekomanduar puntelimin dhe nxjerrjen nga puna të komplet katit të dytë teknik të objektit. Në mënyrë që të zgjidhen problematikat kryesore të ndërtesës, opsioni përfundimtar i sugjeruar nga projektuesi për Spitalin e Pediatriisë së Përgjithshme parashikon zgjatjen e jetëgjatësisë së <i>objektit ekzistues deri në 2-3 vjet</i> dhe më vonë ndoshta ri konceptimi i një objekti të ri, i cili do të zhvillohet në prishjen e objektit ekzistues dhe ndërtimi i një objekti të ri të Spitalit të Pediatriisë së Përgjithshme me parametra bashkëkohore. Oponenca teknike e realizuar nga Instituti i Ndërtimit, me Nr. 1190/2

prot., datë 06.06.2020, është kontradiktore, ka paqartësi ose mos dhënie e përfundimeve të sakta të oponencës teknike. MSHMS nuk ka vlerësuar drejt Investimin e rikonstruksionit të një objekti ekzistues, pa marrë masa përforcuese dhe ndërhyrjet e duhura strukturore, duke e lënë katin e dytë të mbështetur në puntela dhe një investim për një periudhë shfrytëzimi prej 2 vitesh, ç'ka do të thotë që për një vit Buxheti i Shtetit ka paguar 13,319,442 lekë me TVSH (26,638,885 lekë me tvsh / 2) ose për 2 vite 26,638,885 lekë me TVSH, në një kohë kur ky projekt është hartuar në kundërshtim me Kushtet teknike të Projektimit KTP dhe zbatimit KTZ, miratuar me VKM Nr. 68, datë 15.2.2001 “Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit” si dhe Leja e ndërtimit Nr. 14544/4 datë 04.08.2021, është dhënë në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

Kontradiktore është dhe Bashkia Tiranë, pasi pas 3 herë aplikim dhe refuzim të lejes së ndërtimit, në përfundim merret vendimi 14544/4 datë 04.08.2021 ku miratohet leja e ndërtimit. Miratimi i lejes së ndërtimit, pas 3 herë refuzime dhe më pas miratohet, kur projekti i rikonstruksionit nuk ka pësuar ndryshime apo korrigjime nga reflektimet e oponencës realizuar nga Instituti i Ndërtimit, bie në kundërshtim me arsyet fillestare të refuzimeve dhe me ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Pra, projekti është realizuar në Prill 2020, kontrata e zbatimit është nënshkruar në Dhjetor 2020 dhe Leja e ndërtimit është miratuar në Gusht 2021.

Në opinionin e grupit të auditimit, zgjidhja teknike dhe situata aktuale e godinës paraqitet një risk shumë i madh në rast të një tërmeti tjetër brenda një periudhe dy vjeçare (e cila ka kaluar), ku ambienti shfrytëzohet për hospitalizimin e fëmijëve. Gjithashtu zgjidhja e dhënë në projekt me puntelimin e katit të fundit, nuk zgjidh ose përforcon muret perimetral mbajtës, të cilët kanë patur shkëputje në një zonë me muret ndarës të brendshëm. Pra ky investim nuk ka arritur zgjidhjen e qëndrueshmërisë së godinës edhe në rastin e menduar prej 2 vite me puntela (ku mbahet soleta), ku nuk është menduar zgjidhja e qëndrueshmërisë së mureve perimetralë, çka do të kërkojë rikonstruksionin e plotë të godinës. Pra Buxheti i Shtetit/ QSUNT do të harxhojë fonde përsëri që godina të jetë e shfrytëzueshme dhe e sigurt për funksion spitalor. Nga MSHMS dhe nga QSUNT, nuk është parashikuar asnjë Investim për Peditrinë Infektive, për ndërtimin e ndonjë objekti të ri apo edhe për rikonstruksion përfundimtar të godinës së vjetër mbi katin e dytë të mbajtur me puntela provizore. Referuar sa më sipër, vlera prej 26,638,885 lekë me TVSH për Rikonstruksionit të pediatriisë Infektive, përbën efekt negativ të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.

Kriteri:

Kushtet teknike të Projektimit KTP dhe zbatimit KTZ, miratuar me VKM Nr. 68, datë 15.2.2001 “Për miratimin e standardeve dhe të

	kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit”.
Ndikimi/Efekti:	Risk të lartë mbi qëndrueshmërinë dhe integritetin strukturor të godinës.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandime:	<p>-Nga Drejtori i përgjithshëm i QSUNT, të prezantohet në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale risku i lartë i qëndrueshmërisë së godinës së Pedriatisë Infektive, i ardhë si pasojë e mos korigjimeve të projektit, duke i kërkuar Ministrisë së linjës të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës për përcaktimin e integritetit strukturor të godinës, si dhe funksionaliteti operacional i saj në shërbim të pacientëve.</p> <p>-Nga QSUNT dhe MSHMS, në të ardhmen të merren masa që çdo investim të vlerësohet rëndësia e ruajtjes së integritetit strukturor të godinave, duke përcaktuar dhe vlerësuar kapacitetin sizmik dhe metodikat për riaftësimin strukturor të tyre, në mënyrë që të mos keq menaxhohet vlera për investime dhe rikonstruksione të objekteve spitalore.</p>

Titulli i gjetjes Nr. 9	Nuk është hartuar plani i mirëmbajtës së pajisjeve mjekësore për çdo vit, pjesët e dëmtuara pas zëvendësimit me të reja janë marr nga kontraktorët e shërbimit, nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM), i QSUNT, Specialistët e Drejtorisë se IT dhe Inxhinierisë Klinike nuk janë trajnuar për pajisjet mjekësore.
Situata:	<p>Për mirëmbajtje full-risk të pajisjeve mjekësore Autoriteti kontraktor, para shpalljes së proceduarve nuk ka hartuar planin e mirëmbajtës së pajisjeve mjekësore për çdo vit, plan i cili duhet miratuar nga komiteti mjekësor, kjo për faktin se numri i pajisjeve për nevoja mirëmbajtje është shumë i madh dhe nuk mbulohen nga fondet e QSUNT-së.</p> <p>Komisioni mjekësor duhet të kryente dhe klasifikimin e pajisjeve mjekësore në të vogla dhe të mesme.</p> <p>Në QSUNT nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM), i QSUNT, në letër ose në kompjuter historinë (kartelën) e plotë të pajisjes, ku të jenë të identifikuar: Prodhuesi ose furnizuesi, numrin serial, data e blerjes, vlera (reale ose të vlerësuar), të dhënat e historisë së riparimeve dhe të mirëmbajtjes. Emri i personit që ka kryer riparimin, mirëmbajtjen. Emri i personit që ka raportuar një problem me pajisjen mjekësore. Përshkrimi i përgjithshëm i problemit ose i shërbimit të nevojitur. Pjesët e këmbimit të përdorura gjatë riparimit/mirëmbajtjes, por ka vetëm numrin e inventarit.</p> <p>Në të gjitha kontratat e zbatimit pjesët e dëmtuara pas zëvendësimit me të reja janë marr nga kontraktorët e shërbimit, klauzole cila nuk është përcaktuar në kontratë.</p> <p>Specialistët e Drejtorisë se IT dhe Inxhinierisë Klinike nuk janë trajnuar nga QSUNT për njohjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, duke qenë në këtë mënyrë në kushte të pabarabarta</p>

	me specialistët e kontraktorëve , duke krijuar risk të lart në monitorimin e kontratave dhe marrjen në dorëzim të shërbimit të mirëmbajtjes.
Kriteri:	Statuti i miratuar në zbatim të Urdhrit të Përbashkët Nr. 709, date 10.10.2018, i Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e Statutit të QSUNT "Nënë Tereza". Në këtë statut KREU III, pika "ORGANIZIMI", pika 8 " Organet Drejtuese", 18/1, 18.3, 18.4. - Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 122 "Rregullat që zbatohen për kontratën", pika 1. -Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690.
Ndikimi/Efekti:	Risk për keq menaxhim të fondeve për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	-Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për mirëmbajtje full-risk/ose jo të pajisjeve, me qëllim që para shpalljes së proceduarve të prokurimit të jetë hartuar plani i mirëmbajtës së pajisjeve mjekësore për çdo vit, plan i cili duhet miratuar nga komisioni mjekësor, si dhe të kryhet klasifikimi i pajisjeve mjekësore në të vogla dhe në të mesme. - Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të mbajtur Sistemin e Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM), i QSUNT, në letër ose në kompjuter historinë (kartelën) e plotë të pajisjes, si dhe pjesët e dëmtuara të pajisjeve mjekësore pas zëvendësimit me të reja nga kontraktorët e shërbimit, të futen në termat e referencës së prokurimit, të përcaktohen në kontratë dhe tu jepen n.q.s do ti dëshirojnë kontraktorët duke i vlerësuar me vlerën e tregut. - Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa që specialistët e Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike të trajnohen me shpenzimet e QSUNT për njohjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, duke rritur në këtë mënyrë kompetencën profesionale në monitorimin e kontratave dhe marrjen në dorëzim të shërbimit të mirëmbajtjes.
Titulli i gjetjes Nr.10	Moslllogaritje saktë e fondit limit
Situata:	Në procedurën e prokurimit me objekt: Mirëmbajtje Full-Risk e pajisjeve mjekësore, për nevojat e QSUNT për 24 muaj” 62 lote, marrëveshje kuadër me fond limit 312,443,222 lekë, viti 2022, përllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera/spitaleve privat.

Kriteri:	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 76, pik 1 dhe 2.
Ndikimi/Efekti:	Risk për keq menaxhim të fondeve publike.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga Autoriteti kontraktor të merren masa që përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si procedurë e rëndësishme, pasi nga zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, varet saktësia e kësaj vlere, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike.

Titulli i gjetjes Nr.11	Kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë.
Situata:	Në procedurat e prokurimit me objekt: Mirëmbajtje Full-Risk e pajisjeve mjekësore, për nevojat e QSUNT për 24 muaj” 62 lote, marrëveshje kuadër me fond limit në vlerën 312,443,222 lekë, viti 2022, Furnizim vendosje të aparaturave mjekësore për Spitalin e RI “Kabineti i Endoskopisë”, viti 2022 me fond limit në vlerën 18,882,000lekë kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë.
Kriteri:	Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” nenet 77, 87, 89, 90, 92. VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82.
Ndikimi/Efekti:	Shtrembërimin e konkurrencës
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga QSUNT t’i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi procesi i shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.

Titulli i gjetjes Nr. 12	Parregullsi në administrimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore
Situata:	-Dokumentimi i dorëzimit të mbetjeve në ambientet e hidroklovës deri në momentin e dorëzimit tek Operatori Ekonomik, për të treja procedurat (trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta/mbetje që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19) kryhej me anë të regjistrave. Në pjesën më të madhe të regjistrave konstatohet se nuk plotësohej origjina e mbetjeve, lloji i materialit dhe sasia në kg e mbetjeve nga ana e personelit infermieror, të cilët janë përgjegjës për garantimin e ndarjes, manipulimit dhe trajtimit përfundimtar të mbetjeve të rrezikshme spitalore të gjeneruara si rezultat i trajtimit të pacientëve, në përputhje me legjislacionin kombëtar. Mos pasqyrimi në formën e

	<p>kërkuar, bën të pamundur rakordimin ndërmjet peshës së dorëzuar nga secili shërbim dhe peshës së dorëzuar operatorit ekonomik.</p> <p>-Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezultoi se QSUNT, në cilësinë e prodhuesit të mbetjeve të rrezikshme nuk ka marrë asnjë masë për të hartuar një program për uljen e vëllimit, të sasisë dhe toksicitetit të mbetjeve të rrezikshme, në kundërshtim me shkronjën a), pika 3, neni 7, ligji Nr. 9537, 18.05.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”.</p> <p>-QSUNT nuk ka marrë asnjë masë për ngritjen e grupit të administrimit të mbetjeve spitalore (GAMS), duke ndikuar kryesisht në monitorimin e zbatimit të Planit të Administrimit të Mbetjeve Spitalore.</p>
Kriteri:	<p>- Ligji Nr. 9537, 18.05.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”, shkronja a), pika 3, neni 7;</p> <p>-Urdhri Nr. 40, datë 13.02.2014 “Për ndarjen e mbetjeve spitalore në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”;</p> <p>-Rregullore “Mbi administrimin e mbetjeve spitalore” në QSUNT.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>-Mosplotësimi i regjistrave të mbetjeve të rrezikshme sipas parashikimeve të kuadrit ligjor në fuqi sjell mungesën e garantimit të informacionit lidhur me llojin e mbetjeve të trajtuara, si dhe mungesë transparence në sasinë e tyre, mosrakordancë e cila mund të sjelli pasoja financiare për QSUNT, si dhe pasoja për shëndetin publik.</p> <p>-Mungesa e ngritjes së GAMS sjell mungesë në zbatimin me efikasitet dhe efektivitet të Planit të Administrimit të Mbetjeve.</p> <p>-Mos marrja e asnjë mase për hartimin e një programi me qëllim uljen e vëllimit, të sasisë dhe toksicitetit të mbetjeve të rrezikshme mund të shkaktojë kosto më të larta financiare lidhur me trajtimin e mbetjeve.</p>
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	<p>-Personeli infermieror të marri masa që në çdo rast që kryhet dorëzimi i mbetjeve të rrezikshme të plotësoj regjistrat me të gjithë elementët e tyre: origjina e mbetjeve, lloji i materialit, sasia në kg, data e dorëzimit dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm që lidhet me këtë proces.</p> <p>-QSUNT të marrë masa për ngritjen e grupit të administrimit të mbetjeve spitalore (GAMS), me qëllim zbatimin me efikasitet dhe efektivitet të Planit të Administrimit të Mbetjeve, si edhe hartimin dhe zbatimin e një programi për uljen e vëllimit, të sasisë dhe toksicitetit të mbetjeve të rrezikshme, me qëllim uljen e ndikimit në mjedis, shëndet publik dhe të kostove financiare.</p>
Titulli i gjetjes Nr. 13	Parregullsi në argumentimin e kërkesave mbi kriteret e vendosura kualifikuese dhe në procesin e vlerësimit të ofertave në procedurat e prokurimit me objekt trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore.
Situata:	-Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për të treja procedurat e asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore

	<p>konstatohet se nuk argumentohet kërkesa e AK për të dhënat e frigoriferit të instaluar: kapacitet 200-250 kg, temperaturë ngrirje deri në minus -18 gradë celsius, edhe pse instalimi i një frigoriferi është detyrim ligjor që rrjedh nga pika 10.2.15, rregullorja “Mbi administrimin e mbetjeve spitalore në QSUNT”, por kjo rregullore nuk ka përcaktuar temperaturën e frigoriferit apo kapacitetin mbajtës, si rrjedhojë ky kriter konsiderohet i paargumentuar ligjërisht dhe teknikisht.</p> <p>-Për procedurën “Trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta për nevojat emergjente të QSUNT deri në 31 Dhjetor 2021” gjatë vlerësimit të ofertave konstatohet se OE i shpallur fitues nuk ka vërtetuar me dokumentacion provues pronësinë e implantit, sipas kërkesës në ftesën për ofertë.</p> <p>-Në të gjitha procedurat konstatohet se Certifikatat ISO të lëshuara në favor të OE, nga kompania KingCert International Certification Ltd, janë të vlefshme për një periudhë 3-vjecare, por me kusht nëse ky sistem është mirëmbajtur në mënyrë efektive dhe të jenë kryer auditime mbikëqyrëse. Pra, këto certifikata konsiderohen të vlefshme vetëm nëse plotësohet kushti i kryerjes së auditimeve mbikëqyrëse. Nga ana e AK nuk figuron e dokumentuar konfirmimi nëse është plotësuar apo jo kushti dhe si rrjedhojë nëse këto certifikata janë apo jo të vlefshme.</p>
Kriteri:	-VKM 798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores ”Për administrimin e mbetjeve spitalore””, pika 2, neni 78.
Ndikimi/Efekti:	-Kualifikimi i OE si fitues, edhe pse nuk është konfirmuar vlefshmëria e certifikatave apo mos plotësimi i të gjithë dokumentacionit të kërkuar sjell mundësi që OE i zgjedhur të mos e kryejë shërbimin e kërkuar sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor. -Mos argumentimi teknik dhe ligjor i kriterëve të vendosura nga ana e AK sjell mungesë transparence në vendosjen e kriterëve.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	-Personat përgjegjës të hartimit të kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, në çdo rast duhet ti argumentojnë teknikisht dhe ligjërisht. -Komisioni i vlerësimit të ofertave përpara kualifikimit të operatorit fitues, në çdo rast të sigurohet për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar dhe verifikimin e certifikatave që janë lëshuar me kusht vlefshmërie.
Titulli i gjetjes Nr. 14	Mungesë e vendosjes së kriterëve kualifikuese të duhura në procedurat e prokurimit me objekt trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore.
Situata:	-Nga auditimi është konstatuar se në procedurat: Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta, për

	<p>QSUNT për vitin 2021 dhe 2022, si dhe trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19, për realizimin e këtyre procedurave duhet të ishin vendosur edhe kritere të tjera kualifikuese, duke pasur në vëmendje pasojat që rrjedhin nga mos realizimi i këtij procesi në mënyrë të rregullt, si dhe cilësinë e QSUNT e cila në këtë proces është prodhuese e mbetjeve spitalore dhe si rrjedhojë është përgjegjëse për të gjithat dëmet që shkaktohen në mjedis dhe në shëndetin publik nga të gjitha hallkat e procesit deri në asgjësim të mbetjeve duhet të ishin vendosur gjithashtu edhe kriteret:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Në rast të transportit brenda vendit, Operatori duhet të paraqesë Certifikatë e miratimit për mjetet (vetëm për brenda vendit) që transportojnë disa mallra të rrezikshme. (konstatuar vetëm në procedurën e vitit 2022 dhe asgjësimi i mbetjeve ku marrin trajtim pacientët me Covid-19); -Për mjetin e transportit duhet të ishte kërkuar gjithashtu vërtetim se mjeti është regjistruar në Ministri për kryerjen e transportit të mbetjeve të rrezikshme; -Operatorit duhet ti ishte kërkuar të paraqiste Akt Miratimi Higjeno – Sanitar, të lëshuar nga Inspektorati Shëndetësor Shtetëror (ISHSH); -Duhet të ishte kërkuar që personeli i përfshirë në ngarkimin e koshave/kontenierëve tranzit duhet (të jetë kompetent dhe i trajnuar siç duhet; -Duhet të ishte kërkuar se O.E duhet të dorëzojë mbetjet e dala nga përpunimi, në një subjekt të licencuar për depozitimin e hirit (konstatuar vetëm në procedurën e vitit 2021).
Kriteri:	<p>-Ligji Nr. 10 463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, pika 2, 3 dhe 4, neni 21;</p> <p>-VKM 798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores ”Për administrimin e mbetjeve spitalore””, shkronja e), pika 5, kreu II.</p>
Ndikimi/Efekti:	Ofrimi i shërbimit pa u plotësuar kriteret e mësipërme rrezikon të sjellë pasojat të rënda në mjedis dhe në shëndetin publik.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	<p>Komisioni i hartimit të kërkesave për kualifikim, në procedurat e prokurimit me objekt “Asgjësimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme” të marrë masa për përcaktimin si kritere kualifikuese ndër të tjera: Certifikatë e miratimit për mjetet (vetëm për brenda vendit) që transportojnë disa mallra të rrezikshme, vërtetim e mjetit të regjistruar në Ministri për kryerjen e transportit të mbetjeve të rrezikshme, paraqitja e Akt Miratimit Higjeno-Sanitar lëshuar nga Inspektorati Shëndetësor Shtetëror, personeli i përfshirë në ngarkimin e koshave/kontenierëve tranzit duhet (të jetë kompetent dhe i trajnuar, OE të dorëzojë mbetjet e dala nga përpunimi, në një subjekt të licencuar për depozitimin e hirit me qëllim uljen e dëmeve që shkaktohen në mjedis dhe në shëndetin publik.</p>

Titulli i gjetjes Nr. 15	Parregullsi në dokumentimin e realizimit të procesit të trajtimit të hirit dhe të procesit të hidroklovimit.
Situata:	<p>-Në zbatim të procedurës së prokurimit me objekt “Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta, për QSUNT, për 12 muaj”, viti 2021, nuk dokumentohet përmbushja e detyrimit për trajtimin e hirit të prodhuar. Nuk konstatohen gjurmë auditimi/dokumentacioni me qëllim vërtetimin e asgjësimit të mbetjeve, përkatësisht shiritat e incineratorit. AK ka shlyer në mënyrë të plotë detyrimet që kanë rrjedhur si pasojë e zbatimit të kontratës, edhe pse nuk ka marrë siguri lidhur me realizimin e shërbimit të kërkuar, por është mjaftuar vetëm në konfirmimet e përcjella nga OE, të cilat janë në formë vetëdeklarimi.</p> <p>-Në procedurën e prokurimit me objekt “Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta, për QSUNT për vitin 2022” rezulton e paqartë ecuria e procesit të hirit të krijuar, nëse ai dorëzohet pranë një subjekti të licencuar për ta trajtuar apo jo. Është konstatuar një diferencë prej 1,708.1 kg, e cila nuk provohet e asgjësuar me anë të shiritave të incineratorit, si rrjedhojë AK nuk merr sigurinë e duhur që shërbimi i kërkuar dhe i paguar gjithashtu është ofruar sipas kushteve të rëna dakord.</p> <p>-Në procedurën e prokurimit me objekt “Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19, marrëveshje kuadër me afat 12 muaj”, në DST (Shtojcë për ndryshime në DST) është kërkuar Leje Mjedisore Tipi B (Kodi III.1.B) ku të ketë të përfshirë metodën e Autoklavimit/Hidroklovimit, për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore, ose stacion transferimi mbetjesh në rastin kur OE/BOE deklaron se këto mbetje do të transferohen/asgjësohen jashtë territorit të RSHM dhe/ose Leje Mjedisore të Tipit A (Kodi III.1.C) ku të ketë të përfshirë metodën e Incineratorimit, për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore ose stacion transferimi mbetjesh në rastin kur OE/BOE deklaron se këto mbetje do të transferohen/asgjësohen jashtë territorit të RSHM. Gjatë hartimit të kriterëve të kualifikimit AK sqaron në procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim se: <i>”...ka marrë për bazë shkresën e ISHP, e cila i ka drejtuar që trajtimi dhe asgjësimi të kryhet me metodën e Hidroklavës/Autoklavës dhe Incinerimit...”</i>. Edhe pse është bazuar në këtë shkresë, ka kërkuar që OE ti paraqesë të dyja Lejet ose njëren prej tyre, pra duke e lënë në diskrecion të OE.</p> <p>-Konstatohet se OE i shpallur fitues në Lejen e Mjedisit tipi B, me Nr. identifikimi 1780/3, datë 06.04.2021 nuk e ka të drejtën e asgjësimit/trajtimit të mbetjeve me kod 18 01 02 (referuar tabelës 8.1.2). Referuar mungesës së Lejes për trajtimin e mbetjeve me kod 18 01 02 me hidrokalvë/autoklavë, si dhe në mbështetje të faktit se OE nuk ka përcjellë asnjë dokument vërtetues se janë kryer të dyja proceset (printim gjatë procesit të punës me hidroklavë/autoklavë dhe</p>

	incenerim), konsiderohet se procesi i hidroklavës nuk provohet të kryhet nga ana e OE, edhe pse QSUNT e paguan si shpenzim të plotë. Në këtë procedurë është e paqartë ecuria e procesit të hirit të krijuar, nëse ai dorëzohet pranë një subjekti të licencuar për ta trajtuar apo jo.
Kriteri:	-Ligji Nr. 10 463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar; -VKM 798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores ”Për administrimin e mbetjeve spitalore””; - Shkresa e Institutit të Shëndetit Publik Nr. 578/67 prot., datë 12.03.2020.
Ndikimi/Efekti:	-Duke marrë parasysh llojin e mbetjeve të trajtuara dhe dëmin që mund të shkaktojë në mjedis hiri që mbetet pas asgjësimit të mbetjeve, mos përmbushja e këtij detyrimi, për të cilin është rënë dakord ndërmjet palëve sjell ndikim në mjedis dhe në shëndetin publik. -Mungesa e dokumentacionit nga OE për realizimin e procesit të hidroklavës, sjell ndikim në aspektin financiar të QSUNT dhe mos realizim të procedurës sipas kërkesave të OE.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	-Titullari i Institucionit përpara nënshkrimit të kontratës me OE që do të trajtojë mbetjet e rrezikshme spitalore, të sigurohet nëpërmjet strukturave përgjegjëse se përgjatë periudhës që kontrata do të jetë në fuqi OE të ketë një marrëdhënie kontraktuale me një subjekt që do të kryejë asgjësimin e hirit. Gjithashtu, në çdo rast strukturat përgjegjëse të vijojnë me dokumentacionin justifikues për shlyerjen e faturës, vetëm pasi të sigurohen se hiri i prodhuar është asgjësuar, duke marrë siguri të plotë se hallka e fundit e procesit të asgjësimit ka përfunduar me sukses. -QSUNT në çdo rast përpara shlyerjes së faturës me OE i cili ka marrë përsipër trajtimin e mbetjeve të rrezikshme, të sigurohet me anë të dokumentave provues se procesi i trajtimit (me incenerim apo hidroklavë/autoklavë) për të gjithë sasinë e mbetjeve të dorëzuara ka përfunduar me sukses.
Titulli i gjetjes Nr. 16	Prokurimi pa të drejtë i shërbimit të hidroklavës nga QSUNT
Situata:	-QSUNT për të realizuar trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19 ka vendosur që këtë shërbim ta prokurojë. QSUNT ka në pronësi të saj një pajisje “Hidroklavë” me Nr. Serial HSC-091215112, Model H-15, Prodhues HydroclaveInc., me qëllim trajtimin e mbetjeve. Si rrjedhojë, QSUNT është pajisur me Akt Miratimi, Leje Mjedisi Tipi B, me Nr. identifikimi të lejes 1819, datë 26.03.2015. Bazuar në lejen sipërcituar, QSUNT i është njohur e drejta për asgjësimin e mbetjeve

të rrezikshme përveç incenerimit ose lëndfillit. Ndër të tjera, objekt i kësaj leje është edhe asgjësimi i mbetjeve me kod 18 01 02 (pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut) dhe kod 18 01 03 (Mbetjet grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet).

Me anë të shkresës Nr. 578/65 prot., datë 11.03.2020 QSUNT i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor dhe Institutit të Shëndetit Publik lidhur me mbetjet e spitalore të prodhuara nga rastet e pacientëve me COVID-19, të cilat i ka konsideruar potencialisht të rrezikshme, përkatësisht: Pajisjet personale mbrojtëse (PPE) të stafit që ekspozohet ndaj COVID-19 dhe ambalazhet ushqimore një përdorimshme, shishet plastike dhe çdo lloj mbetje tjetër që gjenerohet nga kontakti me pacientin e konfirmuar me COVID-19. Gjithashtu, me anë të kësaj shkrese ka bërë me dije se referuar specifikimeve teknike të aparaturës së trajtimit të mbetjeve (Hidroklavë), që disponojnë nuk është i mundur trajtimi i tyre. Nga auditimi u konstatua se shkresa nuk mbështetej në asnjë relacion që të pasqyronte arsyet e mos realizimit dot të kësaj procedure me anë të Hidroklavës e cila disponohet dhe është në gjendje pune nga QSUNT, edhe pse punonjës të QSUNT deklaruan se Hidroklava ishte testuar për ta kryer këtë proces paraprakisht, por nuk kishte rezultuar e suksesshme (për këtë testim nuk rezulton i mbajtur asnjë procesverbal).

Në përgjigje të saj, Instituti i Shëndetit Publik, me anë të shkresës 578/67 prot., datë 12.03.2020 ka bërë me dije se trajtimi i këtyre mbetjeve duhet të bëhet me metodën e Hidroklavimit dhe Incinerimit. E iniciuar nga informacioni i përcjellë nga QSUNT, se bazuar në specifikimet teknike të Hidroklavës që disponohet nga QSUNT, nuk është i mundur trajtimi dhe menaxhimi i tyre, sugjeron që këto mbetje duhet të trajtohen me incinerim dhe kuadrit ligjor që rregullon këtë proces (rekomandimet e O.), ISHP orienton QSUNT drejt përdorimit të Hidroklavës dhe në pamundësi të përdorimit të saj drejt Incinerimit, pra nënkupton që mjafton një prej metodave dhe jo detyrimisht të dyja.

Mbështetur në sa mësipërm, si dhe referuar informacionit të përfituar nga regjistri i mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore nga shërbimi i ofruar nga OE "M.", rezulton se pajisja Hidroklavë me Nr. Serial HSC-091215112 nuk ka shfaqur asnjëherë problematika përgjatë vitit 2022 dhe ka rezultuar në gjendje normale pune në përputhje me rekomandimet e prodhuesit. Procesverbalet për mirëmbajtjen funksionale janë firmosur nga përfaqësues të OE dhe Përgjegjësi i Sektorit Teknik pranë QSUNT.

Si rrjedhojë, ndodhur në kushtet e mësipërme QSUNT i kishte të gjitha mundësitë për ta kryer procesin me anë të Hidroklavës që disponon dhe të mos vijonte procedurat e prokurimit, e cila i ka

	kushtuar në total 2,678,780 lekë (hidroklavë dhe incinerim).
Kriteri:	-Ligji Nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”; -VKM 798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullore ”Për administrimin e mbetjeve spitalore”.
Ndikimi/Efekti:	-Prokurimi i shërbimit, i cili mund të kryhej edhe nga QSUNT me anë të pajisjes “Hidroklavë” sjell kosto shtesë financiare për buxhetin e QSUNT.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Strukturat drejtuese të QSUNT të marrin masa për mbetjet spitalore që mund të trajtohen me hidroklavë, ta kryejë vetë si proces pa qenë e nevojshme prokurimi i këtij shërbimi. Në rastet kur pajisja “Hidroklavë” nuk ka kapacitet të mjaftueshëm ose paraqet defekt, të argumentohet nga personat përgjegjës dhe ti drejtohen OE i cili ka lidhur një marrëdhënie kontraktuale me QSUNT për mirëmbajtjen e pajisjeve me qëllim rregullimin e defektit të ndodhur dhe mirë përdorimin e fondeve publike.

Titulli i gjetjes Nr. 17	Procedura e trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19
Situata:	Me anë të shkresës Nr. 578/65 prot., datë 11.03.2020 QSUNT i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor dhe Institutit të Shëndetit Publik lidhur me mbetjet e spitalore të prodhuara nga rastet e pacientëve me COVID-19, të cilat i ka konsideruar potencialisht të rrezikshme, përkatësisht: Pajisjet personale mbrojtëse (PPE) të stafit që ekspozohet ndaj COVID-19 dhe ambalazhet ushqimore një përdorimshme, shishet plastike dhe çdo lloj mbetje tjetër që gjenerohet nga kontakti me pacientin e konfirmuar me COVID-19. Gjithashtu, me anë të kësaj shkrese ka bërë me dije se referuar specifikimeve teknike të aparaturës së trajtimit të mbetjeve (Hidroklavë), që disponojnë nuk është i mundur trajtimi i tyre. Në përgjigje të saj, Instituti i Shëndetit Publik, me anë të shkresës Nr. 578/67 prot., datë 12.03.2020 ka bërë me dije se trajtimi i këtyre mbetjeve duhet të bëhet me metodën e Hidroklavimit dhe Incinerimit . E iniciuar nga informacioni i përcjellë nga QSUNT, se bazuar në specifikimet teknike të Hidroklavës që disponohet nga QSUNT, nuk është i mundur trajtimi dhe menaxhimi i tyre, sugjeron që këto mbetje duhet të trajtohen me incinerim, pra ISHP orienton QSUNT drejt përdorimit të Hidroklavës dhe në pamundësi të përdorimit të saj drejt Incinerimit, pra nënkupton që mjafton një

	<p>prej metodave dhe jo detyrimisht të dyja. Mbështetur në sa mësipër, QSUNT vendosi që mbetjet që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19, ti trajtojë me të dyja metodat, pra Hidroklavë dhe Incenerim, si dhe ta prokurojë këtë shërbim.</p> <p>Ndodhur në kushtet e mësipërme, shkresa e ISHP me Nr. 578/67 prot., datë 12.03.2020, lë hapësirë për keqinterpretim, pasi në fillim e drejton subjektin të përdorë detyrimisht të dyja metodat, përkatësisht Hidroklavimi dhe Incenerim, dhe në vijim arsyeton se meqënëse QSUNT nuk e ka të mundur përdorimin e Hidroklavës (të pa argumentuar mbi arsyet), kjo e fundit mund ti drejtohet vetëm metodës së Incenerimit. Si pasojë e keqinterpretimit, QSUNT ka vendosur ti trajtojë mbetjet e prodhuara nga rastet e pacientëve me COVID-19, duke prokuruar shërbimin me të dyja metodat.</p> <p>Konstatohet se shkresa Nr. 578/67 prot., datë 12.03.2020 e Institutit të Shëndetit Publik nuk është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, përkatësisht rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, e cila referuar udhëzimeve mbi menaxhimin e virusit COVID-19, ka përcaktuar se “Alternativat e trajtimit të mbetjeve të prodhuara nga rastet e pacientëve me COVID-19 janë me Autoklavë ose Incenerim”.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> -Ligji Nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”; -VKM 798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores ”Për administrimin e mbetjeve spitalore”; -Shkresa Nr. 578/67 prot., datë 12.03.2020 e ISHP; - Udhëzimi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë mbi menaxhimin e virusit COVID-19, datë 23.04.2020.
Ndikimi/Efekti:	-Mos përcaktimi i saktë i metodave që duhen përdorur për asgjësimin dhe trajtimin e mbetjeve të prodhuara nga rastet e pacientëve me COVID-19 sjell kosto shtesë financiare për buxhetin e QSUNT.
Shkaku:	Mos zbatimi i saktë i kuadrin ligjor.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	ISHP të konsultohet me strukturat përkatëse të Organizatës Botërore të Shëndetësisë lidhur me rekomandimet e përditësuara për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të prodhuara nga rastet e pacientëve me COVID-19 dhe në mbështetje të kuadrin ligjor në fuqi që rregullon këtë fushë të udhëzoj subjektet që prodhojnë mbetje nga rastet e pacientëve me COVID-19 me metodën e duhur të trajtimit dhe asgjësimit.
Titulli i gjetjes Nr. 18	Mos respektimi i afateve në faza të ndryshme të një procedure prokurimi.
	- Në procedurën e prokurimit me objekt: “Sigurimi i ageve të skleroterapisë për trajtimin e pacientëve me hemorragji digjестive dhe ageve të biopsisë për diagnozën e pacientëve me patologji të traktit tretës, si dhe materiale mjekësore për endoskopi” është tejkaluar afati i

Situata:	<p>vlerësimit të ofertave deri në njoftimin e fituesit. Dorëzimi i ofertave nga OE është bërë në datë 12.01.2021, ndërkohë që njoftimi i fituesit është bërë në datë 20.04.2021. Vlerësimi i ofertave nuk duhet të kalojë 15 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla.</p> <p>KVO dërgon procesverbalin për shtyrje afati ku citon se: duke qene se anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave janë të angazhuar edhe në detyra të tjera institucionale, korrespondencave të nevojshme për vlerësimin e kësaj procedurë. Ligji nuk parashikon shtyrjen e afatit për shkak të detyrave të tjera funksionale që kanë anëtarët e KVO.</p> <p>-Konstatohet se ka një tej zgjatje të procedurës pavarësisht <u>nevojave emergjente</u>, dhe është zgjatur pothuajse 6 muaj. Fillon procedura e prokurimit nga AK në mars të vitit 2022 dhe finalizohet në muajin gusht të vitit 2022. Pra nuk justifikohet nevoja emergjente për kryerjen e këtij prokurimi me tej zgjatjen në kohë (F.V e skanerave).</p>
Kriteri:	<p>-VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 82.</p> <p>-Kodi i procedurës Administrative, neni 92, dhe neni 91.</p> <p>- Rregullat e LPP 162/2020 dhe VKM 285.</p>
Ndikimi/Efekti:	Mosrealizimi i prokurimit në afat ka sjellë mangësi në diagnostikimin e pacientëve.
Shkaku:	Mosrespektimi i afateve gjatë fazës së parë dhe gjatë vlerësimit të ofertave.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	AK të marrë masa për parashikimin dhe kryerjen në kohë të procedurave të prokurimit që lidhen me kujdesin shëndetësor të pacientëve me qëllim diagnostikimin në kohë të sëmundjeve dhe shmangien e procedurave të tjera emergjente për plotësimin e nevojave me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

Titulli i gjetjes Nr. 19	Mungesa e argumentimit të nevojave për mallin që do të prokurohet
Situata:	<p>Në procedurën “Sigurimi i ageve të skleroterapisë për trajtimin e pacientëve me hemoragji digjестive dhe ageve të biopsisë për diagnozën e pacientëve me patologji të traktit tretës, si dhe material mjekësore për endoskopi” nuk është argumentuar nevoja e mallit që prokurohet. Konkretisht në hartimin e nevojave nga Shërbimi i Kirurgjisë së Përgjithshme dhe nga Shërbimi i Gastro-Entero-Hepatologjisë, nuk shprehet qartë sasia e nevojshme për zhvillimin e procedurës së prokurimit. Farmacia qendrore nga informacioni i kërkuar konfirmon se gjendja ka qenë “0” por nuk është evidentuar se për cilën kategori nga këto materiale mjekësore, e po ashtu nuk dihet numri i daljeve të materialeve mjekësore që ka bërë për shërbimin e kirurgjisë së përgjithshme dhe shërbimin e gastro-entero-hepatologjisë, me qëllim planifikimin e saktë të nevojave.</p>
Kriteri:	-VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 2, pika 2.

Ndikimi/Efekti:	Mos evidentimi i nevojave reale për trajtimin e pacientëve me hemoragji digjестive dhe ageve të biopsies, sjell anomali dhe mungesën e shërbimit si për pacientët nga Tirana ashtu edhe për pacientët nga rrethet.
Shkaku:	Mos planifikimi i saktë i nevojave dhe sasisë së mallrave të prokuruar.
Rëndësi:	E mesme
Rekomandim:	AK të marrë masa për evidentimin, argumentimin dhe planifikimin e nevojave për materialet mjekësore, me qëllim trajtimin e pacientëve në kohë me cilësi dhe kryerjen e prokurimit me efektivitet.

Titulli i gjetjes Nr. 20	Diferenca të theksuara ndërmjet sasisë që prokurohet dhe konsumit real të mallit
Situata:	<p>Në procedurën e prokurimit të “Blerje të sistemeve të transfuzionit të gjakut”, gjatë shqyrtimit të urdhër shpenzimeve, konkretisht ato me Nr. 385 datë 09.03.2021, në bazë të kontratës me Nr.201/7 datë 09.02.2021. Fletë hyrje në magazinë në datë 10.02.2021, ku janë blerë gjithsesi 11000 copë. Gjithashtu urdhër shpenzimi Nr. 1658 datë 27.07.2021, në bazë të kontratës së furnizimit me Nr. 201/12 më datë 05.07.2021. Fletë hyrje në farmacinë qendrore me datë 05.07.2021 ku janë blerë gjithsesi 16000. Njësitë totale të cilat janë <u>27000</u> sisteme të transfuzionit të gjakut, duke mbetur kështu gjendje 10390 sisteme në datën 01.10.2021. Pra nevoja gjatë një viti ka qenë 16610 sisteme të transfuzionit të gjakut, kjo shifër duke ju referuar prokurimi të mallit dhe gjendjes në magazinë.</p> <p>Procesverbali i argumentimit të nevojave nuk ka argumentim se sa është kërkesa mesatare e konsumit mujor nga pavianët përkatëse. Ndërkohë që nga konstatimi gjendjes reale të këtij malli në magazinën qendrore të QSUNT, nuk përputhen tendencat për nevojën e këtij malli me sasinë që kërkohet të prokurohet. Ka diferenca të theksuara, në rritje ndërmjet sasisë që prokurohet dhe konsumit real të mallit.</p>
Kriteri:	Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” neni 21.
Ndikimi/Efekti:	Diferenca e theksuar me rreth 50%, ndërmjet sasisë së prokuruar dhe nevojave, sjell uljen e konkurrencës si një nga parimet bazë të prokurimit. Në kushtet e kërkesës për një sasi të madhe malli nuk mund të përgjigjen për pjesëmarrje në prokurim edhe operatorë të tjerë ekonomik, duke favorizuar vetëm OE të cilët gëzojnë mundësinë e plotësimit të kërkesave lidhur me gjendjen teknike dhe financiare.
Shkaku:	Neglizhencë dhe favorizim i një OE nga strukturat e prokurimit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	QSUNT, strukturat e prokurimit të marrin masa për argumentimin e saktë e nevojave të sistemeve të transfuzionit të gjakut referuar konsumit të vitit të mëparshëm me qëllim plotësimin e nevojave të PAI-t përkatës dhe arritjen e një prokurimi me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet duke respektuar parimin e konkurrencës.

Titulli i gjetjes Nr. 21	Parregullsi në procedurën e prokurimit “F.V X-Ray Tube & F.V modul detektori për rikthim në gjendje funksionale të pajisjes
---------------------------------	---

	mjekësore skaner CT prodhues GE ”
Situata:	<p>Në kontratën e shërbimit Nr.173/21 të datës 01.02.2021, pra kontratës 11 mujore të mirëmbajtjes të skanerave GE me operator ekonomik “M. ” me vlerë 17,483,868 me TVSH në procesverbalet e mbajtur për shërbimin e mirëmbajtjes së skanerëve mungojnë specifikimet se cilat janë pjesët e skanerit që janë mirëmbajtur, sipas veçorive që ato kanë dhe cili skaner është mirëmbajtur sipas kushteve të kontratës. Në këtë mënyrë nuk mund të evidentohen pjesët mjekësore të cilat janë mallra konsumi dhe lind nevoja e zëvendësimit. Gjithashtu, shumica e procesverbaleve nuk janë të shoqëruar me formularin e mirëmbajtjes dhe nuk janë absolutisht të qarta se për cilën skaner janë bërë mirëmbajtjet preventive dhe korrigjuese.</p> <p>-Mungon dokumentacioni justifikues nëse skanerat janë transferuar në një PAI tjetër dhe për shkaqe të tilla nuk kanë punuar, në këto kushte rezulton se kontrata nuk është realizuar brenda afateve të përcaktuara ose nuk është zbatuar.</p> <p>-QSUNT nuk ka marrë masa për një procedurë prokurimi mirëmbajtje, me qëllim vazhdimin e punës së skanerëve në shërbim të pacientëve dhe mire menaxhimin e fondeve publike duke mos lejuar mbivendosjen në kohë të procedurave të prokurimit.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Udhëzimin Nr.2, datë 18.03.2022 “Mbi raportimin e zbatimit të kontratës” dhe neni 124 LPP. - Udhëzimit 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 54. - Ligji Nr. 162 date 23.12.2020 për prokurimin publik neni 124.
Ndikimi/Efekti:	-Nuk evidentohet në procesverbalet e mbajtura shërbimi periodik i kryer për mirëmbajtjen e skanerit i specifikuar sipas llojit të skanerit.
Shkaku:	Neglizhencë nga strukturat përgjegjëse për ndjekjen e kontratës.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Strukturat përgjegjëse për zbatimin e kontratave të marrin masa për hartimin e procesverbaleve të kryerjes së shërbimit, duke përcaktuar të gjitha shërbimet e kryera sipas llojit të skanerit.

Titulli i gjetjes Nr. 22	Mangësi në dokumentacionin e likuidimit
Situata:	<p>-Me urdhër shpenzimi Nr.1852, datë 24.08.2021 me vlerë 5,029,781 lekë, është likuiduar fat.73/2021 datë 30.07.2021, e cila i referohet kontratës së shërbimit Nr.173/21 të datës 01.02.2021, pra kontratës 11 mujore të mirëmbajtjes të skanerave GE.</p> <p>-Situacioni i punimeve dhe procesverbali i mirëmbajtjes funksionale i përkasin kontratës së shërbimit Nr.173/36 , datë 04.02.2021, mirëmbajtje që janë faturuar kontratës së shërbimit të prodhuesve GE, në fakt është bërë për aparaturat EMG të prodhuesit Micromed, pajisjet të Endoskopisë të prodhuesit KARL STORZ, pajisje Fibroscan prodhues ECHOSENS dhe Hidroklave me prodhues Hidroklave. Ndërkohë që procesverbali bashkëlidhur urdhër shpenzimit i mbajtur nga drejtorja e IT</p>

	dhe e Inxhinierisë Klinike në datën 28.07.2021 për periudhën 02.04.2021 deri më 01.07.2021 ku shprehet se punimet janë kryer brenda afateve kohore dhe kushteve të kontratës dhe në prani të inxhinierëve të I.K për të 3 skanerat GE, është firmosur nga Drejtori i IT dhe I.K znj. B.M. dhe përfaqësuesi i “M.”.
Kriteri:	-Udhëzimit 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 54 -LPP 162/2020 neni 124.
Ndikimi/Efekti:	Mos plotësim me dokumentacionin justifikues të urdhër shpenzimit, sipas llojit të shërbimit.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit Financiar të marrë masa që çdo urdhër-shpenzim ta plotësohet me dokumentacion justifikues referuar kontratës së nënshkruar nga palët duke respektuar objektin, afatet, vlerën dhe llojin e shërbimit të kryer.

Titulli i gjetjes Nr. 23	Mungesa e mirëmbajtjes parandaluese duke i nxjerrë pajisjet mjekësore jo në gjendje pune.
Situata:	-Nuk është kryer mirëmbajtja parandaluese apo preventive e pajisjeve mjekësore sipas kontratës së shërbimit Nr.173/21 prot., datë 01.02.2021 për të parandaluar defektet që lidhen me përdorimin e tyre dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, si dhe për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve.
Kriteri:	LPP 162/2020 neni 124 dhe Kontrata e shërbimit Nr.173/21.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e mirëmbajtjes parandaluese ka sjellë degradim të skanerave dhe nxjerrjen e tyre jashtë funksioni.
Shkaku:	Nuk është zbatuar kontrata.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	QSUNT të marrë masa për zbatimin korrekt të kontratave të mirëmbajtjes me qëllim parandalimin e defekteve të pajisjeve mjekësore që të mos dalin jashtë funksionit si edhe eliminimin e procedurave të reja të prokurimit.

- Për sa trajtuar në këtë Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga Shoqëria “B.A.” sh.p.k është paraqitur observacioni me shkresën Nr. 175/142 prot., datë 07.08.2023, administruar në KLSH me Nr. 1177/23 prot., datë 08.08.2023 në lidhje me furnizimin e Spitalit A2, me shtretër manual, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Vlerësimi i 130 shtretërve me kontroll manual si të përdorur është subjektiv, i pa bazuar në fakte, prova apo ndonjë metod tjetër vlerësimi, si dhe fytes për reputacionin e kompanisë tonë. Vlerësimi i artikujve si të përdorur dhe jo të rinjë, nuk mund të kryhet pa ekspertizën e duhur dhe në mënyrë subjektive nga persona pa kualifikimin përkatës. Shtretërit janë furnizuar konform specifikimeve teknike, bashkëngjitur do të gjeni: Deklaratën doganore, 02.11.2022 dhe 17.11.2022, deklaratën e prodhuesit, dhe letrën e origjinës.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimi nuk qëndron, me arsytet si më poshtë:

Së pari. Grupi i auditimit administron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, i bazuar, cili fakton dhe provon/vërteton, gjetjet e konstatuara).

Së dyti. Programi i auditimit Nr. 1177/1 prot., datë 13.01.2023, i ndryshuar, i miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka të përcaktuar grupin e auditimit, në përbërjen e të cilit ka auditues me ekspertizën e nevojshme profesionale dhe juridike për të gjitha pikat e programit të auditimit. Referuar sa mësipër, në zbatim të Ligjit Nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionim e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Rregulloren e procedurave të auditimit të miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107 datë 08.08.2017 e ndryshuar me vendim Nr. 63, datë 22.06.2020, manualit të përputhmërisë, grupi i auditimit për çdo shkëlqje të konstatuar ka dhënë opinionin e tij, brenda sigurisë së arsyeshme²².

Së treti. Pajisjet/shtretërit janë të pa shoqëruara me raportet e testeve (test raportin e fabrikës), veprim në kundërshtim me Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqëruar të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.

Mos shoqërimi me raportet e testeve (test raportin e fabrikës) për pajisjet /shtretërve, dokument i rëndësishëm për të bërë verifikimi dokumentar të specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës (raportet e testeve), që të konfirmohet që pajisjet /shtretërit janë të njëjtë me ata të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “B.A.” Sh.p.k ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

Së katërti. Verifikimi fizik i kryer në Spitalin A2 (Urgjencës), më datë 27 dhe 28.03.2023 është bërë në prani të E.N. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore dhe E.K. me detyrë Specialist/ Inxhinier Biomedikal i Sektorit të Inxhinierisë Klinike. Së pesti. Në kontratë nuk ka asnjë klauzol (nuk është përcaktuar) që shtretërit duhet të jenë të rinj, si dhe në deklaratën doganore dhe dokumentacionin që ju pretendoni, nuk prezantohet në asnjë rast.

Së gjashti. Dokumentacioni bashkëlidhur këtij observacioni (Manufacturer’s Declaration, datë 06.06.2023 (dokumet që nuk ka lidhje me kontratën në fjalë, pasi është në vitin 2023), letër of origin/ nense mektubu, e pa datuar, commercial invoice date 27.10.2022 dhe 14.11.2022, packing list datë 27.10.2022 dhe datë 14.11.2022, raport montimi/instalimi datë 29.11.2022 janë të fotokopjuara dhe të pa vërtetuara nga noteri në zbatim të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”, neni 62/1.i, për pasojë janë dokumente të pabesueshme për tu marr në konsideratë nga grupi i auditimit.

Së shtati. Pretendimi është në kundërshtim me:

Kontratën me Nr. 64/124 prot., datë 26.07.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shoqërisë “B.A.” Shpk në vlerën 23,064,000 lekë me tvsh, neni 5.1.

- Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 122 “Rregullat që zbatohen për kontratën”, pika 1. Kushtet e kontratës të lidhur sipas këtij ligji nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur

²² ISSAI 300. Siguria e arsyeshme është siguri e lartë, por jo absolute. Për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, ai normalisht nuk jep siguri maksimale në shkallën 100%.

kontraktori, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

- Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi civil” nenet 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur “...Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblimin e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguar”.

- Deklaratën datë 18.10.2021 mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik “B.A.” Shpk.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga, G.S. me detyrë ish-përgjegjëse sektori e Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike, është paraqitur observacioni me shkresën Nr.175/128 prot., datë 03.08.2023, në lidhje me Kabinetin e endoskopisë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Pretendimi i KVO se kualifikimi i operatorit “A.”, Shpk është i drejtë.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimi nuk qëndron, argumenti i detajuar përse nuk qëndron është pasqyruar në akt konstatimin Aktkonstatimin Nr. 7, datë 31.05.2023 datë 31.05.2023 dhe në Projekt Raportin e Auditimit.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit

- Për sa trajtuar në këtë Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga Shoqëria “R.A.” sh.p.k është paraqitur observacioni me shkresën Nr. 175/131 prot., datë 04.08.2023, në lidhje me furnizimin e Spitalit A2, me shtretër manual, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Nga studimi i këtij projekt-raporti, konstatojmë se ai nuk është i saktë, konkluzionet nuk i përgjigjen realitetit, janë të pa bazuara në ligj e në prova, e si të tillë e kundërshtojmë si më poshtë:

Dokumentet sipas deklaratës datë 03.05.2022 janë dorëzuar si: autorizim prodhuesi, certifikatat ISO të R.A. dhe kompanive importuese, testraportet të firmave prodhuese të mallrave të importuara dhe të lëndës së par, deklarata konformiteti, deklaratë garancie etj. Komisioni i marrjes në dorëzim ka konstatuar se malli, ka qenë konformë të gjitha specifikimeve teknike. Ne nuk kemi asnjë foto ose dokumentacion apo konstatim se ku janë provat të pretendimeve të ngritura nga ana juaj. Jemi të interesuar të dimë ju si auditues (pasi nuk keni dhënë asnjë argument se si i keni vërtetuar këto pretendime), jeni konsultuar me ndonjë specialist fushe, keni analizuar mostra apo i keni konstatuar me sy te lir problematikat e parashtruara në projekt raport. Nëse do të ishit konsultuar me specialist të fushës, nuk do të kishit arritur në këto konkluzione të gabuara.

Rekomandimi i dhënë për dëmin ekonomik dhe mënyrën e rikuperimit të tij është i gabuar dhe i pa mbështetur në ligj, pasi nuk jeni ne si operator ekonomik që auditohemi, por Autoriteti kontraktor QSUNT, etj.

Kjo procedurë është fituar nga R.A. me gjysmën e fondit limit të hapjes nga 147,864,531 lekë, fituar në 74,993,500 lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimi nuk qëndron, me arsyet si më poshtë:

Së pari. Grupi i auditimit administron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, i cili fakton dhe provon/vërteton, gjetjet e konstatuara).

Së dyti. Programi i auditimit Nr. 1177/1 prot., datë 13.01.2023, i ndryshuar, i miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka të përcaktuar grupin e auditimit, në përbërjen e të cilit ka auditues me ekspertizën e nevojshme profesionale dhe juridike. Referuar sa mësipër, në zbatim të Ligjit Nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionim e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Rregulloren e procedurave të auditimit të miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107 datë 08.08.2017 e ndryshuar me vendim Nr. 63, datë 22.06.2020, manualit të përputhmërisë. grupi i auditimit i auditimit për çdo shkelje të konstatuar ka dhënë opinionin e tij, brenda sigurisë së arsyeshme²³.

Së treti. Grupi i auditimit ka audituar QSUNT, për pasoj Shoqëria “R.A.” shpk nuk ka se si të ketë nga grupi i auditimit, foto, apo dokumentacion që fakton mbi bazën e provave gjetjet e konstatuara. Referuar kontratës që keni me QSUNT, fotot dhe diçka tjetër duhet ti kërkoj në QSUNT.

Së katërti. Verifikimi fizik i kryer në Spitalin A2 (Urgjencës), më datë 27 dhe 28.03.2023 është bërë në prani të E.N.me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore dhe E.K.me detyrë Specialist/ Inxhinier Biomedikal i Sektorit të Inxhinierisë Klinike.

Së pesti. Për dëmnin ekonomik në Projekt-raport është shprehur në mënyrë eksplicite se “Të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 25,605,000 lekë nga Shoqëria “R.A.” Shpk. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, si pasojë e mos zbatim të specifikimeve teknike në kontratën “Mobilimi i Spitalit të Ri të Ndërtuar (A2), me fond limit 147,864,531 lekë pa TVSH”.

Pra i është kërkuar QSUNT dhe jo Shoqërisë “R.A.” Shpk.

Së gjashti. Mjafton vetëm pretendimi se Kjo procedurë është fituar nga R.A. me gjysmën e fondit limit të hapjes nga 147,864,531 lekë, fituar në 74,993,500 lekë, provon jo vetëm që kjo shoqëri duhej të ishte s’kualifikuar (është kualifikuar padrejtësisht), por dhe përse mobiljet janë furnizuar në kundërshtim me detyrimet kontraktuale (specifikimet teknike).

Së shtati. Pretendimet janë në kundërshtim me :

-Marrëveshjen kuadër të lidhur me Nr. 7/26 prot., datë 17.07.2020 ndërmjet QSUNT dhe operatori ekonomik “R.A.” Shpk.

-Kontratën furnizimi Nr. I, lidhur me Nr. 62/127 prot., datë 16.08.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shoqërisë “R.A.” Shpk në vlerën 59,736,000 lekë me TVSH, neni 5.

-Kontratën furnizimi II, lidhur me Nr. 62/142 prot., datë 22.08.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shoqërisë “R.A.” Shpk në vlerën 81,970,200 lekë me TVSH, neni 5.

-Kontratën furnizimi III, lidhur me Nr. 62/166 prot., datë 30.09.2022 ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shoqërisë “R.A.” Shpk në vlerën 59,736,000 lekë me TVSH.

- Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 122.

- Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690.

²³ ISSAI 300. Siguria e arsyeshme është siguri e lartë, por jo absolute. Për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, ai normalisht nuk jep siguri maksimale në shkallën 100%.

-Deklaratën datë 03.05.2022 mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik “R.A.” Shpk.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit

- Për sa trajtuar në këtë Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga Shoqëria “A.” sh.p.k është paraqitur observacioni me shkresën Nr. 175/142 prot., datë 07.08.2023, administruar në KLSH me Nr. 1177/25 prot., datë 14.08.2023 në lidhje me furnizimin e Spitalit A2, me pajisje të endoskopisë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Operatori ekonomik ka plotësuar kriterin 2.3.d “Kapaciteti teknik” të kërkesave për kualifikim. Konstatimi i grupit të auditimit se në fazën e dorëzimit të dokumentacionit nuk është dorëzuar certifikata e origjinës, nuk qëndron, pasi nuk është kërkuar në kërkuar si kriter.

Operatori ekonomik ka plotësuar kriterin 2.3.dh” të kërkesave për kualifikim. Konstatimi i grupit të auditimit për mos paraqitjen e manualeve të përdorimit nuk qëndron, pasi shoqëria jonë ka paraqitur një autodeklartë në procedurën e prokurimit, dhe këto manuale i janë dorëzuar autoritetit kontraktor ditën e instalimit.

Operatori ekonomik ka plotësuar kriterin 2.3.i të kërkesave për kualifikim. Konstatimi i grupit të auditimit se subjekti yn nuk ka paraqitur një pajisje të regjistruar në QKBPM, por ka paraqitur pajisje të cilat kanë ardhur në RSH dhe regjistruar në QKBPM secila më vehte në data dhe vite të ndryshme, me prodhues të ndryshëm dhe operatorë të ndryshëm, nuk qëndron, pasi shoqëria jonë ka paraqitur një autodeklartë për garantimin e regjistrimit të pajisjeve mjekësore, pas shpalljes së fituesit. Pasi jemi shpallur fitues të gjitha pajisjet që përbëjnë kabinetin e endoskopisë, kanë qenë ose janë të regjistruara nga ana e jonë në QKBPM.

Grupi i auditimit ka një tendencë për të njëzuar mallrat objekt kontrate në një të vetme. Ky interpretim, sikur kabineti i endoskopisë nuk është regjistruar si një i vetëm në QKBPM nga ana e jonë pas shpalljes së njoftimit të fituesit është totalisht jo objektiv.

Operatori ekonomik ka plotësuar kriterin 2.3.a. c .

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimi nuk qëndron, me argumentet si më poshtë:

Së pari. Grupi i auditimit ka audituar QSUNT dhe në rastin konkret ka dhënë opinionin e tij për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizim vendosje të aparaturave mjekësore për Spitalin e RI “Kabineti i Endoskopisë”, viti 2022. Në projekt raport është shprehur në mënyrë eksplicite se “Referuar sa më sipër: Kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik “A.”, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” nenet 77, 87, 89, 90, 92 dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82. Në opinionin e grupit të auditimit duhet të ishte shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorin ekonomik “M..” shpk me ofertë në vlerën 14,800,000 lekë. Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë B.Q., G.S.dhe B.L.”. Në këtë kontekst grupi i auditimit nuk ka kërkuar, nuk pasur kontakt verbal dhe zyrtar me Shoqërinë “A.”, për pasojë të gjitha pretendimet e ngritura për plotësimin e kritereve të mësipërme duhet ti adresoheshin QSUNT ose APP/KPP.

Për pos sa më sipër.

a. Pretendimi se në ofertën teknike të dorëzuar, në përputhje me kërkesat e pikës 2.3.d të DST pasqyrohet në formë tabele informacioni i plotë, ku është përcaktuar përveç të tjerash origjina dhe dhe prodhuesi. Por në kërkesat për kualifikim të pikës 2.3.d (proces verbali i argumentimit të kërkesave për kualifikim) është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në këtë kontekst është kërkuar dhe oferta teknike, me ane të së cilës do të bëhet e mundur verifikimi më i sakte i artikujve të

ofertuar, specifikimeve të tyre, origjina, konformiteti, etj., me dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga ofertuesi”. Pra KVO me dorëzimin e dokumentacionit shkresor duhet të kishte kërkuar përveç të tjerave dhe certifikatat e origjinës për të 19 pjesët e pajisjes, para se ta shpallte fitues.

Pretendimi në pikën 2.3.dh “Kapaciteti teknik”, DST, nga AK është kërkuar që përmbushja e kësaj pike të jetë në formë deklarative. Kjo formë përmbushje jo më kotë është kërkuar e tillë.....Pra në DST kërkohet “quint pro quo”, që në rast se shpallet fitues OE i shpallur fitues duhet ta pajisë AK me manualet e kërkuara në momentin e lëvrimit të pajisjes, pra pajisjet duhet të jenë të shoqëruara me

Së pari. Në kërkesat për kualifikim, por edhe specifikimet teknike, dhe në Seksioni III Termat dhe Kushtet e Kontratës (TKK), Shtojca 14: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Shtojca 15: Kushtet e Veçanta të Kontratës, nuk është përcaktuar Klauzola “Në rast se shpallet fitues OE i shpallur fitues duhet ta pajisë AK me manualet e kërkuara në momentin e lëvrimit të pajisjes, pra pajisjet duhet të jenë të shoqëruara me

Së dyti. Në specifikimet teknike dhe në Seksionin III Termat dhe Kushtet e Kontratës (TKK), Shtojca 14: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Shtojca 15: Kushtet e Veçanta të Kontratës nuk është përcaktuar klauzola që pajisjet do të jenë të shoqëruara me manualet e përdorimit, manualin e vendosjes sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe manualet e servisit/shërbimit, që në fakt kjo klauzolë duhet të ishte përcaktuar në këto dokumente.

Së treti. Në pikën 2.3.dh “Kapaciteti teknik”, të kërkesave për kualifikim është përcaktuar Ofertuesi duhet të paraqesë një autodeklaratë ku deklaron se pajisjet do të jenë të shoqëruara me manualet e përdorimit, manualin e vendosjes sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe manualet e servisit/shërbimit., Referuar këtij kriteri për kualifikim KVO nuk mund të bëjë interpretime, por në zbatim të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 75, pika 4, duhet:

Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë. Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, përgjegjësia për vlerësimin e ofertave është e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Përrjashtimisht, nëse Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson dhe argumenton se një ose disa kriteret janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit dhe/ose legjislacionin e fushës në fuqi, ka të drejtë t’i propozojë titullarit anulimin e procedurës.

Anëtarët e komisionit nuk kryejnë asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.

Pjesët përbërëse të pajisjes të paraqitura në ofertën teknike, kanë ardhur në Republikën e Shqipërisë dhe regjistruar në QKBPM, secila më vehte në data dhe vite të ndryshëm nga viti 2021-2022, me prodhues të ndryshëm dhe operator të ndryshëm, pra jo me një prodhues dhe jo nga një operator i vetëm.

Çka vërteton/provon se pajisja nuk ka ardhur e kompletuar nga një prodhues me vend origjine, ose i procesuar ose mbledhur mjaftueshëm të komponentëve duke rezultuar në një pajisje, nga shoqëri e certifikuar/licencuar për këtë qëllim, por është asambluar në Shqipëri.

Operatori fitues shoqëria “A.” Sh.p.k nuk e ka tagrin ligjor/teknik për ta kryer këtë asamblim. Referuar pikës 13.6.4 të VKM Nr. 731, datë 2.9.2015 “Për Miratimin e Rregullit Teknik “Për Kërkesat Thelbësore, Vlerësimin e Konformitetit. Asamblimi i pajisjes Videoendoskop, si dhe mos mbajtja e raportit të instalimit, funksionimit dhe trajnimit të stafit mjekësor jo vetëm është shpenzim që nuk ja ka arritur qëllimit, por është risk i lartë për kryerjen e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për jetën e pacientëve.

Pajisjet janë të pa shoqëruara me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test raportin e fabrikës).

Referuar sa më sipër.

- Në observacion nuk është sqaruar, cila është certifikata e origjinës së pajisjes, pra cila është kompania që ka certifikuar prodhimin ose asamblimin e kësaj pajisje dhe kalibrimin e saj.

-Pse pajisja Videoendoskop nuk është e shoqëruar raportet e testeve (test raportin e fabrikës) dokument i rëndësishëm për të bërë verifikimi dokumentar të specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës (raportet e testeve), që të konfirmohet që kjo pajisje është e njëjtë me atë të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria "A." sh.p.k ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

- Në observacion nuk është sqaruar, kush do ta mirëmbaj pajisjen, në një kohë që në praktikën e QSUNT, firmat që kanë autorizim prodhuesi, bëjnë dhe mirëmbajtjen (pra kontraktori duhet të ketë 9 autorizime nga prodhues të shumë shteteve).

-Titulli procedurës prokurimit dhe objekti i kontratës "Furnizim vendosje të aparaturave mjekësore për Spitalin e RI "Kabineti i Endoskopisë" është truk procedural për të justifikuar paligjshmërinë e asamblimit të kësaj pajisje në Shqipëri nga subjekte të pa certifikuara për këtë qëllim.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga E.J. me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm i QSUNT për periudhën 01.04.2021-03.12.2021, është paraqitur observacioni me shkresën Nr. 175/125 prot., datë 02.08.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Për procedurën e prokurimit "Full risk" të pajisjeve mjekësore të prodhuesit GE për vitin 2021, procedurës së prokurimit "FV Kokë goditëse për pajisjen mjekësore ESWL..", viti 2021, procedurës së prokurimi REF -18901-02-07-22 në vlerën 61,002,230 lekë viti 2022.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Pretendimet nuk qëndrojnë. Në mënyrë të detajuar argumentimi tekniko-juridik përse nuk qëndrojnë janë dhënë në aktkonstatimet respektive dhe në Projekt Raportin e Auditimit.

Për pos sa më sipër pretendimi se përse i takon procedurave të prokurimit, duke mos marr përsipër ti analizoj ato, për të cilat në zbatimit të legjislacionit të prokurimit, janë ngritur grupet e punës përkatëse/organet/strukturat e ngarkuara me ligj të cilat veprojnë në përputhje me ligjshmërinë në fushën e prokurimit publik, është në kundërshtim me:

-Ligjin Nr.162 datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 21 "Autoriteti ose enti kontraktor" pika 5. Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 19 "Nëpunësi autorizues", pika b ku është shprehur në ligjëratë të drejt "Sigurimin e përdorimit me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve publike që ai menaxhon. Nëpunësi autorizues vepron në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij".

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me ndryshimet vijuese të tij, KREU II "Përgjegjshmëria menaxheriale":

- Neni 8 "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", pika 1, ku është shprehur në ligjëratë të drejt "Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për

vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësisve publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

-Neni 2 “Qëllimi i ligjit” Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë”.

Neni 52 “Kryerja e shpenzimeve” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Procesi dhe përgjegjësitë për autorizimin dhe kryerjen e shpenzimeve publike përcaktohen në ligjin për kontrollin e brendshëm financiar publik. Shpenzimet e njësisve të qeverisjes së përgjithshme verifikohen në bazë të dokumentacionit të plotë, që vërteton kryerjen e shpenzimit përkatës, sipas ligjit për kontrollin e brendshëm financiar publik”.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, është paraqitur observacioni me shkresën Nr. 175/138 prot., datë 04.08.2023, ku janë shprehur pretendimet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Në lidhje me OE fitues i cili rezulton se në Lejen Mjedisore me Nr. Identifikimi 1780/3 prot., datë 06.04.2021 nuk e ka të drejtën e asgjësimit/trajtimit të mbetjeve me kod 18.01.02 (referuar tabelës 8.1.2) sqarojmë se në sistemin e prokurimit elektronik është paraqitur Licenca III.2.B, lëshuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe me Nr. identifikimi 307/1, ku në pikën 4, kushtet e licencës pika C citohet: Subjekti të administrojë dhe klasifikojë mbetjet e krijuara nga veprimtaria në përputhje me VKM 99/2005, përfshirë 18 01 02. Përsa më sipër, oferta e operatorit ekonomik fitues ka qenë në përputhje me kriteret e vendosura në DST.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Përsa i përket pretendimit tuaj risqarojmë se nga ana e subjektit është depozituar Leja e Mjedisit tipi B, me Nr. identifikimi 1780/3, datë 06.04.2021, në të cilën referuar Kushtit 8, në të cilën specifikohet se “Operatori, në përputhje me kushtet e kësaj Leje, duhet të trajtojë dhe të ruajë mbetjet sic përshkruhet në dokumentacionin e Tabelës 8.2.1...”. Në vijim tabela 8.2.1 të drejton drejt mbetjeve të specifikuar në tabelën 8.1.1 dhe 8.1.2, sipas së cilave OE nuk e ka të drejtën e asgjësimit/trajtimit të mbetjeve me kod 18 01 02 (referuar tabelës 8.1.2).

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit

-Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga Instituti i Ndërtimit Ing. Konstruktor. Enoi Deneko, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1218/1 prot., datë 04.08.2023, të protokolluara në KLSH me nr. 1177/22 prot., datë 07.08.2023 në lidhje me projekt raportin e auditimit, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

... Në pikën 4 faqe 16 të oponencës thuhet “Relacioni teknik shprehet vetëm për detyrat e grupit projektues të konstruktorëve si vlerësimi i ngarkesave dhe kombinimet e tyre, i skemave strukturore, provat, dëmtimet e mundshme, analizat modale, ndikimi në murature etj., por nuk ka asnjë të dhënë nëse këto janë realizuar realisht nga konstruktorët dhe sa janë rezultatet, pasi nuk ekzistojnë fletët e llogaritjeve. Pra oponenti është shprehur se kjo analizë nuk është realizuar dhe rekomandohet plotësimi i raportit teknik dhe nuk kanë dijeni që këto vërejte të jenë plotësuar.

....Në pikën 6 faqe 16 të oponencës, është vënë në dukje mungesa e një projekti për ndërhyrje dhe përforcime, por studioja projektuese nuk e ka parë të nevojshme përforcimet dhe nuk hyn në kompetencat e oponencës të shprehet për mundësinë e ndërhyrjeve strukturore.

Si përfundim oponenca kundërshton gjetjet projekt raport, pasi oponenca shprehet se projekti i zbatimit përsa i përket ndërhyrjeve jo-strukturore në objektin ekzistues është i zbatueshëm, gjithmonë pas plotësimit të vërejtjeve dhe rekomandimeve, e cila nuk ka ndodhur.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimi nga Instituti i Ndërtimit, thjesht ka cilësuar faktet e trajtuara, si mungesën e llogaritjeve, përforcimet e nevojshme etj, ashtu edhe mendimet personale të ing. Konstruktor. Referuar ligjit 120/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar neni 6, pika 2 citon në mënyrë eksplicite “Për çdo rast, Institucionet shtetërore ose enetet e tjera, që kryejnë oponencën teknike, janë solidarisht përgjegjëse me projektuesin për çdo dëm që rrjedh si pasojë e gabimeve ose të metave të oponencës teknike, si dhe mbajnë përgjegjësi administrative ose penale sipas rastit, për shkeljen e legjislacionit në fuqi. Pra ISTN kryen shërbime ndaj të tretëve referuar Ligjit dhe nuk është nënpunës autorizues e as zbatues, i ndonjë Institucioni Shtetëror. Referuar projektit të rikonstruksionit, konstatohet qartë se nuk janë zbatuar dhe ndjekur rregullat e Kushteve Teknike të Projektimit dhe nuk mund të merret në konsideratë.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

- Për sa trajtuar në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit, nga operatori ekonomik : “M. ” sh.p.k është paraqitur observacioni me shkresën 175/I24 datë 31.07.2023 , në lidhje me pagesën e dubluar të përfituar nga shoqëria “M. ”sh.p.k, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

.....Argumenti, dhe rrjedhimisht edhe gjithë konkluzionet, referencat ligjore si dhe “begatim pa shkak” dhe rekomandimet përkatëse të projekt-raportit nuk qëndrojnë për arsyet e mëposhtme:

1.Koka goditëse e lithotripterit të pajisjes Modulth SLX-F2 është një aksesor i konsumueshëm me afat të matshëm numerik të goditjeve që kryhen, numërohen dhe sinjalizohen në vijimësi nga vete pajisja ,varësisht sasisë se goditjeve në procedurat litotripsike që pajisja kryen. Koka goditëse nuk mirëmbahet ,as detektohet ,sikurse pjesët e tjera përbërëse të pajisjes ,ajo thjesht konsumohet proporcionalisht shkalles se përdorimit të saj.

2.Cmimi i kokës goditëse është i konsiderueshëm dhe e tejkalon normalisht koston e mirëmbajtjes “full risk” të pajisjes, kjo dëshkohet nga vlerat e kontratave të procedurave të sipërcituara, ku çmimi i kokës goditëse e tejkalon çmimin e mirëmbajtjes “full risk” të pajisjeve. Si mund të pretendohet që nëpërmjet nëpërmjet kontratës se mirëmbajtjes full risk të mbulohet është zëvendësimi i kokës goditëse, ndërkohë që çmimi i kokës goditëse është me i larte se vete kontrata e mirëmbajtjes full risk?

3.Kontratat e mirëmbajtjes se pajisjes ESWL ,model Modulith SLX-F2 ,nuk kanë përputhje kohore dhe as lidhje shkakësore me funksionimin e kokës goditëse cila konsumohet proporcionalisht sipas numrit të goditjeve që kryhen ,pavarësisht nëse pajisja përgjatë përdorimit të saj është e mbuluar me kontrate mirëmbajtje “full risk” apo jo.

Gjate kësaj kontrate mirëmbajtje “full risk”180 ditore nuk ka qëlluar gjithashtu të ndërrohet koka-goditëse. Megjithatë projekt raporti i auditimit të KLSH-së e ka konsideruar edhe këtë rast si “shërbim te dubluar”. Perse?! Edhe sikur zëvendësimi i kokës goditëse të ishte shprehimisht i përfshirë në kontratën e mirëmbajtjes (çka nuk është), përse ky rast duhej konsideruar si shërbim i dubluar nga grupi i auditimit te KLSH-së, përsa kohë që gjate afatit të kontratës së shërbimit të mirëmbajtjes nuk është ndërruar asnjë koke goditëse? Kjo dëshmon qartë inkoherencën dhe pasaktësinë e argumentimit dhe rrjedhimisht të konkluzioneve për “dublim shërbimi” dhe “begatim pa shkak” në projekt raportin e auditimit të KLSH-së, lidhur me këtë çështje.

4. Kontratat e mirëmbajtjes full risk nënkuptojnë mirëmbajtjen e pajisjeve, diagnostifikimin e defekteve, zëvendësimin e pjesëve përbërëse që kanë gjasa të defektohen, dëmtohen, pra që kanë risk dëmtimi.

5. Për të gjithë arsyet e mësipërme zëvendësimi i kokës goditëse si pjesë me konsum numerik goditjesh (pra material konsumi) është prokuruar prej mese 10 vitesh nga QSUNT me procedura prokurimi furnizim-vendosje mallrash, jashtë kontratave të shërbimit të mirëmbajtjes full risk të pajisjes ESWL model Modulith SLX-F2.

6. Nëse koka goditëse do të kërkohet të zëvendësohet nëpërmjet kontratës së mirëmbajtjes full risk të pajisjes ESWL, për vete rëndësinë dhe koston shume të lartë që ajo ka, duhet të cilësohet shprehimisht në dst-të dhe në kontratat e tjera të mirëmbajtjes së pajisjeve. Koka goditëse nuk është përmendur askund as në dst-të dhe as në kontratat respektive të mirëmbajtjes full risk të pajisjeve ESWL.

7. Nëse në kontratën e mirëmbajtjes full risk të pajisjes do të përfshihet edhe ndërrimi i kokës goditëse, fondi i përcaktuar për këtë qëllim do të duhet të ishte shume me i lartë, duke përfshirë çmimin e mirëmbajtjes së pajisjes për periudhën kontraktuale dhe veçmas saj, si zë i veçantë, çmimin e ndërrimit (furnizim –vendosje) së kokës goditëse. Furnizim vendosja e kokës goditëse në këtë rast do të duhet të paguhet varësisht sasisë të kokave goditëse që do të ndërroheshin gjatë afatit total të mirëmbajtjes full risk. Por kjo do të kërkonte gjithashtu kushtin që kontratat e mirëmbajtjes së pajisjeve ESWL do të ishin të vijueshme, përgjatë gjithë kohës së përdorimit të pajisjes ESWL, pa kurrfarë hapësire kohore të pambuluar me kontratën e mirëmbajtjes full risk, gjë e cila nuk ka ndodhur asnjëherë deri me sot.

8. KLSH pretendon që KVO e Autoriteti Kontraktor nuk duhet të kishte kualifikuar shoqërinë M. sh.p.k meqë ajo është shprehur se ofertën e mirëmbajtjes full risk të pajisjes që në çmimin e ofertuar: nuk përfshihet riparimi apo zëvendësimi i pjesëve të këmbimit me konsum numerik goditjesh (koka goditëse etj).

Për me tepër, çfarë do të ndodhte nëse KVO do të s'kualifikonte shoqërinë M. ? Do të kishim “mbivendosje”, “pagese e dubluar”, “begatim pa shkak” në një rast të tillë?

Nëse jo, përse pikërisht vlera e kontratës FV të kokës goditëse është konsideruar nga draft raporti i Auditimit si e nevojshme për tu arkëtuar dhe jo ajo e kontratës së mirëmbajtjes?

9. Si di ta interpretonte grupi i auditimit të KLSH rastin në fjale nëse të dy kontratat e mësipërme për furnizim vendosje koke goditëse dhe për mirëmbajtje full risk të pajisjes ESWL do të fitoheshin nga dy operatore ekonomike të ndryshëm. Cili operator ekonomik do të konsiderohej si i “begatuar pa shkak” dhe me vlerën e cilës kontrate ?

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimet nuk qëndrojnë me arsyet si me poshtë:

Në deklaratën e konformitetit të produktit janë përcaktuar qartë të dhënat e kokës goditëse, në lidhje me jetëgjatësinë dhe numrin e goditjeve. Koka goditëse është një pjesë zëvendësuese ashtu siç çdo pjesë tjetër zëvendësuese.

Ndryshe nga se shpreheni në observacionin tuaj, që “Kontratat e mirëmbajtjes full risk nënkuptojnë mirëmbajtjen e pajisjeve, diagnostifikimin e defekteve, zëvendësimin e pjesëve përbërëse që kanë gjasa të defektohen, dëmtohen, pra që kanë risk dëmtimi”, është keqinterpretim pasi kontrata “full risk nënkupton një kontratë që AK lidh me një operator ekonomik që kërkon që të ofrojë shërbime të miratuara për të gjithë periudhën e përcaktuar me një kosto të përcaktuar dhe me rrezik të plotë financiar. Në rastin e pajisjeve mjekësore një

kontrate mirëmbajtje full risk përfshin gjithë mirëmbajtjen e pajisjes sipas përcaktimeve të prodhuesit, përveç dëmtimeve fizike të pajisjes.

Përsa i përket asaj që ju shprehni në lidhje me faktin që gjatë procedurës së mirëmbajtjes nuk është ndërruar asnjë koke goditëse përsëri nuk qëndron si argument, sepse procedura për blerjen e kokës goditëse është iniciuar në periudhën që kontrata e mirëmbajtjes ka qenë në fuqi. Me datën 22.08.2022 është mbajtur procesverbali i konstatimit ndërmjet punonjësve të inxhinierisë klinike të QSUNTS dhe operatorit ekonomik "M." Shpk, (që është operatori që kryen mirëmbajtjen e pajisjes së sipërcituar sipas kontratës 581/28 datë 01.03.2022), si me poshtë vijon

"Përshkrimi i konstatimit; Shërbimi konstatoi që pajisja sinjalizon që numri i goditjeve të kokës goditëse është drejt përfundimit; Konstatimi u krye me pas nga inxhinieret e kompanisë "M. " dhe njësisë inxhinierike klinike; Nevojitet ndërrimi i kokës goditëse; pajisja është në gjendje të plotë pune aktualisht".

Dokumentacioni bashkëngjitur shkresës për hartimin e fondit limit në lidhje me nevojën për blerjen e një koke goditëse të re nuk është i vlefshëm, pasi është një foto e marrë nga monitori i pajisjes pa përcaktime të tjera. Në foton e marrë nga monitori i pajisjes lithotripter nuk ka të dhëna për datën e fotos dhe të dhëna të vlefshme për ta marrë në konsiderate si dokument justifikues që kokagoditësja ka arritur numrin maksimal të goditjeve (2,000,000-3,000,000), kur në deklaratën e konformitetit përcaktohet qartë se numri i goditjeve arrin deri në 3 milion në një periudhë jetëgjatësie deri në 12 muaj, në varësi të përdorimit. Autoriteti kontraktor QSUNT pavarësisht kësaj në një periudhë rreth një vjeçare nëpërmjet procedurave të prokurimit ka blerë 3 kokegoditëse (furnizuar nga shoqëria M. sh.p.k), pa justifikuar në mënyrë të qartë nevojën për to dhe duke shkaktuar njëkohësisht mbivendosje me kontratat e mirëmbajtjes në fuqi.

Përsa i përket pikës 9 në lidhje me dyshimet tuaja sqarojmë se shërbim i dubluar ,mbivendosje,begatim pa shkak, është përcaktuar blerja e pjesëve zëvendësuese kokë goditëse, në kundërshtim me kontratat e mirëmbajtjes si më poshtë:

-Kontrata me numër prot., 173/36 datë 04.02.2021 e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik "M." shpk dhe Autoritetit Kontraktor QSUNT, ku specifikohet në termat e referencës se: "Operatori ekonomik fitues do të kryej mirëmbajtje full risk, mirëmbajtja parandaluese/preventive e pajisjeve mjekësore, mirëmbajtja korrigjuese e pajisjeve mjekësore, furnizimi me pjesë këmbimi dhe aksesorë, inspektimi i sigurisë së pajisjeve mjekësore".

-Kontratën e mirëmbajtjes me numër prot., 581/28 date 01.03.2022 e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik "M." shpk dhe Autoritetit Kontraktor QSUNT, ku specifikohet në termat e referencës se: "Operatori ekonomik fitues do të kryej mirëmbajtje full risk, mirëmbajtja parandaluese/preventive e pajisjeve mjekësore, mirëmbajtja korrigjuese e pajisjeve mjekësore, furnizimi me pjesë këmbimi dhe aksesorë, inspektimi i sigurisë së pajisjeve mjekësore".

Po ashtu ,në dokumentet standarde të tenderit është përcaktuar se: d) OE duhet të paraqesë Auto deklaratë ku garanton se në rast të shpalljes fitues, do të kryejë shërbimin e mirëmbajtjes (full risk), riparimin dhe zëvendësimin e çdo defekti/pjesë të mundshme/gjatë periudhës së kontratës, për pajisjen dhe të gjithë aksesorëve të cilat janë të lidhura me pajisjen, në mënyrë që ajo të jetë në shërbim të stafit dhe të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e pajisjes brenda standardeve të përcaktuara nga prodhuesi."

Operatori ekonomik është shpallur fitues me përmbushjen e kërkesave për kualifikim ,dhe ka paraqitur deklaratën e përmbushjes së specifikimeve teknike sipas kërkesave të Autoritetit

Kontraktor në DST-të e shpallura për këtë procedure prokurimi .Në këto kushte deklarata për kushtëzimin e ofertës tuaj ,është në kundërshtim me deklaratën për përmbushjen e specifikimeve teknike sipas kërkesave të DST-ve dhe nuk merret në konsiderate. Në këto kushte është dokumentacion shtesë i pavlefshëm.

Fakti që një procedure prokurimi është zhvilluar nder vite në të njëjtën mënyre kjo nuk e legjitimon paligjshmërinë e dublimit të shërbimit

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

2.6. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.

Kontratat e qirave për aktivet afatgjata materiale në QSUNT janë të lidhura prej një kohë të gjatë dhe pothuajse të gjitha me të drejtë rinovimi. QSUNT për të gjitha këto marrëdhënie kontraktuale është njësi përgjegjëse e cila bën monitorimin e tyre, nëse zbatohen kushtet e kontratave, nëse zhvillimi i aktiviteteve në disa prej tyre është konform kontratës. Në këtë mënyrë në zbatim të VKM-së Nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës e të mënyrës së dhënies me qera, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar të pikës 2/3, kreu VI-të “Monitorimi i kontratave”; pikës 42 e udhëzimit të Ministrit përgjegjës për ekonominë Nr.13, datë 26.04.2018 “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar dhe në vijim të rolit të QSUNT si njësi e administrimit të pronave të dhëna me qira, u shqyrtua dokumentacioni lidhur me kontratat e qerasë për periudhën objekt auditimi. Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë, janë ndërtesat, trualli i lirë, trualli i lirë funksional (jo nën ndërtesë), makineritë e pajisjet etj. Procesi i qiradhënies dhe dhënies në enfiteozë bëhet me konkurim. Nga ky rregull janë përjashtuar pasuritë e paluajtshme nën 200 m², që jepen pa proces konkurrimi.

Referuar informacionit të vënë në dispozicion u konstatua se QSUNT është njësi që ka në përgjegjësi administrimi objektet, sipërfaqe të godinave (PAI) të dhënë me qira. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga njësi monitoruese e kontratave e cila bën ndjekjen e praktikës së dhënies me qira të aktiveve dhe ndjek realizimin e kushteve të kontratave të qirave, u konstatua si më poshtë:

- ish magazina e statistikës e dhënë me objekt kontrate bar-kafe dhe librari me personin “K.Gj.”, kontrata me Nr.7827 rep. Nr.2371kol. datë 26.10.2015, 226.5m².
- sipërfaqja e ndodhur poshtë sallave të operacionit pranë spitalit të djegie plastikës me qiramarrës bankën “CREDINS”, kontrata me Nr.1692/10 prot., datë 18.12.2020 dhe kontratën Nr.143/5 prot., datë 16.02.2022 me sipërfaqe totale 194.84 m² dhe kontratën Nr.143/5 prot., datë 16.02.2022 .
- ish-kuzhina e QSUNT-së e dhënë me qira e cila ushtron aktivitetin e gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit të pacientit me operatorin “K.” shpk, kontrata me Nr.283/1 prot., datë 22.01.2021 me sipërfaqe totale 860.2 m²(752 m²sipërfaqe nën ndërtesë dhe 108.2 m² sipërfaqe e jashtme)
- sipërfaqe e dhënë me qira mbi godinën e tarracës për vendosjen e antenave telefonike për kompaninë “V.A.” Sh.a me Nr.1267 prot., datë 28.04.2022 me sipërfaqe totale 20 m².
- sipërfaqe e dhënë me qira 1090 m² me destinacion ushtrimin e lavanterisë dhe hotelerisë në pavijonet e QSUNT me qiramarrës “A.” shpk, kontrata e fundit e qirasë është një aneks kontrate me Nr.1913 prot., datë 15.04.2014.
- sipërfaqe e dhënë me qira mbi godinën e tarracës për vendosjen e antenave telefonike për kompaninë “O. T.” Sh.a me Nr.2523/6 prot., datë 15.11.2021 me sipërfaqe totale 69 m².

- sipërfaqe e dhënë me qira e disa ambienteve “M.T.” shpk me destinacion 10 distributorë automatik kafematë dhe 10 distributorë automatik frigoriferikë, kontrata Nr.342/13 prot., datë 13.04.2021 me sipërfaqe 20 m² dhe kontrata me Nr.178/32 prot., datë 28.12.2022 për 10 distributorë automatik kafematë dhe 10 distributorë automatik frigoriferik me sipërfaqe 20 m², dhe konsumi i energjisë elektrike i llogaritur në çmimin total.
- sipërfaqe e dhënë me qira e disa ambienteve “S.CO” shpk, me destinacion 3 distributorë automatik kafematë dhe 3 distributorë automatik frigoriferikë kontrata me Nr.342/15 prot., datë 23.04.2021 me sipërfaqe 6 m²dhe kontrata Nr.178/26 prot., datë 03.10.2022 për 3 distributorë automatik kafematë dhe 3 distributorë automatik frigoriferik me sipërfaqe 6m².
- sipërfaqe e dhënë me qira e disa ambienteve “C.P.” me destinacion 10 distributorë automatik kafematë dhe 10 distributorë automatik frigoriferikë, kontrata me Nr.342/16 prot., datë06.05.2021 me sipërfaqe totale 20 m², dhe kontrata Nr.178/25 prot., datë 13.09.2022 për 9 distributorë automatik kafematë dhe 9 distributorë automatik frigoriferik më sipërfaqe 18 m².
- sipërfaqe e dhënë me qira e disa ambienteve “G.O.” shpk, me destinacion distributorë automatik kafematë dhe 6 distributorë automatik frigoriferikë, kontrata me Nr.342/14 prot., datë 13.04.2021me sipërfaqe totale 12 m², dhe kontrata Nr.178/24 prot., datë 09.09.2022 destinacion 6 distributorë automatik kafematë dhe 5 distributorë automatik frigoriferikë me sipërfaqe totale 11 m².

QSUNT ka ngritur grupin e punës për monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të kontratave të qirasë me urdhër të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm.

Para lidhjes së kontratave të qirave ose të enfiteozës, njësia administruese duhet të bëjë dorëzimin të qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi me procesverbal të objektit të përshkruar në kontratë, sipas genplanit përkatës. Ku në këtë procesverbal përshkruhen qartë gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira ose enfiteozë sipas llogarive financiare në fund të vitit paraardhës dhe shoqërohet me pamje fotografike të momentit. Është në përgjegjësinë e tyre ligjore, civile dhe administrative, akt dorëzimi i objektit të kontratës së qirasë. Nga auditmi nuk na është vënë në dispozicion asnjë akt dorëzimi, gjë e cila nuk të lë të kuptosh qartë gjendjen fizike të pronës në momentin e parë të dhënë me qira.

Konstatim:

-Mungojnë akt dorëzimet ku përshkruhet gjendja fizike e aktivitetit afatgjatë material, vlera kontabël e objektit që jepet me qira sipas llogarive financiare në fund të vitit paraardhës dhe shoqërohet me pamje fotografike të momentit. Mungesa e tyre sjell mundësi të abuzimeve me pronën shtetërore dhe mos pasur një evidentimin real të pronës çdo rinovimi të kontratës, veprim në kundërshtim me nenin 2 pika a) kapitulli VI i VKM 54 dt..05.02.2014 i ndryshuar.

- Për kontratat në të cilat qiramarrësi është përgjegjës për likuidimin e detyrimeve të tjera të ambientit (si energjia elektrike, uji, etj) mungojnë të jenë dokumentuar monitorimet e kryera për garantimin e likuidimit nga ana e qiramarrësit të këtyre detyrimeve, veprim në kundërshtim me kontratat e lidhura me subjektet qiramarrëse.

Të ardhurat e qirave për vitin 2021 dhe 2022

Për vitin 2021 të ardhurat nga qiratë janë realizuar 100%.

Për vitin 2022 të ardhurat nga qiratë janë realizuar 100%.

Në mënyrë të detajuar pasqyra si më poshtë vijon:

Viti 2021

Nr	Subjekti	Vlera mujore	Vlera e paguar në vitin 2021	Detyrimi për kamatëvonesa	Paguar kamatëvonesa	Paguar Paradhënie	Pjesa e Institucionit	Pjesa e buxhetit
1	K.	317,030	4,159,973	-	-	-	-	4,159,973
2	A.	228,900	2,746,800	-	-	-	-	2,746,800

3	K.Gj.	58,000	696,174	174	174	-		696,174
4	C.P.	33,580	453,052	1,540	1,540	33,580	317,136	135,915
5	G.O. shpk	20,148.00	241,776.00	-	-	20,148.00	169,243.20	72,532.80
6	B.C.	128,594.00	2,017,212.00	2,572.00	2,572.00	128,594.00	1,412,048.40	605,163.60
7	S.C.	10,074.00	122,988.00	2,100.00	2,100.00	10,074.00	86,091.60	36,896.40
8	M.T.	33,580.00	369,380.00	-	-	33,580.00	258,566.00	110,814.00
9	T.A./O.C.	207,000.00	2,509,600.00	29,600.00	20,800.00	-	1,756,720.00	752,880.00
10	V.A.	60,000.00	360,001.66	-	-	-	252,001.16	108,000.50
Totali			13,676,956.66				4,251,806.76	9,425,149.90

Burimi i të dhënave "QSUNT"

Viti 2022

Nr	Subjekti	Vlera mujore e detyrimit sipas kontratës	Vlera e paguar në vitin 2022	Detyrimi për kamatëvonesa	Paguar kamatëvonesa	Paguar Paradhënie	Pjesa e Institucionit	Pjesa e buxhetit
1	K.	317,030.00	3,487,330.00	85,590.00	-	-	-	3,487,330.00
2	A.	228,900.00	2,746,800.00					2,746,800.00
3	K.Gj.	58,000.00	696,000.00					696,000.00
4	C.P.	48,658.50	474,537.00	2,800.00	2,800.00	48,658.50	332,175.90	142,361.10
5	G.O. shpk	30,062.90	269,022.00	840.00	840.00	30,062.90	188,315.40	80,706.60
6	B.C.	128,594.00	1,546,987.00	3,858.00	3,858.00	-	1,082,890.90	464,096.10
7	S.C.	16,219.50	145,376.00	4,260.00	-	16,219.50	101,763.20	43,612.80
8	M.T.	54,065.00	134,320.00				94,024.00	40,296.00
9	T.A./O.C.	207,000.00	2,265,500.00	107,200.00	92,000.00	-	1,585,850.00	679,650.00
10	V.A.	60,000.00	1,066,983.02	74,400.00	31,200.00	-	746,888.11	320,094.91
Totali			12,832,855.02				4,131,907.51	8,700,947.51

Burimi i të dhënave "QSUNT"

Procedura e shpërndarjes së të ardhurave nga veprimtaritë e institucionit, në këtë rast nga kontratat e qirave.

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSKDSH), Këshilli Administrativ, me Udhëzimin Nr.2 datë 11.02.2014, udhëzon që të ardhurat që realizojnë spitalet nga veprimtaria e tyre, të arkëtohen në llogarinë e degës përkatëse të thesarit. Këto të ardhura vlerësohen si të ardhura jashtë limitit dhe janë të trashëgueshme në vitin pasardhës dhe përdoren totalisht nga vetë spitali. Ku më poshtë është e shprehur në rend kronologjik e gjithë procedura.

Përdorimi të ardhurave që realizojnë Spitalet Universitare do të jetë si më poshtë:

a) Për mbulimin e kostos së shërbimit të pagesave të punonjësve me kontratë shërbimi dhe për pagesën e anëtarëve të komisioneve teknike të hartimit të paketave të shërbimit, 25% e shumë totale.

b) Për investime dhe mallra e shërbime 75 % e shumë totale. Detajimi dhe përdorimi në artikujt 602 apo 230 e 231, i të ardhurave nga veprimtaria e spitalit bëhet nga vetë spitali, si pjesë e kostos së shërbimit, bazuar në procedurat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Buxheti për investime (230/231) në QSUT akordohet nga MSHMS, ndërsa buxheti për shpenzime operative (602) dhe paga e sigurime (600&601) nga FSDKSH. Në bazë të nevojave të institucionit, nëse zëri i investimit apo shpenzimit nuk është parashikuar në Planin e Buxhetit të vitit, kërkohet të realizohet me të ardhurat e institucionit.

Drejtoria Juridike (DJ) i drejton Drejtorisë Ekonomike (DE) shkresën "Kërkesë për akordim fondi", pasi verifikohet nga DE që ky zë nuk i përket planit vjetor të buxhetit, kjo e fundit i drejton MSHMS shkresën "kërkesë për miratim shpenzimesh nga të ardhurat dytësore", me anë të së cilës i bëhet e ditur nevoja që ka për kryerjen e shpenzimit si dhe kostoja e tij. DE pasi merr miratimin e MSHMS për përdorimin e të Ardhurave Dytësore i bën të ditur DJ e cila fillon me kryerjen e procedurës së prokurimit.

Të ardhurat e realizuara nga QSUT pasqyrohen në evidencën “Akt-rakordimi të ardhurave” dhe çdo përdorim i tyre sipas zërit të shpenzimit pasqyrohet në evidencën “Të ardhurat Spitalore”, të cilat rakordohen përkatësisht me sektorin e të ardhurave dhe shpenzimeve në Degën e Thesarit Tiranë.

Nga ku rezultojnë: Për vitin 2021 janë realizuar të ardhura gjithsej 34,179,410 nga të cilat 7.3% janë përdorur për llogarinë ekonomike 600, paga, 3% për llogarinë 602, shpenzime operative dhe 17% për llogarinë 231, investime. Pjesa e mbetur pa përdorur nga viti 2021 dhe 2020 përkatësisht 27,533,114 lekë dhe 25,116,557 lekë, janë trashëguar në vitin 2022. Për vitin 2022 janë realizuar të ardhura gjithsej 132,364,952 lekë, nga të cilat 1% janë përdorur për llogarinë ekonomike 600, paga dhe 61% për llogarinë 231, investime. Pjesa e mbetur pa përdorur nga viti 2022 dhe 2021 përkatësisht 50,303,379 lekë dhe 52,649,671 lekë janë trashëguar në vitin 2023.

Kontrata e qirasë e lidhur me subjektin “K.Gj.”.

Kontrata e qerasë lidhur më 26 tetor të 2015 me NIPT L.....T. Objekt i kësaj kontrate është dhënia me qira e pasurisë shtetërore e quajtur “Ish-Magazina e Statistikës ” njësi në administrim të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me numër pasurie 1/313 zonë kadastrale 8130 me afat 10 vjeçar. Palët kontraktuese në kohën e lidhjes të kësaj kontrate janë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ku i cili është qiradhënësi. Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 10 vjeçare, ku qiramarrësi detyrohet të paguajë qiranë në vlerën e 58 000 lekë/ muaj. Fatura për pagesë lëshohet nga njësia që ka në administrim pasurinë e cila është QSUNT.

-Qiramarrësi “K.Gj.” nuk ka paraqitur para qiradhënësit shtesën e plan biznesit për treguesit e periudhës në vazhdim. Në kundërshtim me nenin 5.5 të kontratës, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Qiramarrësi detyrohet që para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira, të paraqesë para qiradhënësit shtesën e plan biznesit për treguesit e periudhës në vazhdim, brenda objektit të kontratës. Kjo shtesë në plan biznesi lidhet me investimet që do të realizohen në vazhdim dhe pas investimeve që ishin parashikuar kur subjekti është paraqitur për konkurrim, e po ashtu me nivelin e punësimit”.

-Vazhdimi i kontratës në këto kushte është në kundërshtim me nenin 8 të kontratës. Një nga rastet e zgjidhjes së kontratës është kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenet 2,5 dhe 6 të saj. Në kundërshtim të nenit 5.5 është një detyrim zgjidhja e kontratës. Titullari i institucioni nuk ka ndër marrë asnjë masë, po ashtu edhe nga MFE nuk është vepruar për ndërprerjen e kontratës.

Akt monitorimet të mbajtura nga grupi i punës nuk janë protokolluar dhe nuk kanë një datë të mbivendosur, për pasojë nuk mund të vërtetohet nëse janë kryer brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë e Financave Nr.13, datë 26.04.2018.

-Në rastet kur kontrata është lidhur me persona fizik dhe nga ana e tyre është marr përsipër ose janë kryer investime në nivele që në bazë të legjislacionit duhet të ushtrojnë veprimtari si persona juridikë, në zbatim të kontratës dhe VKM 54 datë 05.02.2014 ndryshuar, në kapitullin VI pika 5. Pas verifikimit rezultoi se subjekti me këtë NIPT L.....T me datë regjistrimi 13.07.2015 është person fizik dhe nuk është regjistruar si person juridik. Ky fakt nuk është evidentuar nga njësia monitoruese e kontratave si në instancat drejtuese më lartë në institucion.

- Kontratat e qirasë, që kanë për objekt një send të paluajtshëm, dhe me afat më shumë se 9 vite duhet të bëhen me akt noterial dhe të regjistrohen në regjistrat publik të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për efekt vlefshmërie. Kontrata e qirasë me subjektin “K.Gj.” nuk është regjistruar në kundërshtim me nenin 51 të Ligjit Nr.33/2012 i ndryshuar.

Inventarizimi i aktiveve afatgjata materiale të dhëna me qira.

- Mungon inventarizimi i aktiveve afatgjata materiale të dhëna me qira. Në kundërshtim me Udhëzimin 30 i datës 27.12.2011 për menaxhimin e aktive në njësitë e sektorit publik, në kapitullin III pika 31 QSUNT duhet të mbajë një regjistër të veçantë për secilën nga pronat e dhëna me qera, me të dhënat si emërtimi i pronës, NIPTI dhe vendndodhja. Gjithashtu për objektet e dhëna me qera përben: sipërfaqen e objektit në m², numrin dhe datën e kontratës së qirasë, afatin e vlefshmërisë së kontratës, afatin e kohëzgjatjes, veprimtarin që kryhet, subjektin përfitues, qiraja mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

Çmimi dhe tarifat e qirave.

- Nuk është përcaktuar qartë se sa është tarifa e m² e sipërfaqes nën ndërtesë dhe sipërfaqes funksionale për kontrata e lidhur me subjektin “K.Gj.”. Kjo pasuri ka sipërfaqe të përgjithshme 226,5 m², përkatësisht sipërfaqe nën objekt është 180.5 m² dhe sipërfaqe funksionale 46 m². Vlera dysheme e detyrimit mujor përcaktohet si shumë e vlerës së qirasë mujore për ndërtesën dhe sipërfaqen funksionale që jepet me qira, e përcaktuar si sipërfaqe funksionale vetëm sipërfaqja e truallit që ndodhet pranë objektit e cila përdoret për të ushtruar funksionin objekt kontrate. U konstatua nga dokumentet e pronësisë të objektit “Ish-magazina e statistikës” është godinë një katesh dhe qiraja në këto raste paguhet për sipërfaqen e objektit 1 katesh, por nga konstatimi në terren vihet re se tarraca e godinës përdoret për shërbim bar-kafe dhe ka një investim të kryer duke vendosur një çadër mbuluese, dhe rreth 20 tavolina dhe karrige gjë e cila e kalon në një ambient të gatshëm dhe të përshtatshëm për shërbim bar-kafe, pra duke i ndryshuar destinacionin duke e kaluar në një sipërfaqe funksionale e shfrytëzueshme. Në nenin 2 të VKM Nr.354 e datës 11.05.2016, është shprehur se koncepti i shndërrimit i cili përfshin rimodelim e një projekti ekzistues, që përfshin ndryshime thelbësore në ndërtimin e tij ose në përbërësit strukturorë, që i shërbejnë ndryshimit të destinacionit. Gjë e cila ka ndodhur në tarracën e godinës një kat-she ku ushtrohet shërbim bar kafe, duke pasur parasysh anën ekonomike të tij.

-Në tabelat si më poshtë janë pasqyruar vlerat mujore të detyrimeve sipas kontratave, si analizë e sipërfaqes në m² (nën ndërtesë), sipërfaqja në m² (sipërfaqe funksionale) dhe tarifat përkatëse të tyre për m² për vitin 2021 dhe 2022.

Qira 2021

Nr	Subjekti	Sipërfaqja në m ² (nën ndërtesë)	Sipërfaqja në m ² (sipërfaqe funksionale)	Tarifa / m ² ndërtesë	Tarifa / m ² sip.e jashtme	Tarifa për konsumin e Energjisë Elektrike	Vlera mujore e detyrimit sipas kontratës
1	K.	752.00	108.20	400.00	150.00	-	317,030.00
2	A.	1,090.00	-	210.00	-	-	228,900.00
3	K.Gj.	180.50	46.00	-	-	-	58,000.00
4	C.P.	20.00	-	700.00	-	19,580.00	33,580.00
5	G.O. shpk	12.00	-	700.00	-	11,748.00	20,148.00
6	B.C.	194.84	-	660.00	-	-	128,594.40
7	S.C.	6.00	-	700.00	-	5,874.00	10,074.00
8	M.T.	20.00	-	700.00	-	19,580.00	33,580.00
9	T.A./O.C.	69.00	-	3,000.00	-	-	207,000.00
10	V.A.	20.00	-	3,000.00	-	-	60,000.00

Burimi i të dhënave “QSUNT”

Qira 2022

Nr	Subjekti	Sipërfaqja në m ² (nën ndërtesë)	Sipërfaqja në m ² (sipërfaqe funksionale)	Tarifa / m ² ndërtesë	Tarifa / m ² sip.e jashtme	Tarifa për konsumin e Energjisë Elektrike	Vlera mujore e detyrimit sipas kontratës
1	K.	752.00	108.20	400.00	150.00	-	317,030.00
2	A.	1,090.00	-	210.00	-	-	228,900.00
3	K.Gj.	180.50	46.00	-	-	-	58,000.00

4	C.P.	20.00	-	700.00	-	19,580.00	33,580.00
5	G.O. shpk	12.00	-	700.00	-	11,748.00	20,148.00
6	B.C.	194.84	-	660.00	-	-	128,594.40
7	S.C.	6.00	-	700.00	-	5,874.00	10,074.00
8	M.T.	20.00	-	700.00	-	19,580.00	33,580.00
9	T. A./O. T.	69.00	-	3,000.00	-	-	207,000.00
10	V.A.	20.00	-	3,000.00	-	-	60,000.00

Burimi i të dhënave "QSUNT"

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Nr.43, datë 24.01.2022 me Nr.408 prot., në datë 24.01.2022 është ngritur grupi i punës për përcaktimin e çmimit të kontratave të qerasë në të cilat QSUNT figuron si palë kontraktore i përbërë nga:

L.C. – Kryetar (Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse);

E.C. – Anëtare (Specialist/Ekonomiste);

M.C.– Anëtare (Specialist/Sektori i Marrëdhënieve Ligjore).

Ky grup ka përcaktuar që:

- G.O., C.P. dhe S.K. dhe "M.T." do të jepen me qira 1000 lekë/metër² në procesverbalin e mbajtur në datë 16.02.2022 me Nr. 178/22 prot.

- Çmimi i kontratës së qirasë me B.C. është po i njëjti dhe nuk ka ndryshuar me ndryshimin e çmimeve të reja, por shprehet se është vendosur në bazë të kontratave të mëparshme, Në kundërshtim me dispozitat ligjore në VKM sipas përcaktimeve në kapitullin III mbi tarifatat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë.

Nga auditimi u konstatua se rritja e çmimeve të qirasë aplikuar nga QSUNT **nuk** është në të njëjtin nivel për të gjithë subjektet qiramarrëse. Ndryshimi i çmimit nuk është në përputhje me ndryshimet ligjore që solli VKM 672 datë 02.09.2020. Për kontratat shumëvjeçare mbi 200m², vlera e qerasë nuk është rritur për kontratën me bankën "B.C", kontratën me subjektin "K.Gj." dhe "A." shpk duke qëndruar vlera e njëjtë që në lidhje të kontratës.

Kontrata e qirave të cilat lidhja e tyre lidhet me objektin e kontratës së prokurimit publik.

-Nuk ka kontratë qiraje të lidhur mes "A." shpk dhe QSUNT, pavarësisht se shlyhen detyrimet financiare për ambientin kuzhinës 1090 m² të marrë me qira.

Nga QSUNT administrohet vetëm një kontratë qiraje e lidhur me "A." cila është (rinovim) e datës 16.11.2011 me Nr.5075 prot., dhe një aneks kontratë qiraje e datës 15.04.2014 me Nr.1913 prot., dhe nuk administrohen me dokumente të tjera.

Dhënia e pasurive shtetërore me qira që janë të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës së prokurimit publik kundrejt subjekteve privat që janë shpallur fitues dhe kanë lidhur kontratë shërbimi sipas VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 e ndryshuar, kanë të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë nga institucioni qendror shtetëror që mbulon veprimtarinë përkatëse në këtë rast nga QSUNT. Ndodhur përpara rastit se dhënia e pasurive shtetërore me qira që janë të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës së prokurimit publik kundrejt subjekteve privat që janë shpallur fitues dhe kanë lidhur kontratë shërbimi sipas VKM 54, kapitulli I pika g), ku shprehet se dhënia me qira e pasurive shtetërore subjekteve private që janë shpallur fitues dhe kanë lidhur kontratë sipas përcaktimeve të LPP i ndryshuar.

-Ky fakt nuk është konstatuar në asnjë nga akt monitorimet dhe nuk ka gjurmë dokumentacioni të jetë përcjellë tek titullari i institucionit dhe as të jenë ndërmarrë masa për rinovim kontrate. Nuk ka gjurmë dokumentacioni për të marrë masa për lidhjen e kontratës së qirasë. Përsa kohë nuk ka një kontratë në fuqi nuk mund të ketë një marrëdhënie juridiko- civile mes palëve.

Investimet nga të ardhurat detyësore të cilat janë nga qira.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion u konstatua se investimet që janë kryer nga institucioni nga të ardhurat detyësore që në këtë rast janë kontratat e qirave. Këto investime të zhvilluara gjejnë zbatim në kapitullin VII të shpërndarjes së të ardhura vetë qirave. Të ardhurat

që krijohen nga kontrata e qirave të lidhura për pasuri me sipërfaqe deri me 200 m², 30% i kalon buxhetit të shtetit dhe 70% ndërmarrjes ose shoqërisë shtetërore që ka në administrim objektin e dhënë me qira, në këtë situatë QSUNT. Është evidentuar se këto të ardhura janë përdorim për realizimin e disa investimeve. Më poshtë janë të renditura në formë tabelare investimet e kryera nga të ardhurat dytësore.

Investimet nga të ardhurat dytësore për 2022

Nr. rendor	Subjekti	Objekti Kontratës	Nr. kontratës	Dt. Kontratës	Vlera Kontratës
327	N.G. shpk	Kolaudim për Rikonstruksion e Godinës Se Arkivës se Kartelave Mjekësore në QSUNT	146/18	21/04/2022	16,353.00
342	V.I. shpk	Kolaudim I punimeve për Rikonstruksionin e Pediatriisë Infektive	396/26	28/04/2022	37,277.00
483	O.D. shpk	Furnizim Vendorsje të Aparaturave mjekësore për Spitalin e ri loti 5	64/84	15/06/2022	606,000.00
486	O.D. shpk	Furnizim Vendorsje të Aparaturave mjekësore për Spitalin e ri loti 12	64/87	16/06/2022	3,651,120.00
491	S.M.	Furnizim Vendorsje të Aparaturave mjekësore për Spitalin e ri loti 3	64/90	17/06/2022	150,000.00
492	B.A. shpk	Furnizim Vendorsje të Aparaturave mjekësore për Spitalin e ri loti 8	64/91	17/06/2022	9,336,000.00
494	“M.” shk	Furnizim Vendorsje të Aparaturave mjekësore për Spitalin e ri loti 1	64/102	22/06/2022	45,348,000.00
519	“M.” shpk	Furnizim vendorsje aparaturash mjekësore	64/116	15/07/2022	5,316,000.00
531	“M.” shpk	Furnizim Vendorsje X-Ray Tube për rikthimin në gjendje të plote funksionale të pajisjes mjekësore Skaner CT Brightspeed , Loti 1	1655/10	27/07/2022	8,215,920.00
532	“M.” shpk	Furnizim Vendorsje X-Ray Tube për rikthimin në gjendje të plote funksionale të pajisjes mjekësore Skaner CT Brightspeed , Loti 2	1655/11	27/07/2022	5,635,920.00
634	A.M. shpk	F.V Aparatura Mjekësore mobilim dhe hoteleri për godinën e re të pediatriisë loti 19	47/60	29/09/2022	2,619,560.00
768	F.A.	Kolaudim i punimeve për Rikonstruksionin e SPITALIT Infektive	280/37	25/11/2022	424,002.00
TOTALI 2022					81,356,152.00

Burimi i të dhënave “QSUNT”

Investimet nga të ardhurat dytësore për 2021

NR. Rendor	Subjekti	Objekti Kontraktues	Nr. Kontratës	Dt. Kontratës	Vlera Kontratës
528	M. sh.p.k	Furnizim Vendorsje dhe kolaudim i sistemeve të trajtimit të ujit në shërbimin e Nefrologjisë (Hemodializ)	1851/8	19.08.2021	5.391.000.00
579	S.K. shpk	Blerje (FV)kondicioner në ambientet ku është instaluar ct-Skaner.	1092/18	29.09.2021	291.600.00
Totali 2022					5.682.600.00

Burimi i të dhënave “QSUNT”

Sa u përket investimeve të kryera nga të ardhurat e parkimit rezultojnë të jenë kryer vetëm dy investime. “Sistemimi i hapësirave publike pranë QSUNT” me indicie të QSUNT me shkresë Nr.311/10 prot., datë 10.02.2022 ku është paraqitur kërkesa për krijimin e rrugë kalimit ndërmjet Depos së Barnave – Spitali Francez dhe krijimin e rreth- rrotullimit në hyrjen e re të Pediatriisë së Specialiteteve, pas përfundimit të punimit dhe realizimit të investimit. Por ngelet ende pezull një investim tjetër dhe pse është parashikuar që në 2019 për krijimin e dy bokseve të izolimit për shërbimin Onkologjik në Pavionin e Kimioterapisë (bokse sterile në ambient ekzistues).

Akt marrëveshja e parkimit të QSUNT.

Akt marrëveshja e parkimit të QSUNT për sipërfaqe në administrim të objektit me emërtimin “Oborr i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Një pjesë të territorit në administrim të QSUNT me VKM Nr. 688, datë 14.11.2018 ka kaluar në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Fondit Shqiptar i Zhvillimit të objektit me emërtim “Oborr i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë me një sipërfaqe 10457 m², ku në zbatim të këtij vendimi është lidhur akt – marrëveshja në datë 16.11.2018. Në këtë aktmarrëveshje është përcaktuar se F. si person juridik do të përfaqësohet në këtë akt marrëveshje nëpërmjet Agjencisë Ekonomike Mbështetëse (A.), e cila është një strukturë ekonomike e krijuar në 19.06.2018. Objekt i kësaj akt-marrëveshje është qarkullimi i lëvizjes së automjeteve për në territorin e QSUNT, si dhe parkimi i automjeteve brenda këtij territori, si dhe cilësia e shërbimit që lidhet me shfrytëzimin për parkim, përmirësim i infrastrukturës së jashtme urbane dhe pritëse, si dhe menaxhimin cilësor të shërbimeve publike në oborrin e brendshëm të QSUNT.

Në zbatim të VKM Nr. 688, datë 14.11.2018, përgjegjësia e administrimit të një pjesë të oborrit të brendshëm të QSUNT i ka kaluar në përgjegjësi administrimi Fondit Shqiptar të Zhvillimit, me qëllim organizimin e një shërbimi cilësor për parkimin e automjeteve të stafit, pacientëve dhe vizitorëve në QSUNT. Menaxhimi i parkimit të makinave funksionon në të gjithë territorin e spitalit të mbuluar nga politika menaxheriale 24/7. Parkimi menaxhohet nga njësi e menaxhimit të parkimit A. pranë QSUNT. Ky parkim ka 3 hyrje-dalje. Për të aksesuar në parkim në momentin e parë prihet një biletë me orën e hyrjes dhe ngrihet trau për tu futur në parkim. Pagesa për qëndrimin bëhet në dalje, duke dorëzuar biletën me orën e hyrjes dhe në bazë të tarifës së caktuar për çdo orë qëndrimi bëhet pagesa.

Vjelja e të ardhurave bëhet në mënyrë të njëanshme nga A. dhe në fund të çdo 3 mujori behet rakordimi në bazë të dokumentacionit / kupon tatimor që paraqet A..

Ndërmjet A. dhe QSUNT konstatohet se nuk ka asnjë sistem të përbashkët kontrolli mbi numrin e automjeteve që parkojnë, përveç deklarimit që A. bën tek QSUNT, e si rrjedhojë QSUNT nuk merr siguri të mjaftueshme lidhur me numrin e saktë të automjeteve që hyjnë në parkim.

Pjesa takuese e të ardhurave nga parkingu ndërmjet QSUNT dhe F. është përcaktuar në VKM Nr.688, datë 14.11.2018, vlera si 45% e të ardhurave si pjesë takuese e QSUNT, 3% e të ardhurave nga parking që F. do të gjenerojë nga parkingu do të derdhen në llogarinë e thesarit të QSUNT dhe 42% e të ardhurave do të investohet nga F. me kërkesë të QSUNT dhe pas miratimit paraprak të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në infrastrukturë, për përmirësimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme në përmbushje të objektivave dhe misionit të saj, ndryshuar kjo me VKM Nr.135 datë 02.03.2022, përkatësisht pika 4 ku nga 45%, 25 % kalojnë në llogarinë e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, prej të cilave 3 % përdoren për edukimin në vazhdim të burimeve njerëzore të kësaj qendre 22 % përdoren për investime në infrastrukturë, pajisje mjekësore ose investime të tjera. Në zbatim të këtyre ndryshimeve janë duke u shqyrtuar rakordimi i të ardhurave që bëhet nga pagesa e tarifës së parkimit. Në formë tabelare gjenden detyrimet sipas kontratës për vitin 2021 dhe 2022.

- Të ardhurat nga parkimi viti 2021 (tabela1) dhe viti 2022 (tabela e 2) për pjesën e institucionit.

Nr.	Subjekti	Vlera mujore e detyrimit sipas kontratës	Vlera e paguar në vitin 2021	Detyrimi për kamatëvonesa	Paguar kamatëvonesa	Paguar Paradhënie	Pjesa e Institucionit	Pjesa e buxhetit
1	F. (A.)	Arkëtimet çdo 3 muaj sipas Akt-Marrëveshje Nr.1242/41 dt..16.11.2018	2,766,360.00	-	-	-	2,766,360.00	0
Totali 2021			2,766,360.00				2,766,360.00	

Nr.	Subjekti	Vlera mujore e detyrimit sipas kontratës	Vlera e paguar në vitin 2022	Detyrimi për kamatëvonesa	Paguar kamatëvonesa	Paguar Paradhënie	Pjesa e Institucionit	Pjesa e buxhetit
1	F. (A.)	Arkëtimet çdo 3 muaj sipas Akt-Marrëveshje Nr.1242/41 dt..16.11.2018	98,906,391.00	-	-	-	98,906,391.00	0
Totali 2022			98,906,391.00				98,906,391.00	

Burimi i të dhënave "QSUNT"

Kërkesat për investime nga të ardhurat e parkimit

Kjo procedurë investimi, pavarësisht faktit që kjo kërkesë për investim ka filluar në 2019 dhe pse ky investimi është kërkuar në pavionin e kimioterapisë në QSUNT dhe përfaqësojnë investime në funksion të përmirësimit të infrastrukturës së brendshme, ende sot nuk është e realizuar edhe pas miratimit të fondit.

Përmirësimi i infrastrukturës së jashtme urbane dhe pritëse.

-Për periudhën objekt auditimi QSUNT nuk ka një listë investimesh prioritare për vitin 2021 dhe 2022, përveç një e cila është e vitit e 2019. Përmirësimi i infrastrukturës së jashtme urbane dhe pritëse si një nga qëllimet kryesore që lidhen me cilësinë e shërbimit dhe shfrytëzimit për parkim në oborrin e brendshëm të QSUNT, në akt marrëveshjen Nr.1242/41 prot., datë 16.11.2018 dhe amendimit të saj me Nr.884/2 prot datë 12.04.2022 ku neni 3 ngelet i pandryshuar. Konkretisht shprehet se pala e parë e akt-marrëveshjes e cila është QSUNT përgatit në periudhën Nëntor-Dhjetor para çdo fillim viti një listë investimesh prioritare dhe pas me pas miratohet nga MSHMS. Mungesa e një liste investimesh prioritare sjell mungesën e përmirësimit të shërbimit të ofruar, duke pasur gjithnjë në vëmendje objektin e akt-marrëveshjes dhe nevojës që ka QSUNT, si një bashkësi e disa spitaleve dhe dyndjes së madhe të njerëzve për rregullimin e infrastrukturës urbane dhe pritëse dhe menaxhimit cilësor të shërbimit publik.

-Për periudhën objekt auditimi QSUNT nuk ka një listë emërore me targat përkatëse të automjeteve për personat të cilët do të përfitojnë shërbim/pagesë të reduktuar (stafin mjekësor dhe operatorëve ekonomik) që bashkëpunojnë me QSUNT për të përfituar pagesë të reduktuar., kjo në kundërshtim me nenin 2 në akt marrëveshjen Nr.1242/41 prot., datë 16.11.2018 dhe amendimit të saj me Nr. 884/2 prot., datë 12.04.2022.

Në opinionin e grupit të auditimit ka mungesë transparence për operatorët të cilët përfitojnë shërbim me pagesë të reduktuar.

-Ku për çdo vit si dhe gjatë vitit ushtrimor nëse ka ndryshime duhet patjetër të përcaktohen dhe palët e treta dhe operatorët të cilët kanë bashkëpunim më QSUNT dhe banorët të cilët kanë akses brenda territorit të palës së parë të akt-marrëveshjes do të kenë sistem të diferencuar dhe do të favorizohen në pagesë. Kjo listë vendoset në dispozicion nga DSHM pranë QSUNT dhe i dërgohet A. , po ashtu për të dy vitet objekt auditimi si 2021 dhe 2022 nuk gjenden gjurmë dokumentacioni që është dërguar një listë dhe të jetë aprovuar nga të dy palët. Mungesa e një transparence të tillë sjell një listë jo të drejtë dhe të vërtetë.

Për sa është trajtuar më sipër mbajnë përgjegjësi A.F. , E.J., anëtarët e grupit të punës: Xh.H. , E.S., S.B., E.C, Xh.H., E.S., V.T. dhe L.S..

Titulli i gjetjes Nr.1	Mungesa e aktdorëzimeve në kontratat e qirave
Situata:	-Për të gjitha kontratat e qirave të lidhura mes QSUNT dhe Operatorëve

	<p>Ekonomik mungojnë aktdorëzimet, ku në këtë procesverbal të përshkruhet gjendja fizike e aktivitet afatgjatë material, vlera kontabël e objektit që jepet me qira sipas llogarive financiare në fund të vitit paraardhës dhe shoqërohet me pamje fotografike të momentit. Është në përgjegjësinë e tyre ligjore, civile dhe administrative, akt dorëzimi i objektit të kontratës së qirasë.</p> <p>-QSUNT nuk ka mbajtur një regjistër të veçantë, për periudhën objekt auditimi për secilën nga pronat e dhëna me qira, me të dhënat si emërtimi i pronës, NIPTI dhe vendndodhja. Gjithashtu, për objektet e dhëna me qira nuk përmban: Sipërfaqen e objektit në m2, numrin dhe datën e kontratës së qirasë, afatin e vlefshmërisë së kontratës, afatin e kohëzgjatjes, veprimtarinë që kryhet, subjektin përfitues, qiranë mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.</p>
Kriteri :	-VKM 54 dt..05.02.2014 i ndryshuar, kapitulli VI neni 2 pika a).
Ndikimi/Efekti:	<p>-Mungesa e tyre sjell mundësi të abuzimeve me pronën shtetërore dhe mos pasur një evidentimin real të pronës çdo rinovimi të kontratës në momentin e dhënë me qira.</p> <p>-Në këto kushte qiramarrësi nuk përgjigjet për humbjen ose dëmtimet.</p>
Shkaku:	Neglizhencë nga struktura përgjegjëse.
Rëndësia	E mesme
Rekomandime:	<p>-Për kontratat e qirave të lidhura nga QSUNT duhet të bëhet dorëzimi i aktivitet afatgjatë material me anë të një procesverbali/akt dorëzimi, në mënyrë të tillë të përshkruhet qartë gjendja fizike, vlera kontabël si dhe çdo element tjetër i rëndësishëm që identifikon pronën.</p> <p>-Të merren masa për të hartuar kartelën shoqëruese për çdo aktiv të dhënë me qira.</p> <p>-QSUNT të marrë masa për evidentimin në një regjistër të veçantë për secilën nga objektet e dhëna me qira me të gjithë elementët përbërës të pronës, si: Sipërfaqen e objektit në m2, numrin dhe datën e kontratës së qirasë, afatin e vlefshmërisë së kontratës, afatin e kohëzgjatjes, veprimtarinë që kryhet, subjektin përfitues, qiranë mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.</p>

Titulli i gjetjes Nr.2	Mos realizim i kushteve të kontratës së qirasë me subjektin “K.Gj.”
Situata:	<p>Objekt i kontratës së qirasë lidhur më 26 tetor të 2015, me subjektin me nipt: L.....T është dhënia me qira e pasurisë shtetërore e quajtur “Ish-Magazina e Statistikës” njësi në administrim të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me numër pasurie 1/313 zonë kadastrale 8130 me afat 10 vjeçar. Palët kontraktuese në kohën e lidhjes të kësaj kontrate janë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ku i cili është qiradhënësi. Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 10 vjeçare, ku qiramarrësi detyrohet të paguajë qiranë në vlerën e 58,000 lekë/ muaj. Fatura për pagesë lëshohet nga njësia që ka në administrim pasurinë e cila është QSUNT.</p> <p>-Qiramarrësi “K.Gj.” nuk ka paraqitur para qiradhënësit shtesën e plan biznesit për treguesit e periudhës në vazhdim. Në kundërshtim me nenin 5.5 të kontratës, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Qiramarrësi <u>detyrohet</u></p>

	<p>që para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira, të paraqesë para qiradhënësit shtesën e plan biznesit për treguesit e periudhës në vazhdim, brenda objektit të kontratës. Kjo shtesë në plan biznesi lidhet me investimet që do të realizohen në vazhdim dhe pas investimeve që ishin parashikuar kur subjekti është paraqitur për konkurrim, e po ashtu me nivelin e punësimit”.</p> <p>-Vazhdimi i kontratës në këto kushte është në kundërshtim me nenin 8 të kontratës. Një nga rastet e zgjidhjes së kontratës është kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenet 2,5 dhe 6 të saj. Në kundërshtim të nenit 5.5 është një detyrim zgjidhja e kontratës. Titullari i institucioni nuk ka ndërmarrë asnjë masë, po ashtu edhe nga MFE nuk është vepruar për ndërprerjen e kontratës.</p> <p>-Në rastet kur kontrata është lidhur me persona fizik dhe nga ana e tyre është marr përsipër ose janë kryer investime në nivele që në bazë të legjislacionit duhet të ushtrojnë veprimtari si persona juridikë, në zbatim të kontratës dhe VKM 54 datë 05.02.2014 ndryshuar, në kapitullin VI pika 5. Pas verifikimit rezulton se subjekti me këtë nipt L.....T me datë regjistrimi 13.07.2015 është person fizik dhe nuk është regjistruar si person juridik. Ky fakt nuk është evidentuar nga njësia monitoruese e kontratave, si në instancat drejtuese më lartë në institucion.</p>
Kriteri	<p>-Kontrata e qirasë Nr.7827 rep. Nr.2371 Kol. Datë 26.10.2015, Neni 5.5 dhe Neni 8</p> <p>-Ligji Nr.33/2012 i ndryshuar, neni 51</p> <p>- VKM 54 dt..05.02.2014 i ndryshuar , kapitulli II , pika 7 b)</p> <p>- VKM 54 dt..05.02.2014 i ndryshuar , kapitulli VI, pika 2 c)</p> <p>- Ligji Nr.33/2012 i ndryshuar, nenin 51</p>
Ndikimi/Efekti:	-Vazhdimi i marrëdhënies kontraktuale pa zbatuar kushtet e saj.
Shkaku:	Neglizhenca e strukturave përgjegjëse.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	<p>- Drejtori i përgjithshëm i QSUNT në cilësinë e njësisë që ka në administrim pronën dhe MFE në cilësinë e qiradhënësit të ndërmarrin të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për zgjidhjen kontratës me subjektin “K.Gj.”, pasi nuk ka përmbushur kushtet eksplicite të kontratës.</p> <p>Nga Drejtori i përgjithshëm të merren masa për monitorimin dhe përmbushjen e detyrimeve, kriterëve dhe vazhdueshmërinë e kontratave të qirave</p> <p>Nga Drejtori i përgjithshëm të merren masa që kontratat e qirave, që kanë për objekt një send të paluajtshëm, dhe me afat më shumë se 9 vite duhet të bëhen me akt noterial dhe të regjistrohen në regjistrat publik pranë zyrës së Drejtorisë Vendore të ASHK Tiranë, për efekt vlefshmërie.</p>

Titulli i gjetjes Nr. 3	Ndryshimet e çmimeve të kontratave të qirave jo në proporcion të drejtë
Situata:	Në kontraten e qiradhënien e pasurisë shtetërore “Ish-Magazina e Statistikës” njësi në administrim të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, rezulton se nuk është përcaktuar qartë se sa është tarifa e m ² e sipërfaqes në ndërtesë dhe sipërfaqes funksionale për kontratën e lidhur me subjektin

	<p>“K.Gj.”. Kjo pasuri ka sipërfaqe të përgjithshme 226,5 m², përkatësisht sipërfaqja nën objekt është 180.5 m² dhe sipërfaqe funksionale 46 m². Vlera dysHEME e detyrimit mujor përcaktohet si shumë e vlerës së qirasë mujore për ndërtesën dhe sipërfaqen funksionale që jepet me qira, e përcaktuar si sipërfaqe funksionale vetëm sipërfaqja e truallit që ndodhet pranë objektit, e cila përdoret për të ushtruar funksionin objekt kontrate. U konstatua nga dokumentet e pronësisë të objektit se “Ish-magazina e statistikës” është godinë njëkatesh, dhe qiraja në këto raste paguhet për sipërfaqen e objektit 1 katësh, por nga konstatimi në terren vihet re se tarraca e godinës përdoret për shërbim bar-kafe dhe ka një investim të kryer duke vendosur një çadër mbuluese dhe rreth 20 tavolina dhe karrige, gjë që kalon në një ambient të gatshëm dhe të përshtatshëm për shërbim bar-kafe, pra duke i ndryshuar destinacionin, duke e kaluar në një sipërfaqe funksionale të shfrytëzueshme. Gjë e cila ka ndodhur në tarracën e godinës njëkateshe ku ushtrohet shërbim bar – kafe, duke pasur parasysh anën ekonomike të tij.</p> <p>-Çmimi i kontratës së qirasë me bankën C. është po i njëjti dhe nuk ka ndryshuar me ndryshimin e çmimeve të reja, por shprehet se është vendosur në bazë të kontratave të mëparshme.</p> <p>Nga auditimi u konstatua se rritja e çmimeve të qirasë aplikuar nga QSUNT nuk është në të njëjtin nivel për të gjitha subjektet qiramarrëse. Për kontratat shumëvjeçare mbi 200m², vlera e qerasë nuk është rritur për kontratën me bankën “C.”, shpk duke qëndruar vlera e njëjtë që në lidhje të kontratës.</p>
Kriteri:	- Neni 2, VKM Nr.354 e datës 11.05.2016 - VKM 54 dt..05.02.2014 i ndryshuar, kapitulli III.
Ndikimi/Efekti:	Efekte financiare në të ardhurat dytësore të QSUNT.
Shkaku:	Neglizhencë e strukturave përgjegjëse.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Struktura përgjegjëse të angazhohet për analizimin dhe rishkimin e çmimit të qirave në mënyrë të drejtë me vlerën dysHEME për pasuritë shtetërore që jepen me qira, sipas përcaktimeve ligjore.

Titulli i gjetjes Nr.4	Mungesa e kontratës së qirasë mes “A.” shpk dhe QSUNT
Situata:	<p>Nuk ka kontratë qiraje të lidhur mes “A.” shpk dhe QSUNT-në, pavarësisht se shlyhen detyrimet financiare për ambientin e kuzhinës 1090 m² të marrë me qira. Shoqëria “A.” shlyhen detyrimet referuar kontratës së mëparshme e cila është (rinovim) e datës 16.11.2011 me Nr.5075 prot., të cilës i ka mbaruar afati dhe nuk administrohen dokumente të tjera.</p> <p>-Ky fakt nuk është konstatuar në asnjë nga akt monitorimet dhe nuk ka gjurmë dokumentacioni të jetë përcjellë te titullari i institucionit dhe as të jenë ndërmarrë masa për rinovim kontrate. Nuk ka gjurmë dokumentacioni për të marrë masa për lidhjen e kontratës së qirasë. Për sa kohë nuk ka një kontratë në fuqi nuk mund të ketë një marrëdhënie juridiko- civile mes palëve.</p>
Kriteri:	- VKM 54, kapitulli I pika g) -LPP 162/2020.
Ndikimi/Efekti:	Nuk ka një marrëdhënie juridiko-civile sipas përcaktimeve ligjore mes QSUNT dhe OE “A.”, duke patur parasysh që kontrata është burimi i

	detyrimeve.
Shkaku:	Neglizhencë e strukturave përgjegjëse.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për lidhjen menjëherë të kontratës së qirasë me operatorin ekonomik "A." shpk, për shfrytëzimin e ambienteve të kuzhinës.

Titulli i gjetjes Nr.5	Parkimi i QSUNT
Situata:	<p>Për periudhën objekt auditimi QSUNT nuk ka një listë investimesh prioritare për vitin 2021 dhe 2022 për sipërfaqen 10457 m² parking në oborrin e brendshëm të QSUNT-së, përveç një liste investimesh të vitit 2019. Nuk ka përmirësim të infrastrukturës së jashtme urbane dhe pritëse detyrim i përcaktuar në akt marrëveshjen Nr.1242/41 prot., datë 16.11.2018, amenduar me Nr.884/2 prot datë 12.04.2022. Në nenin 3, të kësaj aktmarrëveshje shprehet se pala e parë e cila është QSUNT, përgatit në periudhën nëntor-dhjetor para çdo fillim viti një listë investimesh prioritare dhe pas me pas miratohet nga MSHMS. Për periudhën objekt auditimi, QSUNT nuk ka një listë emërore me targat përkatëse të automjeteve për personat të cilët do të përfitojnë shërbim/pagesë të reduktuar (stafin mjekësor dhe operatorët ekonomikë) që bashkëpunojnë me QSUNT-në për të përfituar pagesë të reduktuar, kjo në kundërshtim me nenin 2 në akt-marrëveshjen Nr.1242/41 prot., datë 16.11.2018 dhe amendimin e saj me Nr. 884/2 prot., datë 12.04.2022.</p> <p>-Për çdo vit si, dhe gjatë vitit ushtrimor, nëse ka ndryshime duhet, patjetër të përcaktohen palët e treta dhe operatorët të cilët kanë bashkëpunim me QSUNT dhe banorët të cilët kanë akses brenda territorit të palës së parë të akt-marrëveshjes do të kenë sistem të diferencuar dhe do të favorizohen në pagesë. Kjo listë vendoset në dispozicion nga DSHM pranë QSUNT dhe i dërgohet A. , po ashtu për të dy vitet objekt auditimi, si 2021 dhe 2022 nuk gjenden gjurmë dokumentacioni që është dërguar një listë dhe të jetë aprovuar nga të dy palët.</p> <p>Menaxhimi i parkimit të makinave funksionon në të gjithë territorin e spitalit të mbuluar nga politika menaxheriale 24/7. Parkimi menaxhohet nga njësia e menaxhimit të parkimit A. pranë QSUNT-së. Vjelja e të ardhurave bëhet në mënyrë të njëanshme nga A. dhe në fund të çdo 3 mujori bëhet rakordimi në bazë të dokumentacionit/kupon tatimor që paraqet A.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - VKM Nr.688, datë 14.11.2018, i ndryshuar - Akt marrëveshjen Nr.1242/41 prot., datë 16.11.2018 dhe amendimit të saj me Nr.884/2 prot datë 12.04.2022.
Ndikimi/Efekti:	<ul style="list-style-type: none"> -Mungesa e një liste investimesh prioritare sjell mungesën e përmirësimit të shërbimit të ofruar, duke pasur gjithnjë në vëmendje objektin e akt-marrëveshjes dhe nevojës që ka QSUNT, si një bashkësi e disa spitaleve dhe dyndjes së madhe të njerëzve për rregullimin e infrastrukturës urbane dhe pritëse dhe menaxhimit cilësor të shërbimit publik. -Mungesë transparence të një liste emërore për operatorët stafin mjekësor,

	dhe banorë të cilët përfitojnë shërbim me pagesë të reduktuar, sjell një listë jo të drejtë dhe të vërtetë. -Ndërmjet A. dhe QSUNT konstatohet se nuk ka asnjë sistem të përbashkët kontrolli mbi numrin e automjeteve që parkojnë, përveç deklarimit që A. bën tek QSUNT, e si rrjedhojë QSUNT nuk merr siguri të mjaftueshme lidhur me numrin e saktë të automjeteve që hyjnë në parkim.
Shkaku:	Neglizhencë e strukturave përgjegjëse.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të ngritur grupin e punës, për vlerësimin e investimeve të kryera në aktivet afatgjata/ambientet të dhëna me qira. Të hartohet lista e investimeve prioritare në Akt-Marrëveshjen e parkimit e cila ka si qëllim kryesor të një shërbim sa më cilësor ndaj pacientëve, si dhe lista emërore me targat përkatëse të automjeteve për personat të cilët do të përfitojnë shërbim/pagesë të reduktuar (stafin mjekësor dhe operatorëve ekonomik) që bashkëpunojnë me QSUNT për të përfituar pagesë të reduktuar. Ndërmjet A. dhe QSUNT duhet të mundësohet një sistem të përbashkët kontrolli mbi numrin e automjeteve që parkojnë, përveç deklarimit që A. bën tek QSUNT, e si rrjedhojë QSUNT të marrë siguri të mjaftueshme lidhur me numrin e saktë të automjeteve që hyjnë në parkim.

-Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar, është paraqitur observacioni me shkresën Nr. 175/135prot., datë 04.08.2023, në lidhje me aktkonstatimin Nr.31, datë 31.05.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Referuar pikës 2 të Konkluzioneve, ju informojmë se grupi i punës ka përcjellë informacionin e nevojshëm brenda afateve që përcakton VKM, shkresa të cilat i gjeni bashkëlidhur këtij dokumenti.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pas sjelljes së dokumentacionit shtesë për përcjelljen e informacionit në lidhje me detyrimet e qirave dhe realizimin e treguesve të punësimit dhe investimeve, pretendimi i subjektit pranohet.

Pretendimi i subjektit:

Referuar pikës 4 të Konkluzioneve, Subjekti “K.Gj.” duhej të dorëzonte në përfundim të vitit të pestë të përdorimi të objektit me qira shtesë e plan biznesit, por duke qenë së koha e dorëzimit të këtij dokumenti përkon me periudhën e pandemisë dhe mbylljen e biznesit, kjo pikë është anashkaluar.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Njësitë monitoruese të kontratave të qirasë, për monitorimin e realizimit të kushteve të kontratës nga Qiramarrësi monitorojnë në vijueshmëri aktivitetin që ushtron subjekti qiramarrës ose enfitozmarrës, në objektin e marrë me qira, në respektim të qëllimit të lidhjes së kontratës. Po ashtu kjo shtesë planë biznesi është një ndër kushtet kryesor të fitimit të konkurrimit për marrjen me qira të objektit. Duke qenë së objekti i marrë me qira nga “K.Gj.” i është nënshtruar rregullave të konkurrimit për sipërfaqet mbi 200 m².

Po ashtu nuk pranohet si argument genia prezent e pandemisë, kjo për arsye se afati për dorëzimin e shtesës së plan-biznesit ka qenë pas datës 26.10.2020, dhe në informacionin e radhës për vitin 2021 dhe as në atë 2022 tek ministria përgjegjëse nuk është evidentuar në asnjë moment mungesa e saj, por në të kundër shprehet se realizohen kushtet e kontratës.

Pretendimi i subjektit

Referuar pikës 5 të Konkluzioneve, ju informojmë se OE “K.Gj.” që prej datës 19.04.2023 është regjistruar si person juridik më emrin tregtar “B.M.” shpk.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pavarësisht faktit se veprimi është kryer jashtë periudhës së auditimit, duke qenë se gjetja e KLSH qëndron dhe është reflektuar, gjykojmë të marrim observacionin në konsideratë.

-Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar, është paraqitur observacioni me shkresën Nr. 175/135 prot., datë 04.08.2023, në lidhje me aktkonstatimin Nr.31, datë 31.05.2023, ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Grupi i punës, pasi ka shqyrtuar kërkesat e subjekteve të interesuar për rinovimin e kontratave të qirasë me QSUT, ka përcaktuar çmimet në zbatim të VKM-së Nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar dhe udhëzimit të Ministrisë përgjegjëse për ekonominë Nr.13, datë 26.04.2018, pika 46 ku citohet se “Dokumentacioni për lidhjen e kontratës së qirasë, përgatitet sipas pikës 1, të kreut II, të VKM-së dhe vlera e detyrimit mujor të qirasë aplikohet referuar tarifave dysheme, të përcaktuara në kreun III të VKM-së dhe tarifa dysheme për qiratë brenda Bashkisë Tiranë janë 300 lekë/m². Në këto kushte, çmimet janë propozuar nga Grupi i Punës dhe janë pranuar nga subjekti përkatës, është dakordësuar dhe si rrjedhim është nënshkruar marrëveshja e qirasë. Gjithashtu, tarifat e kontratave afatgjata, për sipërfaqet mbi 200 m² nuk mund të ndryshohen gjatë kohës që kontrata shtrin efektin e saj. Grupi i punës nuk ka patur detyrë llogaritjen dhe vleresimin e cmimit për të gjitha kontratat njëherësh, por ne baze të nevojës. Pra sa herë që një kontratë rinovohej, atëherë ky grup bënte dhe llogaritjen në bazë të kërkesës së Drejtorisë Juridike. Për sa kohë nga Drejtoria Juridike nuk është vlerësuar ndryshimi i kushteve kontraktore për kontratat e qirve të cituara nga Ju, grupi i punës nuk kishte si dhe pse të kryente llogaritje për këto dy kontrata qiraje A. dhe K.Gj., pasi sic dhe cituam me lartë, detyra e grupit kryeshe në varësi të nevojës që lindnin, pra sa herë rilidhej një kontratë ose kërkohej të rivleresoheshin kushtet e saj. Gjithashtu, marrja e referencës nga një kontratë e ngjashme nuk është aspak në kundërshtim me legjislacionin përkatës, pasi marrja e cmimit nga një kontratë e mëparshme është e lejueshme nga pikëpamja juridike dhe konsiderohet si cmim reference bazuar në një kontratë të ngjashme. Në asnjë rast referenca mbi një kontratë të ngjashme nuk konsiderohet si në kundërshtim me ligjin apo aktet normative. Përsa i përket akti të cilit audituesit i referohen si i shkelur nga grupi i punës, konkretisht VKM 672 date 02.09.2020, pikë së pari nuk ka asnjë dispozitë konkrete të saj, të shkelur nga grupi i punës nëpërmjet veprimit të tyre për t’u referuar cmimit të kontratës së mëparshme të ngjashme. Theksojmë se urdhri i ngritjes së grupit të punës, në bazën e tij ligjore ka patur të përcaktuar VKM Nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si bazë ligjore për përcaktimin e vlerave të kontratave të qirave, e cila në pikën 1 të kreut III “Tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë” ka të përcaktuar konkretisht mënyrën dhe vlerën dysheme per m². Është pikërisht kjo bazë ligjore dhe përlllogaritje konkrete e ndjekur nga ky grup pune, që ka cuar dhe në hartimin e relacionit përkatës të cmimit të qirasë të Bankës Credins, cmim i njëjtë me kontratën e mëparshme. Gjithsesi, QSUT, do të rishikojë edhe njëherë mundësinë për të vlerësuar rekomandimin e lënë nga ana juaj në funksion të përmirësimit të punës.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfitozë, vlera dysheme e detyrimit mujor përcaktohet si shumë e vlerës së qirasë mujore për ndërtesën dhe sipërfaqen funksionale që jepet me qira ose enfitozë, e cila është e përcaktuar në mënyrë eksplicite në VKM 54 datë 5.2.2014. Prandaj ky observacion nuk merret në konsideratë.

2.7. Organizimi dhe funksionimi i protokoll arkivës në zbatim të Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe VKM Nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”.

1. Titullari i institucionit ka miratuar me urdhër të brendshëm Nr. 100 , datë 02.03.2023, të përpiluar nga sekretaria, modelin e njësuar të dokumentit administrativ në Republikën e Shqipërisë, bazuar në nenet 12 dhe 13 e në vijim të Normave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

2. Urdhri është në përputhje me shtojcën Nr. 1, të rregullores.

3. Sekretaria, pranon në sekretari dokumentet administrative, që i propozohen titullarit për nënshkrim dhe kontrollon nëse plotësojnë të gjitha kushtet e normave tekniko-profesionale.

Komisioni i Ekspertizës

Komisioni i Ekspertizës (KE) është ngritur pranë fond krijuesit “QSUNT” në Nr. 99 dt. 02.03.2022, sipas Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

2. Kryetar i KE-së është titullari i institucionit.

Sekretar i KE-së është përgjegjësi i sektorit të arkivit

Janë 11 anëtarë të KE-së, konkretisht: A.F. kryetar; P. P. sekretar; J. H. anëtar; E. Z. anëtar; I.K. anëtar; E. R. anëtar; L.C. anëtar; A.V. anëtar dhe B.M. anëtar.

3. Urdhri për ngritjen e KE-së është i përpiluar brenda ditës së 10-të të punës nga përgjegjësjja e sekretari-arkivit dhe është i miratuar nga titullari i institucionit, sipas modelit të shtojcës Nr. 2

Lista konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK)

Komisioni i Ekspertizës, me propozim të sekretarit, ka miratuar në mbledhjen e parë të zhvilluar datë 21.02.2022 dhe mbledhjen e dytë në datë 21.11.2022, listën konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK) dhe të dokumenteve me afat ruajtjeje të përkohshme, sipas modelit dhe në përputhje me listën “tip” me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK), të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Komisioni Epror i Ekspertizës me vendimin Nr. 11 dt.. 21.02.2022 dhe me vendimin Nr. 37 datë 21.11.2022 ka miratuar listat e dosjeve të veçuara për asgjësim, sipas vendimeve të institucionit dhe ligjit, për dokumentet që kanë humbur vlerën e ruajtjes së mëtejshme.

Pasqyra emërtuese e çeljes së dosjeve

1. Sekretaria, ka përpiluar pasqyrën emërtuese të çeljes së dosjeve për vitet 2021 dhe 2022. Pasqyra është e hartuar veç për dokumentet me ruajtje të përhershme dhe veç për ato me ruajtje të përkohshme, me çështje të renditura sipas drejtorive ose sektorëve në përputhje me renditjen që kanë në strukturën organizative të institucionit, sipas modelit të përcaktuar në normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

2. Është e miratuar nga sekretaria, pasqyra emërtuese e çeljes së dosjeve për vitet 2021 dhe 2022. Janë të mbyllura dosjet e hapura për vitin 2021 dhe për vitin 2022 sipas pasqyrës emërtuese, duke i verifikuar në librin e korrespondencës, brenda 6 –muorit të parë të vitit pasardhës.

Janë në përpunim tekniko-shkencor dokumentet e prapambetura, pasi është bërë përcaktimi i përkatësisë së fondit dhe klasifikimi i dokumenteve, sipas fondeve është bërë ndarja e dokumenteve në fonde, procesi i klasifikimit vazhdon në grupimin e tyre brenda fondit.

Vend ruajtja e dokumenteve

Sallat e ruajtjes së dokumenteve janë të pajisura me rafte metalike dhe të lyera me bojë kundër ndryshkjes për vendosjen e dokumenteve.

Dokumentet janë të vendosura në dosje dhe në kuti kartoni.

Është kryer dezinfektimi i ambienteve të arkivës dhe zyrës së sekretarisë në gusht të 2022, nga vetë strukturat e institucionit.

Ven druajtjet e dokumenteve hapen vetëm në prani të një punonjësi të sekretarisë dhe eprorit direkt të tij, po ashtu, vend ruajtja mbyllet dhe sigurohet pas mbarimit të orarit zyrtar.

Dhënia dhe marrja në dorëzim e dokumenteve nga ven druajtja shënohet në regjistrin e dhënies dhe marrjes së dosjeve në dorëzim nga vend ruajtja (sipas shtojcës 7), kundrejt firmës së punonjësit që e merr për shfrytëzim.

Vend ruajtja nuk është e pajisur me matësa të temperaturës dhe lagështisë, pasi institucioni nuk ka ambiente të përshtatshme për arkivë.

Sallat e ruajtjes së dokumenteve nuk janë të pajisura me sistem mbrojtës kundër zjarrit, me bombola tavanore të mbushura me gaz karboni me presion që të mbulojnë një sipërfaqe deri në 15 m².

Në kundërshtim me VKM Nr. 234, datë 20.04.2022, pika 10 germa “a”, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, ku përcaktohet se për punë të vështira dhe të dëmshme për shëndetin, punonjësve u jepet shtesa mbi pagën bazë mujore në përqindje të caktuara, QSUNT, nuk ka një përcaktim të shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për pozicionet e punës të Arkiv-Protokollit.

m².

Titulli i gjetjes Nr.1	QSUNT nuk ka ambiente të përshtatshme për arkivë
Situata:	Vend ruajtja e dokumentacionit në arkivë nuk është e pajisur me matësa të temperaturës dhe lagështisë, pasi institucioni nuk ka ambiente të përshtatshme për arkivë.. Veprim në kundërshtim me VKM Nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”.
Kriteri:	VKM Nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”.
Ndikimi/Efekti:	Risk përkeqësim shëndeti të punonjësve.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për sigurimin e ambienteve të përshtatshme për ruajtjen e dokumentacionit arkivor, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Titulli i gjetjes Nr.2	Mos përcaktim të shkallës së vështirësisë dhe dukshmërisë për pozicionet e punës të Arkiv- Protokollit
Situata:	Në kundërshtim me VKM Nr. 234, datë 20.04.2022, pika 10 germa “a”, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”,

	ku përcaktohet se për punë të vështira dhe të dëmshme për shëndetin, punonjësve u jepet shtesa mbi pagën bazë mujore në përqindje të caktuara, QSUNT, nuk ka një përcaktim të shkallës së vështirësisë dhe dukshmërisë për pozicionet e punës të Arkiv- Protokollit.
Kriteri:	VKM Nr. 234, datë 20.04.2022, pika 10 germa “a”.
Ndikimi/Efekti:	Risk menaxherial.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Drejtori i përgjithshëm ti paraqes kërkesë Institutit të Shëndetit Publik, për përcaktim të shkallës së vështirësisë dhe dukshmërisë për pozicionet e punës të arkiv- protokollit/por jo vetëm, që të përcaktojë vendet e punës, të vështira e të dëmshme për shëndetin e punëmarrësve në QSUT, si dhe shkallën e vështirësisë e dukshmërisë, për çdo vend pune; dhe pas përcaktimit të kësaj shkalle, të paraqes kërkesën për miratim në ministrinë përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë dhe në ministrinë përgjegjëse për çështjet e punësimit, për shtesë mbi pagën bazë mujore në përqindje të caktuara.

2.8. Organet drejtuese dhe vendimmarrja e tyre.

Organizmi dhe funksionimi i QSUNT bëhet në zbatim të VKM Nr. 654, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të qendrës spitalore universitare "Nënë Tereza". Pika 1, “Miratimin e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", si strukturë shëndetësore universitare e përgjithshme, e cila realizon funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si pjesë e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë Tiranë”.

Pika 2. Mënyra e funksionimit të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", si strukturë shëndetësore universitare, përcaktohet në statutin e saj, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Statuti është miratuar në zbatim të Urdhrit të Përbashkët Nr. 709, date 10.10.2018, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e Statutit të QSU "Nënë Tereza".

Në këtë statut KREU III “ORGANIZIMI”, pika 8 “ Organet Drejtuese”

Organet Drejtuese të QSU "Nënë Tereza", janë: Bordi; Drejtoria e Përgjithshme; Komisioni Mjekësor.

Pika 9/1 “Bordi”. QSU "Nënë Tereza", drejtohet nga Bordi dhe Drejtoria e Përgjithshme. Bordi miraton politikat dhe strategjinë e zhvillimit, si dhe miraton programet tekniko-financiare të veprimtarisë së QSU-së, në përputhje me politikat qeverisëse për shëndetësinë, arsimin e lartë e kërkimin shkencor, si dhe planin e zhvillimit strategjik të universitetit e të fakulteteve të fushës së shëndetit.

Pika 9.2: Bordi kryesohet nga Ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe ka në përbërje katër anëtarë:

- a) Përfaqësuesin nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe sportin;
- b) Përfaqësues nga institucioni i arsimit të lartë mjekësor;
- c) Kryetarin e Komisionit Mjekësor;
- d) Përfaqësuesin nga Institucioni që financon kujdesin shëndetësor (FSDKSH).

Në kundërshtim me Statutin, pika 9.2, të KREU III "ORGANIZIMI", Ministri me urdhër Nr. 369, datë 24.08.2021 ka urdhëruar ngritjen e bordit të QSUNT, me 5 anëtar i përbërë nga: M.R., kryetar bordi, me detyrë Zv/ Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, J.Gj., anëtar, me detyrë përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, A.G., anëtar në cilësinë e kryetarit të komisionit mjekësor (QSUT), A.A. anëtar, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, A.I., anëtar, me detyrë Zv/rektor i Universitetit të mjekësisë Tiranë. Bordi drejtues kryesohet nga M.R. me detyrë zv/ministër i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ky urdhër i Ministrisë është në kundërshtim me:

1.VKM Nr. 654, datë 10.11.2017 "Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "Mënyra e funksionimit të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", si strukturë shëndetësore universitare, përcaktohet në statutin e saj, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë".

Pika 5, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" për zbatimin e këtij vendimi".

3. Urdhërin e Përbashkët Nr. 709, datë 10.10.2018, i Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e Statutit të QSUNT "Nënë Tereza", KREU III "ORGANIZIMI", pika 9.2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "Bordi kryesohet nga Ministri përgjegjës për shëndetësinë".

Për pasojë: Të gjitha vendimet e marra nga bordi janë të pavlefshme, përfshi dhe rregulloren e organizmit dhe funksionimit të QSUNT.

Konkretisht:

-Vendim i Bordit i Spitalit Nr. 2, datë 26.07.2021 (755/6 prot); Vendim për ndryshime në strukturë (Të miratojë ndryshimin e strukturës administrative të QSUNT).

-Vendim i Bordit i Spitalit Nr. 3, date 30.12.2021 (755/13 prot); Vendim "Miratim ndryshimet strukturore".

-Vendim i Bordit i Spitalit Nr. 1, datë 07.03.2022 "Për ndryshime në Rregulloren e QSUT", pika 3.2 dhe aneksin 1.

-Vendim i Bordit i Spitalit Nr. 2, datë 26.07.2021 "Për ndryshime në strukturë".

-Vendim i Bordit i Spitalit Nr. 3, datë 02.12.2022 "Për disa ndryshime të statutit të Qendrës Spitalore Universitare " Nënë Tereza.

- Vendim i Bordit i Spitalit vendim Nr. 4, datë 02.12.2022 "Për ndryshime në strukturë, Klinika trajnuese e vartësisë alkoolike i bashkohet Shërbimit të toksikologjisë dhe adiktologjisë, Shërbimi i laboratorit të gjenetikës bëhet Shërbimi i laboratorit të klinikës gjenetike".

-Vendim i Bordit i Spitalit Nr. 5, datë 29.12.2022 Ndryshime strukturore të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", brenda numrit total të punonjësve 3017, të reflektuar në Aneks Nr.1.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi znj. O.M. me detyrë Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Me urdhër të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 519, date 03.12.2021 "Për emërim të përkohshëm në detyrë", A.F. është emëruar në detyrën, Drejtor i Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", deri në kryerjen e procedurave të konkurrimit në këtë pozicion pune. Në QSUNT, nuk disponohet kontratë punësimi e përkohshme ose e përhershme me drejtorin e përgjithshëm A.F.

Me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 17, date 15.01.2021, “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, B.Q. është emëruar në detyrën e Zv/drejtorit të Përgjithshëm në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, protokolluar në QSUT me Nr. 255 prot, datë 15.01.2021.

Për këtë emërim është lidhur kontratë shtesë me Nr. 44/2 prot., datë 19.01.2021 ndërmjet E.J. dhe B.Q.. Në nenin 3 “Kohëzgjatja shtesë e kontratës” ku në mënyrë eksplicite është shprehur “Kjo shtesë kontrate hynë në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja palët dhe është e vlefshme deri në ç ‘fuqizimin e aktit administrativ Nr. 255 prot., datë 15.01.2021 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që në fakt është urdhri i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 17, date 15.01.2021.

Është lidhur kontratë shërbimi (mjek pedagog) me Nr. 43/5 datë 14.01.2021 ndërmjet E.J. dhe B.Q.. Në nenin 3 “Kohëzgjatja shtesë e kontratës” në mënyrë eksplicite është shprehur “Kjo kontratë shërbimi hynë në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja palët dhe është e vlefshme deri në shprehjen me shkrim të palëve, për zgjidhjen e saj, duke respektuar afatin 5 ditor të njoftimit. Kontrata zgjidhet në çdo kohë, me përfundimin e kontratës së punës si pedagog i Fakultetit të Mjekësisë.

Me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 198, date 30.03.2022 “Për emërim të përkohshëm në detyrë, N.S. është emëruar në detyrën e Zv/drejtorit të Përgjithshëm në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Nuk ka kontratë të lidhur ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zv/Drejtorit të Përgjithshëm N.S., në kundërshtim me Statutin e Spitali KREU IV, “Rregulla dhe procedura të punësimit dhe të vlerësimit ” pika 22. “Kontrata e Punës”.

Pika 22.1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Të gjithë punonjësit në QSU "Nënë Tereza" janë të punësuar me kontrate pune individuale sipas rregullave të Kodit të Punës”.

Pika 22.2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Kontrata individuale e punës lidhet në pajtim të plotë me ligjin dhe kontratën kolektive të punës, për punonjësit e shëndetësisë që lidhet ndërmjet Ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe sindikatës apo sindikatave” dhe Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Veprimi i cili ngarkon me përgjegjësi Drejtorin e Përgjithshëm.

Që prej datës 03.12.2021 deri më datën 31.05.2023 që përfundoi auditimi (18 muaj), QSUNT është drejtuar me drejtor të përkohshëm dhe dy zv/drejtor përgjithshëm/teknik të përkohshëm. Veprim në kundërshtim me statutin, KAPITULLI III, neni 13 “Drejtoria e Përgjithshme”, pika 13.1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Drejtoria e Përgjithshme siguron drejtimin administrativ dhe institucional të QSUNT. Ajo drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Drejtoria menaxhon aktivitetin e përgjithshëm të shërbimeve, programon orientimet strategjike dhe siguron zbatimin e tyre”.

Pika 13.2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Drejtoria e Përgjithshme përbëhet nga: Drejtori i përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm”. Në status, Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 286, datë 21.5.2018 “Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm” në asnjë nen nuk përcaktohet “Drejtor dhe zv/drejtor i përgjithshëm i përkohshëm.

Veprime në kundërshtim me:

Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Neni 18/1, VKM Nr. 286, datë 21.5.2018 “Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm”, pika 1,2,4 dhe 5, Kreu V “Kontrata e Punës”, neni 12.

Në QSUNT nuk është organizuar dhe nuk funksionon Komisioni Mjekësor, veprim në kundërshtim me Statutin e miratuar në zbatim të Urdhrit të Përbashkët Nr. 709, date 10.10.2018, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e Statutit të QSU "Nene Tereza", pika 17 "Zëvendës drejtorët e përgjithshëm", pika 18 "Komisioni Mjekësor i QSU "NËNË TEREZA", pika 18.1. pika 18.2 dhe pika 18.3.

Shkelja e dispozitave ligjore si më sipër ngarkon me përgjegjësi znj. O.M. me detyrë ish-Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe M.R. me detyrë Zv/Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në cilësinë e Kryetares së Bordit të QSUNT.

-2.8/b. Pacientët që dërgohen për kurim në Turqi me vendim të komisionit ndërsptalor.

Për periudhën 01.04.2021 deri më 31.12.2021, komisioni ndërsptalor ka dhënë 45 vendime, ndërsa për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 ka dhënë 58 vendime.

Deri datë 07.03.2023, datë e këtij informacioni, nuk është vënë në dispozicion të grupit të auditimit Vendimi/ose urdhri i Ministrit për ngritjen e komisionit ndërsptalor, rregullorja e organizmit dhe funksionimit të këtij komisioni.

Vendimet janë firmosur nga A.S., kryetare komisioni me detyrë zv/ drejtoreshë teknike J.K. anëtare me detyrë shefe shërbimi i neurologjisë, shefe shërbimi i hipertensionit dhe mjekësisë interne, E.K. shefe e shërbimit të reanimacionit pediatrik, A.D., pedagog dhe A.G. QSUNT disponon Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 35 datë 16.05.2018 "Mbi trajtimin nga komisionet ndër spitalore pranë qendrës spitalore universitare "Nënë Tereza", të rasteve për rikontroll të pacientëve të trajtuar në Turqi".

1. Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" me anë të Komisioneve Ndërsptalore, të vlerësojë nevojën që kanë pacientët e dërguar në Turqi dhe të kryejë trajtimin e rikontrolleve të pacientëve shqiptar të trajtuar në kuadër të Marrëveshjes në fushën e shëndetësisë, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë, të vitit 1999.

2. Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", të dërgojë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Vendimet e Komisioneve ndër spitalore vetëm për rastet e pacientëve, të cilët nuk mund të kurohen në spitalet dhe klinikat shqiptare.

3. Ngarkohet Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" për zbatimin e këtij urdhri.

Nuk ka vendim/urdhër të Ministrit të Shëndetësisë, ose Bordit të Spitalit, për ngritjen e komisionit të sipërpërmendur, si dhe rregullore të organizmit dhe funksionimit të këtij komisioni. Pothuajse të gjitha epikrizat nga shërbimet spitalore si dhe nga spitalet e tjera (SUT) në total 103, janë trajtuar nga A.S. me detyrë zv/ drejtoreshë teknike, pa kaluar nga drejtori i përgjithshëm. Pas vendimmarrjes së komisionit Drejtori i përgjithshëm, ka marrë vendimin e tij dhe ja ka përcjellë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë).

Veprime e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi znj. O.M. me detyrë ish-Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, M.R. me detyrë Zv/Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në cilësinë e kryetares së Bordit, A.F. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i QSUNT për periudhën 03.12.2021-31.12.2022, E.J. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i QSUNT për periudhën 01.04.2021-30.11.2021.

Spitali Universitar i Traumës me shkresën Nr. 475 prot, datë 01.03.2022, protokolluar në QSUNT me Nr. 832 prot., datë 03.03.2022, i është drejtuar Komisionit ndërsptalor duke i përcjellë epikrizën mjekësore të pacientit B. Ç. Në epikrizë është shprehur në mënyrë eksplicite se "Pacienti B. Ç është shtruar në SUT, pas një aksidenti automobilistik të ndodhur më datën 22.02.2021 me Nr. karte 2339 nga data 22.02.2021 deri në datën 13.04.2021. Pacienti vjen në gjendje shumë të rëndë dhe me rrezik për jetën. Pas reaminimit dhe mjekimit operohet nga Fractura aperta cruris dexter dhe Fractura massive bacini me protrusion acetabuli sinistra.

Komisioni ndërsptalor është mbledhur me procesverbal datë 12.05.2022, dhe vendosi që për specifikat që ky rast paraqet, i plotëson kriteret që të dërgohet në një klinikë më të specializuar jashtë vendit. Procesverbali është firmosur nga: A.S. me detyrë kryetare komisioni, M.Gj. anëtare, E.K. anëtare, A.D. antar dhe A.G. anëtare. Nuk është firmosur nga J.K..

Vendimi është marrë me nr. 22, datë 13.05.2022 nga Drejtori i Përgjithshëm, ku ka vendosur, që pacienti B. Ç, duhet të dërgohet në një klinikë më të specializuar jashtë vendit, pasi ka nevojë për protezë totale coxofemorale speciale. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë), i është përcjellë me shkresën Nr. 832/2 prot., datë 13.05.2022.

Pra vendimmarrja dhe përcjellja në Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria e Marrëdhënieve me jashtë), është bërë dy muaj e dhjetë ditë me vonesë, edhe pse në epikrizë është shprehur se pacienti vjen në gjendje shumë të rëndë dhe me rrezik për jetën.

Poli i administrimit Spitali Francez, shërbimi i okulistikës, me shkresë datë 21.02.2022 të firmosur nga mjeku okulist E.S., shefi i shërbimit V.M. dhe mjeku okulist B.Sh., protokolluar në QSUT Nr. 745 prot, datë 22.03.22, i është drejtuar Komisionit ndërsptalor duke i përcjellë epikrizën mjekësore të pacienti A. H.

Komisioni ndërsptalor është mbledhur me procesverbal datë 01.04.2022, dhe vendosi që për specifikat që ky rast paraqet, i plotëson kriteret që të dërgohet në një klinikë më të specializuar jashtë vendit. Procesverbali është firmosur nga: A.S. me detyrë kryetare komisioni, M.Gj. anëtarë, E.K. anëtare, A.D. antar nuk është firmosur A.G. anëtare dhe J.K. anëtare.

Vendimi është marr me nr.122, datë 01.04.2022 nga Drejtori i Përgjithshëm, A.F. ku ka vendosur, që pacienti A. H, duhet të dërgohet në një klinikë më të specializuar jashtë vendit, i është përcjellë me shkresën Nr. 745/2 prot., datë 01.04.2022.

Pra vendimmarrja dhe përcjellja në Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria e Marrëdhënieve me jashtë), është bërë 39 ditë me vonesë.

Të gjitha vendimet e Drejtorit të Përgjithshëm A.F. dhe shkresat përcjellëse në Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria e Marrëdhënieve me jashtë), janë me vulë të komisionit ndërsptalor, vulë e cila nuk është prodhuar dhe sekretuar sipas dispozitave ligjore në fuqi, vulë e ndryshme nga ajo e QSUNT, veprim në kundërshtim me VKM Nr.390, datë 6.8.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”.

Pra, jo vetëm vendimet e drejtorit të përgjithshëm, por edhe shkresat përcjellëse për në ministri janë bërë me këtë vulë.

Drejtorit të Përgjithshëm A.F. ju kërkua procedura e ndjekur për prodhimin e vulës së komisionit ndërsptalor, pasi ky komision nuk është person juridik që ushtron veprimtari në Republikën Shqipërisë dhe nuk detyrohet të ketë vulë zyrtare. Referuar VKM Nr.390, datë 6.8.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”, pika 6, prodhimi i vulave bëhet në një ekzemplar të vetëm, të dhënat e të cilëve regjistrohen në kompjuterin e Ministrisë së Rendit Publik. Kjo procedurë nuk u vu në dispozicion, pra nuk provohet që kjo vulë është prodhuar në subjekte të licencuar nga Ministria e Brendshme dhe e regjistruar nga kjo Ministri në kompjuterin e saj.

Për periudhën 01.04.2021 deri 03.12.2022, të gjitha vendimet e Drejtorit të Përgjithshëm E.J. dhe shkresat përcjellëse në Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë), janë me vulë të QSUNT jo me titullin vulë e Komisionit Ndërsptalor.

Veprime në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” Kreu II “Përgjegjësitë e shtetit dhe të shtetasve”, neni 4, pika 1 “Përgjegjësitë e shtetit”, ku është

shprehur në mënyrë eksplicite se “Shteti ushtron veprimtarinë e tij lidhur me kujdesin shëndetësor në mbështetje të këtij ligji dhe zotohet për të rregulluar dhënie, mbikëqyrjen dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor”, çka ngarkon me përgjegjësi A.S. me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm në cilësinë e kryetares së komisioni ndërsptalor.

Titulli i gjetjes Nr. 1	Bordi drejtues kryesohet nga Zv/Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kundërshtim me statutin
Situata:	<p>Organizmi dhe funksionimi i QSUNT bëhet në zbatim të VKM Nr. 66, datë 3.2.2017 ndryshuar me VKM Nr. 654, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të qendrës spitalore universitare "Nënë Tereza".</p> <p>Statuti është miratuar në zbatim të Urdhrit të Përbashkët Nr. 709, datë 10.10.2018, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e Statutit të QSU "Nënë Tereza".</p> <p>Në kundërshtim me Statutin, pika 9.2, të KREU III “ORGANIZIMI”, Ministri me urdhër Nr. 369, datë 24.08.2021 ka urdhëruar ngritjen e Bordit të QSUNT, me 5 anëtar. Bordi drejtues kryesohet nga M.R.me detyrë Zv/Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.</p> <p>Ky urdhër i Ministrit për ngritjen e bordit është në kundërshtim me:</p> <p>1. VKM Nr. 654, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", pika 2. Mënyra e funksionimit të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", si strukturë shëndetësore universitare, përcaktohet në statutin e saj, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.</p> <p>2. Urdhrin e Përbashkët Nr. 709, datë 10.10.2018, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e Statutit të QSUNT "Nënë Tereza", Kreu III “Organizimi”, pika 9.2: Bordi kryesohet nga Ministri përgjegjës për shëndetësinë.</p> <p>Për pasojë, të 7 vendimet e marra nga bordi janë të pavlefshme, përfshi dhe rregulloren e organizmit dhe funksionimit të QSUNT.</p> <p>Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi Znj. O.M. me detyrë Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.</p>
Kriteri:	VKM Nr. 66, datë 3.2.2017 ndryshuar me VKM Nr. 654, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza".
Ndikimi/Efekti:	Vendimmarrje të bordit drejtues në pavlefshmëri.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga organet drejtuese t’i kërkohet ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të bashkërendojë dhe koordinojë veprimtarinë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për rikompozimin e Bordit ne përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe nënligjor.

Titulli i gjetjes Nr. 2	Menaxhimi i QSUT kryhet nga drejtues të përkohshëm
Situata:	<p>Me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 519, date 03.12.2021 “Për emërim të përkohshëm në detyrë, A.F. është emëruar në detyrën, Drejtor i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, deri në kryerjen e procedurave të konkurrimit në këtë pozicion pune. Në QSUNT, nuk disponohet kontratë punësimi e përkohshme ose e përhershme me drejtorin e përgjithshëm A.F.</p> <p>Që prej datës 03.12.2021 deri më datën 31.05.2023 që përfundoj auditimi (18 muaj), QSUNT është drejtuar me drejtor të përkohshëm dhe dy zv/drejtor përgjithshëm/teknik të përkohshëm. Veprim në kundërshtim me statutin, Kapitulli III, neni 13 “Drejtoria e Përgjithshme”, pika 13.1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Drejtoria e Përgjithshme siguron drejtimin administrativ dhe institucional të QSU "Nënë Tereza". Ajo drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Drejtoria menaxhon aktivitetin e përgjithshëm të shërbimeve, programon orientimet strategjike dhe siguron zbatimin e tyre”.</p> <p>Pika 13.2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Drejtoria e Përgjithshme përbehet nga: Drejtori i përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm”. Në status, Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 286, datë 21.5.2018 “Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm” në asnjë nen nuk përcaktohet “Drejtor dhe zv/drejtor i përgjithshëm i Përkohshëm.</p> <p>Me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 198, date 30.03.2022 “Për emërim të përkohshëm në detyrë, N.S. është emëruar në detyrën e Zv/drejtorit të Përgjithshëm në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.</p> <p>Nuk ka kontratë të lidhur ndërmjet drejtorit të Përgjithshëm dhe zv/drejtorit të përgjithshëm N.S., në kundërshtim me Statutin e Spitalit, Kreu IV, “Rregulla dhe procedura. të punësimit dhe të vlerësimit ” pika 22. “Kontrata e Punës”.</p>
Kriteri:	<p>Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.</p> <p>-VKM Nr. 286, datë 21.5.2018 “Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm”.</p>
Ndikimi/E fekti:	Risk menaxherial.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Bordi të ndërmarr veprime Institucionale për përcaktimin përfundimtar të statusit të punës të Drejtorit dhe Zv/Drejtorëve të Përgjithshëm, shpërbimit dhe lidhjes së kontratave.

Titulli i gjetjes Nr. 3	Në QSUT nuk është organizuar dhe nuk funksionon Komisioni Mjekësor
--------------------------------	--

Situata:	<p>Në QSUT nuk është organizuar dhe nuk funksionon Komisioni Mjekësor, veprim në kundërshtim me Statutin e miratuar në zbatim të Urdhrit të Përbashkët Nr. 709, datë 10.10.2018, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e Statutit të QSU "Nënë Tereza", pika 17 "Zëvendësdrejtorët e përgjithshëm", pika 18 "Komisioni Mjekësor i QSU "Nënë Tereza", pika 18.1 ku është shprehur në mënyrë eksplicite "Komisioni Mjekësor është organ këshillimi teknik i Drejtorisë së Përgjithshme dhe përbëhet nga drejtorët e spitaleve, që funksionojnë brenda autoritetit spitalor të qarkut dhe shefat e shërbimeve ose përfaqësues të zgjedhur nga vete shërbimet e këtyre spitaleve".</p> <p>Pika 18.2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite "Komisioni Mjekësor kryesohet nga kryetari i zgjedhur me votim të fshehtë, në bazë të kriterëve të vendosura nga ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe ushtron veprimtarinë e tij për tre vjet".</p> <p>Pika 18.3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite "Komisioni Mjekësor përbëhet nga 26 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Bordi, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme, sipas formulës: Drejtoria i propozon Bordit kandidaturat për anëtarë të Komisionin Mjekësor të QSU "Nënë Tereza", me një listë jo me të vogël se dyfishi i numrit të vendeve që duhet të plotësohen, në të cilën kandidatet shefa shërbimesh nuk mund të jenë më shumë se 50 për qind".</p> <p>Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër ngarkon me përgjegjësi znj. O.M. me detyrë Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe M.R. me detyrë Zv/Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në cilësinë e Kryetares së Bordit të QSUNT.</p>
Kriteri:	Statuti i miratuar me Urdhër të Përbashkët Nr. 709, datë 10.10.2018, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e Statutit të QSU "Nënë Tereza", pika 18.1,18.2 dhe 18.3.
Ndikimi/Efekti:	Risk operacional dhe menaxherial.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lart
Rekomandime:	Nga Bordi dhe Drejtori i përgjithshëm të merren masa për krijimin dhe funksionimin e Komisionit Mjekësor të QSUNT .

Titulli i gjetjes Nr.4	Vendimmarrje e vonuar Komisionit Ndërspitalor, që ka riskuar shëndetin e pacientëve
Situata:	<p>Komisionit ndërspitalor në 2 raste ka marrë vendimmarrje të vonuar duke riskuar shëndetin e pacientëve.</p> <p>a. Konkretisht, Spitali Universitar i Traumës me shkresën Nr. 475 prot, datë 01.03.2022, protokolluar në QSUNT me Nr. 832 prot., datë 03.03.2022, i është drejtuar komisionit ndërspitalor duke i përcjellë epikrizën mjekësore të pacientit B. Ç. Në epikrizë është shprehur në mënyrë eksplicite: se "Pacienti B. Ç është shtruar në SUT, pas një aksidenti automobilistik të ndodhur më datën 22.02.2021 me Nr. karteles 2339 nga data 22.02.2021 deri në datën 13.04.2021. Pacienti</p>

	<p>vjen në gjendje shumë të rëndë dhe me rrezik për jetën. Pas reaminimit dhe mjekimit operohet nga Fractura aperta cruris dexter dhe Fracture massive bacini me protrusion acetabuli sinistra.</p> <p>Komisioni ndërsptalor i mbledhur me datën 12.05.2022 dhe vendosi që për specifikat që ky rast paraqet i plotëson kriteret që të dërgohet në një klinikë më të specializuar jashtë vendit.</p> <p>Vendimi është marrë me Nr.22, datë 13.05.2022 nga drejtori i përgjithshëm, ku ka vendosur që pacienti B. Ç duhet të dërgohet në një klinikë më të specializuar jashtë vendit, pasi ka nevojë për protezë totale coxofemorale speciale. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria e Marrëdhënieve me jashtë), i është përcjellë me shkresën Nr. 832/2 prot., datë 13.05.2022.</p> <p>Pra, vendimmarrja dhe përcjellja në Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë) është bërë dy muaj e dhjetë ditë me vonesë, edhe pse në epikrizë është shprehur: “Pacienti vjen në gjendje shumë të rëndë dhe me rrezik për jetën”.</p> <p>b. Poli i Administrimit Spitali Francez, Shërbimi i Okulistikës, me shkresë datë 21.02.2022 të firmosur nga mjeku okulist E. S, shefja e shërbimit V. M. dhe mjeku okulist B. Sh, protokolluar në QSUT Nr. 745 prot, datë 22.03.22 i është drejtuar komisionit ndërsptalor duke i përcjellë epikrizën mjekësore të pacientit A. H.</p> <p>Komisioni ndërsptalor është mbledhur me procesverbal datë 01.04.2022 dhe vendosur që për specifikat që ky rast paraqet i plotëson kriteret që të dërgohet në një klinikë më të specializuar jashtë vendit.</p> <p>Vendimi i marrë Nr. 122, datë 01.04.2022 nga drejtori i përgjithshëm, A.F., ku ka vendosur që pacienti A. H duhet të dërgohet në një klinikë më të specializuar jashtë vendit, i është përcjellë me shkresën Nr. 745/2 prot., datë 01.04.2022.</p> <p>Pra, vendimmarrja dhe përcjellja në Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë) është bërë 39 ditë me vonesë.</p>
Kriteri:	Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë , neni 21, neni 55. Ligji Nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” KREU II “Përgjegjësitë e shtetit dhe të shtetasve” Neni 4, pika 1.
Ndikimi/Efekti:	Risk për pasoja të rënda shëndetësore të pacientëve.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për trajtimin e epikrizave nga komisioni ndërsptalor, duke eliminuar trajtim me standard të dyfishtë të pacientëve në punën e këtij komisioni.
Titulli i gjetjes Nr.5	Vula e Komisionit Ndërsptalor, nuk është prodhuar dhe sekretuar sipas dispozitave ligjore në fuqi

Situata:	<p>Të gjitha vendimet e Drejtorit të Përgjithshëm A.F. dhe shkresat përcjellëse në Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria së Marrëdhënieve me jashtë), janë me vulë të Komisionit Ndërsptalor, vulë e cila nuk është prodhuar dhe sekretuar sipas dispozitave ligjore në fuqi, vulë e ndryshme nga ajo e QSUNT.</p> <p>Pra jo vetëm vendimet e Drejtorit të Përgjithshëm por edhe shkresat përcjellëse për në Ministri janë bërë me këtë vulë.</p> <p>Drejtorit të Përgjithshëm A.F. ju kërkua procedura e ndjekur për prodhimin e vulës së komisionit ndër spitalor, pasi ky komision nuk është person juridik që ushtron veprimtari në Republikën Shqipërisë, dhe nuk detyrohet të ketë vulë zyrtare. Referuar VKM Nr.390, datë 6.8.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”, pika 6, prodhimi i vulave bëhet në një ekzemplar të vetëm, të dhënat e të cilëve regjistrohen në kompjuterin e Ministrisë së Rendit Publik. Kjo procedurë nuk u vu në dispozicion, pra nuk provohet që kjo vulë është prodhuar në subjekte të licencuar nga Ministria e Brendshme dhe e regjistruar nga kjo Ministri në kompjuterin e saj.</p> <p>Edhe për periudhën 01.04.2021 deri 03.12.2022, të gjitha vendimet e drejtorit të përgjithshëm E.J. dhe shkresat përcjellëse në Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria së Marrëdhënieve me jashtë), janë me vulë të QSUNT jo me titullin vulë e Komisionit Ndër spitalor.</p>
Kriteri:	VKM Nr.390, datë 6.8.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”, pika 6.
Ndikimi/Efekti:	Cënohet legjimiteti i vendimmarrjes.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të formalizuar vulën e komisionit ndërsptalor në organet përkatëse, në rast të kundërt të gjitha vendimet dhe shkresat përcjellëse në Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria së Marrëdhënieve me Jashtë), të bëhen me vulën e QSUNT-së.

Titulli i gjetjes Nr. 6	Nuk ka Vendim/ose urdhër të Ministrit për ngritjen e Komisionit Ndërsptalor për pacientë që i dërgohen për kurim në Turqi, si dhe rregullore të organizmit dhe funksionimit të këtij komisioni
Situata:	<p>Për periudhën 01.04.2021 deri më 31.12.2021, komisioni ndërsptalor ka dhënë 45 vendime, ndërsa për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 ka dhënë 58 vendime për pacientë që dërgohen për kurim në Turqi.</p> <p>Nuk ka vendim/ose urdhër të ministrit për ngritjen e komisionit ndërsptalor për pacientë që dërgohen për kurim në Turqi, si dhe rregullore të organizmit dhe funksionimit të këtij komisioni.</p> <p>Pothuajse të gjitha epikrizat nga shërbimet spitalore, si dhe nga spitalet e tjera (SUT) në total 103 raste, janë trajtuar nga zv/drejtores teknike, pa kaluar nga drejtori i përgjithshëm. Pas vendimmarrjes së komisionit drejtori i përgjithshëm ka marrë vendimin e tij dhe i ka përcjell</p>

	<p>Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria së Marrëdhënieve me Jashtë).</p> <p>Në QSUNT nuk ka një sistem një sistem të përcaktuar dhe transparent për organizimin dhe funksionimin e komisionit ndërsptalor për pacientët që dërgohen për kurim në Turqi. Ky sistem duhet të përfshijë një procedurë të qartë për ngritjen e komisionit, përcaktimin e përgjegjëseve të anëtarëve, dhe dokumentimin e vendimeve të marra.</p>
Kriteri:	Ligji Nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, Kreu II “Përgjegjësitë e shtetit dhe shtetasve”, Neni 4, Pika 1.
Ndikimi/Efekti:	Risk për vendimmarrje të pa drejtë.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lart
Rekomandimi:	<ul style="list-style-type: none"> - Nga drejtori i përgjithshëm ti kërkohet Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale vendimi ose urdhri të për ngritjen e komisionit ndërsptalor. - Nga drejtori i përgjithshëm ti kërkohet Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale hartimi i rregullores të organizimit dhe funksionimit të komisionit ndërsptalor, duke përfshirë përgjegjësitë e anëtarëve, procesin e vendimmarrjes, dhe raportimin periodik. - Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për implementimin e një procesi të qartë dhe të dokumentuar për shqyrtimin dhe trajtimin e epikrizave nga personeli i caktuar, duke përfshirë kontrollin nga drejtori i përgjithshëm për të siguruar zbatimin e procedurave të duhura.

2.9. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH Nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH”.

Nga auditimi i ushtruar nga KLSH në bazë të programit Nr. 893/1, datë 07.10.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduar në 6-mujorin e dytë të vitit 2021”, në përputhje me kërkesat e Manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistri elektronik institucional”, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH Nr.67 datë 23.06.2020, janë konstatuar raste të mos zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, të cilat më hollësisht janë trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Vendimin e Kryetarit të KLSH Nr.253, datë 31.12.2022 dërguar me shkresë Nr. 835/35 prot, datë 09.01.2023.²⁴

-Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara në shkresën e KLSH Nr. shkresë Nr. 835/35 prot, datë 09.01.2023, rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi (trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit), **inkurajohet përshejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 6-mujorit të parë të vitit 2023** dhe në mbështetje të nenit 30, pika 2, të ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të

²⁴ Afati raportimit në KLSH deri në Qershor 2023, kërkuar në shkresën Nr. 835/35 prot, datë 09.01.2023.

Shtetit”, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve tona, të raportohet me shkrim pranë KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të tyre.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë **70** rekomandime, përkatësisht **31** Masa Organizative, **3** Masa për shpërblim dëmi, **5** Masa për menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitet të Fondeve Buxhetore dhe **31** Masa Disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 31 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 15 zbatuar, 16 në proces zbatimi.

b) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 3 masë shpërblim dëmi nga ku rekomandimet janë pranuar plotësisht dhe statusi ecurisë së zbatimit rezulton 3 në proces zbatimi.

c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 5 Masa për menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitet të Fondeve Buxhetore nga të cilat 1 Zbatuar, 4 në proces zbatimi.

d) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **31** Masë Disiplinore nga ku:

- 24 rekomandime janë drejtpërdrejt për QSUNT nga të cilat 2 zbatuar dhe **22** në proces zbatimi

- 7 rekomandime rekomanduar për APP të kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon **7** pa zbatuar.

Në mënyrë të detajuar mos zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. **Rekomandimi 5.1:** Me qëllim rritjen e efijencës në shpenzimet publike, nëpërmjet kryerjes së procedurave të prokurimit, në përputhje me kriteret ligjore, kapacitetet ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti kontraktor të pranojë vetëm ato oferta, të cilat janë të përbalueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe në përputhje me nevojat e institucionit, Titullari i AK të marrë masa që të forcojë kontrollin dhe të kushtojë vëmendjen e duhur institucionale:

-procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit,

-procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik, dhe

-ofertave të ofertuesve, të marra nga komisionet e vlerësimit të ofertave;

pasi në rastet e konstatuara në gjetjet sa më sipër konstatuam se, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe vlerësimi i ofertave nuk është korrekt dhe ligjor.

Në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

2. **Rekomandimi 6.1:** Drejtori i përgjithshëm të marrë masa për ngritjen e një grupi pune:

- për të analizuar situatën, me qëllim vlerësimin nëse si pasojë e mos kërimit të furnizimit më tej me këto barna konkrete, është cenuar ose jo shëndeti e pacientëve. Nëse po, të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren masa ndaj personave; si dhe

- për të analizuar nëse planifikimi i nevojës për barna ka qenë i mbështetur mbi nevoja reale duke mbajtur gjithmonë në konsideratë pasojat që do të sillte mbi furnizim në magazinë përtej nevojës reale të QSUNT, i cili do të jepte efektin e kundërt, që lidhet me riskun e skadencës së medikamenteve. Në rast se nuk konstatohen pasojat me dëm në shëndetin e pacientëve, të vlerësohet riskedulimi i afateve të furnizimit nga OE, për t’ju përshtatur nevojës së spitalit, duke

mbajtur në konsideratë mirë-menaxhimin e medikamenteve dhe si pasojë edhe të fondeve që lidhen me to.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon

Statusi : *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi*

3. **Rekomandimi 6.2:** Në vijim, strukturat përgjegjëse për buxhetin në QSUNT/MSHMS të marrin masa për kryerjen me seriozitet të një procesi të plotë dhe të saktë planifikimi por edhe monitorimi, mbështetur mbi nevoja reale dhe të mirë argumentuara për medikamente.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon

Statusi : *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

4. **Rekomandimi 7.1:** MSHMS, në cilësinë e organit qendror blerës, të mos delegojë më procedurat e prokurimit, përveç rasteve që parashikohen në VKM, kur autoriteti, të cilit i delegohet kryerja e procedurës, argumentohet të ketë kapacitete mbi organin qendror blerës në fushën e objektit të prokurimit.

Në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon

Statusi : *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

5. **Rekomandimi 8.1:** Drejtori i QSUNT të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi pune për të kryer matje të sakta dhe përlllogaritje të dokumentuar të sasisë së zërave, ku të përcaktohen qartë sipërfaqet mbi të cilat do të kryhet shërbimi, duke argumentuar në këtë mënyrë sasinë e secilit prej zërave.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit

Me Urdhër të Titullarit të QSUNT Nr. 902/1 prot, datë 18.04.2023 është urdhëruar ngritja e strukturës së posaçme për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në përgjegjësi administrimi në MSHMS për QSUNT, në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie.

Urdhri i titullarit nuk ka gjetur ende zbatim nga strukturat përkatëse në QSUNT, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi : *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

6. **Rekomandimi 15.1:** Nga QSUNT të ngrihet një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe gjenplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe mbi këtë bazë të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore dhe të aplikohet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të institucionit.

Menjëherë e në vijimësi

Komenti grupit të auditimit.

Në vijimësi të zbatimit të rekomandimeve, pas dërgimit të shkresës Nr. 893/35, datë 09.01.2023 mbi zbatimin e rekomandimeve, titullari i institucionit, ka nxjerre Urdhër Nr. 211, datë 18.04.2023 “Për ngritjen e strukturës së posaçme për inventarizimin, plotësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në përgjegjësi administrimi të MSHMS për QSUNT, në

regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie”. Nëpërmjet këtij Urdhri, titullari ka urdhëruar ngritjen e një strukture të posaçme lidhur regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie.

Grupi i posaçëm deri 31.05.2023 nuk ka raport/ relacion mbi zbatimin e këtij Urdhri, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi

7. **Rekomandimi 15.2:** Nga QSUNT të merren masa për përlllogaritjen e vlerave nga ekspertët e fushës, dhe më pas Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të ndërmarr veprimet e nevojshme të regjistrimit të pasurisë në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Menjëherë e në vijimësi

Koment i grupit të auditimit.

Statusi i këtej rekomandimi varet nga zbatimi i plote i rekomandimit 15.1, për të cilin titullari ka lëshuar Urdhër Nr. 211, datë 18.04.2023. Grupi i posaçëm i ngritur me Urdhër të titullarit deri në këtë moment të auditimit nuk ka hartuar raport/relacion mbi zbatimin e këtej Urdhri, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi : Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

8. **Rekomandimi 16.2:** Organet Drejtuese të QSUNT duhet të sigurojnë inicimin e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha të drejtat me palët e treta të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin dhe likuidimin e tyre, si dhe të propozojë masa konkrete, duke mos e përjashtuar masat administrative dhe të tjera nëse është e nevojshme.

Në vijimësi

Koment i grupit të auditimit.

QSUNT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon

Statusi : Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

9. **Rekomandimi 16.5:** Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të marrë masa për krijimin e provizioneve për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme, pasi të jenë evidentuar të dhënat për klientët, si shumën e detyrimit, vjetërsinë e tyre (datën e lidhjes së kontratës) dhe situatën aktuale të tyre, si dhe pasi të jenë kaluar më parë të gjitha rrugët e mundshme ligjore për mbledhjen e tyre, duke prekur llogarinë 49 “Shuma të parashikuara për zhvlerësim”.

Në vijimësi

Koment i grupit të auditimit.

QSUNT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon

Statusi : Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

10. **Rekomandimi 17.3:** QSUNT të rakordojë me DAP dhe të fillojë hedhja e të dhënave në Sistemin Informatikë të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS).

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit.

Nga QSUNT nuk u paraqit dokumentacion vërtetues mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimit, pra statusi i zbatimit të rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

11. **Rekomandimi 17.5:** QSUNT të marrë të gjitha masat e nevojshme për të automatizuar mënyrën e përlllogaritjes të pagave, duke përfshirë të gjithë elementët e pagës bazë, me qëllim që të lehtësohet procesi i hartimit të pagës, kontrollet e brendshme dhe të jashtme, si dhe të minimizohet risku operacional.

Në vijimësi

Koment i grupit të auditimit.

Nga QSUNT nuk u paraqit dokumentacion vërtetues mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimit, pra statusi i zbatimit të rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

12. **Rekomandimi 19.1:** NA në QSUNT të marrë të gjitha masat e duhura me qëllim përmirësimin e praktikës së ndjekur për dorëzimin e detyrës nga punonjësit që ndërpresin marrëdhëniet e punës me institucionin me qëllim vendosjen e një afati kohor të përcaktuara për kryerjen e dorëzimit të aktiveve që këta punonjës kanë në ngarkim.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit.

Nga auditimi rezultoi se ka ndryshuar Formulari i Përfundimit të Punësimit, dhe ai përdoret në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punësimit me punonjës të QSUN. Por institucioni ende nuk ka marrë masa të tjera lidhur me detyrimet e prapambetura të vlerës së inventarit ekonomik 8,246,904 lekë në ngarkim të z.A.K., pra statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

13. **Rekomandimi 20.1:** QSUNT në bashkëpunim me FSDKSSH dhe MFE të rishqyrtojnë detajimin e buxhetit në kode të projekteve (paketave shëndetësore) në mënyrë që të mundësohet raportimi i saktë i këtyre shpenzimeve nga ana e QSUNT në kushtet kur aktualisht mënyra e detajimit e bën të pamundur kryerjen e këtyre përlllogaritjeve dhe rezulton në një raportim jo real të Performancës së shpenzimeve në kufirin e planit të çelur.

Në vijimësi

Koment i grupit të auditimit.

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

14. **Rekomandimi 20.2:** QSUNT në bashkëpunim me MSHMS të shqyrtojnë mundësinë për ndërmarrjen e iniciativave konkrete për implementimin e një sistemi të integruar për menaxhimin spitalor, me qëllim optimizimin e sistemeve ekzistuese në mënyrë që të monitorohen dhe raportohen efektivisht shpenzimet në rang spitalor.

Në vijimësi

Koment i grupit të auditimit.

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

15. **Rekomandimi 25.1:** QSUNT të marrë masa të menjëhershme për të pasur një rol më aktiv në drejtim të menaxhimit dhe administrimit të sipërfaqeve që institucioni është përgjegjës, me qëllim respektimin e kushteve të kontratave të lidhura, si dhe shmangien plotësisht të situatave të përdorimit të këtyre hapësirave, në kundërshtim me ligjin.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit.

QSUNT nuk paraqiti dokumentacion mbi masat e marra prej saj për të lidhur një kontratë qiraje ose për të zgjidhur problematikën mbi pronësinë për ambientin e quajtur Bodrumi pranë Spitalit të Kirurgjisë së Përgjithshme, në të cilin ushtrohet aktiviteti privat bar- kafe.

Kjo problematike është trajtuar në disa auditimi nga KLSH dhe në vazhdimësi nuk ka gjetur zgjidhje nga QSUNT.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

16. **Rekomandimi 26.1:**Drejtori i përgjithshëm i QSUNT, në bashkëpunim me Bordin Drejtues të institucionit, të marrë masat për trajtimin e menjëhershëm të problematikave nga auditimi i KLSH, për të përmbushur detyrimet në kuadër të forcimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Në vijim të gjetjeve të konstatuara, të shqyrtohen mundësitë për hartimin e akteve të brendshme administrative të nevojshme; politikave për miratimin dhe monitorimin e objektivave për monitorimin e njësisë dhe unifikimin e sistemeve të integruara menaxhimit spitalor; si dhe propozimin pranë Bordit Drejtues apo MSHMS të këtyre iniciativave konkrete për përmirësimin e situatës, sipas çështjeve të ngritura më sipër.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit.

Nga QSUNT nuk u paraqit dokumentacion mbi:

1. Rregullorja e Brendshme e QSUNT ka pësuar ndryshime të miratuara Nga Bordi Drejtues me Vendim Nr. 2 datë 02.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren bazë të funksionimit të QSUNT ”, duke miratuar detyrat funksionale për pozicionet e punës që nuk përfshiheshin në Rregulloren e Funksionimit të QSUNT (bazë) miratuar më vendim Bordi Nr.7, datë 21.09.2015. Ndryshimet e rregullores kanë reflektuar ndryshime mbi misionin dhe vizionin e QSUNT dhe fushat e aktivitetit si dhe pozicionet e ndryshuara të vendeve të punës (të reja) si p.sh. specialist (koordinator, operator), infermier (logopedit), specialist/dietolog klinik, etj., , duke përcaktuar detyrat funksionale sipas pozicioneve të vendeve të punës., zbatim i cili konsiderohet i zbatuar.
2. QSUNT ka hartuar Strategjinë e Menaxhimit të Risqeve.
3. QSUNT bazuar në Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, ka krijuar regjistri i risqeve, hartat e proceseve të punës sipas manualit të MFK,
4. Lidhur me menaxhimin e barnave, konstatohet mungesa e një rregulloreje për menaxhimin.
5. Në QSUNT konstatohet mungesa e një sistemi të integruar për menaxhimin spitalor, me qëllim optimizimin e sistemeve ekzistuese të Alpha, SISP, dhe atij të pagave (Excel), në rang institucional në mënyrë që të bëhet ndjekja e shpenzimeve, duke filluar nga planifikimi i buxhetit, ekzekutimi i tij dhe kontabilizimi i shpenzimeve. Si rezultat, këto procese zhvillohen në mënyrë të pavarur duke mos garantuar monitorim të plotë në rang sistemi të proceseve të ndryshme të punës.
6. Bordi Drejtues i QSUNT për vitin 2021 nuk ka realizuar asnjë mbledhje bordi dhe vitin 2022 ka realizuar 5 mbledhje për të cilat ka vendimmarrje duke miratuar çështjet e propozuara nga QSUNT, sipas Proces Verbalin të mbajtur për këtë qëllim.

Për shkak të mos përditësimit (update) të programit “Alfa” ose mos mundësimin të përdorimit të programit HRMIS ose implementimit të sistemit Alfa lidhur përlogaritjen e pagave, zbatimi i rekomandimit nuk ndryshon status deri në zbatimin e plotë të tij.

Statusi: Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.Rekomandimi 1.1: Nga Drejtori i përgjithshëm i QSUNT, të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 200,000 lekë, nga personat e ngarkuar me përgjegjësi, për mos verifikimin e datës së skadencës në furnizimin e artikullit “Pacemaker SESR01”, skadencia e të cilit, sipas akt kolaudimit, rezultoi të mos jetë në përputhje me kushtet e kontratës.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit.

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

2. Rekomandimi 2.1: Nga Drejtori i përgjithshëm i QSUNT, të kërkohet në mënyrë ligjore, arkëtimi i vlerës 319,466.70 lekë, nga përgjegjësit për dorëzimin e vonuar të barnave në kundërshtim me kontratën e nënshkruar.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit.

QSUNT nuk ka marrë masa për arkëtim të vlerës 319,466.70 lekë si të ardhura të munguara për shkak shkeljes së parashikimeve kontraktuale dhe lëvrim të mallit në shkelje të afateve të parashikimeve në kontratën Nr.2, Nr. 4181/4, datë 26.12.2019, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

3.Rekomandimi 3.1: Nga Drejtori i përgjithshëm i QSUNT, të kërkohet në mënyrë ligjore, arkëtimi i vlerës 444,565.80 lekë, nga përgjegjësit për dorëzimin e vonuar të barnave në kundërshtim me kontratën e nënshkruar

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit.

QSUNT me shkresën Nr.566/9 prot, datë 23.03.2022 ka sqaruar OE E. mbi zbatimin e kontratës Nr. 3335/5, datë 16.11.2020, lidhur më afatet e zbatimit të kontratës, dhe bazuar në Akt Kolaudimi datë 14.05.2021 ka konstatuar se sasia 722500UI është sjelle 60 ditë me vonesë me vlerë 4,445,658 lekë (*KLSH llogarit dëm për 6 ditë = 444,565 lekë*).

QSUNT në Urdhër Shpenzim Nr. 2967, datë 23.12.202, në shumën e kërkuar për arkëtim sipas faturës tatimore Nr.184/2021 datë 14.05.2021 në shumën 17.296.650 lekë kërkuar për arkëtim ka zbritur penalitetin e llogarit 4,445,658 lekë duke paguar diferencën 12.850.992.

Operatori ekonomik ka kundërshtuar veprimet e QSUNT duke ngritur kërkesë padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë Nr. 4126, datë 19.09.2022, protokolluar në QSUNT me Nr. 2431 prot, date 06.10.2022, e cila është në proces gjyqësor në këtë gjykatë.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Rekomandimi 2.1.: Drejtori i përgjithshëm i QSUNT, ose (i) të marrë masa për hartimin e një rregulloreje ku të identifikohen qartë procedurat për qarkullimin e oksigjenit nga furnizuesi deri të përdoruesit përfundimtar (pacientët), sikundër kërkohet në Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, pika 41; ose (ii) të marrë masa që oksigjeni mjekësor i furnizuar, si bar mjekësor, të kalojë nëpërmjet magazinës (Farmacisë Qendrore) të QSUT, në të njëjtën mënyrë si trajtohen të gjithë barnat e tjerë.

Brenda datës 31.06.2022

Koment i grupit të auditimit.

Titullari me Urdhër Nr.426, datë 07.07.2022 për menaxhimin më të mirë të sasive të oksigjenit të lëngshëm për përdorim spitalor, ka urdhëruar përdorimin e tij sipas përcaktimeve në këtë urdhër. Drejtoria e shërbimeve mbështetëse ka hartuar “rregulloren mbi qarkullimin e oksigjenit mjekësor të lëngshëm” për të vilën me shkresë përcjellëse Nr. 1462/2 prot, datë 08.07.2022 ka

informuar titullarin me relacion mbi hartimin e rregullores, sipas Urdhrit Nr. 133 datë 23.05.2022.

Titullari me Urdhër Nr. 300, datë 10.03.2022, ka miratuar “rregulloren e qarkullimit të oksigjenit, mjekësor në QSUNT, e cila ju është shpërndare PAI-ve për zbatim

Rregullorja e qarkullimit të oksigjenit mjekësor, nuk ka kaluar për miratim në Bordin e QSUNT, sipas të Statutit të QSUNT Nr.709/2018.

Deri në miratimin e Rregullores nga Bordi i QSUNT, rekomandimi nuk ndryshon status.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

2.Rekomandimi 4.3: QSUNT dhe MSHMS të marrin masat që për të gjitha rastet në vijim të lidhjes së marrëveshjeve kuadër që do të nënshkruhen për blerje barnash apo materialesh mjekësore, të përfshihen në DST detyrimi i subjektit të kontraktuar për tërheqjen dhe zëvendësimin e tyre me barna të një skadence të mëvonshme, duke përcaktuar saktësisht:

- afatet kur duhet të kryhet njoftimi nga QSUNT kundrejt OE-ve për zëvendësimin e tyre, dhe

- kushtet që duhet të plotësojnë palët për tërheqjen e skadencave (duke u analizuar situatat rast pas rasti nëse përgjegjësia për mallrat e skaduara mbi marzhin e parashikuar, ka ardhur si pasojë e keq planifikimit, apo rasteve të jashtëzakonshme/të shkëputura).

Në vijimësi

Koment i grupit të auditimit.

QSUNT nëpërmjet shkresës Nr.262/4, datë 01.03.2022 dërguar MSHMS, kërkon informacion mbi hapat e ndërmarra prej, lidhur me zbatimin e rekomandimit të KLSH, për të cilën nuk ka kthim përgjigje.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

3. Rekomandimi 6.2: Me qëllim shmangien e abuzimeve, por edhe përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, për të gjitha rastet në vijim, QSUNT të marrë masa të kryejë peshimin e saktë të mbetjeve që në burim, duke dokumentuar sasinë e mbetjeve të gjeneruara sa herë që bëhet një dorëzim. Dokumentimi i saktë i sasisë së mbetjeve të gjeneruara mund të bëhet vetëm në burim, pasi evitohet mundësia që, në peshimin e kryer në landfill, OE të depozitohet edhe mbetje që nuk janë gjeneruar në QSUNT.

Në vijimësi

Koment i grupit të auditimit.

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

Rekomandimi 7.1: Nga Drejtori i përgjithshëm i QSUNT, të merren masa për amendimin e kontratës së shërbimit Nr. 543/4, datë 27.01.2020, me objekt “Për ofrimin e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë për pacientet e hospitalizuar në pavijonet e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për 30.5 ditë/muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, me të drejtë rinovimi automatikisht çdo muaj deri në lidhjen e kontratës bazë”, me qëllim përcaktimin e specifikimeve teknike për materialin e butë të furnizuar sipas kësaj kontrate.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit.

ASHPP (ish ABP) me shkresën Nr. 1624/1 prot, datë 20.10.2022, protokolluar në QSUNT me Nr. 1083/3 prot, datë 21.10.2022 ka dërguar informacion mbi anulimin e procedurës së prokurimit REF- 30830-07-2018-2019 me objekt për shërbimin e lavanterisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në shërbimin spitalor. Kjo pasi Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me Vendim Nr. 23(86-2022-370) datë 26.07.2022, në datën 19.10.2022 është anuluar procedura e prokurimit sipas objektit të sipërcituar.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37, të ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, nenin 19 të Kontratës Kolektive të Punës Nr. 1528/1 prot., datë 30.03.2021, si dhe në nenin 12 të Kontratave Individuale, i rekomandojmë Ministrin të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të ngrejë një grup për të vlerësuar shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të ushtruar në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, në varësi të analizës së përgjegjësive, si dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore nga “Tërheqje vëmendje n je me shkrim” deri të “Zgjidhje e marrëdhënies së punës”, për personat që gjenden me përgjegjësi në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, e konkretisht:

a. Për shkeljet e konstatuara gjatë zbatimit të Kontratës së Furnizimit Nr. 1334/5, datë 04.04.2019.

1. Y.K.

Koment i grupit të auditimit.

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

2. S.G.

Urdhër Nr. 507 prot, date 03.11.2021 në zbatim të gjetjeve dhe rekomandime nga KLSH, Titullarit të Institucionit lidhur me Seksion D dhe E për shkeljet e konstatuara në seksionin C .

Koment i grupit të auditimit.

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

3. F.K.

Urdhër Nr. 507 prot, date 03.11.2021 në zbatim të gjetjeve dhe rekomandime nga KLSH, Titullarit të Institucionit lidhur me Seksion D dhe E për shkeljet e konstatuara në seksionin C .

Koment i grupit të auditimit.

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

4. A.R.

Urdhër Nr. 507 prot, date 03.11.2021 në zbatim të gjetjeve dhe rekomandime nga KLSH, Titullarit të Institucionit lidhur me Seksion D dhe E për shkeljet e konstatuara në seksionin C .

Koment i grupit të auditimit.

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

b. Për shkeljet e konstatuara gjatë zbatimit të Kontratës së Furnizimit Nr. 1, Nr. 471/11 prot., datë 18.02.2021.

5. Y.K.

Urdhër Nr. 507 prot, date 03.11.2021 në zbatim të gjetjeve dhe rekomandime nga KLSH, Titullarit të Institucionit lidhur me Seksion D dhe E për shkeljet e konstatuara në seksionin C .

Koment i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

6. E.Th.

Urdhër Nr. 507 prot, date 03.11.2021 në zbatim të gjetjeve dhe rekomandime nga KLSH, Titullarit të Institucionit lidhur me Seksion D dhe E për shkeljet e konstatuara në seksionin C .

Koment i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

7. F.K.

Urdhër Nr. 507 prot, date 03.11.2021 në zbatim të gjetjeve dhe rekomandime nga KLSH, Titullarit të Institucionit lidhur me Seksion D dhe E për shkeljet e konstatuara në seksionin C .

Koment i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

8. A.R.

Urdhër Nr. 507 prot, date 03.11.2021 në zbatim të gjetjeve dhe rekomandime nga KLSH, Titullarit të Institucionit lidhur me Seksion D dhe E për shkeljet e konstatuara në seksionin C .

Koment i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

ç. Për shkeljet e konstatuara gjatë vlerësimit të procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore në QSUT për vitin 2019”, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53, pika 3.

9. E.J.

Urdhër Nr. .507 prot, date 03.11.2021 në zbatim të gjetjeve dhe rekomandime nga KLSH, Titullarit të Institucionit lidhur me Seksion D dhe E për shkeljet e konstatuara në seksionin C .

Koment i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

10. E.B.

Urdhër Nr. 507 prot, date 03.11.2021 në zbatim të gjetjeve dhe rekomandime nga KLSH, Titullarit të Institucionit lidhur me Seksion D dhe E për shkeljet e konstatuara në seksionin C .

Koment i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

11. B.L.

Urdhër Nr. 507 prot, date 03.11.2021 në zbatim të gjetjeve dhe rekomandime nga KLSH, Titullarit të Institucionit lidhur me Seksion D dhe E për shkeljet e konstatuara në seksionin C .

Koment i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

e. Për shkeljet e konstatuara në hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim, gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Mobilimi i Depos Qendrore të Barnave në QSUT- Loti 1: Rafta dhe Mobilitet”, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46, pika 1 dhe neni 55, pika 1/b dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27.

12. E.N.

Urdhër Nr. 507 prot, date 03.11.2021 në zbatim të gjetjeve dhe rekomandime nga KLSH, Titullarit të Institucionit lidhur me Seksion D dhe E për shkeljet e konstatuara në seksionin C .

Koment i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

f. Për shkeljet e konstatuara në hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim, gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Furnizim me teste PCR dhe Tampon për 90 ditë”.

13. D.L.

Urdhër Nr. 507 prot, date 03.11.2021 në zbatim të gjetjeve dhe rekomandime nga KLSH, Titullarit të Institucionit lidhur me Seksion D dhe E për shkeljet e konstatuara në seksionin C .

Koment i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

14. M.A.,

Urdhër Nr. 507 prot, date 03.11.2021 në zbatim të gjetjeve dhe rekomandime nga KLSH, Titullarit të Institucionit lidhur me Seksion D dhe E për shkeljet e konstatuara në seksionin C .

Koment i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

h. Për shkeljet e konstatuara gjatë zbatimit të Kontratës së Furnizimit Nr. 2, Nr. 4181/4, datë 26.12.2019.

15. V.P.

Koment i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

16. J.S.

Koment i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

17. E.Q.

Koment i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

18. S.L.

Urdhër Nr. 507 prot, date 03.11.2021 në zbatim të gjetjeve dhe rekomandime nga KLSH, Titullarit të Institucionit lidhur me Seksion D dhe E për shkeljet e konstatuara në seksionin C .

Koment i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

i. Për shkeljet e konstatuara gjatë zbatimit të Kontratës së Furnizimit Nr. 3335/5, datë 16.11.2020.

19. E.D.

Koment i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

20. D.B.

Koment i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

21. J.S.

Koment i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

22. L.Sh.

Koment i grupit të auditimit

QSUT deri 31.05.2023 nuk paraqiti dokumentacion të ri për realizimit të plotë të rekomandimit, arsye për të cilën statusi i rekomandimit nuk ndryshon.

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.*

E. PËR AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK.

II. Për shkeljet e konstatuara gjatë vlerësimit të procedurës së prokurimit me objekt “Furnizim me oksigjen të lëngshëm mjekësor për nevojat e QSUNT”, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 63, pika 1 dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 58.

23. A.S.

24. E.P.

25. B.T.

26. R.G.

27. M.M.

28. E.S.

Në shkresën 110/10 prot, date 20/10/2021 KLSH nuk ka përfshirë rekomandimin e parashikuar në kërkesën tuaj Sektori ‘E’ për Agjencinë e Prokurimit Publik, por në kontekst të kërkesës tuaj

informojmë se APP ka dërguar Vendimin e saj Nr. 48 date 23/05/2022 mbi verifikimin e ligjshmërisë të procedurave të audituara, nga KLSH dërguar asaj me shkresën 110/11 prot 02/11/2021. QSUNT ka vlerësuar vendimin e APP Nr. 48 prot, date 23/05/2022 në baze të tij ka vendosur mase administrative gjore për punonjësit qe janë vlerësuar me shkelje administrative.

1. **A.S.** - APP në vendimin Nr.48, date 23/05/2022 nuk ka propozuar për marrje mase disiplinore dhe/ose penalitet.

Koment i grupit të auditimit

Nga APP nuk ka vendimmarrje nga APP, sipas shkresës se KLSH me Nr. 110/11 prot, date 02.11.2021.

DBNJ nuk u paraqit dokumentacion mbi vazhdimin e procedurës së shqyrtimit të shkeljes së konstatuar nga KLSH dërguar me shkresë Nr. 110/10, datë 20.10.202, administruar në QSUNT me Nr. 387/81 prot, datë 22.10.2021.

Pa veprim nga QSUNT

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe mbetet pa zbatuar*

2. **B.T.** - APP në vendimin Nr. 48, date 23/05/2022 nuk ka propozuar për marrje mase disiplinore dhe/ose penalitet.

Koment i grupit të auditimit

Nga APP nuk ka vendimmarrje nga APP, sipas shkresës se KLSH me Nr. 110/11 prot, date 02.11.2021.

DBNJ nuk u paraqit dokumentacion mbi vazhdimin e procedurës së shqyrtimit të shkeljes së konstatuar nga KLSH dërguar me shkresë Nr. 110/10, datë 20.10.202, administruar në QSUNT me Nr. 387/81 prot, datë 22.10.2021.

Pa veprim nga QSUNT

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe mbetet pa zbatuar*

3. **E.S.** - APP në vendimin Nr. 48.date 23/05/2022 nuk ka propozuar për marrje mase disiplinore dhe/ose penalitet.

Koment i grupit të auditimit

Nga APP nuk ka vendimmarrje nga APP, sipas shkresës se KLSH me Nr. 110/11 prot, date 02.11.2021.

DBNJ nuk u paraqit dokumentacion mbi vazhdimin e procedurës së shqyrtimit të shkeljes së konstatuar nga KLSH dërguar me shkresë Nr. 110/10, datë 20.10.202, administruar në QSUNT me Nr. 387/81 prot, datë 22.10.2021.

Pa veprim nga QSUNT

Statusi: *Rekomandimi është pranuar dhe mbetet pa zbatuar*

Titulli i Gjetjes Nr.1	Nuk janë zbatuar dhe realizuar në mënyrë të plotë rekomandimet e KLSH
Situata:	Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” nuk ka zbatuar dhe realizuar në mënyrë të plotë rekomandimet e KLSH, të lëna në auditimet e mëparshme. KLSH me shkresë Nr. 893/35 prot, datë 09.01.2023 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të mëparshme” ka lënë 70 rekomandime, përkatësisht 31 Masa Organizative, 3 Masa për shpërblim dëmi, 5 Masa për menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitet të Fondeve Buxhetore dhe 31 Masa Disiplinore. Nga verifikimi dokumentacionit u konstatua se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve rezultoi si më poshtë: a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 31 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 15

	<p>zbatuar, 16 në proces zbatimi.</p> <p>b) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 3 masë shpërblim dëmi nga ku rekomandimet janë pranuar plotësisht dhe statusi ecurisë së zbatimit rezulton 3 në proces zbatimi.</p> <p>c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 5 Masa për menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitet të Fondeve Buxhetore nga të cilat 1 Zbatuar, 4 në proces zbatimi.</p> <p>d) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 31 Masë Disiplinore nga ku: 24 rekomandime janë drejtpërdrejt për QSUNT nga të cilat 2 zbatuar dhe 22 në proces zbatimi dhe 7 rekomandime rekomanduara për APP të kanë statusin e ecurisë së zbatimit pa zbatuar.</p>
Kriteri:	<p>Ligji Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH Nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH”.</p> <p>Manuali “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistri elektronik institucional”, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH Nr.67 datë 23.06.2020.</p>
Ndikimi/Efekti:	Risk menaxherial.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” të merren masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilat nga ky auditim rezultuan të pazbatuara dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi.

2.10. Kryerja e shërbimit për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar) me barna të rimbursueshme nga shteti, për sëmundje tumorale dializë dhe transplant.

Për periudhën: 01.04.2021 deri më 31.12.2021, vlera e konsumit për rimbursim nga raportimi e-Rx është në vlerën 2,192,737,755.59 lekë, është likuiduar në vlerën 2,185,648,091 lekë.

Për periudhën: 01.01.2022 deri më 31.12.2022, vlera e konsumit për rimbursim nga raportimi e-Rx është 3,280,487,262.14 lekë, është likuiduar në vlerën 3,280,404,118 lekë.

Në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, për shërbimin e pacientëve të shtruar në spital dhe atyre ambulatorë është e organizuar dhe funksionon Drejtoria e Shërbimit Farmaceutik e përbërë nga 5 sektor, njëri prej të cilëve është sektori i rimbursimit të barnave spitalor, e cila organikusht dhe fizikusht është pjesë e organikës të QSUNT me godinë (farmaci), personel, pagesë personeli, drita, ujë etj..

Për kryerjen e shërbimit për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar) janë lidhur kontrata (aktmarrëveshje) tre palëshe: Fond i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza"(QSUNT) dhe Importuesve Farmaceutik, si dhe Marrëveshje (kontrata) dy palëshe për reduktimin e çmimit të barnave të LBR që tregtohen në farmacitë e spitaleve nga mbajtësi i autorizimit për tregtim, të lidhura ndërmjet FSDKSH dhe Importuesve farmaceutik.

Kërkesa për barna sipas listës së rimbursimit, dhe aneksit të çmimeve konfidenciale, i bëhet importuesve farmaceutik nga QSUNT dhe jo nga FDKSH.

Pacientë ambulatorë (jo të hospitalizuar) paraqiten për të marrë shërbimin në QSUNT, sipas sistemit të referimit. Mbi bazën e këtij sistemi sipas sëmundjeve përkatëse, mjekët e QSUNT të kontraktuar nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lëshojnë receta rimbursimi elektronike e-Rx, receta të cilat pasi kontrollohen nga Drejtoria e Administrimit të Paketave Shëndetësore dhe Ekzaminimet Terciale (Drejtori e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, e instaluar në QSUNT), konfirmohen dhe i kalojnë farmacisë për ekzekutim, dhënien e medikamenteve dhe pajisjeve mjekësore pacientëve për ekzekutim.

Farmacia me paraqitjen e pacientit me recetë të lëshuar nga mjeku dhe e konfirmuar nga Drejtoria e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, e instaluar në QSUNT, bënë ekzekutimin e recetës, duke i dhënë pacientit barin ose pajisjen mjekësore, por pa lënë **asnjë gjurmë auditimi, pra nuk vërtetohet që bari ose pajisja është marrë nga pacienti, edhe pse këto barna dhe pajisje kanë çmim shumë të shtrenjtë.**

Kjo farmaci furnizohet nga importuesit, me faturë tatimore shitje (elektronike) sipas sistemit të fiskalizimit me NIPT të QSUNT dhe jo me NIPT të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, fatura të cilat nuk bëhen hyrje në kontabilitetin e QSUNT, nuk bëhen hyrje dhe në kontabilitetin e FSDKSH, por bën hyrje në programin kompjuterik E-RX në postin që mundësohet nga farmacistët e QSUNT, pra në kontabilitet nuk regjistrohet ngjarja ekonomike.

Barnat e furnizuara nga importuesit farmaceutik, nuk merren në dorëzim nga një grupi i ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, ose nga zyrtari i deleguar prej tij, siç bëhet dhe në farmacinë spitalore, por merren në dorëzim nga vet punonjësit e farmacisë të sektorit të rimbursimit të barnave spitalor, edhe pse barnat dhe pajisjet mjekësore janë me çmime të larta.

Në 31 kontratat trepalëshe të lidhura ndërmjet QSUNT, FSDKSH dhe importuesve farmaceutik “Për rimbursimin e barnave të tregtuara në farmacinë e QSUNT dhe në Marrëveshjet (kontratat) dy palëshe për reduktimin e çmimit të barnave të LBR që tregtohen në farmacitë e spitaleve nga mbajtësi i autorizimit për tregtim, të lidhura ndërmjet FSDKSH dhe Importuesve Farmaceutik, nuk është përcaktuar:

-Afati i skadencës: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.

-Paketimi: Mbi çdo paketim duhet të jetë shënuar barnat duhet detyrimisht të jenë të vulosura edhe me vulën me mbishkrimin “PËRDORIM SPITALOR - NDALOHET SHITJA”.

Përcaktime që janë vendosur në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe procedurat e zhvilluar nga QSUNT, duke aplikuar standart të dyfishtë edhe pse barnat janë me çmim shumë të shtrenjtë.

Farmacia e QSUNT/Spitali, shkarkimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore e bën mbi bazën e recetës të lëshuar nga mjeku, receta të cilat konfirmohet nga Drejtoria e Administrimit të Paketave Shëndetësore dhe Ekzaminimet Terciale (Drejtori e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, e instaluar në QSUNT) duke bërë dhe rakordimet me FDKSH. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor likuidon importuesit farmaceutik. Pra likuidimet e importuesve kryhen FDKSH dhe jo nga QSUNT, e cila gjeneron shërbimin; vizitë pacienti, lëshim recete, personel farmaceutik, edhe pse faturat importuesit farmaceutik, i lëshojnë për QSUNT.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 8/1, Ligjin Nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 6, 7

dhe 8, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35/a,b,c.

Bordi i Spitalit edhe pse zv/ Drejtori i përgjithshëm S.Xh. me shkresën Nr. 755/9 prot., datë 23.11.2021 jo vetëm ka vënë në dijeni për problematikën në lidhje kryerjen e shërbimit për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar) për barnat që rimburohen nga shteti, por dhe ka bërë propozimin konkret për zgjidhjen e kësaj problematike, nga Bordi nuk ka marr asnjë përgjigje.

Për shkeljen e dispozitave ligjore të përmendur si më sipër ngarkohen me përgjegjësi E.D. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar për periudhën 01.04.2021 deri më 20.02.2022, I.K.me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar për periudhën 21.02.2022 deri më 11.11.2022.

Janë lidhur 5 marrëveshje (kontratat) dy palëshe për reduktimin e çmimit të barnave të LBR që tregtohen në farmacitë e spitaleve nga mbajtësi i autorizimit për tregtim, të lidhura ndërmjet FSDKSH dhe importuesve farmaceutik.

Janë lidhur 31 Marrëveshje (kontratat) ndërmjet FSDKSH e përfaqësuar nga A.Ç. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe importueve farmaceutik.

Përzgjedhja me shoqëritë tregtare është bërë nga Komisioni Teknik i Listës së Barnave të Rimbursuar, me relacion me Nr. 3731 prot, datë 14.07.2021 i cilësuar “Draft LBR 2021”, komision i përbërë nga M.R. kryetare komisioni zv/ Ministre e Ministrisë së Shëndetësisë, M.T. anëtar, QSUNT, Dh.T. anëtarë, QSUNT, L.Sh. anëtarë, FSDKSH, A.S. anëtarë FSDKSH, A.S. anëtarë QSUNT, J.B. anëtarë, AKBPN, B.H. anëtar FSDKSH dhe F.R anëtarë, FSDKSH. Relacion përcakton DRAFT LBR 2021. Relacioni është marr referuar vendimit të këtij komisioni Nr.1, datë 14.07.2021.

Komisioni është emëruar me vendim Nr. 2, datë 19.01.2021 të Këshillit Administrativ i FSDKSH e firmosur nga kryetarja e Këshillit Administrativ O.M.

Konkretisht

-Marrëveshja dypalëshe Nr. 4613 prot, datë 30.08.2021 lidhur ndërmjet FSDKSH të përfaqësuar nga A.Ç. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe Kompanisë A. D. në cilësinë e mbajtësit të autorizimit për tregtim përfaqësuar nga M. SHPK.

-Marrëveshja dypalëshe Nr. 4584 prot, datë 27.08.2021 lidhur ndërmjet FSDKSH të përfaqësuar nga A.Ç. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe Kompanisë F.H.-L. R. LTD në cilësinë e mbajtësit të autorizimit për tregtim përfaqësuar nga R.Ph. (S.) Zvicër SHPK.

-Marrëveshja dypalëshe Nr. 4531 prot, datë 23.08.2021 lidhur ndërmjet FSDKSH të përfaqësuar nga A.Ç. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe Kompanisë N.I.S.V. A.S në cilësinë e mbajtësit të autorizimit për tregtim përfaqësuar nga R.P.(S.) Zvicër SHPK.

-Marrëveshja dypalëshe Nr. 4610 prot, datë 30.08.2021 lidhur ndërmjet FSDKSH të përfaqësuar nga A.Ç. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe Kompanisë M.Sh. & D. në cilësinë e mbajtësit të autorizimit për tregtim përfaqësuar nga M. SHPK.

-Marrëveshja dypalëshe Nr. 4532 prot, datë 23.08.2021 lidhur ndërmjet FSDKSH të përfaqësuar nga A.Ç. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe Kompanisë D.S. në cilësinë e mbajtësit të autorizimit për tregtim përfaqësuar nga L. SHPK.

Barna të pa furnizuara në kohë për pacientët, duke shkelur protokollet e mjekimit me pasojë vënie në rrezik të shëndetit e tyre, pasi janë barna të sëmundjeve tumorale dializë dhe transplant.

Auditim me zgjedhje²⁵

Grupi i auditimit përzgjedhi 11 barna.

Me e-mailin e datës 04.02.2022 farmacistja e barnave të rimbursuar, njofton QSUNT dhe QSUNT ka njoftuar FSDKSH, se importuesi M., nuk furnizon farmacinë me barin me kod 710/96 “Palbociclib 125 mg”. Në e-mail, është shprehur në ligjëratë të drejtë: “Theksojmë faktin se QSUNT, *ka një numër pacientësh në pritje të barit të lartpërmendur, i cili është i domosdoshëm për ecurinë e shëndetit të tyre.*”

Ky bar është furnizuar nga importuesi M., më datë 22.02.2022, me Nr. faturë 10429, datë 22.02.2022 me emrin tregtar “Ibrance 125 mg-CAPS) në sasinë 735 CAPS, me vlerë 13,252,844 lekë **me 18 ditë me vonesë**, është bërë dalje nga data 22.02.2022-28.02.2022, me sasinë 588 CAPS, me diferencë të mbetur 147 CAPS (735 hyrje – 588 dalje = 147).

Me e-mailin e datës 26.01.2022 farmacistja e barnave të rimbursuar, njofton QSUNT dhe QSUNT ka njoftuar FSDKSH se importuesi M., nuk furnizon farmacinë me barin me kod 631/335 “Infliximab 100 mg”. Në e-mail, është shprehur në ligjëratë të drejtë: “Theksojmë faktin se QSUNT, *ka një numër pacientësh në pritje të barit të lartpërmendur, i cili është i domosdoshëm për ecurinë e shëndetit të tyre.*”

Ky bar është furnizuar nga importuesi M., më datë 22.02.2022, me faturë Nr. 10429, datë 22.02.2022 me emrin tregtar “INFLECTRA100 mg” në sasinë 50 pluhur për injeksion, me vlerë 1,381,450 lekë **me 27 ditë me vonesë**, është bërë dalje nga data 22.02.2022-22.02.2022, me sasinë 43 pluhur për injeksion, me diferencë të mbetur 7 pluhur për injeksion (50 hyrje – 43 dalje = 7).

Me e-mailin e datës 25.01.2022 farmacistja e barnave të rimbursuar, njofton QSUNT dhe QSUNT ka njoftuar FSDKSH se importuesi D.-A., nuk furnizon farmacinë me barin me kod 662/237 “Erelzi 25 mg” alternativ (Entanercept 25 mg). Në e-mail, është shprehur në ligjëratë të drejtë “Theksojmë faktin se QSUNT, *ka një numër pacientësh pediatrik në pritje të barit të lartpërmendur, i cili është i domosdoshëm për ecurinë e shëndetit të tyre.* Gjendje bari më datën 25.01.2022 është 1 copë.

Ky bar është furnizuar nga importuesi D.-A. , më datë 08.02.2022, me faturë Nr.12104, datë 08.02.2022 me emrin tregtar “Erelzi 25 mg” në sasinë 48 SOL-FOR INJ-PRE_FILLED, me vlerë 388,808 lekë **me 14 ditë me vonesë**, është bërë dalje në datë 08.02 22, me sasinë 16 pre-filled, me diferencë të mbetur 32 (48 hyrje –16 dalje = 32).

Me e-mailin e datës 19.10.2022 farmacistja e barnave të rimbursuar, njofton QSUNT dhe QSUNT ka njoftuar FSDKSH, se importuesi M., nuk furnizon farmacinë me barin me kod 487/325 “Imatinib Accord 100 mg” alternativ (Imatinib 100 mg). Në e-mail, është shprehur në ligjëratë të drejtë: “Theksojmë faktin se QSUNT, *ka një numër pacientësh në pritje të barit të lartpërmendur, i cili është i domosdoshëm për ecurinë e shëndetit të tyre.*” Gjendje bari më datën 19.10.2022 është 90 copë.

Ky bar është furnizuar nga importuesi I., më datë 22.11.2022, me faturë Nr.7083, datë 22.11.2022 me me alternativ “IMATIS 100 mg” në sasinë 15, 000 FC, TABL, me vlerë 561,750 lekë **me 30 ditë me vonesë**, është bërë dalje në datë 23.11.22-30.11.2022, me sasinë 9690, me diferencë të

²⁵ *Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit”, i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.*

Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: “Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampinonët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur” .

mbetur 5400 (gjendje 90 + 15,000 hyrje = 15090 – 9690 =5400). Vo: Zakonisht në një recetë pacienti me 120 FC,TABL, pra gjendja nuk është asnjë për një recetë.

Me e-mailin e datës 10.02.2022 farmacistja e barnave të rimbursuar, njofton QSUNT dhe QSUNT ka njoftuar FSDKSH, se importuesi Deltapharma dhe Reis Farma, nuk furnizon farmacinë me barin me kod 732/92 “Ribociclib 200 mg” alternativ (Kisqali alternativë e parë). Në e-mail, është shprehur në ligjëratë të drejtë “Theksojmë faktin se QSUNT, *ka një numër pacientësh në pritje të barit të lartpërmendur, i cili është i domosdoshëm për ecurinë e shëndetit të tyre.* Gjendje bari më datën 10.02.2022 është 42 copë.

Ky bar është furnizuar nga importuesi R.F., më datë 23.02.2022, me faturë Nr.10494, datë 23.02.2022 me alternativ të parë “Kisqali 200 mg” në sasinë 945 FC,TABL, me vlerë 4804.51 lekë/njësi lekë **me 12 ditë me vonesë.**

Ky bar është furnizuar nga importuesi D.F., më datë 24.02.2022, me faturë Nr.18553, datë 24.02.2022 me alternativ të parë “Kisqali 200 mg” në sasinë 945 FC,TABL, me vlerë 4804.51 lekë/njësi lekë **me 12 ditë me vonesë.**

Është bërë dalje në datë 24.02.22-28.02.2022, me sasinë 1449, me diferencë të mbetur 483 (gjendje 42 + 945+945 hyrje = 1932- 1449 = 483) .

Vo: Zakonisht në një recetë pacienti me 63 FC,TABL, pra gjendja nuk është asnjë për një recetë. Me e-mailin e datës 16.12.2021 farmacistja e barnave të rimbursuar, njofton QSUNT dhe QSUNT ka njoftuar FSDKSH, se importuesi I. nuk furnizon farmacinë me barin me kod 682/14 “Sorafenib 200 mg”. Në e-mail, është shprehur në ligjëratë të drejtë: “Theksojmë faktin se QSUNT, *ka një numër pacientësh në pritje të barit të lartpërmendur, i cili është i domosdoshëm për ecurinë e shëndetit të tyre.*” Gjendje bari më datën 16.12.2021 është 80 copë.

Ky bar është furnizuar nga importuesi I., më datë 29.12.2022, me faturë Nr.14455, datë 29.12.2021 në sasinë 1456 FC,TABL, me vlerë 369,77 lekë/njësi **me 12 ditë me vonesë,** është bërë dalje në datë 29.12 2021, me sasinë 1440, me diferencë të mbetur 90 (gjendje 80 + 1456 hyrje = 1530 – 1440 dalje =90). Vo: Zakonisht në një recetë pacienti me 120 FC,TABL, pra gjendja nuk është asnjë për një recetë.

Me e-mailin e datës 17.02.2022 farmacistja e barnave të rimbursuar, njofton QSUNT dhe QSUNT ka njoftuar FSDKSH, se importuesi M., nuk furnizon farmacinë me barin me kod 776/191 “Enzalutamide 40 mg alternativa e parë”. Në e-mail, është shprehur në ligjëratë të drejtë: “Theksojmë faktin se QSUNT, *ka një numër pacientësh në pritje të barit të lartpërmendur, i cili është i domosdoshëm për ecurinë e shëndetit të tyre.*” Gjendje bari më datën 17.02.2022 është 48 copë.

Ky bar është furnizuar nga importuesi M., më datë 18.03.2022, me Nr. faturë 15139, datë 18.03.2022 në sasinë 2240 CAPSULE, SOFT, me vlerë 2847.32 lekë/njësi **me 27 ditë me vonesë,** është bërë dalje në datë 18.03.2022-25.03.2022, me sasinë 1680, me diferencë të mbetur 608 (gjendje 48 + 2240 hyrje = 2288 – 1680 dalje =608). Vo: Zakonisht në një recetë pacienti me 120 FC,TABL, pra gjendja nuk është asnjë për një recetë.

Me e-mailin e datës 11.05.2021 farmacistja e barnave të rimbursuara, njofton QSUNT dhe QSUNT ka njoftuar FSDKSH, se importuesi M. nuk po furnizon farmacinë me barin me kod 453/191 “Tacrolimus 1mg”. Në e-mail është shprehur në ligjëratë të drejtë “Theksojmë faktin se QSUNT, *ka një numër pacientësh në pritje të barit të lartpërmendur, i cili është i domosdoshëm për ecurinë e shëndetit të tyre.*” Gjendje bari më datë 11.05.2021 është 20 caps, sasi e pamjaftueshme për një recetë.

Ky bar është furnizuar nga importuesi M., më datë 20.05.2021, me faturë Nr.401796051, dt. 20.05.2021, me emrin tregtar Prograf 1 mg (Caps), në sasinë prej 6000 Caps, me vlerë 113.5

lekë/njësi, me 9 ditë vonesë. Ky bar është bërë dalje nga data 20.05.2021- 21.05.2021, në sasinë prej 2400 caps me diferencë të mbetur 3620 Caps (20+6000 Hyrje – 2400 Dalje = 3620).

Me e-mailin e datës 14.05.2021 farmacistja e barnave të rimbursuara, njofton QSUNT dhe QSUNT ka njoftuar FSDKSH, se importuesi M. nuk po furnizon farmacinë me barin me kod 605/441 “Sevelamer Carbonate 800 mg”. Në e-mail është shprehur në ligjëratë të drejtë: “Theksojmë faktin se QSUNT, ka një numër pacientësh në pritje të barit të lartpërmendur, i cili është i domosdoshëm për ecurinë e shëndetit të tyre”. Gjendje bari më datë 14.05.2021 është 60 caps, sasi e pamjaftueshme për një recetë.

Ky bar është furnizuar nga importuesi M., më datë 09.06.2021, me faturë Nr.401800193, dt.09.06.2021, me emrin tregtar Perfose 800 mg (f.c.tabl), në sasinë prej 12600 tabl, me vlerë 37.75 lekë/njësi, me 26 ditë vonesë. Ky bar është bërë dalje nga data 09.06.2021- 10.06.2021, në sasinë prej 5850 caps me diferencë të mbetur 6810 Caps (gjendje 60+12600 Hyrje – 5850 Dalje = 6810).

Me e-mailin e datës 15.11.2021 farmacistja e barnave të rimbursuara, njofton QSUNT dhe QSUNT ka njoftuar FSDKSH, se importuesi R.F. dhe D.-A., nuk po furnizojnë farmacinë me barin me kod 705/92 “Dabrafenib 75 mg”. Në e-mail është shprehur në ligjëratë të drejtë: “Theksojmë faktin se QSUNT, ka një numër pacientësh në pritje të barit të lartpërmendur, i cili është i domosdoshëm për ecurinë e shëndetit të tyre”. Gjendje bari më datë 15.11.2021 është 20 caps., sasi e pamjaftueshme për një recetë.

Ky bar është furnizuar nga importuesi D.-A., më datë 21.12.2021, me Faturë Nr.45070, dt.. 21.12.2021 dhe me emrin tregtar Tafinlar 75 mg (caps), në sasinë prej 840 Caps, me vlerë 5090.14 lekë/njësi, me 36 ditë vonesë.

Ky bar është furnizuar nga importuesi Rejsi Farma, më datë 21.12.2021, me Nr. faturë 389494061, datë. 21.12.2021 dhe me emrin tregtar Tafinlar 75 mg (caps), në sasinë prej 840 Caps, me vlerë 5090.14 lekë/njësi, me 36 ditë vonesë.

Ky bar është bërë dalje në datën 22.12.2021, në sasinë prej 1560 caps me diferencë të mbetur 140 Caps (gjendje 20+ 840+840 hyrje – 1560 dalje = 140).

Me e-mailin e datës 22.04.2021 farmacistja e barnave të rimbursuara, njofton QSUNT dhe QSUNT ka njoftuar FSDKSH, se importuesi I. nuk po furnizon farmacinë me barin me kod 578/307 “Capecitabine 500mg”. Në e-mail është shprehur në ligjëratë të drejtë: “Theksojmë faktin se QSUNT, ka një numër pacientësh në pritje të barit të lartpërmendur, i cili është i domosdoshëm për ecurinë e shëndetit të tyre”. Gjendje bari më datë 22.04.2021 është 61 caps, sasi e pamjaftueshme për një recetë.

Ky bar është furnizuar nga importuesi I., më datë 14.05.2021, me Faturë Nr.178, datë. 14.05.2021, me emrin tregtar Xalvobin 500 mg (f.c.tabl), në sasinë prej 4800 Caps, me vlerë 55.86 lekë/njësi, me 22 ditë vonesë. Ky bar është bërë dalje në datën 14.05.2021, në sasinë prej 1848 caps me diferencë të mbetur 3013 Caps (gjendje 61+4800 hyrje – 1848 dalje = 3013).

Theksojmë se edhe për periudhën janar-mars 2023 vazhdojnë mungesat e barit Imatinib Accord 100 mg. Konkretisht me e-mailin e datës 24.02.2023 farmacistja e barnave të rimbursuara, njofton QSUNT dhe QSUNT ka njoftuar FSDKSH, se importuesi M. nuk po furnizon farmacinë me barin me kod 487/325 “Imatinib Accord 100 mg”. Në e-mail është shprehur në ligjëratë të drejtë: “Theksojmë faktin se QSUNT, ka një numër pacientësh në pritje të barit të lartpërmendur, i cili është i domosdoshëm për ecurinë e shëndetit të tyre”. Gjendje bari më datë 24.02.2023 është 40 f.c.tabl., sasi e pamjaftueshme për një recetë.

Ky bar është furnizuar nga importuesi M., më datë 30.03.2023, me Nr. faturë 16997, dt.. 30.03.2023, me emrin tregtar Imatinib Accord 100 mg (f.c.tabl), në sasinë prej 24000 f.c.tabl, me

vlerë 36.38 lekë/njësi, **me 34 ditë vonesë**. Ky bar është bërë dalje nga data 31.03.2023, në sasinë prej 16680 f.c.tabl me diferencë të mbetur 3620 Caps (40+24000 hyrje – 16680 dalje = 7360)

Referuar dokumentacionit të paraqitur si më sipër, furnizimet janë bërë nga 12 deri në 34 ditë me vonesë, në kundërshtim me recetat e lëshuar nga mjekët, ku barna të tillë për sëmundjet tumorale, dializë dhe transplant kanë një përsëritje fikse, psh, çdo 10 ose 15 ditë.

Theksojmë se nuk bëhet fjalë 13 pacient, por për 13 barna, të domosdoshëm kur kurimin e një numri të konsiderueshëm pacientësh. Grupi i auditimit nuk mundi ta saktësoj/kërkoj shifrën pasi e ka konsideruar sekret shtetëror.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre nuk kanë maksimalizuar plotësisht eficientësinë dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike në lidhje me barnat e sipërcituara, ndërsa dëmi shëndetësor ndaj pacientëve është i pallogaritshëm dhe nuk ka pse të varet nga formalitetet burokratike të sistemit të shëndetësisë (Ministër, Bord drejtues, Drejtor të Përgjithshëm QSUNT/FSDKSH).

Veprime në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.

KREU II “Përgjegjësitë e shtetit dhe të shtetasve” Neni 4, pika 1 “Përgjegjësitë e shtetit”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Shteti ushtron veprimtarinë e tij lidhur me kujdesin shëndetësor në mbështetje të këtij ligji dhe zotohet për të rregulluar dhënien, mbikëqyrjen dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor”.

-Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, neni 7, pika 1 ku është shprehur “Spitali publik ofron shërbim mjekësor për të sëmurët e shtruar në shtruar, si dhe shërbime mjekësore për të sëmurët ambulatorë, sipas kritereve të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë”.

Titulli i gjetjes Nr.1	Ngjarjet ekonomike, për furnizim me barna që rimbursohen nga shteti për kryerjen e shërbimit për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar) nuk regjistrohen në kontabilitet.
Situata:	<p>Për periudhën: 01.04.2021 deri më 31.12.2021, vlera e konsumit për rimbursim nga raportimi e-Rx është në vlerën 2,192,737,755.59 lekë, është likuiduar në vlerën 2,185,648,091 lekë.</p> <p>Për periudhën: 01.01.2022 deri më 31.12.2022, vlera e konsumit për rimbursim nga raportimi e-Rx është 3,280,487,262.14 lekë, është likuiduar në vlerën 3,280,404,118 lekë.</p> <p>Pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), paraqiten për të marrë shërbimin në QSUNT-së, sipas sistemit të referimit. Mbi bazën e këtij sistemi sipas sëmundjeve përkatëse, mjekët e QSUNT të kontraktuar nga FSDKSH, lëshojnë receta rimbursimi elektronike e-Rx, receta të cilat pasi kontrollohen nga Drejtoria e Administrimit të Paketave Shëndetësore dhe Ekzaminimet Terciare (drejtori e FSDKSH-së, e instaluar në QSUNT), konfirmohen dhe i kalojnë farmacisë për ekzekutim, dhënien e medikamenteve dhe pajisjeve mjekësore pacientëve për ekzekutim.</p> <p>Farmacia, me paraqitjen e pacientit me recetë të lëshuar nga mjeku dhe e konfirmuar nga Drejtoria e FSDKSH-së, e instaluar pranë QSUNT, bën ekzekutimin e recetës, duke i dhënë pacientit barin ose pajisjen mjekësore, por pa lënë asnjë gjurmë auditimi, pra nuk vërtetohet që bari ose pajisja është marrë nga pacienti, edhe pse këto barna dhe pajisje kanë çmim shumë të shtrenjtë.</p>

	<p>Kjo farmaci furnizohet nga importuesit, me faturë tatimore shitje (elektronike) sipas sistemit të fiskalizimit me NIPT të QSUNT dhe jo me NIPT të FSDKSH, fatura të cilat nuk bëhen hyrje në kontabilitetin e QSUNT, nuk bëhen hyrje dhe në kontabilitetin e FSDKSH, por bën hyrje në programin kompjuterik E-RX në postin që mundësohet nga farmacistët e QSUNT, pra në kontabilitet nuk regjistrohet ngjarja ekonomike.</p> <p>Barnat e furnizuara nga Importuesit farmaceutikë, nuk merren në dorëzim nga grupi i ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm ose nga zyrtari i deleguar prej tij, siç bëhet dhe në farmacinë spitalore, por merren në dorëzim nga vetë punonjësit e farmacisë të sektorit të rimbursimit të barnave spitalore, edhe pse barnat dhe pajisjet mjekësore janë me çmime të shtrenjta.</p> <p>Në 31 kontratat trepalëshe të lidhura ndërmjet QSUNT-së, FSDKSH-së dhe Importuesve Farmaceutikë “Për rimbursimin e barnave të tregtuara në farmacinë e QSUNT-së dhe në marrëveshjet (kontratat) dypalëshe për reduktimin e çmimit të barnave të LBR që tregtohen në farmacitë e spitaleve nga mbajtësi i autorizimit për tregtim, të lidhura ndërmjet FSDKSH-së dhe Importuesve Farmaceutikë, nuk është përcaktuar:</p> <p>-Afati i skadencës: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.</p> <p>-Paketimi: Mbi çdo paketim duhet të jetë shënuar dhe vulosur mbishkrimi/ pulla “Përdorim spitalor - ndalohet shitja”.</p> <p>Përcaktime që janë vendosur në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe procedurat e zhvilluara nga QSUNT, duke aplikuar standard të dyfishtë edhe pse barnat janë me çmim shumë të shtrenjtë.</p> <p>Farmacia e QSUNT/Spitali, shkarkimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore e bën mbi bazën e recetës të lëshuar nga mjeku, receta të cilat konfirmohen nga Drejtoria e Administrimit të Paketave Shëndetësore dhe Ekzaminimet Terciare (Drejtori e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, e instaluar në QSUNT) duke bërë dhe rakordimet me FSDKSH-së. FSDKSH likuidon importuesit farmaceutikë. Pra, likuidimet e importuesve kryhen nga FSDKSH dhe jo nga QSUNT, e cila gjeneron shërbimin: vizitë pacienti, lëshim recetë, personel farmaceutikë, edhe pse faturat importuesit farmaceutikë, i lëshojnë për QSUNT.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 8/1.</p> <p>-Ligji Nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 6, 7 dhe 8.</p> <p>-Udhëzimi e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35/a,b,c.</p>
Ndikimi/Efekti:	Risk i lart për mos administrim të barnave.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E lartë

Rekomandime:	<p>-Nga Drejtorët e Përgjithshëm QSUNT/FSDKSH ti kërkohet Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale krijimi i mekanizmave efektiv për siguruar se palët përfituese jo vetëm duhet të respektojnë obligimet për arsyeshërinë e plotë të shpenzimeve të subvencionuara/rimbursuara por të vendosen dhe kontrollet e duhura me synim që bari/barnat për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), të regjistrohen dhe raportohen saktë në kontabilitet dhe pasqyrat financiare, për QSUNT por edhe për spitalet e tjera.</p> <p>- Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për pranimin e barnave nga importuesit farmaceutikë, duke ngritur grupe pune për marrjen në dorëzim me qëllim jo vetëm kryerjen e tyre me specialist të fushave, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.</p> <p>- Nga drejtorët e përgjithshëm të QSUNT/FSDKSH, të merren masa për të rinegociuar kontratat/marrëveshjet në fuqi me importuesit farmaceutik, për të bërë amendimet përkatëse me qëllim për të përcaktuar:</p> <p>a. Afati i skadencës: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.</p> <p>b.Paketimi: Mbi çdo paketim duhet të jetë shënuar barnat duhet detyrimisht të jenë edhe me vulën/pullën “Përdorim spitalor - ndalohet shitja”.</p>
---------------------	--

Titulli i gjetjes Nr.2	Barna të pa furnizuara në kohë për pacientët, duke shkelur protokollet e mjekimit me pasojë vënie në rrezik të shëndetit e tyre, pasi janë barna të sëmundjeve tumorale dializë dhe transplant.
Situata:	<p>Grupi i auditimit për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimburohen nga shteti përzgjedhi 13 barna: Konkretisht barin me kod 710/96 “Palbociclib 125 mg”, barin me kod 631/335 “Infliximab 100 mg”, barin me kod 662/237 “Erelzi 25 mg” alternativ (Entanercept 25 mg), barin me kod 487/325 “Imatinib Accord 100 mg” alternativ (Imatinib 100 mg), barin me kod 732/92 “Ribociclib 200 mg” alternativ (Kisqali alternativë e parë), barin me kod 682/14 “Sorafenib 200 mg”, barin me kod 776/191 “Enzalutamide 40 mg alternativa e parë”, barin me kod 453/191 “Tacrolimus 1mg”, barin me kod 605/441 “Sevelamer Carbonate 800 mg”, barin me kod 705/92 “Dabrafenib 75 mg”, barin me kod 578/307 “Capecitabine 500mg”, barin me kod 487/325 “Imatinib Accord 100 mg”.</p> <p>Për mungesën e këtyre barnave në farmaci, farmacistja e barnave të rimbursuara, ka njoftuar me e-mail QSUNT-në dhe QSUNT ka njoftuar FSDKSH-në, duke u shprehur në ligjëratë të drejtë se: “... <i>Importuesi nuk po furnizon farmacinë Theksojmë faktin se QSUNT, ka një numër pacientësh në pritje të barnave të lartpërmendura, të cilat janë të domosdoshëme për ecurinë e shëndetit të tyre</i>”.</p> <p>Referuar dokumentacionit, furnizimet janë bërë nga 12 deri në 34 ditë me vonesë, në kundërshtim me recetat e lëshuara nga mjekët, ku barna të tilla</p>

	<p>për sëmundjet tumorale, dializë dhe transplant kanë një përsëritje fikse, p.sh., çdo 10 ose 15 ditë.</p> <p>Theksojmë se nuk bëhet fjalë për 13 pacientë, por për një numër të konsiderueshëm. Grupi i auditimit nuk mundi ta saktësojë, kërkojë, shifrën pasi institucioni i audituar e ka konsideruar sekret shtetëror.</p> <p>Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre, nuk kanë maksimalizuar plotësisht eficientë dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike në lidhje me barnat e sipërcituara, ndërsa dëmi shëndetësor ndaj pacientëve është i pallogaritshëm dhe nuk ka pse të varet nga formalitetet burokratike të sistemit të shëndetësisë (Ministër, Bord drejtues, Drejtor të Përgjithshëm QSUNT/FSDKSH).</p> <p>Veprime në kundërshtim me:</p> <p>-Ligjin Nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>KREU II “Përgjegjësitë e shtetit dhe të shtetasve” Neni 4, pika 1 “Përgjegjësitë e shtetit”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Shteti ushtron veprimtarinë e tij lidhur me kujdesin shëndetësor në mbështetje të këtij ligji dhe zotohet për të rregulluar dhënien, mbikëqyrjen dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor”.</p> <p>-Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, neni 7, pika 1 ku është shprehur “Spitali publik ofron shërbim mjekësor për të sëmurët e shtruar në shtruar, si dhe shërbime mjekësore për të sëmurët ambulatorë, sipas kritereve të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë”.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji Nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” KREU II “Përgjegjësitë e shtetit dhe të shtetasve” Neni 4, pika 1”.</p> <p>- Ligji Nr. 9106, datë 17.07.2003 “ Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, neni 7, pika 1.</p>
Ndikimi/Efekti:	Shkelje të protokolleve të mjekimit me pasojë vënie në rrezik të shëndetit të pacientëve, pasi janë barna të sëmundjeve tumorale dializë dhe transplant.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	<p>- Nga drejtorët e përgjithshëm të QSUNT/FSDKSH-së, të merren masa për të rinëgociuar kontratat/marrëveshjet në fuqi me importuesit farmaceutikë për të bërë amendimet përkatëse, me qëllim përcaktimin e stokut (rezervës) të nevojshme në farmaci referuar numrit të pacientëve që trajtohen dhe të pritshmit (pacientët e rinj), për të eliminuar riskun e mos disponibilitetit të përkohshëm të barit/barnave për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti.</p> <p>- Pas përfundimit të kontratave/marrëveshjeve në fuqi nga Drejtorët e Përgjithshëm QSUNT/FSDKSH, të merren masa për të korigjuar këtë praktikë duke vlerësuar lidhjen e marrëveshjeve kuadër, për furnizimin me bar/barna në princip aktiv jo në emrin tregtar me disa Importues Farmaceutik, për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që</p>

	<p>rimbursohen nga shteti.</p> <p>- Nga drejtorët e përgjithshëm të QSUNT/FSDKSH-së, të merren masa për të lidhur marrëveshje me homologët në vendet fqinje (Kosova etj), për të shkëmbyer bar/barna nga stoku (rezerva) i secilës palë në raste të mos disponibilitetit të bar/barnave për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti.</p>
--	---

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga A.Ç. me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, është paraqitur observacioni me shkresën Nr. 628/5 prot., datë 10.08.2023, administruar në KLSH me Nr. 1177/24 prot., datë 14.08.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Lidhur me Projekt raportin e Auditimit dhe gjetjet për “Kryerjen e shërbimit për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar) me barna të rimbursueshme nga shteti, për sëmundje tumorale dializë dhe transplant”, i qëndrojmë kundërshtimveve të paraqitur me shkresën tonë me Nr.628/3 prot., datë 02.06.2023, duke risjellë edhe argumentet sa më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Konkluzioni i juaj se programi e-Rx (sistemi i rimbursimi elektronik), nuk është i certifikuar nga AKSHI, nga Ministria e Financës/Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si dhe nuk është i përfshirë tek programi qeveritar e-albania, është i pasaktë, pasi shërbimi i recetës elektronike është prokuruar nga AKSHI dhe kontrata është lidhur ndërmjet AKSHIT dhe Kompanisë Fituese. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është palë përfituese.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Ky fakt dhe dokumentacioni i paraqitur nuk i është bërë prezent grupit të auditimit gjatë auditimit dhe në observacionin e dërguar me Nr. 628/3 prot., datë 02.06.2023. Për pasojë nuk është argument i risjell, por që sillet për herë të parë në observacionin për projektraportin e auditimit.

Pavarësisht kësaj, ky koment do merret në konsideratë dhe nuk do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit

Lidhur me tabelat mbi numrin e kontrolleve dhe penaliteteve të ushtruara nga FSDKSH në subjektet farmaceutike (shpërndarës dhe importues), të vëna në dispozicion në kundërshtimet e bëra me shkresën Nr. 628/3 prot., datë 02.06.2023, komenti juaj: Prezantimi nuk është i besueshëm, është jo korrekt. Për këtë sqarojmë se është përgjegjësi individuale dhe institucionale dhënia e informacioneve të sakta të gjitha strukturave me të drejtën e informimit. Ju bëjmë me dije se në kërkesat tuaja për vënien në dispozicion të informacionit se si Fondi përmbush detyrimet lidhur me zbatimin e kontratave në subjektet farmaceutike (shpërndarës dhe importues), nuk është kërkuar ky informacion nga ana e juaj.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Së pari. Është i vërtet fakti që nuk është kërkuar zyrtarisht me kërkesën Nr. 1, protokolluar me Nr. 628/1 prot., datë 23.02.2023, por grupi i auditimit në dy takimet e zhvilluara në FSDKSH, në intervistat e zhvilluara kur nga FSDKSH është prezantuar se janë kryer kontrolle dhe janë vendosur penalitete në subjektet farmaceutike, në lidhje Importuesit Farmaceutik për furnizimin me barna të rimbursueshme nga shteti, për sëmundje tumorale, dializë dhe transplant për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), është kërkuar verbalisht ti vihen në dispozicion penalitetet e vendosura dhe arkëtimi i tyre. Është fakt gjithashtu që për intervistimet dhe ballafaqimet nuk është mbajtur protokoll si nuk janë kryer incizime, por komunikimet telefonike

besoj kompanitë do ti kenë ruajtur, që është kërkuar një gjë e tillë. Mos pranimi nga ana e juaj i këtij fakti është çështje integriteti.

Së dyti. Grupi i auditimit është shprehur, prezantimi nuk është i besueshëm pasi:

a. Nuk keni paraqitur asnjë provë dokumentare për vendosjen e këtyre penaliteteve.

b. Nuk keni prezantuar nëse janë ekzekutuar/ose jo këto penalitete, dëmin ekonomik dhe dokumentacioni përkatës i ekzekutimit, ose i ndjekjes së procedurave administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e tyre. Fakt i cili nuk është paraqitur dhe në observacionin për projekt raportin e auditimit.

Së treti. Grupi i auditimit nuk është shprehur, informacioni është i vërtet apo i pa vërtet, i saktë apo i pa saktë, por është shprehur për sa na vihet në dispozicion, prezantimi nuk është i besueshëm.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit

Kontrolli me inventar në subjektet farmaceutike kryhet nga strukturat kontrolluese të fondit, bazuar në rregulloren Nr.3, datë 22.10.2014 “Për procedurën dhe mënyrën e kontrollit të dhënë të shërbimit të kontraktuar nga fondi”. Këto kontrole kryhen në prani të drejtuesit teknik dhe farmacistëve të QSUNT të pajisur me nënshkrimin elektronik. Inventari kryhet konform të gjitha rregullave të inventarizimit, ku verifikohen hyrjet sipas fletëdaljeve të importuesve, recetat elektronike të ekzekutuara në sistemin E-RX dhe gjendja fizike në farmaci.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimi nuk qëndron. FSDKSH bën inventar dhe aktrakordime me farmacinë e QSUNT për furnizimet e Importuesve farmaceutik dhe daljet për pacientët, duke mos e pasur në juridiksion farmacinë e QSUNT, por duke mos pasur dhe faturat tatimore shitje (elektronike) të sistemit të fiskalizimit, të lëshuara nga Importuesit Farmaceutik, që në fakt lëshohen nga importuesit me NIPT të QSUNT dhe jo me NIPT të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, fatura të cila **nuk bëhen hyrje** në kontabilitetin e QSUNT, nuk bëhen hyrje dhe në kontabilitetin e FSDKSH, por bëhen hyrje në programin kompjuterik E-RX, në postin që mundësohet nga farmacistët e QSUNT, **pra në kontabilitet nuk regjistrohet ngjarja ekonomike.**

Inventarët FSDKSH kryen në mënyrë të njëanshme pa prezencën e QSUNT/sektorit financiar, si dhe kryerja e inventarit pa fletëhyrje është një formalitet burokratik, anti ligjor me risk shumë të lart në abuzimin me barna shumë të shtrenjta që rimbursohen nga shteti për pacientët me sëmundje të rrezikshme.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 8/1, Ligjin Nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 6, 7 dhe 8, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35/a,b,c, pika 39,81,82 dhe 83.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit

Përse QSUNT ka mungesë disponibiliteti të këtyre barnave, kurse në farmacinë e rrjetit të hapur këto barna disponohen, në kundërshtim me dispozitat ligjore, është i pa vërtet. Barnat që tregtohen në farmacinë e spitaleve nuk gjenden në farmacinë e rrjetit të hapur farmaceutik (alternativat tregtare të listës së barnave të rimbursueshme). Importuesit nuk i lejohet shitja me pakicë e barit, shitja e barit nga importuesi bëhet përmes sistemi depo. Importuesit i bëhet inventar për çdo bar të listës së barnave të rimbursueshme. Argumentimi i mirëmennaxhimit të barnave të rimbursueshme që tregtohen në farmacinë e spitaleve i shtohet dhe raporti i auditimit të performancës i KLSH “Për trajtimin e sëmundjeve tumorale” për periudhën 2020-2022, ku

është shprehur. Megjithëse numri i të sëmurëve me sëmundje tumorale ka ardh në rritje nga viti në vit.....; incidenca e vdekjeve ka ardhur duke u ulur. Sipas këtij raporti në vitin 2021, janë regjistruar 4.4 % më pak humbje jete.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Së pari. Vërtetësia e mos disponibilitetit të barnave e gjenë përgjigjen e-mail për e-mail dhe tek faturat e furnizimit të Importuesve që janë bërë nga 12 deri në 34 ditë me vonesë, në kundërshtim me recetat e lëshuar nga mjekët, për 13 barna që përzgjedhi grupi i auditimit.

Theksojmë se nuk bëhet fjalë për 13 pacient, por për një numër të konsiderueshëm pacientësh. Grupi i auditimit nuk mundi ta saktësoj/kërkoj shifrën pasi e ka konsideruar sekret shtetëror.

Grupi i auditimit disponon jo vetëm e-mailet nga farmacistja e barnave të rimbursuara, ku ka njoftuar me e-mail QSUNT dhe QSUNT ka njoftuar FSDKSH, por dhe recetat, faturat tatimore elektronike të importuesve, se kur kanë bërë furnizimin e mungesës së disponibilitetit, daljen nga farmacia të barit të furnizuar në drejtim të pacienteve dhe gjendjen përkatëse.

Së dyti. Ky numër i madh pacientësh me vonesa në furnizime, që arrin deri në 34 ditë, në perceptimin Tuaj, ka ngel pa marr barin e nevojshëm. Pranimi i këtij fakti, nuk është jo vetëm çështje integriteti, por edhe e organeve të tjera shtetërore të specializuara.

Së treti. Përmendja pjesë nga raporti i KLSH është janë kontekstit, ose më saktë është një devijim për justifikuar paligjshmërinë në lidhje me kryerjen e këtij shërbimit kaq të rëndësishëm, që përfshin jo vetëm sëmundjet tumorale, por dhe të dializës dhe transplantit.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Në lidhje me qëndrimin e kundërshtimeve të paraqitura me shkresën me Nr. 628/3 prot., datë 02.06.2023 për aktkonstatimin Nr. 3, datë 31.05.2023, pa përsëritur nga sa u përmend mësipër, ri sqarojmë:

Pretendimi i subjektit

... . Në respekt të çdo konstatimi të grupeve të KLSH dhe përgjegjësisë së kryerjes së detyrave funksionale, sjellim në vëmendjen tuaj se Fondi, nuk ka qenë subjekt në misionin tuaj auditues. Fondi ju ka vënë në dispozicion dokumentacionin që keni kërkuar Ju në lidhje me subjektin auditues QSUNT, si palë kontraktuese me FondinOpinionin i grupit auditues në këtë aktkonstatim lidhur me përgjegjësitë e FSDKSH në mungesë të një auditimi jo të plotë dhe të pa thelluar është i pa argumentuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Nga verifikimi i dokumentacionit në FSDKSH në zbatim të autorizimit të Kryetarit të KLSH Nr.1177/2 prot., datë 10.02.2023, u konstatua se kryerja e shërbimit për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar) për barnat që rimbursohen nga shteti, FSDKSH e bënë palë me argumentet si më poshtë vijon:

Së pari: Në zbatim të Ligjit Nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenet 15 dhe 16, grupi i auditimit ka kryer verifikimin e dokumenteve (ka realizuar gjurmën e auditimit) me dokumentacion të gjeneruar/prodhuar nga FSDKSH, dokumentacion i cili FSDKSH e përfshinë në mënyrë të rëndësishme në shërbimin për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti.

Së dyti: Referuar neni 2 “Baza ligjore”, për 31 Marrëveshjet (kontratat) të lidhura ndërmjet QSUNT, FSDKSH dhe Importuesve farmaceutik “Për rimbursimin e barnave të tregtuara në farmacinë e QSUNT”, përveç dispozitave të tjera ligjore është dhe Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, në këtë FSDKSH është palë dhe si e tillë, nuk mund të përjashtohet nga procedurat e ndjekura për kryerjen e shërbimit për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar) për barnat që rimbursohen nga shteti .

Së treti: Në zbatim të 31 Marrëveshjet (kontratat) të lidhura ndërmjet QSUNT, FSDKSH dhe Importuesve farmaceutik "Për rimbursimin e barnave të tregtuara në farmacinë e QSUNT", FSDKSH likuidon importuesit farmaceutik dhe nuk i likuidon QSUNT. Konkretisht për periudhën: 01.04.2021 deri më 31.12.2021, vlera e konsumit për rimbursim nga raportimi e-Rx është në vlerën 2,192,737,755.59 lekë, është likuiduar në vlerën 2,185,648,091 lekë, ndërsa për periudhën: 01.01.2022 deri më 31.12.2022, vlera e konsumit për rimbursim nga raportimi e-Rx është 3,280,487,262.14 lekë, është likuiduar në vlerën 3,280,404,118 lekë, pra likuidimin e keni kryer ju dhe jo QSUNT.

Së katërti: FSDKSH ushtron ose jo penalitetet për mos furnizim në kohë të barnave në zbatim të 31 Marrëveshjeve (kontratat) të lidhura ndërmjet QSUNT, FSDKSH dhe importuesve farmaceutik "Për rimbursimin e barnave të tregtuara në farmacinë e QSUNT", gjë që QSUNT nuk ka tagrin ligjor për ta bërë.

Së pesti: FSDKSH bën inventar dhe aktrakordime me farmacinë e QSUNT për furnizimet e importuesve farmaceutik dhe daljet për pacientët, duke mos e pasur në juridiksion farmacinë e QSUNT, por duke mos pasur dhe faturat tatimore shitje (elektronike) të sistemit të fiskalizimit, të lëshuara nga importuesit farmaceutik, që në fakt lëshohen nga importuesit me NIPT të QSUNT dhe jo me NIPT të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, fatura të cila **nuk bëhen hyrje** në kontabilitetin e QSUNT, nuk bëhen hyrje dhe në kontabilitetin e FSDKSH, por bëhen hyrje në programin kompjuterik E-RX në postin që mundësohet nga farmacistët e QSUNT, **pra në kontabilitet nuk regjistrohet ngjarja ekonomike**. Theksojmë se inventarët FSDKSH i kryen në mënyrë të njëanshme pa prezencën e QSUNT/sectorit financiar, si dhe kryerja e inventarit pa fletëhyrje **është një formalitet burokratik, anti ligjor me risk shumë të lart në abuzimin me barna shumë të shtrenjta që rimbursohen nga shteti për pacientët me sëmundje të rrezikshme**.

Së gjashti: Gjurma e auditimit/dokumentacioni nga grupi i auditimit është realizuar në të dy institucionet (QSUNT, FSDKSH), pasi procedurat për kryerjen e shërbimit për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar) **me barna** që rimbursohen nga shteti përfshinë të dy institucionet, referuar sa më sipër aktkonstatimi Nr.3, datë 31.05.2023, është mbajtur me A. Ç. me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, A.F. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i QSUNT për periudhën 03.12.2021-31.12.2022 dhe E.J. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i QSUNT për periudhën 01.04.2021-30.11.2021.

Së shtati: Duke qenë se janë kryer jo vetëm kontrole për disponibilitetin e barnave, por dhe inventar në farmacinë e rimbursimit, Drejtori i Përgjithshëm me siguri është njohur me problematikën e administrimit të barnave, që është në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 8/1, Ligjin Nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndryshimet vijuese të tij, neni 6, 7 dhe 8, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik", me ndryshimet vijuese të tij, pika 35/a,b,c dhe nuk është marr asnjë masë për të zgjidhur problematikën. Pra Drejtori i përgjithshëm ka qenë dy herë i informuar. Njëherë nga audituesit e vet dhe një herë si anëtar i Bordit të Spitalit me relacionin që ka dërguar zv/ Drejtori i përgjithshëm QSUNT S.Xh. me shkresën Nr. 755/9 prot., datë 23.11.2021.

Së teti: Drejtori i përgjithshëm Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është anëtarë i Bordit Drejtues të QSUNT, Bord i cili në zbatim të Statutit të miratuar me Urdhër të Përbashkët Nr. 709, datë 10.10.2018, të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e Statutit të QSU "Nënë Tereza", KREU

III "ORGANIZIMI", pika 8 "Organet Drejtuese", pika 10 b/c, miraton; raportin e veprimtarisë shëndetësore dhe kërkimore shkencore të shërbimeve shëndetësore universitare dhe raportin vjetor të veprimtarisë financiare. Nga auditimi i të gjitha vendimeve të bordit për periudhën objekt auditimi u konstatua se nuk ka asnjë vendimmarrje për këto dy raportime të përmendura, si dhe specifikisht për kryerjen e shërbimit për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar) për barnat që rimbursohen nga shteti dhe nga Drejtor i Përgjithshëm i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor nuk ka asnjë kërkesë të tillë.

Por përkundrazi, Bordi i Spitalit edhe pse zv/ Drejtori i përgjithshëm QSUNT, S.Xh. me shkresën Nr. 755/9 prot., datë 23.11.2021, jo vetëm ka vënë në dijeni për problematikën në lidhje kryerjen e shërbimit për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar) për barnat që rimbursohen nga shteti, por dhe ka bërë propozimin konkret për zgjidhjen e kësaj problematike, nga Bordi nuk ka marr asnjë përgjigje.

Së nënti: Referuar Rregullores së Procedurave të Auditimit, miratuar me Vendim Nr. 107 datë 08.08.2017, të Kryetarit të KLSH me ndryshime, si dhe gjetjeve të prezantuar në Aktkonstatimin Nr.3, datë 31.05.2023, në opinionin e grupit të auditimit lidhur me përgjegjësit e FSDKSH, auditimi për këtë çështje është i plotë, i thelluar dhe plotësisht i argumentuar me prova/fakte dhe dispozitat ligjore respektive. Për dijeninë Tuaj grupi i auditimit administron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që provon/fakton gjetjet e konstatuara.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit

Lidhur me mos dakortësinë e gjurmës së auditimit për rimbursimin e barnave të tregtuara në farmacinë QSUNT.

Qëndrimi i grupit të auditimit

-Argumentimi është në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 8/1, Ligjin Nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndryshimet vijuese të tij, neni 6, 7 dhe 8, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik", me ndryshimet vijuese të tij, pika 35/a,b,c.

Për pos sa më sipër

Dhe në ballafaqimin dy herë në FSDKSH, dhe në observacion nuk është argumentuar:

a. Përse nuk firmos patienti tek receta, që të vërtetohet marrja e barnave, ose të lëshohet mandat arkëtimi zero, siç ndodhë me vizitën e pacientit të mjeku.

b. Si vërtetohet që patienti i ka marrë të gjitha barnat, pasi një recetë mund të ketë më shumë se një bar. Risku i abuzimit me barin tjetër duke i thënë pacientit se nuk ka gjendje për këtë bar dhe barin e pa dhënë ekziston mundësia e nxjerrjes në treg nën dorë. Risk lartë që abuzimi të mund të ndodh nga punonjësit e farmacisë.

c. Për pacientët që për një arsye ose tjerë nuk vijnë dot vetë për ta tërhequr barin, por dërgojnë persona të tretë, si operohet me kartat e identitetit që nuk përkon me kartën e identitetit të pacientit.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit

Lidhur me kontabilizimin e rimbursimit të barnave. Ngjarja ekonomike "Rimbursimi i barnave, drejtorinë e shërbimeve mbështetëse pasi merr në dorëzim dosjen e farmacisë së spitalit dhe aktrakordimin e firmosur nga përgjegjësi i sektorit të rimbursimit, konfirmon vlerën e rimbursimit, procesverbalet përkatëse, listëtreguesin, kontabilizohet bazuar në kontratën dhe rregulloren e sistemit të recetës elektronike. Sektor i financës në analitik të recetave të sistemit e-

rx, pasqyrën përmbledhëse të hyrjeve daljeve dhe bënë përpunimin e listëtreguesve sipas konsumit të importuesve farmaceutik.

Farmacia e rimbursimit të barnave në QSUNT, funksionon ashtu si farmacitë e rrjetit të hapur farmaceutik. Bari i rimbursueshëm që bëhet hyrje në farmacinë spitalore me rimbursim ngarkohet në sistemin e-rx, jo duke e hedhur faturën manualisht, por duke e tërhequr nga sistemi e-depo.

Qëndrimi i grupit të auditimit

-Argumentimi është në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 8/1, Ligjin Nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 6, 7 dhe 8, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35/a,b,c.

-FSDKSH bën inventar dhe aktrakordime me farmacinë e QSUNT për furnizimet e importuesve farmaceutik dhe daljet për pacientët, duke mos e pasur në juridiksion farmacinë e QSUNT, por duke mos pasur dhe fatura tatimore shitje (elektronike) të sistemit të fiskalizimit, të lëshuara nga importuesit farmaceutik, që në fakt lëshohen nga importuesit me NIPT të QSUNT dhe jo me NIPT të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, fatura të cila **nuk bëhen hyrje në kontabilitetin e QSUNT, nuk bëhen hyrje dhe në kontabilitetin e FSDKSH, por bëhen hyrje në programin kompjuterik E-RX në postin që mundësohet nga farmacistët e QSUNT, pra në kontabilitet nuk regjistrohet ngjarja ekonomike.** Theksojmë se inventarët FSDKSH i kryen në mënyrë të njëanshme pa prezencën e QSUNT/ sektorit financiar, si dhe kryerja e inventarit pa fletëhyrje është një formalitet burokratik anti ligjor me risk shumë të lart në abuzimin me barna shumë të shtrenjtë që rimbursohen nga shteti për pacientët me sëmundje të rrezikshme.

Për posë sa më sipër

Dhe në ballafaqimin dy herë në FSDKSH, dhe në observacion nuk është argumentuar:

-Ku kontabilizohen fatura tatimore shitje (elektronike) të sistemit të fiskalizimit, të lëshuara nga importuesit farmaceutik.

-Nga magazinieri/farmacia, a pritet fletëhyrje referuar faturës së Importueseve dhe ku kontabilizohet kjo fletë hyrje. Në referencë të dispozitave ligjore të përmendur si më sipër.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit

Pretendimi se neni 5, pika 7 e kontratës përshkruan detyrimin e Importuesit të tregtoj barnat e listës së barnave që rimbursohen vetëm të pajisura me pullën e kontrollit tatimor të AKBPM dhe brenda serisë së skadencës.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Është keq interpretim i gjetjes së prezantuar në aktkonstatim/projekt raport.

Grupi i auditimit nuk është shprehur që barnat që rimbursohen nuk janë të pajisura me pullën e kontrollit të AKBPM.

Grupi i auditimit në ligjëratë të drejt është shprehur: “Në 31 kontratat trepalëshe të lidhura ndërmjet QSUNT, FSDKSH dhe importuesve farmaceutik “Për rimbursimin e barnave të tregtuara në farmacinë e QSUNT dhe në Marrëveshjet (kontratat) dy palëshe për reduktimin e çmimit të barnave të LBR që tregtohen në farmacitë e spitaleve, të lidhura ndërmjet FSDKSH dhe Importuesve Farmaceutik, nuk është përcaktuar:

-Afati i skadencës: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.

-Paketimi: Mbi çdo paketim duhet të jetë shënuar barnat duhet detyrimisht të jenë të vulosura edhe me vulën me mbishkrimin “PËRDORIM SPITALOR - NDALOHET SHITJA”.

Përcaktime që janë vendosur në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe procedurat e zhvilluar nga QSUNT, duke aplikuar standart të dyfishtë edhe pse barnat janë me çmim shumë të shtrenjtë’.

Pra grupi i auditimit është shprehur, përse është ky standard i dyfishtë për barna që janë kaq të shtrenjtë dhe përse këto barna nuk merren në dorëzim me grup pune të ngritur nga Drejtori i Përgjithshëm, si bëhet për barnat e tjerë.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit

Barnat e rimbursueshme nuk janë barna të trajtimit spitalor, por janë barna për trajtim ambulatorë të pacientëve. Neni 39 “Farmacitë dhe Agjencitë farmaceutike” të ligjit Nr.105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” citon: “Tregtimi me pakicë i barit nga farmacitë dhe Agjencitë Farmaceutike vetëm në referim të paketimit të tij të jashtëm sipas dispozitave të këtij ligji”.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Së pari. Në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”(QSUNT Tiranë, për shërbimin e pacientëve të shtruar në spital dhe atyre ambulatorë është e organizuar dhe funksionon Drejtoria e Shërbimit Farmaceutik e përbërë nga 5 sektorë, njëri prej të cilëve është sektori i rimbursimit të barnave spitalor, e cila organikisht dhe fizikisht është pjesë e organikës të QSUNT (me godinë (farmaci), personel, pagesë personeli, drita, ujë etj.).

Së dyti. Kjo farmaci furnizohet nga importuesit, me faturë tatimore shitje (elektronike) sipas sistemit të fiskalizimit me NIPT të QSUNT.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit

Mbi mos dakortësinë për mungesa të përkohshme të disponibilitetit të barit në farmaci. Verifikimi nga grupi i auditimit është bërë jo i plotë. Është përshkruar vetëm detyrimi kontraktual i QSUNT për të njoftuar fondin mbi mungesën e disponibilitetit dhe jo çfarë bënë fondi si detyrim kontraktual lidhur me mungesën e disponibilitetit.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Së pari. Është keq interpretuar gjetja e prezantuar në aktkonstatim/projekt raport.

Grupi i auditimit është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Për mungesën e këtyre barnave në farmaci, farmacistja e barnave të rimbursuara, ka njoftuar me e-mail QSUNT dhe QSUNT ka njoftuar FSDKSH, duke u shprehur në ligjëratë të drejt se “... .Importuesi nuk po furnizon farmacinë ...Theksojmë faktin se QSUNT, ka një numër pacientësh në pritje të barnave të lartpërmendur, i cilat janë të domosdoshëm për ecurinë e shëndetit të tyre”.

Së dyti. Grupi i auditimit disponon jo vetëm e-mailet nga farmacistja e barnave të rimbursuara ku, ka njoftuar me e-mail QSUNT dhe QSUNT ka njoftuar FSDKSH, por dhe recetat, faturat tatimore elektronike të importuesve, se kur kanë bërë furnizimin e mungesës së disponibilitetit, daljen nga farmacia të barit të furnizuar në drejtim të pacienteve dhe gjendjen përkatëse.

Së tretë. Pretendimi se pacientët janë trajtuar me mjekim alternativ si dhe me trajtim spitalor nuk qëndron me argumente si më poshtë:

Së pari. Në observacionin e QSUNT Nr.175/94 prot., datë 07.06.2023 ky fakt nuk pasqyrohet.

Së dyti. N.q.s FSDKSH ka kontraktuar ndonjë spital tjetër për trajtimin spitalor, përveç QSUNT duhet bashkë me observacionin të paraqiste dokumentacionin përkatës, jo vetëm kontrata/kontratat por dhe rast pas rasti të gjithë pacientët e trajtuar për mos disponibilitetin e 13 barnave.

Së treti. Pretendimi se importuesi vërteton me dokumentacion justifikues që mungesa e disponibilitetit të barit në treg nuk rrjedh si pasoje e veprimeve dhe mos veprime të tij, por për shkaqe që varen nga Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim, nuk justifikon dëmin shëndetësor ndaj pacientëve që është i pallogaritshëm (pra shumë herë më i madh, pasi shëndeti dhe jeta e pacientëve/njeriut nuk ka çmim), dhe nuk ka pse të varet nga formalitetet burokratike të sistemit të shëndetësisë (Ministër, Bord drejtues, Drejtor të Përgjithshëm QSUNT/FSDKSH).

Theksojmë se nuk bëhet fjalë për 13 pacient, por për 13 barna që i përkasin një numër të konsiderueshëm pacientësh, që grupi i auditimit nuk mundi ta saktësoj/kërkoj shifrën pasi e ka konsideruar sekret shtetëror.

Dhe në ballafaqimin dy herë në FSDKSH dhe në observacion nuk është argumentuar:

a. Përse në farmaci nuk është stoku (rezerva) e nevojshme referuar numrit të pacienteve që trajtohen dhe të pritshmit (pacientët e rinj) për të eliminuar riskun e mos disponibilitetit të përkohshëm të barit/barnave për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti.

b. Përse nuk është vlerësuar lidhja e marrëveshjeve kuadër, për furnizimin me bar/barnave në princip aktiv jo në emrin tregtar me disa importues farmaceutik, për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti.

c. Përse nuk janë lidhur marrëveshje me homologë në vendet fqinje (Kosova), për të shkëmbyer bar/barna nga stoku (rezerva) e secilës palë në raste të mos disponibilitetit të bar/barnave për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti.

d. Përse QSUNT ka mungesë disponibiliteti të këtyre barnave, kurse në farmacitë e rrjetit të hapur këto barna disponohen, në kundërshtim me dispozitat ligjore.

e. Cilat janë kontrollet e FSDKSH në farmacitë e rrjetit të hapur për disponibilitetin e këtyre barnave që pacientët/ose familjarët e tyre detyrohen ti blejnë me çmime shumë herë më të shtrenjta.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga E.J. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i QSUNT për periudhën 01.04.2021 -03.12.2021, është paraqitur observacioni me shkresën Nr. 175/125 prot., datë 02.08.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

... Referuar nenit 4 dhe 43 Kodi i procedurave administrative 'Titullari i i organit publik, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj ose akt nënë ligjore, cakton paraprakisht një njësi përgjegjëse për çdo tip procedure administrative në kompetencë të organit, në përputhje me rregullat e brendshme të veprimtarisë së tij. Ky vendim bëhet publik me çdo mjet të përshtatshëm neni 47. E drejta për të paraqitur mendime dhe shpjegime. Të gjitha palët në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtë të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethanat apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes... vendim i Bordit të spitalit Nr. 7, datë 21,09.2015, pika 2.1. Postet e administratës ndahen nga pikëpamja hierarkike në drejtori të përgjithshme, drejtori dhe sektor.....

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Përgjegjësia e Drejtorit të Përgjithshëm është përcaktuar:

-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 107 pika 1 dhe 2.

-Statuti i miratuar me Urdhër të Përbashkët Nr. 709, date 10.10.2018, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e Statutit të QSU "Nënë Tereza", KREU III "ORGANIZIMI", neni 14.1,14.2 dhe 15.1c/ç/dh/e/ë.

-Ligji Nr.162 datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 21“.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b.

-Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, neni 2, 8 dhe 52.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit

Bazuar në Ligjin Nr.10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit Shëndetësor” në Republikën e Shqipërisë”, neni 10 dhe 30, caktimi i listës së barnave të rimbursueshme është nën përgjegjësinë e FSDKSH, në cilësinë e institucionit që kryen pagesa dhe ndjek kontrata për barnat e rimbursueshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Së pari. Gjurma e auditimit/dokumentacioni nga grupi i auditimit është realizuar në të dy institucionet (QSUNT, FSDKSH), pasi procedurat për kryerjen e shërbimit për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar) **me barna** që rimbursohen nga shteti përfshinë të dy institucionet, referuar sa më sipër aktkonstatimi Nr.1, 2 dhe 3, datë 31.05.2023, është mbajtur me A.Ç. me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, A.F. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i QSUNT për periudhën 03.12.2021 - 31.12.2022 dhe E.J. me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm i QSUNT për periudhën 01.04.2021-30.11.2021.

Së dyti. Referuar neni 2 “Baza ligjore”, për 31 Marrëveshjet (kontratat) të lidhura ndërmjet QSUNT, FSDKSH dhe importuesve farmaceutik “Për rimbursimin e barnave të tregtuara në farmacinë e QSUNT, përveç dispozitave të tjera ligjore është dhe Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, në këtë QSUNT është palë dhe si e tillë, nuk mund të përjashtohet nga procedurat e ndjekura për kryerjen e shërbimit për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar) për barnat që rimbursohen nga shteti .

Së treti. Faturat tatimore shitje (elektronike) të sistemit të fiskalizimit, të lëshuara nga importuesit farmaceutik, që në fakt lëshohen nga importuesit me NIPT të QSUNT dhe jo me NIPT të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, fatura të cila nuk bëhen hyrje në kontabilitetin e QSUNT.

Së katërti. Në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”(QSUNT Tiranë, për shërbimin e pacientëve të shtruar në Spital dhe atyre ambulatorë, është e organizuar dhe funksionon Drejtoria e Shërbimit Farmaceutik e përbërë nga 5 sektor, njëri prej të cilëve është sektori i rimbursimit të barnave spitalor, e cila organikisht dhe fizikisht është pjesë e organikës të QSUNT (me godinë (farmaci), personel, pagesë personeli, drita, ujë etj.).

Së pesti. Pacientë ambulatorë (jo të hospitalizuar), paraqiten për të marr shërbimin në QSUNT, sipas sistemit të referimit. Mbi bazën e këtij sistemimi sipas sëmundjeve përkatëse, mjekët e QSUNT të kontraktuar nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lëshojnë receta rimbursimi elektronike e-Rx, receta të cilat pasi kontrollohen nga Drejtoria e Administrimit të Paketave Shëndetësore dhe Ekzaminimet Terciale (Drejtori e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, e instaluar në QSUNT), konfirmohen dhe i kalojnë farmacisë për ekzekutim, dhënien e medikamenteve dhe pajisjeve mjekësore pacientëve për ekzekutim.

Farmacia me paraqitjen e pacientit me recetë të lëshuar nga mjeku dhe e konfirmuar nga Drejtoria e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, e instaluar në QSUNT, bënë ekzekutimin e recetës, duk i dhënë pacientin barin ose pajisjen mjekësore, por pa lënë asnjë gjurmë auditimi, pra nuk vërtetohet që bari ose pajisja është marr nga pacienti, edhe pse këto barna dhe pajisje kanë çmim shumë të shtrenjtë.

Së gjashti. Referuar Rregullores së Procedurave të Auditimit, miratuar me Vendim Nr. 107 datë 08.08.2017, të Kryetarit të KLSH me ndryshime, si dhe gjetjeve të prezantuar në Aktkonstatimin Nr.3, datë 31.05.2023 dhe Projekt Raportin e Auditimit, në opinionin e grupit të auditimit lidhur me përgjegjësit e QSUNT /FSDKSH, auditimi për këtë çështje është i plotë, i thelluar dhe plotësisht i argumentuar me prova/fakte dhe dispozitat ligjore respektive. Grupi i auditimit administron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që provon/fakton gjetjet e konstatuara.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga M.R. me detyrë Drejtor i Shërbimit Farmaceutik, J.R. me detyrë përgjegjës i Sektorit të Rimbursimit pranë DSHF është paraqitur observacioni me shkresën Nr. 175/136 prot., datë 04.08.2023, në lidhje me Rekomandimin 1.2, 2., 2.2, 2.3 të masave organizative, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Për rekomandimin 1.2.

QSUNT është në zbatim të kontratës aktuale trepalëshe “Për rimbursimin e barnave të tregtuara në farmacinë e QSUNT 2021”, miratuar me Vendim të Këshillit Administrativ të Fondit Nr. 12, datë 19.07.2021 ndërmjet Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Importuesit Farmaceutik.

Këto kontrata bazohen në Ligjin Nr. 10383 datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit Shëndetësor” në Republikën e Shqipërisë, ku neni 29.

Në kuptim dhe zbatim të kësaj VKM, ku citohet se është ky Institucion i cili përcakton kriteret dhe miraton kontratat me dhënësit e shërbimit shëndetësor, mbetet kompetencë po e këtij Institucioni parashikimi dhe përfshirja në kontratën 3-palëshe e detyrimit për kolaudimin e barnave si edhe përcaktimin specialistëve të cilët duhet të kryejnë këtë detyrë.

Theksojmë se aktualisht, FSDKSH kryen kontrolle, inventarë dhe akt - rakordime rreth gjendjes së këtyre barnave pranë Farmacisë së Rimbursimit, pa praninë e anëtarëve të tjerë të sektorit të financës së QSUNT.

QSUNT ka zbatuar kontratën trepalëshe rreth administrimit të barnave të cilat janë të përcaktuara në nenin 13, Administrimi i barnave nga QSUNT (Spitali), pika 1 dhe 2 ku citohet se:

1. QSU/Spitali (Farmacia) është e detyruar të marrë në dorëzim barnat nga Importuesi sipas kërkesës së Drejtorisë së QSU-së dhe kundrejt faturave përkatëse. Kërkesa hartohet mbështetur në nevojat 15 ditore të Farmacisë, për trajtimin e pacientëve ambulatorë me barnat objekt i kësaj kontrate.

2. QSU (Farmacisë) i rimbursohen vetëm barnat, të pajisura me pullën e kontrollit të AKBPM, të furnizuara nga Importuesit farmaceutikë, sipas anekseve bashkëlidhur, të zbatuara me përpikëri në çdo rast.

Nisur nga sa më sipër, nuk është në tagrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” pra ndodhur në kushtet kur është Institucion tjetër ai që ka tagrin ligjor për korrigjimin e kësaj praktike/kontrate mbi pranimin e barnave nga Importuesit Farmaceutik dhe për këtë arsye, Drejtori i Përgjithshëm, nuk i ka instrumentet e duhura ligjore dhe administrative për të mundësuar sa pasqyrohet në Projekt Raport. Gjithsesi QSUNT ka përcjellë me shkresë zyrtare pranë FSDKSH rekomandimin e lënë nga KLSH me qëllim përfshirjen në kontratat trepalëshe përcaktimin e kolaudimit të barnave të rimbursuara.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Pretendimi është në kundërshtim me Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij dhe Udhëzimin Nr. 20, datë 17.11.2014 “Për disa

shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 54, me argumente t si më poshtë:

Së pari. Në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" QSUNT Tiranë, për shërbimin e pacientëve të shtruar në Spital dhe atyre ambulatorë, është e organizuar dhe funksionon Drejtoria e Shërbimit Farmaceutik e përbërë nga 5 sektor, njëri prej të cilëve është sektori i rimbursimit të barnave spitalor, e cila organikisht dhe fizikisht është pjesë e organikës të QSUNT (me godinë (farmaci), personel, pagesë personeli, drita, ujë etj.).

Së dyti. Faturat tatimore shitje (elektronike) të sistemit të fiskalizimit, të lëshuara nga Importuesit farmaceutik, lëshohen nga Importuesit me NIPT të QSUNT dhe jo me NIPT të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Së treti. Referuar neni 2 "Baza ligjore", për 31 Marrëveshjet (kontratat) të lidhura ndërmjet QSUNT, FSDKSH dhe Importuesve farmaceutik "Për rimbursimin e barnave të tregtuara në farmacinë e QSUNT", përveç dispozitave të tjera ligjore është dhe Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", me ndryshimet vijuese të tij, në këtë kontekst QSUNT është palë dhe si e tillë, nuk mund të përjashtohet nga procedurat e ndjekura për administrimin e barnave që rimbursohen nga shteti .

Së katërti. Ka standard të dyfishtë, pasi të gjitha barnat që furnizohen si rezultat i procedurave të prokurimit të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe procedurat e zhvilluar nga QSUNT, merren në dorëzim me grup pune të ngritur nga Drejtori i Përgjithshëm.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit

Përsa i përket Rekomandimit 2., 2.2, 2.3:

Referuar Ligjit Nr. 10383 datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit Shëndetësor" në Republikën e Shqipërisë, Neni 1 i këtij ligji "Qëllimi i ligjit" është vendosja dhe zbatimi i skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, i të cilit citon: Ky ligj përcakton statusin ligjor, strukturën, funksionet dhe veprimtarinë e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (më poshtë i quajtur Fondi), i cili menaxhon financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në skemën e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor. Ndërkohë neni 29 "Kontratat" përcakton në pikën 2 të tij se.... "Këshilli administrativ miraton procedurat dhe kriteret për lidhjen e kontratave dhe për pagesat duke synuar në stimulimin e aksesit ndaj shërbimeve, kostos së efektivitetit dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve të ofruara prej dhënësve privatë dhe publikë ndaj komunitetit, dhe pika 3. Fondi lidh kontratë me dhënësit publikë të shërbimit shëndetësor, të licencuar nga autoriteti kompetent, dhe mbulon të gjitha shërbimet e ofruara nga dhënësi, të cilat janë të përfshira në paketën e shërbimeve, sipas nenit 10 të këtij ligji." Pra instrumentet ligjore dhe administrative për ndryshimet e cituara nga KLSH, janë të FSDKSH.

Në kuptim dhe zbatim të kësaj VKM, ku qartësisht citohet se është ky Institucion i cili harton dhe miraton kontratat me dhënësit e shërbimit shëndetësor, mbetet kompetencë po e këtij Institucioni përcaktimi i detajuar për masat që duhen marrë apo çdo detyrim kontraktual i QSUNT apo i Importuesve Farmaceutik. QSUNT është institucion i cili jep shërbimin mjekësor të përcaktuara në kontratat e FSDKSH.

Sa më sipër, QSUNT ka përcjellë me shkresë zyrtare pranë FSDKSH rekomandimin e lënë nga KLSH me qëllim përfshirjen në kontratat trepalëshe përcaktimin e kolaudimit të barnave të rimbursuara.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

QSUNT është jo vetëm është palë nënshkruese e marrëveshjeve (kontratave) tre palëshe në veçanti neni 19 i tyre, por QSUNT gjeneron shërbimin ndaj pacientit sipas sistemit të referimit

në zbatim të Ligjit Nr. 9106, datë 17.07.2003 “ Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, neni 7, pika 1 ku është shprehur “ Spitali publik ofron shërbim mjekësor për të sëmurët e shtruar në spital, si dhe shërbime mjekësore për të sëmurët ambulatorë, sipas kriterëve të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë”. .

Prandaj ky koment nuk në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

2.11. Trajtimi i ankesës së shoqërisë “S.M.” sh.p.k., administruar në KLSH me Nr. 1331 prot., datë 07.12.2021 dhe Nr. 1331/1 prot., datë 09.12.2021.

Në zbatim të pikës 8 të programit të auditimit, lidhur me ankesën e shoqërisë “S.M.” sh.p.k., bazuar në Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin Nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe “Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit”, miratuar me vendimin Nr. 63, datë 22.06.2020 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Kërkesa Nr. 1331 prot., datë 07.12.2021 dhe kërkesa Nr. 1331/1 prot., datë 09.12.2021 shoqërisë “S.M.” sh.p.k., drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit.

- Komunikimi shkresor ndërmjet Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe shoqërisë “H.L.” sh.p.k. dhe shoqërisë “S.M.” sh.p.k.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Me anë të shkresës Nr. 1331 prot., datë 07.12.2021 dhe shkresës Nr. 1331/1 prot., datë 09.12.2021, shoqëria “S.M.” sh.p.k., ka përcjellë pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit ankesë lidhur me auditimin e kryer në subjektin Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (këtu e në vijim QSUNT) në vitin 2019. Ndër të tjera, ka parashtruar se nuk është dakord me gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit, ngritur në zbatim të programit të auditimit Nr. 1422/1, datë 07.01.2019 dhe ka ngritur pretendimin se nuk është vendosur në dijeni në momentin e duhur lidhur me dëmet e konstatuara nga KLSH, në mënyrë që të mund të vijonte me përcjelljen e dokumentacionit provues.

Referuar vendimit Nr. 52, datë 21.08.2019 të Kryetarit të KLSH-së, gjetja nga auditimi Nr.40 përkon me:

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “*Furnizim vendosje aparature rezonancë magnetike për shërbimin e Neurokirurgjisë në QSUT*”, Nr. 2270/23 prot., datë 24.09.2018, me afat të zbatimit të kontratës brenda 90 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, me vlerë totale prej 160,176,000 lekë me TVSH është konstatuar se, vlera prej 1,281,408 lekë (vlera prej 160,176,000 x 4/1000 = 640,704 x 2 ditë), përbën dëm ekonomik ndaj Buxhetit të Shtetit. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos mbajtjes së vlerës së penalteteve për dorëzimin e mallit në kundërshtim me kushtet e kontratës për sa është rënë dakord midis palëve, vlerë monetare kjo e cila duhej të ishte mbajtur nga kontraktori (Trajtuar më hollësisht në pikën 6, të Raportit Përfundimtar).

- Nga auditimi i zbatimit të procedurës së mësipërme është konstatuar se, vlera prej 56,061,600 lekë (160,176,000 lekë x 35%), përbën dëm ekonomik ndaj Buxhetit të Shtetit. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos zbatimit të kushteve kontraktuale sipas përqindjes së marrë përsipër sipas kontratës së bashkëpunimit, në kundërshtim kjo me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 74 (Trajtuar më hollësisht në pikën 6, të Raportit Përfundimtar).

Lidhur me këtë gjetje është rekomanduar të zbatohet menjëherë:

40.1 Të kërkohet në mënyrë ligjore, duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës prej 1,281,408 lekë e cila ka ardhur si rezultat i mos mbajtjes të vlerës së penaliteteve për dorëzimin e mallit në kundërshtim me kushtet e kontratës, nga kontraktori “S.M.&H.&L.” Sh.p.k. lidhur me shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt: “Furnizim vendosje aparature rezonancë magnetike për shërbimin e Neurokirurgjisë në QSUT”.

40.2 Të kërkohet në mënyrë ligjore, duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës prej 56,061,600 lekë e cila ka ardhur si rezultat i mos zbatimit të kushteve kontraktuale sipas përqindjes së marrë përsipër sipas kontratës së bashkëpunimit, në kundërshtim kjo me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nga kontraktori “S.M.&H.&L.” sh.p.k. lidhur me shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt: “Furnizim vendosje aparature rezonancë magnetike për shërbimin e Neurokirurgjisë në QSUT”.

Në përgjigje të sa më sipër, subjekti QSUNT, me anë të observacioneve të dërguara me shkresën Nr. 5/99 prot., datë 05.04.2019 ka ushtruar të drejtën që ka për të paraqitur komente apo shpjegime lidhur me gjetjet e konstatuara, brenda një jave nga marrja e Akt Konstatimit, observacione të cilat grupi i auditimit i ka konsideruar se nuk qëndrojnë. Gjithashtu, në mbështetje të pikës 1, neni 29, të ligjit Nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, përpara nxjerrjes së raportit përfundimtar të auditimit, QSUNT i është krijuar sërish mundësia për të komentuar mbi projekt-raportin brenda 1 muaji nga data e marrjes së tij. Në vijim, është miratuar vendimi Nr.52, datë 21.08.2019 i kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, përcjellë me anë të shkresës Nr. 1422/11 prot., datë 21.08.2019.

QSUNT, në cilësinë e subjektit të audituar, i ka pranuar rekomandimet e vendosura nga KLSH dhe ka filluar me zbatimin e tyre. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se Drejtoria Juridike i ka përcjellë dy shoqërive “S.M.” sh.p.k. dhe “H.L.” sh.p.k. njoftimin për likuidim detyrimesh me shkresën Nr. 5/250 prot., datë 27.12.2019, duke i njoftuar që të marrin masa për shlyerjen e detyrimit objekt auditimi brenda 15 ditësh nga data e marrjes së njoftimit. Gjithashtu, në vijim Drejtoria Juridike me anë të shkresës Nr. 1556/131 prot., datë 16.11.2021 i bën me dije dy shoqërive se konstatimet e tyre përcjellë me shkresën Nr. 1556/93 prot., datë 17.06.2021 dhe me shkresën Nr. 1556/94 prot., datë 17.06.2021 nuk merren në konsideratë dhe si rrjedhojë duhet të vijnë masa për shlyerjen e detyrimit brenda 15 ditësh nga marrja e këtij njoftimi, si dhe mosrespektimi i këtij afati përfundimtar i legjitimon në fillimin e procedurave ligjore.

Përsa më sipër, referuar Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, subjekti “H.L.” sh.p.k., “S.M.” sh.p.k. dhe QSUNT janë palë në kontratën Nr. 2270/23 prot., datë 24.09.2018, e cila konsiderohet një kontratë me detyrime të dyanshme, ku të dyja palët detyrohen reciprokisht ndaj njëra-tjetrës, e si të tillë për çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve kontraktuese, që buron nga një kontratë administrative/publike, zgjidhet drejtpërdrejt nga gjykata kompetente për çështjet administrative.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Parregullsi e shkelje në trajtimin e pacientëve ambulatorë me barna të rimbursueshme, për sëmundje tumorale, dializë dhe transplant.

✓ Për periudhën: 01.04.2021 deri më 31.12.2021, vlera e konsumit për rimbursim nga raportimi e-Rx është në vlerën 2,192,737,755.59 lekë, është likuiduar në vlerën 2,185,648,091 lekë.

✓ Për periudhën: 01.01.2022 deri më 31.12.2022, vlera e konsumit për rimbursim nga raportimi e-Rx është 3,280,487,262.14 lekë, është likuiduar në vlerën 3,280,404,118 lekë.

Pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), paraqiten për të marrë shërbimin në QSUNT-së, sipas sistemit të referimit. Mbi bazën e këtij sistemi sipas sëmundjeve përkatëse, mjekët e QSUNT të kontraktuar nga FSDKSH, lëshojnë receta rimbursimi elektronike e-Rx, receta të cilat pasi kontrollohen nga Drejtoria e Administrimit të Paketave Shëndetësore dhe Ekzaminimet Terciare (drejtori kjo e FSDKSH-së, e instaluar në QSUNT), konfirmohen dhe i kalojnë farmacisë për ekzekutim, dhënien e medikamenteve dhe pajisjeve mjekësore pacientëve për ekzekutim.

Ka rezultuar se, Farmacia, me paraqitjen e pacientit me recetë të lëshuar nga mjeku dhe e konfirmuar nga *Drejtorja e FSDKSH-së pranë QSUNT, ka bërë ekzekutimin e recetës, duke i dhënë pacientit barin ose pajisjen mjekësore, por pa lënë asnjë gjurmë auditimi.* Pra, nuk vërtetohet që bari ose pajisja është marrë nga pacienti, edhe pse këto barna dhe pajisje kanë çmim shumë të shtrenjta.

Konstatohet se kjo farmaci furnizohet nga importuesit, me faturë tatimore shitje (elektronike) sipas sistemit të fiskalizimit me NIPT të QSUNT dhe jo me NIPTI të FSDKSH, *fatura të cilat nuk bëhen hyrje në kontabilitetin e QSUNT, nuk bëhen hyrje dhe në kontabilitetin e FSDKSH,* por bën hyrje në programin kompjuterik E-RX në postin që mundësohet nga farmacistët e QSUNT, si rrjedhojë, në kontabilitet nuk regjistrohet ngjarja ekonomike.

Barnat e furnizuara nga Importuesit farmaceutikë, nuk merren në dorëzim nga grupi i ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm ose nga zyrtari i deleguar prej tij, siç bëhet dhe në farmacinë spitalore, por merren në dorëzim nga vetë punonjësit e farmacisë të sektorit të rimbursimit të barnave spitalore, edhe pse barnat dhe pajisjet mjekësore janë me çmime të shtrenjta.

Në 31 kontratat trepalëshe të lidhura ndërmjet QSUNT-së, FSDKSH-së dhe Importuesve Farmaceutikë “Për rimbursimin e barnave të tregtuara në farmacinë e QSUNT-së dhe në marrëveshjet (kontratat) dypalëshe për reduktimin e çmimit të barnave të LBR që tregtohen në farmacinë e spitaleve nga mbajtësi i autorizimit për tregtim, të lidhura ndërmjet FSDKSH-së dhe Importuesve Farmaceutikë, nuk është përcaktuar:

-*Afati i skadencës:* Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.

-*Paketimi:* Mbi çdo paketim duhet të jetë shënuar dhe vulosur mbishkrimi/pulla “Përdorim spitalor - ndalohet shitja”.

Përcaktime që janë vendosur në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe procedurat e zhvilluara nga QSUNT, duke aplikuar në këtë mënyrë standard të dyfishtë edhe në kushtet që çmime e këtyre barnave janë me shumë të shtrenjta.

Farmacia e QSUNT/Spitali, shkarkimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore e bën mbi bazën e recetës të lëshuar nga mjeku, receta të cilat konfirmohen nga Drejtoria e Administrimit të Paketave Shëndetësore dhe Ekzaminimet Terciare (Drejtori e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, e instaluar në QSUNT) duke bërë dhe rakordimet me FSDKSH-së. FSDKSH likuidon importuesit farmaceutikë. ***Pra, likuidimet e importuesve kryhen nga FSDKSH dhe jo nga QSUNT, e cila gjeneron shërbimin: vizitë pacienti, lëshim recetë, personel farmaceutikë, edhe pse faturat importuesit farmaceutikë, i lëshojnë për QSUNT.*** Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 8/1; kuadrin nënligjor mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, Udhëzimi e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35/a, b, c.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 348-369 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Të merren masa nga Drejtorët e Përgjithshëm të QSUNT dhe FSDKSH, që t’i kërkohet Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale krijimi i mekanizmave efektivë të monitorimit dhe mbikëqyrjes për të siguruar se palët përfituese jo vetëm duhet që të respektojnë obligimet për arsyeshmërinë e plotë të shpenzimeve të subvencionuara/ rimbursuara, por të vendosen dhe kontrollet e duhura me synim që bari/barnat për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), të regjistrohen dhe raportohen saktë në kontabilitet dhe pasqyrat financiare, për QSUNT por edhe për spitalet e tjera.

Menjëherë

1.2. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i QSUNT të merren masa për të korigjuar këtë praktikë për pranimin e barnave nga importuesit farmaceutikë, duke ngritur grupe pune për marrjen në dorëzim të tyre, me qëllim jo vetëm pranimin dhe marrjen në dorëzim me specialist të fushave, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.3. Rekomandimi: Të merren masa nga Drejtorët e Përgjithshëm të QSUNT dhe FSDKSH, për të rinegociuar kontratat/marrëveshjet në fuqi me importuesit farmaceutik, për të bërë amendimet përkatëse me qëllim për të përcaktuar detyrimet/ kërkesat mbi:

a. *Afatin e skadencës:* Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.

b. *Paketimin:* Mbi çdo paketim duhet të jetë shënuar barnat duhet detyrimisht të jenë edhe me vulën/pullën “Përdorim spitalor - ndalohet shitja”.

Brenda datës 31.03.2024

2. Gjetje nga auditimi: Janë audituar nga grupi i auditimit procedurat e zbatuara për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti, ku janë përzgjedhur 13 barna, konkretisht, bari me kod 710/96 “Palbociclib 125 mg”, bari me kod 631/335 “Infliximab 100 mg”, bari me kod 662/237 “Erelzi 25 mg” alternativ (Entanercept 25 mg), bari me kod 487/325 “Imatinib Accord 100 mg” alternativ (Imatinib 100 mg), bari me kod 732/92 “Ribociclib 200 mg” alternativ (Kisqali alternativë e parë), bari me kod 682/14 “Sorafenib 200 mg”, bari me kod 776/191 “Enzalutamide 40 mg alternativa e parë”, bari me kod 453/191 “Tacrolimus 1mg”, bari me kod 605/441 “Sevelamer Carbonate 800 mg”, barin me kod 705/92

“Dabrafenib 75 mg”, bari me kod 578/307 “Capecitabine 500mg”, bari me kod 487/325 “Imatinib Accord 100 mg”.

Për mungesën e këtyre barnave në farmaci, farmacistja e barnave të rimbursuara, ka njoftuar me e-mail QSUNT-në dhe QSUNT ka njoftuar FSDKSH-në, duke u shprehur në ligjëratë të drejtë se “...Importuesi nuk po furnizon farmacinë... .Theksojmë faktin se QSUNT, ka një numër pacientësh në pritje të barnave të lartpërmendura, të cilat janë të domosdoshëm për ecurinë e shëndetit të tyre”.

Referuar dokumentacionit, furnizimet janë bërë nga 12 deri në 34 ditë me vonesë, në kundërshtim me recetat e lëshuara nga mjekët, ku barna të tilla për sëmundjet tumorale, dializë dhe transplant kanë një përsëritje fikse, p.sh., çdo 10 ose 15 ditë.

Audituesit e autorizuar të KLSH theksojnë se bëhet fjalë për një numër të konsiderueshëm pacientësh që u është vonuar ky trajtim. Për rrjedhojë, menaxhimi dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuar më sipër, me veprimet dhe mosveprimet e tyre, nuk kanë maksimalizuar plotësisht eficientësinë dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike në lidhje me barnat e sipërcituara, ndërsa dëmi shëndetësor ndaj pacientëve është i pallogaritshëm dhe nuk ka pse të varet nga formalitetet burokratike të sistemit të shëndetësisë (Ministër, Bord Drejtues, Drejtor të Përgjithshëm QSUNT/FSDKSH etj).

Sa më sipër, këto veprime e mosveprime janë në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, Kreu II, Neni 4, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Shteti ushtron veprimtarinë e tij lidhur me kujdesin shëndetësor në mbështetje të këtij ligji dhe zotohet për të rregulluar dhënien, mbikëqyrjen dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor”.

-Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, neni 7, pika 1 ku është shprehur “Spitali publik ofron shërbim mjekësor për të sëmurët e shtruar në shtruar, si dhe shërbime mjekësore për të sëmurët ambulatorë, sipas kritereve të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 348-369 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Nga drejtorët e përgjithshëm të QSUNT/FSDKSH-së, të merren masa për të rinegociuar kontratat/marrëveshjet në fuqi me importuesit farmaceutikë për të bërë amendimet përkatëse, me qëllim përcaktimin e stokut (rezervës) të nevojshme në farmaci referuar numrit të pacientëve që trajtohen dhe të analizat e projeksioneve (pacientët e rinj), për të eliminuar riskun e mungesës dhe mos disponibilitetit të përkohshëm të barit/barnave për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti.

Brenda datës 31.03.2024

2.2. Rekomandimi: Pas përfundimit të kontratave/marrëveshjeve në fuqi nga Drejtorët e Përgjithshëm QSUNT/FSDKSH, të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë duke vlerësuar lidhjen e marrëveshjeve kuadër, për furnizimin me bar/barna në princip aktiv jo në emrin tregtar me disa Importues Farmaceutik, për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti.

Në vijimësi

2.3. Rekomandimi: Nga drejtorët e përgjithshëm të QSUNT/FSDKSH-së, të merren masa për të lidhur marrëveshje me homologët në vendet fqinje (Kosova, rajoni etj.), për të shkëmbyer bar/barna nga stoku (rezerva) i secilës palë në raste të mos disponibilitetit të bar/barnave për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti.

Brenda datës 30.06.2024

3. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 01.04.2021 deri më 31.12.2021, Komisioni Ndërsptalor ka dhënë 45 vendime, ndërsa për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 ka dhënë 58 vendime për pacientë që dërgohen për kurim jashtë vendit, në Turqi.

Nuk ka vendim/ose urdhër të ministrit për ngritjen e Komisionit Ndërsptalor për pacientë që dërgohen për kurim në Turqi, si dhe rregullore të organizmit dhe funksionimit të këtij komisioni. Pothuajse të gjitha epikrizat nga shërbimet spitalore, si dhe nga spitalet e tjera (SUT) në total 103 raste, janë trajtuar nga Zv/drejtori Teknik, pa kaluar nga Drejtori i Përgjithshëm. Pas vendimmarrjes së komisionit, drejtori i përgjithshëm ka marrë vendimin e tij dhe ja ka përcjellë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtorisë së Marrëdhënieve me jashtë).

Në QSUNT nuk ka një sistem një sistem të përcaktuar dhe transparent për organizimin dhe funksionimin e komisionit ndërsptalor për pacientët që dërgohen për kurim në Turqi. Ky sistem duhet të përfshijë një procedurë të qartë për ngritjen e komisionit, përcaktimin e përgjegjësive të anëtarëve, dhe dokumentimin e vendimeve të marra.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 325-335 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm ti kërkohet Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, vendimi ose urdhri të për ngritjen e komisionit ndërsptalor.

Menjëherë

3.2. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm ti kërkohet Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, hartimi i rregullores të organizmit dhe funksionimit të komisionit ndërsptalor, duke përfshirë përgjegjësitë e anëtarëve, procesin e vendimmarrjes dhe raportimin periodik.

Menjëherë

3.3. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për implementimin e një procesi të qartë dhe të dokumentuar për shqyrtimin dhe trajtimin e epikrizave nga personeli i caktuar, duke përfshirë kontrollin nga drejtori i përgjithshëm për të siguruar zbatimin e procedurave të duhura.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.4. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për përcaktimin i një sistemi monitorimi për të vlerësuar zbatimin e rekomandimeve dhe për të siguruar që proceset janë në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e aplikueshme. Ky rekomandim synon të adresojë mos rregullimet dhe të sigurojë një strukturë të përcaktuar dhe të qartë për veprimtarinë e komisionit ndërsptalor dhe trajtimin e dokumentacionit shëndetësor.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Komisioni Ndërsptalor në 2 raste ka marrë vendimmarrje të vonuar duke riskuar shëndetin e pacientëve.

a. Konkretisht, Spitali Universitar i Traumës me shkresën Nr. 475 prot, datë 01.03.2022, protokolluar në QSUNT me Nr. 832 prot., datë 03.03.2022, i është drejtuar komisionit ndërsptalor duke i përcjellë epikrizën mjekësore të pacientit B. Ç. Në epikrizë është shprehur në mënyrë eksplicite: se “Pacienti B. Ç është shtruar në SUT, pas një aksidenti automobilistik të ndodhur më datën 22.02.2021 me Nr. karte 2339 nga data 22.02.2021 deri në datën 13.04.2021 Pacienti vjen në gjendje shumë të rëndë dhe me rrezik për jetën. Pas reaminimit dhe mjekimit operohet nga *Fractura aperta cruris dexter dhe Fracture massive bacini me protrusion acetabuli sinistra*.

Komisioni ndërsptalor i mbledhur me datën 12.05.2022 vendosi që për specifikat që ky rast paraqet, i plotëson kriteret që të dërgohet në një klinikë më të specializuar jashtë vendit.

Vendimi është marrë me Nr. 22, datë 13.05.2022 nga drejtori i përgjithshëm, ku ka vendosur që pacienti B. Ç duhet të dërgohet në një klinikë më të specializuar jashtë vendit, pasi ka nevojë për

protezë totale coxofemorale speciale. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria e së Marrëdhënieve me Jashtë), i është përcjellë me shkresën Nr. 832/2 prot., datë 13.05.2022.

Pra, vendimmarrja dhe përcjellja në Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria e së Marrëdhënieve me Jashtë) është bërë **dy muaj e dhjetë ditë me vonesë**, edhe pse në epikrizë është shprehur: “Pacienti vjen në gjendje shumë të rëndë dhe me rrezik për jetën”.

b. Poli i Administrimit Spitali Francez, Shërbimi i Okulistikës, me shkresë datë 21.02.2022 të, firmosur nga mjeket okulist, protokolluar në QSUT Nr. 745 prot, datë 22.03.22 i është drejtuar komisionit ndërsptalor duke i përcjellë epikrizën mjekësore të pacientit A. H.

Komisioni ndërsptalor është mbledhur me procesverbal datë 01.04.2022 dhe vendosur që për specifikat që ky rast paraqet i plotëson kriteret që të dërgohet në një klinikë më të specializuar jashtë vendit.

Vendimi i marrë Nr. 122, datë 01.04.2022 nga drejtori i përgjithshëm, ku ka vendosur që pacienti A. H. duhet të dërgohet në një klinikë më të specializuar jashtë vendit, i është përcjellë me shkresën Nr. 745/2 prot., datë 01.04.2022.

Pra, vendimmarrja dhe përcjellja në Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria e së Marrëdhënieve me Jashtë) është bërë **39 ditë me vonesë**. Veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, Kreu II, “Përgjegjësitë e shtetit dhe të shtetasve” Neni 4, pika 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 325-335 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për trajtimin e epikrizave nga komisioni ndërsptalor, duke eliminuar trajtimin me standard të dyfishtë të pacientëve në punën e këtij komisioni.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Të gjitha vendimet e Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT dhe shkresat përcjellëse në Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria e së Marrëdhënieve me Jashtë), janë me vulë të Komisionit Ndërsptalor, vulë e cila nuk është prodhuar dhe sekretuar sipas dispozitave ligjore në fuqi, vulë e ndryshme nga ajo e QSUNT-së.

Pra, jo vetëm vendimet e drejtorit të përgjithshëm, por edhe shkresat përcjellëse për në ministri janë bërë me këtë vulë.

Ky komision nuk është person juridik që ushtron veprimtari në Republikën Shqipërisë dhe nuk detyrohet të ketë vulë zyrtare. Referuar VKM Nr.390, datë 6.8.1993, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”, pika 6, prodhimi i vulave bëhet në një ekzemplar të vetëm, të dhënat e të cilave regjistrohen në kompjuterin e Ministrisë së Rendit Publik. Kjo procedurë nuk u vu në dispozicion, pra nuk provohet që kjo vulë është prodhuar në subjekte të licencuara nga Ministria e Brendshme dhe e regjistruar nga kjo ministri.

Për periudhën 01.04.2021 deri 03.12.2022, të gjitha vendimet e drejtorit të përgjithshëm dhe shkresat përcjellëse në Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria e së Marrëdhënieve me Jashtë), janë me vulë të QSUNT-së, jo me vulën e komisionit ndërsptalor. Veprim në kundërshtim me VKM Nr. 390, datë 6.8.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”, pika 6.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 325-335 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të formalizuar vulën e komisionit ndërsptalor në organet përkatëse, në rast të kundërt të gjitha vendimet dhe shkresat

përcjellëse në Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria së Marrëdhënieve me Jashtë), të bëhen me vulën e QSUNT-së.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Organizmi dhe funksionimi i QSUNT-së bëhet në zbatim të VKM Nr. 66, datë 3.2.2017 ndryshuar me VKM Nr. 654, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Statuti është miratuar në zbatim të Urdhrit të Përbashkët Nr. 709, date 10.10.2018, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e Statutit të QSU “Nënë Tereza”.

Në kundërshtim me statutin, pika 9.2, të kreut III “Organizimi”, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me urdhër Nr. 369, datë 24.08.2021, ka urdhëruar ngritjen e bordit të QSUNT, me 5 anëtarë. Bordi Drejtues kryesohet Zv/ministri i Shëndetësisë.

Ky urdhër i ministrit për ngritjen e bordit është në kundërshtim me:

1. VKM Nr. 654, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, pika 2. Mënyra e funksionimit të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, si strukturë shëndetësore universitare, përcaktohet në statutin e saj, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

2. Urdhrit të Përbashkët Nr. 709, datë 10.10.2018, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e statutit të QSUNT “Nënë Tereza”, kreu III “Organizimi”, pika 9.2: *Bordi kryesohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.*

3. VKM Nr. 66, datë 3.2.2017 ndryshuar me VKM Nr. 654, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Për pasojë, të 7 vendimet e marra nga bordi janë të pavlefshme, përfshi edhe rregulloren e organizimit dhe funksionimit të QSUNT.

Veprimi i cili ngarkon me përgjegjësi znj. O.M. me detyrë ish-ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 325-335 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Nga organet drejtuese t’i kërkohet ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të bashkërendojë dhe koordinojë veprimtarinë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për rikompozimin e Bordit Drejtues në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe nën ligjor.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi:

a. Me urdhër të ministrit të Shëndetësisë Nr. 519, date 03.12.2021 “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, znj. A.F. është emëruar në detyrën Drejtor i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” deri në kryerjen e procedurave të konkurrimit në këtë pozicion pune. Në QSUNT nuk disponohet kontratë punësimi e përkohshme ose e përhershme me Drejtorin e Përgjithshëm znj. A.F..

Që prej datës 03.12.2021 deri më datën 31.05.2023, datë që ka përfunduar auditimi (18 muaj), QSUNT është drejtuar me Drejtor të përkohshëm dhe dy zv/drejtor përgjithshëm/teknik të përkohshëm. Veprime në kundërshtim me Statutin e QSUNT, kapitulli III, neni 13 “Drejtoria e Përgjithshme”,

✓ Pika 13.1, ku është shprehur se: “Drejtoria e Përgjithshme siguron drejtimin administrativ dhe institucional të QSU “Nënë Tereza”. Ajo drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm. Drejtoria menaxhon aktivitetin e përgjithshëm të shërbimeve, programon orientimet strategjike dhe siguron zbatimin e tyre”.

✓ Pika 13.2 ku është shprehur se: “Drejtoria e Përgjithshme përbëhet nga: Drejtori i Përgjithshëm dhe zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm”. Në statut, Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 286, datë 21.5.2018 “Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm”, në asnjë nen nuk përcaktohet “Drejtor dhe zv/Drejtor i Përgjithshëm i Përkohshëm”.

b. Me urdhër të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 198, datë 30.03.2022 “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, znj. N.S. është emëruar në detyrën e zv/drejtorit të përgjithshëm në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Nuk ka kontratë të lidhur ndërmjet drejtorit të përgjithshëm dhe zv/drejtorit të përgjithshëm znj. N.S., në kundërshtim me statutin e spitalit, Kreu IV, “Rregulla dhe procedura të punësimit dhe të vlerësimit”, pika 22. “Kontrata e Punës”. Veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr. 286, datë 21.5.2018 “Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 325-335 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Bordi Drejtues i Spitalit të ndërmarrë veprime institucionale për përcaktimin përfundimtar të statutit të punës të drejtorit dhe zv/drejtorëve të përgjithshëm, shpërblimit dhe lidhjes së kontratave.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha procedurat e prokurimit për periudhën objekt auditimi, për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, blerjen e pajisjeve mjekësore dhe barnave është vendosur kriteri favorizues i kualifikimit autorizim nga prodhuesi.

Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim ka orientuar operatorët ekonomik drejtëpërdrejtë një prodhuesi të caktuar në treg. Për pasojë, operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme ulin në mënyrë të ndjeshme konkurrencën, duke favorizuar vetëm operatorët ekonomikë të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.

Vendosja e këtij kriteri/specifikimi është në keqinterpretim me:

- Rekomandimin Nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore”, rekomandim i cili është përforcuar me shkresën Nr. 7988 prot., datë 24.12.2021, pika 12 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe e Monitorimit).

-Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 3 dhe 77, VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 93.

-Vendimin e Autoritetit të Konkurrencës Nr. 851, datë 03.12.2021 “Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”, pika 2.

-Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.

-Vendimin Nr.00-2015-315, datë 23.01.2015 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Autoriteti kontraktor në vijimësi duhet të hartojë kërkesat e veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mosdiskriminim dhe konkurrencë.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me objekt “*Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore për përballimin e nevojave ekstreme, deri në lidhjen e kontratës bazë të procedurave konkurruese* (me të drejtë shkëputje pa pasoja për Autoritetin Kontraktor me fond limit në vlerën 61,002,230 lekë pa TVSH për periudhën shkurt-shtator 2022, të ndarë në 49 lote sipas prodhuesve të pajisjeve mjekësore.

Përdorimi i kësaj procedure ka ardhur si rezultat i anulimit të procedurës së prokurimit, marrëveshje kuadër me fond limit 645,887,199 lekë pa TVSH me referencë REF-97398-06-04-2021 me objekt “*Menaxhim dhe mirëmbajtje e aparaturave mjekësore në QSUNT*” me afat 4 vjet (48 muaj), marrëveshje kuadër me një operator ekonomik .

Në vlerësimin e audituesve të pavarur, trajtimi si emergjencë nuk ka ardhur për shkaqet e parashikuara si më lartë, por si pasojë e mosvëmendjes së duhur institucionale dhe përgjegjësisë ndaj detyrës së strukturave të përfshirë në këtë proces, duke filluar nga menaxhimi i lartë drejtues.

-Autoriteti kontraktor, edhe pse në dokumentet e tenderit (termat e referencës) ka përcaktuar afatin 180 ditë me kushtin e ndërprerjes së kontratës pa pasoja për autoritetin kontraktor, në momentin e realizimit të procedurës konkurruese, deri në përfundimin e kontratave të nënshkuara nga kjo procedurë, nuk ka iniciuar asnjë procedurë prokurimi, duke provuar dhe njëherë se autoriteti kontraktor e kishte paracaktuar zhvillimin e një procedure me negocim pa shpallje, veprim në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 52, pika 1/c ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “...Me krijimin e nevojës ekstreme, autoriteti/enti kontraktor duhet njëkohësisht të marrë të gjitha masat për realizimin e procedurave normale të prokurimit”.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Procedura e prokurimit me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, duhet konsideruar si rast i veçantë dhe autoriteti kontraktor nuk duhet në asnjë rast të abuzojë me përdorimin e këtij instrumenti, me qëllim shtrembërimin e konkurrencës, por duhet të konsiderohet procedurë konkurrencte përjashtimore.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.2.Rekomandimi: Autoriteti kontraktor nëpërmjet procedurave të tjera të prokurimit, duhet të çojë në rritjen e integritetit në prokurimin publik, me efekt të drejtpërdrejtë në konkurrencën, në çmimin për blerjen e mallrave, shërbimeve apo kryerjen e një pune, të cilat kanë efekt të drejtpërdrejtë në shpenzimet e shtetit, pra në burimet e taksapaguesve.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Për mirëmbajtje full-risk të pajisjeve mjekësore, autoriteti kontraktor para shpalljes së procedurave, *nuk ka hartuar planin e mirëmbajtës së pajisjeve mjekësore për çdo vit*, plan i cili duhet miratuar nga komisioni mjekësor, kjo për faktin se numri i pajisjeve për

nevoja mirëmbajtje është shumë e madh dhe nuk mbulohet nga fondet e QSUNT-së. Komisioni Mjekësor duhet të kryente dhe klasifikimin e pajisjeve mjekësore në funksion të këtij procesi.

Në QSUNT nuk është mbajtur **Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM)**, në hard copy ose në kompjuter, historiku (kartelën) i plotë të pajisjes, ku të jenë të identifikuar: prodhuesi ose furnizuesi; numri serial; data e blerjes; vlera (reale ose të vlerësuar); të dhënat e historisë së riparimeve dhe të mirëmbajtjes; emri i personit që ka kryer riparimin; mirëmbajtjen; raportimi i problemeve me pajisjen mjekësore; përkrahimi i përgjithshëm i problemit ose i shërbimit të nevojitur; pjesët e këmbimit të përdorura gjatë riparimit/ mirëmbajtjes, por janë shënuar vetëm numrat inventarialë.

Në të gjitha kontratat e zbatimit, pjesët e dëmtuara pas zëvendësimit me të reja janë marrë nga kontraktorët e shërbimit, klauzolë cila nuk është përcaktuar në kontratë.

Specialistët e Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike nuk janë trajnuar nga QSUNT për njohjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, duke qenë në këtë mënyrë në kushte të pabarabarta në krahasim me specialistët e kontraktorëve, duke krijuar risk të lartë në monitorimin e kontratave dhe marrjen në dorëzim të shërbimit të mirëmbajtjes.

Veprime në kundërshtim me statutin e miratuar në zbatim të Urdhrit të Përbashkët Nr. 709, date 10.10.2018, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e Statutit të QSU "Nënë Tereza". Në këtë statut, kreu III, pika "Organizimi", pika 8 "Organet Drejtuese", 18/1, 18.3, 18.4; Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 122 "Rregullat që zbatohen për kontratën", pika 1 dhe Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korigjuar këtë praktikë për mirëmbajtje full-risk/ose jo të pajisjeve, me qëllim që para shpalljes së procedurave të prokurimit të jetë hartuar plani i mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore për çdo vit, plan i cili duhet miratuar nga komisioni mjekësor, si dhe të kryhet klasifikimi i pajisjeve mjekësore në të vogla dhe në të mesme.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.2. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të mbajtur Sistemin e Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM), i QSUNT, historinë e plotë të pajisjes (kartelën), si dhe pjesët e dëmtuara të pajisjeve mjekësore pas zëvendësimit me të reja nga kontraktorët e shërbimit, të futen në termat e referencës së prokurimit, të përcaktohen në kontratë dhe iu jepen n.q.s do t'i dëshirojnë kontraktorët duke i vlerësuar me vlerën e tregut.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.3. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa që specialistët e Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike të trajnohen me shpenzimet e QSUNT-së, për njohjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, duke rritur në këtë mënyrë kompetencën profesionale në monitorimin e kontratave dhe marrjen në dorëzim të shërbimit të mirëmbajtjes.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit me objekt: "Mirëmbajtje Full-Risk e pajisjeve mjekësore, për nevojat e QSUNT-së për 24 muaj" 62 lote, marrëveshje kuadër me fond limit 312,443,222 lekë, viti 2022, përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i referuar edhe alternativave të tjera/spitaleve private, veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285,

datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 76, pika 1 dhe 2 .

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Nga autoriteti kontraktor të merren masa që përllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik të vlerësohet si procedurë e rëndësishme, pasi nga zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik varet saktësia e kësaj vlere, por edhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit me objekt: “*Mirëmbajtje Full-Risk e pajisjeve mjekësore, për nevojat e QSUNT për 24 muaj*” 62 lote, marrëveshje kuadër me fond limit në vlerën 312,443,222 lekë, viti 2022, *furnizim vendosje të aparaturave mjekësore për Spitalin e Ri “Kabineti i Endoskopisë”, viti 2022, me fond limit në vlerën 18,882,000 lekë kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomikë nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë. Kjo, pasi oferta ekonomike e operatorit ekonomik “H.L.” shpk e datës 28.09.2022 mban shënimin: Pjesët e dëmtuara pas zëvendësimit me të reja do të merren nga “H.L.” shpk, shënim i cili është në kundërshtim me dokumentet e tenderit/Njoftimi i shkurtuar i kontratës, që nuk e parashikon këtë klauzolë. Veprim në kundërshtim Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” nenet 77, 87, 89, 90, 92 dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

12.1. Rekomandimi: Nga QSUNT t’i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomikë dhe ofertave të ofertuesve, pasi procesi i shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues e operatorëve është me rëndësi kapitale.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Vend ruajtja e dokumentacionit në arkivë nuk është e pajisur me matësa të temperaturës dhe lagështisë, pasi institucioni nuk ka ambiente të përshtatshme për arkivë, veprim në kundërshtim me VKM Nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e Rregullores së njëzuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” .

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 323-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për sigurimin e ambienteve të përshtatshme për ruajtjen e dokumentacionit arkivor, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Brenda datës 30.06.2024

14. Gjetje nga auditimi: Në kundërshtim me VKM Nr. 234, datë 20.04.2022, pika 10, germa “a”, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, ku përcaktohet se për punë të vështira dhe të dëmshme për shëndetin, punonjësve u jepet shtesa mbi pagën bazë mujore në përqindje të caktuara, QSUNT, nuk ka një përcaktim të shkallës së vështirësisë dhe dëmeve për pozicionet e punës të arkiv-protokollit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 323-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm t’i paraqesë kërkesë Institutit të Shëndetit Publik, për përcaktim të shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për pozicionet e punës të arkiv-protokollit por jo vetëm, që të përcaktojë vendet e punës të vështira e të dëmshme për shëndetin e punëmarrësve në QSUNT, si dhe shkallën e vështirësisë e dëmshmërisë për çdo vend pune; pas

përcaktimit të kësaj shkalle, të paraqesë kërkesën për miratim në ministrinë përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë dhe në ministrinë përgjegjëse për çështjet e punësimit, për shtesë mbi pagën bazë mujore në përqindje të caktuara.

Brenda datës 31.03.2024

15. Gjetje nga auditimi: Me vendim Nr. 245, date 01.07.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm është emëruar përgjegjësi i Sektorit të Auditit të Brendshëm.

Baza ligjore e përcaktuar në vendim, mbi të cilën është bërë emërimi është Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, VKM Nr. 555, datë 11.08.2011, i ndryshuar, Vendimet e Bordit Drejtues Nr. 7, datë 21.09.2015, Nr. 3, datë 05.02.2020, Nr. 1, datë 24.03.2021 dhe Nr. 5, datë 17.07.2020.

Në këtë bazë ligjore mungon dispozita ligjore detyruese dhe specifike për këtë pozicion pune, që është Ligji Nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” me ndryshimet vijuese të tij.

Për këtë pozicion pune:

-Mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimit dhe të rregullave të parashikuara në statut ose rregullore.

-Nuk është bërë deklarimi për vende të lira pune në Zyrën e Punësimit Tiranë, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në këtë pozicion pune (përgjegjës i sektorit të auditit).

-Mungon dokumentacioni i kërkuar nga QSUNT, që kandidati/kanidatët të plotësojnë kushtet për pozicionin e punës përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm.

Referuar dosjes personale, e punësuar znj. E. Ç. nuk zotëron certifikatën si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”, e cila lëshohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë si dhe përvojën 5-vjeçare në profesion. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 12/2023 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 11.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 85-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për emërimin e përgjegjësit të Sektorit të Auditit të Brendshëm, me qëllim që emërimi të bëhet me “Auditues të brendshëm në sektorin publik” të liçensuar nga Ministria e Financave, por edhe me përvojë 5-vjeçare në profesion.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Në QSUT nuk është organizuar dhe nuk funksionon Komisioni Mjekësor, veprim në kundërshtim me statutin e miratuar në zbatim të Urdhrit të Përbashkët Nr.709, datë 10.10.2018, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e Statutit të QSU "Nënë Tereza", pika 18 “Komisioni mjekësor i QSU "Nënë Tereza",

-Pika 18.1 ku është shprehur se: “Komisioni mjekësor është organ këshillimi teknik i Drejtorisë së Përgjithshme dhe përbëhet nga drejtorët e spitaleve, që funksionojnë brenda autoritetit spitalor të qarkut dhe shefat e shërbimeve ose përfaqësues të zgjedhur nga vetëshërbimet e këtyre spitaleve”.

-Pika 18.2 ku është shprehur: “Komisioni mjekësor kryesohet nga kryetari i zgjedhur me votim të fshehtë, në bazë të kriterëve të vendosura nga ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe ushtron veprimtarinë e tij për tre vjet”.

-Pika 18.3 ku është shprehur: “Komisioni mjekësor përbëhet nga 26 anëtarë, të cilët zgjidhen nga bordi, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme, sipas formulës: Drejtoria i propozon bordit kandidaturat për anëtarë të Komisionit mjekësor të QSUNT”, me një listë jo më të vogël

se dyfishi i numrit të vendeve që duhet të plotësohen, në të cilën kandidatët shefa shërbimesh nuk mund të jenë më shumë se 50 për qind”.

Veprim në kundërshtim me Statutin e miratuar me Urdhër të Përbashkët Nr. 709, datë 10.10.2018, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e statutit të QSU "Nënë Tereza", pika 18.1,18.2 dhe 18.3.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër ngarkon me përgjegjësi znj. O.M. me detyrë ish-ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe znj. M.R. me detyrë Zv/Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në cilësinë e Kryetares së Bordit të QSUNT.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 325-335 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Nga Bordi dhe Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për krijimin dhe funksionimin e Komisionit Mjekësor të QSUNT .

Brenda datës 31.03.2024

17.Gjetje nga auditimi: Është konstatuar se në të gjitha praktikat e zgjedhura për auditim në procedurat për prokurim me vlerë të vogël:

-Urdhri i prokurimit nuk ka të përcaktuar natyrën dhe sasinë e mallrave/shërbimeve, të cilat do të jenë objekt prokurimi, gjithashtu në urdhër përcaktohet fondi limit i procedurës, veprime në kundërshtim me pikën 8, Udhëzimi Nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

-Në dosjen e prokurimit administrohen dokumentet e kërkuara sipas ftesës për ofertë nga ana e OE, por ato nuk rezultojnë të dorëzuara sipas formës së kërkuar nga ligji, në zyrën e protokollit, në kundërshtim me pikën 17, Udhëzimi Nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

-Lidhur me procedurën “F.V. sinjalistika e brendshme për godinën e re të pediatrisë, ndërtuar me kredi të Bankës Botërore”, është konstatuar se sipas kërkesës të ftesës për ofertë, certifikata ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” rezulton e noterizuar më datë 14.12.2021, kur Kontrata rezulton e nënshkruar në datën 13.12.2021. Autoriteti kontraktor ka shpallur ofertën fituese dhe ka lidhur kontratë duke mos pasur sigurinë nëse operatori ekonomik i plotëson apo jo të gjitha kriteret, veprim në kundërshtim me parashikimet për ftesën për ofertë.

-Lidhur me procedurën “Blerje tonerash për 60 ditë, me kusht ndërprerje me ardhjen e autorizimit nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara për lidhjen e kontratës bazë me të njëjtin objekt prokurimi”, përkatësisht për vitin 2021 dhe për vitin 2022, u konstatua se në të dyja rastet, në kriteret e kualifikimit është vendosur kriteri “OE duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar për zërat e tonerave me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon operatorin ekonomik të ofrojë këta artikuj në këtë procedurë prokurimi”, kriter i vendosur në kundërshtim me Vendimin Nr. 814, datë 02.09.2021 “Për disa rekomandime Agjencisë së Prokurimit Publik në lidhje me procedurat e prokurimit publik me objekt blerje tonera/bojra” të Autoritetit të Konkurrencës dhe pikës 12, të shkresës Nr. 7998 prot., datë 24.12.2021 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Komisioni i blerjeve me vlera të vogla të procedojë me shpalljen e OE fitues pasi të sigurohet se i gjithë dokumentacioni i kërkuar është depozituar dhe është në përputhje të plotë me kërkesat e AK.

Në vijimësi

17.2. Rekomandimi: Komisioni i blerjeve me vlera të vogla të procedojë me shpalljen e OE fitues pasi të sigurohet se i gjithë dokumentacioni i kërkuar është depozituar dhe është në përputhje të plotë me kërkesat e AK.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Poli i Aktivitetit të Integruar të Spitalit Polivalent, Urgjenca e Sëmundjeve të Brendshme dhe Poli i Administrimit të Integruar të Neuroshkencës, Shërbimi i Neurokirurgjisë i është drejtuar DITIK dhe i arsyeton nevojën për vendosje në dispozicion të 4 EKG-ve gjatë ushtrimit të punës, pasi pajisja që disponojnë është jashtë funksionit. Lidhur me mosfunksionimin e EKG-së rezulton se, nuk disponohet asnjë gjurmë auditimi/dokumentare nga DITIK që jetë ngritur një grup pune mbi defektet e konstatuara dhe nxjerrjen jashtë funksionit, veprime në kundërshtim me parashikimet e detyrave dhe përgjegjësive specifikuar në rregulloren bazë të funksionimit të QSUNT-Tiranë.

-Në kriteret për kualifikim nuk është parashikuar detyrimi që pajisja duhet të jetë e regjistruar në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore që mbahet nga Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, sipas parashikimeve të nenit 13, Ligji Nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”, duke rrezikuar që të merren në dorëzim katër pajisje mjekësore të pacertifikuara nga AKBPM-ja. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e IT-së dhe Inxhinierisë Klinike të marrë masa që në rastet e mosfunksionimit të pajisjeve mjekësore të ngrejë grup pune me qëllim identifikimin e defekteve të konstatuara, duke përcaktuar nëse pajisja ka nevojë për mirëmbajtje apo nxjerrjen jashtë funksionit dhe vetëm pas kryerjes së kësaj procedure të vijojë me procedurën për blerjen e pajisjeve zëvendësuese sipas rastit.

Në vijimësi

18.2. Rekomandimi: Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, i ngritur sipas rastit të marrë masa që në çdo procedurë të blerjeve të pajisjeve mjekësore, në kriteret për kualifikim të vendosë si kriter që pajisja duhet të jetë e regjistruar në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore që mbahet nga Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Dokumentimi i dorëzimit të mbetjeve në ambientet e hidroklavës, e cila kryen funksionin e magazinës për mbajtjen e përkohshme të mbetjeve të rrezikshme deri në momentin e dorëzimit tek operatori ekonomik, për të tria procedurat *(trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta/mbetje që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19)* kryhej me anë të regjistrave. Në pjesën më të madhe të regjistrave konstatohet se nuk plotësohej origjina e mbetjeve, lloji i materialit dhe sasia në kg e mbetjeve nga ana e personelit infermieror, që është përgjegjës për garantimin e ndarjes, manipulimit dhe trajtimit përfundimtar të mbetjeve të rrezikshme spitalore të gjeneruara si rezultat i trajtimit të pacientëve, në përputhje me legjislacionin kombëtar, veprim në kundërshtim me urdhrin Nr. 40, datë 13.02.2014 “Për ndarjen e mbetjeve spitalore në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Mospasqyrimi në formën e kërkuar bën të pamundur rakordimin ndërmjet peshës së dorëzuar nga secili shërbim dhe peshës së dorëzuar operatorit ekonomik.

-Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezultoi se QSUNT, në cilësinë e prodhuesit të mbetjeve të rrezikshme, nuk ka marrë asnjë masë për të hartuar një program për uljen e vëllimit, të sasisë dhe toksicitetit të mbetjeve të rrezikshme, në kundërshtim me shkronjën a), pika 3, neni 7, Ligji Nr. 9537, 18.05.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”.

-QSUNT nuk ka marrë asnjë masë për ngritjen e grupit të administrimit të mbetjeve spitalore (GAMS), duke ndikuar kryesisht në monitorimin e zbatimit të Planit të Administrimit të Mbetjeve Spitalore, veprim në kundërshtim me rregulloren “Mbi administrimin e mbetjeve spitalore” në QSUNT.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Personeli infermieror të marrë masa që në çdo rast që kryhet dorëzimi i mbetjeve të rrezikshme të plotësojë regjistrat me të gjithë elementët e tyre: origjina e mbetjeve, lloji i materialit, sasia në kg, data e dorëzimit dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm që lidhet me këtë proces.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.2. Rekomandimi: QSUNT të marrë masa për ngritjen e grupit të administrimit të mbetjeve spitalore (GAMS), me qëllim zbatimin me efikasitet dhe efektivitet të Planit të Administrimit të Mbetjeve, si edhe hartimin dhe zbatimin e një programi për uljen e vëllimit, të sasisë dhe toksicitetit të mbetjeve të rrezikshme, me qëllim uljen e ndikimit në mjedis, shëndet publik dhe të kostove financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për të tria procedurat e asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore konstatohet se nuk argumentohet kërkesa e AK për të dhënat e frigoriferit të instaluar: kapacitet 200-250 kg, temperaturë ngrirje deri në minus -18 gradë celsius, edhe pse instalimi i një frigoriferi është detyrim ligjor që rrjedh nga pika 10.2.15, rregullorja “Mbi administrimin e mbetjeve spitalore në QSUNT”, por kjo rregullore nuk ka përcaktuar të dhënat e rrëgjimit të temperaturës së frigoriferit apo kapacitetit mbajtës, si rrjedhojë ky kriter konsiderohet i paargumentuar ligjërisht dhe teknikisht.

-Për procedurën “*Trajtim i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta për nevojat emergjente të QSUNT-së deri në 31 dhjetor 2021*” gjatë vlerësimit të ofertave konstatohet se OE i shpallur fitues nuk ka vërtetuar me dokumentacion provues pronësinë e impiantit, sipas kërkesës në ftesën për ofertë.

-Në të gjitha procedurat konstatohet se Certifikatat ISO të lëshuara në favor të OE, nga kompania K.C.I.C. Ltd, janë të vlefshme për një periudhë 3-vjeçare, por me kusht nëse ky sistem është mirëmbajtur në mënyrë efektive dhe të jenë kryer auditime mbikëqyrëse. Pra, këto certifikata konsiderohen të vlefshme vetëm nëse plotësohet kushti i kryerjes së auditimeve mbikëqyrëse. Nga ana e AK nuk figuron i dokumentuar konfirmimi nëse është plotësuar apo jo kushti dhe si rrjedhojë nëse këto certifikata janë apo jo të vlefshme. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1. Rekomandimi: Personat përgjegjës të hartimit të kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, në çdo rast duhet t’i argumentojnë teknikisht dhe ligjërisht.

Në vijimësi

20.2. Rekomandimi: Komisioni i vlerësimit të ofertave, përpara kualifikimit të operatorit fitues, në çdo rast të sigurohet për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar dhe verifikimin e certifikatave që janë lëshuar me kusht vlefshmërie.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se në procedurat: *Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta për QSUNT-në për vitin 2021 dhe 2022, si dhe trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19*, për realizimin e këtyre procedurave duhet të ishin vendosur edhe kritere të tjera kualifikuese, në mbështetje të parashikimeve të kuadrit ligjor që rregullon procedurën e prokurimit publik, sipas së cilit kriteret e vendosura nga OE duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe në mbështetje të kuadrit ligjor rregullator të asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme. Gjithashtu, duke pasur në vëmendje pasojat që rrjedhin nga mos realizimi i këtij procesi në mënyrë të rregullt, si dhe cilësinë e QSUNT-së e cila në këtë proces është në cilësinë e prodhuesit të mbetjeve spitalore dhe si rrjedhojë është përgjegjëse për të gjithat dëmet që shkaktohen në mjedis dhe në shëndetin publik nga të gjitha hallkat e procesit deri në asgjësim të mbetjeve duhet të ishin vendosur gjithashtu edhe kriteret:

-Në rast të transportit brenda vendit, operatori duhet të paraqesë certifikatën e miratimit për mjetet (vetëm për brenda vendit) që transportojnë disa mallra të rrezikshme (*konstatuar vetëm në procedurën e vitit 2022 dhe asgjësimi i mbetjeve të trajtimit të pacientëve me Covid-19*).

-Për mjetin e transportit duhet të ishte kërkuar gjithashtu vërtetim se mjeti është regjistruar në ministri për kryerjen e transportit të mbetjeve të rrezikshme.

-Operatorit duhet t'i ishte kërkuar të paraqiste akt miratimi higjeno-sanitar, të lëshuar nga Inspektorati Shëndetësor Shtetëror (ISHSH).

-Duhet të ishte kërkuar që personeli i përfshirë në ngarkimin e koshave/kontejnerëve tranzit të jetë kompetent dhe i trajnuar siç duhet.

-Duhet të ishte kërkuar se OE duhet të dorëzojë mbetjet e dala nga përpunimi në një subjekt të licencuar për depozitimin e hirit (konstatuar vetëm në procedurën e vitit 2021). Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10 463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, pika 2, 3 dhe 4, neni 21 dhe VKM 798, datë 29.9.2010 "Për miratimin e rregullores" Për administrimin e mbetjeve spitalore", shkronja e), pika 5, kreu II.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1. Rekomandimi: Komisioni i hartimit të kërkesave për kualifikim, në procedurat e prokurimit me objekt "Asgjësimi i mbetjeve spitalore të rrezikshme" të marrë masa për përcaktimin si kritere kualifikuese, ndër të tjera: certifikatë e miratimit për mjetet (vetëm për brenda vendit) që transportojnë disa mallra të rrezikshme, vërtetim e mjetit të regjistruar në ministri për kryerjen e transportit të mbetjeve të rrezikshme, paraqitja e akt miratimit higjeno-sanitar lëshuar nga Inspektorati Shëndetësor Shtetëror; personeli i përfshirë në ngarkimin e koshave/kontejnerëve tranzit të jetë kompetent dhe i trajnuar, OE të dorëzojë mbetjet e dala nga përpunimi, në një subjekt të licencuar për depozitimin e hirit me qëllim uljen e dëmeve që shkaktohen në mjedis dhe në shëndetin publik.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se në procedurën e prokurimit me objekt "Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta për QSUNT-në, për 12 muaj", viti 2021 bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar, dokumentacioni që shërben për shlyerjen e faturës dhe që i bashkëlidhet urdhër shpenzimeve përkatëse janë: situacioni, proces-verbal, konfirmim mbi asgjësimin e tyre. Në zbatim të kriterit mbi procedurën që vijon për depozitimin e hirit, në të gjitha konfirmimet, OE shprehet se: "...kg mbetje anatomike të lëngëta dhe të ngurta të cilat janë asgjësuar të gjitha brenda 30 ditëve nga marrja

në dorëzim e tyre". Në kuptim të sa më sipër, asgjësimi i hirit do të kryhet nga shoqëria "A.E." sh.p.k., me të cilën OE ka lidhur marrëveshje të datës 23.11.2020, me afat 6 (gjashtë) mujor duke filluar nga data e nënshkrimit të saj me të drejtë ripërtëritje në momentin që kushtet e kësaj kontrate nuk janë shkelur. Në vijim të aktmarrëveshjesë sipërcituar, OE nuk përcjellë asnjë dokument justifikues për të vërtetuar se marrëveshja është ende në fuqi. Si rrjedhojë, edhe pse shërbimi i kërkuar dhe i paguar nga ana e AK është trajtim dhe asgjësim, pra përfshirë edhe trajtimin e hirit të prodhuar, nuk dokumentohet përmbushja e detyrimeve.

Në mungesë të dokumentacionit të depozitimit të hirit të përfituar nga procesi i trajtimit të mbetjeve spitalore, nuk administrohet informacion mbi vend depozitimit të këtyre mbetjeve të cilat, nisur nga specifikat, mund të kenë ndikim të lartë në mjedis e në shëndetin publik. Nuk konstatohen gjurmë auditimi/dokumentacioni me qëllim vërtetimin e asgjësimit të mbetjeve, shiritat e incineratorit për të vërtetuar realizimin e kontratës, në përputhje me pikën 14, specifikimet teknike, DST "*Marrësi në dorëzim dërgon një informacion në sektorin që ndjek kontratën mbi realizimin e asgjësimit të mbetjeve anatomike të lëngëta dhe të ngurta, në çdo fund muaji*". AK ka shlyer në mënyrë të plotë detyrimet që rrjedhin si pasojë e zbatimit të kontratës, edhe pse nuk ka marrë siguri lidhur me realizimin e shërbimit të kërkuar, por është mjaftuar vetëm në konfirmimet e përcjella nga OE, të cilat janë në formë vetëdeklarimi.

-Nga auditimi është konstatuar se në procedurën e prokurimit me objekt "Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta, për QSUNT-në për vitin 2022" në të gjitha deklaratat e magazinimit, OE shprehet se: "... *mbetjet do të asgjësohen pranë subjekteve të licencuara sipas kontratës së lidhur me shoqërinë B.A.*". Në kuptim të sa mësipërm, asgjësimi i hirit është kryer nga shoqëria "B.A.". Gjithashtu, OE, në zbatim të pikës 15, të termave të referencës DST, sipas së cilës "*O.E duhet të dorëzojë mbetjet e dala nga përpunimi, në një subjekt të licencuar për depozitimin e hirit*" ka paraqitur pranë AK kontratë transferimi, rikuperimi dhe/ose asgjësimi të mbetjeve të lidhur ndërmjet "V.A.L.E. R."shpk dhe "B." Srl. Për të cilën ka përcjellë dhe dokumentacionin provues që vërteton se subjekti është i licencuar për të trajtuar produktin e dalë nga incinerimi (hi) dhe në vijim nuk ka përcjellë asnjë dokument tjetër justifikues (kontratë, licencë) për marrëdhënien e krijuar me shoqërinë "B.A.". Si rezultat është e paqartë ecuria e procesit të trajtimit të këtyre mbetjeve (hirit të krijuar), nëse ai dorëzohet pranë një subjekti të licencuar për ta trajtuar apo jo. Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në fund të çdo muaji OE përcjellë konfirmimin e asgjësimit të cilin e shoqëron me shiritat e incineratorit për të vërtetuar realizimin e kontratës, në përputhje me pikën 14, specifikimet teknike, DST "*Marrësi në dorëzim, dërgon një informacion në sektorin që ndjek kontratën mbi realizimin e asgjësimit të mbetjeve anatomike të lëngëta dhe të ngurta, në çdo fund muaji.*" Në formë tabelare është paraqitur informacion i përmbledhur për periudhën Prill-Gusht 2022 mbi sasinë e tërhequra dhe sasinë e asgjësuar me incinerim nga ana e OE. Si pasojë e rakordimeve është konstatuar një diferencë prej 1,708.1 kg, e cila nuk provohet e asgjësuar, si rrjedhojë AK nuk merr sigurinë e duhur që shërbimi i kërkuar dhe i paguar gjithashtu është ofruar sipas kushteve të rëna dakord.

-Nga auditimi është konstatuar se në procedurën e prokurimit me objekt "*Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19, marrëveshje kuadër me afat 12 muaj*", gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vendosur në dispozicion në DST (shtojçë për ndryshime në DST) është kërkuar:

Leje Mjedisore Tipi B (Kodi III.1.B) ku të ketë të përfshirë metodën e autoklavimit/hidroklavimit për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore ose stacion transferimi mbetjesh në rastin kur OE/BOE deklaron se këto mbetje do të transferohen/asgjësohen jashtë territorit të RSHM dhe/ose Leje Mjedisore të Tipit A (Kodi III.1.C) ku të ketë të përfshirë metodën e

inceneratorit për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore ose stacion transferimi mbetjesh në rastin kur OE/BOE deklaroi se këto mbetje do të transferohen/asgjësohen jashtë territorit të RSHM. Gjatë hartimit të kriterëve të kualifikimit, AK sqaron në procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim se: “...ka marrë për bazë shkresën e ISHP-së, e cila i ka drejtuar që trajtimi dhe asgjësimi të kryhet me metodën e hidroklavës/ autoklavës dhe incenerimit...”. Edhe pse është bazuar në këtë shkresë, ka kërkuar që OE ti paraqesë të dyja Lejet ose njërën prej tyre, pra duke e lënë në diskrecion të OE. Ndërkohë që meqenëse OE kërkon të kryhen të dyja proceset pra hidroklave/autoklavë dhe incenerim, referuar kuadrin ligjor në fuqi detyrimisht të dyja OE duhet të jetë i pajisur me të dyja lejet për kodin përkatës 18 01 02.

-Gjatë shqyrtimit të dokumenteve të depozituar nga OE fitues rezultoi se në Lejen e Mjedisit tipi B, me Nr. identifikimi 1780/3, datë 06.04.2021 nuk e ka të drejtën e asgjësimit/trajtimin të mbetjeve me kod 18 01 02 (referuar tabelës 8.1.2). Referuar mungesës së lejes për trajtimin e mbetjeve me kod 18 01 02 me hidrokavë/autoklavë, si dhe në mbështetje të faktit se OE nuk ka përcjellë asnjë dokument vërtetues se janë kryer të dyja proceset (gjatë procesit të punës me hidrokavë/autoklavë dhe incenerim), konsiderohet se procesi i hidrokavës nuk provohet të kryhet nga ana e OE, edhe pse QSUNT e paguan si shpenzim të plotë. Në të gjitha deklaratat e magazinimit, OE shprehet se “Referuar pikës 1.5.29, të Lejes Mjedisore ... mbetjet do të asgjësohen pranë subjekteve të licencuara sipas kontratës së lidhur me shoqërinë B.A.”. Në kuptim të sa mësipërm, asgjësimi i hirit do të kryhet nga shoqëria B.A. OE, në zbatim të pikës 12, të termave të referencës DST, sipas së cilës “OE duhet të dorëzojë mbetjet e dala nga përpunimi, në një subjekt të licencuar për depozitimin e hirit” ka paraqitur pranë AK kontratë transferimi, rikuperimi dhe/ose asgjësimi të mbetjeve të lidhur ndërmjet “V.A.L.E. R.” shpk dhe “B.” Srl. Për të cilën ka përcjellë dhe dokumentacionin provues që vërteton se subjekti është i licencuar për të trajtuar produktin e dal nga incenerimi (hi) dhe në vijim nuk ka përcjellë asnjë dokument tjetër justifikues (kontratë, licencë) për marrëdhënien e krijuar me shoqërinë Ambiente. Si rezultat është e paqartë ecuria e procesit të hirit të krijuar, nëse ai dorëzohet pranë një subjekti të licencuar për ta trajtuar apo jo. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit përpara nënshkrimit të kontratës me OE që do të trajtojë mbetjet e rrezikshme spitalore, të sigurohet nëpërmjet strukturave përgjegjëse se përgjatë periudhës që kontrata do të jetë në fuqi OE të ketë një marrëdhënie kontraktuale me një subjekt që do të kryejë asgjësimin e hirit. Gjithashtu, në çdo rast strukturat përgjegjëse të vijojnë me dokumentacionin justifikues për shlyerjen e faturës, vetëm pasi të sigurohen se hiri i prodhuar është asgjësuar, duke marrë siguri të plotë se hallka e fundit e procesit të asgjësimit ka përfunduar me sukses.

Menjëherë dhe në vijimësi

22.2. Rekomandimi: QSUNT në çdo rast përpara shlyerjes së faturës me OE, i cili ka marrë përsipër trajtimin e mbetjeve të rrezikshme, të sigurohet me anë të dokumenteve provuese se procesi i trajtimit (me incenerim apo hidrokavë/autoklavë) për të gjithë sasinë e mbetjeve të dorëzuara ka përfunduar me sukses.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se: QSUNT, për të realizuar trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19, ka vendosur që këtë shërbim ta prokurojë. QSUNT ka në pronësi të saj një pajisje “Hidrokavë” me nr.serial HSC-091215112, model H-15, prodhues H., me qëllim trajtimin e mbetjeve. Si

rrjedhojë, QSUNT është pajisur me akt miratimi, leje mjedisi tipi B, me Nr. identifikimi të lejes 1819, datë 26.03.2015. Bazuar në lejen e sipërcituar, QSUNT-së i është njohur e drejta për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme, përveç incenerimit ose lëndfillit. Ndër të tjera, objekt i kësaj leje është edhe asgjësimi i mbetjeve me kod 18 01 02 (pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut) dhe kod 18 01 03 (mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet). Me anë të shkresës nr. 578/65 prot., datë 11.03.2020, QSUNT i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor dhe Institutit të Shëndetit Publik lidhur me mbetjet spitalore të prodhuara nga rastet e pacientëve me Covid-19, të cilat i ka konsideruar potencialisht të rrezikshme, përkatësisht: Pajisjet personale mbrojtëse (PPE) të stafit që ekspozohet ndaj Covid-19 dhe ambalazhet ushqimore njëpërdorimshme, shishet plastike dhe çdo lloj mbetje tjetër që gjenerohet nga kontakti me pacientin e konfirmuar me Covid-19. Gjithashtu, me anë të kësaj shkrese ka bërë me dije se referuar specifikimeve teknike të aparaturës së trajtimit të mbetjeve (hidroklavë), që disponojnë nuk është i mundur trajtimi i tyre. Nga auditimi u konstatua se shkresa nuk mbështetej në asnjë relacion që të pasqyronte arsyet e mos realizimit dot të kësaj procedure me anë të hidroklavës e cila disponohet dhe është në gjendje pune nga QSUNT, edhe pse punonjës të QSUNT deklaruan se hidroklava ishte testuar për ta kryer këtë proces paraprakisht, por nuk kishte rezultuar e suksesshme (për këtë testim nuk rezultoi i mbajtur asnjë procesverbal). Në përgjigje të saj, Instituti i Shëndetit Publik, me anë të shkresës 578/67 prot., datë 12.03.2020 ka bërë me dije se trajtimi i këtyre mbetjeve duhet të bëhet me metodën e hidroklavimit dhe incenerimit. E iniciuar nga informacioni i përcjellë nga QSUNT, se bazuar në specifikimet teknike të hidroklavës që disponohet nga QSUNT, nuk është i mundur trajtimi dhe menaxhimi i tyre, sugjeron që këto mbetje duhet të trajtohen me incenerim dhe kuadrin ligjor që rregullon këtë proces (rekomandimet e O.), ISHP orienton QSUNT drejt përdorimit të hidroklavës dhe në pamundësi të përdorimit të saj drejt incenerimit, pra nënkupton që mjafton një prej metodave dhe jo detyrimisht të dyja. Mbështetur në sa mësipër, si dhe referuar informacionit të përfituar nga regjistri i mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore nga shërbimi i ofruar nga OE “M. ”, rezultoi se pajisja hidroklavë me nr. serial HSC-091215112 nuk ka shfaqur asnjëherë problematika përgjatë vitit 2022 dhe ka rezultuar në gjendje normale pune në përputhje me rekomandimet e prodhuesit. Procesverbalet për mirëmbajtjen funksionale janë firmosur nga përfaqësues të OE dhe përgjegjësi i Sektorit Teknik pranë QSUNT-së. Si rrjedhojë, ndodhur në kushtet e mësipërme QSUNT-ja i kishte të gjitha mundësitë për ta kryer procesin me anë të hidroklavës që disponon dhe të mos vijonte procedurat e prokurimit, e cila i ka kushtuar në total 2.678.780 lekë (hidroklavë dhe incenerim).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të QSUNT-së të marrin masa për mbetjet spitalore që mund të trajtohen me hidroklavë, ta kryejë vetë si proces pa qenë i nevojshëm prokurimi i këtij shërbimi. Në rastet kur pajisja “hidroklavë” nuk ka kapacitet të mjaftueshëm ose paraqet defekt, të argumentohet nga personat përgjegjës dhe t’i drejtohen OE i cili ka lidhur një marrëdhënie kontraktuale me QSUNT-në për mirëmbajtjen e pajisjeve me qëllim rregullimin e defektit të ndodhur dhe mire përdorimin e fondeve publike.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Me anë të shkresës Nr. 578/65 prot., datë 11.03.2020 QSUNT i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor dhe Institutit të Shëndetit Publik lidhur me mbetjet spitalore të prodhuara nga rastet e pacientëve me Covid-19, të cilat i ka konsideruar potencialisht të rrezikshme, përkatësisht: pajisjet personale

mbrojtëse (PPE) të stafit që ekspozohet ndaj Covid-19 dhe ambalazhet ushqimore një përdorshme, shishet plastike dhe çdo lloj mbetjeje tjetër që gjenerohet nga kontakti me pacientin e konfirmuar me Covid-19. Gjithashtu, me anë të kësaj shkrese ka bërë me dije se referuar specifikimeve teknike të aparaturës së trajtimit të mbetjeve (hidroklavë) që disponojnë nuk është i mundur trajtimi i tyre. Në përgjigje të saj, Instituti i Shëndetit Publik, me anë të shkresës Nr.578/67 prot., datë 12.03.2020 ka bërë me dije se trajtimi i këtyre mbetjeve duhet të bëhet me metodën e hidroklavimit dhe incenerimit. E iniciuar nga informacioni i përcjellë nga QSUNT se bazuar në specifikimet teknike të hidroklavës që disponohet nga QSUNT nuk është i mundur trajtimi dhe menaxhimi i tyre, sugjeron që këto mbetje duhet të trajtohen me incenerim, pra ISHP orienton QSUNT-në drejt përdorimit të hidroklavës dhe në pamundësi të përdorimit të saj drejt incenerimit, pra nënkupton që mjafton një prej metodave dhe jo detyrimisht të dyja. Mbështetur në sa mësipër, QSUNT ka vendosur që mbetjet që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19, t'i trajtojë me të dyja metodat, pra hidroklavë dhe incenerim, si dhe ta prokurojë këtë shërbim. Ndodhur në kushtet e mësipërme, shkresa e ISHP-së me Nr. 578/67 prot., datë 12.03.2020, lë hapësirë për keqinterpretim, pasi në fillim e drejton subjektin të përdorë detyrimisht të dyja metodat, përkatësisht hidroklavimi dhe incenerim dhe në vijim arsyeton se meqenëse QSUNT nuk e ka të mundur përdorimin e hidroklavës (të paargumentuar mbi arsyet), kjo e fundit mund t'i drejtohet vetëm metodës së incenerimit. Si pasojë e keqinterpretimit, QSUNT ka vendosur t'i trajtojë mbetjet e prodhuara nga rastet e pacientëve me COVID-19, duke prokuruar shërbimin me të dyja metodat.

Shkresa Nr. 578/67 prot., datë 12.03.2020 e Institutit të Shëndetit Publik nuk është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, përkatësisht rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, e cila referuar udhëzimeve mbi menaxhimin e Covid-19 ka përcaktuar se “alternativat e trajtimit të mbetjeve të prodhuara nga rastet e pacientëve me Covid-19 janë me autoklavë ose incenerim”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1. Rekomandimi: ISHP të konsultohet me strukturat përkatëse të Organizatës Botërore të Shëndetësisë lidhur me rekomandimet e përditësuara për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të prodhuara nga rastet e pacientëve me Covid-19 dhe në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi që rregullon këtë fushë të udhëzojë subjektet që prodhojnë mbetje nga rastet e pacientëve me Covid-19 me metodën e duhur të trajtimit dhe asgjësimit.

Menjëherë

25. Gjetje nga auditimi: Bordi Drejtues i QSUNT-së për periudhën objekt auditimi nuk ka miratuar projektbuxhetin apo raportin vjetor të veprimtarisë financiare të QSUNT-së, në kundërshtim me përcaktimet e VKM Nr. 66, datë 3.2.2017 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen dhe organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”, pika 10, germa “a” dhe “c”; me statutin e QSUNT-së, kreu III, pika 10 e tij; në kundërshtim urdhrin e përbashkët nr. 709 të MSHMS-së dhe MARS “Për miratimin e statutit të QSUNT-së”, pika 10, germa “a”, si dhe urdhrin e Ministrit të MSHMS-së Nr. 369, datë 24.08.2021, “Për ngritjen e bordit drejtues të spitalit universitar QSU “Nënë Tereza”, pika 3 germa “a”.

Drejtori i Përgjithshëm nuk ka propozuar dhe dërguar për miratim në Bordin Drejtues të QSUNT-së projektbuxhetin për PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024 dhe raportin vjetor për vlerësimin e veprimtarisë financiare, në kundërshtim me urdhrin e përbashkët të MSHMS dhe MARS nr. 709, datë 10.10.2018 “Për miratimin e Statusit të QSUNT”, pika 10, germa “ç”, dhe neni 15 germa “d”, si dhe urdhrin e Ministrit të MSHMS Nr. 369, datë 24.08.2021 “Për ngritjen e

Bordit Drejtues të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT), Tiranë, pika 3, germa “a”.

Shpenzimet operative në PBA 2021-2023 parashikohen 16,140,429 mijë lekë. Buxheti i alokuar me disa rishikime përgjatë vitit buxhetor paraqitet në shumën prej 8,728,088 mijë lekë ose 7,402,341 mijë lekë ose 45.86% më pak se kërkesat në PBA. Ndryshimi më i madh paraqitet në zërin e shërbimeve për 7,402,341 mijë lekë ose 58.11% më pak se parashikimi buxhetor. Struktura e ndarjes të zërave të shpenzimeve operative nuk është e njëjtë me strukturën e paraqitur në kërkesat buxhetore në fazën e PBA. Në totalin e buxhetit të QSUNT-së për vitin 2021 në shumën 8,815,600 mijë lekë, siç mund të konstatohet pjesën më të madhe e zënë shpenzimet në zërin “mallra dhe shërbime të tjera” me rreth 60.35%, pas tij zëri “Paga” me rreth 34.13% dhe “Sigurime shoqërore” me rreth 4.64%. “Shpenzimet kapitale” zënë një peshë mjaft të vogël në vetëm 0.88% të buxhetit të planifikuar.

Në PBA 2022-2024, për vitin 2022 janë planifikuar 19,503,842 mijë lekë dhe deri në fund të vitit 2022, pas rishikimeve të buxhetit, janë alokuar 9,346,328 mijë lekë ose 10,157,514 mijë lekë më pak se plani në PBA ose 47.92% më pak se kërkesat e institucionit të parashikuara në PBA. Ndryshimi më i madh paraqitet në zërin e shërbimeve prej 8,856,643 mijë lekë ose 40.18% më pak se parashikimi buxhetor. Diferenca vjen kryesisht në zërin “Barna dhe materiale mjekësore” për shkak të fondeve më të ulëta të vendosura në dispozicion për QSUNT-në krahasuar kjo me kërkesat në PBA. Duke marrë në analizë peshën e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike në planin e shpenzimeve buxhetore mbi totalin e buxhetit të QSUNT-së për vitin 2022 në shumën 9,346,328 mijë lekë, mund të konstatohet se pjesën më të madhe e zënë shpenzimet në zërin “Mallra dhe shërbime të tjera” me rreth 63.64%, pas tij llogaria “Paga” me rreth 29.05%, dhe “Sigurime shoqërore” me rreth 4.51%. “Shpenzimet kapitale” zënë një peshë mjaft të vogël në vetëm 2.69% të buxhetit të planifikuar.

Për shpenzimet kapitale për investime, në PBA 2022-2024 është parashikuar një buxhet prej 599,104 mijë lekë dhe deri në fund të vitit 2022 nga MSHMS nga buxheti i rishikuar janë alokuar fonde në vlerën 250,836 mijë lekë ose 348,268 mijë lekë ose 41.87% më pak se parashikimi në PBA.

Shpenzimet operative për vitin 2021 u realizuan në masën 8,734,524 mijë lekë ose në masën 99.98% , dhe për vitin 2022 u realizuan në masën 9,077,894 mijë lekë ose në masën 99.84% ose brenda planit të rishikuar. Pavarësisht detajimit të planit të shpenzimeve të kryera nga institucioni, u konstatua se në muajin dhjetor 2022 ka tejkalim të buxhetit të planifikuar të zërit “Barna, materiale mjekësore dhe laboratorët”, i cili nga 456,409 mijë lekë të planifikuara u realizua në shumën 947,355 mijë lekë ose 490,946 mijë lekë më shumë se detajimi mujor buxhetor në këtë llogari.

Ndryshimet e buxhetit përgjatë vitit buxhetor dhe realizimi tij në vitin 2021 në masën 99.84 % dhe në vitin 2022 në masën 99.81%, nuk janë tregues të një planifikimi dhe financimi të mirë dhe të plotë të nevojave të mbulimit të shërbimeve shëndetësore spitalore me fondet e buxhetit.

Nga auditimi konstatohet se Bordi Drejtues i QSUNT-së për periudhën objekt auditimi nuk ka miratuar pasqyrat financiare vjetore për vitin 2021 dhe vitin 2022, në kundërshtim me përcaktimet e VKM Nr. 66, datë 3.2.2017, “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen dhe organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”, pika 10, , si dhe statutin e QSUNT, kreu III, pika 10 e tij.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 28-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1.Rekomandimi: Bordi Drejtues i QSUNT-së të programojë kalendarin e aktiviteteve në lidhje me miratimin e buxhetit dhe të raportit vjetor e pasqyrave financiare të llogaridhënies vjetore në përputhje me misionin dhe vizionin e QSUNT-së.

Në vijimësi

25.2. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marr masa për të dërguar për miratim në Bordin Drejtues të QSUNT-së projektbuxhetin e vitit pasardhës dhe vlerësimin e raportit vjetor të veprimtarisë financiare të institucionit.

Në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: PBA 2021-2023 për shpenzimet kapitale për investime ka parashikuar një buxhet prej 608,213 mijë lekësh, dhe deri në fund të vitit 2021 nga MSHMS, sipas buxhetit të rishikuar, janë alokuar fonde në vlerën 77,512 mijë lekë ose 530,701 mijë lekë më pak se parashikimi në PBA. Investimet me fonde buxhetore për vitin 2021 janë realizuar në shumën 73,764 mijë lekë ose në masën 95.16 % krahasuar me fondeve të çelura dhe ndryshuar gjatë vitit. Referuar ndryshimeve të fondeve gjatë vitit buxhetor 2021 rezulton se plani i investimeve ka pësuar ndryshime me pakësimin të fondeve buxhetore deri në anulim të plotë të financimit të projekteve të miratuara si për investimin me kod projekti 18BB103, me kod 18BB137, për të cilin fillimisht alokohen 130,000 mijë lekë dhe në fundviti alokimi rezulton në shumën 37,983 mijë për realizimin e investimit.

Për shpenzimet kapitale për investime, në PBA 2022-2024 është parashikuar një buxhet prej 599,104 mijë lekë dhe deri në fund të vitit 2022 nga MSHMS sipas buxhetit të rishikuar fondet janë alokuar në vlerën 250,836 mijë lekë ose 348,268 mijë lekë më pak ose 41.87% më pak se parashikimi në PBA. Investimet me fonde buxhetore për në vitin 2022 u realizuan në shumën 250,836 mijë lekë ose 100% të fondeve të çelura. Referuar ndryshimeve të fondeve gjatë vitit buxhetor rezulton se plani i investimeve ka pësuar ndryshime të konsiderueshme nga MSHMS, të cilat nuk përputhen me kërkesën buxhetore të QSUNT-së në PBA 2022-2024. MSHMS ka financuar projekte të reja për investime në QSUNT, të cilat duhet të ishin parashikuar në kohën e hartimit dhe miratimit të PBA 2022-2024, si projekte të vlerësuara domosdoshme për t'u financuar përgjatë vitit buxhetor, Kjo dukuri u konstatua në realizimin e projektit të investimit me kod projekti 18BB103 i cili nga çelja e fondit 210,809 mijë lekë miratuar me shkresë nr. 567/4, dt. 03.03.2022, u pakësua nga MSHMS me shkresa përkatëse duke u mbyllur me një fond investimi kapital prej 149,719 mijë lekësh, thënë ndryshe për më pak për shumën 61,090 mijë lekë ose 28.98% se fondet e çelura në fillim të vitit 2022. Investimi me kod 18BB310, fondet e çelura për shumën 27,977 mijë lekë, deri në fund të vitit buxhetor bëhen zero, pra investimi nuk është kryer sipas planifikimit buxhetor etj .

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 28-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1. Rekomandim: Në fazën e hartimit e miratimit final të projektbuxhetit, QSUNT-në të rrisë bashkëpunimin me MSHMS-në për listën e projekteve të investimeve për çdo program, duke dokumentuar në këtë fazë dhe në çdo rast procedurat e ndjekura për projektet me përfitues QSUNT, me qëllim shmangien e rishikimeve të fondeve buxhetore me impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit.

Në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, planifikimi buxhetor për barna dhe materiale mjekimi, në PBA 2021-2023 parashikon në total 10,358,892 mijë lekë, nga të cilat barnat u parashikuan 6,169,955 mijë lekë dhe për pajisje mjekësore 4,188,937 mije lekë. QSUNT, sipas objektivave të MSHMS-së në PBA 2022-2024, ka parashikuar shtim të konsumit për barna dhe materiale mjekësore, duke parashikuar që fondi për barna dhe materiale mjekësore për vitin 2022 të parashikohet në vlerën 10,637,812 mijë lekë. Për periudhën objekt auditimi, planifikimit buxhetor për barna dhe materiale mjekimi, për mbulimin e nevojave të QSUNT-së

për fonde buxhetore, zhvillohet një procedurë e padetajuar dhe e paanalizuar mirë nga shefat e shërbimeve. Hartimi dhe parashikimi i projektbuxhetit nga shefat e shërbimeve bazohet kryesisht në kërkesat e periudhave të mëparshme dhe jo në kërkesat reale të fondeve për barna të tilla, si : konsum historik i llojit të barnave, nevojat për barna sipas mjekimit, numrit të të sëmurëve në periudhat e mëparshme, sasia e barnave të akorduara sipas pacientëve, trendi i rritjes së sëmundshmërisë etj. Rregullorja e Shërbimit Farmaceutik Nr. 2163/1, datë 17.06.2015, nuk përcakton një mënyrë apo model të njësuar për t'u përdorur nga shefat e shërbimeve për parashikimin e fondeve buxhetore për vitin pasardhës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 28-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1 Rekomandimi: Për parashikimin e fondeve buxhetore për vitin pasardhës, të përmirësohet Rregullorja e Shërbimit Farmaceutik Nr. 2163/1 datë 17.06.2015, duke përcaktuar procedura standarde lidhur me metodologjinë që duhet përdorur për parashikimin e shpenzimeve buxhetore për barna dhe materiale mjekësore, për t'u përdorur nga farmacia qendrore dhe shefat e shërbimeve spitalore në QSUNT, bazuar në analizën e risqeve dhe masave për përbalimin e tyre, sipas objektivave të MSHMS-së dhe QSUNT-së.

Menjëherë

28. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e monitorimit të buxhetit të QSUNT-së për vitin 2021-2022 ka mangësi në monitorimin dhe raportimin e buxhetit sipas kërkesave të Ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 4, pika 23/1. Monitorimet dhe raportimet për realizimin e buxhetit mbështeten vetëm në rakordimet mujore me degën e thesarit, monitorim ky që kryhet në vlerë dhe jo në produkt, duke pasqyruar realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre. Rakordimet nuk mundësojnë kryerjen e monitorimit të performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, për shkak të mos krahasimit të treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktikë. Nuk bëhet i mundur evidentimi nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin, në mënyrë që të bëhen propozime, rekomandime për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese nëpërmjet alokimit të burimeve. Nuk kryhet analiza krahasimore e realizimit të fondeve me periudhat e mëparshme. Nuk sigurohet informacion për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit. Të dhënat lidhur me performancën financiare nuk rezultojnë të publikuara në faqen zyrtare të QSUNT-së, për pasojë nuk garantohet transparencë institucionale. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me statutin e QSUNT-së dhe Rregulloren bazë të QSUNT-së, kuadrin ligjor të buxhetimit si dhe nenin 23/1 të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, datë 15.10.2015, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 28-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1. Rekomandim: Organet Drejtuese të QSUNT të marrin masa për përgatitjen e raporteve 4-mujore dhe vjetor të monitorimit të zbatimit të buxhetit, të cilat do t'i mundësojnë institucionit orientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit, mbështetur mbi ata tregues të planifikuar gjatë hartimit të programit buxhetor afatmesëm.

Në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se QSUNT, në parashikimin e fondeve buxhetore sipas PBA 2021-2023, drejtuar FSDKSH-së me shkresë nr. 2129/76 prot, datë 08.07.2020 dhe PBA 2022-2024 drejtuar FSDKSH-së me nr. 1955/1 prot, datë 15.07.2021, nuk ka parashikuar shpenzimet buxhetore sipas paketave të shërbimeve shëndetësore të miratuara.

Kjo bie ndesh me kërkesat e VKM Nr. 308, datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH në shërbimin spitalor”, i ndryshuar, pika 4, sipas të cilit fondi financon paketat e shërbimeve shëndetësore, bazuar në koston e shërbimeve sipas shtojcave përkatëse. Gjithashtu, nuk përputhet edhe me kërkesën e FSDKSH-së në shkresën Nr. 460, datë 01.07.2020, “Për hartimin e treguesve të PBA 2021-2023”, protokolluar në QSUNT me Nr. 2129/74 prot, datë 08.07.2020, në të cilën për parashikimin e shpenzimeve për shërbimin shëndetësor në spital duhet të plotësohen pasqyrat shtesë në të cilat kërkohet parashikimi i koston sipas paketave të shërbimeve të miratuara me VKM Nr. 308/2014, të ndryshuar.

QSUNT nuk ka pasur mundësinë objektive për të parashikuar shpenzimet buxhetore sipas paketave të shërbimeve shëndetësore të miratuara, sipas kërkesave të VKM Nr. 308, datë 21.05.2014 , “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH në shërbimin spitalor”, i ndryshuar , pika 4, sipas të cilit fondi financon paketat e shërbimeve shëndetësore , bazuar në koston e shërbimeve sipas shtojcave përkatëse. Po kështu, QSUNT nuk ka mundësi objektive të kostojë paketat e shërbimeve shëndetësore dhe të ndajë koston e shërbimeve sipas shërbimeve spitalore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 28-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

29.1. Rekomandim: QSUNT , në bashkëpunim me FSDKSH dhe MSHMS, të marrë masa për përcaktimin e modaliteteve të parashikimit të shpenzimeve buxhetore, jo vetëm me zëra shpenzimesh sipas llogarive kontabël, por dhe buxhetim në kode të projekteve (paketave shëndetësore) konform VKM Nr. 308, datë 21.05.2014, “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH në shërbimin spitalor” , i ndryshuar.

Në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2021, sipas PBA 2021-2023, janë parashikuar të ardhurat dytësore në vlerën 46,476 mijë lekë, realizuar në shumën 40,416 mijë lekë ose realizuar në masën 86.96% krahasuar me parashikimin në PBA 2021-2023, në të cilin janë planifikuar 46,476 mijë lekë. Në total, mosrealizimi i të ardhurave kundrejt parashikimit rezulton në shumën 6,060 mijë lekë.

Përdorimi i të ardhurave dytësore për vitin 2021 paraqitet në total në shumën 9,063 mijë lekë me destinacion për investime në shumën 5,682 mijë lekë, për paga 2,480 mijë lekë dhe shpenzime operative në shumën 900 mijë lekë. Për vitin 2022 , sipas PBA 2022-2024, të ardhurat dytësore janë planifikuar në vlerën 26,120 mijë lekë dhe janë realizuar 141,480 mijë lekë ose 96,725 mijë lekë më shumë se planifikimi sipas PBA 2022-2024 ose 115,360 mijë lekë më shumë se fakti i vitit pasardhës, në të cilin të ardhurat faktike paraqiten në vlerën 44,755 mijë lekë. Rritja e të ardhurave vjen si efekt i ndryshimeve të VKM 688/2018 me VKM Nr. 135, datë 02.03.2022 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga MSHMS të FZHZH të objektit me emërtim “Oborr i QSUNT-së”, mbi përqindjen e ndarjes së të ardhurave të akumuluar dhe të papërdorura. Nga auditimi u konstatua mungesa e një plani veprimi për përdorimin e të ardhurave dytësore në nivelin e këtij fondi, mungesa e të cilit nuk mundëson kryerjen e investimeve në përputhje me objektivat afatgjata të institucionit, duke mundësuar përdorimin e tyre rast pas rasti, për projekte që nuk janë realizuar dot nga buxheti i shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 28-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

30.1. Rekomandim: QSUNT, në funksion të optimizimit të mundësive për rritjen e të ardhurave dytësore, të hartojë plan veprimi për gjenerimin, arkëtimin dhe përdorimin të tyre, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Në vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: QSUNT dhe F. kanë nënshkruar akt-marrëveshjen me nr. 1242/41, datë 16.11.2018, ndryshuar me amendamentin Nr. 1, protokolluar me Nr. 884/2, datë 12.04.2022, në zbatim të VKM nr. 135/2022, “Për disa shtesa në vendimin Nr. 688, datë 14.11.2018 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga MSHMS të F., të objektit me emërtim “Oborr i QSUNT-së”. VKM 688 /2018 pika 3 dhe 4, ndryshuar me VKM 135/2022 pika 4/1, ka përcaktuar qartë raportet e ndarjes së të ardhurave midis palëve nënshkruar në aktmarrëveshje. Pas momentit të hyrjes në fuqi të aktit normativ, hyrjes në fuqi të VKM 135/2022 (botuar në FZ Nr. 37, datë 09.03.2022) detyrimi ligjor mbi palët është se deri në momentin e hyrjes në fuqi të VKM 135/2022, të ardhurat e krijuara dhe të papërdorura duhet të kalojnë në buxhetin e QSUNT-së në masën 80% si të ardhura dytësore për t’u përdorur për investime në infrastrukturë, pajisje mjekësore ose investime të tjera etj.

Nga auditimi u konstatua se QSUNT nuk ka arkëtuar shumën 13,499,579 lekë për faturat për arkëtim Nr. 33/2, datë 22.04.2022 Nr. 37/2022, datë 06.10.2022, konsideruar si 15% tatim fitim për t’u mbajtur nga pjesa takuese e të ardhurave të QSUNT-së. Mbajtja e tatim fitimit në masën 15% mbi të ardhurat dytësore të QSUNT-së, cënon raportin e ndarjes së të ardhurave sipas kërkesave të VKM Nr. 135/2022, pika 4/1 dhe Akt Marrëveshjes nr. 1242/41, datë 16.11.2018, të ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 28-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

31.1. Rekomandim: Mbështetur në Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, neni 10, pika 2, QSUNT, t’i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për qëndrimin e saj zyrtar lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor për mbajtjen 15% të tatimit mbi fitimin nga pjesa takuese e të ardhurave të QSUNT-së në shumën 13,499,579 lekë, në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 135/2022, “Për disa shtesa në vendimin Nr. 688, datë 14.11.2018 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga MSHMS e F. të objektit me emërtim “Oborr i QSUNT” dhe zbatimin e aktmarrëveshjes së nënshkruar midis QSUNT-së dhe F.-së, me Nr. 1242/41, datë 16.11.2018, ndryshuar me Amendamentin Nr. 1, protokolluar me Nr. 884/2, datë 12.04.2022.

Menjëherë

32.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua QSUNT ka nënshkruar kontratë shërbimi Nr.5216, datë 09.10.2020, me kontraktorin “O.” shpk, me objekt “*Mirëmbajtje e sistemit të informacionit për shëndetin publik të QSUNT-së (SISP)*”. Neni 8.1 dhe 8.2 i kontratës parashikon se kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha shërbimet siç specifikohet të oferta teknike dhe kushtet e veçanta të kontratës neni 10 , “Pranimi Shërbimeve”. Me shkresë Nr. 1544/1 prot, datë 01.06.2022, QSUNT ka kërkuar nga kontraktori hedhjen në SISP të tarifave të ndryshuara, miratuar në urdhrin e MSHMS-së nr. 310, datë 17.05.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhrin nr. 493, datë 02.07.2019 “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”. Kërkesa për dijëni i është drejtuar dhe AKSH-it dhe MSHMS-së.

Sipas kontratës së nënshkruar, kërkesa e QSUNT-së përbën detyrim kontraktual për t’u përmbushur nga kontraktori. Kontraktori në sistemin SISP ka ndryshuar tarifat në datën 26 shtator 2022 në kundërshtim me kërkesën me shkresën Nr. 1544/1 prot, datë 01.06.2022, dhe urdhrin e MSHMS nr. 310, datë 17.05.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr. 493, datë 02.07.2019 , “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”, i cili në paragrafin e fundit kërkon zbatim të menjëhershëm të tij. Kontraktori ka aplikuar me vonesë tarifat e reja, me efekt pas datës 26 Shtator 2022, në kundërshtim me kontratën e shërbimit nr. 5216, datë 09.10.2020, neni 8.1 dhe 8.2 dhe kushtet e veçanta të kontratës, neni 10, kërkesën e QSUNT-së me nr. 1544/1 prot, datë 01.06.2022 dhe urdhrin e MSHMS Nr. 310, datë 17.05.2022

“Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin Nr. 493, datë 02.07.2019 “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”. Për pasojë, QSUNT duhet të përllogariste dhe mbante tarifa ditore (dëm) për kryerjen me vonesë të shërbimit të kërkuar në hedhjen me vonesë të tarifave të reja në sistemit SISP, sipas urdhrin të MSHMS Nr. 310, datë 17.05.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin Nr. 493, datë 02.07.2019 , “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”, për 85 ditë në vlerën 2,055,301 lekë (24,179,892 * 85 * 1/1000), në zbatim të nenit 20, germa “c” të kontratës së shërbimit nr. 5216, datë 09.10.2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 28-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

32.1. Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i QSUNT-së në bashkëpunim me AKSH-in, të ngrenë një grup të përbashkët pune për të vlerësuar teknikisht nëse shërbimet e kërkuara me shkresën Nr. 1544/1 prot, datë 01.06.2022 për hedhjen në Sistemin Informacionit për Shëndetin Publik (SISP) të tarifave të ndryshuara të shërbimeve, kanë qenë pjesë e kontratës së shërbimit Nr. 5216, datë 09.10.2020, nënshkruar midis kontraktuesit dhe përfituesit. Pas verifikimit , nëse kushtet nuk ndryshojnë, të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 2,055,301 lekë, për mosmbajtje tarife ditore (dëm) në vlerën 2,055,301 leke.

Brenda datës 31.03.2024

33. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk ka një rregullore të saj ku të cilën përcaktohen objekti i punës, detyrat, struktura dhe detyrat funksionale të çdo punonjësi, kërkesë kjo e paragrafit 2.2 të rregullores bazë të QSUNT-së.

Plotësimi i vendeve vakant në QSUNT, sipas strukturës administrative dhe shërbimeve mjekësore, krahasuar me numrin e të punësuarve, rezultojnë me mosrealizim në fund të vitit 2021 me 165 vende vakante ose realizim 94.53% dhe për vitin 2022 rezultojnë me 259 vende vakante ose realizim në masën 91.42%. Referuar të dhënave statistikore të QSUNT-së, konstatohet se numri i të punësuarve ka pësuar rënie të vazhdueshme nga 3-mujori II 2021 deri në 3-mujorin IV të vitit 2022, duke arritur numrin më të ulët prej 2,759 punonjësish në 3-mujorin IV 2022 kundrejt 3017 punonjës të miratuar. Për sa i përket plotësimit të strukturës së miratuar me personel “mjek” dhe “infirmier”, konstatohet se struktura organike për personel “mjek” planifikuar për 386 vende, rezultojnë e plotësuar deri në 318 vende ose për 68 vende vakante, dhe personel “infirmier” ka planifikuar në strukturë 1250 vende pune, plotësuar deri në 1207 vende ose 33 vende vakante. Mungesat e stafit të specializuar mjekësor rrisin rrezikun për t’iu përgjigjur plotësisht dhënies cilësore të shërbimit mjekësor të specializuar terciar pranë këtij institucioni.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 85-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

33.1. Rekomandim: Strukturat përkatëse në QSUNT të marrin masa për hartimin dhe miratimin nga bordi drejtues i spitalit të rregullores së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore mbështetur në rregulloren bazë të institucionit, me qëllim mbarëvajtjen e punës për funksionimin sa më të mirë të strukturës përkatëse.

Menjëherë

33.2. Rekomandim: QSUNT bazuar në fondet buxhetore dhe të ardhurat dytësore, për shërbimet e ofruara nga personeli mjekësor në bazë të indikatorëve performancës, të shqyrtojë mundësinë e hartimit të një rregulloreje të posaçme për shpërblimin e tyre në funksion të nxitjes dhe rritjes së interesit për punësim.

Menjëherë dhe në vijimësi

34. Gjetje nga auditimi: Vlerësimi i punës për vitin 2022 është kryer pas daljes urdhrin të brendshëm nr.179, datë 30.03.2023 dhe jo brenda vitit kalendarik, në mospërputhje me statutin e

QSUNT-së nr.709/2018, pika 23.3, germa “dh”, sipas të cilit dosja e të punësuarit duhet të përmbajë “Vlerësimin e punës që bëhet në fund të çdo viti”. Në zbatim të statutit, Titullari në pikën 2 të urdhrit të brendshëm Nr. 179, datë 30.03.2023, ka përcaktuar: “Formulari i vlerësimit të stafit të sipërcituar do të plotësohet 1 (një) herë në vit. Ky formular depozitohet pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe ruhet në dosjen e punëmarrësit”. Urdhri brendshëm nr. 179, datë 30.03.2023, nuk përcakton një afat të vlerësimit të performancës vjetore dhe mungon shkalla hierarkike e vlerësimit nga miratimi nga eprori i drejtpërdrejtë deri tek aprovimi nga drejtori i Përgjithshëm, si Titullari më i lartë ekzekutiv, drejtues, organizues dhe kontrollues i të gjithë veprimtarisë, konform statutit dhe rregulloreve të brendshme të QSUNT.

Në dosjet e përzgjedhura dokumentacioni i administruar është konform kërkesave të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”. DBNJ nuk ka rifreskuar “Fletën prezantuese” duke administruar dosjet e personelit sipas kërkesave të pikës 23 të statutit të QSUNT-së. Konkretisht, fleta e përmbledhjes së dokumenteve në dosje është e ndryshme nga flete-inventari i dosjes së të punësuarit (lidhja 2), kriteri i VKM Nr. 833/2020. Fleta aktuale nuk përmban të dhëna si: informacion lidhur me të punësuarin, si numër personal, datëlindje, certifikate personale/ familjare etj.; nuk përmban të dhëna mbi vendbanim të përkohshëm dhe të përhershëm; informacion lidhur me arsimin, informacion lidhur me grada/titull shkencor; informacion mbi gjuhët e huaja; informacion mbi masat disiplinore, veprime këto në mospërputhje me kërkesat e VKM Nr. 833/2020, “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 85-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

34.1. Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa që vlerësimet vjetore të performancës në punë të punonjësve të bëhen brenda një afati të paracaktuar nga titullari dhe sipas shkallës hierarkike të vlerësimit nga miratimi nga eprori drejtpërdrejt deri tek aprovimi nga drejtori i Përgjithshëm.

Në vijimësi

34.2. Rekomandim: Nga ana e strukturave përgjegjëse në QSUT të ndryshohen elementet e fletës prezantuese të dosjes së personelit, sipas kriterëve të VKM Nr. 833, datë 28.10.2020, “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Menjëherë dhe në vijimësi

35.Gjetje nga auditimi: Kontrata individuale e punës për punëmarrësin nuk ka të përcaktuar datën të saktë të dhënies së pagës ose në kontratat e reja të vitit 2022 është përcaktuar si “jo më vonë se data 13 e muajit paraardhës”. Kjo marrëdhënie kontraktuale punësimi bie ndesh me kërkesat e nenit 21, pika 3, germa “j”, të Kodit të Punës, sipas të cilit kontrata e punës e lidhur me shkrim duhet të përmbajë sidomos elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj, si dhe nenin 15 pika, 12, të kontratës kolektive të punës Nr. 1528/1, datë 30.03.2021, që përcakton: “Paga jepet në monedhë shqiptare, në rrugë bankare, për çdo muaj deri në datën 10 të muajit paraardhës”. Kontrata individuale të punës deri në dhjetor 2022 nuk përcakton kontratën kolektive në fuqi me ekstremitet e saj (numër, data) por përdor fjalët “Kontrata Kolektive”, veprime në mospërputhje me nenin 21, pika 3, germa “j” të Kodit të Punës. Transaksionet bankare të kalimit në bankë të pagës së punëmarrësve pas datës 10 të muajit pasardhës, veçanërisht pagat e muajit dhjetor 2022 në datë 17.01.2021 dhe për muajin dhjetor 2022 në datë 19.01.2023 konsiderohen shkelje e nenit 15, pika 12, të kontratës kolektive të punës, si dhe

dispozitës përkatëse në kontratën individuale të punësimit ose kontratën e shërbimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 85-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

35.1.Rekomandim: Nga organet drejtuese të QSUNT-së të merren masa për të bërë unifikimin e kontratës kolektive me kontratën individuale të punës në lidhje me përcaktimin e datës së pagesës së punonjësve.

Në vijimësi

36. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimet dhe testimet e auditimit, rezulton se për punëmarrësit me emërtesën “*punonjës social*” me *iniciales S.K. dhe E.Z.* mungon leja e ushtrimit të profesionit të punonjësit social, sipas kërkesave të nenit 8, pika 1, të Ligjit Nr. 163/2014 “*Për urdhrin e punonjësve socialë në Republikën e Shqipërisë*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 85-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

36.1.Rekomandim: Për punonjësit social, në dosjen e të cilëve mungon leja e ushtrimit të profesionit të punonjësit social, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për pajisjen me licencë për ushtrimin individual të profesionit të punonjësit social të lëshuar nga Urdhri i Punonjësve Socialë.

Menjëherë

37. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e pagave me elementet e përbërëse të saj, QSUNT nuk ka mundur implementimin dhe përdorimin e Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS), sipas dispozitave të VKM Nr. 833, datë 28.10.2020, “*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*” nëpërmjet përdorimit të regjistrit qendror të personelit të administruar nga DAP, situatë e cila do të lehtësonte procesin e përlllogaritjes së pagës mujore dhe do të jepte siguri lidhur me saktësinë dhe përditësimin e të dhënave lidhur me elementet e saj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 85-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

37.1. Rekomandim: QSUNT të marrë masa për menaxhimin e llogaritjes së pagave nëpërmjet implementimit të regjistrit qendror të personelit disponuar nga DAP ose përdorimit të programit të informatizuar që përdoret nga sektori i financës, për të siguruar në çdo kohë të dhëna të sakta dhe të sigurta mbi marrëdhëniet e punësimit si për punëdhënësin dhe për punëmarrësin.

Në vijimësi

38. Gjetje nga auditimi: Në statutin e QSUNT-së miratuar me urdhrin e përbashkët të MSHMS-së dhe MASR-së Nr. 709, datë 10. 10.2018, në paragrafin 24, “*Procedurat e marrjes në punë*”, nuk janë amenduar procedurat e marrjes në punë të drejtuesve të shërbimeve spitalore, në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM Nr. 424, datë 10.05.2017, “*Për përcaktimi e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 85-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

38.1. Rekomandim: Nga organet drejtuese t’i kërkohet ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të bashkërendojë dhe koordinojë veprimtarinë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për procedurat e marrjes në punë të drejtuesve të shërbimeve spitalore.

Menjëherë

39. Gjetje nga auditimi: Procesi i përzgjedhjes së kandidaturave për shefat e shërbimeve spitalore për 8 vende vakante për shkak të ndërprerjes së parakohshme të mandatit të drejtuesit (dalje në pension ose vdekje), nuk është në përputhje me procedurën e përzgjedhjes së

kandidaturave, pasi emërimi i përkohshëm në detyrë nuk është bërë nga ministri i MSHMS-së dhe ministri i MARS-së, por nga titullari i QSUNT-së, në mospërputhje me pikën 19 në VKM Nr. 424, datë 10.05.2017, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”. DBNJ në QSUNT nuk ka organizuar procesin e përzgjedhjes së drejtuesit të ri të shërbimit spitalor brenda 6 muajve nga krijimi i vendit vakant, në mospërputhje me pikën 19 në VKM Nr. 424, datë 10.05.2017 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 85-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

39.1.Rekomandim: DBNJ në QSUNT për vendet vakante të organizojë procesin e përzgjedhjes së drejtuesve të shërbimit spitalor për ushtrimin e detyrës të drejtuesit të shërbimit spitalor.

Menjëherë

40. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i paraqitur u konstatua se drejtuesit e shërbimeve kanë nënshkruar deklaratën “Mbi konfliktin e interesit”, sipas Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2015, neni 4, pika 1, germa “c” dhe “ç”, por të pashoqëruar me vërtetimin respektiv të MSHMA-së, në mospërputhje me pikën 25.2 të statutit të QSUNT-së miratuar me urdhër të përbashkët ndërmjet MSHMS dhe MARS Nr. 709/2018.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 84-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

40.1 Rekomandim: Dosja e drejtuesve të shërbimeve të plotësohet me vërtetimin respektive të lëshuar nga MSHMA-së në përputhje me pikën 25.2 të statutit të QSUNT-së miratuar me urdhër të përbashkët ndërmjet MSHMS dhe MARS Nr. 709/2018.

Menjëherë dhe në vijimësi

41. Gjetje nga auditimi: Procedura e rekrutimit të personelit “mjek” është kryer duke patur si reference urdhrin e shfuqizuar të MSHMS-së Nr. 355, datë 18.08.2018, “Për kriteret e punësimit të mjekëve në spitalet universitare” dhe urdhrin Nr. 511, datë 13.12.2011 “Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publik” (shfuqizuar). Procedura e emërimit nuk përputhet me procedurën e udhëzimit të ministrit të MSHMS-së Nr. 499, datë 02.07.2019, “Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 85-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

41.1. Rekomandim: Procedura e pranimit dhe emërimit të mjekëve në statutin e QSUNT-së miratuar me urdhrin të përbashkët të MSHMS dhe MARS Nr. 709/2018, (statuti i QSUNT) paragrafi 24 dhe rregulloren bazë të QSUNT-së, pika 2.5 “Rregulla të përgjithshme të procedurës së punësimit për personelin mjekësor dhe administrativ”, të harmonizohet me procedurën e miratuar nga ministri i Shëndetësisë, me udhëzim Nr. 499/2019, “Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 85-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

42. Gjetje nga auditimi: QSUNT, për mbulimin e shërbimit të rojës 24-ore, bazohet në urdhrin e ministrit të MSHMS-së nr. 145, datë 20.03.2013, “Për mbulimin e mjekut të rojës në QSUNT”, ku procedohet nepermjet kërkesave në MSHMS mbi nevojat për mbulimin e këtij shërbimi. Urdhri i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 145, datë 20.03.2013, për mbulimin e shërbimit të mjekut të rojës në QSUNT, përcakton sigurimin e këtij shërbimi duke përfshirë në këtë shërbim mjekët specializantë të vitit të tretë e më lartë si mjekët specializantë të viteve të

para (si dublantë) dhe jo mjekë të pajisur me licencë për ushtrimin individual të profesionit miratuar nga Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë. Statuti i QSUNT-së në pikën 24, dhe Rregullorja Bazë e QSUNT-së nuk përcaktojnë rregulla se si do të procedohet në përzgjedhjen e kërkesave për mbulimin e shërbimit 24 orë për mjek vullnetarë, të cilët gëzojnë licencë për ushtrim aktiviteti nga Urdhri i Mjekut.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 85-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

42.1. Rekomandim: Nga organet drejtuese t'i kërkohet ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të bashkërendojë dhe koordinojë veprimtarinë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për përcaktimin e rregullave dhe procedurave në përzgjedhjen e kërkesave për mbulimin e shërbimit 24 ore për mjek vullnetarë mbi nevojat për mbulimin e këtij shërbimi.

Menjëherë

43. Gjetje nga auditimi: Sipërfaqet e trojeve në llogarinë 210 si dhe vlerat e tyre në vitin 2021 dhe 2022 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vlerën 0 lekë. Nga institucioni disponohet dokumentacion dhe planimetri (genplan) për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve, që ka në dispozicion subjekti për periudhën objekt auditimi, por rezulton se nuk është regjistruar kjo sipërfaqe në zyrat e kadastrës shtetërore, në bazë të përcaktimeve të Ligjit Nr. 8743, datë 22.02.2001, “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe Ligjit Nr. 111/2018, “Për kadastrën”. Sipërfaqja totale e tokës prej 165,000 m² që ka QSUNT në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet, në kundërshtim me pikën 3.3 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci)”, paragrafi 62, dhe paragrafi 91, të udhëzimit të MFE me Nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 131-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

43.1 Rekomandim: Nga QSUNT të ngrihet një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplan të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe mbi këtë bazë të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore dhe të aplikohet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të institucionit.

Menjëherë e në vijimësi

43.2. Rekomandim: Nga QSUNT të merren masa për përlllogaritjen e vlerave nga ekspertët e fushës dhe më pas Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të ndërmarrë veprimet e nevojshme të regjistrimit të pasurisë në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Menjëherë e në vijimësi

44. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrën e pozicionit financiar të institucionit më 31.12.2022, gjendja debitorë (klasa 4) paraqitet në vlera të konsiderueshme përkatësisht:

Llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” paraqitet në vlerën 392,342,181 lekë, e cila përbëhet nga detyrime të lëna nga KLSH ndër vite (2009-2019), për shkeljet e konstatuara:

-për vitin 2009 në shumën prej 52,854,614 lekë;

-për vitin 2011 në vlerën 201,053lekë;

-për vitin 2013 në vlerën 1,009,125 lekë;

-për vitin 2016 në vlerën 32,320,512 lekë;

-për vitin 2019 në vlerën 284,220,030 lekë;

-për vitin 2020 në vlerën 12,740,164 lekë.

Nga auditimi rezulton se nga QSUNT nuk është bërë një ndarje e detyrimeve për të përcaktuar se sa janë me shpresë arkëtimi apo likuidimi, sa prej tyre kanë një vjetërsi mbi 10 vjet, si dhe nuk janë marrë masat për zhvlerësimin e të drejtave. Sa më lartë është vepruar në kundërshtim me UMF nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e ministrit të financave dhe ekonomisë nr. 8 ndatë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes , paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 15, seksioni 3.1 paragrafi dytë: “Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, përpara mbylljes së llogarive vjetore 2021, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura” në debi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këto llogari në datën 31.12.2021”.

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në vlerën 124,166,367 lekë dhe përfaqëson detyrime të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, të cilat i ka ndarë sipas natyrës së tyre në:

“Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura, për shërbime dhe mirëmbajtje” në vlerën 17,126,898 lekë; “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për investime” në vlerën 2,862,616 lekë, si dhe kreditorë të ndryshëm për blerje barnash në vlerën 30,786,399 lekë, detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, të cilat i përkasin periudhave 2009-2013; si dhe “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore” në vlerën 73,390,454 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 131-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

44.1.Rekomandim: QSUNT të marrë masa, duke krijuar një grup pune të veçantë me përfaqësues të fushës së financave dhe fushës juridike për analizimin e hollësishëm të debitorëve. Të bashkëpunohet me Polet e Administrimit të Integruar (PAI), për gjetjen e saktë të të dhënave të debitorëve fizikë (ish-punonjës) dhe të subjekteve fizike e juridike, për të identifikuar shumat pa shpresë arkëtimi të klientëve dhe debitorëve të ndryshëm, pasi të jenë ezauruar më parë të gjitha rrugët e mundshme ligjore për arkëtimin e tyre.

Në vijimësi

44.2. Rekomandim: Organet Drejtuese të QSUNT-së duhet të sigurojnë nisjen e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha të drejtat me palët e treta të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin dhe likuidimin e tyre, si dhe të propozojnë masa konkrete, duke mos përjashtuar masat administrative dhe të tjera nëse është e nevojshme.

Në vijimësi

44.3. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të marri masa për të sistemuar veprimin e mbylljes së llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura” në debi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këto llogari në datën 31.12.2022.

Në vijimësi

45. Gjetje nga auditimi: QSUNT nuk ka një regjistër të hartuar dhe miratuar si dhe kartela të punonjësve, të aktiveve në varësi të llojit që ka në pronësi apo përdorim, ku të përmbajë datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e vënies në përdorim, etj. Gjithashtu, QSUNT nuk ka hartuar dhe miratuar regjistrin kontabël mbi pronat publike që ka në administrim apo pronat të cilat ka dhënë me qira dhe siguron të ardhura. Veprim në kundërshtim me kapitullin III, pika 26,28,30 dhe 31 të Udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011 të MFE-së “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 131-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

45.1. Rekomandim: Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme në caktimin e nëpunësit zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të të gjitha aktiveve të institucionit si dhe pronave, të cilat ka në administrim në formë kartelesh ose të sintetizuar të miratuar prej tij.

Menjëherë

46. Gjetje nga auditimi: Evidentohet se pjesa më e madhe e grupeve të inventarizimit kanë kryer kontrollin fizik referuar inventarit kontabël të vënë në dispozicion nga sektori i financës, duke u shprehur vetëm për gjendjen fizike të tyre dhe jo për gjendjen cilësore. Në disa raste, grupet e inventarizimit, janë shprehur në mënyre narrative për disa aktive, të cilat duhet të nxirren jashtë përdorimit pasi janë jashtë funksionit dhe kanë zënë hapësirat e pavijonit, por nuk kanë evidentuar se cilat janë këto pajisje.

- Në disa raste të testuara nga auditimi, grupi i inventarizimit nuk ka përmbyllur inventarizimin e përgjithshëm të çdo aktivi, pasi në disa raste, grupi i inventarizimit shprehet se personat përgjegjës të materialeve kanë qenë me leje apo zyra ka qenë e mbyllur ndaj nuk është bërë i mundur inventarizimi i aktiveve, duke mos zbatuar urdhrin e titullarit i cili ka lënë një afat pothuajse njëmuajor për të kryer inventarizimin, dhe lejet njëditore apo javore nuk janë justifikim për mos të zbatuar urdhrin e titullarit në një moment të dytë gjatë harkut kohor të përcaktuar. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me pikën 85/a të udhëzimit Nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve të NJSP”, e cila citon: “Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësive publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit”; pikën 82 të udhëzimit nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve të NJSP”, urdhri i titullarit Nr.588, datë 06.12.2021, “Për inventarizimin e pajisjeve, aparaturave mjekësore dhe inventarit ekonomik në të gjitha Polet Administrative të Integruar në QSUNT për vitin 2021”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 131-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

46.1. Rekomandim:

Personat përgjegjës të përmbyllin procesin e inventarizimit duke u shprehur për gjendjen fizike e cilësore të aktiveve, me qëllim përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre.

Në vijimësi

47. Gjetje nga auditimi: Titullari i institucionit, edhe pse raportet përmbledhëse mbi problematikat e konstatuara nga grupi i inventarizimit për secilin nga shërbimet janë dorëzuar me datë 30.12.2022 deri në afatin e auditimit (faza në terren) 31.05.2023, nuk ka vazhduar procesin e inventarizimit të aktiveve, për sa i përket ngritjes së grupit të punës për konstatimet e raportuara, ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e aktiveve të propozuara për t’u nxjerrë jashtë përdorimit, urdhër përkatës për tepricat apo mungesat e konstatuara duke nxjerrë personat përgjegjës dhe marrjen e masave kundrejt tyre si dhe ngritjen e grupit të punës për asgjësimin e aktiveve të cilat do të vlerësoheshin për t’u nxjerrë jashtë përdorimit në kundërshtim me 87-90, 93 dhe 99-100 të udhëzimit MFE Nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve të NJSP”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 131-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

47.1. Rekomandim: Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme që të ngrëjë grupet e punës për vlerësimin e aktiveve, si dhe grupin e punës për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të cilat janë vlerësuar për t’u nxjerrë jashtë funksionit, duke bërë të mundur lirimin e ambienteve të pavijoneve në shërbim të qytetarit dhe jo pajisjeve të nxjerra jashtë funksionit.

Menjëherë

48. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për vitin 2021 dhe 2022, si strukturë përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës nr.543/4, datë 27.01.2022, me objekt kontrate “Për ofrimin e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavijonet e QSUNT për 30.05 ditë/muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, me të drejtë rinovimi automatikisht çdo muaj deri në lidhjen e kontratës bazë, nuk ka hartuar procedurat e monitorimit të saj, për tja kaluar për zbatim sektorit të monitorimit të kontratës, si dhe nuk ka raportuar për realizimin e kontratës tek titullari i institucionit.

- Nga verifikimi në terren 2 (dy) nga barrierat larëse profesionale (të cilat shërbenin për proces larje), ishin magazinuar në një ambient brenda lavanterisë të cilat nuk ishin në gjendje pune, se bashku me disa materiale të tjera.

- Referuar specifikimeve teknike, seksioni “Përkujdesje”, Operatori Ekonomik “A.”, duhet të disponojë 7 (shtatë) lloje thasësh për mbledhjen e materialeve të buta në varësi të rrezikshmërisë së tyre. OE dispononte vetëm thasë me ngjyrë blu “Për materialet e kontaminuara nga një pacient pas ekzaminimit në mjekësinë nukleare” dhe thasë me ngjyrë vishnje “Për mbulesa, mbrojtëse dysheku, bluza pambuku”, çka sjell mungesën e ndarjes së materialeve me rreziqe të ndryshme, si materiale të kontaminuara, materiale me rrezik mikrobiologjik etj., referuar specifikimeve të kontratës.

Referuar specifikimeve teknike të materialit të butë dhe strukturës së nevojshme logjistike citohet se: “Autoriteti kontraktor ka të drejtë të ushtrojë kontroll në ambientet e lavanterisë dhe depove të materialeve të buta nëpër pavijone, në prani të përfaqësuesit të kontraktorit”. Grupit të auditimit ju dorëzuan disa formate A4, të shkruara me shkrim dore, si dhe të firmosura nga kryeinfermieri dhe specialisti i sektorit të monitorimit të kontratave dhe jo procesverbale të protokolluara me numër protokollit dhe datë, si dokumente vërtetuese për verifikimin e kryer.

Për sa me sipër, veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me specifikimet teknike të materialit të butë dhe strukturës së nevojshme logjistike, seksioni “Makineri dhe Pajisje”, neni 20, i kontratës Nr.543/4, datë 27.01.2022, me objekt kontrate “Për ofrimin e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavijonet e QSUNT-së për 30.05 ditë/muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, me të drejtë rinovimi automatikisht çdo muaj deri në lidhjen e kontratës bazë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

48.1. Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa të menjëhershme në hartimin dhe miratimin e procedurës për monitorimin dhe ndjekjen e kontratës së shërbimit të lavanterisë, në mënyrë që secili nga personat përgjegjës të ndjekjes/monitorimit të kontratës të ketë instruksione mbi të drejtat dhe detyrimet mbi kontrollet dhe raportimet, si dhe shpeshësinë e kryerjes së tyre.

Menjëherë

48.2. Rekomandim: Sektori i Monitorimit të Kontratës të marrë masa të menjëhershme për të kryer verifikime në ambientet e lavanterisë, si dhe nëpër pavijone në bashkëpunim me kryeinfermieret (si përgjegjëse të materialeve të buta) për t’u siguruar se detyrat (ku përfshihet procesi si dhe pajisjet) e të kontraktuarit po zbatohen në mënyrë rigoroze, të saktë dhe në kohë prej tij, si dhe të mbahet procesverbali me numër dhe datë protokollit. Të merren masa të menjëhershme ku OE “A.” të rivendosë në punë dy barrierat larëse për mos të cenuar punën në vazhdimësi si dhe të furnizojë AK me 5 (pesë) thasët për mbledhjen e materialeve të buta referuar specifikimeve teknike të kontratës së sipërpërmendur.

Menjëherë

49. Gjetje nga auditimi: Për të gjitha kontratat e qirave të lidhura mes QSUNT dhe Operatorëve ekonomikë mungojnë akt-dorëzimet, ku në këtë procesverbal të përshkruhet gjendja fizike e aktivitetit afatgjatë material, vlera kontabël e objektit që jepet me qira sipas llogarive financiare në fund të vitit paraardhës dhe të shoqërohet me pamje fotografike të momentit. Është në përgjegjësinë e tyre ligjore, civile dhe administrative, akt-dorëzimi i objektit të kontratës së qirasë, veprim në kundërshtim me VKM 54 dt..05.02.2014 i ndryshuar, kapitulli VI, neni 2, pika a.

QSUNT nuk ka mbajtur një regjistër të veçantë, për periudhën objekt auditimi për secilën nga pronat e dhëna me qira, me të dhënat si emërtimi i pronës, NIPT-i dhe vendndodhja. Gjithashtu, për objektet e dhëna me qira nuk përmban: Sipërfaqen e objektit në m², numrin dhe datën e kontratës së qirasë, afatin e vlefshmërisë së kontratës, afatin e kohëzgjatjes, veprimtarinë që kryhet, subjektin përfitues, qiranë mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik. Veprim në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktive në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, në kapitullin III, pika 31.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 307-323 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

49.1. Rekomandim: Për kontratat e qirave të lidhura nga QSUNT duhet të bëhet dorëzimi i aktivitetit afatgjatë material me anë të një procesverbali/akt dorëzimi, në mënyrë të tillë të përshkruhet qartë gjendja fizike, vlera kontabël si dhe çdo element tjetër i rëndësishëm që identifikon pronën.

Menjëherë dhe në vijimësi

49.2. Rekomandim: Nga QSUNT të merren masa për të hartuar kartelën shoqëruese për çdo aktiv të dhënë me qira.

Menjëherë dhe në vijimësi

49.3. Rekomandim: QSUNT të marrë masa për evidentimin në një regjistër të veçantë për secilën nga objektet e dhëna me qira me të gjithë elementët përbërës të pronës, si: Sipërfaqen e objektit në m², numrin dhe datën e kontratës së qirasë, afatin e vlefshmërisë së kontratës, afatin e kohëzgjatjes, veprimtarinë që kryhet, subjektin përfitues, qiranë mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

Menjëherë dhe në vijimësi

50. Gjetje nga auditimi: Objekt i kontratës së qirasë lidhur më datën 26 tetor 2015, me subjektin me NIPT: L.....T është dhënia me qira e pasurisë shtetërore e quajtur “Ish-Magazina e Statistikës” njësi në administrim të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me numër pasurie 1/313 zona kadastrale 8130 me afat 10-vjeçar. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, është në cilësinë e qiradhënësit. Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 10 vjeçare, ku qiramarrësi detyrohet të paguajë qiranë në vlerën e 58,000lekë/ muaj. Fatura për pagesë lëshohet nga njësia që ka në administrim pasurinë, e cila është QSUNT.

-Qiramarrësi “K.Gj.” nuk ka paraqitur para qiradhënësit shtesën e plan biznesit për treguesit e periudhës në vazhdim. Në kundërshtim me nenin 5.5 të kontratës, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Qiramarrësi detyrohet që para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira, të paraqesë para qiradhënësit shtesën e plan biznesit për treguesit e periudhës në vazhdim, brenda objektit të kontratës. Kjo shtesë në plan biznes lidhet me investimet që do të realizohen në vazhdim dhe pas investimeve që ishin parashikuar kur subjekti është paraqitur për konkurrim, e po ashtu me nivelin e punësimit”.

-Vazhdimi i kontratës në këto kushte është në kundërshtim me nenin 8 të kontratës. Një nga rastet e zgjidhjes së kontratës është kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenet 2,5 dhe 6 të saj. Në kundërshtim të nenit 5.5 është një detyrim zgjidhja e kontratës. Titullari i

institucioni nuk ka ndërmarrë asnjë masë, po ashtu edhe nga MFE nuk është vepruar për ndërprerjen e kontratës.

-Në rastet kur kontrata është lidhur me persona fizikë dhe nga ana e tyre është marrë përsipër ose janë kryer investime në nivele që në bazë të legjislacionit duhet të ushtrojnë veprimtari si persona juridikë, në zbatim të kontratës dhe VKM 54, datë 05.02.2014, ndryshuar, në kapitullin VI, pika 5. Pas verifikimit rezultoi se subjekti me këtë nipt L.....T me datë regjistrimi 13.07.2015 është person fizik dhe nuk është regjistruar si person juridik. Ky fakt nuk është evidentuar nga njësia monitoruese e kontratave, si në instancat drejtuese më lartë në institucion. Veprime në kundërshtim me nenin 5.5 dhe 8 të kontratës së qirasë Nr.7827 rep., Nr.2371 kol., datë 26.10.2015, Ligjin Nr.33/2012 i ndryshuar, neni 51, VKM 54 dt..05.02.2014 i ndryshuar, kapitulli II, pika 7 b), VKM 54 dt..05.02.2014 i ndryshuar, kapitulli VI, pika 2 c), Ligji Nr.33/2012 i ndryshuar, neni 51.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 307-323 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

50.1.Rekomandimi: Drejtori i përgjithshëm i QSUNT në cilësinë e njësive që ka në administrim pronën dhe MFE në cilësinë e qiradhënës të ndërmarrin të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për zgjidhjen e kontratës me subjektin “K.Gj.”, pasi nuk ka përbushur kushtet eksplicite të kontratës.

Brenda 31.03.2024

50.2.Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për monitorimin dhe përbushjen e detyrimeve, kritereve dhe vazhdueshmërinë e kontratave të qirave.

Menjëherë dhe në vijimësi

50.3.Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa që kontratat e qirave, që kanë për objekt një send të paluajtshëm dhe me afat më shumë se 9 vite, duhet të bëhen me akt noterial dhe të regjistrohen në regjistrat publikë pranë zyrës së Drejtorisë Vendore të ASHK Tiranë, për efekt vlefshmërie.

Menjëherë dhe në vijimësi

51. Gjetje nga auditimi: Në kontratën e qiradhënien e pasurisë shtetërore “Ish-Magazina e Statistikës” njësi në administrim të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, rezultoi se nuk është përcaktuar qartë se sa është tarifa e m² e sipërfaqes nën ndërtesë dhe sipërfaqes funksionale për kontratën e lidhur me subjektin “K.Gj.”. Kjo pasuri ka sipërfaqe të përgjithshme 226,5 m², përkatësisht sipërfaqja nën objekt është 180.5 m² dhe sipërfaqe funksionale 46 m². Vlera dysheme e detyrimit mujor përcaktohet si shumë e vlerës së qirasë mujore për ndërtesën dhe sipërfaqen funksionale që jepet me qira, e përcaktuar si sipërfaqe funksionale vetëm sipërfaqja e truallit që ndodhet pranë objektit, e cila përdoret për të ushtruar funksionin objekt kontrate. U konstatua nga dokumentet e pronësisë të objektit se “Ish-magazina e statistikës” është godinë njëkatesh, dhe qiraja në këto raste paguhet për sipërfaqen e objektit 1 katësh, por nga konstatimi në terren vëhet re se tarraca e godinës përdoret për shërbim bar-kafe dhe ka një investim të kryer duke vendosur një çadër mbuluese dhe rreth 20 tavolina dhe karrige, gjë që kalon në një ambient të gatshëm dhe të përshtatshëm për shërbim bar-kafe, pra duke i ndryshuar destinacionin, duke e kaluar në një sipërfaqe funksionale të shfrytëzueshme. Gjë e cila ka ndodhur në tarracën e godinës njëkateshe ku ushtrohet shërbim bar – kafe, duke pasur parasysh anën ekonomike të tij.

-Çmimi i kontratës së qirasë me bankën C. është po i njëjti dhe nuk ka ndryshuar me ndryshimin e çmimeve të reja, por shprehet se është vendosur në bazë të kontratave të mëparshme.

Nga auditimi u konstatua se rritja e çmimeve të qirasë aplikuar nga QSUNT nuk është në të njëjtin nivel për të gjitha subjektet qiramarrëse. Për kontratat shumëvjeçare mbi 200m², vlera e

qerasë nuk është rritur për kontratën me bankën “C.”, shpk duke qëndruar vlera e njëjtë që në lidhje të kontratës. Veprime në kundërshtim me nenin 2, VKM Nr.354 të datës 11.05.2016 dhe VKM 54 dt..05.02.2014 i ndryshuar, kapitulli III.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 307-323 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

51.1. Rekomandimi: Struktura përgjegjëse të angazhohet për analizimin dhe rishkrimin e çmimit të qirave në mënyrë të drejtë me vlerën dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira, sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë

52. Gjetje nga auditimi: Nuk ka kontratë qiraje të lidhur mes “A.” shpk dhe QSUNT-në, pavarësisht se shlyhen detyrimet financiare për ambientin e kuzhinës 1090 m² të marrë me qira. Shoqëria “A.” shlyhen detyrimet referuar kontratës së mëparshme e cila është (rinovim) e datës 16.11.2011 me Nr.5075 prot., të cilës i ka mbaruar afati dhe nuk administrohen dokumente të tjera.

-Ky fakt nuk është konstatuar në asnjë nga akt monitorimet dhe nuk ka gjurmë dokumentacioni të jetë përcjellë te titullari i institucionit dhe as të jenë ndërmarrë masa për rinovim kontrate. Nuk ka gjurmë dokumentacioni për të marrë masa për lidhjen e kontratës së qirasë. Për sa kohë nuk ka një kontratë në fuqi nuk mund të ketë një marrëdhënie juridiko- civile mes palëve. Veprime në kundërshtim me VKM 54, kapitulli I pika g) dhe LPP 162/2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 307-323 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

53.1. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për lidhjen menjëherë të kontratës së qirasë me operatorin ekonomik “A.” shpk, për shfrytëzimin e ambienteve të kuzhinës.

Menjëherë

53. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi QSUNT nuk ka një listë investimesh prioritare për vitin 2021 dhe 2022 për sipërfaqen 10457 m² parking në oborin e brendshëm të QSUNT-së, përveç një liste investimesh të vitit 2019. Nuk ka përmirësim të infrastrukturës së jashtme urbane dhe pritëse detyrim i përcaktuar në akt marrëveshjen Nr.1242/41 prot., datë 16.11.2018, amenduar me Nr.884/2 prot datë 12.04.2022. Në nenin 3, të kësaj aktmarrëveshje shprehet se pala e parë e cila është QSUNT, përgatit në periudhën nëntor-dhjetor para çdo fillim viti një listë investimesh prioritare dhe pas me pas miratohet nga MSHMS. Për periudhën objekt auditimi, QSUNT nuk ka një listë emërore me targat përkatëse të automjeteve për personat të cilët do të përfitojnë shërbim/pagesë të reduktuar (stafin mjekësor dhe operatorët ekonomikë) që bashkëpunojnë me QSUNT-në për të përfituar pagesë të reduktuar, kjo në kundërshtim me nenin 2 në akt-marrëveshjen Nr.1242/41 prot., datë 16.11.2018 dhe amendimin e saj me Nr. 884/2 prot., datë 12.04.2022.

-Për çdo vit si, dhe gjatë vitit ushtrimor, nëse ka ndryshime duhet, patjetër të përcaktohen palët e treta dhe operatorët të cilët kanë bashkëpunim më QSUNT dhe banorët të cilët kanë akses brenda territorit të palës së parë të akt-marrëveshjes do të kenë sistem të diferencuar dhe do të favorizohen në pagesë. Kjo listë vendoset në dispozicion nga DSHM pranë QSUNT dhe i dërgohet A. , po ashtu për të dy vitet objekt auditimi, si 2021 dhe 2022 nuk gjenden gjurmë dokumentacioni që është dërguar një listë dhe të jetë aprovuar nga të dy palët.

Menaxhimi i parkimit të makinave funksionon në të gjithë territorin e spitalit të mbuluar nga politika menaxheriale 24/7. Parkimi menaxhohet nga njësia e menaxhimit të parkimit A. pranë QSUNT-së. Vjelja e të ardhurave bëhet në mënyrë të njëanshme nga A. dhe në fund të çdo 3 mujori bëhet rakordimi në bazë të dokumentacionit/kupon tatimor që paraqet A.. Veprime në kundërshtim me VKM Nr.688, datë 14.11.2018, i ndryshuar, akt-marrëveshjen Nr.1242/41 prot.,

datë 16.11.2018 dhe amendimit të saj me Nr.884/2 prot datë 12.04.2022.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 307-323 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

53.1. Rekomandimi: Nga drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të ngritur një grup pune, për vlerësimin e investimeve të kryera në aktivet afatgjata/ambientet të dhëna me qira. Të hartohet lista e investimeve prioritare në akt-marrëveshjen e parkimit, e cila ka si qëllim kryesor një shërbim sa më cilësor ndaj pacientëve, si dhe lista emërore me targat përkatëse të automjeteve për personat të cilët do të përfitojnë shërbim/pagesë të reduktuar (stafin mjekësor dhe operatorët ekonomikë) që bashkëpunojnë me QSUNT për të përfituar pagesë të reduktuar. Ndërmjet A. dhe QSUNT-së duhet të mundësohet një sistem i përbashkët kontrolli mbi numrin e automjeteve që parkojnë, përveç deklaratimit që A. bën tek QSUNT e si rrjedhojë QSUNT të marrë siguri të mjaftueshme lidhur me numrin e saktë të automjeteve që hyjnë në parkim.

Brenda 31.03.2024

54. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: *“Sigurimi i ageve të skleroterapisë për trajtimin e pacientëve me hemorragji digjестive dhe ageve të biopsisë për diagnozën e pacientëve me patologji të traktit tretës, si dhe materiale mjekësore për endoskopi”* është tejkalluar afati i vlerësimit të ofertave deri në njoftimin e fituesit. Dorëzimi i ofertave nga OE është bërë në datë 12.01.2021, ndërkohë që njoftimi i fituesit është bërë në datë 20.04.2021. Vlerësimi i ofertave nuk duhet të kalojë 15 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla. Për këtë vonesë KVO ka hartuar procesverbalin për shtyrje afati me arsyetimin se anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave janë të angazhuar edhe në detyra të tjera institucionale.

Në procedurën e prokurimit *“Furnizim Vendorsje për skanerat e prodhuesve GE”* ka një tej zgjatje të procedurës pavarësisht nevojave emergjente dhe është zgjatur pothuajse 6 muaj. Procedura e prokurimit nga AK është filluar në mars të vitit 2022 dhe finalizohet në muajin gusht të vitit 2022. Pra nuk justifikohet nevoja emergjente për kryerjen e këtij prokurimi me tej zgjatjen në kohë. Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 82, Kodi i Procedurës Administrative, neni 92 dhe neni 91 dhe Rregullat e LPP 162/2020 dhe VKM nr.285.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

54.1. Rekomandimi: AK të marrë masa për parashikimin dhe kryerjen në kohë të procedurave të prokurimit që lidhen me kujdesin shëndetësor të pacientëve me qëllim diagnostikimin në kohë të sëmundjeve dhe shmangien e procedurave të tjera emergjente për plotësimin e nevojave me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

55. Gjetje nga auditimi: Në procedurën *“Sigurimi i ageve të skleroterapisë për trajtimin e pacientëve me hemorragji digjестive dhe ageve të biopsisë për diagnozën e pacientëve me patologji të traktit tretës, si dhe material mjekësore për endoskopi”*, nuk është argumentuar nevoja e mallit që prokurohet. Konkretisht, në hartimin e nevojave nga Shërbimi i Kirurgjisë së Përgjithshme dhe nga Shërbimi i Gastro-Entero-Hepatologjisë nuk shprehet qartë sasia e nevojshme për zhvillimin e procedurës së prokurimit. Farmacia qendrore nga informacioni i kërkuar konfirmon se gjendja ka qenë “0” por nuk është evidentuar se për cilën kategori nga këto materiale mjekësore, e po ashtu nuk dihet numri i daljeve të materialeve mjekësore që ka bërë për shërbimin e kirurgjisë së përgjithshme dhe shërbimin e Gastro-Entero-Hepatologjisë, me qëllim planifikimin e saktë të nevojave. Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 2, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

55.1.Rekomandimi: AK të marrë masa për evidentimin, argumentimin dhe planifikimin e nevojave për materialet mjekësore, me qëllim trajtimin e pacientëve në kohë me cilësi dhe kryerjen e prokurimit me efektivitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

56. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të “Blerje të sistemeve të transfuzionit të gjakut”, gjatë shqyrtimit të urdhër shpenzimeve, konkretisht ato me Nr. 385 datë 09.03.2021, në bazë të kontratës me Nr.201/7 datë 09.02.2021. Fletëhyrje në magazinë në datë 10.02.2021, ku janë blerë gjithsesi 11,000 copë. Gjithashtu urdhër shpenzimi Nr. 1658 datë 27.07.2021, në bazë të kontratës së furnizimit me Nr. 201/12 më datë 05.07.2021. Fletë hyrje në farmacinë qendrore me datë 05.07.2021 ku janë blerë gjithsesi 16,000 copë. Njësitë totale të cilat janë 27,000 sisteme të transfuzionit të gjakut, duke mbetur kështu gjendje 10,390 sisteme në datën 01.10.2021. Pra nevoja gjatë një viti ka qenë 16,610 sisteme të transfuzionit të gjakut, kjo shifër duke ju referuar prokurimi të mallit dhe gjendjes në magazinë.

Procesverbali i argumentimit të nevojave nuk sqaron se sa është kërkesa mesatare e konsumit mujor nga pavijonet përkatëse. Ndërkohë që nga konstatimi gjendjes reale të këtij malli në magazinën qendrore të QSUNT nuk përputhen tendencat për nevojën e këtij malli me sasinë që kërkohet të prokurohet. Ka diferenca të theksuara, në rritje ndërmjet sasisë që prokurohet dhe konsumit real të mallit. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” neni 21.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

56.1.Rekomandimi: QSUNT, strukturat e prokurimit, të marrin masa për argumentimin e saktë e nevojave të sistemeve të transfuzionit të gjakut referuar konsumit të vitit të mëparshëm, me qëllim plotësimin e nevojave të PAI-t përkatës dhe arritjen e një prokurimi me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet duke respektuar parimin e konkurrencës.

Në vijimësi

57. Gjetje nga auditimi: Në kontratën e shërbimit Nr.173/21 të datës 01.02.2021, pra kontratës 11 mujore të mirëmbajtjes të skanerëve GE me operatorë ekonomikë “M. ”, me vlerë 17,483,868 me TVSH në procesverbalet e mbajtura për shërbimin e mirëmbajtjes së skanerëve mungojnë specifikimet se cilat janë pjesët e skanerit që janë mirëmbajtur, sipas veçorive që ato kanë dhe cili skaner është mirëmbajtur sipas kushteve të kontratës. Në këtë mënyrë nuk mund të evidentohen pjesët mjekësore të cilat janë mallra konsumi dhe lind nevoja e zëvendësimit. Gjithashtu, shumica e procesverbaleve nuk janë të shoqëruar me formularin e mirëmbajtjes dhe nuk janë absolutisht të qarta se për cilin skaner janë bërë mirëmbajtjet preventive dhe korrigjuese.

-Mungon dokumentacioni justifikues nëse skanerët janë transferuar në një PAI tjetër dhe për shkaqe të tilla nuk kanë punuar, në këto kushte rezulton se kontrata nuk është realizuar brenda afateve të përcaktuara ose nuk është zbatuar.

-QSUNT nuk ka marrë masa për një procedurë prokurimi mirëmbajtje, me qëllim vazhdimin e punës së skanerëve në shërbim të pacientëve dhe mirë menaxhimin e fondeve publike, duke mos lejuar mbivendosjen në kohë të procedurave të prokurimit. Veprime në kundërshtim me udhëzimin Nr. 2, datë 18.03.2022, “Mbi raportimin e zbatimit të kontratës”, neni 124 LPP, udhëzimi 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 54 dhe Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 124.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

57.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse për zbatimin e kontratave të marrin masa për hartimin e procesverbaleve të kryerjes së shërbimit, duke përcaktuar të gjitha shërbimet e kryera sipas llojit të skanerit.

Në vijimësi

58. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimi Nr.1852, datë 24.08.2021 me vlerë 5,029,781 lekë, është likuiduar fat.73/2021, datë 30.07.2021, e cila i referohet kontratës së shërbimit Nr.173/21 të datës 01.02.2021, pra kontratës 11 mujore të mirëmbajtjes të skanerëve GE.

-Situacioni i punimeve dhe procesverbali i mirëmbajtjes funksionale i përkasin kontratës së shërbimit Nr.173/36 , datë 04.02.2021, mirëmbajtje që i janë faturuar kontratës së shërbimit të prodhuesve GE, në fakt është bërë për aparaturat EMG të prodhuesit “M.”, pajisjet e endoskopisë të prodhuesit “K.S.”, pajisje Fibroscan me prodhues “E.” dhe hidroklave me prodhues “Hidroklave”. Ndërkohë që procesverbali bashkëlidhur urdhër shpenzimit i mbajtur nga drejtoria e IT-së dhe e Inxhinierisë Klinike në datën 28.07.2021 për periudhën 02.04.2021 deri më 01.07.2021, ku shprehet se punimet janë kryer brenda afateve kohore dhe kushteve të kontratës dhe në prani të inxhinierëve të IK për të 3 skanerët GE, është firmosur nga Drejtori i IT dhe IK dhe përfaqësuesi i “M.”. Veprime në kundërshtim me udhëzimin 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 54 dhe LPP 162/2020, neni 124.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

58.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit Financiar të marrë masa që çdo urdhër-shpenzim të plotësohet me dokumentacion justifikues referuar kontratës së nënshkruar nga palët duke respektuar objektin, afatet, vlerën dhe llojin e shërbimit të kryer.

Në vijimësi

59. Gjetje nga auditimi: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” nuk ka zbatuar dhe realizuar në mënyrë të plotë rekomandimet e KLSH-së, të lëna në auditimet e mëparshme. KLSH-ja me shkresë Nr. 893/35 prot, datë 09.01.2023 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të mëparshme”, ka lënë 70 rekomandime, përkatësisht 31 masa organizative, 3 masa për shpërblim dëmi, 5 masa për menaxhimin me Efektivitet dhe Ekonomicitet të Fondeve Buxhetore dhe 31 masa disiplinore. Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve rezultoi si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 31 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 15 zbatuar, 16 në proces zbatimi.

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 masë shpërblim dëmi, nga ku rekomandimet janë pranuar plotësisht dhe statusi ecurisë së zbatimit rezulton: 3 në proces zbatimi.

c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 5 Masa për menaxhimin me Efektivitet dhe Ekonomicitet të Fondeve Buxhetore nga të cilat 1 është zbatuar, 4 në proces zbatimi.

d) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 31 masë disiplinore nga të cilat: 24 rekomandime janë drejtpërdrejt për QSUNT-në nga të cilat 2 janë zbatuar dhe 22 në proces zbatimi dhe 7 rekomandime rekomanduar për APP-në kanë statusin e ecurisë së zbatimit pa zbatuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 335-348 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

60.1 Rekomandim: Nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” të merren masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilat nga ky auditim rezultuan të pazbatuara dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi.

Menjëherë e në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

1. Gjetje nga auditimi: Agjencia Shtetërore e Blerjeve të Përqendruara me shkresën Nr. 119/26 prot., datë 15.07.2022, protokolluar me Nr. 35/33 prot., datë 15.07.2022, ka njoftuar Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza"(QSUNT) Tiranë për lidhje kontrate, për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyresh", me afat të marrëveshjes 1 vit, me fond limit 147,864,531 lekë pa TVSH.

Nga verifikimi fizik i kryer në Spitalin A2 (Urgjenca), më datë 27 dhe 28.03.2023, në prani të përgjegjësit të Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore dhe specialistit /inxhinier biomedikal të Sektorit të Inxhinierisë Klinike, u konstatua se në 1,312 copë për 6 artikuj në vlerën 25,605,000 lekë me TVSH nuk janë zbatuar specifikimet teknike, si dhe mobiljet janë të pashoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat.

Për pasojë, ***vlera 25,605,000 lekë për Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" dhe buxhetin e shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria "R.A." sh.p.k.***

Veprime në kundërshtim me:

-Marrëveshjen kuadër të lidhur me Nr. 7/26 prot., datë 17.07.2020, ndërmjet QSUNT-së dhe operatori ekonomik "R.A." shpk.

-Kontratën e furnizimit Nr. I, lidhur me Nr. 62/127 prot., datë 16.08.2022 ndërmjet QSUNT-së të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë "R.A." Shpk në vlerën 59,736,000 lekë me TVSH, neni 5.

-Kontratën e furnizimit II, lidhur me Nr. 62/142 prot., datë 22.08.2022 ndërmjet QSUNT-së të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë "R.A." shpk në vlerën 81,970,200 lekë me TVSH, neni 5.

-Kontratën e furnizimit III, lidhur me Nr. 62/166 prot., datë 30.09.2022 ndërmjet QSUNT-së të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë "R.A." shpk në vlerën 59,736,000 lekë me TVSH.

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 122.

-Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690.

-Deklaratën datë 03.05.2022 mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik "R.A." shpk.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i **vlerës 25,605,000 lekë** nga shoqëria "R.A." shpk. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, si pasojë e moszbatimit të specifikimeve teknike në kontratën "Mobilimi i Spitalit të Ri të Ndërtuar (A2), me fond limit 147,864,531 lekë pa TVSH.

Brenda datës 31.03.2024

2. Gjetje nga auditimi: Për furnizim, vendosje të aparaturave mjekësore për Spitalin e Ri të ndërtuar (A2), loti 10, viti 2022, është lidhur kontrata me Nr. 64/124 prot., datë 26.07.2022, ndërmjet QSUNT-së të përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm dhe shoqërisë "B.A." Shpk në vlerën 23,064,000 lekë me TVSH.

Nga verifikimi fizik i kryer në Spitalin A2 (Urgjencës), më datë 27 dhe 28.03.2023, në prani të E.N. me detyrë përgjegjës i Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore

dhe E.K. me detyrë specialist/ inxhinier biomedikal i Sektorit të Inxhinierisë Klinike, u konstatua se 130 shtretër pacienti me kontroll manual për vlerën 10,400,000 pa TVSH, ose 12,480,000 lekë me TVSH, ***nuk janë të rinj, por të përdorur.***

Pajisjet/shtretërit janë të pashoqëruar me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test-raportin e fabrikës). Veprime në kundërshtim me:

-Kontratën me Nr. 64/124 prot., datë 26.07.2022, ndërmjet QSUNT-së të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë “B.A.” shpk në vlerën 23,064,000 lekë me TVSH, neni 5.1.

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 122 “Rregullat që zbatohen për kontratën”, pika 1.

-Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690.

-Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1.

-Deklaratën datë 18.10.2021 mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik “B.A.” shpk.

Vlera 12,480,000 lekë përbën dëm ekonomik për QSUNT-në dhe buxhetin e shteti dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria “B.A.” shpk.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i **vlerës 12,480,000 lekë** nga shoqëria “B.A.” shpk. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, si pasojë e moszbatimit të specifikimeve teknike në kontratën “Mobilimi i Spitalit të Ri të Ndërtuar (A2), me fond limit në vlerën 147,864,531 lekë pa TVSH.

Brenda datës 31.03.2024

3. Gjetje nga auditimi: Furnizim vendosje të pajisjes mjekësore për Spitalin e Ri “Kabineti i Endoskopisë”, viti 2022.

Kontrata është lidhur me Nr. 1387/28 prot., datë 18.10.2022, ndërmjet QSUNT sha të përfaqësuar nga znj.A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “A., Shpk përfaqësuar nga administrator znj.E.Xh. për vlerën 17,184,000 lekë me TVSh, me afat të zbatimit të kontratës afat 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Pjesët përbërëse të pajisjes të paraqitura në ofertën teknike kanë ardhur në Republikën e Shqipërisë dhe regjistruar në QKBPM, secila më vete në data dhe vite të ndryshme nga viti 2021-2022, me prodhues të ndryshëm dhe operatorë të ndryshëm, çka dëshmon se pajisja është asambluar në Shqipëri. Procesimi/mbledhja (asamblimi) në një pajisje është bërë nga shoqëria “A.” Sh.p.k e cila nuk e ka tagrin ligjor/teknik për ta kryer këtë asamblim, referuar pikës 13.6.4 të VKM Nr. 731, datë 2.9.2015 “Për miratimin e rregullit teknik” Për Kërkesat Thelbësore, Vlerësimin e Konformitetit. Asamblimi, i pajisjes Videoendoskop, si dhe mosmbajtja e raportit të instalimit, funksionimit dhe trajnimit të stafit mjekësor, jo vetëm është shpenzim që nuk ia ka arritur qëllimit, por është risk i lartë për kryerjen e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për jetën e pacientëve.

Pajisjet janë të pashoqëruara me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test-raportin e fabrikës).

Vlera 17,184,000 lekë përbën dëm ekonomik për QSUNT-në dhe Buxhetin e Shteti dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria “A.” sh.p.k. Ndërsa dëmi shëndetësor ndaj pacientëve është i pallogaritshëm (pra shumë herë më i madh), pasi shërbimi ndaj pacientëve me këtë pajisje të

asambluar në Shqipëri nga persona të palicensuar, pajisje pa kalibruar, pa raport instalimi dhe funksionimi, pa raport trajnimi për personelin, pa manuale shërbimi dhe përdorimi, pa raportet e testeve (test-raportin e fabrikës) është me risk të lartë për shëndetin e pacientëve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **17,184,000 lekë** nga shoqëria “A.” Sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, pasi pajisja është asambluar në Shqipëri. Procesimi/mbledhja (asamblimi) i pjesëve në një pajisje është bërë nga një shoqëri e pa certifikuar/licencuar për këtë qëllim.

Brenda datës 31.03.2024

4. Gjetje nga auditimi: Zhvillimi i procedurës së prokurimit kërkesë me propozim me objekt “F. v kokë goditëse për pajisjen mjekësore ESWL, prodhuesi S.M./ekuivalent”, me REF -84075-01-14-2021, viti 2021, kontraktuar dhe likuiduar për vlerën **6,886,800 lekë** shkakton mbivendosje (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e mirëmbajtjes në vlerën 5,636,219.18 lekë me TVSH, e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik “M.” shpk dhe QSUNT me numër prot., 173/36 datë 04.02.2021, ku specifikohet në termat e referencës se: “Operatori ekonomik fitues do të kryejë mirëmbajtje full risk, mirëmbajtja parandaluese/ preventive e pajisjeve mjekësore, mirëmbajtja korrigjuese e pajisjeve mjekësore, furnizim me pjesë këmbimi dhe aksesore, inspektimi i sigurisë së pajisjeve mjekësore”.

Për veprimin e mësipërm është shkelur koncepti i “Bëgatimit pa shkak”, i ardhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të personave të përfshirë në këtë proces me përfitues padrejtësisht shoqërinë “M.” sh.p.k në vlerën 6,886,800 lekë. Referuar Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 655, “Bëgatimi pa shkak”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të bëgatimit”.

Vlera 6,886,800 lekë përbën dëm ekonomik për QSUNT-në dhe buxhetin e shteti dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria “M.” shpk.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **6,886,800 lekë** nga shoqëria “M.” Sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, pasi shkakton mbivendosje, (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e mirëmbajtjes në vlerën 5,636,219.18 lekë me TVSH, e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik “M.” shpk dhe QSUNT me numër prot., 173/36 datë 04.02.2021.

Brenda datës 31.03.2024

5. Gjetje nga auditimi: Zhvillimi i procedurës së prokurimit kërkesë me propozim me objekt “F. V kokë goditëse për pajisjen mjekësore ESWL, prodhuesi S.M./ekuivalent”, me REF 42106-09-16-2022, viti 2022, kontraktuar dhe likuiduar për vlerën 3,443,400 lekë shkakton mbivendosje (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e mirëmbajtjes në vlerën 3,074,122 lekë me TVSH, e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik “M.” shpk dhe QSUNT-së me numër prot., 581/28 date 01.03.2022, ku specifikohet në termat e referencës se: “Operatori ekonomik fitues do të kryejë mirëmbajtje full risk, mirëmbajtje parandaluese/preventive e pajisjeve mjekësore, mirëmbajtje korrigjuese e pajisjeve mjekësore, furnizim me pjesë këmbimi dhe aksesore, inspektim i sigurisë së pajisjeve mjekësore”.

Për veprimin e mësipërm është shkelur koncepti i “Begotimit pa shkak”, i ardhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të personave të përfshirë në këtë proces me përfitues padrejtësisht shoqëria “M.” Sh.p.k në vlerën 3,074,122 lekë. Referuar Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 655 “Begotimit pa shkak”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të begotimit”.

Vlera 3,443,400 lekë përbën dëm ekonomik për QSUNT-në dhe buxhetin e shteti dhe duhet të dëmshpërblehet, nga shoqëria “M.” shpk.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **3,074,122 lekë** nga shoqëria “M.” shpk . Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, pasi shkaktonte mbivendosje (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik “M.” shpk dhe QSUNT-së me numër prot., 581/28, datë 01.03.2022.

Brenda datës 31.03.2024

6. Gjetje nga auditimi: Nga inventarizimi në Polin e Administrimit të Spitalit Polivalent janë konstatuar 192 aktive të munguara në vlerën 21,885,993 lekë. Referuar raportit përmbledhës të inventarit me shkresën Nr.2450/8, datë 30.12.2022, “Mbi rezultatet për inventarizimin e aktiveve të QSUNT-së”, grupi i inventarizimit i përbërë nga E.T., E.K., M.R., E.B., A.K., deklaroi se janë gjetur dyert e hapura me dhunë (të dëmtuara) dhe një pjesë e aktiveve nuk janë gjetur. Drejtori i Përgjithshëm, në zbatim të kompetencave dhe detyrimeve ligjore që janë përcaktuar në statut, si dhe të legjislacionit specifik për administrimin e pronës shtetërore, ***nuk ka marrë asnjë masë për sa i përket denoncimit të aktit në organet kompetente (prokurori, polici etj.), nxjerrjes së përgjegjësive për aktivet e humbura, si dhe dëmshpërblimin e vlerës 21,885,993 lekë për 192 aktivet e humbura.*** Drejtori i Përgjithshëm i është drejtuar policisë së shtetit 4 muaj me vonësë, në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 8, udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 93 (më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 131-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Bordi i spitalit të analizojë vlerën **21,885,993 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me 192 aktive të munguara në Polin e Administrimit të Spitalit Polivalent, si dhe të evidentohen përgjegjësitet e të merret vendimi përkatës për zhdëmtim, vlerë e cila për QSUNT-në dhe buxhetin e shtetit përbën dëm ekonomik.

Brenda datës 31.03.2024

7. Gjetje nga auditimi: QSUNT ka lidhur kontratë . 543/4 prot, datë 27.01.2020 me shoqërinë “A.” shpk me objekt “Për ofrimin e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavijonet e QSUNT-së për 30.05 ditë/muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, me të drejtë rinovimi automatikisht çdo muaj deri në lidhjen e kontratës bazë” në vlerën 26,738,538.88 lekë me TVSH. Grupi i auditimit përzgjedhi 11 materiale të buta për t’i peshuar, nga 15 materiale në total për shërbimin e lavanterisë nga ku krahasuar peshave për të cilat QSUNT paguan referuar stacioneve të firmosura nga OE “A.” u konstatuan diferenca në peshë për 5 materiale. Referuar situacioneve mujore, grupi i auditimit për çdo muaj për periudhën

objekt auditimi kreu llogaritjen e tyre sipas peshave faktike, nga ku u konstatua se për periudhën prill-dhjetor 2021, OE "A." shpk është likuiduar në vlerën 193,300,331.07 pa TVSH, ndërkohë që referuar peshave reale duhej të likuidohej në vlerën 189,622,252.16 lekë, më një diferencë prej 3,678,078.91 lekë ose 4,413,693.82 lekë me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik për QSUNT-në dhe buxhetin e shtetit.

Për vitin 2022, OE "A." shpk është likuiduar/paguar në vlerën 259,913,157.42 lekë pa TVSH ndërkohë që referuar peshave reale duhej të likuidohej/paguhej në vlerën 254,397,274.03 lekë, më një diferencë prej 5,515,883.39 lekë pa TVSH ose 6,619,060.07 me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik për QSUNT-në dhe buxhetin e shtetit.

OE "A." shpk për periudhën objekt auditimi ka përfituar pa të drejtë në total vlerën 9,193,961.57 lekë ose 11,032,753.88 lekë me TVSH, duke shkaktuar dëm për QSUNT-në dhe buxhetin e shtetit. Veprime në kundërshtim me kontratën Nr.543/4, datë 27.01.2022, neni 3, Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 122, Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690, Deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik "A." shpk, udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik", me ndryshimet vijuese të tij.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **11,032,753.88 lekë** nga shoqëria "A." shpk . Kjo vlerë është përfituar padrejhtësisht nga kjo shoqëri, si pasojë e diferencës së peshave të materialeve të buta të paguara me ato faktike.

Brenda datës 31.03.2024

8. Gjetje nga auditimi: Në datë 12 maj 2022, në PAI-n e Qendrës së Konsultave Ambulatore, u transferua nga PAI i Spitalit Infektiv, aparatura e elastografisë në vlerë 14,140,000 lekë. Më datë 20 korrik nga PAI i Spitalit Infektiv është sjellë në PAI-n e Konsultave Ambulatore një sondë, e cila nuk ka lidhje me sondën e inventarizuar të kësaj pajisje. Fakt i konstatuar në datë 9 gusht nga "B.", me interpretimin se sonda e sjellë nuk është ajo e inventarit bazuar në numrin serial dhe datën e kalibrimit të realizuar të prodhuesit, me Mirëmbajtjen Preventive 2021. Në lidhje me këtë çështje, znj. R.G. me detyrë administratore e PAI-t të Konsultave ka deklaruar/sqaruar se momentalisht aparatura elastografi në vlerën 14,1140,000 lekë është e vetmja në QSUNT si dhe rajon, e cila shërben për të nxjerrë analizat e funksionimit të mëlçisë, kryesisht për pacientët me Hepatit B dhe C, aparaturë së cilës i është vendosur një sondë tjetër dhe kjo duke mos qenë sonda e saj, aparatura shpesh herë kërkon kalibrimin e pajisjes. Referuar pikës 13.6.4 të VKM Nr. 731, datë 2.9.2015, "Për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat thelbësore, vlerësimin e konformitetit, klasifikimin dhe markimin të pajisjeve mjekësore" kalibrimi i pajisjeve mjekësore, është i detyrueshëm për të siguruar dhe vërtetuar se rezultatet të cilat vijnë nga këto pajisje janë të sakta dhe të sigurta.

Modifikimi i pajisjes mjekësore me sondë tjetër, jo bashkëkohore në përshtatje të plotë me specifikat teknike të pajisjes së elastografisë, jo vetëm është shpenzim i tepër, por është risk i lartë për kryerjen e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për jetën e pacientëve.

Përpos sa më sipër, transferimi i aparaturës së elastografisë është bërë jo vetëm i mangët, por edhe me tre muaj me vonesë, duke shkaktuar kështu mosdhënien e shërbimit për pacientet për tre muaj radhazi (shërbim i llojit të veçantë). Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe

Neni 8, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 93.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4, faqe 131-178, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Bordi i Spitalit të analizojë **vlerën 14,140,000 lekë**, e cila ka të bëjë me diferencë inventari (sondë) të pajisjes së elastografisë në PAI-n e Qendrës së Konsultave Ambulatore, jo vetëm që modifikimi me sondë tjetër është shpenzim i tepër, por është risk i lartë për kryerjen e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për jetën e pacientëve. Të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për zhdëmtim, vlerë e cila për QSUNT-në dhe buxhetin e shtetit përbën dëm ekonomik. Dëmi shëndetësor është i pallogaritshëm, pasi nuk u është dhënë shërbimi për tre muaj pacienteve me diagnozë (Hepatit B & C), por prej datës 21.08.2022 e në vazhdim, analizat e kësaj pajisjeje janë të pasigurta pasi nuk është kryer kalibrimi i kësaj pajisjeje (pas vendosjes së sondës së re).

Brenda datës 31.03.2024

C. MASA PËR ELEMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:

1. Gjetje nga auditimi: Ndërtesa e Pediatriës Infektive, përbëhet nga 3 kate mbi tokë dhe një gjysmë kati teknik mbi soletën e katit të fundit me lartësi 1.95 m, duke krijuar një interkapet mes tarracës dhe katit të dytë. Spitali i Pediatriës Infektive ka një lartësi kati prej 3.25 m dhe arrin një sipërfaqe totale ndërtimi 3,191 m²: Kati përdhes 1,075 m², kati i parë 1,058 m², kati i dytë 1,058 m². Referuar situatës së tërmetit të 26.11.2019, nga analiza e grupit të projektuesve pas situatës së tërmetit, vihen re dëmtime në muraturë kryesisht në katin e dytë të godinës të cilat vijnë si pasojë e dëmtimeve në strukturat konstruktive të mureve mbajtëse perimetrale dhe plasaritje të lehta në suvanë e jashtme dhe të dukshme në rifiniturat e brendshme. Kati i fundit i godinës është i evakuar, për çështje sigurie ky kat është i boshatisur.

Në kushtet e emergjencës për vazhdimin e funksionimit të tij, projektuesi ka rekomanduar puntelimin dhe nxjerrjen nga puna të komplet katit të dytë teknik të objektit. Në mënyrë që të zgjidhen problematikat kryesore të ndërtesës, opsioni përfundimtar i sugjeruar nga projektuesi për Spitalin e Pediatriës së Përgjithshme parashikon zgjatjen e jetëgjatësisë së *objektit ekzistues deri në 2-3 vjet* dhe më vonë ndoshta rikonceptimi i një objekti të ri, i cili do të zhvillohet në prishjen e objektit ekzistues dhe ndërtimi i një objekti të ri të Spitalit të Pediatriës së Përgjithshme me parametra bashkëkohore.

Oponenca teknike e realizuar nga Instituti i Ndërtimit, me Nr. 1190/2 prot., datë 06.06.2020, është kontradiktore, ka paqartësi ose mos dhënie e përfundimeve të sakta të oponencës teknike. MSHMS nuk ka vlerësuar drejt investimin e rikonstruksionit të një objekti ekzistues, pa marrë masa përforcuese dhe ndërhyrjet e duhura strukturore, duke e lënë katin e dytë të mbështetur në puntela dhe një investim për një periudhë shfrytëzimi prej 2 vitesh, ç’ka do të thotë që për një vit Buxheti i Shtetit ka paguar 13,319,442 lekë me TVSH (26,638,885 lekë me tvsh / 2) ose për 2 vite 26,638,885 lekë me TVSH, në një kohë kur ky projekt është hartuar në kundërshtim me Kushtet teknike të Projektimit KTP dhe zbatimit KTZ, miratuar me VKM Nr. 68, datë 15.2.2001, “Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit” si dhe Leja e ndërtimit Nr. 14544/4 datë 04.08.2021, është dhënë në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

Kontradiktore është dhe Bashkia Tiranë, pasi pas 3 herë aplikim dhe refuzim të lejes së ndërtimit, në përfundim merret vendimi 14544/4, datë 04.08.2021, ku miratohet leja e ndërtimit. Miratimi i lejes së ndërtimit, pas 3 refuzimesh dhe më pas miratohet, kur projekti i rikonstruksionit nuk ka pësuar ndryshime apo korrigjime nga reflektimet e oponencës realizuar nga Instituti i Ndërtimit, bie në kundërshtim me arsyet fillestare të refuzimeve dhe me Ligjin Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Pra, projekti është realizuar në prill 2020, kontrata e zbatimit është nënshkruar në dhjetor 2020 dhe leja e ndërtimit është miratuar në gusht 2021.

Në opinionin e grupit të auditimit, zgjidhja teknike dhe situata aktuale e godinës paraqitet një rrezik shumë të madh në rast të një tërmeti tjetër brenda një periudhe dyvjeçare (e cila ka kaluar), ku ambienti shfrytëzohet për hospitalizimin e fëmijëve. Gjithashtu, zgjidhja e dhënë në projekt me puntelimin e katit të fundit nuk zgjidh ose përforcon muret perimetrale mbajtës, të cilët kanë pasur shkëputje në një zonë me muret ndarës të brendshme. Pra ky investim nuk ka arritur zgjidhjen e qëndrueshmërisë së godinës edhe në rastin e menduar prej 2 vitesh me puntela (ku mbahet soleta), ku nuk është menduar zgjidhja e qëndrueshmërisë së mureve perimetrale, çka do të kërkojë rikonstruksionin e plotë të godinës. Pra, buxheti i shtetit/ QSUNT do të harxhojë fonde përsëri që godina të jetë e shfrytëzueshme dhe e sigurt për funksion spitalor. Nga MSHMS dhe nga QSUNT, nuk është parashikuar asnjë Investim për Pediatri të Infektive, për ndërtimin e ndonjë objekti të ri apo edhe për rikonstruksion përfundimtar të godinës së vjetër mbi katin e dytë të mbajtur me puntela provizore.

Referuar sa më sipër, vlera prej 26,638,885 lekë me TVSH për rikonstruksionin e pediatri të Infektive përbën efekt negativ të konstatuar në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 178-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i QSUNT, të prezantohet në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale risku i lartë i qëndrueshmërisë së godinës së Pediatri të Infektive, i ardhur si pasojë e mos korrigjimeve të projektit, duke i kërkuar Ministrisë së linjës të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës për përcaktimin e integritetit strukturor të godinës, si dhe funksionalitetit operacional të saj në shërbim të pacientëve.

Menjëherë

1.2. Rekomandimi: Nga QSUNT dhe MSHMS, në të ardhmen të merren masa që çdo investim të vlerësohet rëndësia e ruajtjes së integritetit strukturor të godinave, duke përcaktuar dhe vlerësuar kapacitetin sizmik dhe metodikat për riaftësimin strukturor të tyre, në mënyrë që të moskeq menaxhohet vlera për investime dhe rikonstruksione të objekteve spitalore.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga inventarizimi në Polin e Administrimit të Spitalit Polivalent janë konstatuar **165 aktive** të papërdorshme, të dëmtuara, për t’u vlerësuar për nxjerje jashtë përdorimit **në vlerën 86,754,536 lekë**. Ky fakt është pasqyruar në raportin përmbledhës të inventarit me shkresën Nr.2450/8, datë 30.12.2022, “Mbi rezultatet për inventarizimin e aktiveve të QSUNT-së”, grupi i inventarizimit. Vlera prej 86,754,536 lekë për 165 aktivet e dëmtuara përbën një shpenzim për të cilin nuk është arritur plotësisht qëllimi i blerjes, pasi nuk janë përdorur deri në amortizimin apo mosfunksionimin plotë të tyre, por janë dëmtuar duke u nxjerrë jashtë funksionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 131-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Bordi i Spitalit të analizojë vlerën **86,754,536 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë 165 aktive të papërdorshme, të dëmtuara, për t'u vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit në Polin e Administrimit të spitalit Polivalent, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për zhdëmtim, vlerë e cila për QSUNT-në dhe buxhetin e shtetit është shpenzim pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet nga QSUNT.

Brenda datës 31.03.2024

Ç. PËR AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe konstatimeve të pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe vërejtjeve, komenteve dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitura nga subjekti i audituar, mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) të Ligjit Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 129 si dhe VKM-së nr.285 ,datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar neni 107, pika 7 dhe 8, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, fillimin e procedimit administrativ, për:

1.Operatorin ekonomik “R.A.” shpk.

Për arsye të mos zbatimit të specifikimeve teknike në kontratën “Mobilimi i spitalit të ri të ndërtuar (A2), në QSUNT”.

Agjencia Shtetërore e Blerjeve të Përqendruara me shkresën Nr. 119/26 prot., datë 15.07.2022, protokolluar me Nr. 35/33 prot., datë 15.07.2022, ka njoftuar Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza"(QSUNT) Tiranë për lidhje kontrate, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyresh”, me afat të marrëveshjes 1 vit, me fond limit 147,864,531 lekë pa TVSH.

Ndërmjet QSUNT-së dhe operatori ekonomik “R.A.” shpk është lidhur Marrëveshja kuadër me Nr. 7/26 prot., datë 17.07.2020.

Nga verifikimi fizik i kryer në Spitalin A2 (Urgjencës), më datë 27 dhe 28.03.2023, në prani të përgjegjësit të Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore dhe specialistit/inxhinier biomedikal të Sektorit të Inxhinierisë Klinike, u konstatua se në 1312 copë për 6 artikuj në vlerën 25,605,000 lekë me TVSH nuk janë zbatuar specifikimet teknike, si dhe mobiljet janë të pashoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat.

Për pasojë, vlera **25,605,000 lekë** për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe buxhetin e shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria “R.A.” sh.p.k.

Veprime në kundërshtim me:

-Marrëveshjen kuadër të lidhur me Nr. 7/26 prot., datë 17.07.2020, ndërmjet QSUNT-së dhe operatori ekonomik “R.A.” shpk.

-Kontratën efurnizimit Nr. I, lidhur me Nr. 62/127 prot., datë 16.08.2022 ndërmjet QSUNT-së të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë “R.A.” shpk në vlerën 59,736,000 lekë me TVSH, neni 5.

- Kontratën e furnizimit II, lidhur me Nr. 62/142 prot., datë 22.08.2022 ndërmjet QSUNT-së të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë “R.A.” shpk në vlerën 81,970,200 lekë me TVSH, neni 5.
- Kontratën e furnizimi III, lidhur me Nr. 62/166 prot., datë 30.09.2022 ndërmjet QSUNT-së të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë “R.A.” shpk në vlerën 59,736,000 lekë me TVSH.
- Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 122.
- Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690.
- Deklaratën datë 03.05.2022 mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik “R.A.” shpk.

2. Operatorin ekonomik “B.A.” shpk:

Për arsye se të mos zbatimit të specifikimeve teknike në kontratën “Mobilimi i spitalit të ri të ndërtuar (A2), në QSUNT.

Për furnizim, vendosje të aparaturave mjekësore për spitalin e ri të ndërtuar (A2), loti 10, viti 2022, është lidhur kontrata me Nr. 64/124 prot., datë 26.07.2022, ndërmjet QSUNT-së të përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm dhe shoqërisë “B.A.” shpk në vlerën 23,064,000 lekë me TVSH.

Nga verifikimi fizik i kryer në Spitalin A2 (Urgjencës), më datë 27 dhe 28.03.2023, në prani të përgjegjësit të Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore dhe specialistit/inxhinier biomedikal të Sektorit të Inxhinierisë Klinike, u konstatua se 130 shtretër pacienti me kontroll manual për vlerën 10,400,000 pa TVSH, ose 12,480,000 lekë me TVSH, ***nuk janë të rinj, por të përdorur.***

Pajisjet/shtretërit janë të pashoqëruar me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test-raportin e fabrikës). Veprime në kundërshtim me:

- Kontratën me Nr. 64/124 prot., datë 26.07.2022, ndërmjet QSUNT-së të përfaqësuar nga A.F. në cilësinë e drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë “B.A.” shpk në vlerën 23,064,000 lekë me TVSH, neni 5.1.
 - Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 122 “Rregullat që zbatohen për kontratën”, pika 1.
 - Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690 .
 - Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1.
 - Deklaratën datë 18.10.2021 mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik “B.A.” shpk.
- Vlera **12,480,000 lekë** përbën dëm ekonomik për QSUNT-në dhe buxhetin e shteti dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria “B.A.” shpk.

3. Operatorin ekonomik “A.” shpk.

Për arsye se të mos zbatimit të specifikimeve teknike në kontratën Furnizim vendosje të pajisjes mjekësore për Spitalin e Ri “Kabineti i Endoskopisë”, viti 2022 në QSUNT.

Kontrata është lidhur me Nr. 1387/28 prot., datë 18.10.2022, ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga znj. A.F. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “A.” shpk

përfaqësuar nga administrator E.Xh. për vlerën 17,184,000 lekë me TVSh, me afat të zbatimit të kontratës afat 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Pjesët përbërëse të pajisjes të paraqitura në ofertën teknike kanë ardhur në Republikën e Shqipërisë dhe regjistruar në QKBPM, secila më vete në data dhe vite të ndryshme nga viti 2021-2022, me prodhues të ndryshëm dhe operatorë të ndryshëm, çka dëshmon se pajisja është asambluar në Shqipëri. Procesimi/mbledhja (asamblimi) në një pajisje është bërë nga shoqëria “A.” Sh.p.k e cila nuk e ka tagrin ligjor/teknik për ta kryer këtë asamblim, referuar pikës 13.6.4 të VKM Nr. 731, datë 2.9.2015 “Për miratimin e rregullit teknik” Për Kërkesat Thelbësore, Vlerësimin e Konformitetit. Asamblimi, i pajisjes Videoendoskop, si dhe mosmbajtja e raportit të instalimit, funksionimit dhe trajnimit të stafit mjekësor, jo vetëm është shpenzim që nuk ia ka arritur qëllimit, por është risk i lartë për kryerjen e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për jetën e pacientëve.

Pajisjet janë të pashoqëruara me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test-raportin e fabrikës).

Vlera **17,184,000 lekë** përbën dëm ekonomik për QSUNT-në dhe Buxhetin e Shteti dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria “A.” sh.p.k. Ndërsa dëmi shëndetësor ndaj pacientëve është i pallogaritshëm (pra shumë herë më i madh), pasi shërbimi ndaj pacientëve me këtë pajisje të asambluar në Shqipëri nga persona të palicensuar, pajisje pa kalibruar, pa raport instalimi dhe funksionimi, pa raport trajnimi për personelin, pa manuale shërbimi dhe përdorimi, pa raportet e testeve (test-raportin e fabrikës) është me risk të lartë për shëndetin e pacientëve

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT